

ENVER HOXHA

VEPRA

41

PROLETARE TE TE GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË
SHQIPÉRISE



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANE KQ TE PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

41

MAJ 1969 — SHTATOR 1969

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1984

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 41-TË

Vëllimi i 41-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përmban materiale të periudhës maj-shtator 1969. Shumica e tyre batohet për herë të parë.

Si një nga detyrat kryesore të shtruara nga Partia, zhvillimi i mëtejshëm dhe i gjithanshëm i ekonomisë gjen pasqyrim të gjerë në faqet e këtij vëllimi. Autori trajton në mënyrë shkencore çështje të industrisë dhe të bujqësisë, duke e konsideruar të domosdoshme mbështetjen fort në të dy këta sektorë. Ndërsa për industrinë thekson nevojën e rritjes së prodhimit nëpërmjet përdorimit më të plotë të aftësive prodhuuese dhe zhvillimit sidomos të industrisë minerare dhe energetike, për bujqësinë vë në dukje rëndësinë e mekanizimit, të bashkimit të kooperativave të vogla në më të mëdha, të organizimit më të mirë të punës. Me orientimet për të shpejtuar ritmet e rritjes së prodhimit bujqësor, Partia dhe shoku Enver Hoxha synonin zbutjen e shpërpjesëtimeve midis bujqësisë e industrisë dhe ngushtimin e dallimeve në nivelin e jetesës midis fshatit dhe qytetit.

Që të drejtohet me plan dhe të ecë përparrë ekonomia, përcaktohet si shumë e nevojshme njohja e politikës së Partisë dhe e ligjeve të zhvillimit ekonomik të socializmit.

Edhe në këtë vëllim shtrohen e zbërthehen probleme të rëndësishme të rritjes së rolit udhëheqës të Partisë, si: forcimi i unitetit në radhët e Partisë, gjallërimi i organizatave-bazë dhe i forumeve, zbatimi i normave leniniste etj. Shoku Enver Hoxha porosít që komunistët të jenë kudo e kurdoherë në ballë, të mendojnë vazhdimisht si ta organizojnë punën më mirë për të plotësuar me sukses detyrat dhe njëkohësisht tërheq vëmendjen për të zbatuar në çdo punë një metodë e stil leninist revolucionar.

Nga fjala në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë «Të vazhdojmë me këmbëngullje dhe në mënyrë metodike edukimin e gjithanshëm të klasës punëtore» dalin detyra të vlefshme për kombinimin e formave dhe të metodave të ndryshme, më të kualifikuara e më revolucionare, për edukimin e punonjësve. Në këtë kuadër i vihet theksi sidomos studimit kolektiv dhe individual të teorisë marksiste-leniniste e të dokumenteve të Partisë sonë.

Edukimi komunist i masave, sidomos i rinisë, lidhet ngushtë me punën e shkollës. Mjaft dokumente të vëllimit dëshmojnë për kujdesin e vazhdueshëm të Partisë e të shokut Enver Hoxha për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës. Si problem parësor përcaktohet gërshtimi i harmonishëm i brendisë së lartë marksiste-leniniste të njohurive teoriko-shkencore, i politikës dhe i ideologjisë, i punës prodhuese, i edukimit fizik e ushtarak dhe i çlodhjes së kulturuar. Mendimet e vlefshme për strukturën e shkollës sonë të re, që dalin nga fjala në Plenumin e 8-të të Komitetit Qendror të PPSH, nga diskutimet në mbledhjet

e Byrosë Politike e nga materiale të tjera, ndihmojnë që shkolla të luajë një rol të fuqishëm për ndërtimin socialist të vendit.

Në këtë vëllim përfshihen edhe fjalimet e mbajtura gjatë vizitave në disa rrethe të vendit. Midis popullit, në mbledhje të organizuara me punonjësit e bazës e në mitingje ku grumbullohen mijëra njerëz, shoku Enver Hoxha bisedon e këshillohet me masat. Ndërmjet të tjerash, ai porosit që çdo mendim e veprim t'i nënshtronhet gjykimit të popullit e të çelikoset më shumë uniteti Parti-popull, për të çuar përparrat fitoret e arritura. Krahas kësaj, tërheq vëmendjen për edukimin e njerëzve, sidomos të brezit të ri, me të kaluarën e lavdishme dhe me traditat e shquara të popullit tonë, me veprën e patriotëve dhe të dëshmorëve. Gjithashtu udhëzon që të vazhdohet lufta kundër zakoneve prapanike e paragjykimeve fetare, si dhe për emancipimin e gruas.

Partia për asnjë çast nuk e ka ulur vigjilencën dhe nuk i ka reshtur përpjekjet për mbrojtjen e vendit nga armiqtë e jashtëm. Vazhdimi i punës për forcimin e mëtejshëm të Ushtrisë sonë Popullore, për edukimin politik, ideologjik e ushtarak të saj e të të gjithë popullit ushtar përbën një nga çështjet e rëndësishme që shtjellohen në materiale. Ndër të tjera shoku Enver Hoxha nën vizion se atdheu mbrohet duke armatosur popullin, duke armatosur Partinë me ideologjinë e vërtetë marksiste-leniniste, me një politikë marksiste-leniniste realiste e kurajoze kundër kujtdo që shkel parimet e marksizëm-leninizmit dhe interesat jetikë të popujve.

Në shkrime të këtij vëllimi pasqyrohet politika e drejtë e Partisë sonë në mbrojtje të proletariatit, të çështjes së revolucionit e të socializmit. Njëkohësisht demaskohet aleanca e zezë amerikano-sovjetike, e cila, vë në dukje autorë, i zgjat thonjtë grabitqarë kudo ku ka konflikte e tensione: në Vietnam apo në Çekoslovakia, në Lindjen e Mesme apo në brigjet e Usurit, në detin Mesdhe apo në atë të Japonisë.

Disa artikuj e materiale të tjera të periudhës tre-gojnë të vërtetën lakuriqe rreth mbledhjes së të ashtu-quajturit forum ndërkontinentar komunist që u zhvillua në Moskë më 5 qershor 1969. Që para se të mbledheshin përfaqësuesit e partive revizioniste në sallën Gieorgievskaja, shoku Enver Hoxha parashikonte se kjo farsë lidhej në mënyrë vendimtare me strategjinë globale dhe me politikën hegemoniste e ekspansioniste të revizionistëve sovjetikë. Synimi kryesor i tyre, shpjegonte ai, është: grumbullimi rreth vetes i gjithë forcave revizioniste, kontrolli i plotë ideologjik, politik e organizativ i frontit revizionist, hedhja e tij në luftë kundër revolucionit e socializmit, kundër partive mark-siste-leniniste.

Mbledhja e Moskës, e nisur nga Hrushovi dhe e përfunduar pas shumë kohësh me mundime të mëdha nga pasardhësit e tij, vuri më në dukje mungesën e ko-hezionit, dezintegrimin dhe përcarjen në frontin revizionist. Si duke e bërë mbledhjen e përgjithshme revizioniste, si duke mos e bërë fare, nxjerr konkluzionin shoku Enver Hoxha, revizionizmi nuk mund t'i shpëtojë falimentimit të pashmangshëm. Në të njëjtën kohë bën të qartë se valës demagogjike revizioniste i duhet

përgjigjur me veprimitari revolucionare nga partitë dhe forcat marksiste-leniniste.

Edhe në këtë vëllim duket qëndrimi parimor i Partisë sonë në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi. Duke dënuar gjyqet dhe terrorin masiv për shkombëtarizimin dhe për zhdukjen e shqiptarëve, shoku Enver Hoxha ngrë zërin kundër veprimeve të tillë të egra shoviniste dhe për respektimin e të drejtave të ligjshme të vëllezërve tanë. Nga ana tjetër, rithekson se Partia dhe shteti ynë socialist ndjekin një politikë marksiste-leniniste ndaj minoritarëve në Shqipëri, se ata gëzojnë pa asnje dallim të gjitha të drejtat, sikurse çdo qytetar i Republikës.

Partishmëria dhe parimësia e lartë, vlera ideologjike dhe fryma aktuale që spikatin në këtë vëllim, do të jenë një nxitje e re për komunistët dhe për masat në punën për të zbatuar direktivat e Partisë.

Vëllimi është i pajisur me tregues.

OBJEKTET SOCIAULKULTURORE NË FSHAT JANE TË DOMOSDOSHME PËR POPULLIN

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

5 maj 1969

Jam i mendimit që brenda një afati sa më të shkurtër të mbarohen të gjitha objektet ekonomike e socialkulturore në fshatra, sepse mundësítë i kemi. Si shpjegohet që në një kooperativë bujqësore ndërtohen një numër shtëpish për nevojat e anëtarëve dhe nuk ngrihen dot çerdhe përfmijët? Pra, mundësi pas ka, po vlerësimi s'është i njëjtë. Mirëpo është e nevojshme që më parë të ndërtohen objektet me karakter ekonomik e shoqëror, kurse shtëpitë e reja të anëtarëve të ndërtohen pas tyre, se, në fund të fundit, ata nuk janë pa banesë. Natyrisht, edhe shtëpi do të ndërtohen, por, e theksoj, mbasi të kenë përfunduar ndërtimet që u interesojnë tërë kooperativës e kooperativistëve, si objektet që kanë të bëjnë me shtimin e prodhimit, dhe ato me karakter socialkulturor.

¹ Në këtë mbledhje u diskutua për përdorimin e aftësive profesionale të specialistëve që kthehen nga ushtria dhe përgatitjen e kuadrove sipas nevojave të fshatit.

Për plotësimin e këtyre detyrave të shikohen mirë mundësitë që ka çdo rrëth, pa pritur të ndihmojë ministria përkatëse. Duhet kuptuar mirë se dikasteri, aktualisht, nuk mund të merret me probleme korente të artizanatit, sepse drejton një industri të madhe, përveç kujdesit që duhet të tregojë për veprat e reja që ndërtohen. Tani që në rrethe janë krijuar mundësitë dhe gjendja nuk është ajo e 15 vjetëve më parë, jam i mendimit që këto punë të kryhen në çdo rrëth. Përvojë të mirë ka dhe, për të përfituar prej saj, duke u interesuar, gjithashtu, vetë, mund të shkohet, bie fjala, në Durrës, për të parë q'mund të merret nga përvoja e tij. Çdo rrëth mund të veprojë kështu; përsë duhet të ndërhyjë në këtë rast dikasteri? Po të pritet që çdo gjë të zgjidhet me ndërhyrjen e dikasterit, s'i dilet situatës përpara.

Për këto që diskutojmë duhet vepruar shpejt, se s'ka pse të zvarritet ngritja e një çerdheje, e një këpucarie, e një banje etj. S'duhet të shqetësohem i nëse do të binden masat përfrekuantimin e tyre, sepse nuk ka fshat që të mos dëshirojë të ketë një këpuçar, një farkëtar apo një marangoz. Banjën edhe sikur të mos e dojë, hëpërhë, gjysma e fshatit, ta ngremë për pjesën tjeter dhe të jemi të sigurt se në një të ardhme të afërt do të jetë një domosdoshmëri për të gjithë.

Veçanërisht ka rëndësi ngritja e mensave. Do të ishte një hop i madh po të arrijmë të kemi në çdo fshat mensa, sepse kështu do të lehtësoheshin mjafit punonjësit e sidomos gratë. Sigurisht të gjithë nuk do të hanë në mensa, se, e dimë, edhe në mensat e qendrave të punës hanë vetëm një pjesë e punëtorëve.

Prandaj të bëhet kujdes dhe të mos imponohet ngrënia në mensa. Nga ana tjetër, në mensa të përdoren sa më shumë perime, në mënyrë që kostoja e gjellëve të jetë e ulët. Megjithatë, ngrënia atje nuk mund të kushtojë më pak se në familje, kështu do të ndodhë që shumë anëtarë të kooperativës do të hanë në shtëpi, pra, s'është e thënë që, po të ngrihet mensa, do të venë të hanë të tërë atje. Rëndësi ka që të ndërtohen hëpërhë ato, të tjerat do të vijnë gradualisht.

Ngritja e objekteve të interesit kolektiv është diçka e domosdoshme për popullin, mirëpo nuk janë marrë kudo masat e duhura për zbatimin e kësaj direktive. Po të krahasosh sa shtëpi banimi dhe sa institucionë socialkulturore janë ndërtuar në fshatra nga viti 1963, vihet re se numri i këtyre të fundit është shumë i vogël. Ato që thuhen se duhen më tepër forca pune e të tjera, nuk qëndrojnë, prandaj Partia t'i sqarojë mirë e shpejt këto çështje.

Sigurisht, specialistët e fshatit do të punojnë me norma, të cilat mendoj se nuk mund të jenë të njëllotta me ato të punëtorëve të qytetit. Këto norma, sipas mendimit tim, duhet të jenë në përshtatje me shkallën e kualifikimit dhe të mekanizimit, më të larta se ato të kooperativistëve të arave, dhe të realizohen me punë, ndryshe do të abuzohej në kurrit të kooperativistëve.

Mendoj, gjithashtu, se normat nuk mund të jenë të njëjta për të gjitha kooperativat bujqësore, si në industri, por të diferencuara dhe t'i caktojë vetë çdo kooperativë. Do të ketë kooperativa që mund t'i japin një specialisti aq sa edhe punëtorit të arës ose blegt-

rit, po, në qoftë se e lyp interes i që të nxitet zhvillimi i një zanati, specialistit përkatës mund t'i jepet diçka më shumë. Kur në një fshat nuk ka muratorë, kurse kooperativës i duhet të përgatitë të tillë për të përballuar nevojat për ngritjen e objekteve të përbashkëta, si për rritjen e prodhimit, ashtu edhe për një kopsht, çerdhe, a shtëpi lindjeje, të karakterit ekonomik e socialkulturor, atëherë, për t'i nxitur, u jepet këtyre pak më shumë. Muratorët e përgatitur nga koooperativat, në radhë të parë, të përfundojnë ndërtimet me karakter ekonomik e shoqëror, pastaj të punojnë për ndërtimin e shtëpive të anëtarëve. Duhen parë, gjithashtu, numri i zanatçinjve që i duhen kooperativës, trajtimi i tyre, radha e punimeve, e sidomos e ndërtimeve etj., sipas kërkesave të çdo rrethi dhe të çdo ekonomie.

Çdo vit përgatitet një numër i madh specialistësh të rinj. Një kontingjent të tërë specialistësh përgatit për nevojat e veta ushtria, një pjesë e madhe e të cilëve, pas kryerjes së shërbimit ushtarak, kthehen në fshat. Krahas zanatit të fituar, ata janë në gjendje të kryejnë edhe punë të tjera, kështu secili do të kryejë 8 orë efektive në punë, sepse, bie fjala, një berber në fshat s'do të ketë punë për çdo ditë njëlloj. Ai që rregullon këpucët, mund të shkëputet gjysmë dite nga kooperativa, të shkojë në qytet të furnizohet me penj, shollë, thumba etj., që i duhen për punën që do të bëjë dhe të kthehet pa pasur nevojë për një përgjegjës ose furnizues. Doemos, këto do të bëhen me dokumentacion të rregullt. Po të viheshin njerëz të tjerë për t'u marrë me furnizimin, atëherë një numër

njerëzish të aftë për punë do të largoheshin kështu nga prodhimi bujqësor, vlera e ditës së punës do të ulej dhe kooperativistët me të drejtë do të thoshin: «S'ka ç'na duhet ky farë artizanati, më mirë shkojmë në qytet për ato që na lypsen!».

Për përgatitjen e specialistëve të nevojshëm për fshatin mundësitë i kanë të gjitha rrethet e jo vetëm Tirana. Në Gjirokastër, për shembull, ka një fabrikë këpucësh, ku brenda disa muajve mund të përgatiten këpuçarë përnjëherësh për të tëra kooperativat e rrethit, ashtu siç mund të përgatiten elektricistë, marangozë e specialistë të tjera që u duhen kooperativave bujqësore të rrethit. Prandaj mund të merren njerëz nga çdo kooperativë, t'u sigurohen ushqimi e fjetja në qytet dhe mbasi të përgatiten, të kthehen në fshat, ku duhet t'i gjejnë lokalet të furnizuara me të gjitha veglat e nevojshme, kështu që menjëherë të fillojnë punën. Mendoj se këto gjëra mund të bëhen pa pritur sa të kthehen specialistë të përgatitur nga ushtria, afati i shërbimit të të cilëve zgjat deri në tre vjet. Kur të kthehen, këta mund të punojnë në bujqësi.

Mendoj, gjithashtu, që konkluzionet e kësaj mbledhjeje të formulohen si duhet në një protokoll e të vihen në dijeni gjithë komunistët. Të caktohet detyrë që brenda vitit 1970 të përfundojnë të gjitha objektet kryesore për të cilat diskutuam.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

MINORITARËT GËZOJNË TË GJITHA TË DREJTAT SI ÇDO QYTETAR I REPUBLIKËS SONË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH*

5 maj 1969

Si për çdo çështje tjetër, edhe për qëndrimin ndaj minoritetit Partia ka luftuar e lufton të zbatohet vija e saj e drejtë. Për ne janë krejtësisht të palejueshme dhe të dëmshme devijimet nacionaliste dhe shoviniste. Minoriteti është i lidhur ngushtë me Shqipërinë sociale; minoritarët janë shtetas shqiptarë, vellezërit tanë, që jetojnë në socializëm dhe gëzojnë pa asnjë dallim të gjitha të drejtat, sikurse çdo qytetar i Republikës sonë. Ata kanë të drejtë të ruajnë gjuhën amtare, zakonet dhe doket e tyre, ashtu siç e ka këtë të drejtë gjithë populli shqiptar¹. Kjo është marksiste-leniniste.

1 Këto të drejta janë sanksionuar në Kushtetutën e RPSSH, në nenin 42 të së cilës thuhet: «Pakicave kombëtare u sigurohet mbrojtja e zhvillimi i kulturës dhe i traditave popullore, përdorimi i gjühës amtare dhe mësimi i saj në shkollë, zhvillimi i barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore».

Partia ka caktuar drejt që minoritarëve në asnjë mënyrë nuk duhet t'u mohohet apo t'u zhduket gjuha amtare. Gjuhën e mëmës ata duhet ta mësojnë patjetër dhe kjo është, gjithashtu, marksiste. Ne jemi internacionalistë, prandaj pse dikush flet greqisht apo një gjuhë tjeter, kjo s'ka asnjë rëndësi për marksistin, aq më tepër për minoritarët te ne, që janë shtetas me të drejta të barabarta dhe jetojnë në shoqërinë tonë socialiste, ku zbatohet doktrina marksiste-leniniste. Në shkollat fillore të minoritetit grek të mësohet me seriozitetin më të madh greqishtja, gjuha e mëmës, dhe mësuesit që do të jepin këtë lëndë të jenë kompetentë. Pra, duhen bërë përpjekje që mësuesit e gregishtes të jenë nga minoriteti, kurse mësuesit shqiptarë që dërgojmë në këto shkolla të jenë me nivel të lartë ideologjik dhe profesional.

Në shkollat fillore të minoritetit, ku të gjitha mësimet bëhen në gjuhën greke, sigurisht, jepet edhe gjuha shqipe, por mësimi i shqipes në këto shkolla bëhet rregullisht në katër klasat e larta të 8-vjeçares, në të cilat, gjithashtu, vazhdon puna për perfeksionimin e gjuhës greke, që nxënësi minoritar e ka gjuhën e nënës. Me këtë sy duhen parë edhe programet.

Mësimi i gjuhës shqipe në shkollat e minoritetit bëhet sepse do t'u duhet minoritarëve në jetë. Dihet se gjuha zyrtare në Republikën tonë Popullore është shqipja, se në zyra e kudo flitet e shkruhet shqip. Kur të rritet, minoritarit mund t'i qëllojë të bëhet punëtor, drejtor ndërmarrjeje, mësues, nëpunës, oficer etj., pra nuk do të jetojë vetëm në Dropull, por do të shkojë të punojë e të drejtojë kudo, si të gjithë shtetasit e

tjerë të Republikës. Minoritari e ka këtë të drejtë, prandaj duhet ta dijë gjuhën shqipe.

Prandaj duhet bërë kujdes e të punohet më mirë që gazeta «Llaiko vima», e cila botohet në greqisht¹, të dalë më nivel pérherë më të lartë, me gjuhë të kulluar e të pastër. Kjo gazetë duhet të trajtojë të gjitha problemet që preokupojnë minoritetin, me një rrëth të gjerrë lexuesish të të gjitha moshave. Veç kësaj, të shikohen mundësitë që për minoritarët të shtypen edhe më shumë libra në gjuhën e tyre². Kjo s'do të thotë që ata të mos abonohen në gazetën «Zëri i popullit», «Zëri i rinisë» ose në organet e tjera të shtypit e të propagandës, ashtu si gjithë qytetarët e tjerë. Si shtetas me të drejta të barabarta dhe luftëtarë aktivë në gjithë jetën e vendit, minoritarët e kanë të domosdoshme të abonohen edhe në këto organe, siç vihet re, por kam parasysh këtu se, megjithëqë ata e mësojnë gjuhën shqipe, ka akoma një masë njerëzish, sidomos të moshave të rritura, që shqipen nuk e dinë. E kemi për detyrë që ky brez të mos mbetet mbrapa nga të tjerët për sa i përket nivelit kulturor, prandaj të bëhet kujdes që, krahas studimit në gjuhën greke, të mësojnë mirë edhe shqipen, sepse kështu do të përfitojnë shumë nga fondi i gjerë i kulturës sonë socialiste. Secili nga ata e kupton këtë,

¹ Kjo gazetë; organ i Frontit Demokratik të Rrethit të Gjirokastrës, është për minoritetin grek në Shqipëri dhe ka filluar të botohet në maj të vitit 1945.

² Që nga viti 1969 deri më 1983, në shtypshkronjën e Gjirokastrës janë shtypur e janë shpërndarë 200 botime shkollore dhe 123 libra e broshura të tjera në gjuhën greke.

pavarësish se nuk e di shqipen. Pra, minoritarët e ndiejnë domosdoshmërinë për të mësuar shqipen, për ta zotëruar atë, të paktën, sa për të lexuar gazetën.

Zhvillimi i shoqërisë sonë socialiste në tërësi, zhvillimi i marrëdhënieve të shëndosha me njëri-tjetrin ecin normalisht dhe pa paragjykime, në unitet mendimi e veprimi, sukses i jashtëzakonshëm ky i vijës së drejtë të Partisë. Për sa u përket marrëdhënieve me minoritarët, këto kanë qenë e janë të shëndosha si në të gjithë vendin. Bie fjala, martesat midis tyre janë trajtuar si një e drejtë e secilit për të vendosur vetë me vullnet të lirë për krijimin e familjes. Në qoftë se një vajzë minoritare dashuron një djalë shqiptar, le të martohet me të, kjo është e drejtë e saj, ashtu si për gjithë qytetarët e tjerë të Republikës. Ose në qoftë se një vajzë shqiptare dëshiron të marrë një djalë minoritar, le ta marrë, por kurrë të mos nxitet as njëri, as tjetri; sepse ndryshe jo vetëm s'do të respektohen ndjenjat e të rinjve, por kjo do të kthehej edhe në një tendencë me pasoja jo të mira.

Këto çështje, pra, duhen shikuar drejt, në vijën marksiste-leniniste. Ne kemi në minoritet një popull patriot që është i lidhur jashtëzakonisht ngushtë me popullin tonë dhe me Partinë, që vijën e Partisë dhe direktivat e saj në politikë, në ideologji, në qëndrimin ndaj fessë, në ekonomi e në çdo gjë i ka përqafuar dhe i zbaton si duhet. Minoritarët janë punëtorë, çdonjëri prej tyre e konsideron veten shtetas shqiptar dhe e do Shqipërinë socialiste, e do Partinë e Punës dhe ka luftuar për to. Ai e do diktaturën e proletariatit dhe e mbron nga çdo rrezik. Ia kemi dhënë minoritetit

këto të drejta jo vetëm për arsyet që përmenda më lart, por se ne jemi marksistë-leninistë.

Për sa i përket fesë, minoritarët e kuptuan drejt që lufta kundër saj ishte e përgjithshme, në shkallë republike; nuk u prishën vetëm kishat e minoritetit, po kudo në Shqipëri, si ato, ashtu edhe xhamitë. Ata e kuptuan, pra, esencën ideologjike dhe politike të këtyre masave, prandaj u morën iniciativa për likuidimin e institucioneve fetare.

Duhet, gjithashtu, të ruhet folklori i minoritetit, këngët, vallet, poezitë etj. si një thesar shpirtëror i popullit. Sigurisht, minoritarët edhe labçë mund të kércejnë, po të kércejnë më parë vallet e tyre. Ne nuk e ndalojmë minoritetin të kércejë labçen apo vallen e Kukësit, kurse për të kërcyer të tijat duhet ta nxitim. Folklori i minoritetit bën pjesë në thesarin e gjithë kulturës sonë populllore.

Duke vepruar kështu, kur shohin se të drejtat që u janë dhënë zbatohen me rrëptësi, minoritarët e duan akoma më shumë Partinë, sepse në jetën e tyre vërtetojnë drejtësinë e vijës së saj marksiste-leniniste.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

PUNA POLITIKE NË USHTRI TË NGRIHET NË NJË NIVEL MË TË LARTË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

5 maj 1969

Jam dakord që, siç u tha këtu, ju shokët e aparatit politik të ushtrisë të thelloheni më shumë sidomos për përmirësimin e mëtejshëm të punës politike në të gjitha instancat. Natyrisht, ka mjaft rezultate, por është e nevojshme që puna politike në ushtri të ngrihet në një nivel më të lartë, duke iu shmangur veçanërisht formulimeve e frazave stereotipe. E theksoj këtë se konstatohet që leksionet e përgatitura nga aparatet politike jo vetëm janë të shumta, por edhe të mbushura plot perifraza. Patjetër leksione do të bëhen aq sa duhet, por rëndësi ka që ushtarakëve t'u nguliten fort në mendje parimet e Partisë, në bazë të të cilave ndërtohet puna në ushtri. Më duket se këtij problemi

1 Në këtë mbledhje u diskutua për punën e komiteteve të Partisë në ushtri për ngritjen e rolit të organizatave-bazë të Partisë.

me kaq përgjegjësi jo vetëm në ushtri, por edhe në sektorë të tjerë nuk i shkohet deri në fund, në mënyrë këmbëngulëse, sepse mendohet që këto parime e norma njihen nga të gjithë, mbasi «janë trajtuar e janë kup-tuar mirë», prandaj «zor se gabohet në vijë». Kjo nuk është plotësisht e drejtë.

Masat që morëm vitet e fundit në ushtri kishin për qëllim thellimin e demokracisë, vendosjen e marrëdhënieve më të shëndosha midis oficerëve e ush-tarëve, komandës dhe vartësve, forcimin e disiplinës etj. S'ka dyshim, punë e madhe është bërë, mirëpo kam përshtypjen se, duke mos përfillur të këqijat që lindin në raste të tilla nga keqkuptimet, ekziston mendimi që këto masa revolucionarizuese janë kuptuar dhe orientimet e Partisë për to janë rrënjosur plotësisht te të gjithë. Në fakt nuk duhet të jetë kështu; mund të realizosh për pak kohë se sa e dëmshme është një praktikë e njojur, por për ta zhdukur atë e për të rrënjosur një tjetër duhen më tepër kohë e punë.

Kur flitet, bie fjala, për liberalizmin, ky duhet kuptuar si një shfaqje me rrezikshmëri jashtëzakonisht të madhe. Po të mos kuptohet si duhet esenca teorike, politike dhe praktike e kësaj rrezikshmërie në jetën e përditshme të ushtrisë, leksionet që bëhen do të jenë me fraza e me formula që nuk do të sjellin asnjë dobi. Shpesh liberalizmi konfondohet me demokracinë, nuk kuptohet drejt nga të gjithë ç'është demokracia në ushtri, ç'rëndësi ka sekreti ushtarak, ç'është disiplina apo respekti për eprorin dhe për komandën etj. Që të kuptohen mirë e të rrënjosjen te secili të gjitha këto parime shumë të rëndësishme që na mëson Partia,

është e domosdoshme të bëhet vazhdimisht një punë politike e dendur, e gjallë dhe efikase.

Edhe unë jam i mendimit që materialet e përgatitura për këtë qëllim të jenë sa më të thjeshta, sa më të përbledhura dhe jo me fjalë lumë, të gjata e me çështje të përsëritura. Një material i gjerë, që kërkon shumë kohë të zbërthehet, pengon përqendrimin e vëmendjes, nuk u lë mundësi njerëzve të reflektojnë. Edhe në pak faqe mund t'u jepen kuadrove apo ushtarëve njojuritë kryesore për një problem, pastaj vetë atyre t'u punojë mendja për ta zbërthyer. Materiali, edhe pse i shkurtër, duke trajtuar çështje kryesore nga të cilat njerëzit do të udhëhiqen në çdo veprim, mbahet mend më mirë, është, pra, më i dobishëm.

Konkretisht, le të shohim ç'punë të madhe duhet të bëjë Partia për ruajtjen e sekretit ushtarak. Në qoftë se nuk lejohet mungesë konspiracioni në asnje nga sektorët e tjerë, kjo absolutisht nuk lejohet në ushtri. Ruajtja e sekretit, veçanërisht në forcat e armatosura, ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Askush s'ka pse të flasë poshtë e lart, për shembull, sa traktorë punojnë në fushën e Tiranës apo sa drithë grumbulloj rrethi etj., etj., ca më tepër nuk lejohet të flitet ç'armë ka në këtë apo në atë rajon. Në qoftë se oficerët dhe ushtarët që shërbejnë në repart nuk e kuptojnë dhe nuk janë të ndërgjegjshëm se nga këto armë në rast lufte varet fati i mbrojtjes nga bombardimi i armikut, i cili i mban veshët ngritur dhe bën çdo gjë për të ditur posaçërisht ku janë vendosur ato, puna e Partisë në ushtri do të ishte e kotë. Në qoftë se nuk vlerësohet drejt rëndësia e madhe e ruajtjes së sekretit

ushtarak dhe nuk punohet vazhdimesht për kalitjen ideologjike e politike të njerëzve, atëherë ushtria dhe mbrojtja do të dëmto heshin shumë.

Drejtoria Politike¹ dhe komandat duhet ta shohin me seriozitetin më të madh këtë, si një çështje jetike. Nuk i lejohet në asnjë mënyrë, absolutisht, askujt të vejë në ndonjë objekt ushtarak. Ai që ka punë, cilido qoftë, para se të futet në një objekt të kësaj natyre, të marrë leje nga komanda përkatëse. Mirëpo konstatohet se ka raste që lejohet tjetri për të parë, fjalavjen, tunelet e këtij ose të atij reparti, depot e municationit etj. Se ku është ndërtuar depoja, këtë duhet ta dinë vetëm komanda përkatëse, Këshilli i Mbrojtjes dhe ai oficer osë ushtar që shërben atje, jo kush të dojë, qoftë ai edhe ministër. Këto janë rregulla ushtarake, të cilat duhen kuptuar drejt politikisht nga të gjithë dhe të zbatohen me rreptësi, prandaj s'ka përsë të fyhet njëri a tjetri, nëse nuk lejohet të futet në një objekt ushtarak ku s'ka asnjë punë.

Kur flasim për konspiracionin në çështjet ushtarake, nuk e kemi fjalën vetëm për personat e jashtëm,

1 Pas Plenumit të 6-të të KQ të PPSH të datës 16-17 dhjetor 1974, Drejtoria Politike u suprimua, sepse, siç vuri në dukje në këtë Plenum shoku Enver Hoxha, «...në realitet ajo përfaqëson atje pucistët, të cilët, për të realizuar punën e tyre armiqësore; e kishin shndërruar këtë organ në një aparat «partie» të tyre... Kjo Drejtori Politike e kishte çorientuar Partinë në ushtri, kishte futur në organizatat e Partisë atje metodat më të urryera të një ushtrie borgjeze pretoriane». (Shih: Enver Hoxha. «Për Ushtrinë Popullore», vëll. II, f. 248-249.)

por edhe për vetë kuadrot dhe ushtarët. Në ushtri duhet të zbatohen me rreptësi rregulloret për të gjitha çështjet. Ato që di komanda, s'ka përsë t'i dijë ushtari i thjeshtë, ndryshe nuk mund të ketë as sekret, as disiplinë ushtarake. Ushtari i një reparti e ka të domosdoshme të dijë ato çështje që i takojnë, kurse të tjerat, të cilat, aktualisht, nuk është nevoja t'i dijë, s'ka pse t'i thuhen, ashtu si nuk lejohet të bisedohen çështjet ushtarake të repartit me ushtarakët e një reparti tjeter. Këto s'kanë të bëjnë fare me demokracinë në ushtri. Për probleme të tillë, më duket mua, nuk ka nevojë për leksione të veçanta, siç bëhej njëherë e një kohë, kur shumë nga njerëzit që na vinin për të kryer shërbimin ushtarak ishin gjysmanalfabetë ose s'dinin fare shkrim e këndim; tani kushtet kanë ndryshuar shumë.

Në ushtri kujdesi duhet të jetë i madh në çdo rast dhe për çdo gjë. Komandanti i njësisë, bie fjala, në klub mund të takojë oficerë të reparteve ose kuardro të tjerë vartës, mirëpo s'ka përsë, si pa gjë të keqë; të zhvillohen aty biseda të palejueshme, për shembull, ku janë vijat e mbrojtjes, depot, tunelet etj. Jashtë punës s'i lejohet asnjë ushtaraku të flasë për çështje që duhen mbajtur sekret. Muhabete të tillë nuk janë në rrugën e Partisë sonë, përkundrazi, bien në kundërshtim me normat e saj. Qëndrime e veprime të kësaj natyre janë shkelje e disiplinës ushtarake, ato cenojnë fryshtë e saj proletare dhe s'kanë të bëjnë aspak me demokracinë, me fryshtë shoqërore, miqësore, me thjeshtësinë etj. Brenda normave të sjelljes me njerëzit të kemi kurdoherë parasysh normën e Partisë që çësht-

ja e ushtrisë është para së gjithash çështje sekreti, për të cilin ka një mijë e një kërkesa të tjera. Për zbatimin e tyre u duhet tërhequr vëmendja, në radhë të parë, kuadrove, ndaj veprimeve e qëndrimeve të të cilëve të jemi rreptësish ekzigjentë.

Ne duhet të luftojmë shfaqjet e gabuara të mbivlerësimit të teknikës, duke e parë këtë problem thellë, ideologjikisht. S'kanë q'na duhen kuadro thjesht teknikë e teknicienë topash e raketash, që i tërheq zvarrë pikëpamja se pa to nuk u bëka lufta. Kjo do të ishte një shprehje e qartë e teknokratizmit. Nuk duhet të harrojmë se gjatë Luftës Nacionalçlirimtare shokët tanë, që s'kishin haber nga teknika, kanë komanduar deri divizione, duke mos qenë më shumë se 20 vjeç. Kjo nuk do të thotë të nënveftësohet teknika, po në radhë të parë qëndron puna ideopolitike me njerëzit. Në ushtri janë bërë mjaff hapa përpara. Megjithatë ka ndonjë kuadër, i cili, duke mos kuptuar drejt rolin e njeriut në luftë, fetishizon teknikën, fetishizon epërsinë e armikut në armatime dhe arrin të nënvljerësojë masat që kemi marrë ne përfuqizimin e mbrojtjes sonë. Në këtë çështje duhet thelluar mirë, me qëllim që oficerët dhe ushtarët të kuptojnë qartë që, edhe pse armiku do të jetë superior në njerëz dhe në armatime, ne do të fitojmë mbi të, pavarësisht nga vështirësitë.

Në drejtimet që përmenda është e nevojshme të rishikohet e të përsoset metoda e punës, siç ëtheqsoi edhe shoku Hysni [Kapo], jo vetëm nga Partia, por edhe nga rinia. Në ushtri rinia duhet të mësohet t'i kuptojë problemet ashtu siç i kupton Partia. Kur shkon

ushtar i riu, t'i kuptojë detyrat seriozisht dhe t'i zbatojë me përpikëri të madhe njëlloj si edhe anëtarët e Partisë, prandaj duhen gjetur forma sa më efikase punë me të rinjtë që kryejnë shërbimin ushtarak. Nuk i lejohet asnjë ushtari të jetë liberal, të largohet pa leje etj., etj. me justifikimin se është i ri. Liberalizmi kudo, aq më tepër në ushtri, është shumë i dëmshëm, prandaj ta luftojmë atë, të punojmë vazhdimesh në fryshtë e Partisë dhe në vijën që ka caktuar ajo për edukimin ideologjik dhe politik të ushtrisë.

Që të kuptohet mirë ana politike dhe ushtarake e problemit, në radhë të parë duhet të shpjegohen, të kuptohen dhe të zbatohen drejt e plotësisht normat, sepse këtu çalon akoma puna. Dhe që të zbatohen deri në një ato, komunistët e zgjedhur në komitetet e Partisë në ushtri, duhet të venë më shumë në organizatat-bazë, të njojin mirë njerëzit, masat e ushtarëve e të dëgjojnë me kujdes mendimin e tyre. Ata që nuk shkojnë në bazë, nuk janë të përshtatshëm për detyrat që janë zgjedhur. E theksoj këtë se, siç na thuhet, anëtarët e komiteteve të Partisë në ushtri nuk para shkojnë në organizatat-bazë të Partisë, se ka një shkëputje midis kuadrove dhe bazës. Atëherë si mund të flitet për lidhjet me bazën? Përderisa kuadri nuk shkon në organizatën-bazë si anëtar i komitetit, ai nuk shkon atje as si oficer, as si komendant dhe kështu punën e bën gjysmake. Shokët që janë anëtarë të komiteteve të Partisë në ushtri, në çdo gjë, në çdo veprim të kenë parasysh se duhet të bëjnë më tepër si komunistë, të reflektojnë drejt në çdo rast, në vijën

e Partisë, të kenë parasysh mendimin e bazës dhe të përpiqen për edukimin e efektivit të ushtrisë sipas mësimeve të Partisë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verball i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

MEKANIZMI I BUJQËSISE DO TË BËHET NË PËRSHTATJE ME SITUATAT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

6 maj 1969

Jam dakord me studimin që ka paraqitur Institut i Studimeve Marksiste-Leniniste. Shokët kryesorë që e kanë përgatitur këtë studim, Hekuran Mara dhe Neshmedin Luari, kanë bërë një punë përgjithësuese të mirë, që u shërbën shumë udhëheqjes dhe bazës, sepse ka të bëjë me perspektivën e zhvillimit të mëtejshëm të bujqësisë sonë socialiste dhe me forcimin e kooperativave bujqësore si në fushën e prodhimit, ashtu edhe në atë të shpërndarjes, për mënyrat dhe format e së cilës këtu u diskutua më gjerë. Kjo, natyrisht, është një nga çështjet bazë me rëndësi të madhe. Format e shpërndarjes që eksperimentojmë, janë të drejta, so-

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth studimit të paraqitur nga Institut i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH «Për disa çështje të shpërbimit të punës në kooperativat bujqësore dhe të zhvillimit perspektiv të pronës kooperativiste».

cialiste, ngaqë kurdoherë jemi përpjekur e përpinqemi që ato të kenë baza sa më të shëndosha e përmbajtje të thellë ideologjike e morale. Çështja është që ndërtimi i socializmit në fshat të harmonizohet me gjithë ndërtimin e socializmit në Shqipëri dhe t'u pritet rruga të papriturave si në fushën e organizimit e të prodhimit, ashtu edhe në atë të ideologjisë.

Partia jonë ka treguar gjithnjë kujdes për problemin e shpérndarjes dhe e ka trajtuar drejt atë, sepse për ndërtimin socialist të vendit është bazuar në parimet marksiste-leniniste. Të dy sektorët kryesorë të ekonomisë, industrinë dhe bujqësinë, ajo i ka vlerësuar kurdoherë si duhet, duke u dhënë rëndësinë që u përket. Sigurisht, për ndërtimin socialist të vendit ne kemi pasur parasysh edhe eksperiencën sovjetike, të cilën nuk e kemi zbatuar në mënyrë shabllone dhe dogmatike, por sipas kushteve tonë reale ekonomike, politike, ideologjike e gjeografike, duke bërë kujdes që nëasnje mënyrë të mos shtrembëroheshin parimet leniniste.

Mund të jenë bërë edhe gabime në punë, mund të ketë pasur të meta, s'ka dyshim që disa çështje mund të zgjidheshin më mirë dhe më shpejt, megjithatë, në tërë veprimtarinë e Partisë sonë të metat jo vetëm nuk kanë qenë asnjëherë deri në atë shkallë sa të kenë çuar në devijimin e vijës marksiste-leniniste, por kurdoherë janë korrigjuar plotësisht e në kohën e duhur. Kështu do të vazhdojmë edhe këtej e tutje dhe kjo është marksiste, dialektike.

Përgjegjësia jonë për ndërtimin me sukses e të plotë të socializmit bëhet akoma më e madhe (dhe

këtë nuk e themi për mburrje), për arsyen se Shqipëria është i vetmi vend që po e vazhdon më tej eksperiencën në këtë drejtim. Siç e dimë, në Bashkimin Sovjetik (prej të cilit fillimisht kemi marrë eksperientë) dhe në vendet e ish-demokracisë popullore, pas vdekjes së Stalinit, procesi i ndërtimit të socializmit jo vetëm u frenua, por edhe u kthye mbrapsht, kurse ne shkojmë vazhdimi i përparrë në kushte të veçanta, të cilat është e domosdoshme t'i studiojmë me imtësinë më të madhe dhe të ecim me kujdes më tej.

Këto çështje kanë rëndësi të posaçme edhe për arsyen se revisionistët modernë largimin e vendeve të tyre nga rruga e socializmit e fshehin prapa një demagogjje të madhe, sikur gjoja ndjekin rrugën leniniste, kurse, në fakt, bujqësinë, industrinë dhe gjithë ekonominë e kulturën po i zhvillojnë me forma dhe etiketa të tilla, gjoja më liberale, që çojnë në një qafë, në restaurimin e kapitalizmit në vendet ku ata sundojnë. Pra, për të gjitha këto arsyen kemi përgjegjësi të madhe për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Zhvillimin e industrisë dhe të bujqësisë ne e shikojmë kurdoherë në funksion të njëra-tjetrës, duke marrë paraçysh edhe karakteristikat e tyre në Shqipëri. Karakteristike për industrinë tonë është se ajo u ndërtua krejtësisht e re, drejtpërdrejt nga populli, nga klasa jonë punëtore. Ndryshe nga shumë vende të tjera, që u futën ndërkokë në rrugën e zhvillimit socialist, ne nuk trashëguam nga e kaluara as industri dhe as proletariat industrial. Klasa jonë punëtore u rrit bashkë me veprat e para, ajo i krijoi vetë mjetet e prodhimit, të cilat i konsideroi që në fillim si pronë

të përbashkët të të gjithë popullit. Ky është një faktor shumë pozitiv ideopolitik për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Me revolucionin tonë popullor, me Reformën Agrare dhe me të gjitha transformimet e tjera që kemi bërë deri në ditët e sotme, të cilat, natyrisht, duhet të perfektionohen vazhdimesht, ne ia kemi ndryshuar krejtësisht faqen bujqësisë. Kjo tregon se edhe në fushën e bujqësisë Partia ka ecur në rrugë të drejtë; ajo nuk ka bërë dhe nuk do të lejojë të bëhen gabime parimore.

Rëndësi ka që, me gjithë përparimet që ka bërë vendi ynë, të kemi kurdoherë parasysh veçoritë e zhvillimit dhe të përparimit të fshatarësisë, e cila edhe nga ana politiko-ideologjike ecën, dhe është e arsyeshme të ecë, më ngadalë nga klasa punëtore, pavarësisht se shumica e kësaj të fundit në vendin tonë është me prejardhje nga fshati. Situata objektive e zhvilluar gjatë këtyre 25 vjetëve të lindjes, të rritjes dhe të kalitjes së klasës sonë punëtore e ka bërë këtë ta përaqofjë në mënyrë të vendosur vijën e Partisë, pse politikisht, ideologjikisht dhe materialisht të gjitha masat e marra nga Partia kanë qenë vazhdimesht të bashkërenduara në mënyrë të tillë që ngritja ideopolitike e klasës punëtore të ishte më e lartë nga ajo e fshatarësisë. Prandaj në punën me fshatarësinë është e nevojshme të kemi parasysh edhe një sërë faktorësh të tjerë, sepse çdo veprim i pamatur, i pastudiuar ose i nxitur, qoftë edhe i bërë për të ndërmarrë e për të realizuar diçka të mirë, mund të na çonte në gabime.

Midis fshatarësisë dhe klasës punëtore ka ndry-

shime, për shembull, në nivelin e jetesës. Ne luftojmë që kjo gjendje të shkojë gradualisht drejt barazimit, por, për t'i arritur këtij objektivi, që gërshtëra të vijë gjithnjë duke u ngushtuar, do të duhet akoma shumë kohë, prandaj kemi akoma mjaft punë për të bërë. Aktualisht ne duhet të marrim për bazë nivelin e jetesës së klasës punëtore dhe në krahasim me të të përpinqemi për ngritjen e nivelit të jetesës së fshatarësisë, por pa e ulur atë të klasës punëtore. Kështu thuhet edhe në studimin e paraqitur, pra, nuk po them ndonjë gjë të re; e tillë është vija e Partisë sonë. Por sa më shpejt të ngushtohen diferencat në të ardhura midis qytetit dhe fshatit, aq më mirë do të jetë. Atëherë mund të themi se ndërtimi i socializmit në vendin tonë, dhe veçanërisht në fshat, ka arritur në një stad të përparuar. Por kur do të arrihet ky stad? Për këtë nuk mund të përcaktohen afate 10, 15 ose 20-vjeçare, se kjo çështje varet nga shumë faktorë, siç janë gjendja e brendshme e vendit, ndërtimet dhe investimet që po bëhen e do të bëhen, ngritja e nivelit ideologjik dhe politik të njerëzve tanë, gjendja ndërkombëtare etj. Të gjitha këto, si përparësitë e ndërtimit tonë socialist, edhe vështirësitë që na janë dashur e do të na duhet të përballojmë, është e domosdoshme t'i njohim e t'i kemi kurdoherë parasysh, por pa u influencuar në asnje mënyrë nga vështirësitë në rrugën tonë marksiste-leniniste. E theksoj këtë se disa shfaqje negative, si vënia e interesit personal mbi interesin e gjithë shoqërisë, ndërgjegjja e ulët në punë e shumë të tjera si këto kanë mundësi të na influencojnë, përderisa nuk është arritur akoma që çdo in-

divid, çdo pjesëtar i shoqërisë sonë socialiste, qoftë ky edhe element i klasës punëtore, t'i kuptojë ato, në radhë të parë, politikisht dhe ideologjikisht në nivelin që kërkon Partia. Këta faktorë ne duhet t'i kemi kurdoherë parasysh.

Të gjitha veprimet dhe masat që merren janë të drejta dhe të gjithë njerëzit tanë (aq më tepër elementët e klasës punëtore, që punojnë sipas formave më të përparuara të punës dhe të organizimit marksist-leninist) e shohin përmirësimin e jetesës, që konkretizohet vazhdimisht me të ardhurat që realizon secili. Por nuk mund të themi që në komunizëm do të arrijmë me po këto forma pune dhe organizimi që kemi sot në shoqërinë socialiste, prandaj, gjatë periudhës së ndërtimit të plotë të socializmit, na vihet detyrë të bëjmë një punë të madhe ideopolitike, të gjemë forma të tillë pune dhe organizimi, që të ndihmojnë për zhdukjen në mënyrë progresive të të gjitha mbeturinave të vjetra nga ndërgjegjja e njerëzve. Kjo nuk mund të bëhet për 10, 15, 20 apo më shumë vjet, zhdukja e mbeturinave nga ndërgjegjja e njerëzve do të arrihet pas disa brezash. Këtë proces do ta zhvillojnë vetë masat me metodat dhe me format që do të përdorim ne, prandaj të përpinqemi që këto të jenë sa më të drejta dhe, nga ana tjetër, të jemi kurdoherë të gatshëm për t'i korrigjuar gabimet që mund të bëjmë gjatë punës.

Në zhvillimin e industrisë dhe të bujqësisë sonë të mos ndikohemi nga parimet kapitaliste dhe revizioniste. Ne ndërtojmë shoqërinë socialiste, e cila presuzon zhvillimin e gjithanshëm në mënyrë proporcionalisht.

nale e të harmonizuar të ekonomisë, në rrugën që ka caktuar Partia, duke u mbështetur në të dyja këmbët, në industrinë e në bujqësinë, dhe pa lejuar në asnje rast që njëra të pengojë tjetrën dhe tjetra të kapërcejë caqet e mundshme.

Të mos mendojmë që brenda një kohe të shkurtër në vendin tonë do të arrihet një shkallë e lartë mekanizimi në bujqësi. Kjo mund të jetë një dëshirë, po edhe sikur t'i kemi mundësitë për një gjë të tillë, mekanizimi do të bëhet i studiuar, kurdoherë brenda realitetit tonë dhe situatave të jashtme. Mekanizimi dhe automatizimi i bujqësisë te ne do të bëhen kurdoherë më ngadalë se mekanizimi i industrisë edhe për vetë natyrën e prodhimit bujqësor dhe të konfiguracionit të terrenit. Për këtë arsyen nuk mund të përcaktojmë dhe as të themi qysh tanë se vetëm 25 ose 30 për qind e popullsisë duhet të punojë në fshat, pse një orientim i tillë mund të jetë i gabuar.

Kapitalizmi e ka mekanizuar bujqësinë dhe merr prej saj rendimente të larta, por këtë e ka arritur duke zvogëluar sipërfaqen e tokës bujqësore dhe duke hedhur në rrugë të madhe fermerët, të cilët i ka shndërruar në rezervë skllevërish për industrinë e automatizuar. Ky është «zhvillimi modern» i bujqësisë, që paska sigruar kapitalizmi, kurse te ne, siç thuhet me të drejtë edhe në studim, nuk shkohet nga kjo rrugë, ne nuk pakësojmë sipërfaqet e mbjella, por përkundrazi, luftojmë për pëllëmbën e tokës. Por, gjersa luftojmë për çdo pëllëmbë tokë, duhet të mendojmë edhe për njerëzit që do të punojnë atje, se në to nuk mund të kemi një mekanizim të madh.

Ne do të investojmë, natyrisht, aq sa kemi mundësi, për ta shumëfishuar dhe për ta automatizuar pa ndërprerje, nga etapa në etapë, industrinë tonë. Kjo do të krijojë mundësi të mëdha edhe për mekanizimin e bujqësisë, por nuk do të thotë ta zvogëlojmë numrin e fshatarësisë dhe as të lejojmë që ajo të braktisë fshatin e të mbushë qytetin, se vetë zhvillimi dhe automatizimi i industrisë do të bëjnë që atje ku sot punojnë 20 punëtorë, të duhet vetëm një.

Rruja që ndjek Partia për thithjen e forcave të punës nga fshati është shumë e drejtë. Kurse kapitalizmi ecën në një rrugë tjetër, pse i tillë është interes i tij. Revisionistët, gjithashtu, ecin në rrugën kapitaliste. Kjo duket qartë edhe në Jugosllavinë e Titos, e cila ka krijuar *azienda*¹ të mëdha në bujqësi dhe po shkon drejt krijimit të koncerneve kapitaliste. Në to mund të merren edhe 30 ose 40 kuintalë drithë për hektar, por veç në fshat është krijuar papunësia kronike, që e detyron fshatarin e varfër dhe të mesëm jugosllav ta braktisë atë dhe të emigrojë në Australi, në Gjermaninë Perëndimore etj. për të siguruar kafshatën e bukës. Ne në asnjë mënyrë nuk mund të lejojmë që të krijohet papunësi dhe ta detyrojmë fshatarin të shkojë në Australi apo në vende të tjera, prandaj politika e balancimit, që ndjekin Partia dhe shteti ynë në këtë drejtim, është shumë e drejtë dhe duhet të respektohet me rreptësinë më të madhe. Moslejimi i braktisjes së fshatit mund të duket si një kufizim i së drejtës së nënshtetasve për zgjedhjen e

1 Italisht — ndërmarrje, firma.

vendbanimit dhe të profesionit, prandaj puna politike dhe ideologjike e Partisë duhet t'i sqarojë njerëzit që ata ta kuptojnë se kjo masë nuk i pengon në asnje mënyrë për ushtrimin e kësaj së drejtë dhe është plotësisht në interesin e tyre, në interesin e të gjithë popullit dhe të ndërtimit socialist të vendit në kushtet tona, në rrugën marksiste-leniniste.

Ndërtimi i socializmit kërkon industrializimin dhe elektrifikimin e vendit, zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor, intensifikimin dhe mekanizimin e bujqësisë. Për të ecur drejt në këtë rrugë, duhet të mos lejojmë elementë të parakohshëm në ngritjen e nivelit të jetesës dhe të mos e nxitim interesin vetjak ose familjar të punonjësve tanë. Ne do të luftojmë për ta ngritur vazhdimisht nivelin e jetesës së masave punonjëse, por i gjithë populli, klasa punëtore, fshatarësia dhe e gjithë Partia duhet të kuptojnë se jemi akoma në momentet e sakrificave të mëdha. Këtë ta kemi parasysh dhe të mos shkohet me mendimin që, meqenëse po ndërtojmë socializmin, përsë të mos ketë secili frigorifer, makinë larëse rrobash etj., etj., se akoma s'janë mundësítë për plotësimin e kërkësave të kësaj natyre. Në këtë drejtim na duhet të luftojmë shumë ideologjikisht dhe politikisht, prandaj t'i studiojmë mirë problemet që na vihen përpara.

Lidhur me bujqësinë unë kam një propozim, që mendoj se mund të studiohet. Në këtë fushë, përveç mjaft çështjeve që kanë të bëjnë me organizimin më të mirë dhe me zhvillimin e mëtejshëm të prodhimit bujqësor e blegtoral, ka edhe çështje të mëdha financiare, zgjidhja e të cilave është shumë e rëndësi-

shme për zhvillimin e mëtejshëm e në rrugë të drejtë të bujqësisë dhe për balancimin e koordinimin e zhvillimit të saj me zhvillimin e gjithë ekonomisë sonë socialiste në përgjithësi. Për çështjet financiare të bujqësisë tani interesohen Ministria e Bujqësisë, Ministria e Financave, Instituti i Studimeve Ekonomike etj., por as Ministria e Financave, as Banka e Shtetit dhe as Ministria e Bujqësisë, që kanë edhe mjaft detyra të tjera, nuk mund ta kenë si duhet syrin në organizimin dhe në balancimin e të gjitha këtyre çështjeve të mëdha e të koklavitura me anën e kredive. Këto institucionë nuk janë në gjendje të shikojnë si zhvillohen problemet në gjithë kompleksin e tyre, pa pasur një institucion të veçantë, siç mund të jetë Banka e Kreditit Agrar. Kjo bankë duhet të ndërtohet në mënyrë të atillë që të mos ketë vetëm të drejtën t'u japë kredi, por edhe të mbikëqyrë gjithë anën financiare të kooperativave bujqësore.

Siç u tha këtu, për kooperativat bujqësore dalin shumë probleme, si për shembull, nëse do t'i japid ato ndihma njëra-tjetrës, nëse do të lejohet dhurimi apo kreditimi nga një kooperativë një tjetre me të ardhura më të pakta, kurdoherë duke pasur parasysh veçoritë e pronës së grupit etj. Këto probleme duan studim dhe orientim, pse edhe kooperativa që e jep kreditinë dëshiron të ketë një siguri jo vetëm për kthimin e saj, por edhe që kjo, në radhë të parë, të ndihmojë përrritjen e prodhimit. Banka që propozojmë të krijohet, e cila do të ketë në dorë gjithë anën financiare të bujqësisë dhe forcën e kreditit të shtetit, do ta koordinojë punën me Ministrinë e Bujqësisë, së cilës

do t'i mbetet të merret me organizimin e mëtejshëm të formave dhe të metodave të punës, sidomos me rritjen e prodhimit dhe me anën agroteknike.

Banka e Shtetit, që është banka jonë kryesore, sipas mendimit tim, duhet të ketë një bankë ndihmëse, Bankën e Kreditit Agrar, që të marrë përsipër të gjitha anët financiare të kooperativave bujqësore dhe koordinimet midis tyre. Ne shikojmë që Banka e Shtetit s'e ndjek dot si duhet përdorimin e kreditit, prandaj për këtë problem kaq të madh mund të kemi një bankë të posaçme, e cila, përvèç atyre që thamë, të ndihmojë edhe për studimet e ndryshme që do të ndërmarrin në këtë fushë të ndërtimit tonë socialist Instituti i Studimeve Ekonomike dhe Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste. Shokët që bënë këtë studim, siç më tha shoqja Nexhmije, kanë qëndruar me ditë të tëra për të bërë vetë një për një llogaritë e për të gjetur të dhënat, që fare mirë mund t'i nxirrnin specialistët e bankave, kurse po të krijohet kjo bankë, specialistët tanë të ekonomisë do të kenë mundësi në çdo kohë të marrin materialet që u duhen, t'i studiojnë ato dhe të nxjerrin konkluzione. Nga ana tjeter, nëpërmjet bankës, që është një organ politik dhe kontrolli, ata do të ndjekin edhe dinamizmin dhe zhvillimin e gjithë këtyre aktiviteteve. Prandaj, më duket mua, ka ardhur koha të shohim nëse mund ta ngremë një institucion të tillë, pse bujqësia, që përbën gjysmën e ekonomisë, është një sektor i ndërlikuar dhe shumë i vështirë.

Mënyra e shpërblimit të punës në kooperativat bujqësore të mos ndryshojë në parim, ndërsa format

t'i provojmë, ashtu sikurse thanë edhe shokët. Të bëjmë kurdoherë një luftë të gjithanshme e të vazhdueshme për shtimin e prodhimit, por të mos u japim rëndësi vetëm formave, pse prodhimin, në radhë të parë, duhet ta shtojnë puna, mekanizimi, zgjedhja e farërave etj. Ka, pra, një sërë faktorësh agroteknikë që janë vendimtarë për shtimin e prodhimit, por, në goftë se një formë shpërblimi na jep rezultate të mira, atë mund të vazhdojmë ta zbatojmë.

Si konkluzion, dëshiroj të them edhe një herë që ky studim do të na shërbejë në punën tonë, por mendoj, siç u shprehën edhe të gjithë shokët që diskutuan, që të mos japim orientimin sikur të gjitha mendimet që përmban ai janë direktiva të prera. Idetë që jepen në të t'i shikojmë, t'i provojmë në punë e sipër dhe, po të jatin rezultate, t'i përgjithësojmë, pse për bashkimin e kooperativave dhe për vendosjen e pagave të garantuara duhet të ecim me kujdes të madh dhe me faza. Në fillim këto t'i zbatojmë në disa kooperativa të ndryshme, pra jo vetëm fushore, dhe, pasi të kalojnë tre-katër vjet, atëherë të shohim si po shkojnë ato me fondin e krijuar etj. Nga ana tjetër, banka që do të krijohet, e cila do të ketë në mbikëqyrje kooperativat, mund të na hapë horizonte të tjera për të vepruar më tutje.

Ngajeta e përditshme, nga eksperiencia e Partisë dhe nga studimi i përqendruar, i konkretizuar dhe i pjekur si duhet nga ana e organeve të Partisë, të shtetit dhe atyre të ekonomisë do të arrijmë me siguri në konkluzione të sakta. Ne ecim në rrugë të drejtë marksiste-leniniste, por, për të bërë disa hapa përpara, të

cilët do të na shërbejnë për të ecur më tutje në të ardhmen, duhet të dimë sa dhe deri ku mund të shkojmë në këtë drejtim, se mund të na duhet të bëjmë edhe sakrifica. Prandaj këto çështje t'ia bëjmë të qarta edhe popullit.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

KUPTIMI DHE ORGANIZIMI DREJT I PUNËS ILEGALE E LEGALE TË PARTISË — ÇËSHTJE THEMELORE E REVOLUCIONIT

Nga biseda me një delegacion të PK të Cejlonit

17 maj 1969

Në fillim fjalën e mori miku nga Cejloni, i cili, mbasi falënderoi për pritjen e përzemërt, tha:

Në kohën e agresionit sovjetik kundër Çekoslllovakisë ne kemi menduar shumë për rrezikun që qëndronte mbi Shqipërinë, i kemi pritur shumë mirë fjalimet tuaja dhe i kemi publikuar ato gjerësisht.

Pastaj fjalën e mori shoku Enver Hoxha:

Ato situata të vështira nuk na erdhën papritur, ne i kishim parashikuar me kohë dhe qemë përgatitur. Pozita jonë gjeografike është e tillë që na mban kurdoherë në këmbë, na detyron të jemi vazhdimesh vigjilentë, të gatshëm e të mobilizuar në çdo moment.

Megjithëse situata e përgjithshme është në favor të revolucionit, të komunistëve, të partive marksiste-leniniste, ne duhet të jemi medoemos kurdoherë vigjilentë. Në mënyrë të veçantë është e domosdoshme të jemi të përgatitur ne shqiptarët, pse vendi ynë është

i rrrethuar nga të katër anët nga shtete imperialiste dhe revizioniste, të cilat janë përpjekur dhe përpinqen vazhdimisht të na dëmtojnë e të na shkatërrojnë. Prandaj sikur, qoftë edhe për një çast, të humbasim vigjilencën ose ta zbutim sadopak luftën kundër armiqve, këta veprojnë menjëherë si gjarpri që të pickon e të helmon papandehur.

Tradhtia e revizionistëve sovjetikë është një ngjarje me pasoja të rënda për lëvizjen marksiste-leniniste revolucionare botërore. Megjithatë gjendja tregon se vërtet ata kanë një fuqi të madhe ekonomike dhe armatime, por brenda në vendin e tyre janë të dobët, shumë të dobët.

Doktrina jonë marksiste-leniniste na mëson se rolin kryesor në luftë e luajnë njerëzit, frysmezimi i tyre në rrugë të drejtë dhe jo armatimet. Klikat revizioniste, ashtu si imperialistët, kanë kundër të gjithë popujt. Këtë e provon orë e çast gjendja ndërkombëtare që po zhvillohet në disfavor të tyre dhe vetë gjendja e breshtshme në Bashkimin Sovjetik, ku, megjithëse nuk kemi të dhëna të sakta, sipas mendimit tonë, situata politike dhe ekonomike nuk është aspak e favorshme për kërët tradhtarë sovjetikë. Në Bashkimin Sovjetik gjendjen e kanë në dorë mareshalët dhe gjeneralët me tendencia të theksuara nacionaliste, fashiste, imperialiste. Një evolucion i tillë tregon se revizionistët sovjetikë nuk kanë qetësi në popull dhe, për të dalë nga kaosi ku kanë rënë, përpinqen të shtypin lëvizjen revolucionare që ekziston në vendin e tyre. Në ç'formë zhvillohet dhe sa e gjerë është kjo lëvizje, nuk e dimë, por masat që kanë marrë revizionistët për fashistizimin

e regjimit tregojnë qartë gjendjen e rëndë në vend dhe dobësinë e tyre.

Tradhtarët hruščovianë pësuan një disfatë të mëdhe në Çekoslovaki, të cilën vërtet e pushtuan, por popullin çekoslovak nuk do ta nënshtronë. Udhëheqësit revizionistë çekoslovakë nuk u treguan të fortë, ata kapitulluan menjëherë. Urrejtja që manifestoi populli çekoslovak në mënyrë herë pasive, herë me greva e demonstrata, u frenua nga udhëheqja. Po të kishte një rezistencë më të fortë në Çekoslovaki, sidomos të armatosur, krejt ndryshe do të zhvilloheshin ngjarjet në Evropë dhe në vetë Bashkimin Sovjetik. Rezistencës së armatosur ia kishin shumë frikën kërët tradhtarë sovjetikë, por kësaj i shpëtuan nga qëndrimi i përulur i udhëheqësve kapitullues çekoslovakë.

Për shtypjen e popullit çekoslovak me gjithfarë represionesh pasuesit e Hruščovit sollën në fuqi në Çekoslovaki një grup të ri, të kryesuar nga njëfarë Husaku, një revizionist me tendenca autoritare fashiste-nacionaliste, grup më adapt se ai i kryesuar nga revizionisti Dubcek. Me anën e tradhtarëve si ky, revizionistët sovjetikë po mundohen të realizojnë pak nga pak qëllimet e tyre në Çekoslovaki, të shuajnë edhe atë lëvizje pasive që ekziston tanë atje. Por carët e rinj të Kremlinit ende nuk kanë krijuar besim të plotë dhe kanë frikë se, kushedi, mos pas disa vjetësh ua kthejnë fletën edhe revizionistët e rinj në Pragë.

Çështja çekoslovake hodhi drithë të qartë në sy të gjithë revolucionarëve dhe popujve, veçanërisht të atyre të Evropës, në dy drejtime: Së pari, ajo vërtetoi vijën e drejtë të përbashkët marksiste-leniniste të të

gjithë komunistëve të vërtetë në botë, drejtësinë e luftës që bëhet për demaskimin e këtij grupi renegatësh e tradhtarësh të Kremlinit dhe të tendencave të tyre fashiste imperialiste; ajo vërtetoi plotësisht se fasada e tyre «marksiste» nuk është tjetër veçse një blof. Së dyti, ajo vërtetoi bashkëpunimin amerikano-sovjetik për ndarjen e zonave të influencës dhe përgatitjet për luftë që bëjnë bashkërisht kundër popujve, lëvizjeve nacionalçlirimtare, socializmit dhe kundër partive marksiste-leniniste në botë.

Partia jonë dhe të gjitha partitë e tjera marksiste-leniniste luftën për demaskimin e agresionit fashist ndaj popullit çekoslovak e zhvilluan si duhet, prandaj ky demaskim është bërë mjaft i fortë. Natyrisht, revisionistët sovjetikë përveç Çekoslovakisë kanë edhe synime të tjera ndaj vendeve e popujve që i konsiderojnë kundërshtarë të tyre kryesorë dhe më të vendosurit. Por synimet e tyre më të afërtë ne mendojmë se janë ndaj Rumanisë e, gjer në njëfarë shkalle, edhe ndaj Jugosllavisë, si edhe ndaj nesh.

Sipas mendimit tonë, udhëheqja rumune është revisioniste-nacionaliste. Në radhët e saj duhet të ketë edhe tendenca pro, edhe antisovjetike, por asnjëherë në rrugën marksiste-leniniste. Në situatat e krijuara pas pushtimit të Çekoslovakisë dhe manifestimit pa maska të tendencave sovjetike për pushtimin e Rumanisë, udhëheqja rumune mbajti, si të thuash, një qëndrim opozitar. Në fillim, kur Dubçeku që kishte marrë përsipër rivendosjen e kapitalizmit në Çekoslovakia, rezistoi, rumunët flitnin më me kurajë kundër revolucionistëve sovjetikë, duke menduar se do të kishin një-

farë mbrojtjeje nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe e shteteve të tjera kapitaliste të Perëndimit. Mirëpo, pas pushtimit të Çekosllovakisë, kur e panë se imperialistët amerikanë nuk lëvizën fare kundër revisionistëve sovjetikë, atëherë e ulën tonin.

Ne mendojmë se vështirësitet që u dolën tradhtarëve sovjetikë pas pushtimit të Çekosllovakisë, ua prishën planet për pushtimin e Rumanisë. Natyrisht, ne e mbështetëm qëndrimin e rumunëve kundër revisionistëve sovjetikë, sepse kjo ishte në interes të lëvizjes komuniste e të revolucionit botëror.

Për sa u përket popujve të Jugosllavisë duhet thënë se këta janë trima. Por udhëheqësit jugosllavë, me gjithëse kanë të bëjnë me popuj të tillë, gjatë ngjarjeve që u zhvilluan, konstatuan se u trembën nga një invazion i mundshëm sovjetik. Kjo, sipas mendimit tonë, vinte jo më shumë prej kërcënimit imediat nga jashtë, sesa për arsyen se brenda në Jugosllavi pozitat e regjimit titist ishin shumë të dobëta. Titoja ka akoma ndikim në vend, por kontradiktat e brendshme që ekzistojnë dhe rriten çdo ditë e më shumë në mes borgjezisë serbe dhe asaj kroate e sllovene etj., në Jugosllavi kanë krijuar antagonizma të mëdhenj nacionalë, të cilët rrezikojnë unitetin e shtetit jugosllav. Pikërisht këtu qëndron frika e Titos, se mos sovjetikët, nga brenda, nëpërmjet shovinistëve serbë, si Rankoviçi me shokë, krijonin një situatë të turbullt, të përshtatshme për agresion. Megjithatë, ne nuk besojmë akoma se revisionistët sovjetikë janë në gjendje të shpërthejnë agresion kundër Jugosllavisë. Kërcënimet që i bënë kësaj, sipas mendimit tonë, synonin më shu-

më të frikësonin Titon që ky të mos nxiste rezistencën antikomunistike në Çekosllovaki e në ndonjë vend tjetër, të mos bënte zë as për presionin sovjetik, as për ndërr-hyrjen më vonë me armë në Çekosllovaki. I ndodhur në këto kushte, Titoja mori masa dhe e «spastroi» ushtrinë nga qindra gjeneralë, shumica dërrmuese e të cilëve qenë kuadro të luftës nacionalçirimitare, personalitete e bashkëpunëtorë të tij të afërt, duke i aku-zuar sikur këta kishin dobësuar mbrojtjen jugosllave dhe kishin ngjallur tendenca shoviniste e nacionaliste në mbarë Jugosllavinë. Me sa duket Titoja këto masa i mori për interesat e tij të brendshëm, pavarësisht se vetë, siç mendojmë ne, për shumë arsyesh nuk beson në një agresion sovjetik.

Pse mendojmë kështu ne?

E para, sepse hrushovianët, për të sulmuar Jugosllavinë, duhet të mendojnë shumë, se ajo nuk është Çekosllovakia. Revisionistëve sovjetikë do t'u duhej t'i bënин mirë llogaritë në rast agresioni të armatosur kundër Jugosllavisë, sepse ia kanë frikën disfatës, mbasi popujt e Jugosllavisë do të luftonin me vendosmëri kundër tyre.

E dyta, sepse interesat ekonomikë të kapitalit amerikan, anglez etj. në Jugosllavi aktualisht janë ja-shtëzakonisht të mëdhenj. Ai ka hedhur në dorë gjithë ekonominë jugosllave. Industria e këtij vendi është e tëra në duart e koncerneve amerikano-angleze. Po të pushtohej Jugosllavia nga sovjetikët, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e tjera imperialiste që kanë bërë investime të mëdha në Jugosllavi, do të ndërhynin për të mbrojtur interesat e tyre ekonomikë.

E treta, po të sulmonte Jugosllavinë, Bashkimt Sovjetik do t'i dilte përpara edhe diçka tjetër e rënëdësishme nga ana strategjike, aleanca e NATO-s dhe ndihma ushtarake amerikane ndaj Jugosllavisë. Pra, përveç luftës që do të bënin vetë popujt e Jugosllavisë kundër një agresioni të mundshëm sovjetik, do të viheshin në lëvizje tërë organizmat e NATO-s dhe vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Për të gjitha këto arsyen mendojmë se Titoja nuk e pret një agresion nga ana sovjetike. Megjithatë, ai i mori masat si për brenda vendit, ashtu edhe përsa i përket aleancës që ka me imperialistët amerikanë, të cilët e quajnë «udhëheqës» të botës së «të paangazhuarve», megjithëse ne e dimë që është agjent i tyre dhe jo asnjanës.

Partia jonë në ato momente, kur udhëheqja jugosllave u frikësua, e gjykoi të nevojshme të bënte deklaratën¹ që publikoi kundër përqendrimit të forcave ushtarake sovjetike në Bullgari dhe kërcënimit që këto u bënin Jugosllavisë dhe Rumanisë. Sipas deklaratës sonë, në rast se do të sulmoheshin Jugosllavia dhe Rumania, ne do t'i mbronim këto vende, do të mbanim anën e tyre, por duke vënë si kurdoherë pikat mbi i, pa fshehur pikëpamjet tona të papajtueshme me titistët, bile bëmë të njohura edhe një herë kundërshtimet ideologjike që kemi, gjithashtu, me udhëheqjen rumune. Ne gjykuam se një qëndrim i tillë i ven-

¹ Kjo deklaratë u botua në gazeten «Zeri i popullit» më 11 prill 1969, nëpërmjet artikullit «Presionet ushtarake — bazë e diktatit dhe e shantazhit politik të udhëheqësve revisionistë sovjetikë».

dosur ishte në interes të socializmit dhe të mbrojtjes së atdheut tonë, pse, po të sulmohej Jugosllavia, merrat me mend që do të sulmohej edhe Shqipëria.

Ne jemi kurdoherë të përgatitur për mbrojtjen e atdheut në rast se armiku do të shpërthejë kundër nesh një luftë të armatosur. Populli ynë nuk ka frikë nga lufta. Këtë e dinë mirë miqtë tanë, partitë motra marksiste-leniniste, këtë e dinë mirë edhe armiqtë.

Deklarata jonë në përkrahje të popujve të Jugosllavisë, të Rumanisë, të Bullgarisë etj. në rast agresioni nga socialimperialistët sovjetikë, u prit me entuziazëm nga këta popuj. Qëndrimi heroik i popullsit shqiptar dhe deklarata ndikuan jashtëzakonisht shumë në qëndrimin e popujve të Ballkanit.

Titoja është një armik i tërbuar i popullit shqiptar dhe i lëvizjes komuniste ndërkombëtare, por dinak. Ai, fill pas deklaratës sonë, deklroi se në momentet kur sovjetikët kërcenojnë Jugosllavinë, Republika Popullore e Shqipërisë luan një rol vendimtar në Ballkan. Po ne e njohim mirë politikën e tij dhelparake. Edhe kur ndodhën ngjarjet e Usurit midis Bashkimit Sovjetik dhe Kinës, Titoja u përpoq të bënte njëfarë politike asnjanëse, duke mos mbajtur as anën e Kinës, as atë të revisionistëve sovjetikë.

Koniunkturat dhe situatat e acaruara që shkaktoi agresioni sovjetik mbi Çekoslovakinë, si dhe aleanca sovjeto-amerikane kanë bërë që gjendja në botë, vëçanërisht tani, të mos jetë e qetë. Revisionistët sovjetikë janë të prirur për agresion, vetëm kanë frikë, sepse llogaritin rezistencën dhe luftën e popujve, jo

vetëm të Shqipërisë, por edhe të Jugosllavisë, bile edhe të Rumanisë, natyrisht me aq sa mund të bëjë populli rumun. Duke mos hequr dorë nga agresioni ushtarak, revisionistët sovjetikë përpiqen tani të thyen në brendapërbrenda rezistencën e Rumanisë, ku ka shumë agjentë sovjetikë, të cilët vazhdojnë punën e tyre minuese.

Revisionistët sovjetikë punojnë edhe në Jugosllavi, natyrisht me më pak sukses se në Rumani, kurse Titoja nga ana e tij vazhdon të predikojë unitetin e popullit, të sulmojë borgjezinë serbe, të mbështetet më shumë në borgjezinë kroato-sllovene etj.

Situatat e vështira e detyrojnë Titon t'u bëjë disa lëshime edhe një milion e ca shqiptarëve të Kosovës, të cilët i ka shumë frikë, prandaj, për t'i qetësuar, u ka lejuar tani hapjen e shkollave në gjuhën shqipe dhe mbajtjen e flamurit shqiptar.

Në rrethanat që përmenda më lart, revisionistët sovjetikë, në bashkëpunim me imperialistët amerikanë, përpiqen tani të qetësojnë gjendjen në Evropë, të ruajnë këtu statukuonë, me synimin që të intensifikojnë luftën në Azi.

Në Evropë ekzistojnë kontradikta të mëdha. Në këtë kontinent sunojnë kapitalistët dhe revisionistët, të cilët po ecin drejt forcimit të diktaturave të tyre fashiste. Ata godasin pa pushim forcat revolucionare në rritje dhe përpiqen të qepin të çarat që u janë hapur e po u hapen përditë, por një gjë e tillë është e zorshme ta arrijnë. Të gjitha grevat e shumta e gati të përditshme që po bëhen në Francë, në Itali etj., kriza e madhe monetare në Angli, kriza në Tregun

e Përbashkët, rënia e Dë Golit etj. tregojnë kalbëzimin e gjendjes në të gjitha vendet evropiane.

Në këto situata Gjermania Perëndimore përpinqet të luajë rolin e forcës kryesore evropiane në NATO. Ajo e di se pa ekzistencën e saj NATO-ja dhe SHBA nuk balancojnë dot forcën e imperializmit sovjetik në Evropë. Revisionistët sovjetikë kanë përgatitur dy-tri plane për «sigurimin evropian». Kjo do të thotë që në Evropë ata duan të ketë qetësi nën sundimin amerikano-sovjetik, me qëllim që revisionistët sovjetikë t'i mbajnë lehtë në zap gjithë satelitët e tyre, si: Poloninë, Çekoslovakianë, Gjermaninë Lindore, Hungarinë, Bullgarinë, mundësish edhe Rumaninë, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës të vënë, nga ana e tyre, nën kontroll Kinën në Lindje. Por megjithatë situata në Evropë është revolucionare, prandaj ne duhet të përfitojmë shumë prej saj. Lëvizjet revolucionare marksiste-leniniste në Evropë tani për tani nuk janë të forta, por janë duke u mëkëmbur, dhe, me gjithë vështirësitë, që janë të kuptueshme, në të vërtetë ato ecin çdo ditë e më shumë përpara.

Ne kemi parasysh se partitë dhe grupet e reja marksiste-leniniste që veprojnë në vendet evropiane kanë mbi shpinë tre armiq: kapitalizmin e vendit të tyre me aparatet shtypëse përkatëse, socialdemokracinë, që luan rolin e grevëthyesit, si dhe revisionizmin sovjetik me revisionistët e brendshëm. Shokët komunistë në këto vende, për të çarë përpara, përpinqen të gjunjë rrugët më të përshtatshme revolucionare, por që, në të njëjtën kohë, janë edhe ca të ndërlikuara. Elementët marksistë-leninistë që udhëheqin këto lë-

vizje dhe parti, janë të vendosur në luftën kundër revizionizmit, por meqenëse në shumicën e rasteve ata vijnë nga partitë revizioniste, ruajnë akoma forma dhe metoda të luftës e të punës së partive revizioniste, pse kanë bërë një jetë të gjatë në radhët e tyre. Prandaj ata ka raste që ndjekin të njëjtat forma lufte që ndiqnin partitë ku bënин pjesë. Përveç kësaj, për partitë e reja marksiste-leniniste ekziston kurdoherë edhe një rrezik tjetër i madh, që borgjezia dhe revizionistët, me qëllime sabotimi dhe diversioni, t'u futin në radhët e tyre njerëzit e vet.

Le të marrim, për shembull, lëvizjen revolucionare në Itali. Atje është krijuar një parti marksiste-leniniste e re që mban në përgjithësi qëndrim të mirë. Por në Itali ka edhe tri-katër grupe të tjera që grinden me njëri-tjetrin për çështje parimore dhe jo-parimore. Në këto grupe ka njerëz të mirë, po ka edhe të këqij. Në kushte të tilla kjo parti e re marksiste-leniniste nuk i ka akoma mundësitet që të bëjë një politikë të zgjuar, të hidhet në aksion, të studiojë ku janë të mirat dhe të këqijat e këtyre grupeve, të bisedojë me to për të sheshuar mosmarrëveshjet mbi baza parimore marksiste-leniniste. Njerëzit e këtyre grupeve, që i njohin qëndrimet tona të mosndërhyrjes në punët e tyre, na drejtohen neve e na luten të flasim edhe për ta. Ne u jemi përgjigjur atyre se, gjersa në çështjet kryesore jeni dakord me njëri-tjetrin, interesë i revolucionit e kërkon të merreni vesh midis jush dhe mbi baza marksiste-leniniste t'i likuidoni mosmarrëveshjet. Kështu si në Itali ngjet edhe në Austri e gjetkë.

Në këto situata Partia jonë, me aq sa mundet, për-

piqet ta bëjë të njojur kudo vijën e saj dhe atë të partive të tjera marksiste-leniniste, të luftojë me ash-përsinë më të madhe revizionizmin sovjetik, imperializmin amerikan dhe përgjithësisht kapitalizmin në Evropë e në botë. Me ato mundësi të kufizuara e mje-te të pakta propagandistike që ka vendi ynë, Partia jonë do të përpinqet t'i ndihmojë në mënyrë modeste shokët tanë revolucionarë në Evropë, në Amerikën Latine e kudo dhe njëkohësisht të konsolidojë dita-ditës pozitat politike, ideologjike e luftarake brenda vendit. Lufta kundër propagandës armiqësore ka një rëndësi të madhe për ne, pse rrezatimi i propagandës kapitaliste revizioniste në drejtim të vendit tonë është i madh. Me dhjetëra radiostacione armike flasin tani përditë kundër Shqipërisë.

Rëndësi të madhe ka për ne forcimi i gjendjes së brendshme të vendit, mobilizimi politik dhe ideologjik i mbarë popullit dhe, krahas me këtë, realizimi i planeve ekonomike, e, në radhë të parë, përgatitja ushtarake në shkallë të gjerë e gjithë popullit. Zhvillimi i punës së Partisë sonë në çdo drejtim vërteton se të gjitha çështjet, duke ecur krahas dhe pa ndër-prerje përpara, na shkojnë mirë dhe asnjëra çështje nuk e pengon tjetrën nga ana materiale.

Ndonjë mund të pyesë: Ku e gjejnë kohën shqiptarët që edhe punojnë e mësojnë, edhe edukohen politikisht e ideologjikisht, njëkohësisht stërviten edhe ushtarakisht? Të gjitha këto: punën, mësimin, edukimin dhe marshimet e stërvitjet ushtarake, ne i bëjmë shumë bukur dhe shohim se sa më thellë u hyjmë këtyre problemeve, aq më mirë na shkojnë punët.

Në përpjesëtim me madhësinë e vendit tonë ne kemi arritur suksese të mëdha në zhvillimin e degëve të ndryshme të ekonomisë, të cilat rriten vazhdimisht. Bujqësia jonë ecën përpara, kooperativat bujqësore zhvillohen pa ndërprerje në rrugën leniniste. Kjo ka një rëndësi kolosale. Tani Partia jonë u ka vënë rëndësi të jashtëzakonshme ngritjes së rendimenteve, përgatitjes së kuadrove në një shkallë të gjerë dhe zgjerimit të njojurive agroteknike në masat fshatare. Nga njerëz pa tokë që ishin në fillim, fshatarët tanë dikur të varfér u bënë me tokë, pse para kolektivizimit bëmë Reformën Agrare, pastaj kaluan gradualisht në kolektivizimin e plotë, në fillim me kriimin e kooperativave bujqësore në bazë fshati dhe më vonë me bashkimin e këtyre. Te ne po rritet me shpejtësi mekanizimi i bujqësisë, janë tharë këneta e moçale, janë sistemuar fusha të tëra dhe sipërfaqja e tokave nën ujë po rritet nga 45 në 50 e më shumë për qind të të gjithë tokës së punueshme. Blegtoria jonë është duke u futur çdo ditë e më shumë në rrugën e modernizimit. Ne po i kushtojmë kujdes të veçantë tani zhvillimit në mënyrë ritmike të zonave malore, ku po hapen me mijëra e mijëra hektarë toka të reja për drithërat, për pemët frutore, për kullota etj.

I gjithë ky zhvillim ekonomik dhe kjo ngritje ideo-politike kanë ndihmuar që vetë fshatarësia të goditë tani mbeturinat mikroborgjeze në ndërgjegjen e vet, në radhë të parë ato për çështje ekonomike. Kooperativistët, me iniciativën e tyre, po shkurtojnë oborret personale, pse shohin konkretisht se si dita-ditës forcohet ekonomia e përbashkët, e cila u siguron atyre

të ardhura të mira. Gati në të gjitha fshatrat tani janë ndërtuar furra, kopshte e çerdhe, mensa e restaurante, reparte artizanati, shkolla, ambulanca etj. Kooperativistëve në disa kooperativa u çohet ushqimi atje ku punojnë, në fusha, i gatshëm e me çmime shumë të lira. Kështu fshatarësia jonë po kupton gjithnjë e më mirë q'janë socializmi dhe kolektivizimi e po bindet plotësisht për rrugën e saj. Nga vetë kooperativistët kanë dalë propozime për kolektivizimin e oborreve, megjithatë ne u themi se ato akoma u duhen, gjersatë vijë koha kur kooperativa t'u sigurojë më me bollëk, veç bukës, edhe qumështin e gjithçka tjetër që u nevojitet, si perime, fruta, vezë etj.

Tani te ne ka filluar një tjetër lëvizje e madhe. Grupe njerëzish, gra e burra, të rinj dhe të reja, në mënyrë të organizuar, vijnë nga fshatrat e malësisë në ato të fushës e anasjelltas dhe qëndrojnë si mysafirë te njëri-tjetri, jetojnë e punojnë si në familjet e tyre. E zonja e shtëpisë u jep miqve çelësat. Ky është një gjest i lartë që shpreh një afrim të madh e vëllazërim të vërtetë midis njerëzve tanë. Të gjithë së bashku punojnë, përgatitin gjellët, mësojnë nga njëri-tjetri dhe njihen me njëri-tjetrin. Malësorët shikojnë tani se Shqipëria nuk është ai fshati i tyre i largët atje lart në malësi, me shtëpitë e vogla, po relativisht është një vend shumë më i madh, prandaj kur bëjnë vizita të kësaj natyre që thashë, ata gjëzohen, mësojnë dhe e ndiejnë veten kudo si në shtëpinë e tyre, si motra dhe si vëllezër. Kjo lëvizje, që tani ka filluar të zhvillohet në shkallë të gjerë, rritet çdo ditë.

Në një fshat të rrëthit të Vlorës u mor iniciativa

për të ndihmuar kooperativat e reja të malësive të Veriut. Kjo iniciativë shpreh solidaritetin socialist në gjirin e fshatarësisë sonë. Me mijëra bagëti të imëta, dele e dhi, po edhe lopë, u mblohdhën nga kooperativat e fushës dhe u nisën si dhuratë për malësitë e thella të vendit tonë. Të gjitha këto u kanë dhënë një hov të madh çimentimit të unitetit të popullit dhe ngritjes së rendimenteve, ndërtimit të institucioneve socialkulturore dhe shtëpive të reja të banimit nëpër fshatra. Vërehet me kënaqësi se te ne, çdo ditë e më tepër, po rritet te të gjithë dëshira për mësim dhe për zhvillimin tekniko-shkencor.

Edhe industria jonë ecën përpara. Po realizohen me sukses të gjitha planet. Midis bujqësisë dhe industrisë janë vendosur një lidhje e bashkëpunim i ngushtë.

Gjithë ky zhvillim i ekonomisë shtroi detyrën që edhe shkolla t'u përgjigjej nevojave të zhvillimit të prodhimit. Ai i tregoi Partisë që t'i hynte studimit të ndryshimit të të gjithë sistemit të arsimit, me qëllim që shkolla jonë të luajë edhe ajo nga ana e vet rolin aktiv e të fuqishëm në periudhën e tanishme e në perspektivë për ndërtimin e plotë të shoqërisë sociale. Ka më se një vit që po diskutohet çfarë tip shkollë duhet të kemi. Me qindra mijë njerëz të popullit kanë diskutuar rreth tezave të Partisë për revolucionarizimin e shkollës, me mijëra janë njerëzit që marrin pjesë nëpër komisionet e ngritura për këtë qëllim. Këtë studim tani jemi duke e përfunduar, kështu që nga qershori mendojmë të bëjmë mbledhjen e Plenumit të Komitetit Qendror për të vendosur që arsimi, si do që ka marrë një hov të madh, të bëhet akoma më

masiv, që në vendin tonë të mos mbetet njeri pa shkollë.

Shkolla jonë do të punojë në tri drejtime: në drejtim të mësimit, në atë të punës prodhuese dhe në drejtim të përgatitjes fiziko-ushtarake të nxënësve e të studentëve, duke pasur të tria si bosht themelor edukimin marksist-leninist. Edukimi marksist-leninist presupozon jo vetëm mësimin e marksizëm-leninizmit si lëndë të veçantë, por edhe përgatitjen e të gjitha teksteve të lëndëve të ndryshme të përshkuara nga doktrina jonë. Puna prodhuese do të zhvillohet në mënyrë të atillë që intelektualët të fitojnë nëpërmjet saj tiparet e punëtorit. Krahas mësimit dhe punës në prodhim do të zhvillohet dhe edukata fiziko-ushtarake e shkollarëve. Të tre këta komponentë do të përfshihen në programin e shkollave të të gjitha kategorive.

Partia jonë përpinqet që lëvizjet revolucionare përndërtimin e shoqërisë socialiste të përfshijnë të gjitha sferat e jetës, që asnjëra të mos mbetet prapa. Ne konstatojmë se këto lëvizje kanë rritur një hov të madh revolucionar në popull. Njerëzit marrin iniciativa të shumta, luftohen kudo burokracia. Vetë populli, masat në fshat e në lagje të qytetit diskutojnë se kush duhet të marrë një bursë shteti, kush të ndjekë shkollën e lartë etj.

Ne po ndërtojmë tani vazhdimisht shtëpi banimi, me gjithatë prapë jemi deficit, sepse kërkesat e popullit shtohen; po kur ndërtohen të reja, merr shtëpi më parë ai që ka nevojë më shumë, sigurisht, pasi diskutohet problemi në kolektiv, në fabrikë apo në lagje. Për çdo gjë, pra, te ne vendosin masat dhe dihet se

nuk ka drejtësi më të madhe se ajo e popullit. Për të përballuar nevojat për banim, përveç banesave që ndërtohen nga shteti, Partia organizon masat në lagje e në fabrika për të ngritur ndërtesa të reja me kontribut vullnetar, pas orarit të punës. Shteti jep vetëm ndihmë materiale. Prandaj këta dy vjetët e fundit janë ndërtuar me kontribut vullnetar me mijëra apartamente jashtë atyre që parashikon plani i shtetit. Kjo ka ndihmuar, veç të tjerave, që të përgatiten nga radhët e punonjësve e të nëpunësve mijëra muratorë, karpentierë e të tjerë, pa kaluar nëpër kurse. Nëpunësit, sidomos, gjatë kësaj pune, kalitin edhe duart, edhe ndërgjegjen dhe krijohen në ta koncepte më të drejta.

Megjithatë ne kemi pasur e kemi edhe vështirësi e mungesa të shumta, të cilat, duke zbatuar me këmbëngulje vijën e përgjithshme të Partisë, i kemi kapërçyer e do t'i kapërcejjmë patjetër.

Ne jemi jashtëzakonisht të gëzuar kur shohim se shokët tanë komunistë në të katër anët e botës po korrin suksese në luftën e tyre. Ne çmojmë, gjithashtu, shumë, luftën e partisë suaj, njohim vështirësitë e mëdha që i krijojnë asaj imperializmi, kapitalizmi dhe revisionizmi modern, sepse edhe ne kemi kaluar nga ato situata nëpër të cilat po kaloni ju. Ne e dimë se kapitalizmi dhe borgjezia në vendin tuaj janë më të rafinuar se ata që ishin para Çlirimtës në vendin tonë. Borgjezia e vendit tonë ishte pa eksperiencë, e paorganizuar. Ndryshtë me ju që keni një borgjezi të organizuar e shumë të djallëzuar. Tani, pas tradhitës së revisionistëve sovjetikë, ndaj partisë suaj janë

shtuar edhe më tepër presionet e vështirësitë, të cilat ju po i kapërceni...

Luftën e partive e të grupeve marksiste-leniniste e konsiderojmë si një faktor shumë të rëndësishëm, pa të cilën as ne shqiptarët nuk ecim dot përpara. Kështu na mëson t'i vlerësojmë gjërat doktrina jonë, marksizëm-leninizmi...

Në lëvizjen tonë të madhe një parti ndihmon me eksperiencën e saj në një drejtim, një tjetër në një drejtim tjetër, por të gjitha së bashku, në unitet, krijojnë atë forcë të madhe që do ta bëjë revolucionin në dritën e marksizëm-leninizmit.

Në Evropë, nga sa vëmë re, marksistë-leninistët nuk kanë arritur akoma të kuptojnë si duhet domosdoshmërinë e organizimit të veprimtarisë së partisë në ilegalitet dhe në gjysmileygalitet. Këtu ndikon shumë veprimtaria e revizionistëve. Partitë e reja marksiste-leniniste, megjithëse nuk bëjnë fjalë për ndjekjen e rrugës parlamentare, gjithë aktivitetin e tyre synojnë ta kryejnë në forma legale, siç veprojnë edhe partitë revisioniste. Atyre u duket sikur nuk bëjnë gjë, po të hidhen në gjysmileygalitet ose në ilegalitet të plotë. Duke e hedhur një pjesë të anëtarëve të partisë në ilegalitet për t'u bërë bërtlama kryesore e gjithë aktivitetit të partisë, kujtojnë sikur nuk punojnë. Pra ata nuk e kuptojnë rëndësinë e krijimit të një bërthame të fortë në kushtet e ilegalitetit.

Në kohën e ilegalitetit, kur ne ndiqeshim nga fašistët dhe agjentët e qeverive kuislinge, çdo komitet partie nxirrte buletinin e vet të shtypur me shaptilografë, mjete këto që duken si të vogla, po në atë kohë

ne mezi i gjenim. Atëherë na duhej të sulmonim ministritë për t'i rrëmbyer të tilla mjete, bile shumë shokë na janë vrarë gjatë aksioneve që organizonim për të sigruuar materiale të kësaj natyre, që janë të domosdoshme për propagandën e partisë. Në një rast, brenda natës, në Tiranë shokët tanë kanë çmontuar një shtypshkronjë të tërë të një privati, e cila u montua gjetkë në ilegalitet, në një vend që mbahej nga Partia në mënyrë shumë konspirative. E tillë duhet të jetë lufta e organizuar në ilegalitet.

Gjatë kohës së luftës traktet tona shtypeshin në mënyrë ilegale në shtypshkronjat e shtetit fashist dhe të pronarëve privatë nga shokët tanë punëtorë, të cilët nuk njiheshin nga policia për një veprimitari të tillë. Në mënyrë ilegale traktet dhe gazetat e Partisë radhiteshin, shtypeshin dhe fshehtazi, brenda orës, shpërndaheshin në masë në mijëra kopje. Habiteshin njerëzit si dilnin këto nga Komiteti Qendror ose nga ky apo ai qarkor. Njerëzit tanë ishin stërvitur mirë si të punonin ilegalisht dhe në fshehtësinë më të madhe në këtë fushë. Ata hiqeshin sikur nuk ishin komunistë, prandaj armiku çorientohej, nuk dinte mbi cilin të vinte dorë, pse shokët tanë në luftë e sipër mësohen edhe si të mbroheshin prej tij.

Organizimi i punës së partisë në ilegalitet ka shumë rëndësi dhe duhet ta kuptojmë mirë që armiku nuk fle. Për të të njohur kush je dhe ç'forca ke, ai mund të të lejojë të zhvillosh për një kohë disa aktivite, por pastaj shpejt ta gjen rastin dhe papandehur, brenda një nate, të asgjëson. Revisionistët i njo hin mirë metodat e luftës ilegale, ata kanë eksperien-

cë, sepse kanë luftuar edhe vetë në ilegalitet, prandaj janë jashtëzakonisht të rrezikshëm. Nuk duhet nën-vleftësuar në asnje mënyrë armiku, pse ai që e nën-vleftëson, kurdoherë humbet, por ai as nuk duhet mbivlerësuar. Rëndësi ka që të mos kesh frikë dhe të dish të kuptosh taktikat e tij. Imperialistët amerikanë shpenzojnë shuma kolosale për të na luftuar ne. Në Jugosllavi në anën e tyre ata kanë Titon, si edhe agjentë të tjerë të kualifikuar kundër komunizmit. Të gjithë ata që Titoja dërgon si ambasadorë në Indi, në Egjipt, në Algjeri etj., nuk janë thjesht diplomatë, ata janë njerëz shumë të stërvitur. Këtë e themi se i njohim mirë kush janë, pse disa prej tyre kanë qenë edhe në Shqipëri, si ambasadori Josip Gjergjia, ose delegatë të rinisë, si Dizdareviçi e të tjerë, dhe kanë bërë të gjitha përpjekjet për të mposhtur Partinë tonë.

Rëndësi të madhe ka edhe puna me gratë e me rininë. Partia jonë i ka kushtuar shumë vëmendje qysh në fillim kësaj çështjeje. Kjo duket edhe nga fakti se luftëtarët tanë që kanë rënë gjatë Luftës Nacional-çlirimtare, në shumicë ishin nga 20 gjer 22-23 vjeç, ishin, pra, të rinj e të reja, ata i digjte zjarri revolucionar. Edhe tani në aksionet revolucionare në ballë janë kudo rinia dhe gratë, në radhë të parë, që përbëjnë një forcë të madhe jo vetëm në punë, por edhe në kuptimin ideologjik e politik të problemeve dhe në vënien në jetë të direktivave të Partisë. Sikur ne të mos kishim bërë për vete këtë forcë të madhe që kanë gratë, do të hasnim shumë pengesa në rrugën tonë, pse gruaja ndikon shumë, për të mirë ose për të keq, në familje. Duke pasur parasysh këtë forcë

të madhe të grave dhe të rinisë, ne këto i mobilizuam edhe në luftën kundër koncepteve që kanë lidhje me paragjykimet e vjetra. Reaksionarët flitnin me përbuzje për gratë. Ata thoshin «gratë janë leshgjata dhe mendjeshkurtra», por realiteti në vendin tonë provoi të kundërtën, zotësia e grave është shumë e madhe. Sot gratë në Shqipëri janë futur kudo, në çdo fushë, dhe po zgjidhin me sukses shumë probleme, kryejnë në mënyrë të shkëlqyer të gjitha detyrat që u ngarkohen.

Veç guximit e trimërisë, gratë e vendit tonë janë të pajisura edhe me virthyte të larta. Tek ato vërehet një ndershmëri më e madhe në krahasim me burrat. Kudo që administrohen vlera materiale e monetare në vendin tonë, në përgjithësi, punojnë gra. Tani ne kemi gra me shumicë jo vetëm në arsim e në shëndetësi, por edhe në industri, në tregti, në ekonomi, në financë etj. Përpara gruaja në Shqipëri nuk punonte fare, ajo ishte skllave e shtëpisë. Tani ajo ka marrë krahë dhe ka arritur të meritojë edhe vende drejtuese në pushtet, në organizatat e masave, në uzina, në fabrika, në kooperativa e në ndërmarrje bujqësore, në institucionë shtetërore e në administratë. Shumica e këtyre janë vajza të reja. Ato po tregojnë një zotësi aq të madhe, saqë edhe pleqtë më konzervatorë detyrohen t'i respektojnë. Ishte shumë zor të ne që të pranonte në udhëheqje, sidomos fshatari, të riun, pale vajzën 20-vjeçare. Mirëpo puna e Partisë dhe zotësia e vetë grave dhe e vajzave tona i kanë thyer këto koncepte.

Rinia përbën gjakun e ri për Partinë. Të rintjtë

dhe të rejat janë njerëz të sakrificës. Njerëzit me moshë 40 vjeç e lart janë në gjendje të bëjnë propagandë, po për t'u hedhur në luftë dhe në punë nuk e kanë atë vrull si të rintjtë, pse është e natyrshme që këta do të mendojnë ca jo për shtëpinë, jo për gruan e fëmijët, jo për shëndetin etj., kurse të rintjtë, që nuk i kanë këto preokupacione, nuk pyesin fare, ata hidhen pa hezitim në çdo front pune e lufte që i cakton Partia, mjafton vetëm puna e vazhdueshme edukuese e bindëse me ta.

Ne kemi një organizatë rinie shumë të mirë, por si këtë, ashtu edhe organizatën e gruas revisionistët u përpoqën të na i likuidonin. «Ç'na duhen këto?», na thoshin ata, bile në disa vende të tjera e prishën organizatën e gruas, ndërsa ne, përkundrazi, e forcuam atë gjithnjë e më shumë. Organizatën e rinisë revisionistët donin, gjithashtu, të na e shthurnin, mirëpo Partia jonë nuk ua vuri veshin «këshillave» të tyre dhe bëri të kundërtën; ajo porosiste pareshtur dhe merrte masa konkrete që rinia të kalitej e të forcohej vazhdimiشت.

Përpjekjet e Partisë sonë kanë synuar që të kuptohej mirë ç'detyra kanë organizata e Frontit, e bashkimeve profesionale, e rinisë, e gruas, me qëllim që veprimitaria e tyre të mos përplasej, duke ngatërruar kështu kompetencat dhe detyrat e njëra-tjetrës. Ato kanë edhe detyra të përbashkëta, po kanë edhe detyra specifike. Të gjitha këto, natyrisht, u përcaktuan në luftë e sipër dhe gjatë gjithë kohës këto organizata dhe leva të fuqishme të Partisë kanë fituar një përvojë të madhe, si për punën e tyre të përbashkët, ashtu

edhe për punën e veçantë. Partia jonë e ka specifikuar ndihmën që jep për secilën, me qëllim që të gjithë njerëzit t'i ushqejë me mësimet e veta dhe t'i vërë në lëvizje, pse secila, rinia, gruaja, krahas klasës punëtore si klasë udhëheqëse, kanë probleme të vëcanta.

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha. «Kun-
dër revizionizmit modern
(Përbledhje veprash)
1968-1970», f. 363*

*Botohet me ndonjë shkurtim
sipas librit: Enver Hoxha.
«Kundër revizionizmit mo-
dern (Përbledhje veprash)
1968-1970», f. 363*

**SITUATA NË EVROPËN PLAKË KËRKON
INTENSIFIKIMIN E LUFTËS KUNDER
KAPITALIZMIT E REVIZIONIZMIT**

Nga biseda me ambasadorin kinez

22 maj 1969

Ne pritëm me gëzim ardhjen tuaj në Shqipëri, si i dërguari i popullit të madh kinez. Ju do ta vizitoni vetë anembanë Shqipërinë, do të merrni takim me komunistë e me popullin dhe do të keni rastin të shikoni dashurinë që kanë ata për popullin kinez. Vija e Partisë sonë është e tillë që miqësia dhe aleanca midis popullit shqiptar e atij kinez të forcohen, që masat punonjëse të Shqipërisë këtë aleancë, miqësi e dashuri t'i shikojnë edhe si një faktor me rëndësi për zgjerimin dhe për forcimin e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkontinentare. Shpresojmë që bashkëpunimi midis nesh të mos zhvillohet në forma diplomatike, por në rrugë komuniste, në linjë partie. Në mes partive tona nuk duhet të ketë diplomaci. Dihet se komunistët, brenda në parti, bashkëpunojnë ngushtë dhe me zemër të hapët me njëri-tjetrin për çdo çësht-

je. Kështu duhet të veprohet edhe midis partive, pra, edhe midis nesh, prandaj them që në marrëdhëniet tona me ju nuk duhet të ketë forma diplomatike. Ardhja juaj në vendin tonë, shoku ambasador, duhet, mendojmë ne, të aktivizojë e të gjallërojë më tepër bashkëpunimin midis nesh. Për t'ia arritur këtij qëllimi kanë rëndësi të madhe lidhjet tona të ngushta e të shpeshta.

Ne jetojmë dhe luftojmë në Evropë. Për ato që dimë, e sa do të mund të mësojmë, ne do të bisedojmë e do të konsultohemi bashkërisht (jo si diplomatë, por si shokë) për gjendjen që ekziston në çdo shtet revisionist e kapitalist edhe këtu në Evropën plakë¹, për situatat e krijuara e, mundësisht, edhe për ato që do të krijohen, për takтикat që përdorin e do të përdorin armiqjtë për të shtypur lëvizjet revolucionare në botë dhe takтика kundër nesh e marksizëm-leninizmit. Do të bisedojmë edhe për kontradiktat që kanë këta armiq midis tyre, për mjetet që na duhen neve për t'i thelluar këto kontradikta, për të neutralizuar propagandën e tyre dhe për t'ua vështirësuar e për

1 Në fakt, udhëheqësit kinezë mbanin heshtje ndaj ngjarjeve që zhvilloheshin në Evropë. Tri javë më parë, në Ditarin e vet Politik shoku Enver Hoxha, ndër të tjera, shkruante: «Shokët kinezë nuk pipëtijnë fare mbi ç'po ngjet në Çekoslovaki, në Poloni dhe në Evropë. Ata asnjë shenjë s'japin, asnjë presje nuk vënë në gazetat e asgjë nuk thonë në radiot e tyre për çka shkruajmë dhe themi ne kundër revizionistëve. Çudi!!... politika kinezë nuk interesohet fare për Evropën. Çudi!!». (Shih: Enver Hoxha. «Shënimë për Kinën», vëll. I, f. 423, 424.)

t'ua prishur planet që ata përgatitin për shpërthimin e një lufte të re etj.

Në këtë drejtim, përveç çështjeve tona të tjera të brendshme politike, ekonomike, kulturore etj., që kanë një rëndësi të dorës së parë, mendojmë që për problemet e përmendura më lart të kemi një bashkëpunim më të ngushtë, mbasi në luftën e saj lëvizja komuniste e punëtore ndërkombëtare ka nevojë përqëndrime strategjike dhe taktkike të përbashkëta.

Momentet aktuale janë të atilla që çdo ditë e më shumë, me gjithë kontradiktat e thella që kanë menjëri-tjetrin, midis imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve sovjetikë, të cilët përdorin parulla socialiste, por në të vërtetë zbatojnë një politikë imperialiste në të gjitha fushat, ekziston bashkëpunimi për shumë çështje, si për ndarjen e sferave të influencës, ashtu edhe për të luftuar së bashku kundër marksizëm-leninizmit, popujve e revolucionit.

Urrejtja në popujt e botës, bile edhe pakënaqësia në shtete, qofshin këto kapitaliste, qofshin revizioniste, janë reale, konkrete kundër imperializmit amerikan dhe revizionizmit sovjetik. Kjo është e padiskutueshme, pse ne i shohim qartë kontradiktat që ekzistojnë. Këto kontradikta midis popujve dhe armiqve imperialisto-revizionistë vijnë vazhdimisht duke u thelluar. Imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik përpilen ose t'i shtypin me forcë popujt, ose t'u bëjnë disa lëshime të vogla për të ruajtur hegemoninë e tyre. Por ajo që i bashkon më shumë ata është frika e madhe që kanë nga marksizëm-lenizmi dhe nga revolucioni proletar. Kjo do të thotë

se imperializmi dhe revizionizmi janë të krimbur, kurse ne jemi të fortë. Kontradiktat e mëdha që kanë ata me njëri-tjetrin po i brejnë gjithnjë e më shumë.

Ne do të kemi rast të bisedojmë bashkërisht edhe në detaje për luftën tonë, por edhe sikur pak e në përgjithësi të flasim, mund të themi se stani revizionist është i shthurur. Vetë krerët e revizionistëve modernë, revizionistët hrushovianë, jo vetëm që e kanë shndërruar Bashkimin Sovjetik plotësisht në një vend kapitalist, por tani po përdorin metoda fashiste si brenda në partinë dhe në vendin e vet, ashtu edhe ndaj satelitëve të tyre. Demagogjité e hrushovianëve se gjoja janë të fortë dhe në unitet midis tyre nuk na gjenjejnë. Ato nuk gjenjejnë dot as partnerët e vet në vendet kapitaliste, që e dinë se perandoria fashiste revizioniste nuk është e fortë. Në interesin e revolucionit ne duhet të bëjmë edhe më shumë për shkatterrimin e klikës revizioniste hrushoviane të Moskës dhe të satelitëve të saj.

Le ta shohim çështjen nga pikëpamja ideologjike. Revizionistët do të bëjnë më 5 qershor të këtij viti një mbledhje në Moskë. Kudo po flitet nga ana e tyre për «unitetin marksist-leninist», po qëllimet e kësaj mbledhjeje janë një *modus vivendi* i revizionistëve sovjetikë, që përpilen për të mbajtur nën drejtimin e vet klikat në fuqi në partitë revizioniste të vendeve të ndryshme të Evropës dhe të kontinenteve të tjera. Klikat revizioniste që do të dërgojnë përfaqësuesit e tyre në këtë mbledhje nuk janë dakord me revizionistët sovjetikë. Ato kanë kontradikta të mëdha

me ta, sepse janë vetë të borgjezuara, politika e tyre anon më shumë nga borgjezia kombëtare e vendeve të veta, që është në kundërshtim me synimet e social-imperializmit sovjetik. Prandaj revisionistët dërgojnë përfaqësuesit e tyre në Moskë jo për unitet, por për t'i thelluar edhe më shumë kontradiktat dhe për të dobësuar forcën e socialimperializmit sovjetik.

Grupi i Gomulkës paraqitet aktualisht prosovjetik i vendosur, por në të vërtetë ai është antisovjetik. Gomulka është një fashist. Këtë neve na e ka thënë me gojën e tij Hrushovi. Tani ky fashist na qenka «miku» i sovjetikëve. Po përse Gomulka paraqitet tani si prosovjetik? Për arsy, kuptohet, të pozitave të tij shumë të lëkundshme brenda në Poloni dhe për t'u mbrojtur nga ndonjë katrahurë e madhe qoftë në lidhje me një revolucion të vërtetë brenda, qoftë me një sulm nga Gjermania Perëndimore. Për këto arsy ai përpinqet të duket si mik i sovjetikëve, pra, nga halli e jo nga malli.

Janosh Kadari është këlysh besnik i Moskës, ai ishte «djali» i dashur i Hrushovit, prandaj ky e mban te shumë afër. Ne e njohim kush është Kadari, një element kundërrevolucionar, fashist. A mund të jetë ky prosovjetik? Në asnjë mënyrë! Ai është gati të shitet dhe është shitur në çdo moment në Perëndimin kapitalist. Por aktualisht nuk ka ç'të bëjë, sepse situata në Hungari tani mbahet vetëm me forcë dhe mund të ngjasë ndonjë gjë si në kohën e ekipit të Imre Nagit.

Titoja është një antimarksist nga maja e kokës gjer në fund të këmbëve, një agjent shumë i kualifi-

kuar i imperializmit. Ai mendoi të përfitonte shumë nga degjenerimi i Bashkimit Sovjetik nga një vend socialist në një vend revisionist. Hrushovi, sa erdhi në fuqi, u përpoq ta gëlltiste edhe Jugosllavinë revisioniste të Titos, ta fuste nën kontrollin e tij. Por Titoja është dinak. Ky kishte planet e tij, jo t'i përulej Hrushovit, por ky i fundit t'i binte në gjunjë. Me politikën e vet Titoja ka synuar që, për të dobësuar Bashkimin Sovjetik, të shkëpuste më parë sate-litet e tij. Kjo taktkë është ndjekur qysh në fillim nga ana e tij dhe këtë Partia jonë e ka kuptuar prej kohësh. Titoja në fillim ka qenë agjent i Çërçillit, i anglezëve, pastaj ndërroi padron, u kthyte dhe u bë agjent i imperialistëve amerikanë. Strategjia e tij kishte për qëllim të shkëpuste të gjitha vendet ballkanike dhe të Evropës Qendrore nga Bashkimi Sovjetik, pastaj ta godiste dhe ta dobësonte vetë atë. Këtë strategji e dinte edhe Hrushovi, prandaj ai u përpoq ta fuste brenda në vathën e tij Jugosllavinë. Për këtë revisionistë hrushovianë kanë përdorur çdo mjet, çdo manovër, herë me përkëdheli e herë me presione, por nuk u ka ndezur, se Titoja është dhelpër¹. Ai edhe

¹ Lidhur me këtë, në Ditarin Politik shoku Enver Hoxha ka shkruar: «Sovjetikët... e përkëdhelin Titon, shkruajnë e flasin mirë për të, i premtojnë e i japin kredi. Titoja, si një dhëlpër plakë, u avitet dhe u buzëqesh. Kur s'ia arrijnë dot plotësisht qëllimit, sovjetikët i shtrëngojnë dhëmbët. Titoja merr atëherë pozën e maces, që mpreh thonjtë dhe ngre mustaqet kundër sovjetikëve, por në të vërtetë bën mjau në drejtim të amerikanëve». (Shih: Enver Hoxha. «Shënimë për Kinan», vell. II, f. 166.)

tani qëndron në opozitë me Brezhnjevin e me Kosigjin, për arsyet taktike dhe strategjike.

Në rrethanat aktuale Titoja ndjek një politikë pro-amerikane. Ai vazhdon politikën e shthurjes së vendeve revizioniste, që Bashkimi Sovjetik përpinqet t'i mbajë nën fre, dhe punon për dobësimin e pozitave të tij kudo në botë, me qëllim që padronët amerikanë të mos kenë te Bashkimi Sovjetik një rival të fortë, por të krimbur. Pikërisht për këto arsyet Brezhnjevi e kërcënnon Titon me agresion. Ky hiqet sikur ka frikë nga Bashkimi Sovjetik, por në të vërtetë ne mendojmë se nuk duhet të ketë, mbasi e merr me mend që në situatat aktuale Bashkimi Sovjetik e ka shumë të vështirë të sulmojë Jugosllavinë. Titoja ka frikë vetëm nga një gjë, nga vështirësimi i gjendjes së brendshme të vendit, sepse me regjimin kapitalist që ai ka vendosur, ua ka shitur Jugosllavinë fuqive imperialiste. Në Jugosllavi, në fakt, është vendosur një diktaturë fashiste, prej kohësh po nxiten ndjenjat shoviniste kundër popujve të saj dhe është krijuar tani një situatë e brendshme shumë e vështirë.

Tani atje ekzistojnë kontradikta të mëdha ndërmjet serbëve dhe kroatëve, sllovenëve dhe serbëve, kroatëve e maqedonasve, malazezve dhe maqedonasve, serbëve dhe vëllezërve tanë shqiptarë që banojnë në trojet e veta në Jugosllavi. Njerëzit e Rankoviçit përpinqen ta shfrytëzojnë këtë gjendje dhe ta rrëzojnë Titon. Pikërisht nga kjo ka shumë frikë Titoja, prandaj aktualisht po bën «spastrime» të mëdha në ushtri, duke larguar prej saj e duke nxjerrë në pension me qindra gjeneralë, figura të njoitura të luftës na-

cionalçlirimtare, shumë nga të cilët mund të janë prosovjetikë. Këtu e ka Titoja pikën më të dobët, megjithëse i bën thirrje popullit për t'u mobilizuar kundër një pushtimi sovjetik. Por pozitive është se popujt e Jugosllavisë janë trima, luftëtarë.

Sipas mendimit tonë, presioni sovjetik kundër Jugosllavisë synon që Titoja të ndalojë veprimtarinë di-versive antisovjetike në Çekoslovaki dhe të mos mbështetë rezistencën e rumunëve. Mirëpo Titoja nuk e ka ndaluar këtë veprimtari në këto dy drejtime, prandaj sovjetikët e vazhdojnë presionin kundër tij.

Titoja, pas vitesh të tëra, më së fundi e pa se nuk mund ta gjelltiste dot Shqipërinë, sepse ajo ka luftuar dhëmb për dhëmb me të. I nisur edhe nga koniunkturat e krijuara, në një fjalim të kohëve të fundit, u detyrua të deklarojë se Shqipëria është një faktor i rëndësishëm paqeje në Ballkan. Po ne e kemi të qartë q'dredharak është Titoja. Këtë e ka treguar edhe kur ndodhën ngjarjet në Usuri midis Bashkimit Sovjetik dhe Kinës. Ai nuk mbajti qëndrim as prokinez, as prosovjetik, por një qëndrim ekuivok, me gjithëse ambasadori sovjetik Benediktov, me porosi të Brezhnjevit, shkoi në Brioni, ku e akuzoi Titon se po mbante qëndrim prokinez.

Gjatë zhvillimit të këtyre ngjarjeve në Evropën Lindore, në gazeten tonë «Zëri i popullit» botuan një artikull¹, në të cilin deklaronim dhe bënim të ditur se, megjithëse ne kemi kontradikta të papajtueshme politike dhe ideologjike me titistët, në rast se do të

1 Shih në këtë vëllim shënimin e faxes 38.

kryhet ndonjë agresion kundër Jugosllavisë dhe Rumanisë, populli shqiptar do të mbajë anën e popujve të Jugosllavisë dhe të atij rumun. Kjo u erdhi shumë mirë Titos dhe Çausheskut, por sidomos ka bërë përshtypje të madhe te popujt e Jugosllavisë e te popujt e tjerë të Ballkanit, të cilët e vlerësojnë këtë qëndrim si plotësisht të drejtë.

Rezistenca jugosllave dhe rumune kundër një agresioni sovjetik ka rëndësi të madhe edhe për vendin tonë. Rreziku për ne nga ana e socialimperializmit sovjetik aktualisht ekziston, por një sulm sovjetik kundër Shqipërisë do t'i detyrojë forcat e armatosura sovjetike, qofshin këto ajrore ose tokësore, të kalojnë nëpërmjet Jugosllavisë. Pra, në rast se do të sulmohet Jugoslavia, vendi ynë rrezikohet, prandaj ne do të luftojmë kundër një agresioni ndaj Jugosllavisë. Edhe taktikisht rezistenca jugosllave, pavarësisht çfarë është Titoja, neve na intereson, pse, duke u futur me luftë në territorin jugosllav, sovjetikët do t'i drejtohen, të dobësuar moralisht dhe ushtarakisht, vendit tonë dhe atëherë ne do të luftojmë për t'u dhënë goditjen e duhur e s'do t'i lejojmë të hyjnë në Shqipëri.

Mendojmë se një sulm sovjetik kundër Shqipërisë, nëpërmjet hapësirës ajrore të Jugosllavisë, nuk do të ketë shumë efekt. Sovjetikët mund të hedhin desantë ajrorë në Shqipëri, por ne i kemi marrë masat e do t'i grijmë ata. Fashistët sovjetikë, megjithatë, çdo gjë mund të bëjnë, por çështja është se jo vetëm ne, por edhe popujt e Jugosllavisë do të luftojnë. Revisionistët sovjetikë përpinqen ta rrëzojnë nga brenda klikën e Titos dhe të sjellin në fuqi atë të Rankoviçit,

pse po ta sulmojnë ushtarakisht Jugosllavinë, rreziku i parë për ta do të ishte se popujt e saj do të luftojnë kundër tyre dhe rreziku i dytë se në këtë ndeshje do të ndërlikohej edhe NATO-ja, mbasi me pushtimin e Jugosllavisë rrezikohet drejtpërsëdrejti anëtarja e saj, Italia.

Ne e kemi të qartë që, në qoftë se do të na sulmojnë socialimperialistët sovjetikë, mund të na sulmojnë edhe imperialistët në të njëjtën kohë, sepse vendi ynë është një pikë e rëndësishme strategjike, të cilën armiqqtë tanë synojnë ta rrëmbejnë secili për vete. Të gjitha këto koniunktura ne i kemi parasysh dhe ato na bëjnë të mos humbasim për asnjë çast vigjilencën, të cilën vazhdimisht e kemi mbajtur lart, mbasi rreziku i sulmit për ne ka ekzistuar kurdoherë, ai ka qëndruar si shpata e Damokleut mbi Shqipërinë. Ne jemi të përgatitur për t'i bërë ballë çdo rreziku, qoftë nga Lindja, qoftë nga Perëndimi.

Partia jonë ndjek një politikë konsekiente mark-siste-leniniste e, së bashku me popullin, punon vazhdimisht që të forcohem i çdo ditë e më shumë ushtarakisht.

Sa për Todor Zhivkovin, mund të themi pa frikë se është një shërbëtor besnik i revizionistëve sovjetikë, pa asnjë kredi në popull dhe qëndron në fuqi vetëm në sajë të forcave sovjetike.

Edhe udhëheqësit rumunë janë oportunistë, revizionistë, por në opozitë me sovjetikët. Gjer tani ata mbajnë, si të thuash, njëfarë qëndrimi nationalist, natiyrish, janë kundër një pushtimi të vendit të tyre nga revizionistët sovjetikë. Sa do të qëndrojnë në këto

pozita, duke marrë parasysh sa «revolucionarë» janë ata, këtë nuk e dimë, por kjo varet edhe nga qëndrimi i udhëheqjes dhe nga veprimtaria e rrjetit të madh agjenturor që ka Bashkimi Sovjetik brenda në Rumania etj. Rumania merr pjesë në manovrat që bëjnë vendet e Traktatit të Varshavës, ajo do të marrë pjesë, gjithashtu, në mbledhjen e Moskës të 5 qershorit.

Edhe për Çekosllovakinë s'kemi q'të themi, agresioni sovjetik mbi të tregon gjithçka për gjendjen e saj.

Socialimperialistët sovjetikë, pra, kërkojnë t'i forcojnë pozitat e tyre fashiste në vendet satelite, ku popujt kanë filluar të rezistojnë, kurse udhëheqjet e këtyre vendeve të kundërshtojnë diktatin sovjetik. Qëllimi i socialimperializmit sovjetik, sipas mendimit tonë, është që të gjitha vendet e Traktatit të Varshavës t'i mbajë nën fre me metoda fashiste, imperialiste dhe të shtypë çdo rezistencë. Por shtypja krijon dhe do të krijojë medoemos rezistencë e kontradikta gjithnjë e më të mëdha. Klika e Brezhnjevit përpinqet t'i mbajë këto vende nën sundimin e vet ideologjik, politik, ushtarak dhe ekonomik, ajo përpinqet, sa të jetë e mundur, që vendet satelite të mos i rrëshqasin nga dora e të mos bëhen koloni të imperializmit amerikan apo të borgjezisë kapitaliste evropiane.

Klikat revisioniste në fuqi në vendet e «demokracisë popullore», si ajo e Gomulkës e të tjera, janë transformuar në klika fashiste. Qëllimi i tyre është të shtypin çdo rezistencë dhe revoltë popullore. Revisionistët sovjetikë synojnë t'i tërheqin satelitët e tyre pas qerres së politikës së vet imperialiste jo vetëm në Evropë, por edhe në Azi.

E tillë është situata në vija të përgjithshme në stanin revizionist.

E njëjtë situatë ekziston edhe në vendet kapitaliste të Evropës. Le të marrim, për shembull, Italinë që kemi afër vendit tonë. Pozitat e qeverisë aktuale demokristiane atje janë të lëkundshme. Çdo ditë në Itali po bëhen greva të mëdha nga punëtorët, gjë që tregon paqëndrueshmërinë e gjendjes. Atje kanë penetruar thellë kthetrat e kapitalit monopolist amerikan. Kudo ka pakënaqësi të madhe në popull, të gjitha partitë politike janë të çoroditura. Partia Demokristiane është e ndarë në shtatë-tetë korrente, edhe partitë e tjera janë bërë çorbë. Tendenca e partisë revizioniste italiane është të futet në aleancë me partitë e borgjezisë kapitaliste që të mund të zhvatë edhe ajo ndonjë post në qeveri. Ky është synimi i saj, prandaj partia revizioniste italiane është një nga ato që u kundërshton më shumë revizionistëve sovjetikë.

Në Francë është e njëjtë gjendje si në Itali. Largimi i Dë Golit është një disfatë për grupet monopoliste franceze, e shkaktuar nga kriza monetare dhe nga intrigat e mëdha që thur në Francë imperializmi amerikan. Mirëpo largimi i Dë Golit nga skena politike shkaktoi disa situata të vështira për statukuonë e grupimeve kapitaliste të krijuara nga imperializmi amerikan. Tani imperializmi gjerman, për shembull, ka ngritur krye, përpinqet të sigurojë në Evropë pozita më të forta politike, ekonomike dhe ushtarake e tanëdryshojë situatën. Ndërsa më parë promotori i një Evrope të bashkuar gjer në Uralet ishte Dë Goli, këtë rol tani kërkon ta luajë Gjermania Perëndimore.

Kapitali evropian, sipas mendimit tonë, tani është mëkëmbur, ai ka krijuar tregjet e veta në botë, që bien në kundërshtim me interesat e imperializmit amerikan, i cili mbahet në sajë të këtyre tregjeve duke thithur prej kolonive të tij të reja të gjitha lëndët e para. Këto, natyrisht, nuk janë koloni në kuptimin klasik, por imperialistët grabitqarë, sidomos ata amerikanë, janë po aq kolonialistë, bile më të tmerrshëm se kolonialistët e vjetër. Karakteri i imperializmit amerikan nuk ka ndryshuar, megjithëse politika e tij neokolonialiste nuk është më si ajo e kolonializmit të vjetër, ta zëmë si e kolonializmit francez që kishte territore të caktuara me kufij dhe bojëra, ose si e kolonializmit anglez. Imperializmi amerikan sot ka forma të tjera, të reja skllavërimi. Ai ka shtrirë kudo rrjetin e merimangës dhe thith jo vetëm lëndët e para, por deri edhe te trutë, domethënë rrëmbe sa më shumë njerëz të mësuar nga Italia, Gjermania, Franca, Anglia etj., për të fuqizuar potencialin e vet. Ai i ka dhënë një fuqi aq të madhe garës së armatimeve, saqë Pentagoni është bërë tani jo vetëm një qendër lufte, por edhe një qendër që vë në lëvizje një industri kolosale, që vë në lëvizje në vendin e vet dhe në vendet e tjera klikat në fuqi.

Të gjitha këto imperializmi amerikan i ka mbështjellë me demagogjinë e «lirisë», të «botës së lirë», të «demokracisë», të «mbrojtjes së paqes» etj. Edhe ndërhyrjen në Vietnam me këtë demagogji përpinqet ta shpjegojë, gjoja për të mbrojtur «lirinë» dhe «demokracinë». Ai rrëzoi Mosadekun për të forcuar pozitat e shahut të Iranit për hir të «lirisë», të «humana-

nizmit» etj. Në Kubë, në Santo-Domingo e gjetkë ka vepruar po kështu. Me një fjalë, imperializmi amerikan kërkon të vendosë kudo në botë sundimin e vet, përpinqet t'i mbajë nën fre edhe aleatët e tij më të ngushtë në Evropë, mirëpo ndër ta ekzistojnë e porriten vazhdimisht forca centrifugale dhe, në një mënyrë ose në një tjetër, ata përpinqen të shkëputen nga zinxhiri i hekurt i imperializmit amerikan.

Të njëjtat tipare ka edhe imperializmi sovjetik, që ka futur nën kthetrat e veta vendet e «demokracisë populllore» në Evropë dhe përpinqet të penetrojë edhe gjetiu, si në Egjipt, në Siri, në Liban, në Algjeri etj., e të ndajë sferat e influencës me imperializmin amerikan.

Në Lindjen e Mesme ka shumë kontradikta. Revizionistët sovjetikë po bëjnë atje një punë shumë të poshtër. Ata po përpinqen ta shuajnë luftën e partizanëve palestinezë, e cila nuk u leverdis, mundohen të bëjnë kompromise me imperialistët amerikanë. Bashkimi Sovjetik revizionist po bën mjaft orvatje për të hapur kanalin e Suezit, për të shkuar më shpejt në Oqeanin Indian.

Partia dhe Komiteti i saj Qendror na mësojnë të ndjekim kurdoherë me vigjilencë të lartë të gjitha koniunkturat që po zhvillohen në botë. Me ato mundësi që kemi, ne do të japim edhe në të ardhmen kontributin tonë për demaskimin e plotë e të pamëshirshëm të imperializmit amerikan, të revizionizmit sovjetik dhe të gjithë imperializmit botëror; për të ngjallur te popujt besimin në fitoren, e cila do të realizohet vetëm nëpërmjet luftës së armatosur, sepse

ndryshe imperializmi dhe revizionizmi modern nuk mund të mposhten; për të forcuar te popujt bindjen se ata janë më të fortë nga klikat imperialiste, të cilat përbëhen nga disa grushte njerëzish. Kur popujt bëhen të ndërgjegjshëm për forcën e pathyeshmërینë e tyre, dhe ne duhet të punojmë pa u lodhur për ta forcuar këtë bindje tek ata, imperializmi amerikan dhe ai sovjetik dobësohen e, së fundi, shkatërrohen. Komunistët duhet të punojnë që t'i përgatitin popujt për të filluar dhe për të intensifikuar rezistencën kundër imperializmit amerikan e revizionizmit sovjetik dhe për t'u shtuar besimin në të ardhmen.

Me dhjetëra e dhjetëra radio flasin çdo ditë kundër nesh, duke na quajtur satelitë të Kinës. Ditë dhe natë Radio Moska nuk lodhet së përmenduri ato që na ka dhënë Bashkimi Sovjetik: një kombinat tekstili, një fabrikë sheqeri e çimentoje e disa fabrika të tjera më të vogla. Është tipike kjo sjellje e revizionistëve, me të cilën kërkojnë që, për hir të këtyre ndihmave, ne të bëherni shërbëtorët e tyre. Ç'njérëz të poshtër që janë! Në gjithë propagandën që zhvillojnë në drejtim të Shqipërisë, revizionistët sovjetikë shpifin duke thënë se ne paskemi mbetur me ato që kemi ndërtuar në kohën e tyre. Sa keq kanë vepruar ata kundër nesh! Kur na dërgonin traktorë, nuk na jepnin pjesë këmbimi dhe traktorët për një kohë të gjatë nuk na punonin; kur shkonin shokët e ambasadës sonë dhe kërkonin të plotësosheshin këto mungesa, ata na dërgonin sasi fare të vogla pjesësh, nga tri-katër arka dhe, gjoja për urgjencë, me avion. Kur u kërkonim një uzinë, na jepnin me reparte të tëra mangët, me të

vetmin qëllim që të na kishin në dorë. Ekipet e tyre gjeologjike gjatë kërkimeve që bënин për naftë, krom, bakër etj., na thoshin se asgjë prej këtyre nuk paskësh në Shqipëri. Mirëpo kur u larguan specialistët që na kishin dërguar revizionistët sovjetikë, ne filluam të bëjmë kërkime dhe zbuluam vetë shumë lloje mineralesh. Dokumentet që kemi në dorë, të firmosura nga gjeologët sovjetikë, për ato territorë në të cilat tani kemi gjetur burime mineralesh, tregojnë sikur nuk ka minerale, kurse tani ne po i vazhdojmë kërkimet pikërisht në ato pika ku ata «kanë vërtetuar» se nuk kishte, dhe kemi gjetur. Byroja Politike i porositi gjeologët tanë të rinj të vazhdonin të kërkonin më parë atje ku gjeologët revizionistë na thoshin se nuk ka. Kështu kanë vepruar ata në vendin tonë. Prandaj e marrim me mend se si sillen me popujt e tjerë, për shembull, të vendeve afrikane, tamam si imperialistë, me të gjitha tiparet e tyre të shëmtuara.

Propaganda shpifëse e revizionistëve sovjetikë nuk na prish asnë punë, fundja këtë detyrë kanë armiqtë, të flasin keq kundër nesh. Por nuk do të mund të na bëjnë dot gjë, pse me ne është drejtësia marksiste-leniniste, janë popujt. Për t'ua arritur qëllimeve tona do të na duhet të bëjmë shumë luftë, përpjekje dhe sakrifica, po këto ne i kemi marrë parasysh. Imperialistët dhe revizionistët kërkojnë qetësi, kurse ne duam revolucion. Prandaj ata flasin e propagandojnë aq shumë për «humanizmin» e tyre, për politikën e «bashkekzistencës paqësore», me qëllim që të livadhisin në kurriz të popujve.

Neve na vjen shumë keq kur shohim se po tradhetohet lufta heroike e popullit vietnamez. Ky popull ka luftuar e ka derdhur shumë gjak, por ai duhet ta vazhdojë akoma luftën dhe t'i kapërcejë vështirësitë. Ne kemi besim se ai do t'i kapërcejë këto vështirësi.

Duke folur shkurtimisht për gjendjen në Shqipëri, shoku Enver Hoxha tha:

Sot te ne ka shpërthyer një lëvizje e madhe kundër burokratizmit. Po rishikohen organikat, veçanërisht, nëpër dikastere, pse edhe shkresa bëhen më pak kur numri i njerëzve në administrata është aq sa duhet. Edhe pak kuadro po të kesh, kur janë njerëz të vendosur, të aftë dhe me iniciativë, punët kryhen më mirë. Ne kështu kemi vepruar e vazhdojmë të ecim në këtë rrugë dhe shohim që punët na shkojnë shumë më mirë. Shkurtimi i aparateve dhe i hallkave të tępërtë ka për qëllim jo vetëm t'i bëjë këto më pak të kushtueshme, por ajo që ka më shumë rëndësi, kjo masë synon të revolucionarizojet mendjet e kuadrove tanë. Nga qyteti do të shkojnë në fshatra një numër kuadrosh, të cilët jo vetëm do t'i ndihmojnë fshatarët, por do të kaliten edhe vetë. Me përjashtim të të sëmurëve dhe të atyre që janë të kaluar nga mosha, të gjithë kuadrot tanë bëjnë punë në prodhim në uzina, në ndërmarrje, në kooperativa bujqësore etj. Këto masa janë shumë të domosdoshme, ndryshtë ngjasin katastrofa për Partinë dhe për popullin, pse jepet mundësi të mbizotërojnë në Parti sëmundjet mikroborgjeze, kuadrot, qofshin edhe komunistë, të borgjezojen, të bëhen arrogantë, mendjemëdhenj, mashtrues, të përdorin autoritetin e Partisë në dëm të saj, të po-

pullit dhe të socializmit etj., ashtu siç bëhet sot në Bashkimin Sovjetik, ku anëtarët e së quajturës parti e Leninit janë kthyer në borgjezë me tërë kuptimin e fjalës.

Tani çështjen e edukatës së punës ne po e futim edhe me anë të revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës, bashkë me përgatitjen ushtarake dhe ideologjike në forma më të përparuara. Këtë po e bëjmë me qëllim që brezat e ardhshëm të krijojnë mentalitetet e punëtorëve dhe të fshatarëve e të mos infektohen me tiparet e intelektualit borgjez e mikroborgjez. Qëllimi i revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës është që ta përgatitim rininë me shkencë dhe me dituri, por, në radhë të parë, ta brumosim atë me ideologjinë marksiste-leniniste jo vetëm nga ana teorike, por edhe praktike.

Po përpinqemi që në të gjitha tekstet mësimore brendia të përshkohet nga ideologjia marksiste-leniniste. Ne kemi parasysh që edhe në punët praktike nxënësit e studentët të punojnë dhe të jetojnë gju më gju me popullin, me punëtorët dhe me fshatarët, të përgatiten njëkohësisht edhe ushtarakisht për mbrojtjen e atdheut. Gjithë sistemi ynë i ri shkollor do të jetë një kombinim i tërë. Në diskutimet për këtë problem po merr pjësë në shkallë të gjerë dhe në mënyrë të organizuar mbarë populli. Prandaj për këtë problem Komiteti Qendror i Partisë sonë ka tani një shumicë të madhe propozimesh. Së shpejti do të bëhet një mbledhje e Byrosë Politike për çështjen e shkollës, e cila do të dalë me konkluzione për Plenumin e Komitetit Qendror, për të përcaktuar përfu-

ndimisht orientimet e përgjithshme lidhur me rrugën në të cilën duhet të ecë shkolla jonë.

Si marksistë-leninistë, si komunistë dhe revolucionarë që jemi, ne do të luftojmë brez pas brezi, gjer në fund, për fitoren e plotë të socializmit dhe të komunizmit, pa kursyer asgjë ngajeta jonë, mbasi jemi të bindur e plotësish të ndërgjegjshëm se vetëm kështu mbrohet liria e atdheut dhe e popullit, vetëm kështu ndërtohen socializmi e komunizmi dhe shpëton mbarë njerëzimi nga kapitalizmi botëror.

Ne luftojmë me këmbëngulje që t'i kapërcejjmë pengesat dhe vështirësitë e zhvillimit. Gjithçka kapërcehet kur ekzistojnë vendosmëria, qëllimet e larta, drejtësia në vijë dhe uniteti. Kemi besim të madh në fitoren tonë dhe jemi të bindur që do të fitojmë mbi armiqjtë, nga të cilët kurrë nuk kemi pasur dhe nuk kemi frikë.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

ALEANCA SOVJETO-AMERIKANE NË VEPRIM KUNDËR POPULLIT ÇEKOSLLOVAK

Artikull i botuar në gazeten «Zëri i popullit»

23 maj 1969

Sot nuk ka gjë tjetër që të jetë aq antipopullore dhe aq e urryer nga popujt e botës sa ç'është bashkëpunimi agresiv i imperialistëve amerikanë dhe i revisionistëve sovjetikë kundër lirisë e pavarësisë së popujve, kundër revolucionit dhe përpjekjeve për përparimin e shoqërisë njerëzore. Në Vietnam apo në Çekoslovaki, në Lindjen e Mesme apo në brigjet e Usurit, në detin Mesdhe apo në atë të Japonisë, kudo ku ka konflikte e tensione, janë kurdoherë të pranishëm thonjtë grabitqarë të kësaj aleance të zezë ultrareaksionare.

Ngjarjet e Çekoslovakisë, për momentin kur ndodhën dhe për mënyrën si u zhvilluan, vërtetuan edhe një herë jo vetëm ekzistencën e një komploti amerikano-sovjetik për ndarjen e sferave të influencës dhe përvendosjen kudo të hegemonisë së tyre politike, ekonomike e ushtarake, por edhe faktin se ky komplot po zbatohet në praktikë. Qëndrimi prej Pons Pilati që

mbajtën Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe fuqitë e tjera perëndimore ndaj agresionit të revizionistëve sovjetikë kundër Çekoslovakisë, zbulon gjithë cinizmin dhe poshtërsinë e këtij makinacioni monstruoz imperialisto-revizionist. Këtë të vërtetë e dëshmuant përsëri edhe ndryshimet që u bënë kohët e fundit në hierarkinë e lartë të Pragës.

Është krejtësisht e kuptueshme që krerët e Krem-linit e kishin litarin në grykë dhe do të bënин çmos për të vendosur në Çekoslovakia në mos «normalizimin» aq të dëshiruar, të paktën pamjen e tij. Pas agresionit fashist kundër Çekoslovakisë, për udhëheqësit sovjetikë u krijua një situatë shumë e vështirë. U zbulua hapur fytyra e tyre prej socialimperialistësh e socialfashistësh. Përpjekjet që bënë për ta paraqitur agresionin brutal të armatosur si «ndihmë internacionale», nuk e mashtruan dot opinionin publik ndërkombëtar, që u ngrit në këmbë me urrejtje kundër tyre. Rezistenca e popullit çekoslovak po rritej vazhdimesht. Klika kapitulluese e Dubçekut nuk u tregua as plotësisht e gatshme, as në gjendje të zbatonte deri në fund vullnetin e pushtuesve sovjetikë për të krijuar në Çekoslovakia një situatë të qëndrueshme në favor të tyre. Pushtuesve sovjetikë u digjte toka nën këmbë.

Por çështja çekoslovake, e sidomos vështirësitetë në të cilat hasën revizionistët sovjetikë pas pushtimit të Çekoslovakisë, patën pasoja të rënda për klikën e Brezhnev-Kosiginit edhe brenda në Bashkimin Sovjetik; ato ndikuan për thellimin e mëtejshëm të kontradiktave në gjirin e udhëheqjes sovjetike dhe për

zgjerimin e pakënaqësisë e të kundërshtimit popullor ndaj vijës së saj tradhtare e imperialiste. Në të njëjtën kohë, marrëdhëniet me miqtë dhe aleatët e tyre jashtë, me partitë e ndryshme revizioniste dhe me popujt e ndryshëm, u keqësuan. Kontradiktat midis revizionistëve u acaruan, u shtua mosbesimi ndaj klikës udhëheqëse sovjetike, prestigji i Bashkimit Sovjetik, nën udhëheqjen e revizionistëve, pësoi një tronditje të thellë, ra përtokë.

Çekoslovakia u bë një plagë shumë e rrezikshme për revizionistët sovjetikë. Vazhdimi më gjatë i gjenjës së krijuar do të sillte pasoja shumë të rënda për klikën e Kremlinit dhe për gjithë politikën e saj.

Pa krijuar njëfarë pamjeje «normalizimi» të krizës çekoslovakake, klika e Brezhnev-Kosiginit nuk mund t'i mashtronte më gjatë popujt sovjetikë dhe të evitonë shpërthimin e shpejtë të urrejtjes popullore kundër saj. Pa mbyllur, në njëfarë mënyre, plagën çekoslovakake, udhëheqësit sovjetikë nuk mund t'i qetësonin aleatët e tyre në vendet revizioniste, të cilët rrojnë me frikën se ajo që ndodhi në Çekoslovakia, mund t'u ndodhë edhe atyre; nuk mund të zbutnin zemërimin e partive të ndryshme revizioniste dhe të rehabilitonin disi prestigjin e humbur.

Më në fund, pa gjetur një mënyrë për të ulur përkohësisht krizën çekoslovakake, revizionistët sovjetikë, siç u provua edhe kohët e fundit në mbledhjet e komisionit përgatitor në Budapest e Moskë, nuk mund të mbledhin dot më 5 qershor, në kryeqytetin e tyre, partitë e tronditura e të çoroditura revizioniste, përderisa çështja çekoslovakake të mos qe mbyllur të pak-

tën formalisht. Ata e dinë mirë se miqtë e tyre italia-në, anglezë, skandinavë e të tjerë, për të qenë në rregull me borgjezinë e tyre dhe për të evituar speku-limet e saj propagandistike, nuk mund të niseshin me qejf për në Moskë, pa u krijuar më parë opinioni i «normalizimit» të gjendjes çekoslovakake dhe pa filluar procesi i rehabilitimit të pushtuesve moskovitë.

Por si mund të arrihej kjo? Dy rrugë kishte: ose të hiqnin trupat pushtuese nga Çekoslovakia, gjë që ata nuk mund ta bëjnë kurrë, ose të sillnin në fuqi një ekip tjetër më të përshtatshëm e më të aftë për të realizuar qëllimet e tyre, qoftë edhe sikur ky ekip të mos ishte plotësisht ideal për klikën sovjetike. Ata zgjodhën rrugën e dytë — hoqën Dubçekun dhe vunë në krye të partisë revizioniste çekoslovakake Gustav Husakun. Për realizimin e këtij projekti u përdorën të gjitha mjetet, që nga provokacionet, nga agjentura e shantazhet deri te premtimet dhe kërcënimet, duke dërguar për këtë qëllim në Pragë vetë ministrin e Mbrojtjes të Bashkimit Sovjetik, mareshalin Greçko.

Eshtë fakt se për kryerjen e këtij operacioni udhëheqësit sovjetikë patën mbështetjen e plotë dhe përkrahjen e imperializmit amerikan dhe të reaksionit të brendshëm e të jashtëm. Këta, gjatë gjithë kë-saj periudhe, u treguan të kujdeshëm për të mos ua shtuar edhe më tepër udhëheqësve sovjetikë telashet në Pragë. Ky koncesion amerikan, sigurisht, nuk është bërë pa llogari. Ai është një lëshim ose têrheqje, që xhentëlmenët revizionistë të Moskës nuk do të mun-gojnë t'ua paguajnë katërfish partnerëve të tyre të Uashingtonit. Indiferentizmi ndaj largimit të ekipit të

Dubçekut, i cili deri kohët e fundit gjithë simpatitë e borgjezisë dhe të reaksionit perëndimor, trengon se përpara interesave të mëdhenj të aleancës sovjeto-amerikane jo vetëm fati i tij, por edhe ai i gjithë Çekosllovakisë është një monedhë e thjeshtë këmbimi. Niksoni e ndiente se krerët sovjetikë nuk mund t'i fillonin bisedimet në nivel të lartë me imperialistët amerikanë, për të përfunduar projektet e përbashkëta kundër socializmit, lirisë e pavarësisë së popujve, pa vënë më përpara rregull në oborrin e tyre. Për këtë, foli hapur më 11 maj, përpara përfaqësuesve të afaristëve amerikanë kryetari i CIA-s, Riçard Helms. Ai deklaroi se «marrëdhëni amerikano-sovjetike në të ardhmen do të varen nga ajo se në çfarë mënyre udhëheqësit e Kremlinit do t'i zgjidhin problemet e tyre me vendet e bllokut komunist». Nga ana tjetër, «normalizimi» në Çekosllovaki do të qetësonte në njëfarë mase edhe opinionin publik amerikan, i cili, pas pushtimit të Çekosllovakisë, nuk është edhe aq i dispozuar të aprovojë fillimin e menjëherëshëm të bisedimeve të planifikuara sovjeto-amerikane. Ndërrimi i rojave në Pragë, megjithëse nuk është një zgjidhje e plotë e përfundimtare, në situatën e krijuar ndihmon për t'i vënë një kore plagës, në mënyrë që revolucionistët sovjetikë dhe imperialistët amerikanë të përfundojnë pazarllëqet që kanë ndër mend.

Është e vërtetë se Dubçeku dhe ekipi i tij, pas 21 gushtit të vitit të kaluar, kishin kapitulluar plotësisht përpara pushtimit dhe kishin tradhtuar interesat e lartë të popullit çekosllovak. Po për udhëheqësit sovjetikë kjo nuk ishte e mjaftueshme. Ata duan ta

sundojnë Çekoslovakinë nëpërmjet një «udhëheqjeje çekoslovake» që të jetë besnike, e bindur ndaj urdhrale të tyre dhe që njëkohësisht të jetë e fortë dhe e aftë për të shtypur rezistencën e popullit. Ekipi i Dubçekut, për shkak të rr Ethanave nga lindi dhe të kushteve të krijuara, nuk i kishte këto atribute. Ai nuk arriti kurrë të bëhet një grup udhëheqës kompakt, i cili di çfarë kërkon dhe vepron me energji për të realizuar objektivat e caktuar. Barka e Dubçekut u mbyt në dallgët që krijoi pushtimi i Çekoslovakisë nga revizionistët sovjetikë dhe nga vija e tij kapitulluese e tradhtare.

Propaganda revizioniste sovjetike po bën tanë një zhurmë të madhe për ta paraqitur kuislingun e ri çekoslovak, Husakun, si një «dorë të fortë», i cili gjoga mbron interesat e Çekoslovakisë dhe është në gjendje jo vetëm të vendosë rregullin në vend, por edhe të krijojë marrëdhënie të drejta reciproke me sovjetikët. Bile edhe borgjezia perëndimore i mban iso kësaj propagande dhe ish-përkrahësit e flaktë të Dubçekut nuk gjejnë fjalë për t'u thurur lavde «virtive» të tij. Një orkestrim me të vërtetë i çuditshëm! «Patriotizmi i tij si çekoslovak — shkruan gazeta amerikane «Kristçën sajëns monitor» — nuk mund të vihet në dyshim». «Husaku — përgjigjet gazeta e madhe e borgjezisë franceze «Lë Mond» — nuk është aspak agjenti «i pakushtëzuar» i sovjetikëve». Nga ana tjetër, Emil Zatopeku, zëdhënës i autorizuar i reaksionit çekoslovak, deklaron: «Jam i një mendimi me Husakun dhe admiroj nacionalizmin e tij, ai është një politikan i vërtetë».

Që Husaku është një nacionalshovinist sllovak, kjo është një gjë tepër e njojur. Por pse midis asaj morie të madhe kolaboracionistësh, të mbledhur tani në Pragë, sovjetikët zgjodhën pikërisht një nationalist sllovak, i cili, pa dyshim, është më afër ndaj sovjetikëve, por përsëri jo një njeri qind për qind i tyre? Fakt është se jo vetëm më 21 gusht, po edhe shumë kohë më vonë emri i Husakut nuk figuronte në listat e çarëve të rinj të Kremlinit për mëkëmbësin e tyre në Pragë. Duke vënë tani në krye të udhëheqjes së partisë revizioniste çekoslovakë një ultranationalist dhe antimarksist të njojur botërisht, megjithëse ai mund t'u nxjerrë jo pak telashe, udhëheqësit sovjetikë edhe sigurojnë më mirë hegemoninë e tyre në Çekoslovakia, edhe i jepin asaj pamjen e një shteti «të pavarrur». Ata e dinë se Husaku, për të forcuar pozitat e nacionalizmit borgjez sllovak në dëm të çekëve, të hungarezëve e të tjerëve, do të ketë gjithnjë nevojën e përkrahjes nga Moska, e cila do t'ia japë atë me pika, në atë masë sa ai do të jetë i gatshëm të zbatojë urdhrat dhe të mbrojë interesat e saj. Në fund të fundit, përqarja nationale ka qenë, që në kohët që mban mend histori, arma më e preferuar e pushtuesve. Nga ana tjetër — dhe për këtë kujdesen mjaft në Kremlin — qenia e një nationalisti në krye të udhëheqjes çekoslovakë i jep mundësi borgjezisë perëndimore të justifikojë indiferencën e saj ndaj fatit të Çekoslovakisë dhe pajtimin me pushtimin e kësaj nga revolucionistët sovjetikë. Duket qartë, pra, se në Moskë kanë menduar gjatë për këtë çështje dhe kanë vendosur për kandidaturën e Husakut, duke mbajtur parasysh edhe

se drejt kujt shkojnë simpatitë e qarqeve sunduese perëndimore.

Nga çdo anë që t'i shikosh, ngjarjet e Çekoslovakisë reflektojnë bashkëpunimin dhe komplotin e revisionistëve sovjetikë me imperialistët amerikanë, të cilët, për të ruajtur interesat egoistë dhe për të zbatuar planet e tyre kundërrevolucionare, janë kurdoherë të gatshëm të marrin nëpër këmbë dhe të sakrifikojnë lirinë e pavarësinë e popujve, nderin dhe dinjitetin e tyre kombëtar. Më 1939 Çekoslovakia u bë fli për të kënaqur oreksin agresiv të Hitlerit, me shpresë se kjo do të shërbente për të forcuar aleancën e fuqive të mëdha perëndimore me Gjermaninë fashiste, për të mbrojtur interesat e tyre imperialistë dhe për ta shtyrë atë drejt Lindjes, drejt Bashkimit Sovjetik. Edhe tani u përsërit Munihu, edhe tani fuqitë perëndimore e lanë Çekoslovakianë në mëshirën e agresorëve, me qëllim që këta t'i nxitin drejt Lindjes, por këtë herë drejt Lindjes së Largme, drejt Kinës. Ashtu si tridhjetë vjet më parë borgjezia perëndimore i bënte thirrje popullit çekoslovak për «urtësi», «realizëm» e nënshtrim, edhe tani ajo nuk mungon të përsërítë të njëjtat parulla. Tipik është qëndrimi i Vatikanit, i këtij përfaqësuesi më të autorizuar të reaksionit ndërkombëtar. «Përballë qëndrimit të Moskës — shkruante e përvjavshmja e tij «Oservatore dela domenika» më 23 prill të këtij viti — realistët çekoslovakë duhet të përulen, sepse nuk kanë rrugë tjetër».

Që në kurriz të popullit çekoslovak u bënë allishverishe për hir të interesave më të mëdhenj të «aleancës së shenjtë» sovjeto-amerikane, e provojnë edhe

disa veprime të tjera që, «për koïncidencë», morën zhvillim më të gjerë dhe shoqëruan ngjarjet e fundit të Pragës. Më kryesoret janë planet e imperializmit amerikan për çështjen vietnameze, propozimi i sovjetikëve dhe i aleatëve të tyre në Traktatin e Varshavës për «sigurimin evropian» dhe intensifikimi i propagandës antikineze të revizionistëve sovjetikë e shoqërimi i saj edhe me provokacione të armatosura në kufirin sovjeto-kinez.

Në të vërtetë, këto probleme kanë qenë edhe më parë në rendin e ditës, por kohët e fundit lidhur me to vihen re disa shfaqje të reja. Kështu, udhëheqësit sovjetikë ka kohë që nuk i kursejnë përpjekjet e tyre për t'i ndihmuar imperialistët amerikanë të dalin nga qorrskaku ku janë futur në Vietnam. Por që nga koha e ardhjes në fuqi të Niksonit këto përpjekje janë shtuar dhe bashkëpunimi i revizionistëve sovjetikë për arritjen e synimeve amerikane po bëhet më i hapur. Fakt është se presidenti i ri amerikan, duke paraqitur planin e tij të ri prej 8 pikash për të ashtuquajturën zgjidhje politike të çështjes vietnameze, nuk e fshehu se realizimi i tij kërkon medoemos mbështetjen e udhëheqësve sovjetikë, ndërhyrjen e tyre pranë qeverisë së Hanoit. Me fjalë të tjera, Niksoni u thotë udhëheqësve sovjetikë: «Borxhi duhet paguar. Ne ju ndihmuam në Çekoslovaki, ju duhet të na e shpërbleni në Vietnam». Koncesionet reciproke i çelin rrugën zbatimit të projekteve të reja kundërrevolucionare të «aleancës së shenjtë» sovjeto-amerikane.

Në kuadrin e këtyre lëshimeve e pazarllëqeve politike duhet parë edhe e ashtuquajtura politikë e sigu-

rimit evropian e revizionistëve sovjetikë. Për «sigurimin evropian» revizionistët hruščovianë kanë bërë thirrje edhe herë të tjera, por në Perëndim asnjë nuk i dëgjonte. Plani sovjetik i atëhershëm parashikonte si kusht njohjen e RD Gjermane e të kufijve të saj lindorë e perëndimorë. Kurse thirrja e re ndryshon në përbajtje dhe në drejtime. Ajo, për shembull, nuk përmend më as RD Gjermane, as kufijtë perëndimore të Polonisë e të Çekoslovakisë. Jo pa gjëzim të veçantë e vunë re këtë «harresë» qarqet drejtuese të NATO-s, dhe veçanërisht në Bon. Agjencitë perëndimore të lajmeve i dhanë një publicitet të gjerë fjalimit që mbajti në Bundestag më 25 prill ministri gjermanoperëndimor i Punëve të Jashtme, Vili Brand, i cili, sipas tyre, «rikonfirmoi» në këtë rast se sovjetikët kishin njofuar Bonin se kalimi në realitetet e pasluftës (ekzistenca e Gjermanisë së Lindjes, vija Oder-Najse etj.) nuk përbëjnë një kusht paraprak për mbajtjen e një konference evropiane. Ç'do të thotë kjo?

Pazarllëku në kurrit të interesave të RD Gjermane e të Polonisë këtu duket sheshit. Në këtë mënyrë revizionistët sovjetikë kërkojnë të sigurojnë krahët e tyre në Evropë.

Por politika sovjetike e «sigurimit evropian», ndërsa ka ngjallur shpresa në Perëndim, ka shqetësuar mjaft partnerët e Traktatit të Varshavës e, në radhë të parë, RD Gjermane e Poloninë, të cilat e kanë nuhatur se do t'i paguajnë vetë shpenzimet e këtij «sigurimi». Interesant është fakti se, ndërsa propaganda sovjetike thirrjen e një konference në lidhje me «sigurimin evropian» nuk e kondicionon me ndonjë kusht

paraprak, bile thekson se të tilla nuk do të ketë, ajo polake vë kushte të përcaktuara mjaft qartë. Kështu, për shembull, në një artikull të fundit të revistës teoreike polake «Novi drogi», në polemikë me sovjetikët dhe ndryshe nga teksti i «Thirrjes» së Budapestit, thuhet: «Është e kuptueshme se njojja nga ana e RF të Gjermanisë e të gjithë kufijve ekzistues, e kufirit Oder-Najse dhe e kufirit midis RD Gjermane dhe RF të Gjermanisë, si dhe heqja dorë nga ana e qeverisë së RF të Gjermanisë prej aspiratave të saj atomike dhe pretendimeve të saj për të përfaqësuar gjithë kombin gjerman, janë premisat bazë të sistemit të sigurimit evropian».

Në botën e sotme nuk ka ngjarje të shkëputura. Edhe ngjarjet në Çekosllovaki u zhvilluan në lidhje të ngushtë me koniunkturën e sotme ndërkombëtare dhe nuk mund të kuptohen jashtë komplotit të madh kundërrevolucionar sovjeto-amerikan. Por a e pastruan revisionistët plagët çekosllovake? A do ta nënshtrojnë dot ata popullin çekosllovak?

As përkrahja e imperialistëve, me ata amerikanë në krye, as ndërrimi i kuislingëve në Pragë dhe as forca brutale nuk do t'i nxjerrin revisionistët sovjetikë nga bataku. Fjala e fundit i përkthet popullit liridashës çekosllovak. Klika e Husakut, që zuri vendin e asaj të Dubçekut në kështjellën e Pragës, me urdhër të pushtuesve sovjetikë dhe me bekimin e imperializmit dhe të reaksionit të brendshëm e ndërkombëtar, do të përpinqet tani, me mashtime dhe me terror, të frikësojë popullin çekosllovak dhe të shuajë rezistençën e tij. Por si pushtuesit e huaj, ashtu edhe tradh-

tarët e brendshëm nuk do t'ia arrijnë kurrë këtij qëllimi.

Populli çekoslovak e njeh tani mirë fytyrën prej bishe gjakatare të pushtuesve sovjetikë dhe e di mirë se çdo kuisling që ata sjellin në fron në Pragë është këlysh i pushtuesve dhe armik i tij i betuar. Ai nuk ushqen asnjë iluzion për ta, ashtu siç nuk duhet të ushqejë asnjë shpresë tek imperialistët amerikanë dhe tek aleatët e tyre, të cilët, brenda 30 vjetëve, dy herë me radhë e kanë shitur tek agresorët për pazarllëqet e ndyra me ta. Ai nuk i trembet sakrificës dhe e di mirë se pa liri nuk ka as dinjitet kombëtar, as socializëm. E vetmja rrugë shpëtimi është lufta me të gjitha mjetet, deri te lufta me armë në dorë, kundër pushtuesve të huaj dhe tradhtarëve të vendit. Punëtorët e fshatarët çekoslovakë, gratë e të rinxjtë, inteligjencia patriote do të ngrihen kundër tyre në një luftë të tillë, do t'ua bëjnë të padurueshme e të pamundshme jetën pushtuesve të huaj në Çekoslovakia, do t'i dëbojnë ata nga trualli i shenjtë i atdheut të vet dhe do të rivendosin diktaturën e proletariatit. Në këtë luftë të drejtë ata nuk do të jenë vetëm, por do të kenë me vete solidaritetin dhe përkrahjen e të gjitha forcave revolucionare e të popujve liridashës të botës.

Ngjarjet e Çekoslovakisë janë një mësim dhe paralajmërim i madh për të gjithë popujt për rrezikun që përbën aleanca sovjeto-amerikane për lirinë dhe pavarësinë e tyre. Liria e pavarësia e çdo populli, e drejta për të qenë sovran dhe për t'u zhvilluar sipas kushteve dhe dëshirave të tij nuk mbrohen vetëm aty ku fillojnë e mbarojnë kufijtë shtetërorë, nuk mbrohen vetëm atë ditë kur armiku të ka thyer me shqelma

derën dhe të ka shkelur vatrën. Ato mbrohen çdo ditë e çdo orë në një luftë dhëmb për dhëmb me armiqtë imperialistë e revizionistë, të cilët nuk flenë dhe nuk heqin dorë nga qëllimet për të nënshtuar të gjitha vendet, kudo që ndodhen, qofshin këto të vogla apo të mëdha.

Por planet kriminale të imperialistëve amerikanë dhe të socialimperialistëve sovjetikë do të pësojnë disfatë përballë forcës së bashkuar të popujve revolucionarë e liridashës të botës. Si çdo aleancë kundërrevolucionare, fashiste, në krahasim me forcën e popujve, aleanca sovjeto-amerikane është e dobët, por mund të bëhet shumë e rrezikshme në qoftë se nuk demaskohet, nuk luftohet e nuk izolohet me kohë. Është detyrë e të gjithë popujve liridashës, e të gjitha forcave revolucionare e antiimperialiste që në këtë situatë të mbushur plot rreziqe të forcojnë vigjilencën, të mos tërhiqen dhe t'u bëjnë ballë me guxim valëve të tërbuara të reaksionit imperialisto-revisionist. Frontit të bashkuar kundërrevolucionar sovjeto-amerikan i duhet kundërvënë fronti i bashkuar antiimperialist e antirevisionist i popujve, i cili është plotësisht në gjendje të shkatërrojë që në fillim planet agresive të pretduesve të rinj të sundimit botëror. Lufta mund të jetë e gjatë, e ashpër dhe shpesh e pabarabartë, por fitorja e sigurt u takon popujve.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i popullit»,
nr. 122 (6474), 23 maj 1969*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje
veprash) 1968-1970», f. 383*

JEMI BIJ DHE USHTARË TË POPULLIT E TË PARTISË QË NUK PLAKEN KURRË

*Fjala gjatë vizitës në sallën ku zhvilloi punimet
Kongresi i Përmetit*

24 maj 1969

Të dashur shokë dhe shoqe, ish-delegatë të Kongresit Antifashist Nacionalçlirimtar të Përmetit,

Në radhë të parë, dëshiroj t'ju sjell përshëndetjet e Komitetit Qendror, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, të Qeverisë dhe të të gjithë Partisë me rastin e festës sonë të madhe jubilare, 25-vjetorit të Kongresit Antifashist Nacionalçlirimtar të Përmetit.

25 vjet më parë, nga të katër anët e atdheut, ne erdhëm këtu në Përmet me pushkë në dorë, si të deleguar të popullit dhe të Partisë sonë, për të diskutuar e për të vendosur për një varg problemesh me rëndësi të madhe historike, politike dhe ushtarake, për të sanksionuar dhe për të ligjëruar epopenë e lavdishme të popullit tonë, të udhëhequr nga Partia jonë heroike Komuniste.

Në luftë për të sjellë këto ditë të bukura që gëzon

populli sot, na ranë shumë shokë. Edhe ne, ish-delegatët e këtij Kongresi historik, dhamë kontributin tonë modest në luftën e madhe që bënë populli dhe Partia, e tash, pas 25 vjetësh, po kthehemë edhe një herë në këtë sallë po aq të rinj nga shpirti, por shumë më të vendosur për të vazhduar luftën për çështjen e madhe të popullit, për socializmin dhe komunizmin, nën udhëheqjen e Partisë sonë të shtrenjtë të Punës.

Asnjë vështirësi, sado e rëndë dhe e tmerrshme të jetë, nuk do të na përkulë kurrë, as shpirtërisht as fizikisht, ne që jemi mbledhur sot në këtë sallë, se jemi bijtë dhe ushtarët e thjeshtë të këtij populli trim, të kësaj partie trime, që nuk plaken kurrë. Partia në shekuj do të qëndrojë e re, e fuqishme, e guximshme dhe do të na udhëheqë ne dhe brezat e ardhshëm në rrugën e ndritur të socializmit e të komunizmit, në rrugën e revolucionit fitimtar botëror, për triumfin e të cilit do të japim edhe ne kontributin tonë.

Shokë veteranë, zemrat tona sot, ashtu si kurdoherë, rrahin si në kohën e luftës.

Rroftë Partia!

Rroftë populli!

Botohet për herë të parë si-pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

JU RRITËT ATA HERONJ E HEROINA, GJAKU I TË CILËVE ËSHTË NË THEMELET E SHQIPËRISË SË RE SOCIALISTE

*Fjala në takimin me pjesëtarë të familjeve
të dëshmorëve të rrëthit të Përmetit*

24 maj 1969

Është një gjëzim i madh për të gjithë shokët dhe përmua që po takohemi sot nga afër me ju, prandaj ky takim për të gjithë ne do të mbetet i paharruar. Për Partinë kryesorja mbi kryesoret është populli, me të cilin komunistët duhet të lidhen ngushtë si mishi me thoin. Njerëzit që janë zgjedhur ose janë caktuar në vende drejtuese në Parti, në pushtet, në organizatat e masave e kudo, në rast se shkëputen nga populli, nuk mund të kryejnë detyrat me përgjegjësi që u ngarkohen, se faktori vendimtar për realizimin e tyre është populli, ndërsa ne të zgjedhurit, që jemi bijtë e tij, duhet të jemi shërbëtorë besnikë të popullit, të rrimë gju më gju me të, ta dëgjojmë me vëmendje dhe të punojmë pa u lodhur për të realizuar dëshirat e tij.

Partia na mëson që në mënyrë të veçantë të duam

dhe të nderojmë mëmat e baballarët e heronjve dhe të dëshmorëve, të shoqeve e të shokëve tanë, të cilët dhanë jetën për lirinë e atdheut dhe për ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Jeni ju, të dashura nëna, ju, të dashur baballarë, që rritët ata heronj e heroina, gjaku i të cilëve është në themel e Shqipërisë së re socialist. Pikërisht për këtë arsyе Partia na porosit vazhdimisht që me popullin e sidomos me njerëzit që kanë luftuar e me familjet e dëshmorëve, të lidhemi fort.

Një njeri, pesë ose dhjetë, sado të zotë të jenë, në punë e sipër mund edhe të gabojnë, kurse populli nuk gabon kurrë. Prandaj Partia na porosit vazhdimisht të këshillohemë me popullin, se tek ai do të gjejmë fjalë, mendime e këshilla të urta që do të na ndriçojnë rrugën për arritjen e çdo objektivi. Vetë teoria jonë marksiste-leniniste është ushqimi i mendjes, që vë në lëvizje gjithë veprimtarinë mendore e fizike të popullit, i cili, nën udhëheqjen e Partisë, ka bërë të mundur të arrihen gjithë këto suksese në vendin tonë.

Ato që kemi bërë gjer tani janë vepra me rëndësi të madhe, por akoma më të rëndësishme do të jenë veprat që do të ndërtojmë paskëtaj. Popullin tonë e presin ditë edhe më të bardha e më të gjëzuara. Planet e Partisë dhe të Qeverisë janë të atilla që transformimi rrënjosor i atdheut tonë do të vazhdojë të bëhet me ritme të shpejta nga viti në vit e nga pesëvjeçari në pesëvjeçar. Partia jonë tani ka fituar një eksperiençë të madhe gati 30-vjeçare. Gjithë këto vite lufte, përpjekjesh e realizimesh e kanë fuqizuar Republikën tonë Popullore në fushën e industrisë dhe të bujqë-

sisë, në fushën e arsimit dhe të kulturës, i kanë krijuar asaj mundësi të mëdha, të cilat Partia dhe Qeveria po i shfrytëzojnë me nikoqirllëk. Këtej e tutje ne do të përparojmë me shpejtësi edhe më të madhe se gjer tani, pse kemi mundësi dhe një horizont më të gjërë.

Ndryshe ishte gjendja pas Çlirimt, kur sapo filluam ndërtimin e jetës së re. Regjimet e kaluara na lanë trashëgime të hidhura, siç ishin prapambetja e madhe në bujqësi dhe në industri, në arsim dhe në kulturë, sëmundjet, varfëria e rëndë dhe mjerimi i pafund i masave punonjëse. Por populli ynë, me Partinë e tij heroike në krye, me gjak, me punë, me djersë dhe me mundime të papërshkruara, vuri çdo gjë në rrugë të drejtë.

Ashtu si gjer tani, edhe në të ardhmen ne do të vazhdojmë punën për transformimin e atdheut, për ta bërë Shqipërinë një vend me të vërtetë të bukur, të begatshëm, me një industri të zhvilluar e me një bujqësi socialiste nga më të përparuarat, me arsim e kulturë të zhvilluar. Në mënyrë të veçantë do të shfrytëzojmë të gjitha pasuritë që fsheh nëntoka jonë, të cilat do t'i zbulojnë vajzat e djemtë tuaj, bijtë e popullit. Kjo do të na japë mundësi të ngremë ndërmarrje të tjera moderne. Bujqësinë do ta bëjmë, gjithashstu, akoma më të përparuar, fshatrat, si të fushës, edhe të malësissë, do t'i lulëzojmë, dhe kooperativat bujqësore do t'i bëjmë siç na mëson marksizëm-leninizmi, që të shkojnë përpara, për ta rritur vazhdimisht e pandërpërre mirëqenien e popullit.

Ashtu siç na ka porositur vazhdimisht Partia, kë-

to detyra ne do t'i bëjmë realitet me krahët, me djer-sën, me zotësinë dhe me mendjet e njerëzve tanë. Me mjetet që kanë vënë e do të vënë vazhdimisht në dispozicion Partia dhe pushteti popullor, malet tona do të bëhen po aq pjellore sa dhe fushat, drithërat e bukës do të prodhohen më me shumicë. Investime të mëdha do të bëjmë në blektori, do të zhvillohen e do të përmirësohen sidomos lopët, jo më nga ato që mezi japid nga 200-300 litra qumësht, por nga ato të racës që japid mijëra litra në vit. Janë marrë masa që përkëtë qëllim të importohen qindra e mijëra mëshqerra race, të cilat në fillim do të mbahen në ndërmarrjet bujqësore sa të rriten e të shumëzohen, pastaj, brenda disa vjetëve, viçat e tyre do të shpërndehen me radhë në të gjitha kooperativat bujqësore të vendit, në zonën fushore e në malësi. Do të merren masa, gjithash tu, që pemëtaria të zhvillohet më tej. Porosia e vazhdueshme e Partisë është që të punohet kudo për të siguruar rezerva uji për ujitje, me qëllim që gruri, misri, jonxha, bimët industriale, perimet, frutat etj. të zhvillohen sa më mirë, pavarësisht nga kushtet klimatike.

Të gjitha këto, të dashura nëna e motra, shokë dhe vëllezër, i bëri dhe po i bën Partia, i bënë lufta dhe gjaku i djemve dhe i vajzave tuaja, i bënë puna dhe mençuria e popullit të udhëhequr nga Partia. Në Luftën heroike Nacionalçirimitare dikush humbi djalin, dikush vajzën, dikush burrin apo vëllanë, por të tërë këta gjakun e tyre ua falën atdheut dhe Partisë. Në shembullin e shoqeve dhe të shokëve tanë që ranë në luftë, u ngritën me qindra e mijëra të tjerë për

çlirimin e atdheut nga zgjedha e të huajve dhe e tradhtarëve të vendit, kurse sot mbarë populli shqiptar i është përveshur punës për ndërtimin e socializmit dhe për ruajtjen me vigjilencë të të gjitha fitoreve të arritura.

Kur mendojmë se si mbeti nga lufta qyteti i Përmjetit dhe trualli i gjithë rrethit tuaj, dëshira jonë është që ai të shndërrohet nga dita në ditë në një kopsht të lulëzuar. Rrethi juaj pas Çlirimit, gjatë këtyre 25 vjetëve, ka bërë përparime të mëdha. Megjithatë, në mjaft nga kooperativat tuaja nuk ka ujë të mjaftueshmë për ujitjen e bimëve, megjithëse studimet, për të parë se nga mund të nxirret uji, vazhdojnë. Në të ardhmen këto studime do të bëhen tok me ju, duke marrë jo vetëm mendimin e specialistëve, por edhe të shokëve në bazë, të cilët po tregojnë një gatishmëri të jashtëzakonshme, se e kuptojnë dobinë e madhe të këtij aksioni për bujqësinë. Në Përmjet ne do të krijojmë fidanishte për shtimin e pemëve frutore në një shkallë shumë më të gjerë se deri tanë, për të mbjellë jo njëqind rrënje në vit, por me mijëra fidanë nga të gjitha llojet dhe që t'i përshtaten klimës së rrethit tuaj.

Partia ju bën thirrje të vazhdoni punën me vrull, për t'i marrë prodhime gjithnjë më të begata e të shumëllojshme tokës. Kështu, atje ku sot marrim 10-15 kuintalë grurë ose 15-20 kuintalë misër për hektar, në të ardhmen të marrim më shumë. Prodhime tokës mund t'i marrësh më shumë po ta punosh, po ta plehërosh dhe po ta ujitësh, domethënë po t'u sigurosh bimëve të gjitha shërbimet që rekomandon agroteknika.

Tani ne i kemi të gjitha mundësitë për t'i bërë këto, për arsyet e rrugës së drejtë e të udhëheqjes së urtë të Partisë, për arsyet e zgjuarsisë, të trimërisë, të guximit dhe të punës së palodhur të mbarë popullit shqiptar. Populli e do Partinë me gjithë shpirt, prandaj ai, duke pasur besim të patundur te mësimet e saj, është ngritur në këmbë kundër mbeturinave të së kaluarës që kanë penguar dhe në disa raste pengojnë akoma si ferra nëpër këmbë ecjen e njerëzve tanë përpara. Sa drejt i kupton populli, me ç'vullnet i zbaton ai direktivat e Partisë, te të cilat shikon të ardhmen e ndritur, rrugën që duhet ndjekur. Njeriu ynë sot nuk mendon më si përpara, kur rronte i mbyllur dhe interesohet e mendonte vetëm për familjen e tij, për atë copë tokë dhe për dy-tri kokë dhi, kur i kishete. Jo, tash Partia ia ka bërë të qartë popullit se Shqipëria është e tëra e vetja dhe me duart e tij ajo po bëhet çdo vit më e bukur dhe më e begatshme. Njerëzit tanë, në dritën jetëdhënëse të mësimeve të Partisë, po i bëjnë analizë vetes së tyre dhe gjykojnë se nëpër këtë rrugë të madhe që u ka hapur Partia, s'mund të ecet më me mendimet prapanike që kanë pasur dhe që te disa qëndrojnë akoma të fshehura në ndërgjegje.

Një luftë e madhe po bëhet çdo ditë, shoqe dhe shokë, në zemrat dhe në mendjet e njerëzve tanë. Në këto përpjekje për të ecur përpara ndrit me shkëlqim drita e Partisë, që nuk lejon të kthehet prapa e kaluarë e zezë për popullin. Për shkak të koncepteve të vjetra të rrënjosura në ndërgjegje, ka akoma disa që nuk e kuptojnë drejt ndonjë aspekt të zhvillimit tonë,

bile ndodh që ndonjëri ka edhe frikë se si do ta gjykojë mëhallat ose fshati këtë hap të ri që ai hedh përpara. Por edhe në të tilla momente të vështira njëriu ynë troket «në derë» të Partisë, kërkon këshillat dhe mësimet e saj, bëhet i ndërgjegjshëm, punon siç porosit ajo dhe çan përpara, kurse mëhallat, fshati, kushërinjtë etj., në qoftë se nuk e kuptojnë sot, do ta kuptojnë me siguri nesër, se ajo që po bëhet është në rrugën e drejtë të Partisë, në interesin e popullit. Pikërisht pse veprohet kështu, vendi ynë bëhet çdo ditë e më i fortë.

Shqipëria duhet të jetë e fortë, në radhë të parë, për të mirën e popullit tonë, së dyti, për të plotësuar, me aq sa na takojnë dhe sa i kemi mundësitet, edhe detyrat në arenën ndërkombëtare. Pavarësisht se jemi një popull i vogël, detyrat tona në këtë fushë janë të mëdha. Prandaj po luftojmë që vijën tonë marksiiste-leniniste ta kuptojnë drejt popujt dhe revolucionarët e vendeve të ndryshme të botës, në mënyrë që edhe ata të ecin në rrugën e revolucionit dhe të socializmit. Interesat tanë të brendshëm dhe të jashtëm kërkojnë nga Partia dhe nga mbarë populli që t'i zbatojmë si duhet, në mënyrë krijuese e revolucionare, të gjitha detyrat që kemi përpara.

Ju, shoqe dhe shokë përmetarë, ju përgëzojmë për luftën që keni bërë për çlirimin e atdheut dhe që po vazhdoni të bëni edhe sot për ndërtimin e socializmit. Si në gjithë vendin, edhe në rrëthin tuaj luftohet me vetëmohim për të ardhmen e lumtur të popullit. Prandaj, në emër të Partisë, ju urojmë me këtë rast sukseze akoma më të mëdha. Ne dëshirojmë që, si kur-

doherë, ju, në radhë të parë, të jeni të lidhur si mishi me thoin me Partinë e me pushtetin popullor. Kudo që jeni të punoni ditë e natë, njëkohësisht pushkën ta mbani kurdoherë gati dhe barutin të thatë. Askujt nuk i lejohet ta lërë pushkën të ndryshket, jo më brezit tonë, por as brezave të ardhshëm.

Trimëria e popullit, fryma e tij luftarake duhet t'u lihen trashëgim pasardhësve tanë brez pas brezi, pse përpara kemi akoma armiq të mëdhenj e të egër, siç janë imperialistët amerikanë, socialimperialistët sovjetikë dhe gjithë reaksionarët në botë, të cilët, më gjithëse duken të fortë, nuk janë të tillë; ata janë të krimbur nga brenda. Por si fashistë dhe dinakë që janë, po të gjejnë shtete të dobëta, me situata të brendershme të paqëndrueshme, ata guxojnë dhe i sulmojnë, kurse kundër popujve e njerëzve të guximshëm tremben të veprojnë. Megjithatë, në qoftë se do të guxojnë të ndërmarrin ndonjë aventurë kundër vendit tonë, agresorët me siguri do të shpartallohen.

Këto nuk i themi për mburrje, pse Partia kurre s'na ka mësuar të mburremi dhe nuk do të mburremi, por i tillë është realiteti ynë. Kujtoni kohën e luftës, shoqe dhe shokë, kur s'kishim as pushkë, as fishekë, as veshmbathje dhe as bukë. Atëherë ju, me gjithë zemër e me bujari të madhe, na jepnit ato pak gjëra që kishit, na ushqenit me kujdes dhe na mbanit në kasollet tuaja. Ju kujtohet si ju thoshim ne atëherë, që armiqtë e huaj e tradhtarët do t'i mundim, pavëresisht se janë më të mëdhenj në numër e shumë më të armatosur se ne. Partia ishte e sigurt për ato që thoshte, se luftonte për drejtësinë, se popullin e kishte

me vete dhe udhëhiqej nga teoria marksiste-leniniste. Kishte edhe njerëz që s'besonin në ato që thoshte Partia, por ata ishin të paktë. S'ka forcë më të madhe se forca e popullit dhe e ideologjisë marksiste-leniniste. Të tillë besim kishim ne atëherë, që ishim shumë të paktë në numër, të zhveshur e pa armë.

Tash jemi një mijë herë më të fortë nga çdo pikëpamje, pastaj s'jemi as vetëm, se gjëzojmë përkrahjen e partive të vërteta marksiste-leniniste dhe të mbarë popujve përparimtarë të botës. Prandaj fitorja jonë është e sigurt. Popujt e shtypur, kudo që janë, po luftojnë për liri dhe për pavarësi. Armiqjtë do të mposhten, sado të armatosur që të jenë. Mund të kesh armë sa të duash dhe nga më modernet, po në rast se nuk ke me vete masat e popullit, në qoftë se nuk je me të drejtën, armën do ta braktisësh dhe do t'u mbathësh këmbëve për të shpëtuar. Pa njerëz të guximshëm e luftëtarë që dinë përse luftojnë, armët nuk vlejnë gjë. Kurse shqiptari, sidomos njeriu ynë i edukuar nga Partia, trimërinë e ka në gjak. Ai e ka të qartë politikisht, ideologjikisht e teknikisht se mitralozi, topi, raketa dhe çdo armë tjetër duhen mbajtur pastër e kurdoherë në gatishmëri për të mbrojtur jetën, nderin dhe atdheun, se pa armë nuk mund të çlirohesh, pa to nuk mbron dot fitoret e arritura dhe kufijtë e atdheut. Pra, vigjilencë, kurdoherë vigjilencë ndaj armikut, cilido qoftë ai, i jashtëm apo i brendshëm.

Ne themi vazhdimisht të jemi vigjilentë, po vigjilencën duhet ta kuptojmë në shumë drejtime, jo vetëm ndaj veprimitarisë së armiqve, por ndaj kujtdo

që nuk ecën në rrugën e drejtë të Partisë. Armiku mund të ngrihet me pushkë kundër Partisë e popullit dhe me këtë lloj veprimtarie ai diktohet lehtë, por mund të ngrihet edhe me fjalë, duke lëshuar helm nëpërmjet thashethemeve e duke bërë një mijë dredhi për të çoroditur mendjet e njerëzve tanë dhe pastaj për të na goditur. Prandaj ne duhet të mbajmë qëndrim ndaj të gjitha shfaqjeve armiqësore. Në fillim t'i këshillojmë ata që gabojnë, në rast përsëritjeje t'i vëmë në mengene, para gjykimit të masave, dhe kur bëhen të pandreqshëm, t'i godasim pa mëshirë.

Në këto kushte le t'i përvishemi punës që, gjatë viti jubilar të 25-vjetorit të Çlirimt, t'i japim një pamje akoma më madhështore atdheut, njerëzit tanë të jenë më të lumtur e më të gëzuar, se ata janë kryesorët.

Sigurisht, siç e shikoni edhe ju vetë, vija që ndjek Partia është e drejtë, se shpreh vullnetin e popullit punonjës. Gjatë rrugës kur erdhëm për këtu, pamë arat me drithëra që na u dukën se kishin zhvillim të mirë. Shokët e komitetit të Partisë të rrethit na thanë se këtë vit prodhimet do t'i keni të mbara.

Le ta pimë, pra, këtë dolli për shëndetin, për lumturinë dhe për begatinë tuaj, motra dhe vëllezër, për shëndetin e nënave e të baballarëve të atyre që dhanë jetën për çlirimin e atdheut e për ndërtimin e socializmit! Të rrojë Partia!

Neve na pëlqyen shumë grupet artistike të shtëpisë së kulturës të rrethit tuaj, artin dhe bukurinë e interpretimit të të cilave e shijuam mbrëmë. Si kudo, edhe në Përmet ka një përparim të madh në këtë

drejtim. Veprimtarinë e grupeve kulturore artistike duhet ta vlerësojmë, pse ka rëndësi të jashtëzakonshme. Në radhë të parë, arti dhe kultura mbajnë kurdoherë gjallë shpirtin e bardhë, të bukur, të pastër e guximtar të popullit. Në çdo kohë, edhe në periudhat më të vështira të historisë së vet, populli kurdoherë ka kënduar e ka kërcyer. Gjatë dhe pas çdo beteje, si në luftërat e të parëve tanë kundër hordhive dhe pushtuesve të ndryshëm, ca më tepër gjatë Luftës heroike Nacionalçlirimtare, shqiptari kurrë nuk e ka hequr këngën nga goja, zemra dhe shpirti i tij kanë kënduar në çdo kohë. Sot kënga, vallja, teatri, muzika janë bërë kudo të masës dhe një ushqim i domosdoshëm për jetën e njeriut të ri të vendit tonë. Mbarë populli ynë jo vetëm në qytet, por edhe në fshat, kudo tani këndon, kërcen, vallëzon. Kjo ka rëndësi për çlodhjen e kulturuar të njerëzve, mban lart gjendjen shpirtërore të popullit, përtërin forcat e tij dhe e bën më të bukur jetën e masave punonjëse. Me këtë zhvillim të madh që kanë marrë arti dhe kultura në vandin tonë, tani nga kooperativat bujqësore edhe nga krahinat më të largëta dalin vazhdimi shët talente të reja. Sidomos këtu në Përmjet populli është mjaft i talentuar në këtë fushë, ai i ka dashur kurdoherë artin dhe kulturën, prandaj jo vetëm të rinjtë e të rejat, por edhe të moshuarit marrin pjesë gjerësisht në aktivitetet kulturore e artistike. Sa lezet u ka të moshuarve që, kur kthehen nga puna, ia marrin shtruuar ndonjë kënge të luftës apo të punës. Ca më tepër vlen të thuhet kjo për të rinjtë dhe të rejat, të cilët po gjelqjnë sot gjithë të mirat. Ata duhet të

tregojnë një dashuri e respekt të madh ndaj prindërve që i kanë lindur, i kanë rritur, i kanë ushqyer dhe kanë bërë aq shumë sakrifica për ta.

Ju të rinj e të reja kini parasysh se prindërit janë tepër zemërgjerë me fëmijët e tyre. Bile ata nuk kundërshtojnë kur ndonjë e re njihet me një djalë dhe dëshiron të martohet me të, pavarësisht se në rininë e tyre martesën e kanë bërë, si të thuash, symbyllur, se të tilla ishin zakonet e asaj kohe. E cili është ai baba ose ajo nënë që nuk kanë dëshirë që fëmijët e tyre të bashkohen me ata që u do zemra e ta kalojnë të lumtur jetën bashkëshortore? Asnjë. Veçse çdo prind do që dashuria dhe martesa nga të rejat e të rintjtë tanë të bëhen siç na mëson Partia, mbi bazën e një ndershmërie të lartë e sipas normave të moralit proletar.

Para ca kohësh u takova në Tiranë me Athina Milen¹, vajzë nga rrethi juaj, e cila, midis qindra e mijëra shembuje që po vërtetohen në Shqipëri, dha një shembull të madh në luftën kundër zakoneve prapanike. Bashkë me të takova edhe djalin që zgjodhi ajo, një djalë i mirë, plot shëndet, i zgjuar, punëtor dhe patriot. Ata dukeshin të lumtur. E ku ishte dëgjuar më parë që një vajzë përmetare apo nga një rreth tjetër të vente të punonte në Mirditë dhe ca më tepër atje të dashuronte një djalë, me të cilin të krijonte familje? Jo, në të kaluarën nuk ndodhnin gjëra të tilla. Tani kemi mësimet që na jep Partia, të cilat kanë për bazë një moral të shëndoshë. Natyrisht,

¹ Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 40, f. 127.

ka edhe ndonjë që nuk punon mirë dhe i shtrembëron këto mësime. E kemi për detyrë që njerëz të tillë t'i këshillojmë, t'i qortojmë dhe, kur gabojnë, t'u shkulim edhe veshin e, me punën tonë, të masave, të përpinqemi t'i futim në rrugë të drejtë.

Nga një filozof i vjetër, i cili ka jetuar para disa qindra vjetësh dhe që e vlerësonte lart rolin e masave në shoqëri, ka mbetur shprehja: «Fjala e popullit, fjala e zotit». Sigurisht, në ato kohë njerëzit besonin te zoti. Kurse ne sot nuk i besojmë më kësaj fantazme që nuk ka ekzistuar ndonjëherë, por që klasat shfrytëzuese e përdorën në shekuj për t'u pirë gjakun popujve. Njerëzit tanë u bindën që zoti s'ishte gjë, prandaj «ia këputën kokën». Të gjitha institucionet fetare: teqetë, xhamitë, kishat, manastiret etj. vazhdimisht e kanë mashtruar dhe e kanë gënjer popullin. Kështu vepronë edhe teqeja e Sukës këtu në Përmetin tuaj. Po populli u vuri pishën ideologjisë fetare e dogmave të saj dhe po brumoset me ideologjinë e proletariatit, të klasës punëtore, të Partisë. Kjo ideologji pasqyron qëllimet e larta të njerëzimit, ajo hedh poshtë përrallat e atyre që, për të fituar para, duke gënjer popullin, bënин mashtrime. Të mashtruar nga feja shumë nga të parët dhe prindërit tanë bëheshin myhibë. Babai i teqesë thoshte disa gjepura që besimtarët nuk i kuptionin fare dhe, për të mos i dalë boja, i porosiste myhibët të mos u tregonin asgjë të tjerëve nga ato që kishin dëgjuar në teqe.

Doktrina e bektashinjve, që predikohej nga teqetë, nga të cilat kishte mjaft edhe këtu në rrethin tuaj,

ka qenë krijuar nga Haxhi Bektashi, një jeniçer turk që u shërbente sulltanëve për të mbajtur në këmbë të disiplinuar hordhitë e jeniçerëve, të cilët, të armatoshur me palla e këllëçe, ruanin oborrin e padishahut, vritnin e pritnin ku t'u thoshte ai. Dervishët, siç e mban mend, mbanin krahëve një peshqir të madh, kurse në kokë vinin një taç, me të cilin tmerronin njerëzit, dhe në gjoks lidhnin disa zinxhirë si tërkuza me kombe dhe me daulle të mëdha. Kur krerët e tyre u binin daulleve dhe ktheheshin përmbysh kazanët e mëdhenj të gjellëve, jeniçerët e kuptonin se kjo ishte shenja që tregonte se lejoheshin të plaçkitnin, të rrëmbezin e të digjin gjithçka, të vritnin edhe njerëz. Dhe të tëra këto i bënин për padishahun dhe për kalifin e Stambollit.

Të parët tanë, deri edhe prindërit tanë, u besonin përrallave të fesë myslimanë, ashtu siç besonin ortodoksët te shenjtorët e ndryshëm. Po të lexoni historinë e këtyre shenjtorëve, të shkruar prej shkrimtarësh të dalë nga gjiri i vetë borgjezisë, të ngrihen leshrat e kokës përpjetë. Por nga radhët e borgjezisë kanë dalë edhe njerëz përparimtarë, të cilët janë revoltuar nga mizoritë e tmerrshme të fesë. Ata kanë gërmuar nëpër dokumente, kanë studiuar dhe kanë shkruar sa e sa libra, në të cilët hedhin poshtë dogmat fetare.

Krishti historikisht nuk ka ekzistuar, por sa shumë teori janë shpikur për të! Rreth tij është krijuar një legjendë njëlloj sikur një mëngjes të ngrihet dikush në mes nesh e t'u thotë të tjerëve se në malin e Potomit na paska lindur një njeri i shenjtë, i cili

bën ato e këto mrekulli. Ky gjoja na qenka i shenjtë. Këto janë të gjitha përralla, motra dhe vëllezër. Po ç'të bënин të parët tanë, atë nivel zhvillimi kishin, besonin verbërisht, prandaj nuk mund t'i bëjmë fajtorë. Tani të gjithë e kanë kuptuar të vërtetën, me gjithatë Partia punon e duhet të punojë vazhdimisht që çdo ditë e më mirë të kuptohen të këqijat e fesë dhe të ideologjisë së saj, gjersa të çrrënjosën nga ndërgjegjja e njerëzve tanë. Sistemi që sundonte në ato kohë duhej të mbështetej patjetër në paditurinë e masave dhe në filozofinë mashtruese të fesë, që e përdorte për t'i nënshtruar këto masa, pa punën e të cilave klasat shfrytëzuese nuk mund të kishin jetë.

Të dashur vëllezër e motra, ju faleminderit edhe një herë për pritjen e përzemërt dhe për vëmendjen.

Rroftë Partia!

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

VENDIMET HISTORIKE TË KONGRESIT TË PËRMETIT U BËNË ZJARR I PASHUAR PËR POPULLIN

*Fjala në pritjen e dhënë me rastin e 25-vjetorit
të Kongresit të Përmetit*

24 maj 1969

Shokë ish-delegatë të Kongresit të Përmetit dhe
të ftuar,

Më lejoni që me rastin e jubileut të madh, 25-vjetorit të Kongresit të Parë historik Antifashist Nacionalçirimitar të Përmetit, në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe të Këshillit të Ministrave, t'ju sjell përshtendetjet më të zjarra të gjithë juve dhe veçanërisht popullit heroik të rrethit e të qytetit të Përmetit, i cili gjatë Luftës Nacionalçirimtare luftoi me heroizëm dhe dha me qindra bij e bija dëshmorë. Qyteti i Përmetit u dogj tri herë me radhë nga pushtuesit barbarë nazi-fashistë, por, ashtu si gjithë populli shqiptar, edhe populli i këtij rrethi qëndroi i papërkulur në vijën e drejtë të Partisë sonë shqiponjë. Përmetaret dhe përmetarët, në kohët më të vështira, me trimëri dhe

me bujari, vunë në dispozicion të Partisë jetën, shtëpitë dhe kasollet e tyre, që në këtë qytet të zhvillohej Kongresi historik që mban emrin e tij.

Populli shqiptar i ka të qarta rëndësinë dhe vendimet historike të Kongresit të Përmetit. Ky Kongres ishte krijesë realiste e Partisë Komuniste dhe e popullit shqiptar. Orientimet e Partisë na udhëhoqën dhe na frymëzuan, na mbushën zemrat me kurajë të pashembullt neve delegatëve të Kongresit, që me pushkë në dorë erdhëm këtu për të realizuar aspiratat e popullit shqiptar, ëndrrat e gjyshërve e të stërgjyshërve tanë, ëndrrat e shokëve e të shoqeve që ranë në beteja, për të marrë vendime politike, ideologjike e ushtarake, të cilat do të kurorëzonin plotësisht qëllimet e shenjta të Partisë dhe të popullit. Të gjitha këto ne i bëmë nën krismën e topave dhe të avionëve të armikut që lëvrinin rrëth Përmetit, i cili mbrohej në atë kohë nga të katër anët, nëpër gërxhe e male, nga brigadat e Ushtrisë sonë heroike Nacionalçirimitare, që nuk lejuan të kalonte as miza për të shqetësuar këtë vepër të madhe që ndërmerrte Partia.

Ne i kujtojmë me krenari të gjitha ato momente aq madhështore dhe ndiejmë në vetvete një gëzim të papërshkruar që gjaku i shokëve tanë, gjaku dhe djesa e mbarë popullit, vuajtjet e tij, nuk shkuan kot. Me pjekurinë dhe me qartësinë e madhe politike që e karakterizonte, Partia gjeti momentin e përshtatshëm për thirrjen e Kongresit të Përmetit dhe formuloi tezat politike, ideologjike dhe ushtarake që do të shtroheshin atje, të cilat e ardhmja do t'i vërtetonte se ishin plotësisht të domosdoshme dhe të drejta.

Para Kongresit të Përmetit shtrohej detyra historike për të konsakruar ligjërisht bazat e pushtetit të popullit nga një asamble e zgjedhur demokratikisht në luftë kundër pushtuesve dhe tradhtarëve; për të përcaktuar karakterin e këtij pushteti që populli dhe partizanët e lavdishëm, nën udhëheqjen e Partisë, krijuan nga themelitë nëpërmjet luftërash të përgjakshme; për të hedhur bazat kushtetuese të pushtetit, të cilat të kishin në themel të tyre aspiratat demokratike, liridashëse, luftarake dhe revolucionare të popullit tonë në shekuj.

Ky pushtet, i bazuar në teorinë ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit, që Partia jonë e kishte bërë gjakun dhe mishin e saj, do të realizonte njérën pas tjetrës detyrat e rëndësishme dhe me përgjegjësi kolosale që kishin marrë përsipër komunistët përpara popullit. Në radhë të parë, duhet të përfundonte me sukses Lufta Nacionalçlirimtare, të dërrmohej përfundimisht forca e pushtuesit, të likuidoheshin bazat e reaksionit, të Ballit Kombëtar e të Legalitetit dhe të çlirohej sa më parë e gjithë toka shqiptare. Me fjalë të tjera, duhej shkatërruar fund e krye, me një revolucion të zjarrtë, me pushkë në dorë, barbarizmi i kohëve moderne që e përfaqësonin ujqit nazistë gjermanë dhe fashistë italianë, si dhe të fshiheshin nga faqja e dheut mbeturinat e barbarizmit të feudalëve, të bejlerëve, të agallarëve dhe të gjakpirësve të tjerë të popullit.

Me këta objektiva kryesore që përcaktuan Partia dhe Komiteti i saj Qendror, ne delegatët e Kongresit të Përmetit erdhëm këtu të bindur se populli do t'i

miratonte ata dhe do t'i bënte të vetat, ashtu sikundër i bëri. Vendimet historike që u morën 25 vjet më parë u bënë zjarr i pashuar për popullin dhe për partizanët heroikë të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, të cilët shumëfishuan energjitetë, shtrënguan edhe më fort radhët dhe marshuan më me furi përmbi armikun, duke bërë sakrifica të panumërtë. Në këtë luftë le gjendare ata treguan një pjekuri të rrallë politike dhe ideologjike, që e kishte burimin në pjekurinë e Partisë së tyre të dashur, e cila, në të katër anët e vendit, ngriti peshë të madh e të vogël, duke i bindur masat se fitorja është jona, është e popullit.

Por, siç e dini, të dashur shoqe dhe shokë, Kongresi i Përmetit pati edhe rëndësi të madhe ndërkommbëtare. Ai synonte konsolidimin e pozitave të Shqipërisë në arenën ndërkommbëtare dhe u deklaronte botërisht armiqve tanë se duhet të marrë fund njëherë e mirë ajo histori e të mbylljet përgjithmonë ai defter kur populli shqiptar jo vetëm nuk llogaritej, por robërohej, shtypej, digjej dhe copëtohej. Kurse miqve Kongresi u thoshte se populli shqiptar, i cili tërë jetën ka luftuar me pushkë në dorë, me Luftën Nacionalçlirimtare u dha fund veprave mizore të armiqve të tij, qofshin këta të jashtëm apo të brendshëm. Kongresi i siguroi, gjithashtu, popujt përparimtarë të mbarrë botës se te populli shqiptar ata do të kishin një mik dhe aleat besnik të sprovuar, kurse politikanëve të imperializmit, që në atë kohë ishin aleatë me ne në luftën kundër fashistëve dhe nazistëve, ua bëri të qartë se në Shqipëri morën fund njëherë e përgjithmonë regjimet e kurdisura nga klikat me njëqind fla-

murë në xhep, se banditët, si: Ahmet Zogu, Mehdi Frashëri, Lumo Skëndo, Ali Këlcyra e të tjerë, jo vetëm s'kishin më vend në Shqipëri, por do të shkonin në satërin e popullit, sepse Shqipëria tani kishte vetëm një zot — popullin, kishte vetëm një forcë politike, ideologjike, organizative dhe udhëheqëse — Partinë Komuniste të Shqipërisë.

Populli me Partinë në krye e çlroi atdheun me sakrifica të mëdha. Në këtë luftë ai dha 28 000 dëshmorë, që në përpjesëtim me numrin e popullsisë, përbën një nga humbjet më të mëdha në krahasim me vendet e tjera të botës. Vendi ynë u dogj dhe u shkatërrua. Pas Çlirimt na u desh të kalonim vësh-tirësi të mëdha, i duhej përveshur punës nga e para. Të gjithë e dini vetë se si mbarë populli u ngrit përimëkëmbjen dhe fuqizimin e atdheut të rrënuar, përndërtimin e Shqipërisë së re.

Në Luftën Nacionalçlirimtare Partia i kushtoi një kujdes të madh marrjes së pushtetit. Një gabim i vogël po të bëhej në këtë drejtim, do t'i kushtonte rëndë popullit shqiptar. Por Partia jonë e lavdishme, që ishte gjaku i popullit dhe mishëronte traditat më të mira luftarake të tij, të shkruara në histori me gjakun e gjuhërve e të stërgjyshërve tanë, të shokëve e të shoqeve që dhanë jetën në revolucionin populor, nuk bëri dhe s'mund të bënte gabim në çështjen e pushtetit. Ajo s'mund të gabonte në këtë çështje, se udhëhiqeji nga ideologjia marksiste-leniniste, që na mësonte se ky pushtet duhet të ishte diktatura e proletariatit, pushtet i dhunës kundër borgjezisë, kapitalistëve e mbeturinave të tyre.

Ky pushtet, na mësonte Partia, duhej të ishte nga më demokratikët, të mbronte demokracinë dhe lirinë e vërtetë për masat e popullit, për klasën punëtore, për fshatarësinë punonjëse, për gratë dhe për rininë; me të do të ndërtoheshin në të ardhmen socializmi dhe komunizmi. Një lëkundje në këtë çështje kaq të rëndësishme do të thoshte t'u bëje lëshime atyre që me shekuj kishin shtypur e kishin shfrytëzuar popullin, ta ndaje pushtetin me bejlerët, me agallarët, me fajdexhinjtë dhe me sejmenët e tyre. Të bëje kompromis me ta, do të thoshte të rrezikoje fitoret e popullit, të zbutje dhe të dobësoje në forma të ndryshme reformat e thella politike, ekonomike e ushtarake, të shknonin dëm gjithë vuajtjet e luftërat e popullit tonë. Të bëje lëshime ndaj amerikanëve dhe anglezëve, do të thoshte të rrezikoheshin kryekëput e ardhmja, liria, demokracia e vërtetë, pavarësia e atdheut. Të tregoheshe i butë e i lëkundshëm ndaj tyre, duke menduar se ata ishin pjesëmarrës në luftën kundër fashizmit, kjo do të kushtonte shtrenjtë. Partia nuk shkeli në dhogë të kalbur, sepse i njihte mirë kush ishin anglo-amerikanët, dinte se ishin ata që mëkëmbën nazifashizmin, diktaturën më të egër, mjet që përdoret nga borgjezia dhe kapitali, kur shikojnë që rrezikohen nga revolucioni. Imperialistët amerikanë dhe anglezë ishin ata që mbështetën e nxitën Hitlerin dhe Musolinin kundër atdheut të socializmit, Bashkimit Sovjetik, si dhe kundër gjithë popujve liridashës të botës. Por kontradiktat që ekzistonin në atë kohë midis vetë vendeve kapitaliste, kishin arritur në atë fazë saqë e bënë Hitlerin që me ëndrrën e tij të çmendur t'u

shpallë më parë luftë atyre dhe, më vonë, të sulmojë Bashkimin Sovjetik. Pikërisht, duke i pasur të qarta të gjitha këto çështje, Partia jonë nuk gaboi.

Vija e Partisë dhe vendimet e Kongresit të Përmetit u zbatuan jo si në gjalpjë, por me vështirësi të shumta e në luftë të vazhdueshme, që zgjatën për vite të tëra. Lufta jonë zhvillohej në të gjitha drejtimet, me armë dhe në fushën politike kundër pushtuesve e mbeturinave të borgjezisë, kundër intrigave të anglo-amerikanëve, luftë për miqësinë me Bashkimin Sovjetik, tek i cili ne kemi pasur besim të madh, pse ai ishte atdheu i socializmit, atdheu i Leninit dhe i Stalinit, që mbajti peshën më të madhe në luftën kundër fashizmit.

Shokë, kur mendojmë se si e krijuam dhe e kalitëm pushtetin tonë të këshillave popullore, se si goditëm dhe likuiduam pa mëshirë mbeturinat e forcave ekonomike, politike dhe të bandave të reaksionit, të cilave u hoqëm nga duart çdo gjë që kishin; kur mendojmë rindërtimin që nga themellet të atdheut tonë të rrënuar, zbatimin e Reformës Agrare, ndërtimin e industrisë sonë socialiste, triumfin e socializmit në fshat, reformën arsimore etj., na bëhet zemra mal. Gjithë këto fitore të mëdha historike e bëjnë popullin shqiptar të krenohet për Partinë e tij, e cila e ktheu Shqipërinë në kështjellë të fortë dhe të pathyeshme të socializmit. Partia krijoj hap pas hapi dhe brumosi njeriun tonë të ri me ndërgjegje revolucionare, të ngritur politikisht dhe të qartë ideologjikisht, njeriun që do të kuqtonte si duhet dhe do të zbatonte me përpikëri, pa lëkundje dhe me zjarr revolucionar vijën

e Partisë, që do të mishëronte dëshirat e zjarrta të masave. Kjo ishte fitorja më e madhe e Partisë. Qartësia politike e ideologjike, uniteti i çeliktë e i pathyeshmë i popullit me Partinë, që u farkëtua në kushtet e luftës dhe të përpjekjeve heroike, krijuan atë gjendje politike e morale të popullit që bëri të kapërcehen të gjitha vështirësitë.

Në realitetin dhe në luftën e vendit tonë vërtetohet drejtësia e parimit sipas të cilit në çdo veprim populli duhet të mbështetet në forcat e veta. Kjo nuk përjashton ndihmën internacionale, të sinqertë dhe pa interes të proletariatit ndërkombëtar, të partive komuniste të vërteta dhe të popujve përparimtarë të botës. Këtë parim të madh, si në kohën e Luftës Nacionallirimi, ashtu dhe sot në ndërtimin socialist të vendit, Partia jonë e zbatoi dhe po e zbaton drejt.

Gjatë Luftës Nacionallirimi ne luftuam dhe e liruam vetë atdheun tonë. Ne e kuptuam drejt se duhej të luftonim e të derdhnim gjak, sepse liria nuk dhurohet, por fitohet. Por, duke luftuar vetëm nëpër male, Partisë kurrë nuk i kishte shkuar në mend se po bënte një luftë të izoluar, sepse atëherë lufta jonë do të ishte pa shpresa, prandaj ajo ia bëri të qartë popullit se në këtë luftë ne nuk ishim vetëm, me ne ishin Bashkimi Sovjetik, i udhëhequr nga Stalini, ishin të gjithë popujt liridashës të botës, të cilët luftonin kundër nazifashizmit, duke përfshirë këtu edhe vetë popullin anglez dhe atë amerikan.

Reaksioni anglo-amerikan, nëpërmjet veglave të tij në Shqipëri, ballistëve e zogistëve, të cilët nuk

shkrehën asnjë pushkë kundër pushtuesve, përkundrazi, u hodhën kundër nesh për të dobësuar dhe për të shuar luftën që bënte populli nën udhëheqjen e Partisë, dilte me gjithfarë parullash, si: «Mos luftoni», «Pse të sakrifikoheni», «Përse të vriteni», «Pse të digjeni», «S'ka ardhur koha për luftë» etj. Me parulla të kësaj natyre imperialistët anglo-amerikanë donin të na thoshin: «Pritni t'ju çlirojmë ne», me qëllim që në të ardhmen të na skllavëronin edhe më shumë se më parë; ata kërkonin që populli të mos luftonte si luan për mbrojtjen e tij, por të nënshtrohej që t'ia hidhnin më lehtë zinxhirët. Anglo-amerikanët thur-nin plane për të ardhmen, por i bënë hesapet pa hanxhinë.

Pra, kështu e zbatuam ne parimin e mbështetjes në forcat e veta në kohën e luftës dhe fituam. Shqipërinë e çliruam me gjakun, me djersën dhe me sakrificat tonë. Ashtu si na mëson Lenini, i cili e ka çmuar kurdoherë drejt dhe në mënyrë internaciona-liste ndihmën e proletariatit dhe të popujve të botës për fitoren e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit dhe për mbrojtjen e pushtetit të ri të sovjetëve, pa të cilën, ka nënvizuar ai, Bashkimi Sovjetik do të kishte humbur; ashtu si Stalini, i cili e njihte dhe e çmonte, gjithashtu, shumë kontributin që popujt e robëruar jepnin për kauzën e madhe të fitores mbi fashizmin, edhe Partia jonë e ka shtruar gjithmonë drejt çështjen që Lufta e Madhe Patriotike e Bashkimit Sovjetik ka qenë faktori i jashtëm vendimtar i fitores historike të popullit tonë.

Parimin e mbështetjes në forcat e veta Partia e

zbatoi drejt edhe pas Çlirimt të vendit. Ne e kërkuam ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe Stalini, me aq sa kishte mundësi, na ndihmoi me bujari. Kërkësat tonë ishin të drejta, normale dhe internacionaliste. Edhe ndihmat që na u dhanë patën rëndësinë e tyre, por Partia dhe populli ynë asnijëherë nuk i varën shpresat vetëm tek ato, por i vunë gjoksin punës dhe me forcat e veta ndërtuan kështu, siç e shohim sot, këtë vend që në të kaluarën kishte vuajtur shumë.

Rezisionistët sovjetikë, renegatë të marksizëm-leninizmit, na quajnë «tradhtarë», sepse, sipas tyre, ne qenkemi larguar nga marksizëm-leninizmi e nga internacionalizmi proletar dhe sepse nuk i mbështetim ata në tradhtinë e tyre. Ne i kemi vlerësuar drejt, në frymë të pastër internacionaliste, ndihmat që na kanë dhënë në rrugë të drejtë marksiste-leniniste popujt sovjetikë dhe u jemi mirënjoyës atyre, por ne luftojmë dhe do të luftojmë me tërë forcën e urrejtjes deri në shkatërrimin e plotë të rezisionistëve hrušovianë, të cilët usurpuan pushtetin në Bashkimin Sovjetik, në atdheun e Leninit e të Stalinit, dhe e kthyen atë në një vend kapitalist, socialimperialist. Momenet historike që po kalojmë tregojnë se rruga që ndjek Partia janë është e drejtë, kurse rezisionistët janë zhytur në llumin e tradhtisë.

Le të marrim çështjen e ndihmave ekonomike. Derisa ishte gjallë Stalini, ndihmat Shqipërisë i jepe-shin në frymë internacionaliste, ndërsa me të ardhur në fuqi hrushovianët, të ashtuquajturat kredi dhe disa fabrika (që i dimë sa janë e qysh janë), na u dhanë për qëllime të tjera. «Ndiham» e tyre nuk

ishin më internacionaliste, por kishin karakter imperialist, skllavërues. Hrushovianët kërkonin që ne shqiptarët jo vetëm t'i përmendnim vazhdimisht ato, por të qëndronim kurdoherë të bindur dhe servilë përpara tyre, që gjoja përfaqësonin socializmin dhe marksizëm-leninizmin!

Po kështu kontributin e madh që dha Ushtria e Kuqe në luftën për çlirimin e popujve nga fashizmi, revisionistët sovjetikë e shfrytëzuan për qëllime imperialiste. Ata harruan krejtësisht dhe përcmuant luttën e kontributin që dhanë populli shqiptar dhe popujt e tjerë për fitoren kundër fashizmit. Këtu s'ka asnjë fije internacionalizmi, asnjë fije të doktrinës së mëdhe të Marksit dhe të Leninit që e vlerëson si duhet kontributin që jep çdo popull, i madh apo i vogël qoftë, në revolucion. Partia jonë këtë çështje e ka parë dhe e shikon kurdoherë drejt.

Parimi i mbështetjes në forcat e veta, që ndjek Partia jonë e udhëhequr nga idetë e marksizëm-leninizmit, luftohet nga imperializmi amerikan, nga këlyshët e tij dhe nga socialimperializmi sovjetik për të bërë të pranueshme «ndihmat» që u japid vendeve të tjera, por që në fakt janë litar në grykë, janë helm. Ata, duke të dhënë majën e thoit, përpilen të të gjallabërojnë krahun dhe pastaj gjithë trupin.

Partia e Punës e Shqipërisë nuk ka pritur dhe nuk pret «ndihma» e kredi nga imperialistët e revisionistët, pse ne kemi forcën, djersën dhe pasuritë tonë, kemi Partinë tonë, që me zgjuarsi e me zotësi i shfrytëzon të gjitha këto pasuri për të mirën e popullit. Prandaj edhe fuqia jonë politike, ekonomike, ush-

tarake rritet e fuqizohet çdo ditë dhe bëhet tmerr për armiqjtë.

Ne e kemi të qartë përse e kundërshtojnë imperialistët amerikanë dhe revisionistët modernë sovjetikë parimin e mbështetjes në forcat e veta dhe reklamojnë me të madhe «ndihmën» e tyre. Revisionistët sovjetikë me teorinë e «sovranitetit të kufizuar» përpiken të realizojnë qëllimet e tyre imperialiste dhe skllavëruese. Këtë teori të kalbur antimarksiste dhe imperialiste ata e konsiderojnë si teorinë më të kuilluar marksiste-leniniste gjoja për mbrojtjen e përbashkët nga imperializmi. Me parullën demagogjike për mbrojtjen e përbashkët nga imperializmi, revisionistët sovjetikë duan të na bindin që të hedhim poshtë ndjenjën e pastër marksiste-leniniste të sovranitetit, për të cilën ata na akuzojnë si nacionalistë. Sovraniteti dhe uniteti marksist-leninist kundër imperializmit realizohen drejt vetëm kur një vend socialist nuk është i skllavëruar prej një fuqie të madhe imperialiste e shoviniste, por është një forcë revolucionare dhe zbaton parimet e drejta të lirisë, të demokracisë dhe të sovranitetit, duke u mbështetur në forcat e veta dhe në idetë e marksizëm-leninizmit, që të armatosin për të luftuar me sukses imperializmin. Revisionistët sovjetikë, të cilët janë shndërruar në socialimperialistë, dëshirojnë që teorinë e «sovranitetit të kufizuar», që s'është gjë tjetër veçse një teori imperialiste, ta vënë në zbatim me petka false marksiste-leniniste, për të futur në kthetrat e tyre lëvizjen komuniste e revolucionare botërore. Këtë nuk e pranon marksizëm-

-leninizmi, nuk e pranon, por e lufton me ashpërsi Partia e Punës e Shqipërisë.

Një nga aspektet më të rrezikshme të politikës së imperialistëve dhe të revizionistëve modernë është shovinizmi i shtetit të madh, që ka për qëllim vendosjen e hegemonisë së tyre me anën e forcës shtypëse të armëve, të presioneve ekonomike, të shantazheve e të frikësimeve, me aleancat imperialisto-revisioniste dhe me luftërat grabitqare për rindarjen e botës.

E gjithë kjo politikë hegemoniste e agresive dhe intrigat që sundojnë në aleancën amerikano-sovjetike po zbatohen me ritme të shpejta nga imperialistët amerikanë dhe nga revizionistët sovjetikë në të katër anët e botës. Ato mbulohen nën petkun e teorisë së bashkezistencës paqësore të tradhtarëve të Moskës, të cilët kuptimin e drejtë që Lenini dhe Stalini i kanë dhënë këtij parimi e shtrembërojnë siç ua kërkon interesi. Me këtë ata duan të ligjërojnë sundimin e tyre imperialist në botë, të shuajnë luftërat revolucionare dhe të zhvillojnë luftëra agresive e grabitqare, që i kanë në gjak. Kjo është arma e ideologjisë së tyre, një nga mjetet me anën e së cilës imperializmi dhe social-imperializmi sovjetik përpiken të realizojnë qëllimet e tyre. Për këtë ata predikojnë edhe teorinë e çarmatimit, duke dashur të çarmatosemi ne, ndërsa vetë qëndrojnë të armatosur dhe vazhdojnë të armatosen deri në dhëmbë.

Rreth këtyre çështjeve revizionistët sovjetikë zhvillojnë teori «të mëdha», antimarksiste, me të cilat këta ujq duan të thonë: «Ju duhet të bindeni, se ne jemi

të destinuar të bëjmë ligjin; na i lini fatet tuaja në duart tona, se ne jemi marksistë-leninistë, jemi bijtë e Leninit dhe Lenini lindi në Bashkimin Sovjetik, prandaj na përket neve të luftojmë për interesat e socializmit dhe të komunizmit». «Ombrella jonë e armëve atomike, — thonë tradhtarët revisionistë sovjetikë, — do t'ju mbrojë të gjithë ju, tërë popujt». Duke luftuar për të sunduar popujt, për të grabitur pasuritë e tyre dhe për të turbulluar ndërgjegjen dhe pikëpamjet e njerëzve, revisionistët sovjetikë përpinqen të forcojnë pozitat shoviniste të shtetit të madh.

Edhe imperializmi amerikan të gjitha grabitjet dhe luftërat që ka bërë e po bën për pushtimin e vendeve dhe të tregjeve të huaja, për sigurimin e lëndëve të para, pa të cilat nuk mund të ekzistojë, i mbulon me teorinë e tij të «mbrojtjes së botës së lirë», të «ndihmave për zhvillim» etj. Për të grabitur pasuritë e vendeve të tjera dhe për të sunduar popujt, ai ka shtuar armatimet dhe ka ndërtuar bazat e veta ushtarake në shumë vende të botës, që kurrë nuk do t'i dorëzojë po nuk iu morën me forcë nga popujt, me luftë dhe me gjak. Vetëm kështu bota do të shpëtojë njëherë e mirë nga ky gjakpirës.

Imperializmi amerikan përpinqet, gjithashtu, të blejë ndërgjegjen dhe mendjen e njerëzve deri edhe nga aleatët e tij, për t'i varfëruar këta dhe për t'i vënë nën thundrën e vet. Së bashku me revisionistët sovjetikë, ai kurdis komplete për të mposhtur popullin e Vietnamit dhe popujt e tjerë që luftojnë për liri, paravarësi e socializëm.

Të gjitha këto, në plan të përbashkët, imperiali-

stët dhe revizionistët i bëjnë për të shuar revolucionin socialist dhe për të përjetësuar pushtetin kapitalist, për të shndërruar vullnetin revolucionar të popujve për çlirim e socializëm në një butësi fataliste, për të ruajtur kështu shfrytëzimin kapitalist dhe për t'i kthyer popujt në mish për top për kasaphanat e reja imperialiste.

Këto veprimtari djallëzore të imperialistëve dhe të revizionistëve zhvillohen në sytë tanë. Po edhe ne nuk rrimë duarlidhur, por luftojmë me ta dhëmb për dhëmb dhe thikë më thikë, prandaj ata e kanë halë në sy dhe armike Shqipërinë tonë.

Pavarësisht nga parullat që përdorin, mund të themi se tiparet e politikës së të dyja këtyre fuqive të mëdha imperialiste janë të njëjta. Në këto tipare është mbështetur edhe aleanca sovjeto-amerikane. Imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë kanë qëllime të njëjta. Ata i lidh lufta kundër socializmit, kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, kundër luftërave nacionalçirimitare të popujve, kundër marksistë-leninistëve të vërtetë në botë. Në këto qëllime ata janë në unitet midis tyre, por si imperialistë që janë kanë edhe kontradikta, të cilat janë në dobi të revolucionit.

Duke i hedhur një shikim të shpejtë zhvillimit të situatës në botë, duket qartë se, me gjithë aleancat që ekzistojnë midis imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve sovjetikë, vihen re edhe tendenca të theksuara ashpërsimi të kontradiktave midis tyre për ndarjen e sferave të influencës. Përveç kësaj, socialimperializmi sovjetik ka vështirësi të mëdha si brenda

vendit të vet, ashtu edhe në marrëdhëniet me satelitët, të cilëve kërkon t'ua shtrëngojë sa më fort zinxhirët. Ai ka vendosur në vendet e Evropës Lindore ushtritë e veta, që synojnë, në radhë të parë, të konsolidojnë pozitat e renegatëve të Kremlinit, sepse klikat revizioniste në fuqi të këtyre vendeve kanë kontradikta me revisionistët sovjetikë, por edhe të shtypin kryengritjet e popujve dhe të marksistë-leninistëve, nga të cilat këto klika kanë një frikë të madhe. Socialimperialistët sovjetikë kërkojnë t'i mbajnë në zap vendet e tjera revisioniste, kurse këto s'duan të qëndrojnë nën hekurat e carëve të rinj të Kremlinit, prandaj janë të përqara. Nga njëra anë, revisionistët e vendeve satelite u buzëqeshin padronëve sovjetikë, por, nga ana tjetër, duan të përqafohen me imperialistët amerikanë, anglezë, gjermanoperëndimorë e të tjera, për arsy se, ashtu si vetë revisionistët sovjetikë, edhe ata janë njerëz të njëqind flamurëve. Mirëpo për të realizuar qëllimet e tyre nuk i lejojnë padronët sovjetikë. Kjo është arsyja që perandoria sovjetike, e kalbur nga brenda, mbahet me forcën e militarizmit fashist.

Në të njëjtën mënyrë vepron imperializmi amerikan me aleatët e tij të Evropës. Edhe këta të fundit, megjithëse kanë frikë nga popujt, nga komunizmi, si armiqjtë kryesorë të tyre, dhe kanë nevojë për mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, prapëserapë, kur gjejnë rastin, përpiken t'u vënë bërrylat për arsy se kapitali amerikan po u zë frymën.

Në këto koniunktura imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik përpiken t'i kenë secili të mbërthyer mirë në darën e vet satelitët, me qëllim që

në Evropë të ketë «qetësi» dhe, nën parullën e bashkëekzistencës paqësore, së bashku t'i zgjidhin problemët në mënyrë «paqësore», me diskutime etj., etj.; me një fjalë, të shuhen grindjet imperialiste dhe kontradiktat në mes tyre për të shtypur më mirë lëvizjet revolucionare në Evropë.

Vija e drejtë revolucionare e partive të vërteta komuniste zbulon dhe zgjon te popujt forca madhështore të pallogaritshme. Këtë forcë e shikojmë edhe në vendin tonë. Kudo zienjeta, revolucioni. Njerëzit tanë marrin fuqi si Anteu, hidhen me guxim e me iniciativë në veprime revolucionare, duke zbërthyer, duke konkretizuar dhe duke vënë në jetë direktivat e Partisë. Industria jonë fuqizohet, rritet e çelikoset klasa punëtore, shkenca ecën përpala dhe bëhen gjithë këto transformime teknike. Bujqësia jonë, gjithash tu, zhvillohet me ritme të shpejta. Partia dhe shteti do të marrin masa që në pesë vjetët e ardhshëm Shqipëria të bëhet akoma më e fortë e më e bukur në çdo drejtim. Do të rriten, sidomos, rendimentet në bujqësi, sepse do të shtohet mekanizimi, do të zgjerohen sipërfaqet e ujitshme, do të përmirësohen farërat etj.

Në radhë të parë Partia u ka vënë rëndësi të madhe ngritjes moralo-politike të njerëzve, që janë pasuria më e vlefshme, dhe progresit teknik. Revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës do t'i japë një hov të madh ndërtimit të socializmit në shoqërinë tonë. Ai do të ndihmojë për transformimin rrënjosor marksist-leninist të njeriut tonë të ri të edukuar me ideo-logjinë marksiste-leniniste, duke zbatuar parullën e Partisë «Në njérën dorë kazmën dhe në tjetrën pu-

shkën», që brezat e ardhshëm ta ndiejnë plotësisht përgjegjësinë e madhe që kanë për të marrë dhe për të çuar më tej stafetën e revolucionit. Puna e prindërve me të mirat e të metat t'u shërbejë atyre për ta çuar atdheun në rrugën e sigurt të socializmit e të komunizmit dhe ata, duke qenë të rinj, të rriten të pastër, të kulluar, punëtorë, marksistë-leninistë të vërtetë, bolshevikë revolucionarë. Qëllimi ynë kryesor me revolucionarizimin e shkollës është që te njerëzit e rinj të vendit tonë të luftohen mbeturinat e vjetra të intelektualizmit e të burokratizmit, kundër të cilave lufton sot Partia dhe ka arritur suksese të mëdha. Brezat e ardhshëm duhet ta kenë kurdoherë të qartë se trashëgimi që po u lënë baballarët e nënët e tyre u sigurua me gjak, me djersë, me punë, me vuajtje dhe me luftëra të ashpra e të pandërprera. Prandaj ata kanë për detyrë që këtë trashëgim ta çojnë përpara.

Revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës sonë do të bëjë që të rinjtë, të cilët do të dalin nga shkolla, të jenë të vendosur për çështjen e klasës punëtore e të kaliten me fryshtë e saj, të dinë të mendojnë, të punojnë e të ndiejnë si ajo, të jenë të thjeshtë, trima e besnikë ndaj çështjes së Partisë, ashtu sikurse klasa punëtore. Të gjitha këto ata duhet t'i fitojnë nga eksperienca e madhe e Partisë dhe e popullit, e klasës punëtore, e fshatarësisë heroike, që do të pasqyrohet akoma më mirë në programet e në tekstet e shkollave, si dhe nga puna që do të bëjnë në fabrika, në ara e kudo ku punohet e derdhet djersë.

Vëlezër dhe motra, t'i mësojmë kurdoherë djemtë

dhe vajzat tona të punojnë, të djersijnë, të jenë kokulur e ta duan Partinë si jetën. Ne i duam shumë fëmijët, por dëshirojmë që ata të rriten dhe të edukohen ashtu si na mëson Partia, të mos tërhiqemi nga ndjenja thjesht prindërore, por të mendojmë thellë se, në rast se ata i çojmë në rrugën që na mëson Partia, atëherë i kemi dashur me të vërtetë. Në qoftë se i përkëdhelim, u fërkojmë krahët, u themi të rrinë në qytet, se prandaj mësuan e morën diplomën, ne do të dëmtojmë kështu veprën e Partisë, do të shkelim gjakun e shokëve tanë dhe do të rrezikojmë ndërtimin e socializmit, sepse do të krijojmë burokratë e intelektualë të sëmurë, do të dëmtojmë edhe vetë fëmijët. Njerëz të tillë nuk i shërbejnë si duhet popullit, i cili ka nevojë për njerëz me zemër të fortë, të guximshëm, punëtorë dhe luftarakë.

Rrezikun e imperializmit amerikan dhe të revisionizmit sovjetik kurrë të mos e harrojmë. Prandaj të jemi kurdoherë vigjilentë e të armatosur. Armët t'i mësojmë dhe t'i ruajmë mirë. Arti ushtarak duhet të mësohet jo vetëm në ushtri, por nga i gjithë populli, nga gratë e burrat, nga të rinjtë e pleqtë, që në rast rreziku cilido jo vetëm të jetë në gjendje të luftojë siç kanë luftuar baballarët e gjyshërit tanë dhe siç luftuam ne në luftën partizane, por të dijë të luftojë dhe t'i vërë armiqtë përballë një taktkë dhe strategjje marksiste-leniniste të zgjuar, të vendosur e të shkathët, për t'i shkatërruar ata sa më shpejt dhe përfundimisht.

Ne, vëllezër dhe motra, jemi të bindur se këtë do ta bëjmë, sepse në këtë rrugë na udhëheq Partia

jonë e lavdishme, sepse kështu çojmë në vend amanetin e dëshmorëve tanë, që është kurdoherë pishtar për ne. Ata ditë e natë duket sikur na thonë: «Shokë e shoqe, jini luftëtarë të guximshëm dhe trima si nel Kurrë mos u bëni kryelartë, por të jini të thjeshtë, sikundër ishim edhe ne! Ne luftuam për popullin dhë, me fjalën e Partisë në zemër, dhamë gjakun si partizanë të thjeshtë, prandaj edhe ju ta doni popullin me gjithë shpirt, mos kurseni as jetën tuaj po të jetë nevoja, siç nuk e kursyem edhe ne! Ta doni Partinë me gjithë shpirt, sepse Partia na frymëzoi, na udhëhoqi në luftën fitimtare! Ne morëm plumbat në gjoks, ku kishim të skalitur dashurinë e thellë për Partinë, dhe ramë me këngë në gojë për Partinë, për Partinë, për Partinë!».

Prandaj për Partinë kurdoherë përpara! Kjo është rrugë jonë, rruga e drejtë, rruga e fitores. Në këtë rrugë s'ka armik që të na pengojë. Të gjitha vështirësitë do t'i kapërcejmë dhe Shqipëria socialiste do të rrojë në shekuj, brezat e ardhshëm do të ndërtojnë komunizmin. Revolucioni do të fitojë!

Rroftë Partia!

Rroftë populli!

*Botohet për herë të parë, me
ndonjë shkurtim, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin
Qendror të Partisë*

NJË MUZE — MONUMENT I RËNDËSISHËM HISTORIK

*Nga biseda pas vizitës në Muzeun historik
të Gjirokastrës¹*

26 maj 1969

Me rastin e kësaj vizite, dëshiroj të përgëzoj personelin e Muzeut historik të Gjirokastrës pér punën e ndërgjegjshme e të organizuar mirë që ka kryer. Gjithçka e vendosur në këtë institucion është eks-pozuar drejt dhe bukur, me shije e me zgjuarsi, që të ndihmon të krijosh një përshtypje të plotë e të gjallë të luftës dhe të përpjekjeve heroike që ka bërë mbarë populli shqiptar e në mënyrë të veçantë populli i kësaj krahine.

Rëndësi të veçantë ka fakti që ky muze është vendosur në shtëpinë e dy patriotëve e luftëtarëve të shquar shqiptarë të Rilindjes sonë Kombëtare, Bajo e Çerçiz Topulli, që luftuan me pushkë dhe me penë e

1 Ky muze historik përfshin kryesisht dokumente të një-qind vjetëve: 1839-1939.

sakrifikuanc gjithçka për lirinë e popullit dhe për pavarësinë e atdheut.

Nga çdo pikëpamje që ta marrësh, kjo ndërtesë-muze, ku lindën Bajoja me Çerçizin dhe, më vonë, nipi i tyre Ago Topulli, i cili ra dëshmor në Luftën e madhe Nacionalçlirimtare, është një monument i rëndësishëm historik, një shkollë e madhe për popullin dhe për brezat e ardhshëm të vendit tonë.

Ata që kanë nderin të punojnë në këtë institucion duhet të studiojnë vetë, në radhë të parë, mendimin dhe veprën revolucionare të patriotëve e të luftëtarëve të shquar të popullit tonë, me qëllim që t'ua transmetojnë në mënyrë sa më të qartë të mëdhenjve e të vegjëlve, pleqve e të rinjve që jetojnë, mësojnë e punojnë këtu në Gjirokastër, si dhe atyre që vijnë e do të vijnë nga të katër anët e Shqipërisë për ta vizituar muzeun. Në këtë drejtim ka rëndësi se si do të komunikoni ju e si do t'ua shpjegoni atyre këtë të kaluar të lavdishme revolucionare të patriotëve e të luftëtarëve tanë.

Shkrimet dhe mendimet e patriotëve të Rilindjes janë gjithë zjarr e barut, kanë vlera të mëdha edukative. Njerëzve tanë u vihet detyra të mos qëndrojnë vetëm brenda klisheve të caktuara qysh më parë, domethënë brenda kuadrit të fjalëve, të veprave, të vjershave e të prozave të patriotëve tanë, ku shprehë mendimet dhe gjykimet e tyre, siç janë, për shembull, vjershat e Naim Frashërit, mendimet e Koto Hoxhit, të Jorgji Meksit e të sa e sa të tjerëve; por ata, si njerëz të cilëve Partia u ka hapur horizonte të gjera, duhet të shohin më thellë filozofinë e

mendimet revolucionare të këtyre burrave të shquar. Prandaj e kërkon puna që luftërat, përpjekjet, vjer-
shat e mendimet e patriotëve të studiohen me vëme-
ndje e thellë. Asnjë nga punonjësit tanë të mos me-
ndojë se me një të lexuar, ose vetëm me studimin që
u ka bërë këtyre veprave qysh kur ka qenë në bankat
e shkollës, ato kuptionen lehtë. Tani çdo njeri te ne,
me atë formim politik dhe ideologjik që e ka përga-
titur Partia, t'i studiojë me vëmendje dokumentet e
patriotëve të Rilindjes e të reflektojë, pse kështu do
të gjejë në to një thesar të madh, akoma të pazbu-
luar. Këtu qëndron rëndësia e këtyre dokumenteve.
Prandaj nuk duhet mjaftuar vetëm duke i lexuar
një herë.

Me qëllim që te njerëzit tanë të nxitet dëshira
për të studiuar historinë dhe gjuhën shqipe, mund të
krijohen forma të veçanta pune, sidomos me arsim-
tarët, ku të mësohet me kujdes dhe e përbledhur hi-
storia që përfshihet në gjithë dokumentet e ekspo-
zuara si në këtë Muze historik të Rilindjes sonë Ko-
mbëtare, ashtu edhe në të tjérët, dhe kështu të për-
vetësohet kuptimi i thellë revolucionar i luftërave të
popullit shqiptar e veçanërisht i periudhës së Rilindjes.

Historia e kësaj periudhe duhet të mësohet në-
përmjet dokumenteve ekzistuese, si dhe nga kujtimet
e nga tregimet e njerëzve që i kanë jetuar ngjarjet e
asaj kohe. Por kjo nuk do të thotë që të lihen pas
dore përpjekjet e mëtejshme për të zbuluar dokumen-
të e të dhëna të reja dhe për ta pasuruar vazhdimit
e më shumë këtë muze me to. Prandaj, sidomos të
rinjtë dhe të rejat tonë, duhet të kujdesen për të për-

fituar sa më shumë nga ata të shkuar në moshë, të cilët, për fat të mirë, jetojnë akoma, qoftë duke i pyetur, qoftë edhe duke dëgjuar prej tyre me hollësi deri edhe ngjarje të vogla të së kaluarës. Këto ngjarje atyre vetë mbas mund t'u duken se nuk kanë ndonjë vlerë, por për historinë e vendit tonë paraqitin rëndësi të veçantë, mbasi nëpërmjet këtyre ngjarjeve, në dukje të thjeshta, mund të sqarohet një periudhë për të cilën dokumentet akoma mungojnë. Edhe këto të dhëna të reja duhet të mblidhen me kujdes nga shokët që punojnë këtu.

Por ata që vijnë për ta vizituar muzeun, natyrisht, nuk qëndrojnë dot ditë të tëra më radhë për të parë dhe për të lexuar çdo dokument e vepër që është eksposuar. Një rëndësi të veçantë kanë edhe puna e punonjësve të muzeut me vizitorët, shpjegimet e qarta e të plota që duhet t'u bëjnë atyrc, në mënyrë që këta, kur të dalin nga kjo çerdhe filozofie e trimërie revolucionare, të jenë të sqaruar dhe të kenë plotësuar akoma më mirë njojuritë e tyre. Prandaj secili nga ju të bëjë një plan studimi personal për të përvetësuar brenda një kohe të caktuar gjithë këtë thesar të paçmueshëm që keni në dorë. Kjo do të ndihmojë që vizitorët të kuptojnë akoma më mirë trimërinë e madhe të popullit tonë, mençurinë, zgjuarsinë, sakrificat e tij të panumërtë në shekuj, të kuptojnë akoma më thellë filozofinë e Partisë sonë dhe veprën e saj, që është e lidhur si një zinxhir i vetëm me gjithë të kaluarën heroike të popullit tonë, dhe të mësojnë kështu si t'i shërbeshet sa më mirë atij.

Luftuan të parët tanë, luftuam edhe ne. Ata na

lindën ne që mësuam prej tyre dhe ne lindëm djem e vajza, të cilët sot përbëjnë brezin e ri të Shqipërisë, që po mëson nga vepra e pavdekshme e Partisë. Kështu do të ndodhë edhe me brezat e tjerë që do të vijnë më pas. Ky është ai thesar i madh që krijohet e rritet brez pas brezi në shekuj. Prandaj shokët e komitetit të Partisë të rrethit dhe akoma më shumë punonjësit e muzeut kanë detyra të mëdha në këtë drejtim.

Këtu kemi drejtor shokun Lefter Dilo, njeri me kulturë e me pasion të madh për punën në muze. Pasioni në çdo punë ka rëndësi të madhe, pse një punë që kryhet me pasion, del e shkëlqyer. Por ai, së bashku me të gjithë shokët e tjerë të muzeut, duhet kurdoherë të jenë objektivë, si dhe të ndihmohen me gjithçka që nevojitet për ta kryer si duhet detyrën e rëndësishme të pasqyrimit në mënyrë sa më të plotë të së kaluarës së lavdishme të popullit tonë.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

LABËRIA — NJË NGA KOLONAT MË TË ÇELIKTA TË PARTISË

Fjala në mitingun e Picarit të rrethit të Gjirokastërës

27 maj 1969

Të dashur burra dhe gra trime të Kurveleshit e
të Labërisë heroike,

Të dashur djem, nipër e mbesa të heronjve të
këtyre maleve,

Shokë komunistë dhe komuniste të çelikta të kë-
saj krahine,

Kam ardhur sot këtu te ju, në gjirin e këtij po-
pulli heroik, të patundur dhe besnik të Partisë, tok
me shokun Shefqet Peçi, birin e kësaj krahine, një
nga komandantët e lavdishëm të Ushtrisë Nacional-
çlirimtare, udhëheqës i shquar i Partisë dhe i pushtet-
tit tonë, si dhe me shokët Rrapo Dervishi, Nexhmije
Hoxha, Subi Bakiri¹ e të tjerë, për t'ju sjellë për-

¹ Rrapo Dervishi e Subi Bakiri, në atë kohë ishin, përkatësisht, sekretar i parë i Komitetit të Partisë dhe kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Gji-
rokastërës.

shëndetjet më të zjarrta të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë. Në emër të tyre dhe të mbarë popullit shqiptar ju falënderoj për gjithçka keni bërë për çlirimin e atdheut dhe për ndërtimin e socializmit. Kam ardhur për të shprehur, gjithashtu, mirënjohjen tonë të pafund dhe për t'u përulur me nderimin më të madh përpara kujtimit të dëshmorëve heroikë të Kurveleshit e të gjithë Labërisë, në sajë të luftës e të sakrificave të të cilëve dhe të të gjithë popullit tonë, lindi nga gryka e pushkës pushteti popullor, Shqipëria e re.

Partia më dërgoi këtu të kuvendoj e të këshillohem me ju, t'ju them q'mendon ajo për të tashmen dhe për të ardhmen e Shqipërisë socialiste. Dhe unë do t'ju flas si djali juaj, si vëllai juaj dhe si udhëheqës i Partisë. Por, përpara se t'ju flas si Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë, dëshiroj t'ju trajtoj diçka ngajeta ime.

Ashtu si ju, edhe unë linda dhe u rrita këtu në Labëri, u ushqeva me historinë legjendare të të parëve tanë, njoha nga afër përpjekjet dhe punën e njerëzve të kësaj krahine. Ashtu si juve, edhe mua më hynë thellë në shpirt, që në vegjëli, këngët e bukurë plot heroizëm të Labërisë, ku i këndohet trimërisë labe, që ka bërë të gjëmojnë këto male kreshnike, të cilat, me gjithëse gjatë shekujve kanë rënkuar nga skllavëria e të huajve, kurrë nuk janë përkulur. Ashtu si ju, edhe unë jam frymëzuar nga këto male të Labërisë, ku dimrit në kallkan kërciste sholla me proka e lebërve, veshur me bruca e llabane të dhirta në krahë, me shpatë e me pushkë në duar, që ndiqnin këmba-këmbës pu-

shtuesit e huaj, që të ishte i pavarur ky vend, që të ishte i lirë ky popull. Le ta digjte Pashai i Tepelenës Kardhiqin pse lebërit i ofenduan Valide hanëmin, burrat dhe gratë kardhiqote nuk i mposhti dot kurrë vezir Aliu. Hordhitë turke e greke, të ndjekura nga golemasit me dyfek e bruca me llapa, largoheshin të tmerruara nga këto male kreshnike. Ja sa bukur e ka përjetësuar populli në këngë këtë trimëri:

«Ç'janë ata që shkojnë zallit?

Trimat e Çelo Picarit.

Mos i dil përpëra kalit,

Se të merr lulen e ballit,

Bej, o more bej»...

«Në Mashkullorë te Rrapi,

Ergjeri ç'u vra bimbashi,

· · · · ·

Te rrapi në Mashkullorë

Foli Çeçua me gojë,

Lerni djemtë e mi të shkojnë,

Se ju bëj të kuq me bojë,

Cerçiz Topulli më thonë...»

Dhe e tërë kjo histori e lavdishme e luftërave për liri të popullit tonë s'ka mbarim.

Kur isha i vogël, nëna më thoshte: «Enver, o djalë, këta djathë, qumësht e mish që të rritin, i prodhojnë labët; këta drunj e këtë kongjill që po të vë në mangall për të ngrohur duart në dimër, që të mund të shkruash e të mësosh dhe që këtë dituri ta

vësh në shërbim të popullit kur të rritesh, i bëjnë labët; këtë lesh me të cilin të bëj çorapet e fanellat, si dhe leshin e palarë, që, pasi ta spërkat me raki, ta vë në gjoks kur ftohesh, e marrim nga labët». Të gjitha këto fjalë të nënës zienin në atë kohë në kokën time të vogël, por dalngadalë e duke u rritur fillova edhe unë ta kuptoja jetën. Ato tregime në vegjeli kalltnin nga dita në ditë ndërgjegjen time të re.

Këto desha t'ju thosha në fillim, motra dhe vëllezër, për veten time, se edhe unë, ashtu si ju, jam krenar që linda shqiptar, që jam bir i kësaj Labërie dhe që u bëra komunist.

Traditat heroike që ka trashëguar populli shqiptar brez pas brezi, u zhvilluan më shumë dhe u përjetësuan me epopenë legjendare më të madhe të historisë sonë, me Luftën Nacionaçlirimtare kundër pushtuesve të mëdhenj, të egër e të armatosur deri në dhëmbë, siç ishin fashistët italianë dhe nazistët gjermanë e, tok me ta, edhe bejlerët, agallarët, sundimtarët e gjithë gjakpirësit e tjerë të popullit tonë.

Përpara gjëmës së madhe që pësoi atdheu më 7 prill të vitit 1939, u ngrit në këmbë si një trup i vetëm mbarë populli, u ngritët ju, vëllezër e motra, trima e trimëresha të Labërisë, të Kurveleshit, të Gjirokastrës e të gjithë Shqipërisë. Mund të rronte vallë populli i krahinave të ndryshme të atdheut, mund të rronte populli kreshnik i Labërisë dhe i Kurveleshit nën zgjedhën e robërisë së të huajve? Kurrën e kurrës!

Që me thirrjen e parë të Partisë sonë heroike, duke ruajtur e duke zhvilluar traditat patriotike të

prindërve dhe të gjyshërvë tanë, mbarë populli shqiptar u ngrit në këmbë. Gjëmoi anembanë Shqipëria nga çetat dhe batalionet partizane, se zëri i Partisë ishte zëri juaj, zëri i punëtorit të shtypur, i fshatarit të shfrytëzuar deri në palcë, i malësorit të varfër e të rraskapitur, por kurrë të nënshtruar. Thirrja e Partisë shprehte dëshirat tuaja, dëshirat e gjithë popullit,ëndrrat e tij shekullore; ajo përfaqësonte të ardhmen e bukur që do të vinte. Dhe populli, ju fshatarë patriotë të Labërisë e të Kurveleshit, i vutë veshin thirrjes dhe ndoqët me besnikëri e gjer në fund Partinë, se ajo ishte juaja, ajo përbëhej nga djemtë dhe vajzat më të mirë të popullit, qe brumosur me shpirtin dhe me virtytet e tij më të larta. Partia, e armatosur me teorinë marksiste-leniniste, me eksperiencën e luftëtarëve revolucionarë të klasës punëtore, të fshatarësisë së shtypur e të malësorëve trima, me zgjuarsinë dhe me trimërinë e rrallë të shqiptarëve, vuri në themel të programit të vet idealet e popullit, të klasës sonë punëtore, në radhë të parë.

Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ashtu si në çdo anë të atdheut, edhe këtu në Labëri dolën gjithfarë armiqsh për të na penguar në rrugën tonë. Këta ishin ballistët, bejlerët e agallarët, shtypës e shfrytëzues të popullit, që u lidhën me armiqtë e huaj. Ne bëmë të gjitha përpjekjet t'i bindnim që të ndërronin rrugën, të bashkoheshin me popullin, të luftonin për çështjen e tij të drejtë, por sa mund të bashkohet zjarri me ujin, aq mund të bashkohen armiqtë me popullin dhe me Partinë e tij. Ne ishim zjarri, revolucioni, ata ishin uji që kërkonte të shuanë luftën tonë. Por nuk

ua arritën qëllimeve, sepse ne i mundëm, i thyem dhe i shpartalluam e jo vetëm ata, po edhe padronët e tyre.

Armiqtë tanë të jashtëm dhe të brendshëm ishin të egër, gjakpirës e barbarë. Sa herë është djegur krahina juaj, sa herë u dogjën gjatë Luftës Nacional-çlirimtare krahina të tëra të Shqipërisë! Por armiqtë nuk na mposhtën dot, se ata ishin të krimbur nga brenda, se politika dhe ideologjia nga të cilat udhëhiqeshin ishin skllavëruese, antipopullore. Në këtë truall ku ka jetuar në shekuj një popull i paepur, nga gjiri i të cilit lindi një parti revolucionare dhe e drejtë si Partia jonë, nuk ishte e mundur të qëndronte gjatë asnje këmbë armiku, prandaj, sado të fortë që ishin ata në fillim, ne i thyem.

Ne nuk patëm frikë se na mungonin armët, buka apo rrobat për t'u veshur, sepse kishim vendosmërinë, trimërinë, kishim Partinë në ballë që na udhëhiqte, na frymëzonte dhe na bënte të patundur si këto male, sepse me ne ishte mbarë populli, prandaj i bëmë ballë furtunës. Me armët që u rrëmbyem armiqve, i shpartalluam ata në beteja të përgjakshme, çliruam atdheun dhe ndërtuam Shqipërinë e re të popullit.

Nga krahina juaj dhanë jetën në altarin e atdheut me dhjetëra heronj, përpara të cilëve përulet me nderim të thellë mbarë populli. Kështu do të përulet përpara tyre vazhdimisht e brez pas brezi rinia jonë. Sakrificat e mëdha që bënë ata, ne dhe brezat e ardhshëm do të na frymëzojnë e do të na udhëheqin për të qenë kurdoherë gati me pushkë në dorë për mbrojtjen e këtij vendi të shtrenjtë, të lyer pëllëmbë më

pëllëmbë me gjak dëshmorësh. Armiqtë nuk i kanë hedhur armët, por edhe ne kurrë nuk do t'i lëshojmë armët nga dora, përkundrazi, ato do t'i shtojmë dhe do t'i perfeksionojmë çdo ditë e më shumë. Ne nuk jemi agresorë, me armët që kemi sot dhe me ato që do të kemi në të ardhmen, nuk kemi ndër mend t'i bëjmë keq askujt, por do t'u tregojmë vendin të gjithë armiqve të socializmit e të komunizmit, të gjithë atyre që do të guxojnë të prekin Shqipërinë tonë të shtrenjtë socialiste.

Trimërinë, motra dhe vëllezër të Labërisë, populli ynë e ka në gjak. Ne e kemi për detyrë që traditat patriotike t'ua transmetojmë brez pas brezi djemve e vajzave, nipërve e mbesave; t'u themi atyre se doktrina jonë marksiste-leniniste na mëson t'i ruajmë e t'i zhvillojmë tiparet karakteristike të kombit, të qëndrojhmë të paepur e kurrë të mos thyhem i përparrë armikut.

Shqipëria dhe populli i saj u kanë qëndruar të patundur rrebesheve të historisë. Populli shqiptar, sado i vogël që është, u reziston edhe sot me guxim të pashoq armiqve më të egër e më të mëdhenj që ka njojur njerëzimi, siç janë imperialistët dhe revizionistët modernë, se është trim dhejeta ka provuar që trimat e të fortët nuk zhduken dot. Historia botërore njeh popuj të tjerë shumë më të mëdhenj, që janë skllavëruar e pastaj janë zhdukur pa nishan, kurse populli shqiptar, sado i vogël, nuk është zhdukur dhe kurrë nuk do të zhduket. Pra, të dobëtit dhe të nënshtuarit janë të destinuar të shuhën, kurse të fortët, trimat, të guximshmit, të paepurit rrojnë dhe

shkojnë kurdoherë përpara. Ky është një ligj i natyrës që vërtetohet si në jetën e kafshëve e të bimëve, ashtu edhe në shoqërinë njerëzore. Prandaj, motra dhe vëllezër, të rrënjosim në zemrat e fëmijëve tanë dashurinë e zjarrtë për atdheun dhe për Partinë që t'i duan si jetën dhe t'i mbrojnë nga çdo rrezik.

Partia dhe atdheu mbrohen e forcohen jo vetëm me trimëri, me gjak e me sakrifica, por edhe me punë, me djersë. Sa për trimëri, lebërve dhe labeve s'ke ç'u thua, në këtë çështje ju jeni shembull për tërë Shqipërinë dhe gjëzoni respektin e të gjithëve.

Populli shqiptar ka një respekt të veçantë, sidomos, për gratë, për ju, nëna dhe motra, që jeni veshur me të zeza, për ju, nuse dhe vajza të reja, që jeni veshur me rroba të bukura, pse keni edukuar dhe edukoni fëmijët me dashuri të pakufishme për këtë truall, për popullin dhe për Partinë. E vërteta është se një nga faktorët kryesorë që djemtë dhe burrat e vendit tonë janë bërë kaq trima, është se ata kanë pirë në gjokset e mëmave shqiptare, sepse që kur janë përkundur në djep, ata janë brumosur nga ju, nëna dhe motra trimëresha, me virtytet e njerëzve të shquar, të luftëtarëve të papërkulur.

Prandaj Partia na këshillon t'i ndihmojmë akoma më shumë gratë, që ato të çlironen plotësisht nga mbeturinat dhe nga paragjykimet e së kaluarës, ndryshe nuk mund të ketë Shqipëri të lirë socialiste, nuk mund të lindin dhe të rriten djem e vajza të fuqishëm e të shëndoshë fizikisht dhe shpirtërisht, ashtu siç i duan populli e Partia. Ne burrat, duke reflektuar thelli në këto porosi, gjykojmë se Partia ka shumë të

drejtë. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se nganjëherë është vepruar gabim në trajtimin e grave, prandaj këtej e tutje të përpinqemi të mos ndodhë më kështu, por të spastrohemi nga mbeturinat e dëmshme të së kaluarës, që nënënat, gratë, motrat dhe vajzat tona të ecin përpara. Ne duhet t'i ndihmojmë ato të korrigojnë edhe të metat që kanë vetë dhe së bashku të luftojmë për të zhdukur të gjitha ato trashëgime të hidhura që na kanë lënë shekujt, pushtuesit e huaj, sundimtarët e pasanikët vendës dhe feja e të ecim krah për krah përpara në ndërtimin e socializmit, siç na mëson Partia.

Pas Luftës së madhe Nacionalçlirimtare që bëri populli, Shqipëria, me forcat e veta dhe nën udhëheqjen e Partisë, e ka ndryshuar faqen. Kur themi me forcat tona, kjo për ne është shumë e qartë, se kurdoherë kryesisht në to jemi mbështetur. Po të mos luftonim vetë, po të mos punonim e të mos derdhnim gjak e djersë vetë, as atdheu nuk do të çlirohej, as liria nuk do të fitohej, as Shqipëria nuk do të rindërtohej dhe as mirëqenia e popullit nuk do të sigurohej.

Është fakt se për rimëkëmbjen e vendit pas luftës dhe për ndërtimin e socializmit i madh e i vogël te ne i vunë gjoksin punës në të gjithë sektorët, në industri e në bujqësi, në fusha e në malësi. Çdo fitore që kemi korrur gjatë luftës dhe pas Çlirimtit u arrit me luftën, me gjakun, me sakrificat, me punën dhe me djersën e ballit të mbarë popullit shqiptar. Këtë të vërtetë të madhe populli ynë e ka pasur dhe e ka kurdoherë parasysh. Ai do ta ketë parasysh këtë mësim të madh të Partisë edhe në të ardhmen.

Por të punosh, të ndërtosh, të jesh gati të luftosh për mbrojtjen e atdheut, për popullin dhe për socializmin, nuk do të thotë të mos pranosh ndihmën bujare internacionaliste ekonomike e politike dhe pa interes të miqve të vërtetë, ashtu siç nuk duhet të pranosh kurrë «ndihmën» e armiqve imperialistë dhe revisionistë, përkundrazi, është më mirë të shtrëngosh rripin, të mbetesh edhe pa ngrënë fare, po të jetë nevoja, por armikut të mos ia zgjatësh kurrë dorën.

Në vitet e para pas Çlirimt Shqipërinë e ndihmoi Bashkimi Sovjetik, në udhëheqje të të cilit qe Josif Visarionoviç Stalini. Ndihma e tij atëherë ishte e vogël, sepse atdheu i Leninit ishte djegur e ishte zhuritur për vete gjatë Luftës së Madhe Patriotike. Unë kam pasur fatin të takohesha e të bisedoja disa herë me Stalinin, t'i flisja atij për gjendjen dhe për nevojat e popullit tonë, për të cilin ai ka pasur një dashuri dhe respekt të madh. Sa herë shkova në Bashkimin Sovjetik, Stalini më premtoi se do të na ndihmonte me të gjitha forcat dhe me të vërtetë ai na ndihmoi bujarisht jo vetëm në fushën ndërkontëtare, por edhe nga ana ekonomike, natyrisht, me aq sa kishte mundësi në atë kohë. Më vonë, na pati thënë ai, kur Bashkimi Sovjetik të mëkëmbej, do të na ndihmonte më shumë. Në radhë të parë Stalini na ndihmoi me armë. «Unë e di, — më tha ai njëherë, — se shqiptari pa armë nuk rron dot». Kur i thashë në ç'mënyrë do t'i paguanim borxhet për armët që na dërgonte Bashkimi Sovjetik, ai m'u përgjigj: «Ç'flet për pagesë, shoku Enver, merrini këto që ju japim dhe s'keni për t'i paguar kurrë». Kjo ishte një ndihmë që na jepej nga

një marksist i madh e internacionalist i vërtetë. Edhe kur i fola Stalinit me zemër të hapët për nevojat e mëdha që kishim ne për njerëz të ditur në shkencë, në teknikë e në fusha të tjera të dijes, ai na premtoi se do të na dërgonte, por, me të mbaruar punë, ata duhej të ktheheshin menjëherë në Bashkimin Sovjetik. Një herë tjetër, kur i parashtrova pikëpamjen e Partisë dhe të Qeverisë sonë se nuk na dukej e drejtë që specialistët sovjetikë që na kishte dërguar, të shpërbleheshin njëloj sa tanët, për arsy se, duke qenë larg vendit dhe familjeve, ata kishin nevoja më të mëdha, Stalini na tha që specialistët sovjetikë në asnjë mënyrë të mos paguheshin më shumë, kurse Hrušovi kërkonte që një specialisti sovjetik t'i paguanim rrogë disa herë më të madhe se rroga e një udhëheqësi të Partisë e të shtetit, që në atë kohë ishte më e lartë se tani.

Veç kësaj, duke biseduar për nevojat e mëdha që kishim ne në atë kohë për kuadro, Stalini na këshilloi që, po të donim, të bënim siç kishin bërë ata vetë pas Revolucionit të Tetorit, domethënë të hapnim edhe ne universitetin në vendin tonë. Kur unë e vura në dijeni se e kishim vështirë këtë punë, mbasi na mungonin kuadrot, ai na çeli rrugë, na tha se ne me ata njerëz të mësuar që kishim, bashkë me disa të tjera që do të na dërgoheshin nga Bashkimi Sovjetik, mund të hapnim universitetin, ku të përgatitnim kuadrot e rinj të Shqipërisë. Ne e ndoqëm këtë këshillë të Stalinit dhe tani kemi universitetin tonë, ku po përgatitim me qindra kuadro çdo vit.

Pas vdekjes së Stalinit, ndihma e mëvonshme që

na dha Bashkimi Sovjetik, kur atje pushtetin e morën hrushovianët, kishte dy qëllime: të na tërhiqte në kurth, që të bëheshim bisht i këtyre tradhtarëve, dhe pastaj të na skllavëronte. Por Partia jonë i kishte sytë hapur, ajo vigjilonte ditë e natë, sepse filloi shpejt të dyshonte te tradhtari Nikita Hrushov, që paskësh qenë një mik i fshehtë i renegatit Tito, i cili, siç e dini, qysh gjatë kohës së luftës, u përpoq ta robëronte Shqipërinë, por nuk ia arriti dot qëllimit. Titoja na e mori të keqen, se ne e kuptuam herët ku e kishte syrin, prandaj u treguam vendin me kohë atij dhe agjentëve të tij në vendin tonë. Shpejt fillua të dyshonim edhe në politikën e revisionistëve sovjetikë. Sa kalonte koha, për ne bëhej gjithnjë e më e qartë ç'qëllime kishte «ndihma» e tyre. Duke vepruar si armiq, pak nga pak, atyre filloi t'u cirrej maska. Partia jonë ishte nga të parat, nga më të vendosurat dhe heroiket, që ua çori maskën Nikita Hrushovit dhe shokëve të tij. Atëherë Partia dhe populli tendosën nervat, mblohdhën të gjitha forcat dhe u dhanë këtyre renegatëve grushtin që meritonin.

I gjithë transformimi i Shqipërisë u bë në sajë të luftës dhe të punës së popullit shqiptar, të udhëhequr nga Partia. Me këtë shndërrim u zbukuruan, në radhë të parë, njerëzit, u zbukurua mendja e tyre.

Ka rëndësi shumë të madhe për të ardhmen që populli t'i kuptojë mirë politikisht dhe ideologjikisht të gjitha problemet, të gjykojë drejt nga këto pozita njerëzit e çdo shkalle dhe veprimet e tyre. Partia u hapi sytë punonjësve tanë që të njohin mirë njërit-tjetrin, të dinë cilët janë ata që drejtojnë në Parti e

në pushtet, të mbrojnë të mirët dhe të shpartallojnë të këqijtë. Ajo punon që populli t'i kuptojë problemet jo nga pozita të ngushta të interesit personal. Interesat personalë dhe familjarë, na mëson Partia, të vijnë pas atij të përgjithshëm, kurse interesi i madh i popullit të jetë në radhë të parë e mbi çdo gjë. Këtë këshillë populli ynë e ka bërë të vetën prej kohësh.

Le të marrim një shembull konkret nga jeta jonë për ta vërtetuar këtë që po them. Po ta gjykonit Luftët Nacionallirimi tare nga ana e interesit thjesht personal apo familjar, ju, o lebër trima, nuk do ta kishit filluar, por do të vepronit siç këshillonin tradhtarët si Vehib Runat e Ali Këlcyrat me shokë, që ju thoshir: «Mos u bini në qafë pushtuesve italianë, ndryshe do t'ju digjen krahinat, shtëpitë, do t'ju shfarosen bagëtitë» etj., etj. Mirëpo ju, lebërit, menduat krejt ndryshe nga këta tradhtarë dhe thatë: «Në djall të venë shtëpitë, bagëtitë e prokopia përrpara interesit të madh të atdheut, të lirisë së popullit! Të rrojë Shqipëria!». Ja ç'do të thotë ta kuptosh drejt politikisht dhe ideo-logjikisht këshillën e Partisë për të vënë interesin e atdheut, interesin e përgjithshëm mbi atë të familjes apo të një personi.

Tani populli e kuption ca më mirë akoma këtë çështje. Që të rrojnë të lumtur familjet, djemtë dhe vajzat tona, duhet të jetë e lumtur tërë Shqipëria. Që të arrihet kjo, kërkohet që mbarë populli shqiptar të bashkohet si një trup, të ndjekë dhe të zbatojë drejt vijën e Partisë, pse vetëm kështu do të lulëzojë Shqipëria, do të forcohet ekonomia e do të lulëzojë familija e secilit, kështu do të jemi të gjithë të lumtur.

Dhe lumturia e kënaqësia e të gjithëve, e jo vetëm e disave, është më e mira. Prandaj Partia na porosit vahdimisht të mos harrojmë asnjëherë që çështjet t'i kuptojmë në radhë të parë politikisht dhe ideologjikisht.

Le të shohim edhe një problem tjeter shoqëror të kohëve tonë. Kur një baba merr vesh se vajza dashuron një djalë, të cilin ai mbasë nuk e njeh fare, fillon të bluajë shumë gjëra në kokë, të lëkundet në mendime, herë-herë i duket se ka gabuar vajza, se ajo «e turpëroi», herë-herë i thotë vetes: «Epo mirë, pse të mos fejohet me atë që do?». Njollat e së kaluarës në ndërgjegjen e tij e shtyjnë në ndonjë rast të mos mendojë drejt, pra të mos jetë dakord që vajza të fejohet me dashuri, mbasi një gjë të tillë e ndalon zakoni. Por mësimet e Partisë, nga ana tjeter, e bien në rrugë dhe ai i bën pyetje vetes: «Përse të mos i lejojmë të rinjtë të martohen me dashuri? E pse u dashka dënuar dashuria, ç'është ajo?». Dhe, duke e rrahur çështjen mbarë e prapë në mendje, fillon të arsyetojë drejt e të thotë: «Po unë, vallë, nuk e kam dashur gruan time kur isha i ri? Nuk kam shkuar mirë tërë jetën dhe nuk kam bërë kalamanë me të? Ja, pra, kjo është dashuria. Atëherë, përse ta gjykoj për keq vajzën dhe t'ia prish të ardhmen?». Kur njëriu i shoshit mirë të tëra çështjet, atëherë del në rrugën që na mëson Partia, i kuption drejt ideologjikisht dhe politikisht problemet e jo vetëm gjëzohet dhe e uron vajzën të trashëgohet, por i kërkon asaj t'ia sjeillë trimin në shtëpi që ta shohë e ta njohë. Dhe kur dhëndri i vjen, prindi gjëzohet, e shikon nga koka te këmbët, e këshillon të jetë kurdoherë i ndershëm, të

dojë Partinë, popullin, të dojë edhe vajzën me të cilën do të shkojë jetën dhe pastaj u uron të dyve lumturi dhe punë të mbarë. Kështu prindi gëzohet edhe vetë po aq sa të rinxjtë që realizuan ëndrrat e tyre dhe që së bashku do të punojnë më mirë për forcimin e kooperativës, pra, për të mirën e përgjithshme e, si pasojë, edhe për begatinë e familjes së tyre. Të veprosh kështu, do të thotë t'i kuptosh çështjet drejt.

Njerëzit tanë e kanë kuptuar mirë ideologjikisht e politikisht çështjen e madhe të zhvillimit të ekonomisë, që është një nga drejtimet kryesore të punës së Partisë për lumturinë e popullit dhe për sigurinë e atdheut. Çdo fjalë dhe masë e Partisë në këtë fushë ju ka ngrohur kurdoherë zemrën. Partia pas Çlirimt veproi me zgjuarsi në çdo drejtim, nuk eci kuturu, prandaj nuk u qorollis kurrë.

Në fillim ajo mori masa që toka t'u jepej atyre që e punonin. Po t'ju thoshte qysh në atë kohë të bashkonit në kooperativa bagëtitë, tokat dhe mjetet e punës, ju nuk do ta kuptonit. Prandaj Partia u tregua e matur. Reforma Agrare u kuptua shumë drejt nga populli. Asnjë fshatar s'u ankua se nuk i mjaftonte sipërfaqja që i dha Reforma, pse lufta dhe vuajtjet e së kaluarës e kishin sqaruar atë. Fshatari ynë mendoi drejt se me sasinë e tokës që i dha pushteti popullor, me ato kafshë e mjete pune kishte mundësi të punonte dhe të jetonte. Puna e madhe sqaruese që bënte vazhdimisht Partia në këtë drejtim, e bindi fshatarin të pranonte me zell të madh Reformën. Por Partia nuk u mjaftua vetëm me zbatimin e Reformës, ajo nuk i la fshatarët dhe malësorët në gjendjen e

mjeruar që u gjend vendi ynë në vitet e para pas Çlirimt. Duke e udhëhequr popullin në rrugën e punës dhe të lumturisë, Partia, që ka për qëllim sigurimin e mirëqenies së popullit, mori masa për t'i ardhur në ndihmë fshatarësissë sonë patriote me kredi, me traktorë e me mjete të tjera, duke e ndihmuar për të tharë këneta e moçale, për të përmirësuar racën e bagëtive, për të hapur kullota të reja dhe për të përmirësuar kullotat ekzistuese etj.

Që të realizoheshin detyrat madhështore në fushën e bujqësisë, më parë u ndërmorën një sërë aksionesh të mëdha, të cilat u kryen hap pas hapi, dhe vetëm kur ato u realizuan, Partia u bëri thirrje fshatarëve të bashkoheshin në kooperativa. Në fillim disa nuk pranonin, kishte të tjerë që lëkundeshin, ndonjë fshatar thoshte: «Shohim e bëjmë». Prandaj Partia dërgonte anëtarët e saj në fshat për t'i sqaruar me durim njerëzit dhe për t'u treguar se ç'të mira do të kishin nga kooperativa, pra, për t'u bërë të njoitura të mirat e kolektivizimit. Kur shokët e luftës, djemtë dhe vajzat tuaja, vinin t'ju bënin propagandë përkëtë çështje, nganjëherë disa prej jush thoshin me mendje: «E ç'flitni kot, more shokë, ne jemi më mirë kështu». Por Partia i mendonte e i gjykonte me urtësi edhe këto gjëra që bluanin disa në mendjen e tyre atëherë dhe porosiste të tregohej durim i madh, se e kishte të qartë që fshatari për këtë tokë kishte derdhur lumenj gjaku gjatë shekujve dhe e kishte vështirë ta kuptonte e të bindej shpejt për nevojën e bashkimit të saj me atë të njërit dhe të tjetrit. Prandaj ajo këshillonte që, para se të bëhej bashkimi i tokave

në kooperativa, kjo çështje t'u shpjegohej mirë fshatarëve, se vetëm atëherë ata do ta përqafonin me bindje të plotë kolektivizimin. Dhe kështu u veprua, prandaj sot e gjithë fshatarësia ka hyrë përfundimisht dhe plotësisht e bindur në rrugën e kolektivizimit. Tani ne nuk kemi kooperativa bujqësore vetëm në zonat fushore, por edhe në ato malore. Ky është një sukses i madh historik, që përbën një forcë të pallogaritshme për të shkuar akoma më përpara në rrugën e zhvillimit e të përparimit të pandërprerë të socializmit edhe në fshatin tonë.

Sic e dini, Partia i ka vënë një rëndësi shumë të madhe zhvillimit të bujqësisë si në fushë, ashtu edhe në mal, e, sidomos, zhvillimit të drithërave të bukës dhe të bimëve industriale, të blegtorisë, të pemëtarisë, mekanizimit të punimeve bujqësore etj.

Kongresi i 5-të i Partisë dha orientimin që zonave malore t'ua ndërrojmë faqen, t'i bëjmë po aq pjetlore sa edhe fushat. Për këtë qëllim Partia dhe Qeveritja kanë marrë mjaft vendime të rëndësishme, së shpejti do të marrin edhe të tjera që do të kënaqin në mënyrë të veçantë fshatarësinë kooperativiste të malësisë së Shqipërisë së Jugut, të Mesme dhe të Veriut. Kjo ndihmë do të konsistojë në zhvillimin e atyre sektorëve të bujqësisë e të blegtorisë, që janë më të përshtatshëm e më shpejt fitimprurës. Deri tashëti ne kërkonim nga fshatarësia të prodhonte më shumë, sidomos grurë, misër e bimë industriale, si: lule dielli, pambuk, duhan etj., kështu që jonxha e foragjeret që nevojiteshin për zhvillimin e blegtorisë ishin lënë pothuajse pas dore. Kjo na diktohej nga nevoja,

por tash që jemi duke kaluar në një fazë më të përparuar të zhvillimit bujqësor, ka mundësi t'i specializojmë rrethet, krahinat dhe kooperativat e veçanta në disa drejtime kryesore, disa për drithëra, disa të tjera për bimë industriale, një pjesë për blegtori apo për pemëtari etj., dhe, në varësi me këtë të përqendrojmë edhe ndihmat që do t'u japim kooperativave në këto drejtime.

Në ato rrethe apo kooperativa bujqësore ku specializimi do të bëhet në blegtori, ne do të synojmë që bagëtitë që do të rritim, të jenë sa më pjellore, me qëllim që popullit t'i jepen më shumë qumësht, djathë, gjalpë, lesh, lëkurë e çdo gjë tjetër dhe me cilësi të lartë. Do të përpinqemi, gjithashtu, që të gjitha këto prodhime t'i përpunojmë në vend.

Pushteti popullor ka investuar gjer tanë për bujqësinë me miliarda lekë, që përbëjnë frytin e punës dhe të djersës së të gjithë popullit. Partia dhe Qeveria janë përpjekur t'i administrojnë me kujdes të madh këto fonde dhe në ato drejtime që krijojnë mundësi për t'i bërë tokat sa më shumë e sa më shpejt pjellore. Tani që janë krijuar kushte të përshtatshme pas gjithë kësaj pune të madhe që është bërë, ka ardhur koha që kooperativave të zonave fushore, sidomos, t'u vëmë detyra më të mëdha, me qëllim që në to të merren jo si gjer tanë nga 6-12 kuintalë drithë për hektar, por nga 40, 50, bile deri në 80 kuintalë¹.

¹ Në vitin 1983, në zonat fushore të dy kooperativave bujqësore «Cepo» e «Partizani» të krahinës së Kardhiqit, u morën rreth 35 kuintalë grurë dhe 65-70 kuintalë misër për hektar.

Mos u çuditni, motra dhe vëllezër, shkenca agro-teknike ka arritur të realizojë rendimente të larta me anë farérash të zgjedhura dhe shërbimesh agroteknike me një kulturë të lartë. Vetë ju, nga 8,9 apo 10 ku-intalë grurë për hektar që merrnit përpara, tani keni arritur të merrni deri në 25 e 30 kuinalë, dhe nuk habiteni, po thoni se këto rendimente po i merrni se keni zbatuar vazhdimisht mësimet dhe porositë që u jep Partia. Në të kaluarën golemasit, atje lart, në zonën malore të Kurveleshit, korrnin vetëm koçanë të vegjël misri, kurse tani kanë arritur të marrin 40 kuinalë misër për hektar¹, pse punojnë më mirë, u shërbijnë si duhet bimëve, u hedhin më shumë pleh dhe sigurojnë farëra të zgjedhura. Në të ardhmen ne do t'i vëmë një rëndësi edhe më të madhe shtimit të farërave të zgjedhura jo vetëm nga ato që kemi në vendin tonë, por do të blejmë farëra të tjera mjaft të mira që kanë dalë tani në botë dhe do t'i përdorim për të marrë rendimente shumë më të larta nga ato që marrim tani.

Duke mbjellë në fusha lloje të tillë farérash, do të arrijmë të krijojmë rezerva drithi dhe atëherë, në fshatra të zonave malore, do të rriten rendimentet në prodhimet blegtore, do të arrihet të merren nga 50, 60 e më shumë kilogramë qumësht për çdo dele².

1 Në vitin 1983, në Golemin malor u arrit të merren 30 kuinalë grurë për hektar.

2 Në vitin 1983, rendimenti i qumështit në delet e të dyja ekonomive të krahinës së Kardhiqit arrii mbi 50 kilogramë për dele. Në një tufë delesh në Mashkullorë u morën 120 kilogramë qumësht për dele, kurse në Plesat 250 kilogramë qumësht për dhi.

Qeveria ka filluar të sjellë mëshqerra të racës, të cilat, kur të rriten e të bëhen lopë, do të na japin me mijëra litra qumësht në vit. Këto bagëti po i blejmë me valutë, me djersën e popullit, por për të mirën e tij. Tani këto mëshqerra race po i çojmë në ndërmarrjet bujqësore, ndërsa pas tre-katër vjetësh, kur ato të jenë bërë lopë, do t'i shpërndajmë edhe nëpër kooperativat bujqësore. Kjo kërkon që të përgatitemi për t'i mbajtur e për t'i ushqyer mirë ato, në radhë të parë, por edhe gjithë bagëtitë e tjera që kemi, të luftojmë për të përmirësuar vazhdimisht edhe racën e vendit me lloje nga më të mirat, më të pastrat e më prodhimitaret. Ky është njëri drejtim.

Drejtimi tjetër që synojmë, është zhvillimi i gjithanshëm i pemëtarisë. Frutat janë po aq të nevojshme për ushqimin e njeriut sa edhe mishi, buka, qumështi etj. Njerëzit jashtë shtetit ato i blejnë shumë shtrenjtë. Kurse ne kemi një vend të mrekullueshëm dhe një klimë të bukur, ku mund të rritet shumë mi-rë çdo lloj frute. Por, për fat të keq dhe kryesisht për fajin e atyre që para Çlirimt e kanë shtypur dhe e kanë shfrytëzuar vendin, ky sektor i rëndësishëm ka mbetur prapa. Prej disa kohësh kanë filluar të krijohen plantacione të mëdha me mollë, dardhë, qershi, fiq, kumbulla, rrush etj., por këto janë akoma pak në krahasim me synimet e Partisë. Tani ne pomarrim masa që gjatë pesë vjetëve të ardhshëm t'i futemi frontalisht edhe këtij sektori, të mbjellim e të rritim pemë frutore, sidomos nëpër male e kodra, me qëllim që t'i kthejmë ato në kopshte të lulëzuara për prodhimin e frutave. Kjo na vë detyrën që të hapim.

toka, të bëjmë përpjekje për të siguruar ujë të mjaf-tueshëm për to, të përgatitim qysh tani fidanishte të mëdha në sipërfaqe prej dhjetëra hektarësh në çdo rreth, ku të mbillen fidanë pemësh frutore. Shteti për këtë qëllim do të vëré fonde në dispozicion të bujqësisë, do të dërgojë jashtë shtetit edhe specialistë pér të blerë farëra e fidanë frutash të zgjedhura pér t'i shartuar me fidanët e pemëve më të mira frutore që kemi. Punën pér krijimin e fidanishteve të reja në çdo rreth do ta fillojmë që sivjet, me qëllim që brenda tre-katër vjetësh të jetë rritur një numër i madh fidanësh, të cilët t'u shpërndahen kooperativave bujqësore, në radhë të parë atyre të zonave kodrinore e malore.

Gjatë tre-katër vjetëve të ardhshëm do të punojmë me një sistem e plan pune të studiuar me kujdes pér zgjidhjen e disa prej problemeve më të mëdha në bujqësi e në blegtori. Kjo përgatitje, shokë, kërkon një studim të thellë shkencor. Duhet të mendohet që tash nga çdo ndërmarrje e kooperativë bujqësore se në cilat sipërfaqe do të mbillet gruri ose misri, ku do të mbillen bimët industriale, drurët frutorë apo vreshstat, cilat toka do të përdoren pér mbjelljen e bimëve foragjere pér ushqimin e bagëtive etj. Për çdo lloj bime duhet të kemi të qarta detyrat pér të ardhmen, ashtu edhe pér frutat, pse vërtet nuk rröhët dot pa grurë e pa misër, pa bimë industriale e pa bagëti, por edhe frutat janë shumë të nevojshme pér njeriun.

Ecja përpara në front të gjerë pér zhvillimin e pemëtarisë është e domosdoshme. Por ne duhet të ecim në front të gjerë edhe pér sigurimin e ushqimit të

bagëtive. Kjo detyrë do të zgjidhet kur të kemi ngritur, gjithashtu, në masë rendimentet e misrit e të grurit në fusha dhe në parcelat e posaçme të malësisë, që do të mbillen me drithëra, në mënyrë që të na krijohen mundësi për të lënë një pjesë të sipërfaqeve për ushqimin e bagëtive.

Industria është sektori kryesor vendimtar i ekonomisë së vendit, pa të cilën nuk mund të zhvillohet bujqësia, por edhe vetë industria pa bujqësinë, gjithashtu, nuk ka si zhvillohet. Partia e konsideron bujqësinë degën bazë të ekonomisë, kurse industrinë degën kryesore për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit. Prandaj ajo i vuri që në fillim një rëndësi të madhe industriisë. Me këtë sektor ne nisëm gati nga hiçi dhe arritëm këtu ku jemi aktualisht.

Ato që kemi ndërtuar gjatë këtyre 25 vjetëve, nuk po i numëroj me radhë, se janë shumë, po dëshiroj të them se nga minierat, ku fshihen pasuri të mëdha, bijtë dhe bijat tuaja, që deri dje venin me dhi e me lopë, po nxjerrin minerale të vlefshme që u sigurojnë të ardhura të mëdha ekonomisë sonë popullore, ndërtimit të socializmit në Shqipëri. Minierat tona po modernizohen, ato do të shtohen akoma më shumë dhe do të bëhen më moderne.

Kam studiuar ca kohë më parë harta ku kanë bërë shënime disa shkencëtarë të huaj. Sipas tyre, në malet tona duhet të ketë pasuri të tjera, bile edhe metale shumë të rralla, të cilat me siguri do t'i zbulojë syri i mprehtë i djemve dhe i vajzave që edukon Partia. Barinjtë e Labërisë në këto gërxhe plot shkëmbinj e gurë më parë shikonin vetëm nëse kishte apo jo

kullota për bagëtitë; atyre as që u shkonte ndonjëherë ndër mend se do të vinte një kohë që bijtë dhe nipërit e tyre do t'i shponin në thellësi këto male të ashpra për të nxjerrë prej tyre minerale të vlefshme, të cilat do të përpunohen në fabrikat që do të ndërtojmë.

Miniera, fabrika e vepra të tjera të reja janë duke u ndërtuar kudo në vendin tonë, të tjera më të mëdha e më të bukura do të ndërtohen në të ardhmen. Gjatë pesë vjetëve të ardhshëm ne do të ngremë fabrika e uzina moderne, do ta dyfishojmë prodhimin e plehrave kimike, që t'i përdorim jo vetëm për grurin, por edhe për misrin, bile pas një kohe edhe për pemët.

Në të ardhmen nxjerra dhe përpunimi i naftës, gjaku i industrisë sonë moderne, do të marrin zhvillim më të madh. Atë deri tashti e kemi përpunuar pjesërisht në vend në disa rafineri të vogla, por në pesëvjeçarin e ardhshëm do të ndërtojmë një rafineri të madhe dhe atëherë vendet e tjera nuk do të marrin më naftë bruto nga ne, siç bëhet tash, ngaqë s'kemi mundësi ta përpunojmë në vend.

Veprat e reja madhështore që do të ndërtojmë në të ardhmen, do të duan hekur, nikel, krom etj. Hekurin e quajnë kudo buka e industrisë, atë e importojmë me vështirësi të mëdha dhe jo në sasitë që na nevojiten, prandaj jemi ngushtë për shumë artikuj metalikë, që kërkohen nga të katër anët nga fshatarësia, si: pompa të fuqishme për të ujitur tokat, tuba, vegla bujqësore etj. Pikërisht për sigurimin e kësaj «buke» ne po ndërtojmë një kombinat në Elbasan, i cili në të ardhmen do të bëhet një bazë shumë e fuqishme e industrisë sonë të rëndë.

Edhe kromin, gjithashtu, ne e shesim bruto. Më vonë mendojmë ta pasurojmë në vend këtë mineral, pastaj ta eksportojmë. I përpunuar ky kërkon shumë në tregjet e jashtme. Shqipëria jonë është një nga shtetet më të pasura të botës në krom, me të cilin, duke e përpunuar në vend, do të sigurojmë të ardhura më të mëdha, çka do të ndihmojë përfuqizimin gjithnjë e më mirë të ekonomisë sonë popullore dhe përrritjen e mirëqenies së popullit.

Partia do të punojë që industria të prodhojë më shumë e më mirë, bujqësia të mekanizohet më tej jo vetëm me traktorë, por me të gjitha llojet e mekanizmave e me gjithfarë mjetesh të tjera, që punojnë me energji elektrike. Ju e dini vendimin historik që ka marrë Komiteti Qendror i Partisë, sipas të cilit gjer në fund të vitit 1971 të gjitha fshatrat e vendit tonë do të elektrifikohen. Ky do të jetë një tjetër revolucion i madh në jetën e njerëzve tanë. Tani jemi duke ndërtuar hidrocentralin e Vaut të Dejës, kurse vitin që vjen ndërtuesit tanë të lavdishëm do të ngrenë shtëpitë në Fierzë, ku do të ndërtohet një hidrocentral i madh, një nga më të mëdhenjtë e Evropës. Megjithatë puna nuk do të mbarojë me këta, se hidrocentrale të tjera do të ndërtohen në të ardhmen mbi lumenjtë tanë të fuqishëm, gjë që do ta rritin vazhdimisht fuqinë ekonomike të vendit tonë.

Puna nxjerr punën, fabrika kërkon fabrikën dhe të gjitha këto duan forca pune. Ky zhvillim i madh kërkon e do të kërkojë vazhdimisht edhe njerëz të ditur, të mësuar. Veprat madhështore nuk mund të bëhen me njëqind apo me një mijë njerëz, prandaj

Partia këshillon që i gjithë populli, i madh e i vogël, të mësojë në shkolla dhe në punë. Prandaj, motra dhe vëllezër të Labërisë, i dërgoni bijtë dhe bijat tuaja nëpër shkolla, mos i lini kurrë pa mësim. Të gjithë ne mburremi me të drejtë se rrethi i Gjirokastrës zë vendin e parë në Shqipëri për sa i përket ndjekjes së shkollave, po i dërgoni fëmijët tuaj akoma më me shumicë edhe në shkollat e mesme e të larta. Për çështjen e shkollës, për pajisjen me dije e kulturë të njerëzve tanë Partia ka këshilluar vazhdimisht me ngulm, ca më shumë e thekson këtë problem të madh tani që po bëjmë reformën për revolucionarizimin e shkollës, e cila është një nga veprat e tjera të mëdha të Partisë sonë.

Për të gjetur rrugën më të drejtë se si duhet të jetë shkolla jonë e ardhshme, sa vjet duhet të zgjatin mësimet dhe q'duhet mësuar në të, Partia iu drejtua si kurdoherë popullit, i kërkoi atij mendim për ta revolucionarizuar më tej shkollën. Mos vallë vajzat dhe djemtë tanë duhet vetëm të mësojnë në shkolla dhe të harrojnë par mendën, kazmën, lopatën, fabrikën, të harrojnë se buka fitohet me djersë? Populli na këshilloi që nxënësit dhe studentët, krahas mësimit, duhet të mësojnë edhe si të punojnë, si të djersijnë, si të lodhen, pse vetëm atëherë dituritë do t'i përvetësojnë më mirë. Kjo ishte këshilla e parë e popullit.

Djemtë dhe vajzat, që jetojnë në këtë tokë e midis këtij populli, që ka vuajtur aq shumë nga armiqjtë shekullorë, duhet të mësojnë njëkohësisht si të përordin të gjitha llojet e armëve, të mësojnë që të jenë jo vetëm të ditur, por edhe ushtarë të mirë për mbroj-

tjen e atdheut nga çdo rrezik. Kjo ishte këshilla e dytë e popullit.

Populli i tha, gjithashtu, Partisë që djemve, çu-pave e gjithë punonjësve me radhë t'u mësohet më parë se çdo gjë teoria marksiste-leniniste, që e nxori atdheun tonë në dritë dhe e udhëhoqi të realizojë këto vepra madhështore. Kjo ishte e treta këhillë që populli i dha Partisë, pse e di që, po ta mësojmë të gjithë me rrënëjë marksizëm-leninizmin, ne do të bë-hemi zgalema dhe atëherë s'do të ketë forcë në botë që të na thyejë.

Kjo është vija e qartë e perspektivës që na hap Partia për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik e kultu-ror të vendit, që do të zbatohet me forcën e popullit tonë heroik. Pas disa vjetësh populli do të shohë fry-tet e kësaj pune të madhe që po bëhet në të katër anët e Shqipërisë dhe atëherë ai do ta urojë si gjith-një me gjithë shpirt Partinë për udhëheqjen e saj kaq të drejtë e largpamëse. Për këtë perspektivë të madhe Partia po harton plane të reja. Si kurdoherë ajo çdo gjë e peshon mirë më parë, sepse me interesat e she-njtë të popullit askujt nuk i lejohet të luajë. Këta interesa janë mbi të gjitha, prandaj kushdo duhet t'i ketë mirë parasysh. Kur diçka është në interesin e përgjithshëm, ajo duhet mbrojtur edhe me gjak, po e lypi nevoja. Për këtë qëllim është e domosdoshme të përvetësojmë mësimet e Partisë, të jemi kurdoherë vi-gjilentë, barutin ta mbajmë të thatë, pushkën në një dorë dhe kazmën në tjetrën, se vetëm kështu do të ecim të sigurt përpara dhe do t'i sjellim popullit ditë akoma më të ndritura.

Partia i flet hapur popullit. Edhe kur diskutohet për të pranuar një njeri në Parti, është mirë të kërkoitet mendimi i popullit, t'i thuhet kolektivit si e njeh atë njeri, a është i mirë, i ndershëm e i vlefshëm për Partinë, njeri i vendosur për çdo sakrificë dhe punëtor i palodhur apo jo. Nëse këto vërtetohen nga kolektivi, atëherë ai person ia vlen të futet në radhët e Partisë, se populli e do shumë një njeri të cilit ia njeh vetë të mirat që ka. Kështu duhet të veprohet për çdo gjë, prandaj të jemi kurdoherë të lidhur ngushtë si mishi me thoin me popullin. Ndonjëri që gabon, nuk mund të quhet i lig në qoftë se ia hap zemrën popullit, i tregon gabimin dhe kërkon gjykimin e tij. Kur ai që gabon jep fjalën se do të ndreqet, populli e këshillon të japë prova, të mos gabojë përsëri dhe e ndihmon të korrigohet e të ecë përpara si të gjithë. Në këtë rrugë na mëson Partia të ecim edhe në të ardhmen.

Neve na duhet të ndërtojmë socializmin në rrethana të tilla kur imperialistët e egër, gjakpirës e luftënxitës amerikanë, së bashku me socialimperialistët sovjetikë, që kanë në dispozicion një fuqi ekonomike të madhe dhe armatime të shumta, që janë në aleancë të ngushtë me njëri-tjetrin, përpiken të luftojnë e të zhdukin ndërtimin e shoqërisë socialiste, të shuajnë luftërat çlirimtare të popujve që janë ngritur në këmbë kundër shtypjes dhe shfrytëzimit kapitalist.

Në këto situata të ndërlikuara ndërkombëtare e ndërtojmë ne socializmin, prandaj përgatitemi njëkohësisht për mbrojtje, që, po të guxojë kush të na prekë, të jemi të gatshëm në çdo moment t'u shkak-

tojmë armiqve vdekjen. Ne do të fitojmë me siguri mbi imperialistët dhe revizionistët, sepse forcat e popujve në arenën ndërkontaktare dhe forca e Republikës Popullore të Shqipërisë, e udhëhequr nga Partia e Punës, forcat e mbarë proletariatit ndërkontaktar prriten e bashkohen dita-ditës dhe bëhen të pamposhtura. Armiqtë e betuar të popujve, imperialistët amerikanë, revizionistët sovjetikë dhe gjithë reaksionarët e botës, janë një grusht njerëzish që shfrytëzojnë pa mëshirë klasën punëtore dhe masat e tjera punonjëse, prandaj nuk mund t'i kenë kurrë popujt me vete. Në një mënyrë apo në një tjetër ata mund t'i çojnë popujt në luftë, por me siguri do të pësojnë disfatë, siç pësuan gjatë Luftës së Dytë Botërore krerët e fashizmit italian dhe të nazizmit gjerman, të cilëve popujt e botës e, së bashku me ta, populli shqiptar, u bënë varrin. Kështu do ta pësojë në të ardhmen kushdo që do të përpinqet të na sulmojë, se me ne janë mbarë popujt e botës, se ne përbëjmë shumicën. Pastaj kemi edhe ne armë, siç kanë armiqtë tanë.

Në vendin tonë ekziston një situatë revolucionare, njerëzit janë në unitet të çeliktë rrëth Partisë dhe shkojnë çdo ditë përpara në revolucion, armatosen përt'u mbrojtur, njëkohësisht punojnë e prodhojnë përtë rritur mirëqenien e vet. Populli ynë s'do t'ia dijë se është i rrëthuar nga armiq. Shqipërisë tèrr s'ia bën sýri prej tyre, populli ynë i ka njojur të gjithë ç'janë dhe i ka paralajmëruar që, po të guxojnë të kalojnë piramat, do ta pësojnë njëqind herë më keq se në të kaluarën, kur na kanë rënë në qafë.

Në vendet e ish-demokracisë popullore të Evro-

pës sundojnë klika revizioniste, që, duan s'duan, janë futur nën zgjedhën e sovjetikëve. Të gjithë këta kanë vendosur diktaturën fashiste dhe, sa herë që populli revoltohet kundër tyre, përdorin shkopinjtë, bombat me gaz lotsjellës, bile edhe plumbin. Në Çekosllovaki revizionistët sovjetikë shkuan deri në pushtimin e këtij vendi me ushtrinë e tyre fashiste dhe të satelitëve të tyre.

Imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë përpara rrezikut të komunizmit, për të cilin aspirojnë gjithë popujt e botës, kanë hyrë në aleancë të ngushtë midis tyre dhe përpinqen që popujt në Evropë dhe në botë t'i mbajnë nën thundër. Do t'ia arrijnë vallë këtij qëllimi? Kur të shohin se e kanë humbur davanë në luftë, ata mund të futen në aventura, por kurrë nuk do t'ia arrijnë qëllimit, pse ne nuk flemë. Sidoqoftë, po të guxojnë ta sulmojnë Shqipërinë, këtu ata do të gjejnë vdekjen e sigurt; në malet, në fushat, në kodrat dhe në bregdetin tonë ne s'do të lëmë këmbë armiku të gjallë. Pastaj në luftë s'jemi vetëm, kemi me vete gjithë marksistë-leninistët, revolucionarët dhe popujt përparimtarë kudo në botë. Vendosmërinë dhe internacionalizmin e shqiptarëve, të Partisë sonë armiqtë i njohin mirë, prandaj le të vazhdojnë të grijnë kundër nesh, le të na shajnë «nacionalistë», sikur ne s'qenkemi marksistë etj. dhe se marksistë «të kulluar» qenkan ata; kjo s'prish punë, bota na njeh cilët jemi ne dhe cilët janë ata. Shpifjet e tyre nuk do t'i besojnë popujt.

Partia jonë e ka edukuar dhe e brumos çdo ditë popullin me tiparet e larta të internacionalizmit pro-

letar jo vetëm në marrëdhëniet me popujt e tjerë të botës, por edhe në platformën e brendshme. Tipare internacionaliste të popullit dhe të Partisë sonë spikatën në solidaritetin vëllazërор тë popullsisë së Shqipërisë së Jugut, që u dhuroi me mijëra bagëti vëllezërve të Veriut. Me dashurinë e me bujarinë tuaj të madhe, me atë gjest vëllazërimi, ju e forcuat Shqipërinë më shumë, ndihmuat të lidhet si me beton, që s'do të ketë mortje, i gjithë vendi. Shumë nga ju kanë shkuar në Veri, qindra malësorë kooperativistë nga Veriu kanë ardhur e po vijnë vazhdimisht në kooperativat dhe në shtëpitë e fshatarëve të Shqipërisë së Jugut. Vëllezërit tanë nga krahinat e Veriut kanë mbetur shumë të kënaqur nga pritja e përzemërt dhe nga dashuria e madhe që keni treguar ju ndaj tyre. Një fshatare nga Veriu më tregonte një ditë e entuziazmuar për atë punë të madhe që ka bërë Partia për forcimin e vëllazërimit midis njerëzve të krahinave të ndryshme të atdheut. Kur malësoret dhe malësoret e Veriut shkuan në Kurvelesh, tregonte ajo, gratë e Labërisë u dhanë kyçet e sepeteve e të dollapëve, gjë që as mund të imagjinohej nga ana e tyre.

Shikoni, pra, c'forcë të madhe krijuan vija e drejtë e Partisë, qëndrimet tuaja përparimtare, solidariteti vëllazërор internasionalist brendapërbrenda vendit.

Të njëjtën ndihmë internasionaliste Partia jonë, me aq sa mundet, u jep vëllezërve tanë të klasës jash-të vendit. Ashtu si na vinte mirë neve kur, në vitet e vuajtjes e të mjerimit nën zgjedhën e imperialistëve, Lenini i madh hidhte poshtë Traktatin e fshehtë të Londrës që ishte për copëtimin e atdheut tonë; kur,

gjatë Luftës së Dytë Botërore, përfaqësuesi i Bashkimit Sovjetik, me porosi të Stalinit, deklaronte se Shqipëria duhet të jetë e lirë; kur Ushtria e Kuqe, duke goditur armikun e përbashkët, i vinte në ndihmë Shqipërisë; ashtu u vijmë edhe ne në ndihmë shokëve tanë komunistë e patriotë revolucionarë në të katër anët e botës. Ata krenohen kur dëgjojnë që ne u themi se jemi solidarë me ta, që Shqipërinë ta konsiderojnë si atdheun e tyre dhe ne, me aq sa kemi mundësi, vazhdimisht do t'i ndihmojmë. Të gjithë ata i duan Partinë e Punës të Shqipërisë dhe popullin shqiptar, kryesisht për frymëzimin që u japim me vijën tonë të drejtë, për ndihmën që i japim çështjes së revolucionit në të gjithë botën. Atdheu ynë, Shqipëria, do të vazhdojë të luftojë në rrugën e revolucionit, në aleancë të pathyeshme me marksistë-leninistët e revolucionarët kudo në botë.

Revisionistët sovjetikë kanë deklaruar se së afërmë do të bëjnë një mbledhje në Moskë, ku do të marrin pjesë më shumë se 60 parti «komuniste», por në të vërtetë në këtë mbledhje tradhtarësh do të shkojnë përfaqësuesit e klikave që janë larguar prej kohësh nga marksizëm-leninizmi. Qëllimi i kësaj mbledhjeje është të dënojë Partinë tonë e ndonjë parti tjetër. Mirëpo brenda radhëve të revisionistëve ka mos-marrëveshje e përçarje të mëdha për këtë çështje. Një pjesë thonë se komunistët shqiptarë vërtet i kemi armiq, po nuk dëshirojmë të merren vendime apo edhe të flasim kundër tyre. Duke parë se po gjejnë kundërshtime, udhëheqësit tradhtarë të Bashkimit Sovjetik, për t'i bindur revisionistët e tjerë të shkojnë

në mbledhje, u premtojnë atyre se atje do të flitet vetëm kundër imperializmit dhe do të shprehet solidariteti për luftën e popullit të Vietnamit. E vërteta është se për mbledhjen kanë nevojë të madhe krerët e Kremlinit, në radhë të parë për të gënjer popullin dhe komunistët sovjetikë, për t'u lënë atyre përshtypjen sikur të gjitha forcat e komunizmit botëror gjoja janë të bashkuara rreth tyre, gjë që s'është aspak e vërtetë. Revisionistët janë si karavidhet, ata nuk janë kundër imperializmit, përkundrazi, qëndrimet e veprimet e tyre vërtetojnë se janë në aleancë me të. Revisionistët po puthen e përqafohen me imperialistët amerikanë. Prandaj, gjithçka që llomotitin janë llafe boshe. Nuk do të kalojë shumë kohë pas kësaj mbledhjeje tradhtarësh dhe jeta do të vërtetojë se çdo gjë ecën kundër tyre.

Shokë dhe shoqe, motra dhe vëllezër,

Vija e Partisë sonë është e qartë si drita e diellit në një qiell pa re, ajo është e drejtë, se e ka bazën e vet në popull dhe në ideologjinë marksiste-leniniste. Partia jonë është e pathyeshme, se ka rreth saj të bashkuar si një trup i vetëm gjithë popullin. Shqipëria është e fuqishme, mbasi ka ngritur në këmbë një industri, një bujqësi e një blegtori të përparuar socialiste, ka zhvilluar në masë të paparë ndonjëherë arsimin dhe kulturën; ajo është e paprekshme, sepse qëndron rojë vigjilente dhe e armatosur më së miri për të përballuar çdo armik; është e fortë, se ka miq në të gjithë

botën. Me ne janë edhe popujt fqinj që na rrrethojnë, pavarësisht se në vendet e tyre sundojnë klika të degjeneruara tradhtarësh. Me ne janë popujt e mbarë botës.

Prandaj, vëllezër dhe motra, të ecim si kurdoherë përpara me besim në rrugën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë; të shtrëngojmë çdo ditë e më shumë radhët; të ushqejmë si kurdoherë një dashuri të zjarrtë për Partinë, për diktaturën e proletariatit, për njëri-tjetrin; të zhdukim çdo gjë të keqe nga skutat e ndërgjegjes sonë, nga radhët tonë; të jemi kurdoherë të çeliktë e të qëndrojmë të patundur në rrugën tonë të drejtë, ashtu si këto male kreshnike që në shekuj janë skuqur me gjak nga gjyshërit e stërgjyshërit tanë; të punojmë pa u lodhur që t'i bëjmë ato pjellore e njëkohësisht kala të pamposhtura të mbrojtjes së lirisë e të pavarësisë së atdheut, të socializmit e të komunizmit.

Këto dëshiroja t'ju thosha në emër të Komitetit Qendror të Partisë, në emër të Qeverisë, juve, motra dhe vëllezër, që jeni një nga kolonat më të çelikta të këtij pushteti e të kësaj partie, që keni vënë të gjitha forcat për zbatimin e programit të Partisë dhe luftoni ditë e natë që organizatat e Partisë në Tepele-në e në Gjirokastër të jenë zjarr e barut, në unitet të plotë me vijën e Partisë, me vijën e popullit. Partia ka besim të pafund te ju, pse këtu ka një nga mbësh-tetjet më kryesore, ashtu sikurse edhe ju keni te Partia nënën tuaj të shtrenjtë, jetën tuaj, të sotmen dhe të ardhmen e ndritur.

Të rrojë Partia!

Të rrojë populli i Labërisë!

Të rrojë populli shqiptar!

Të rrojë Ushtria jonë heroike Popullore!

Të rrojnë e të edukohen në mënyrë luftarake rinia
jonë heroike, pionierët tanë!

Të rrojë i lavdishëm përjetë kujtimi i dëshmorëve
të Labërisë dhe të gjithë Shqipërisë!

*Botohet për herë të parë, me
ndonjë shkurtim, sipas origji-
nalit që gjendet në Arkivin
Qendror të Partisë*

NE PRAG TË FARSËS REVIZIONISTE TË MOSKËS

Artikull i botuar në gazeten «Zëri i popullit»

28 maj 1969

Thuhet se më 5 qershor, më në fund, do të bëhet mbledhja e partive revizioniste. Farsa e filluar para pesë vjetëve nga Nikita Hrushovi dhe e luajtur me zell të madh nga pasardhësit e tij, po përfundon tanë një shfaqje me të vërtetë qesharake në Moskë. Nuk mbahen mend sa takime e mbledhje të ashtuquajtura-rash grupe, komisione e komitete iniciatore, konsultative, përgatitore, të redaktimit etj. janë bërë gjatë kësaj periudhe. Nuk mbahen mend sa komunikata janë lëshuar, sa deklarata janë shpallur, sa afate e data janë caktuar për këtë mbledhje renegatësh. Historia e saj është historia e shturjes dhe e degjenerimit politik e ideologjik të mbarë revizionizmit modern, e, në radhë të parë, të atij sovjetik. Ajo është historia e tradhtisë ndaj marksizëm-leninizmit dhe revolucionit, është historia e kalimit gradual, por përfundimtar, të revizionizmit në ekstremin më kundërrevolucionar, në socialimperializëm e socialfashizëm. Shumë mundime dhe shumë djersë u janë dashur krerëve të partisë

revisioniste të Bashkimit Sovjetik për të mbledhur tok përfaqësuesit e partive të përqara, të çoroditura e të shthurura revizioniste. Shumë presione, kërcënime, dredhi e shantazhe, bile edhe shumë rubla kanë shpenzuar ata për t'i detyruar partnerët e tjerë të shkojnë në mbledhjen e përgjithshme revizioniste.

Thirrja e një asambleje të gjerë revizioniste pëkrerët e Kremlinit ka qenë jo vetëm një çështje e madhe prestigji, por edhe një nga problemet më preokupuese të karrierës së tyre, e lidhur në mënyrë vendimtare me strategjinë globale dhe me politikën e tyre hegemoniste dhe ekspansioniste. Gjatë këtyre pesë vjetëve objektivat e mbledhjes kanë ndryshuar disa herë në përshtatje me situatat politike që kalonte revizionizmi hrushovian sovjetik dhe me preokupimet e problemet që qëndronin në këtë ose në atë periudhë përpëra tij. Por që nga fillimi e deri tanë synimi kryesor i udhëheqësve sovjetikë ka qenë grumbullimi rrëthvetes i gjithë forcave revizioniste, kontrolli i plotë ideologjik, politik e organizativ i frontit revizionist, hedhja e tij pa ngurrime dhe pa rezerva në luftë kundër revolucionit e socializmit, kundër partive marksiste-leniniste. Dominimi absolut mbi partitë e tjera revizioniste ka qenë dhe është për krerët renegatë të Bashkimit Sovjetik një nga bazat kryesore për të sunduar mbi popullin sovjetik dhe për të mashtruar opinionin publik ndërkombëtar. Në qoftë se ata nuk do të kishin një klientelë të huaj që, me hir ose me pahir, të brohorasë për ta, vështirë është të mendohet se do të mund të mbanin dot akoma maskën e «komunizmit», të «internacionalizmit proletar» dhe frazeolo-

gjinë marksiste, me të cilat janë të mbushura demagogjia dhe propaganda e tyre mashtruese.

Nga goditjet e fuqishme dhe nga lufta parimore e konsekuente që Partia e Punës e Shqipërisë dhe partitë e tjera marksiste-leniniste i kanë bërë revizionizmit modern, e në mënyrë të veçantë atij sovjetik, vija oportuniste e renegatëve që sundojnë në Bashkimin Sovjetik është demaskuar thellë, tradhtia e tyre ka dalë në shesh, planet e tyre kriminale janë zbuluar. Nga ana tjetër, vetë veprimtaria e revizionistëve sovjetikë kundër revolucionit dhe kundër luftës çlirimtare të popujve, bashkëpunimi gjithnjë është më i ngushtë me imperializmin dhe me reaksionin, kalimi, më në fund, në aksione të hapëta agresive e kolonialiste kundër popujve të tjerë, e kanë bërë edhe më të thellë izolimin e tyre, e kanë ulur edhe më poshtë autoritetin e prestigjin që mund t'u kishte mbetur akoma.

Në këto kushte mbledhja e të ashtuquajturit forum ndërkombëtar komunist nën egjidën e krerëve revizionistë sovjetikë përbën një përpjekje për të dalë nga ky batak. Atyre u duhet një certifikatë mirësjelljeje nga ky «forum», për t'u hequr përpjekje popullit sovjetik se ata jo vetëm nuk janë të izoluar, por politika e tyre e brendshme dhe e jashtme është një politikë «marksiste-leniniste», që ka edhe aprovimin e «lëvizjes komuniste ndërkombëtare» dhe se Moska mbetet gjithmonë «qendra» e saj. Prandaj të pakënaqurit, ata që i kritikojnë, e sidomos ata që janë revoluuar kundër politikës së tyre, duhet të heshtin, të nënshtronhen.

Në planin e politikës së jashtme shfrytëzimi i

mbledhjes së përgjithshme revizioniste nga ana e kre-rëve sovjetikë shkon akoma më larg. Faktin që ajo mblidhet në kryeqytetin dhe nën kryesinë e tyre, ata do të donin ta propagandonin si një aprovim nga «komunizmi ndërkontrollor» të vijës së tyre.

Por synimet, dëshirat, shpresat janë një gjë dhe realiteti është diçka tjetër. Mbledhja revizioniste e Moskës mblidhet në një situatë jashtëzakonisht të vështirë për mbarë frontin revizionist. Sot jo vetëm nuk ekzistojnë një unitet e bashkëpunim ndërkontrollor i partive revizioniste, por ato janë të përcara e të shthurrura si jashtë edhe brenda. Duke ndjekur shembullin dhe traditat e partive borgjeze, ato janë të brejtura nga oportunizmi e liberalizmi, nga fraksionet, nga luttérat karrieriste për pushtet etj. dhe në pjesën më të madhe janë shndërruar në parti borgjeze nacionaliste, që mendojnë vetëm për t'u shërbyer interesave të ngushtë të borgjezisë kombëtare. Politika e ndërhyrjeve dhe e presioneve që kanë ndjekur ndaj tyre udhëheqësit sovjetikë, i ka nxitur edhe më tepër të ecin në këtë rrugë. Peripecitë e shumta për përgatitjen e mbledhjes e tregojnë ndoshta më mirë se çdo gjë tjetër rënien e madhe dhe gjendjen e rëndë që ekzistojnë në marrëdhëni midis partive revizioniste. Fushatat e njëpasnjëshme të ndërmarra nga udhëheqësit e Bashkimit Sovjetik për organizimin e konferencës revizioniste jo vetëm që nuk çuan në një afrim pikëpamjesh ose koordinim të aksioneve e të veprimeve të përbashkëta, por i bënë më të thella divergjencat dhe më të ashpra kontradiktat. Tanimë qëndrimet opozitare të partnerëve të ndryshëm janë

kristalizuar e janë ngurtësuar krejtësisht. Përpjekjet për të shpëtuar nga tutela dhe nga hegjemonia sovjetike përbëjnë një nga tiparet kryesore që karakterizon luftën e brendshme të frontit revizionist.

Agresioni i revizionistëve sovjetikë kundër Çekoslovakisë jo vetëm i bëri shumë më të ndera marrëdhëni me partitë revizioniste, por u dha atyre edhe justifikimin formal për të kundërshtuar hegjemoninë sovjetike dhe për të mbajtur gjallë synimet e tyre centrifugale, që në mjaft raste shkojnë shumë larg.

Kjo nuk është pasoja kryesore e agresionit kundër Çekoslovakisë. Kryesorja është që ai e bëri të qartë se marrëdhëni e partive revizioniste me ata që kanë usurpuar udhëheqjen e partisë sovjetike, mund të jenë vetëm marrëdhënie nënshtimi, bindjeje servile dhe zbatimi të verbër të diktatit të tyre. Në qoftë se në Çekoslovakia ata përdorën dhunën e armëve, atje ku s'kanë mundësi të dërgojnë tanket do të përdorin mjetë të tjera për t'i nënshtuar, ose për të bërë grushte shtetesh në partitë e pabindura dhe për të vënë në krye udhëheqje që do t'u shkonin sipas qejfit të tyre.

Situata për revizionistët sovjetikë në prag të kësaj mbledhjeje nuk është, pra, shumë e këndshme, por atyre u duhet që, ashtu si pushtuan Çekoslovakianë dhe «bindën» partinë revizioniste çekoslovake, të sundojnë politikisht e organizativisht edhe partitë e tjera revizioniste.

Në situatën aktuale, grupet e ndryshme revizioniste nuk duken edhe shumë të gatshme të pranojnë qind për qind politikën e jashtme të Moskës. Në qoftë se bashkohen në luftën kundër marksizëm-leninizmit e

revolucionit, ata ndahen në ato çështje në të cilat politika sovjetike bie në kundërshtim me interesat e tyre kombëtarë, grinden për pozita dominuese, për epërsi në zona të ndryshme etj. Duke hequr dorë nga parimet e internacionalizmit proletar, në marrëdhëniet midis tyre shprehen plotësisht kontradiktat e papajtueshme kombëtare e ndërkombejtare të borgjezisë. Secila parti kërkon që mbledhja të mbështetë dhe të reklamojë ato teza e parime që ajo propagandon e zbaton në vendin e saj, pa u preokupuar nëse ato bien në kundërshtim me të të tjerëve.

U bënë kaq vjet dhe, me gjithë kompromiset e lëshimet reciproke, komisionet përgatitore s'kanë mundur të formulojnë akoma një tekst të përbashkët për komunikatën përfundimtare. Kur të dalë, do ta shikojmë çfarë do të jetë ky krijim i «mençurisë kolektive» revizioniste.

Fakt është se mbledhja revizioniste e Moskës, e projektuar nga Nikita Hrushovi dhe për të cilën pasardhësit e tij shkrinë gjithë energjitë e tyre për ta thirrur, e nisur për të dënuar Partinë e Punës të Shqipërisë dhe partitë e vërteta marksiste-leniniste, po përfundon në një përpjekje të dëshpëruar për vendosjen e paqes midis vetë pjesëmarrësve të saj.

Grindjet, kontradiktat dhe shthurja e frontit revizionist arritën kulmin me agresionin sovjetik në Çekosllovaki. Në prag të mbledhjes sundimtarët e Bashkimit Sovjetik kanë bërë e po bëjnë përpjekje të mëdha për të kapërcyer pengesën çekosllovake. Për këtë qëllim u bënë ndryshimet në udhëheqjen e Pragës dhe u morën një sërë masash të tjera. Tani krerët e

Kremlinit po i japid Husakut disa dhurata dhe po i bëjnë mjaft pretime lajkatare. Kështu, për shembull, thuhet se ata e kanë zgjidhur qesen dhe do t'i japid Çekoslovakisë një kredi të konsiderueshme në rubla ari për të mbajtur në këmbë ekonominë, e cila po bie gjithnjë e më poshtë. Gjithashtu, Greçkoja ka premtuar se do të fillojë të tërheqë së shpejti një pjesë të trupave të tij nga Çekoslovakia, gjoja si faza e parë e një evakuimi të përgjithshëm. Këto manovra, sigurisht, synojnë jo vetëm në forcimin e pozitave të brendshme e të jashtme të ekipit të Husakut, por edhe në krijimin e përshtypjes se pushtimi i Çekoslovakisë i përket së kaluarës. Në qoftë se do të arrihej ky objektiv, kjo do t'u hiqte argumentimin kryesor disa partive revizioniste të pabindura, që pjesëmarrjen e tyre në mbledhjen e Moskës e kushtëzonin me «normalizimin» e gjendjes në Çekoslovakia. Për më tepër, në qoftë se arrihej të imponohej një përshtypje e favorshme, atëherë pakësohej edhe mundësia që agresioni kundër Çekoslovakisë të bëhej objekti kryesor i mbledhjes së Moskës, që do t'i prishte krejtësisht planet e krerëve sovjetikë.

Por, me gjithë përpjekjet e krerëve sovjetikë, disa parti revizioniste kanë lënë të kuptohet se në mbledhje nuk do të heshtin për «çështjen çekoslovakë». Tanimë ajo është bërë për mjaft parti revizioniste, sidomos për ato të Evropës Perëndimore, jo vetëm një argument për t'u treguar partive borgjeze se ato janë të pavarura nga Moska, por edhe një mjet mbrojtës nga ndërhyrjet dhe presionet hegemoniste të udhëheqësve sovjetikë.

Krerëve revizionistë të Bashkimit Sovjetik, sigurisht, do t'u interesonte që mbledhja e tanishme në Moskë të aprovonte një dokument që të shprehte tërësinë e vijës ideologjike e politike të partisë revizioniste të Bashkimit Sovjetik, që të pranonte teorinë brezhanjeviane të «sovranitetit të kufizuar», «internacionalizmin e ri proletar» domethënë nënshtrimin e plotë dhe besnikërinë servile ndaj udhëheqësve sovjetikë. Ata do të donin që mbledhja t'u njihte revizionistëve sovjetikë të drejtën e ndërhyrjes e të agresionit në vendet e tjera, që ajo të justifikonte aleancën kundërrevolucionare sovjeto-amerikane dhe, çka është kryesorja, që gjithë revizionistët të radhiteshin pas tyre në fushatën dhe në veprimtarinë antikineze, e cila përbën aktualisht një nga bazat kryesore të politikës së jashtme sovjetike. Kjo nuk qe e mundur. Të pranonin një gjë të tillë do të ishte katastrofike për çdo parti revizioniste, do të thoshte që ato vetë të nënshkruanin me dorën e tyre dënimin me vdekje.

Përpara kundërshtimit të partnerëve të tjerë dhe përpara alternativës që të mos thirrej fare mbledhja, revizionistët sovjetikë u detyruan të tërhiqen. Ata u treguan «zemërgjerë» dhe pranuan një të ashtuquajtur rend dite «të kufizuar e unitar», të cilat i vunë emrin «detyrat aktuale në luftën kundër imperializmit dhe uniteti i veprimit i partive komuniste e punëtore».

Nga të dhënat e pjesshme dhe nga komentet që ka botuar shtypi revizionist, duket se projektdokumenti kryesor që ka hartuar komisioni përgatitor është një kartë boshe dhe pa asnje vlerë. Ai jo vetëm praktikisht, por as me fjalë nuk angazhon njeri dhe është

formuluar në mënyrë që mund të nënshkruhet pa kurrfarë druajtjeje nga të gjithë.

Për sa i përket vetë thelbit të çështjes «lufta kundër imperializmit», që, sipas rendit të ditës të caktuar, duhet të diskutojë mbledhja, kushdo e kupton se kjo është një frazë boshe, e zhveshur nga çdo kuptim politik, nga çdo përbajtje konkrete dhe nga çdo veprim praktik. Demagogjia këtu arrin një gradë të tillë absurditeti sa shndërrohet në një gjë krejt qesharake. Cilët janë «kalorësit e tryezës së rrumbullakët» që po mblidhen tani në Moskë dhe kundër cilit imperializëm do të luftojnë? Revisionistët sovjetikë, të cilët vetë janë imperialistë nga më të këqijtë dhe që janë lidhur në aleancë të ngushtë me ortakët e tyre të SHBA-së, apo revisionistët e vendeve perëndimore, të cilët po shkrihen me borgjezinë e tyre imperialiste? Imperializmin do ta luftojnë ata që pushtuan Çekosllovakinë dhe që vringëlljinë armët kundër vendeve të tjera, apo ata që janë bërë flamurtarët e kundërrevolucionit në vendet e tyre?

Se sa i trashë është blofi demagogjik i luftës kundër imperializmit, që mbledhja revizioniste i paska vënë vetes si detyrë ta diskutojë, mjafton të përmendim vetëm një fakt. Përgatitjet për mbledhjen e Moskës janë bërë njëkohësisht me përgatitjet për bisedimet në nivel të lartë midis qeverisë së re të Nixonit dhe asaj sovjetike, ato janë bërë kur midis sovjetikëve e amerikanëve po zhvillohen në paqe e në qetësi bisedimet e Gjenevës rreth çështjeve të monoplit bërthamor dhe të imponimit të çarmatimit të popujve, kur dy fuqitë e mëdha po bisedojnë të ndaj-

në Lindjen e Mesme, kur SHBA bekojnë pushtimin sovjetik në Çekosllovaki dhe nuk e fshehin shpresën që «Moska, — siç thotë Niksoni, — do ta nxitë Hanoин t  arrij  n  nj  marr veshje» etj.

P r t  gjith  esht  e qart  se q ndrimi i v rtet  i mbledhjes nuk esht  ai q  do t  thuhet n  fjalimet oratorike t  pjes marr sve t  saj, as ai i dokumenteve q  ajo do t  aprovoj . Q ndrimi i v rtet  esht  ai q  zbatohet n  praktik , n  c shtjet e p rditshme konkrete. Dhe praktika tregon se q ndrimi i revizionist ve esht  jo vet m proimperialist, por shum  m  tep r. Ai esht  nj  bashk punim i hap t me imperializmin, q  ka si synim t  shuaj  revolucionin dhe t  minoj  luft rat  lirimitare t  popujve, q  k rkon t  zhduk  socializmin dhe t  ruaj  kapitalizmin. Tanim  aleanca kund revolucionare sovjeto-amerikane esht  nj  fakt i jet s s  p rditshme nd rkomb tare, me t  cil n popujt kan  hyr  n  nj  luft  p r jet  a vdekje.

N  lidhje me mbledhjen e ardhshme t  Mosk s revizionist t b jn  nj  zhurm  t  madhe dhe preten- dojn  se ajo do t  forcoj  e do t  konsolidoj  unitetin e tyre. Ky esht  nj  tjet r blof, nj  tjet r frazeologji boshe. Midis antimarksist ve, tradhtar ve e renegat ve s ka pasur e s do t  ket  kurr  unitet. P r carja e partive t  sotme revizioniste nuk esht  nj  fenomen i rastit, as i p rkohsh m. Ajo esht  rezultat i vij s s  tyre oportuniste e kapitulluese, esht  rezultat i interesave t  kund rt. Gati t  gjitha partit  revizioniste tani, n  prag t  takimit t  tyre n  Mosk , kan  folur jo vet m p r ekzistenc n e pik pamjeve dhe t  vler sim ve t  ndryshme q  ato kan  p r shum  probleme politike,

ideologjike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare, por kanë theksuar se do t'i mbrojnë këto me këmbëngulje në Moskë dhe do t'i ruajnë edhe pas mbledhjes. Dhe këto nuk janë divergjenca për çështje stilesh letrare ose pasionesh sportive. Ato kanë të bëjnë me qëndrime konkrete për probleme themelore, siç është edhe qëndrimi ndaj atij imperializmi për të cilin do të bisedojnë, ose ndaj vetë Bashkimit Sovjetik. Demagogji për unitet mund të bëhet, kjo s'kushton gjë, por praktikisht ajo as bind, as gënjen dot njeri.

Duke shqyrtuar gjendjen në pragun e mbledhjes revizioniste të Moskës, nuk mund të mos bjerë në sy dalja e një faktori të ri: interesimi i veçantë i imperialistëve amerikanë dhe i borgjezisë ndërkombëtare për mbledhjen e «komunistëve». Drejtimi i përgjithshëm antimarksist dhe kundërrevolucionar patjetër e tërheq si me magnet vëmendjen e reaksionit botëror. Llogaritë e imperializmit dhe të reaksionit janë të thjeshta. Ata kanë frikë nga lëvizja revolucionare dhe nga partitë e vërteta marksiste-leniniste, por nuk i shqetësojnë ekzistenca e partive revizioniste dhe politika aktuale që ato ndjekin, qoftë edhe nën hegemoninë sovjetike. Ato jo vetëm nuk përbëjnë një rrezik për demokracinë borgjeze, por janë një zbukurim i vërtetë i saj. Prania e tyre në shtetet kapitaliste, paraqitja si forca të majta opozitare, krijojnë iluzionin e lirisë politike dhe të të drejtave demokratike të punonjësve, gjë që është e domosdoshme për një shogëri me luftë klasash të zhvilluar. Kush më mirë se partitë revizioniste mundet sot, pas falimentimit të partive socialdemokrate, të luajë rolin e grevëthyesit,

të sabotuesit dhe të minuesit të revolucionit? A nuk po e luajnë këtë rol të urryer revizionistët francezë apo ata italianë në Evropë? A nuk është tipik shembulli i partive revizioniste të Amerikës Latine, të cilat, duke iu bindur urdhrale të marrë nga Moska, janë kthyer në detashmente të luftës kundër revolucionit në vendet e tyre, në parti të kompromisit dhe të tradhtisë kombëtare? Legalizimi i tyre nga ana e diktaturave ushtarake, që po bëhet kohët e fundit, nuk është bërë pa «këshillat e urta» të daj Samit nga Uashingtoni. Imperialistët amerikanë bëhen pak merak në qoftë se këto grupe oportuniste do të thonë nganjëherë edhe ndonjë fjalë kundër tyre. Ata e dinë se fjalët janë fjalë dhe veprat vepra. Bile është e domosdoshme që revizionistët të hiqen si antiimperialistë, përndryshe ata do të demaskoheshin shpejt dhe do të bëheshin të pavlefshëm.

Përpara se të vijnë në mbledhjen e tanishme të përgjithshme, revizionistët kanë bërë edhe mbledhje të veçanta. Të njohura janë ato të Moskës, të Budapestit e të Karlovi-Varit. Pas se cilës nga këto udhëheqësit sovjetikë, që kanë qenë edhe organizatorët, kanë thirrur e janë çjerrë për «suksesin» e tyre, janë mburrur për «forcimin e unitetit», për «veprimet e përbashkëta», për «ideologjinë, politikën e interesat e përbashkët». S'ka kaluar shumë kohë dhe ata i janë vënë punës për thirrjen e një mbledhjeje tjetër. Por jeta ka treguar se mburrjet e revizionistëve ishin demagogji bajate për të fshehur disfatat, për të mbuluar thellimin e përqarjeve, dezintegrimin dhe shthurjen e frontit revizionist. S'ka asnjë dyshim se fatin e të

parave do të ndjekë edhe mbledhja e tanishme e përgjithshme revizioniste e Moskës. Ajo nuk mund të përfundojë ndryshe veçse me një falimentim të turpshëm.

Mbledhja e tanishme revizioniste ka vënë në bazë të saj luftën kundër marksizëm-leninizmit, luftën kundër partive të vërteta revolucionare, mobilizimin për të sabotuar revolucionin dhe luftën çlirimitare të popujve. Por historia ka vërtetuar se tradhtia ndaj proletariatit e socializmit çon vetëm në falimentim e shkatërrim. Nga ky rregull nuk mund të bëjnë përjashtim as revizionistët e sotëm, që kanë ngritur flamurin e leckosur të kundërrevolucionit dhe duan të kthejnë mbrapsht zhvillimin e shoqërisë. Rruja e tyre i çon drejt vdekjes dhe lufta e vendosur e klasës punëtore dhe e proletariatit, lufta e marksistë-leninistëve dhe e revolucionarëve të vërtetë do t'i shpjerë me siguri në varr.

Duke organizuar mbledhjen tradhtare të Moskës, krerët revizionistë marrin një përgjegjësi të madhe përpara lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe punonjësve të të gjithë botës. Proletariati i gjithë vendeve nuk mund t'ua falë kurrë klikave revizioniste këtë ndërmarrje të ndyrë, e cila ka për qëllim të godasë dhe të përqajë forcat e revolucionit, të minojë marksizëm-leninizmin dhe socializmin. Ai nuk mund të rrijë indiferent përpara orvatjeve të revizionizmit dhe të borgjezisë, të cilët kërkojnë ta mashtrojnë dhe ta vënë në rrugë të gabuar për ta shtypur dhe për ta lidhur më fort me vargonjtë e robërisë kapitaliste.

U takon marksistë-leninistëve të ngrihen me gu-

xim dhe me vendosmëri kundër këtij komploti të ri, për të demaskuar dhe për të goditur pa mëshirë klikat uzurpatore revizioniste, për t'i izoluar dhe për t'i shkattereduar përfundimisht. Komunistët dhe revolucionarët e vërtetë nuk mund t'i shmanget kësaj detyre të tyre të madhe. Qofshin brenda ose jashtë partive revizioniste, ata duhet ta ndezin sa më fort luftën revolucionare, për t'i shkëputur masat punonjëse të mashtruara nga influenca revizioniste dhe për t'i hedhur në luftë kundër klikave renegate. Ata nëpërmjet aksioneve konkrete të guximshme duhet t'i thyejnë zinxhirët me të cilët krerët revisionistë mbajnë të lidhur punonjësit, anëtarët e thjeshtë të partisë dhe kuadrot e ulët.

Rruja e luftës dhëmb për dhëmb, e izolimit dhe e demaskimit të pamëshirshëm të klikave revizioniste është e vetmja rrugë e drejtë për shpartallimin e përlikuidimin e revizionistëve modernë dhe për triumfin e marksizëm-leninizmit. Kjo është edhe rruja e drejtë për krijimin dhe për forcimin e partive të reja marksiste-leniniste, besnikë deri në fund të ideologjisë së vërtetë të klasës punëtore dhe të forcimit të internacionalizmit proletar, është rruja e fitores së revolucionit mbi kundërrevolucionin.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i popullit»,
nr. 126 (6478), 28 maj 1969*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përbledhje
veprash) 1968-1970», f. 394*

VRASJA E AVNI RUSTEMIT NË KËMBË GJITHË POPULLIN

Fjala në mitingun e qytetit të Libohovës

28 maj 1969

Me të mësuar për ardhjen e udhëheqësit të Partisë e të popullit në Libohovë, qindra banorë të qytetit dhe nxënës të shkollave u grumbulluan para bustit të Avni Rustemit. Midis duartrokositjeve dhe brohoritjeve në këtë miting spontan, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Me rastin e vizitës në qytetin tuaj, dëshiroj t'ju them disa fjalë, juve, të dashur punonjës të Libohovës, si dhe juve, të dashur shkollarë e shkollare.

Me shumë të drejtë ju po brohoritni me kaq zjarr për Partinë tonë, sepse e dini që vetëm nën udhëheqjen e saj të drejtë u çlirua përgjithmonë populli ynë dhe u krijuar Republika Popullore e Shqipërisë. Është Partia e Punës ajo që vuri në piedestal heronj si Avni Rustemi, luftëtarët patriotë të kohëve të kaluara dhe partizanët trima të kohëve tona, që derdhën gjakun për Shqipërinë, për popullin dhe për rininë tonë.

Libohova juaj është një qytet i bukur. Populli i

saj ka vuajtur shumë në të kaluarën, sepse pikërisht këtu ishte çerdhja e njërit prej feudalëve më të egër e më gjakpirës, Myfit bez Libohovës, i cili, si një nga krerët e feudalizmit në vendin tonë, ju shtypte jo vetëm ju, por mbarë popullin dhe ishte gati ta shiste Shqipërinë. Mund ta shtypësh përkohësisht popullin, siç bënin feudali i urryer Myfit Libohova dhe familja e tij, siç bënte satrapi Ahmet Zogu e të tjerë, por as ata, as padronët e tyre, të jashtëm, te të cilët kishin shitur ndërgjegjen e tyre dhe atdheun tonë, nuk ia arritën dot qëllimit, pse populli është i pamposhtur.

Këtu në Libohovë, në gjirin tuaj, lindi Avni Rustemi, një djalë i zoti, me zemër të madhe, të guximshme dhe me mendje të qartë. Ai nuk ishte njeri iën-dërrimeve të kota, nuk ishte një njeri që mendonte të ecej si të ecej, po ishte një revolucionar, ishte revolucionar pikërisht pse kishte dalë nga gjiri i popullit të vuajtur të këtij qyteti, ku në të kaluarën sundonte kala e feudalëve, kamxhiku i tyre.

Qysh kur ishte në bankat e shkollës, afërsisht në moshën që jeni ju sot, të dashur shkollarë e shkollare, ai mendonte përfatet e popullit. Kur ishte nxënës, Avniu përpiquej të mësonte sa më shumë dhe sa më mirë. Ai donte që dituritë e fituara t'i shërbën jo si stoli përvete, por t'i vinte në shërbim të popullit, ashtu siç i vuri. Më vonë, kur u rrit, mendimet e tij gradualisht u zhvilluan e u kaliten gjithnjë e më shumë.

Akti heroik i Avni Rustemit në Paris nuk ishte një atentat i thjeshtë; ai nuk kishte karakter terrorist apo anarkist. Jo! Akti i Avni Rustemit kishte një

kuptim të madh politik dhe ideologjik. Plumbat e Avni Rustemit, që shtrinë përdhe Pashën e Toptanit mu në zemër të Parisit, ishin sinjali, kushtimi i Revolucionit Demokratiko-Borgjez, i një revolucioni të popullit tonë që po ngrihej kundër feudalizmit.

Avni Rustemi nuk e zgjodhi kot personin mbi të cilin duhej të shpërthente urrejtjen e mbarë popullit shqiptar. Ai zgjodhi Esat pashë Toptanin, pikërisht atë që ishte shitur Shqipërinë tek osmanët, atë që i shërbeu Princ Vudit të gjermanëve dhe që ishte shitur kokë e këmbë tek imperialistët italianë. Ishte Esat pashë Toptani ai që shtypi «rebelët» dhe përgatiste në Paris kurthe të tjera për Shqipërinë e re. Avni Rustemi, ky revolucionar me ide të qarta e me zemër të çeliktë, që përfaqësonte ndjenjat dhe aspiratat e popullit të vuajtur dhe të rinisë trime të të gjithë vendit tonë, rrëzoi Pashën e Toptanasve përdhe. Aksioni i tij do ta ndizte akoma më shumë flakën e patriotizmit në zemrat e popullit shqiptar.

Pas atentatit historik, gjykata franceze u gjend përpara një opinioni të gjerë botëror që u ngrit në mbrojtje të këtij djaloshi të ri nga Shqipëria, i cili brenda në Paris guxoi t'u thotë franezëve se, ashtu si ata vetë ia prenë kokën mbretit të tyre në kohën e Revolucionit Demokratiko-Borgjez, edhe ai, për të shpëtuar popullin shqiptar, ia zbrazi në gjoks qenit tradhtar të gjithë fishekët, e bashkë me ta edhe urrejtjen e popullit shqiptar. Përpara opinionit botëror, gjykata e Parisit u detyrua ta lironte Avniun.

Avni Rustemi ishte njeri i aksionit. Veprimtaria dhe mendimet e tij revolucionare nuk përfaqësohen

vetëm nga vrasja e Esat Pashës. Vepra e Avniut shkëlqen gjatë gjithë jetës së tij, megjithëse të shkur-tër. Derisa u vra nga armiqtë e popullit, Avniu mendoi, punoi dhe luftoi si revolucionar.

Si djalë i popullit që ishte, pasi u kthye në Shqipëri¹, Avniut nuk i shkoi në mendje të kapardisej, duke pretenduar se meqë vrah tradhtarin Esat Pa-sha, të gjithë duhej ta adhuronin si njeri të madh. Jo, nuk ndodhi kështu me të². Avni Rustemi ishte njeri i thjeshtë, siç janë dhe duhet të jenë gjithë revolu-cionarët; ai mendoi se ajo që bëri ishte vetëm një pjesë e luftës së tij, se, si bir i popullit, që e lindi dhe e rriti, i kishte borxhe të mëdha këtij. Prandaj fi-lloj nga puna për të ngritur popullin, për ta bash-kuar e për ta hedhur në luftë, që në Shqipëri të shku-lej nga rrënjet pushteti i bejlerëve, i agallarëve, i pa-shallarëve e i gjithë gjakpirësve të tjerë të popullit shqiptar. Avniu organizoi rininë në shoqërinë demo-kratike «Bashkimi»³. Ai shkruante artikuj në shtypin demokratik të kohës për probleme të rëndësishme të shtruara nga zhvillimi historik i vendit, mbante fjal-

¹ Më 24 dhjetor 1920 Avni Rustemi arriti në skelen e Vlorës. Në pritjen e organizuar për ndër të tij foli Heroi i Popullit Halim Xhelo.

² Midis të tjerave, në fjalën që mbajti ditën e ardhjes, Avni Rustemi tha: «Jam krenar që ndodhem midis djalërisë vlonjate, nuk bëra gjë tjetër veç detyrës që më takonte e që duhej ta bënte qđo shqiptar».

³ Kjo shoqëri, që u krijuar në Tiranë më 13 tetor 1922, ishte vazhdim i federatës «Atdheu», për mbylljen e degëve kryesore të së cilës urdhëroi feudali Ahmet Zogu, në atë kohë ministër i Punëve të Brendshme.

me të zjarrta në popull e në parlament dhe ishte një nga kundërshtarët më të rreptë të demokratëve fals e, në radhë të parë, të satrapit Ahmet Zogu, të politikës së tij të brendshme shtypëse antipopullore dhe të politikës së jashtme skillavëruese që synonte të copëtonte Shqipërinë dhe t'u jepte si dhuratë pjesë të saj shteteve fqinje, pse aq i bënte mbretit Zog për fatet e popullit.

Avni Rustemi ishte një nga ata që udhëhiqte lufthen e popullit shqiptar, Revolucionin Demokratiko-Borgjez. Pikërisht pse ishte i tillë, Ahmet Zogu vuri njerëz dhe e vrau heroin tonë Avni Rustemin. Zogollinuk e vrau Avniun në kuptimin e thjeshtë të hakmarrjes, pse i kishte vrarë dajën, Esat pashë Toptanin. Jo! Kjo vrasje kishte një kuptim të madh politik dhe ideologjik. Në radhë të parë, Ahmet Zogu, si përfaqësuesi më i egër i feudalizmit në Shqipëri, i rrethuar nga bejlerët e agallarët, si dhe nga borgjezia që pongrihej, shikonte te populli që po përgatitej për kryengritje armikun e vendosur të interesave të tyre, shikonte tek Avni Rustemi dhe tek organizata «Bashkimi» që ai pati formuar, një rrezik të jashtëzakonshëm për të është për dështimin e komplotit që kurdiste. Për këto arsyen Ahmet Zogu e vrau Avni Rustemin. Ai me këtë akt synonte të godiste Revolucionin Demokratiko-Borgjez në ngjitje.

Mirëpo vrasja e Avniut ngriti në këmbë gjithë popullin shqiptar. Kjo ngjarje bëri të pëlciste pikërisht ai revolucion, që po përgatiste Avni Rustemi, vrasja e të cilin u bë një pishtar për popullin tonë. Nga të katër anët e Shqipërisë u mblodhën në atë

kohë në Vlorën heroike, në Vlorën e luftërave për çlirim, në Vlorën ku më 1912 u ngrit flamuri ynë kombëtar, në Vlorën ku u varros dhe tash prehet përgjithmonë trupi i heroit tonë, Avni Rustemit, njërezit më të mirë, të cilët, së bashku me popullin, rrëmbyen pushkët dhe marshuan drejt Tiranës për të goditur edhe një herë në mënyrë masive feudalizmin, përfaqësuesin e tij kryesor, Ahmet Zogun, dhe gjithë sejmenët që ai kishte rrreth vetes.

Ahmet Zogu u shporr dhe në Shqipëri u formua qeveria demokratike borgjeze e Fan Nolit. Por kësaj i mungonte një dorë e hekurt dhe një mendje e ndritur, si ajo e Avni Rustemit. Kjo qeveri u përpelit për një kohë, bëri lëshime të mëdha në politikë, ajo nuk zbatoi reformat politike dhe ekonomike për të cilat u ngrit në këmbë Avniu, shokët e tij dhe gjithë djalëria shqiptare që u vente pas. Në këto kushte Ahmet Zogu, me ndihmën politike, morale dhe materiale të Serbisë, Greqisë, Italisë dhe Francës, u kthye përsëri në Tiranë, ku vendosi regjimin e tij të egër, për të bërë në kurriz të atdheut të gjitha ato që dimë dhe që popullit tonë iu desh t'i lante më vonë me lumenj gjaku.

Populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e tij heroike Komuniste, bëri Luftën legjendare Nacional-çlirimtare për të përzënë pushtuesit fashistë italianë e pas tyre nazistët gjermanë. Me këtë luftë ai shkallmoi nga themelët njëherë e përgjithmonë pushtetin e vjetër të bejlerëve, të agallarëve, të kulakëve, të fajdexhinjve, të tregtarëve e të tradhtarëve dhe ngriti në këmbë Shqipërinë e re të popullit, Shqipërinë e atyre

që kishin vuajtur për një copë bukë e për një pëllëmbë tokë.

Ëndrrat dhe përpjekjet e Avni Rustemit dhe të gjithë atyre të rinxje që luftuan për liri i realizoi Partia Komuniste e Shqipërisë, e cila udhëhoqi revolucionin e madh proletar, revolucionin socialist. Partia zbatoi rrënjesisht ato reforma ekonomike shoqërore që kishte në mendje Avni Rustemi dhe për të cilat ai u përpoq e luftoi derisa vdiq. Partia i bëri thellë këto reforma, ajo e bëri Shqipërinë me të vërtetë të popullit, të shqiptarëve dhe të shqiptarkave, duke sjellë masat në fuqi dhe duke i mësuar ato të drejtojnë pushtetin me duart e tyre të çelikta, për t'ia ndryshuar pamjen krejtësisht Shqipërisë, për ta bërë të lulëzuar e të begatë.

Partia filloi nga puna për të ndryshuar njerëzit, në radhë të parë, pse këta janë gjëja më e çmuar, pse mendja dhe dora e njeriut bëjnë gjithçka. Çdo gjë në të kaluarën dhe në të tashmen e ka bërë populli. Në të kaluarën bejlerët, agallarët, fajdexhijntë dhe gjithë gjakpirësit shiteshin sikur bënин gjithçka, por ata dinin të bënин vetëm një gjë: të rripnin e t'i pinin gjakun popullit, të cilin e detyronin të punonte e të derdhët djersë e gjak për ta. Në ato kohë prindërit dhe vëllezërit tanë më të mëdhenj shkonin për të çarë çakëll në pisk të vapës për dy lekë në ditë, me të cilët nuk i siguronin dot familjes as bukë thatë. Në këto kushte fëmijët e vegjël ishin vazhdimesht të uritur, pse gjokset e nënave thaheshin nga uria, populli mbarë vuante të zitë e ullirit. Ca më e keqe u

bë gjendja pas pushtimit të vendit nga Italia fashiste, tek e cila na kishte shitur Ahmet Zogu. Prandaj Partia, e themeluar në kushtet e rënda të okupacionit, i bëri menjëherë thirrje popullit të hidhej në luftë, të mos priste shpëtim nga askush, por nga vetja, nga mendja, nga duart dhe nga zemra e tij.

Partia pranoi në radhët e saj nga njerëzit më të mirë të popullit, pse vetëm kështu do të bëhej e çelik-të, e pathyeshme, për të udhëhequr masat drejt fitores, drejt çlirimtë atdheut. Kujdes të madh tregoi e po tregon vazhdimisht Partia për organet e pushtetit, ku populli duhet të zgjedhë njerëz të sprovuar, të sakrificës, t'i zgjedhë këta në rrugë demokratike, jo për t'u dhënë rytbe, por nga ata që ulin kokën, që punojnë mirë e pa u lodhur kurrë për çështjen e Partisë dhe të popullit. Ne që jemi të zgjedhur në organet e Partisë dhe të pushtetit, duhet të jemi kurdoherë në ballë, të jemi shembull ndershmërie dhe të dashur me popullin. Atyre që veprojnë ndryshe, t'u japim dudat, siç themi ne këtej nga Gjirokastra. Nuk duhet të lejojmë njeri të mos i japë llogari popullit, pse Shqipëria e re nuk është as e njërit, as e dy ose e pesë vetave, por është e shtrenjtë për të gjithë popullin.

Ata që zgjidhen në udhëheqje të Partisë e të pushtetit, nuk janë me yll në ballë, po njerëz si të gjithë. Në qoftë se ne udhëheqësit dimë diçka, këtë e dimë se jemi rritur në gjirin e popullit dhe kemi mësuar prej tij; në rast se ne jemi të fortë, kjo ndodh se i fortë është populli që na jep fuqi, të fortë jeni ju.

Prandaj, në qoftë se ndonjë gabon dhe nuk bën përpjekje të korrigohet, ai duhet të shkarkohet nga detyra, pse nuk mund të luhet me çështjen e atdheut dhe të popullit. Në gjirin e popullit ka plot të rinj të përgatitur që mund t'i kryejnë shumë mirë detyrat që u ngarkohen. Ai që është i mirë, nuk duhet të matet vetëm me ç'ka bërë në të kaluarën për atdheun e për popullin, por njëkohësisht edhe me atë që po bën sot. Cilido qoftë, në rast se ka punuar mirë në të kaluarën dhe tani e sheh se nuk ecën dot përrpara me këtë ritëm, le të bëjë përpjekje, pse çështja e popullit është e shenjtë, se për hatërin e njërit apo të tjetrit që nuk punon si duhet e nuk sillet mirë me njerëzit, që nuk është i thjeshtë me ta e s'derdh djerësë, nuk mund të vihet në balance interesë i madh i përgjithshëm. Revolucionari duhet të punojë mirë e vazhdimisht gjatë gjithë jetës.

Ky është ai mësim i madh që na jep Partia, i cili duhet të na ngulitet mirë në mendje dhe jo vetëm kaq, por t'i bëjmë sytë katër, që kur të shohim apo të dëgjojmë se diçka nuk ecën, se dikush nuk punon mirë, bën hatëre, shkel vijën e Partisë etj., të ngremë zërin pa frikë, ndryshe ndodh si me të sëmurin, që, po të mos vizitohet nga mjeku në kohën e duhur dhe po të mos marrë mjekimet e nevojshme, sëmundja përparron dhe një mëngjes të mirë ai edhe mund të vdesë. Kështu ndodh edhe me çështjen e socializmit. Interesat e popullit duhen pasur, pra, kurdoherë parasysh, të ruhen me kujdes dhe nga të gjithë.

Këto që ju thashë sot këtu, Partia jua ka përsëritur vazhdimisht. Kur të jetë nevoja, ajo prapë do

t'jua thotë, por unë i preka me këtë rast, që ju si bij e bija të denja të Partisë, të ndiqni rrugën e saj, ta doni atë me gjithë shpirt, të ndiqni rrugën e pastër e revolucionare të Avniut, në politikë, në punë, në jetë e kudo. Të gjitha orientimet dhe porositë e Partisë shprehin dëshirat dhe qëllimet tuaja, të mbarë popullit tonë, prandaj secili duhet t'i zbatojë drejt, por, në radhë të parë, t'i kuptojë mirë politikisht, pse kështu do të mobilizohet me të gjitha forcat për t'i zbatuar, me qëllim që atdheu ynë, Shqipëria, populli dhe brezat e ardhshëm të rrojnë gjithmonë të lumtur e të gëzuar.

Për lumturinë dhe lirinë e popullit, për sot e përmot, mendon vazhdimisht Partia. Mendimi i Partisë është i gjerë dhe i thellë. Partia mendon dhe punon që njerëzit tanë të bëhen të fortë, të zotë për çdo gjë e të mësuar, se kështu do të lulëzojë atdheu, do të përparojnë industria dhe bujqësia, do të krijohet çdo vit e më mirë bollëku, do të zhvillohen më tej arsimi dhe kultura, do të forcohet mbrojtja e vendit.

Partia punon që të kemi një Ushtri Popullore të fortë, që në çdo kohë secili nga ne të jetë ushtar i paepur për mbrojtjen e fitoreve të arritura, për mbrojtjen e Republikës sonë Popullore. Ushtria i duhet vendit tonë për të mbrojtur vendin nga armiqëtë imperialistë, revisionistë dhe gjithë këlyshët e tyre. Me ne janë popujt përparimtarë të botës. Vetëm krerët e vendeve kapitaliste e revisioniste janë kundër nesh, ata janë pikërisht si Ahmet Zogu dhe Esat pashë Toptani dikur te ne. Por fundi që gjeti më parë ata, fundi që gjeti më vonë tradhtarët e popullit tonë gjatë Luftës

Nacionalçlirimtarc, si Ali Këlcyrën e Lumo Skëndon¹ me shokë, ai fund i pret edhe krerët e imperializmit dhe të revizionizmit modern.

Revolucioni do t'i përbysë të gjithë sundimtarët e egër të popujve dhe tradhtarët e çështjes së tyre; e ardhmja i përket komunizmit, që është rinia e botës, siç ka thënë një revolucionar francez; u përket klasës punëtore dhe fshatarësisë heroike.

Armiqtë tanë, imperialistët e revisionistët, janë të dobët, ne jemi të fortë. Ata janë vetëm klika, kurse ne përbëjmë shumicën, prandaj nuk ua kemi frikën. Trimi rron dhe fiton kurdoherë, i dobëti është i destinuar të humbasë dhe të vdesë. Por triumfi,jeta e lirë, e bukur dhe e begatshme nuk vijnë vetveti, ata kërkojnë luftë e punë të palodhur, kërkojnë, pra, përgatitje.

Prandaj, i madh e i vogël në vendin tonë duhet të ndjekin shembullin e klasës punëtore. T'i përvishemi punës me të gjitha forcat, se punojmë për vete, për lumturinë tonë. Çdo ditë t'i vëmë detyrë vetes që të punojmë, të luftojmë, të mësojmë, të vigjilojmë vazhdimisht e pa u lodhur për popullin, për atdheun. Minutat të çmohen si flori nga kushdo. S'ka jetë më të bukur se jeta në punë, në luftë e në revolucion. Partia kurdoherë na këshillon që më parë të punojmë, të mësojmë, të mësojmë që më parë të punojmë, të luftojmë, pastaj të dëfremjë, të këndojmë e të hedhim valle. Të gjitha t'i bëjmë, na këshillon ajo, dhe të gjitha po i bën populli ynë nën udhëheqjen e saj, prandaj jemi të

1 Mithat Frashëri.

lumtur e të gjëzuar dhe kurdoherë me zemër të re e të freskët. Sigurisht, çdo gjë nuk është akoma ashtu si do Partia, se ka edhe vështirësi, po këto ne do t'i kapërcejmë me përpjekjet dhe me punën tonë.

Në të gjitha anët e Shqipërisë janë bërë përparrime të mëdha, për të cilat ju keni dëgjuar ose lexoni vazhdimisht nëpër gazeta, por shumë nga ju mund t'i keni parë edhe vetë, prandaj nuk po i numëroj. Edhe Libohova juaj, ashtu si i gjithë vendi, ka ecur përpara. Në të ardhmen ajo do të bëhet një kopsht me të vërtetë i lulëzuar. Shumë nga qytetarët e Libohovës punojnë si punëtorë në ndërmarrjen bujqësore. Ju që tani bëni pjesë në radhët e armatës së madhe të klasës sonë punëtore jo vetëm për të ardhurat më të mëdha që merrni, por sidomos për detyrat më të vështira që kryeni për të mirën e atdheut dhe të gjithë popullit. Prandaj, që ta bëjmë Shqipërinë siç dëshiron Partia, kalituni edhe ju më tej si tërë klasa jonë punëtore. Por kalitja bëhet në punë, prandaj një nga detyrat tuaja është që këto kodra kaq të bukura përreth qytetit t'i ktheni në kopshte me pemë frutore.

Vend i bukur e pjellor është Libohova juaj, që ka pranë ujë të bollshëm. Shteti ka investuar dhjetëra milionë lekë për të ndërtuar rezervuarin e Doftisë këtu afér Libohovës, me ujin e të cilit do të ujitet dhe do të lulëzojë krejt fusha e Dropullit. Kjo do të gjë zojë gjithë Shqipërinë, por, në radhë të parë, do t'ju gjë zojë ju dhe vëllezërit dropullitë, të cilët kanë vuajtur shumë përpara nga regjimet gjakpirëse të së kaluarës. Por, si mbarë populli ynë, edhe populli i minoritetit u ngrit dhe, nën udhëheqjen e Partisë, u çlirua

nga shfrytëzimi i egër i bejlerëve e i agallarëve. Me masat e shumta që mori Partia, edhe atje u çua uji i pijshëm, u bënë bonifikime në fushat dhe tani do të arrihet që të ujiten, u çua drita elektrike etj. Kudo në fshatrat e minoritetit janë ngritur shkolla fillore e 8-vjeçare, vatra e shtëpi kulture, ambulanca, spital, dyqane etj. Nga minoriteti janë përgatitur qindra kuadra me arsim të mesém e të lartë, të cilët punojnë në të katër anët e atdheut. Por e ardhmja, si për gjithë popullin shqiptar, edhe për ju që jetoni në këtë vend, do të jetë akoma më e bukur.

Planet që janë paraqitur nga Partia dhe pushteti i studioni, i shtroni, i diskutoni me njëri-tjetrin, pastaj kazmën në dorë, dyfekun në sup dhe nisjani punës. Kam dëshirë që, kur të vij herë tjetër, këto kodra e fusha pjellore t'i gjej me të vërtetë të lulëzuara, ta shoh të realizuar këtë dëshirë të madhe të Partisë dhe tuajën.

Ju uroj punë të mbarë, shëndet të plotë juve dhe gjithë të dashurve të zemrave tuaja!

Të na rrojë në shekuj Partia, të rrojë populli shqiptar, të rrojë e të kalitet rinia!

Mbetshi me shëndet!

Botohet për herë të parë si-pas originalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TA RUAJMË QYTETIN E GJIROKASTRËS, KËTË XHEVAHIR TË ARKITEKTURËS SË POPULLIT

Fjala në mitingun e qytetit të Gjirokastrës

28 maj 1969

Të dashur motra dhe vëllezër, shokë dhe shoqe gjirokastritë,

Jam shumë i gëzuar që ndodhem sot në mes jush. Me këtë rast, ju sjell ju të gjithëve dhe familjeve tuaja shumë të fala nga shokët udhëheqës të Partisë dhe të Qeverisë... Meqenëse fjala m'u pre për një çast nga emocioni, mos kujtoni se më ka kaluar mosha. Jo, shoqe dhe shokë! Jam si kurdoherë i ri nga zemra, por, si kushdo, kam edhe unë emocione dhe mall të madh për qytetin e lindjes dhe për ju të gjithë. Prandaj ju falënderoj nga zemra që morët pjesë në këtë takim. Sa herë që vij këtu, në Gjirokastër, gëzohem shumë që njerëzit i shoh gjithnjë e më të shëndetshëm, më të lumtur, më të kulturuar e më të ngritur politikisht dhe ideologjikisht, të lidhur si mishi me thoin me Partinë. Dhe keni arsyë të jeni të lumtur e të gëzuar, se Partia jonë heroike, që udhëheq popullin shqiptar drejt ndërtimit të plotë të socializmit, me

luftën dhe me direktivat e saj të drejta, po krijon çdo ditë e më shumë një gjendje të mrekullueshme shpirtërore dhe ekonomike për gjithë punonjësit e vendit tonë.

Partia ka forcuar vazhdimisht gjendjen brenda vendit, ndërsa jashtë autoriteti i atdheut tonë është rritur si asnjëherë më parë. Për këto arsyen, ashtu si gjithë populli shqiptar, edhe ju, vellezër e motra të Gjirokastrës, jeni ngritur në këmbë për të dhënë kontributin tuaj në këtë revolucion të pambaruar, të vazhdueshëm e frytdhënës. Populli e do me një dashuri të pafund Partinë e tij, nën udhëheqjen e së cilës u çlirua, dhe tani, me patriotizëm të madh, po ndërton të sotmen e bukur që lindi nga gryka e pushkës, me gjakun e derdhur lumë të heronjve dhe të heroinave, që garanton të ardhmen e sigurt.

Sot këtu dëshiroj t'ju flas thjesht, ashtu siç i flet vëllai vëllait apo motrës. Dua t'ju them sinqerisht se kam dëshirë të madhe ta vizitoj gjithsecilin deri në shtëpinë e vet, por kushdo e kupton se kjo është e pamundur. Prandaj takime të tillë të gjera, si ky i sotmi, janë shumë të përshtatshme për këtë qëllim. Kur të vij herë tjetër, dëshiroj të mos ju flas nga ballkonë, por të jem sa më afër jush, aty poshtë te trouari, ku në kohën e regjimeve shtypëse kanë qëndruar dërrasaxhinjtë, furrxhinjtë, këpuçarët, hamejtë, që vuanin e rropateshin tërë ditën për tre grosh dhe që s'kishin një pikë ujë të shuanin etjen; aty ku vinin fshatarë, të cilëve u kullonte djersa çurg derisa sillnin një gomar dru për të blerë një kile bukë.

Por vuajtjet e mëdha, ashtu si gjithë popullin to-

në, ata kurrë s'i përkulën. Punëtorët, fshatarët e varfër dhe inteligjencia popullore e Shqipërisë asnjëherë nuk e kërrusën kurrizin përpara bejlerëve e agallarëve, satrapëve dhe pushtuesve, por, me t'u bërë thirrje Partia, brofën në këmbë, rrokën armët e luttuan me heroizëm, përmbyssën pushtetin e egër dhe vendosën diktaturën e klasës punëtore, që është bërë tani mbrojtësja e vendosur e demokracisë, e lirisë, e interesave dhe e jetës së lumtur të popullit që ndërton, lulëzon e fuqizon çdo ditë e më shumë Shqipërinë tonë të dashur, e cila i tmerron armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm.

Tani dëshiroj t'ju them disa fjalë jo si gjirokastrit, po si «tiranas». U lutem shumë popullit të Gjirokastrës, arkitektëve, shokëve drejtues të Partisë dhe të pushtetit të rrëthit tuaj ta ruajnë kështu siç është këtë qytet, por edhe ta zbukurojnë, pse është me të vërtetë një mrekulli. Gjatë jetës kam pasur rastin të shoh shumë vende, kam lexuar, gjithashtu, libra të ndryshëm që flasin për qytete të tjera të botës, por pa u nxitur aspak nga dëshira që të mburr vendlindjen, dua t'ju them se qytet të tillë si Gjirokastra nuk kam parë. Disa thonë se njeriut, kur i kalon mosha, i shtohet çdo ditë e më shumë malli për atdheun dhe për vendlindjen, prandaj vlerësimet nuk i bën me metrin e logjikës. Ne marksistë-leninistët logjikën e kemi të fortë, se na udhëheq teoria jonë e pamposhtur. Prandaj, për sa i përket vlerësimit për Gjirokastrën, jam i mendimit se nuk bëj ndonjë teprim. Ky qytet është me të vërtetë një xhevahir i arkitekturës së popullit. I parhruar goftë kujtimi i të parëve tanë muratorë duar-

artë e përparimtarë, që e ndërtuan, kurse neve tani na bie detyra ta ruajmë e ta mirëmbajmë, ta zbukurojmë më tej këtë qytet, por pa ia prishur origjinalitetin.

Dëshiroj, gjithashtu, t'u uroj që t'u bëhet dita një mijë atyre që meremetuan pazarin, duke e kthyer atë në një vend të bukur. Kjo tregon mençurinë, zotësinë dhe shijen e hollë artistike të punëtorëve tanë. Nga sa pashë këto ditë, ata jo vetëm kanë rregulluar mirë pazarin, por kanë ngritur bukur ndërtuesat, dyqanet dhe po e mirëmbajnë qytetin në mënyrë të tillë që, siç thashë edhe më lart, një arkitekturë si kjo rrallë e gjen jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë. Prandaj, në emër të popullit, në emër të Shqipërisë, i bëj thirrje çdo qytetari e qytetareje gjirokastrite t'i ruajnë të parakura për brezat e ardhshëm këto vlera të bukura arkitekturore.

Edhe ju shokë arkitektë, që punoni në Gjirokastër, qofshi gjirokastritë ose nga rrethe të tjera, të keni kujdes që, kur punoni, kur projektoni dhe zbatoni, atë dituri dhe eksperiencë, atë shije marksiste-leniniste, me të cilën ju kanë pajisur Partia dhe populli, t'ua përshtatni ndërtimeve të reja, stilit të këtij qyteti të lashtë e të bukur, që është ngritur këtu në shpatet e Malit të Gjerë. Mos e imaginoni në asnje mënyrë Gjirokastrën me bulevarde të gjera, me pallate shumëkatëshe e me ballkone moderne, pse atëherë këtij qyteti, në vend që t'i vihen vetullat, i nxirren sytë. Bulevarde të gjera le të ndërtojnë Tirana, Durrësi, Vlora etj. Gjirokastra ka karakteristikat e saj arkitekturore që duhet t'i ruajë e t'i zhvillojë më tej. Në mos sot, nesër sidomos, punonjësit e qyteteve të tjera

do t'ia kenë zili Gjirokastrës këto karakteristika. Unë mendoj se në të ardhmen s'do të mbetet shqiptar pa ardhur për të vizituar këtë qytet. Kur të vijnë këtu, ata do të çlodhen dhe ju t'u krijoni mundësi që të njihen me kuriozitetet e qytetit.

Me kënaqësi të madhe pashë se këtu po riparohen me radhë shtëpitë e vjetra, që do të mbeten si monumente kulture. Këtë punë që keni nisur vazhdojeni. Kur të kthehem në Tiranë, do t'u kërkoj Byrosë Politike dhe Qeverisë t'i shtojnë akoma edhe ca fondet për këtë qëllim dhe, të merremi vesh, këtë do ta bëj jo si gjirokastrit, por si marksist, dhe jam i bindur që shokët do ta kuuptojnë drejt këtë propozim. Qëllimi është që me këto fonde të krijuhen mundësi që shteti, nga njëra anë, të bëjë riparime të rëndësishme në ndërtesat që janë pronë shtetërore, kurse nga ana tjetër qytetarët vetë të bëjnë riparimin e shtëpisë të tyre personale me kreditë që do t'u jepen me kushte të favorshme nga shteti.

Për pastërtinë brenda shtëpisë s'kam ç't'ju them, atë e keni merak vetë, sidomos ju gratë gjirokastrite, që, si gjithë motrat anembanë Shqipërisë, midis shumë meritave të tjera, pastërtinë e keni në gjak. Për këtë Partia ju falënderon, sepse pastërtia, përveç që është një shprehje e kulturës, ka të bëjë, në radhë të parë, me shëndetin e njerëzve, është çështje jete.

Por lidhur me pastërtinë s'duhet kufizuar vetëm brenda katër mureve të shtëpisë. Çdo qytetar e qytetare t'i vërë detyrë vetes për t'i lyer shtëpitë edhe jashtë, për të pyllëzuar kodrat dhe kopshtet e vogla rrëth shtëpisë, disa prej të cilave, vetëm nga një sy

i shpejtë që u hodha, vura re me kënaqësi se janë përmirësuar. Megjithatë brenda qytetit ka akoma bokërima, ku është mirë të mbillen lule të bukura me erë të këndshme, pemë për hije, si edhe pemë frutore, por jo ama çerçeme e lofata, siç mbillnin gjyshërit e baballarët tanë, apo kumbulla si të teto Çinesë dhe të Xhanos. Shumica nga ju jeni të rinj e nuk i keni njohur këto dy gra, por ato që janë të moshuara, i kanë njohur. Kur isha vetë i ri dhe veja të mbushja ujë me gjyma në krojet e Meçites¹, teto Çineja e teto Xhanoja më jepnin nga një grusht kumbulla aguridhe që më dukeshin mjaltë. Ato s'kishin fruta të tjera, se ishin të varfra, po ato që kishin, na i jepnin ne të vegjëlve që na donin shumë. Tashti kanë ndryshuar kohët, në nivelin e jetesës të njerëzve te ne janë bërë shumë përparime.

Meqenëse fola pak më parë për pastërtinë, dëshiroj të theksoj edhe një herë se për këtë Partia i falën-deron gratë gjirokastrite, pa përmendur pastaj që ato shquhen edhe për trimërinë, për vendosmërinë, për shpirtin përparimtar, si dhe për zotësinë e tyre në administrimin e mirë të të ardhurave të familjes.

Gjirokastritët janë kursimtarë dhe të kursesh nuk do të thotë të mbetesh pa ngrënë, por t'i administrosh të ardhurat e t'i shpenzosh me vend. Gjirokastriti jo vetëm për vete kurrë nuk ka kursyer për të ngrënë, por edhe mikun e ka pritur me bujari. Fjalën e kam këtu, që ekonomia duhet të jetë kurdoherë e organizuuar në mënyrë të atillë që të hash sot, po të men-

¹ Një nga lagjet e Gjirokastrës.

dosh që të kesh për të ngrënë edhe nesër, të hash çdo ditë e më mirë. Kështu duhet vepruar edhe në administrimin e pasurisë së të gjithë popullit. Partia na mëson ta administrojmë çdo gjë me ekonomi. Po të mos kishin një kujdes të tillë Partia dhe Qeveria, nuk do të bëheshin gjithë këto që u bënë gjatë këtyre 25 vjetëve në Shqipëri. Po kush i ngriti tërë këto vepra madhështore? Djersa, mendja dhe dituria juaj, e të gjithë popullit, pse këto fonde të mëdha në vlera monetare që janë investuar në të katër anët e atdheut, në fushat e ndryshme të ekonomisë e të kulturës, janë djersa juaj, merita juaj, po edhe merita e Partisë që ka ditur t'i akumulojë, t'i investojë dhe t'i shpérndajë me drejtësi të madhe popullore, e frymëzuar nga marksizëm-leninizmi.

Partia përpinqet që njerëzit tanë të janë të shëndetshëm. Për këtë qëllim duhet që, në radhë të parë, ata të ushqehen mirë, se kështu do të punojnë e do të mësojnë më shumë. Dhe puna e mësimi ata i forcojnë, i kalitin, u sjellin gëzim e lumburi. Ky gëzim i madh i njerëzve tanë, o Xhevati¹, duket edhe në vallet e bukurë që kërcen ti me shokë me aq shkathtësi, dhe në këngët si ato që dëgjuam mbrëmë, që tingëllonin aq bukur, kur ia morët shtruar e zgjatur, gjirokastritë. Këto këngë e valle duhet t'i mësojnë të gjithë.

Në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë dhe të punës së palodhur të popullit tonë trim e punëtor, janë bërë ndryshime të mëdha në mbarë jetën e vendit.

¹ Xhevati Avdalli, këngëtar populor gjirokastrit, që ndodhet në miting.

Përparime edhe më të mëdha do të bëhen në të ardhmen në të gjitha fushat. Partia, përveç sektorëve të tjerë, do t'i japë një rëndësi akoma më të madhe zhvillimit të bujqësisë socialiste. Nuk është nevoja t'ju numëroj këtu ç'është bërë në këtë sektor, se ju i keni parë e i keni dëgjuar vetë, por dua t'ju them se në këta pesë vjet dhe në ata që do të vijnë më pas, kjo bujqësi, që aktualisht konsiderohet e përparuar (dhe në fakt kështu është, se ka marrë rrugën e përparimit), do të ecë akoma më shumë. Shtimi i prodhimit bujqësor e blegtoral në të ardhmen do të arrihet duke hapur toka të reja, por sidomos nëpërmjet intensifikimit të bujqësisë. Fushat që populli, nën udhëheqjen e Partisë, i bëri kaq pjellorre, tash lypset të na jasin rendimente akoma më të larta. Ka kaluar koha kur fshatari ynë kënaqej me pak prodhime. Tani luftohet e do të luftohet vazhdimisht për ngritjen e pandërprerë të rendimenteve.

Vjet, vëllezër dhe motra, ne patëm suksese të mëdha në prodhimin e drithërave të bukës, sidomos në grurë e në misër. Kjo hapi perspektiva dhe e mbushi me besim të madh popullin, i cili mban mend mirë dhe bën krahasim me atë kohë, kur kënaqej me 8-9 kuintalë grurë apo 10-12 kuintalë misër për hektar. Por tash që kemi tharë këneta, që kemi ndërtuar një rrjet të gjerë ujitës, që kemi ngritur uzina për prodhimin e plehrave kimike, kapacitetin e të cilave do ta shtojmë akoma më shumë, tani që po rritim vazhdimisht mekanizimin e bujqësisë jo vetëm me traktorë, por me të gjitha mjetet e tjera të nevojshme, tani që shërbimet e ndryshme kulturore

kudo, në fusha dhe në male, po i kryejmë gjithnjë e më mirë, patjetër do të rriten më tej rendimentet në bujqësi e në blegtori. Prandaj në të ardhmen ne nuk do të kënaqemi me prodhimin e 18 apo 20 kuin-talëve grurë e misër për hektar, po do të luftojmë për më shumë.

Në sajë të masave që janë marrë e do të merren, bujqësia jonë po përparon nga dita në ditë. Tani po punohet për shtimin e mekanizimit dhe për përgatitjen e farërave të zgjedhura, sidomos të grurit. Parashikoj-më të sjellim në vendin tonë farëra të atilla, nga të cilat të arrijmë të marrim edhe 60 e 80 kuinalë misër për hektar. Të moshuarit që mbajnë mend ç'kalli mis-ri, i hollë si bizhgo dhe i vogël si cinxami, bëhej përpara në fushat këtu rrötull, të mos çuditen. Tash puna e madhe e kooperativistëve dhe e specialistëve, të cilët luftojnë për të vënë në jetë direktivat e Partisë për zhvillimin e bujqësisë, ka bërë që te ne të prodhohet misër i tillë, nga i cili në parcela prej disa hektarësh po merren me dhjetëra kuinalë për hektar. Prandaj, me mundësitë e mëdha që po krijojnë Partia dhe Qe-veria, del detyrë të sigurohen rendimente maksimale, me qëllim që të shtohet prodhimi e të përmirësohet çdo ditë, çdo muaj e çdo vit, gjithnjë e më shumë, jeta e njerëzve tanë të mrekullueshëm. Duke marrë prodhime më të larta për hektar në drithërat e bukës, do të kemi mundësi të lirojmë ca toka për kullota, për t'i ushqyer më mirë e për t'i pasur më të shëndetshme e prodhuese bagëtitë tona, sidomos lopët, të cilat të përpinqemi t'i bëjmë fabrika të vërteta qumështi, mi-shi e plehu.

Fshatarësia jonë kooperativiste ka bërë një hop të mirë në zhvillimin e blegtorisë. Ajo i kupton drejt porositë e Partisë dhe është e bindur në çdo gjë që i thotë Partia. Prandaj po punon çdo ditë e më shumë për t'u kriuar kushte sa më të mira bagëtive. Ky është një kuptim i drejtë politik i direktivave nga ana e fshatarësisë sonë heroike, besnike e Partisë. Të përpinqemi gjithnjë e më shumë për të shtuar e për të përmirësuar racat e bagëtive. Vazhdimeshit kemi sjellë e do të sjellim lopë race që prodhojnë 3 000-4 000 e më shumë litra qumësht në vit. Kontingjentet e para të këtyre lopëve që kanë ardhur tani edhe në rrethin tuaj, janë nga më të mirat. Partia ka bindjen se do t'i mbani me kujdes e do t'i rritni mirë. Raca të tilla ne do t'i përhapim në gjithë vendin.

Krahas bujqësisë e blegtorisë duhet t'i futemi me vrull të madh punës edhe për pyllëzimet dhe për zhvillimin e pemëtarisë. Nuk dua të zgjatem këtu, por dëshiroj të vë në dukje, sidomos, se prodhimi i frutave te ne është akoma i paktë, megjithëse dihet mirë rëndësia e madhe që kanë ato për ushqimin e popullit. Kur ishim ne të vegjël, pleqtë nga familjet e varfra pritnin sa të errej dhe në të mbaruar të pazarit shkoni për të blerë ndonjë kastravec nga ata të verdhët që mbeteshin pa shitur, se ishin më të lirë. Kështu bënин të gjithë të varfrit e qytetit kur donin të blinin zarzavate, pa sa për fruta, as që u shkonte në mendje, jo se nuk i hanin, po sepse nuk kishin me se t'i blinin. Kurse tani që Partia e ka ngritur mirëqenien e popullit, kur fuqia blerëse është rritur sepse të tërë punojnë, ne duhet të mendojmë që ta zhvillojmë me ritme

më të shpejta kultivimin e frutave dhe të perimeve jo vetëm në fusha, por edhe në kodra e në male. Pemët frutore ne duhet t'i shtojmë, t'u bëjmë shërbime të kulturuara, që të na japin prodhime të bollshme. Me shtimin e sipërfaqeve të tyre dhitë «do të qajnë» ca, po s'kemi q'tu bëjmë, ato në qytet s'ka pse t'i mbajmë, sepse na prishin pemishtet dhe gjelbërimin. Gjer tani ne mbill fidanë e dhitë ha. Mirëpo kështu nuk mund të shkohet, prandaj t'i gjelbërojmë qytetin dhe kodrat rreth tij. Për një zhvillim më të madh të pemëtarisë në të ardhmen e afërt do të bëhen investime akoma më të mëdha. Kooperativave bujqësore do t'u jepen ndihma të shumta materiale e teknike dhe do të mobilizohen kooperativistët frontalisht, me qëllim që vendin ta mbushim me fruta gjithfarësh, me agrume, me vreshta e me ullinj jo vetëm për nevojat e tregut të brendshëm, por edhe për eksport.

Këta objektiva do të arrihen me siguri edhe në rrithin tuaj, se Gjirokastra nuk është më e disave si përpara, ajo sot është e njerëzve të punës, të djersës, të mësimit dhe të pushkës, prandaj Partia duhet të mendojë për plotësimin e të gjitha nevojave të tyre, materiale e kulturore. Gjirokastra është sot një rrith industrial, bujqësor dhe me kulturë të zhvilluar. Pamja e saj ka ndryshuar e do të ndryshojë vazhdimi, prandaj banorëve të të gjithë rrithit u bie barra që kodrat e qytetit e të krejt rrithit t'i kthejnë në kopshtije, që arat të lulëzojnë e të bëhen pjellore, malat të pyllëzohen me pemë e me drurë të ndryshëm dhe bagëtitë të shtohen e raca e tyre të përmirësos het pandërprerë. Kjo kërkon që edhe këtu masat puno-

njëse, si ato të të gjithë vendit, të kontribuojnë në ecjen kaq të vrullshme përpara të mbarë atdheut.

Për sa i përket zhvillimit të industrisë, që është dega kryesore e ekonomisë sonë, përsëri nuk dëshiroj të numëroj ç'kanë bërë Partia dhe populli gjer tanë, por dua t'ju them se gjatë këtyre pesë vjetëve dhe atyre që do të vijnë ajo do të marrë një zhvillim të mëtejshëm. Qysh këtë pesëvjeçar po hidhen baza të rëndësishme për një përparim më të madh në industri-në minerare. Ç'pasuri të tjera të mëdha fshehin në gjirin e tyre këto male, nuk i dimë akoma, por hartat e vjetra gjeologjike tregojnë se nëntoka jonë ka shumë pasuri, vetëm duhet të punojmë me këmbëngulje që t'i gjejmë dhe t'i nxjerrim. Djemtë dhe vajzat tona gjeologe që punojnë në këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë, edhe në të ardhmen do të zbulojnë vendburime pasurish me vlerë.

Minierat tona janë me perspektivë shumë të mirë. Mineralet, duke filluar nga nafta e gjer te fosforitet, ne do të përpinqemi t'i përpunojmë në vend në një shkallë gjithnjë e më të lartë nga sa janë përpunuar deri tash. Për këtë arsyе do të ndërtohen akoma fabrika të tjera të mëdha, me qëllim që të mos i eksportojmë më bruto mineralet dhe nga ato të përfitojmë në radhë të parë vetë. Deri tash nuk kemi pasur mundësi të bënim më shumë, ndërsa këtej e tutje po krijohen gjithnjë e më mirë mundësi të tillë.

Sic e dini, në vendin tonë po ndërtohen e do të ndërtohen hidrocentrale të tjera të mëdha, uzina për shkrirjen dhe përpunimin e hekurit e të nikelic, do të shtohet kapaciteti prodhues i uzinave të plehrave ki-

mike, të çimentos e kështu me radhë. Ky proces vazhdon si një zinxhir i pandërprerë në vendin tonë. Dhe me të vërtetë, çdo fabrikë që ndërtojmë, e ndjek edhe ndërtimi i dy-tri të tjerave, por, duke ngritur këto, del nevoja edhe për sa e sa të tjera e kështu vazhdimesht, se këtë e kërkon domosdoshmëria e zhvillimit të ekonomisë sonë socialiste. Përpara në Gjirokastër kishte vetëm një farkëtar, që quhej Qato. Ai përpunonte hekurin në kudhër me forcën e krahut, se në atë kohë ekonomia e vendit tonë ishte në pikë të hallit. Sot djemtë dhe vajzat e Gjirokastrës e të mbarë Shqipërisë luftojnë dhe punojnë për të ngritur uzina të mëdha e moderne për përpunimin e mineraleve, sepse çdo vit krijohen ndërmarrje të reja ekonomike, ngrihen shkolla e spitale, zgjaten vijat hekurudhore, shtohen trenat, vaporët tanë që çajnë dete dhe oqeane, makinat, traktorët etj., etj., prandaj ne themi që ndërtimi i një vepre kërkon doemos tjetrën. Të tëra këto janë në ecje dhe ngrihen me vrull revolucionar nga populli ynë heroik, me Partinë tonë trime në krye.

Në kohën kur qeverisnin sundimtarët e egër dhe shfrytëzuesit e pamëshirshëm të popullit tonë, për Gjirokastrën thuhej: «S'të mban ky vend, ku ha pula strall», prandaj njerëzit përpinqeshin të largoheshin këtej. Natyrisht, vepronin kështu hallexhijtë, të cilët s'gjenin punë dhe s'kishin me se të rronin, që nuk sığuronin dot as bukën për familjet e tyre, kurse sarafi Mitat Ciu ose ndonjë tjetër si ai, si e qethën mirë e mirë popullin e Gjirokastrës, synonin të hapnin banka të mëdha, prandaj, së toku me agallarë të tjerë, iu lëshuan Tiranës që të rripnin njerëzit edhe ca më

tutje Gjirokastrës. Krejt ndryshe qëndron çështja sot, kur ka punë kudo dhe për të gjithë, prandaj nuk mund të mendohet si më parë.

Me vendosjen e pushtetit popullor, filloj të ndryshojë edhe Gjirokastra, si e gjithë Shqipëria. Tash ne shohim se këtu janë ndërtuar fabrika, ku punojnë me qindra e mijëra djem e vajza, burra e gra, të cilët, nga sa kam parë e siç më kanë thënë, punojnë mirë. Në të ardhmen e afërt në rrethin tuaj do të ndërtohen edhe fabrika e uzina të tjera, që do të ndihmojnë për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë.

Prandaj, duke filluar që tash, para jubileut të lavdishëm të 25-vjetorit të Çlirimit, punonjësve të rrethit tuaj u del detyrë të mobilizohen me të gjitha forcat për të realizuar e për të tejkaluar planet në bujqësi, në industri e në çdo sektor tjetër, çka do të thotë të fuqizohet potenciali ekonomik në mbarë atdheun tonë të dashur socialist dhe të vihen blloqe të tjera të çelikta në rrugën që na në komunizëm.

Të gjitha këto punë të mëdha që po bën populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, kërkojnë të ngrihet kurdoherë lart e më lart, në radhë të parë, nivel politik dhe ideologjik i çdonjërit, të ngrihet niveli arsimor e kulturor jo vetëm i disa qindra mijë të rinjve e të rejave, të cilët ndjekin shkollat, por i të gjitha masave punonjëse të vendit tonë. Secili prej nesh çdo problem që i del përpara për ta zgjidhur, çdo hap e veprim që bën, duhet të përpinqet ta gjykojë drejt politikisht e ideologjisht, të mendojë e të pyesë veten: «U shërben apo jo popullit dhe atdheut, kjo që bëj, u shërben Partisë dhe çështjes së socializmit?». Në

qoftë se bindet dhe arrin në përfundimin se i shërben, atëherë të thyejë çdo pengesë që mund t'i dalë përpara dhe mendimin e tij t'ua bëjë të njohur miqve, shokëve, masave, të diskutojë kudo së bashku me ta dhe të punojë me këmbëngulje deri në fund sa t'ia arrijë qëllimit.

Vëllezër dhe motra, planet që kemi përpara do t'i realizojmë dhe mirëqenia materiale, morale e shpirtërore e popullit do të ngrihet vazhdimesht e me ritme të shpejta. Kjo do të arrihet me siguri në qoftë se, siç thashë, mendon e punon i gjithë populli, i madh e i vogël. Partia e shikon çdo ditë e më qartë sa me perspektivë mendojnë të gjithë punonjësit e vendit tonë, sa thellë e drejt i gjykojnë ata çështjet dhe sa demokratikisht veprojnë. Ajo i ka futur gjithsecilit në gjak ndjenjën e përgjegjësisë, që të bëhen të ndërgjegjshëm jo vetëm një, dhjetë, njëqind ose një mijë njerëz, por të gjithë, prandaj edhe çdo njeri veças duhet të mendojë se është përgjegjës përfatet e popullit dhe të atdheut, se të gjithë «i kemi futur duart në brumë», kemi derdhur gjak e tani po derdhim djersë që punët te ne të ecin në rrugën e popullit e të Partisë, që njerëzit të rrojnë kurdoherë të lirë e të lumtur. Kur mësimet e Partisë përfatet të gjitha problemet bëhen mish e gjak i popullit, kur ato zbatohen drejt edhe në praktikë, me një kuptim të thellë politik e ideologjik dhe me bindje të plota nga të gjithë, ato kthehen në një forcë të madhe materiale.

Shokë dhe shoqe, shikoni ç'përpjesëtime të mëdha ka marrë zhvillimi i arsimit, i kulturës dhe i teknikës në vendin tonë! Kur flitnim përpara përfatet kuadro me

arsim të lartë, fjala vjen për ekonomistë, për mjekë, për inxhinierë, për agronomë, për mësues e të tjerë, mendonim me dhimbje sa pak kishim, kurse tani kemi me mijëra, mbasi universiteti dhe shkollat e tjera të larta e të mesme që kemi ngritur përgatitin kuadro çdo vit. Megjithatë nuk duhet të kënaqemi me rezultatet e arritura, bile gjumi të mos na zërë, se akoma kemi mungesa për kuadro, na duhen edhe mjaft të tjerë. Partia lufton tani që të mësojnë sa më shumë të gjithë, për arsyen se sa më të ditura të janë masat, aq më mirë është për zhvillimin e vendit, për lulëzimin dhe për forcimin e atdheut tonë. Ne synojmë që çdo njeri të dijë jo vetëm zanatin që ushtron, por, po të jetë e mundur, të dijë dy, tri, edhe katër zanate. Populli ynë e kupton ç'fitim të madh ka vendi, kur se cili mëson disa zanate. Prandaj është mirë që njeriu të mësojë edhe xhamën e vërë, edhe dërrasa të zdrugojë, edhe hekurin të farkëtojë, të mballosë këpucë etj. Dhe tani kemi shumë nga këta që janë përgatitur në kurse e shkolla.

Në nivelin e zhvillimit aktual të vendit del se shkollat ekzistuese, sado që janë shtuar e janë zgjeruar si kurrë ndonjëherë, nuk janë të mjaftueshme. Prandaj Komiteti Qendror dha direktiva për reformën arsimore, që ka për qëllim revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë. Këto direktiva ju i dini mirë, se keni marrë pjesë në diskutimin e madh popullor. Në këtë diskutim, për të dhënë mendime se si duhet të jetë shkolla, çfarë njohurish të merren atje, sa vjet të zgjatë ajo, ç'programe të ndiqen, ç'forma e metoda të përdoren etj., u angazhua i madh e i vogël.

Sa ndihmë të madhe, shokë, dhe vëllezër, u keni dhënë ju Partisë dhe Qeverisë me mendimet tuaja gjatë diskutimit për problemet e shkollës. Shumë nga ju ndoshta mendojnë se s'kanë dhënë ndonjë kontribut, përveç ndonjë mendimi të thjeshtë, po nuk është kështu. Duke bërë sumumin e asaj që ka shprehur secili, pra, duke i marrë në një të vetme të bashkuara të gjitha mendimet, del se ato përbëjnë një thesar të madh. Janë formuar kudo komisione që kanë shoshitur mendimet e popullit. Në to janë diskutuar si anët e mira, ashtu edhe të metat e vështirësitë që paraqiten në lidhje me mundësitet tona aktuale e të së ardhmes, të një të ardhmeje imediate dhe të mëtejshme.

Komisioni Qendror do t'u paraqitë së afërmi Byrosë Politike dhe Komitetit Qendror rezultatet e mrekullueshme të këtij diskutimi të madh popullor për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë, i cili do të bëjë që të gjithë pa përjashtim të marrin njo-huri akoma më të thella shkencore për të mirën e popullit, të atdheut e të socializmit, për të përgatitur për të ardhmen një rini edhe më të kulturuar e të shkolluar, të pastër, pa mbeturina të së kaluarës.

Me reformën e re arsimore ne do të përgatitim një rini të ditur, me mendje të zhvilluar, në radhë të parë një rini të punës e të sakrificës, që të ketë tiparet e klasës punëtore dhe të ecë me vendosmëri nën udhëheqjen e saj, e ndriçuar kurdoherë nga mësimet e Partisë. Kur ta kemi kryer mirë këtë detyrë, atëherë gradualisht do të arrijmë në atë fazë, kur do të zhdukjet dallimi midis njerëzve të punës mendore dhe atyre të punës fizike. Por për t'ia arritur kësaj,

do të duhen akoma punë e djersë, veç Partia dhe populli janë të bindur se ky objektiv do të arrihet me siguri. Rinia jonë do të edukohet në shkollën tonë të re me shpirtin e gjerë të klasës punëtore, me nerva të çelikëtë, me dashuri të zjarrtë për popullin e për Partinë, e gatshme në çdo çast për çdo detyrë dhe sakrificë, se vetëm kështu Shqipëria do të përparojë kurdoherë. Një rini të tillë Partia e ka rritur dhe po e kalit me ideologjinë marksiste-leniniste, që do të jetë shtylla kurrizore e shkollës sonë të re. Partia, si gjithë popullin, edhe rininë po e kalit që të jetë trime, e pushkës, në mënyrë që të rintjtë tanë në çdo moment që t'i kërkojë atdheu të jenë ushtarë të gatshëm të popullit dhe të Republikës.

Të gjitha këto janë një kombinim i harmonishëm i punës së Partisë, e cila synon që te ne i madh dhe i vogël jo vetëm të mësojnë e të punojnë, po të dinë të qëllojnë edhe me pushkë e me lloje të tjera armësh, që në bankat e shkollës secili të mësojë strategjinë dhe taktilën ushtarake të luftës popullore, eksperiencën e Luftës së lavdishme Nacionalçirimitare dhe eksperiencën e re që po përpunon Partia për t'i bërë ballë çdo rreziku që mund të kërcënojë atdheun, popullin dhe socializmin. Një kombinim të tillë të gjitha këtyre detyrave e perspektivave imperialistët, revisionistët, të gjithë armiqtë e vënë me keqdashje në dyshim. Ata thonë se është e pamundur të bëhen të gjitha këto, por e vërteta është që ne çdo ditë e më mirë po i bëjmë, prandaj populli është i entuziazmuar, i lumtur, i gjëzuar dhe i thotë Partisë: «Prina

Parti, se udhëzimet e tua na gjallërojnë, na kalitin zemrën dhe muskujt, na forcojnë shëndetin!».

Siq e shihni vetë, gjaku i të parëve dhe i shokëve tanë, gjaku i Çerçizit, i heroit tonë, nuk shkoi dëm. Duket sikur ai po na shikon nga piedestali dhe sikur i falënderon popullin e Partinë që po bëjnë gjithë këto mrekulli.

Situatat në vendin tonë dhe në botë janë revolucionare, në favorin tonë. Revolucioni është në ngjitje, dita-ditës po forcohet lufta e popujve për çlirim kundër imperializmit, kundër revizionizmit dhe gjithë reaksionit botëror. Armiqtë e socializmit po tronditen. Ata në pamje duken të fortë, kurse nga brenda janë të kalbur. Me gjithë gjendjen e vështirë që u është krijuar armiqve, njerëzve tanë nuk u lejohet të bien në gjumë. Partia e Punës e Shqipërisë dhe revolucionarët e popujt në mbarë botën, që janë ngritur në revolucion, duke analizuar gjendjen në dritën e marksizëm-leninizmit, shohin se pozitat e imperializmit amerikan, të revizionizmit sovjetik e të gjithë satelitëve të tyre sa vete e po dobësohen akoma më shumë, ndërsa forcat e revolucionit shtohen e forcohen vazhdimi. Megjithatë armiqtë nuk i hedhin armët që disponojnë, ata janë fashistë dhe aventurierë e pikërisht, duke i njojur mirë tiparet e tyre të egra dhe dinake, populli e Partia jonë, si dhe gjithë revolucionarët ku do që janë, nxjerrin konkluzione reale, marksiste-leniniste për gjendjen në botë, forcojnë vigjilencën dhe nuk flenë mbi dafina. Prandaj ata marrin masa mbrojtëse, kaliten e armatosen, në radhë të parë politikisht,

ideologjikisht, pastaj edhe ushtarakisht dhe ekonomikisht, përkrahin luftërat e drejta që bëjnë popujt e shtypur e të shfrytëzuar në të katër anët e botës. Armiqtë përpiken t'i shpëtojnë vdekjes, prandaj, si të gjithë ata, edhe revizionistët në krye të partive revisioniste dhe të shteteve të ish-demokracisë popullore të Evropës, përpiken t'u shpëtojnë jetën kapitalizmit, imperializmit amerikan dhe vetes së tyre.

Hrushovianët tashmë kanë hequr dorë përgjithmonë nga marksizëm-leninizmi; ekonomisë dikur socialistë, vetëm pamjen përpiken t'ia ruajnë të këtillë, se, në fakt, e kanë kthyer në një ekonomi kapitaliste. Ushtrinë e Kuqe që krijuan Lenini, Stalini dhe bolshevikët, ushtritë e vendeve të ish-demokracisë popullore revizionistët sovjetikë dhe klikat në fuqi në vendet e varura prej tyre i kanë kthyer në ushtri agresive, grabitqare e pushtuese, gjë që e vërtetoi më së miri agresioni kundër Çekoslovakisë. Tradhtarët revisionistë nuk do të mjaftohen me kaq, ata po bëjnë plane për të sulmuar vende të tjera, për të siguruar koloni të reja. Prandaj kanë forcuar e forcojnë dita-ditës aleancën me imperializmin amerikan.

Është e vërtetë se imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë kanë gjëra që i lidhin, por kanë edhe kontradikta që i ndajnë. Ajo që i lidh ata është lufta kundër popujve, kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, lufta kundër marksistë-leninistëve në botë, kundër lëvizjeve nacionalçirimitare të popujve dhe kundër revolucionit. Por midis tyre ata kanë edhe kontradikta të mëdha, sepse secili, kush më shumë e sa më parë, dëshiron të krijojë perandorinë

e tij të re, të kolonizojë e të shtypë popuj të tjerë. Pikërisht në këtë garë të shfrenuar atyre u lindin edhe mosmarrëveshje, të cilave u shtohen edhe grushtë i madh politik, ideologjik dhe forca jonë, e marksistë-leninistëve, lufta e klasës punëtore ndërkombe-tare, luftërat nacionalçirimtare, që ziejnë në të katër anët e botës.

Në këto situata imperialistët dhe revisionistët modernë bëjnë përgatitje të ethshme për luftë. Do t'ia arrijnë apo jo qëllimit, kjo është tjetër punë, vetëm një gjë është e sigurt: revolucioni ata do t'i shkatërrojë. Në qoftë se armiqtë e socializmit do të arrijnë të hapin luftë kundër nesh, ata do të shkatërrohen përgjithmonë dhe në botë do të triumfojnë socializmi dhe komunizmi.

Si revisionistët sovjetikë, ashtu edhe imperialistët amerikanë përpiken, para së gjithash, t'u hedhin zinxhirët aleatëve të tyre, t'i kenë ata mirë në zap, me qëllim që këta agresorë, së toku, të realizojnë ëndrrat e tyre. Mirëpo brenda kampit të secilit, kampit revisionist apo atij imperialist, shpërthejnë shpesh e vazhdimisht kacafytje në mes njëri-tjetrit. Shtetet kapitaliste që janë nën vargonjtë e imperializmit amerikan, si dhe revisionistët e vendeve të ish-demokracisë popullore, nuk mund të durojnë për një kohë të gjatë grushtin e hekurt të monopoleve amerikane apo të fashtëve të Kremlinit. Këto kacafytje karavidhesh i dobësojnë pozitat e armiqve në favorin tonë.

Kacafytjet midis krerëve revisionistë e kanë burimin në rritjen e pandërprerë të forcës revolucionare të vetë popujve të tyre, që mendojnë, luftojnë e

godasin dhe i bëjnë të tronditen klikat në fuqi brenda-përbrenda vendeve të veta. Edhe kjo është, gjithashtu, në favorin e revolucionit.

Ne na ka ndihmuar Bashkimi Sovjetik në kohën e Stalinit. Ju e dini mirë sa fort e kemi dashur ne Bashkimin Sovjetik, sa fort i kemi dashur Stalinin dhe Partinë Bolshevikke. Këtë e kemi bërë, sepse ata kanë qenë në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Stalini ishte një marksist i madh, një nga të katër klasikët e marksizëm-leninizmit. Bashkimi Sovjetik, në kohën që rronte ai, ishte në pozita të drejta, prandaj edhe ndihma që na jepej ishte internacionaliste. Për arsy se qëndrimet e Bashkimit Sovjetik në kohën e Stalinit ndaj vendit tonë dhe ndaj vendeve të tjera ishin të tilla dhe kurdoherë parimore, Partia dhe populli ynë kanë mbajtur atë qëndrim aq dashamirës ndaj tyre. Për hir të sakrificave dhe të rrugës së drejtë që ndiqte Bashkimi Sovjetik në kohën e Stalinit, ne ishim aleatë dhe miq nga më besnikët me të, por kur atje morën fuqinë në dorë tradhtarët hrushovianë, popullit dhe Partisë sonë u vihej detyrë e domosdoshme, e ngutshme, kombëtare dhe ndërkombëtare, t'u hapte luftë deri në fund, deri në shkatërrimin e plotë revisionistëve sovjetikë. Ne nuk bëjmë hipokrizi e lajka, po themi atë që kemi në zemër. S'e harrojmë kurrë ndihmën që na ka dhënë Bashkimi Sovjetik në kohën e Stalinit, por, gjithashtu, do t'i luftojmë gjer në vdekje tradhtarët e Bashkimit Sovjetik, të Partisë Bolshevikke, të marksizëm-leninizmit, të komunizmit, të Shqipërisë dhe të gjithë popujve.

Kush do të guxojë të prekë Shqipërinë socialiste,

do të gjejë vdekjen e sigurt. Cilido armik ose koalicion armiqsh goftë, e di tani mirë se duhet të mendohet shumë para se të prekë vendin tonë dhe, në goftë se nuk e di, ne i themi edhe një herë që kufijtë e vendit tonë janë të pakapërcyeshëm, kushdo që do të orvatet t'i cenojë ata, do të gjejë vdekjen.

Shqipëria sot nuk mposhtet, as nuk thyhet; ajo ka rezistuar dhe ka triumfuar në kohë të tjera shumë më të vështira e jo më tash që është fuqizuar një mijë herë më shumë, ndërsa armiqjtë tanë janë duke u kalbur. Megjithatë ne nuk flemë, nuk fle tërë Shqipëria, nuk flini as ju këtu, që jeni pranë kufirit, prandaj qëndroni ditë e natë vigjilentë, të armatosur, mësoni artin ushtarak, mbani kazmën në një dorë, po edhe pushkën kurdoherë afër, pse vetëm kështu ndërtohet socializmi, gjersa në botë ekziston e do të ekzistojë akoma rreziku imperialist dhe revizionist.

Shokë dhe shoqe, motra dhe vëllezër,

Në këtë situatë revolucionare, brenda dhe jashtë, duhet ta forcojmë akoma më shumë vendin tonë, unitetin Parti-popull. Ne nuk jemi luftënxitës, nuk kemi ndër mend të sulmojmë kurrikënd, përkundrazi, dëshirojmë të rrojmö në fqinjësi të mirë me shtetet që kemi në kufi, por kemi deklaruar dhe deklarojmë se politikisht dhe ideologjikisht kurrë nuk do t'i hedhim armët, kurrë nuk do t'i fshehim idetë tona. Ne nuk atakojmë njeri, bile shpeshherë kemi deklaruar se dëshirojmë të rrojmö në miqësi me popujt e këtyre ven-

deve, por nuk lejojmë në asnjë mënyrë ndërhyrje në punët tonë të brendshme. Ne jemi për bashkekzistençën leniniste revolucionare dhe jo për bashkekzistençën hrushoviane tradhtare, kuptimi i vërtetë i së cilës është që popujt të shuajnë luftën, të hedhin armët dhe këto t'i mbajnë vetëm fuqitë e mëdha kapitaliste e revisionistët.

Revisionistët duan të shuajnë luftën e proletariatit, kurse ne përkrahim luftën revolucionare të proletariatit që përpinqet të hedhë tej prangat e robërisë e të zgjedhës kapitaliste; ne luftojmë me mish e me shpirt kundër luftërave të padrejta imperialiste dhe grabitqare dhe jemi gati të derdhim gjakun e të ndeshem me të gjithë ata që janë për këto luftëra.

Revisionistët modernë, në bazë të politikës së tyre të «bashkekzistencës paqësore», gjoja bëjnë përpjekje për çarmatin, në një kohë kur armatosen ditë e natë, bëjnë vazhdimisht prova armësh bërthamore në të katër anët, në kontinente e oqeane. Me demagogji ata kërkojnë të na gënjejnë që të biem në gjumë, po Partia jonë nuk fle, atë kurrë nuk do ta zërë gjumi, popujt do të qëndrojnë vigjilentë, do të jenë kurdoherë të përgatitur dhe çdo ditë e më mirë do të përgatiten për mbrojtje, në qoftë se sulmohen nga agresorët.

Revisionistët sovjetikë dhe imperialistët amerikanë thonë se po përpiken të sigurojnë paqen këtu në Evropë, po Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik e bëjnë këtë për të sunduar të qetë mbi ne, që të bëjnë pastaj si të duan. Me gjithë manovrat që përdorin, nuk do t'ia arrijnë kurrë qëllimit. Ata s'na

i lidhin dot duart. Ne e kuptojmë ku e kanë qëllimin, e kuptojmë se duan t'i kenë krahët të lirë në Evropë.

Politika e Partisë sonë, vëllezër dhe motra, është e drejtë, parimore, luftarake. Për këtë arsyе populli ynë trim e ka përkrahur atë dhe punon, lufton e jep edhe jetën për këtë Parti e për vijën e saj të drejtë. Prandaj, me besim të patundur në të ardhmen tonë të lumtur, me mendjen, me djersën dhe me zotësinë tonë, të frymëzuar e të udhëhequr si kurdoherë drejt nga Partia jonë e dashur dhe e shtrenjtë, t'i vihem i punës me hov revolucionar, të realizojmë planet, të kapërcejmë çdo pengesë që na del përpara, të pastrojmë çdo mbeturinë dhe të krijojmë për popullin çdo ditë, çdo muaj e çdo vit një jetë më të begatshme. Kjo është një detyrë e shenjtë e të gjithëve. Me Partinë në krye, edhe në të ardhmen, ne do të korrim si kurdoherë suksese.

Më falni që ju mbajta në këmbë kaq shumë. Aneve që ju presin në dritat e shtëpive, u çoni nga ana ime përshëndetjet dhe ndjenjat e respektit që ushqej për to dhe u thoni se Enveri ju kërkon ndjesë që na mbajti kaq vonë, po kishte dy vjet pa ardhur dhe nesër i duhet të largohet.

Ju falënderoj edhe një herë për gjithë këtë dashuri të madhe që tregoni. Këto ndjenja të forta gëzimi dhe entuziazmi revolucionar i përkasin Partisë dhe vetëm Partisë.

Të rrojë Partia!

Të rrojë populli shqiptar!

Rrofshi dhe qofshi të lumtur e të gjëzuar në punë,
në mësime, në kalitje revolucionare, ju populli i Gji-
rokastrës!

Natën e mirë dhe mirupafshim!

*Botohet për herë të parë me
ndonjë shkurtim sipas origji-
nalit që gjendet në Arkivin
Qendror të Partisë*

TË JEMI TË ARMATOSUR ME ARMË, TË NGRITUR POLITIKISHT DHE TË MOBILIZUAR NË PUNË

Fjala në mitingun e qytetit të Tepelenës

29 maj 1969

Të dashur motra e vëllezër,

Komunistë dhe komuniste të Tepelenës,

Më lejoni, para së gjithash, t'ju sjell përshëndetjet e zjarrra revolucionare të Komitetit Qendror të Partisë, të Qeverisë, si dhe përshëndetjet e mia personale, t'ju përgëzoj pér luftën që po bëni dhe pér kontributin e madh që jepni në ndërtimin e socializmit, pér vendosmërinë tuaj në zbatimin e direktivave të Partisë.

Sa herë kalojmë këtej nga Tepelena, ne marrim forca të reja, se populli i kësaj krahine është një nga shtyllat e fuqishme të diktaturës sonë të proletariatit, besnik deri në fund i Partisë. Kur mësojmë që qyteti i lashtë historik i Tepelenës dhe kooperativat bujqësore, të ngritura në këto male të larta rrëth saj, lulëzojnë nga dita në ditë, na forcohet besimi se kauza e Partisë dhe e popullit kurrë nuk do të mposhtet, se mbarë populli dhe atdheu ynë do të ecin kurdoherë

përpara dhe do të jenë fanar ndriçues për revolucionarët e vendeve të tjera.

Vlera e një populli nuk matet as me madhësinë e territorit ku jeton, as me numrin e njerëzve që e përbëjnë, por me qëndrimet e tij; sa i zoti dhe sa i aftë është ai të mbijetojë dhe të çajë përpara, pa marrë parasysh furtunat e stuhitë e shekujve; sa u ka rezistuar, u reziston dhe mposht njërin pas tjetrit armiqjtë e shumtë; nëse di t'u bëjë ballë vështirësive e rrebesheve të kohëve me guximin, me mençurinë, me vitalitetin, me takтикën dhe me strategjinë e tij. Një popull i tillë, qoftë edhe i vogël në numër, siç është populli ynë, meriton të mbijetojë dhe me siguri do të rrojë përgjithmonë. Këtë populli ynë i vogël, por i pamposhtur në shekuj, e ka vërtetuar gjatë gjithë ekzistencës së vet e gjer sot.

Le t'i hedhim një sy të shpejtë historisë para erës sonë. Në këto anë ka pirë gji nga një nënë nga fisi i molosve të Epirit Aleksandri i Madh i Maqedonisë. Të parët tanë, ilirët, që i kanë dhënë shumë perandorë Romës, u kanë rezistuar hordhive të saj. Me perandorët ne nuk mburremi, ata le t'i quajnë romakët si të tyret, veç rëndësi ka fakti që këta njerëz kanë dalë nga gjiri i të parëve tanë.

Shkrimtarë realistë dhe historianë objektivë të shquar kanë shkruar se shqiptarët luajtën një rol të madh për shkatërrimin e Perandorisë Osmane. Populli shqiptar, nën udhëheqjen e Skënderbeut, i shpartalloi hordhitë e sulltan Muratit e të sulltan Mehmetit. Ushtritë legjendare të heroit tonë të pavdekshëm, për 25 vjet me radhë, u bënë mbrojtëse jo vetëm të popullit

tonë të vogël, por të të gjithë Evropës. Edhe pas vdekjes së Skënderbeut populli shqiptar nuk u përkul, përkundrazi, ai vazhdoi luftën me trimëri e me heroinëzëm nëpër male e gërxhe, në fusha e lumenj kundër shtypësve osmanë dhe hordhive të tyre, që dita-ditës, nga viti në vit e vazhdimit nuk i la të qetë, derisa fitoi pavarësinë kombëtare.

Ideologët dhe luftëtarët e Rilindjes sonë Kombëtare, të frymëzuar dhe të mbështetur nga masat e popullit, luftuan jo vetëm për lirinë e Shqipërisë, po u dhanë zemër edhe turqve të rinj që rrëzuan sultatin. Kështu, e lavdishme, vazhdoi historia legjendare e popullit tonë edhe më vonë, kur ai u ngrit me armë në dorë për të luftuar kundër qëllimeve grabitqare të shovinistëve fqinjë që kërkonin ta copëtonin Shqipërinë dhe të shkelnin mbi gjakun dhe eshtrat e dhjetëra mijë heronje të rënë gjatë shekujve. Por asnjë armik nuk mundi ta zhdukë dot Shqipërinë. Lakmitë dhe planet e tyre vazhduan, ne i pësuam kaq herë pasojat e rënda të pushtimeve të tyre, por kurrë nuk u mposhtëm.

Roli i Shqipërisë, lufta e pandërprerë e popullit tonë për çështjen e vet kombëtare, me pushkë dhe njëkohësisht me penë, me dituri e me politikë, edhe përpëra ka kontribuar fuqimisht në planin ndërkombëtar, në të gjitha periudhat historike që përmenda shkurtimisht më lart. Armiqtë janë orvatur vazhdimisht ta shtypin këtë popull që u gërryente themelët. Lufta, zëri i tij për të drejtën janë dëgjuar kurdoherë dhe kudo. Për të kanë folur papa i Romës, perandori i Francës, mbreti i Anglisë e, natyrisht, edhe sultani.

Dhe në këtë luftë të madhe, të përgjithshme të popullit shqiptar (dua t'ju flas me fakte historike dhe jo për t'ju bërë qejfin), gjyshërit e stërgjyshërit tuaj, vëllezër e motra të dashura të Tepelenës, kanë dhënë një kontribut të çmuar gjatë gjithë historisë, që Shqipëria të rronte, të lulëzonte dhe zëri i saj të dëgjohej i fortë në botë. Të parët tuaj, si gjithë populli ynë, kanë luftuar pandërprerë nëpër këto male bashkë me Skënderbeun, ashtu sikurse edhe pas vdekjes së tij, kundër hordhive të egra të sulltanëve turq.

Pikërisht këtu në Tepelenë ka lindur Ali Pasha, i cili ishte vërtet një feudal i madh e satrap, por edhe një politikan i zgjuar, që i vuri dërmën perandorisë së sulltanëve. Bota evropiane e vlerësonte Ali Pashën e Tepelenës në kohën e vet. Historitë dhe enciklopeditë e Evropës flasin në mënyrë të veçantë për Tepelenën dhe tregojnë se si Aliu, për qëllimet e tij feudale, u ngrit kundër sulltanëve dhe krijoi pashallëkun e Janinës, të cilin e fuqizoi mjaft. Ai synonte ta shkëpuoste fare pashallëkun e tij nga Perandoria Osmane, mundësishët ta lidhte edhe me Veriun, me pashallëkun e Shkodrës, që sundohej atëherë nga Bushatlinjtë. Kjo ishte një politikë e zgjuar që bënte Aliu. Këtë politikë e njihte mirë edhe perandori i francezëve, Napoleon Bonaparti, ushtaraku dhe takticieni i shquar që pushtoi gjithë Evropën dhe u bë tmerri i anglezëve, i gjermanëve, i austriakëve dhe i rusëve, por që, më së fundi, përfundoi syrgjyn në ishullin e Shën Elenës. Kur ishte në kulmin e fuqisë, Napoleoni dërgoi ambasadoret e vet për të bërë aleancë me Ali Pashën, që e konsideronte ashtu siç ishte, një faktor të rëndësishëm,

pa përkrahjen e të cilit pozitat strategjike të sundimit francez në brigjet lindore të Mesdheut viheshin në rrezik. Në arkivat e Parisit janë gjendur dokumente me rëndësi, të shkruara nga Napoleoni, ku ai porosit të deleguarin e vet, gjeneralin Donzëlo, që komandonte në atë kohë forcat franceze në Korfuz, të përpinqej për t'u lidhur me Ali pashë Tepelenën, por, njëkohësisht, të kishte edhe mendjen se mos ky politikan i madh, siç e vlerësonte ai, e fuste në thes, në qoftë se gjer në kohën që do të merrte letrën, s'e kishte futur akoma.

Lufta e Ali Pashës kontribuoi për fitoret e para të kryengritjes greke në vitet 1821-1822 dhe, me gjithë konfliktet që kishin ndodhur midis Aliut dhe një pjese të popullsisë greke, udhëheqësit e kryengritjes greke i shkruanin Ypsilantit të bashkoheshin me Aliun e Tepelenës, t'u bënин thirrje trimave shqiptarë, Çaparajve të Çamërisë dhe shqiptarëve të Moresë që të ngriheshin së bashku në kryengritje. Ata u bënин thirrje kryengritësve grekë të harronin ato që u kishte bërë Aliu, se vetëm me ndihmën e tij e të shqiptarëve do të mund të dilnin triumfues.

Të gjitha këto ngjarje, shoqe dhe shokë, kanë të bëjnë me historinë e kohëve të kaluara. Por epopeja më e shkëlqyer e popullit shqiptar është Lufta e madhe Nacionalçlirimtare që udhëhoqi Partia.

Kjo luftë ishte vendimtare, pse bëri të mundur jo vetëm të shporrnim pushtuesit fashistë italianë dhe nazistët gjermanë, por të shkatërronim njëherë e përgjithmonë klasat shfrytëzuese e sunduesit brenda vendit, bejlerët, agallarët, fajdexhinjtë, tregtarët e gjithë

plehrat e mbeturinat e tjera të historisë dhe i dha kështu mundësi popullit shqiptar për herë të parë të krijojë shtetin e vet të demokracisë popullore. Kjo luftë e madhe u bë nën udhëheqjen e Partisë së lavdishme Komuniste të Shqipërisë, sot Partia e Punës e Shqipërisë. Tani vendi ynë jeton i lirë dhe ndërton me sukses socializmin. Ai, duke jetuar dhe duke luttuar në socializëm jo vetëm kapërceu rreziqe të tmerrshme e të panumërtë, gjatë të cilave populli tregoi si asnijëherë vitalitetin dhe trimërinë e tij, por u bë edhe një shembull për popujt e tjerë.

Edhe në këtë epope të madhe të pakrahasueshme shquhet lufta e popullit trim të Tepelenës. Gjatë Luftës Nacionalçirimitare shkëlqyen si drita e diellit trimëria, zotësia, mençuria juaj. Ju, si i gjithë populli shqiptar, që kurrë nuk e kishit ulur kurrizin gjatë shekujve, i thatë Partisë: «Na prij përpara, ne na ke kurdoherë me pushkë në dorë e të patundur si shkëmb graniti, barutin do ta hamë me grushte, veç armiqtë do t'i mposhtim dhe Shqipërinë do ta çlrojmë, do ta bëjmë të bukur, të lulëzuar». Dhe me të vërtetë, i madh e i vogël nga këto male e shkrepët u vërsulën me zjarr në gji kundër armiqve fashistë italianë, kundër nazistëve gjermanë dhe bashkëpunëtorëve të tyre, tradhtarëve të Ballit Kombëtar. Me fjalën e Partisë, që shprehte dëshirat e popullit tonë të vuajtur, me idealin e saj që ishte ideali i popullit, partizanët trima të Tepelenës formuan çeta, batalione e brigada dhe lufta e tyre shpërtheu me furi të papërmabjtor si vullkani që lëshon zjarr.

Në Luftën Nacionalçirimitare patëm edhe viktima,

motra dhe vëllezër, na u vranë me dhjetëra e qindra shoqe dhe shokë edhe nga rrethi juaj, por kjo ju s'ju përkuli aspak, sepse lufta për çlirimin e Shqipërisë ishte për ju mbi gjithçka. Kur plakut patriot të Progonatit, Zenel Haskajt, i dhanë lajmin për vrasjen e të birit, Heroit të Popullit Asim Zeneli, këtij djali të Progonatit dhe të Partisë, i cili luftoi me trimëri dhe u bë pishtar në Mezgoran, ai hodhi një sy rreth e rrotull dhomës dhe i tha djalit tjetër: «Sherif, s'kemi nge të qajmë, bir, po rrëmbe shpejt pushkën, shko lufto kundër armikut dhe zër kështu me nder vendin e Asimit». Nga kjo krahinë na u vranë, gjithashtu, Mustafa Matohiti, Abaz Shehu e dhjetëra e qindra dëshmorë të tjerë, bija e bij heroikë të popullit të rrethit tuaj. Por në Tepelenë, si në të gjitha anët e Shqipërisë, një binte, dhjetëra ngriheshin, se e tillë ishte lufta e popullit që udhëhoqi Partia. Ne sot, por edhe brezat që do të vijnë pas, do të përulemi kurdoherë me respekt përpara veprës së pavdekshme të dëshmorëve; ata do të janë kurdoherë pishtarë, që do të na ndriçojnë vazhdimesht rrugën neve dhe brezave që do të vijnë, për të kryer detyrat e mëdha që na dalin përpara.

Detyra jonë e madhe është tanë të ndërtojmë plotësisht socializmin dhe të kalojmë gradualisht në shqërinë pa klasa, në komunizëm. Këtë do ta arrijmë medoemos, se të tillë janë vullneti dhe dëshirat e popullit shqiptar, e tillë është forca e tij, e tillë është dhe Partia e Punës e Shqipërisë që e udhëheq atë me lavdi. Dhe sot, në përpjekjet e mëdha që po bën populli shqiptar për ndërtimin e socializmit, punonjësit e

rrethit të Tepelenës qëndrojnë, gjithashtu, në radhët e para.

Të gjithë e dinë se Partia jonë mishëron dëshirat tuaja të zjarrta. Ajo përbëhet nga djemtë dhe bijat më të mira të popullit. Partia do t'i realizojë me sukses detyrat e mëdha që ka marrë përsipër, për arsyse se vija e saj përfaqëson vullnetin e masave dhe ndriçohet nga ideologjia e pamposhtur e marksizëm-leninizmit, prandaj ajo gjen mbështetjen e plotë të mbarë popullit shqiptar.

Ideologjia e Partisë është shpirti i luftës së klasës punëtore, që është e destinuar të mposhtë imperializmin, kapitalizmin, borgjezinë, shoqërinë e vjetër gjakpirëse dhe të ndërtojë shoqërinë socialiste e, më vonë, atë komuniste. Marksizëm-leninizmi është shpirti i klassës që na udhëheq ne dhe revolucionin kudo në botë. Partia e Punës e Shqipërisë është pararoja e çeliktë, është maja e shpatës sonë, prandaj që kjo të godasë fort mbi armiqjtë (siç punonte shpata e Gjolekës, që «godiste si vetëtimë» dhe «i ndriste atij pëqinë»), duhet të jetë e kalitur në zjarr e në hekur, të jetë e pathyeshme. Partia jonë kërkon që komunistët, anëtarët e saj, të jenë njerëz të çeliktë, të parët që të hidhen në zjarr, të parët në sakrifica, por, njëkohësisht, edhe të punës, të djersijnë, të lodhen, të jenë të gatshëm të japidhët në çdo moment edhe jetën, po të jetë nevoja, të jenë kurdoherë të thjeshtë, shembull pozitiv për popullin. Komunistët duhet të pajisen me virtutet më të mira të popullit: të jenë të drejtë, të ndershëm, të kuptueshëm e të dashur me të, të rreptë e të pamëshirshëm me armiqjtë. Që populli të ndërtojë

jetën e tij të lumtur e të arrijë kurdoherë suksese, duhet që komunistët, në radhë të parë, t'i futin duart e këmbët në vaj e në baltë dhe barutin, si gjithë populli, ta mbajnë kurdoherë të thatë. Në rrethin tuaj ne kemi një organizatë partie të fortë, të çeliktë e besnikë gjer në fund ndaj popullit, me komunistë të dalë nga gjiri juaj e të kalitur në zjarr e në beteja.

Për Partinë dhe për popullin tonë është sukses që me luftën që po bëhet kundër mbeturinave të së kaluarës, ato po shpartallohen. Një nga këto mbeturina ka qenë edhe qëndrimi jo i drejtë ndaj gruas, edhe ndaj gruas heroike të këtyre maleve. Gratë shqiptare, e veçanërisht ato të Labërisë, kanë luftuar krah për krah me burrat, ato kanë pritur e kanë përcjellë partizanët, u kanë lidhur plagët, por kanë marrë edhe vetë dyfekun në dorë, duke mbushur radhët e çetave e të brigadave. Ne partizanëve gratë shqiptare na kanë mbajtur fryshtë gjallë, duke ndarë me ne edhe krodhën e bukës; ato u lagnin buzët shokëve tanë të plagosur dhe u qëndronin pranë si bijve e vëllezërve të tyre. Këtyre trimëreshave të Shqipërisë që lindin jetën, që janë kaq të zgjuara dhe përparimtare, Partia u dha të drejta të barabarta me burrat. Në çdo front gratë po zënë vendin që meritojnë dhe gjithë respektin e gjithë shoqërisë jo vetëm se kështu këshillon Partia, por sepse ato vetë, me luftën, me punën e palodhur, me zotësinë e tyre, e meritojnë të respektohen nga burrat. Të gjitha detyrat që u ngarkohen, shoqet i kryejnë më së miri.

Në radhë të parë dhe sipas rregullave, duhet të punohet që ato të futen më shumë edhe në radhët e

Partisë, pse janë të gatshme të punojnë dhe me punën e tyre të tregojnë se e meritojnë të jenë anëtarë partie, pse i kapërcejnjë me heroizëm, nganjëherë edhe më mirë se burrat, të gjitha provat që kërkohen. Është një gëzim i madh për popullin që gratë tona, gratë heroike të Shqipërisë, në përgjithësi, dhe të Tepelenës, në veçanti, po mbushin tanë radhët e Partisë, e thonë me dinjitet fjalën e tyre në jetën politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të vendit.

Partia dhe populli ynë, pasi siguruan pozitat politike, ideologjike, shoqërore dhe ekonomike, me vendsjen e diktaturës së proletariatit, iu përveshën një pune të madhe për ndërtimin e bazave të socializmit. Kanë kaluar 25 vjet nga dita e çlirimtë të vendit, por këto kanë qenë vite luftërash në çdo fushë. Armiqtë nga të katër anët u përpoqën jo vetëm të na pengonin në rrugën tonë, por edhe të na sulmonin. Mirëpo të gjitha përpjekjet, dallaveret dhe intrigat e tyre dështuan përpara forcës së pathyeshme të popullit dhe të Partisë, përpara drejtësisë dhe unitetit të tyre të çeliktë. Intrigat e revisionistëve jugosllavë, me tradhtarin Tito në krye, për ta pushtuar Shqipërinë, për ta bërë skllave dhe për të sjellë në fuqi njerëzit e tyre, dështuan, pse Partia dhe populli ynë u qëndruan me guxim.

Edhe imperialistët italianë, që i kemi thyer në truallin tonë, si në Luftën e Vlorës, kur qindra shqiptarë, me Selam Musa Salarinë në ballë, kapërcyen te lat me gjemba për të kapur topat nga gryka, i dërrmuam përsëri edhe një herë në vitet e Luftës Nacional-çlirimtare. Megjithatë, ata nuk i pushuan intrigat kundër vendit tonë, përkundrazi, tok me imperialistët

anglezë dhe amerikanë, bënë një mijë e një orvatje për ta shkatërruar pushtetin e ri të demokracisë popullore në Shqipëri. Por populli dhe Partia përsëri i dërrmuani bashkë me gjithë pasuesit e tyre.

Një sërë aksionesh të rrezikshme ndërmorën kundër vendit tonë edhe monarko-fashistët grekë, të cilët u orvatën sidomos të na sulmonin kufijtë, mirëpo heronjtë e ushtrisë sonë, të dalë nga shkolla e Luftës Nacionalçlirimtare, mbrojtën të pamposhtur pëllëmbë më pëllëmbë tokën tonë të shenjtë përkëtej kufirit. Monarko-fashistët grekë dhe organizatorët e tyre anglezë, përpëra rezistencës së madhe heroike të ushtrisë dhe të popullit shqiptar në kufi, u tërhoqën me turp. Imperialistët anglezë u detyruan më vonë të tërhiqeshin nga Greqia, t'u lëshonin vendin amerikanëve, pse e shihnin që me forcat e tyre nuk ishin në gjendje t'i bënin ballë kryengritjes së popullit grek. Ne e kemi për nder të themi se, me aq sa mundëm, i ndihmuam partizanët grekë, por gabimet që bënë udhëheqësit e tyre penguan fitoren e popullit grek.

Në këto kushte të vështira, në sajë të mobilizimit e të punës së pashembullt të popullit, të udhëhequr nga Partia, me ato forca të pakta dhe me atë varfëri të madhe që trashëguam, por me bindje dhe me besim të patundur, u bë rindërtimi i vendit të djegur e të përvëluar nga lufta.

Ne e kemi thënë dhe përsëri e themi se në luftën tonë kemi pasur ndihmën e Bashkimit Sovjetik. Prandaj u jemi mirënjohës Stalinit dhe popullit sovjetik që ndihmuani luftën çlirimtare të popujve dhe të Shqipërisë nga fashizmi. Megjithatë, në qoftë se nuk do të

kishim luftuar vetë trimërisht dhe gjer në fund, sikurse luftuam, pavarësisht nga dëshira dhe nga përpjekjet e Stalinit, që, si një marksist-leninist i madh që ishte, e donte dhe e përkrahte me gjithë zemër popullin tonë, Shqipëria nuk do të ishte çliruar.

Lenini dhe Stalini e kanë çmuar ndihmën internacionale që dhanë proletariati dhe mbarë popujt e botës për Revolucionin e Madh Socialist të Totorit. Lenini ka theksuar se ky Revolucion fitoi në sajë të luftës së proletariatit rus, por edhe se u ndihmua nga mbarë proletariati botëror. Edhe Bashkimi Sovjetik e Stalini, që ndihmuar popujt të çlironen nga fashizmi, kanë njojur e kanë deklaruar shpeshherë se popujt e tjerë kanë ndihmuar në fitoret e popullit sovjetik.

Pas Çlirimtë vendit tonë Bashkimi Sovjetik dhe Stalini na kanë ndihmuar politikisht dhe ekonomikisht, natyrisht, me aq sa i lejonin mundësitë e pasluftës, se në atë kohë ata ishin në kushte të vështira edhe për vete, të djegur e të shkatërruar. Ndihma e tyre ishte internacionale.

Sido që të jetë, ndihma e miqve është e vogël përpëra forcës së madhe të popullit. Është ky faktor vendimtar, i cili, nën udhëheqjen e Partisë, me punën dhe me mendjen e tij, ndërton vepra madhështore. Në Shqipëri janë ngritur vepra të shumta në sajë të vijës së drejtë të Partisë, me djersën e ballit të njerëzve tanë, me sakrificat e shumta të popullit, me komunitët në ballë.

Ju e mbani mend vrullin e madh që shpërtheu pas Çlirimtë, kur filluam të ngrinim nga hiçi industrinë, e cila gati nuk ekzistonte, të mëkëmbnim buj-

qësinë, të bënim Reformën Agrare për t'i dhënë fshatarit tokën e për të shkallmuar mbeturinat e feudalistimit, zgjedhën e bejlerëve e të agallarëve. Armiqve të klasës, pasi i groposëm politikisht, u konfiskuam të gjitha pasuritë, u hoqëm kështu nga duart fuqinë ekonomike dhe i dërguam të hapnin kanale. Të gjitha këto u bënë me mençuri, me pjekuri, por me këmbëngulje, duke u bazuar në një politikë të drejtë, që populli të shihte qartë e të kuptonte rrugën që duhej të ndiqte, shkallët që duhej të ngjiste njëren pas tjetrës në çdo drejtim. Partia ia bëri të qartë popullit se çdo gjë është e tij, se ai tani është zot në vendin e vet. Ajo punoi që populli ta kuptonte drejt politikën e saj në industri, në bujqësi e në çdo sektor tjetër; të kuptonte qëllimet dhe karakterin e Reformës Agrare dhe perspektivat e zhvillimit të bujqësisë. Dhe populli ynë, i zgjuar e i lidhur ngushtë me Partinë, i kuptoi drejt të gjitha masat revolucionare që u morën për të mirën e tij, përpjekjet dhe synimet e Partisë; i vuri shpatullat punës dhe krijoj këtë situatë kaq të bukur që gëzojmë sot dhe që nesër, me siguri, do ta çojmë akoma më tutje drejt një lulëzimi më të madh.

Gjatë kohës që ne në qytet dhe në fshat ndërttonim me sukses socializmin dhe kalitnim aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, në Bashkimin Sovjetik ndodhi tradhtia e madhe. Armiqtë e komunizmit, të fshehur vite me radhë në Partinë Bolshevikë dhe në pushtetin sovjetik, pas vdekjes së Stalinit, me puqe dhe me komplotë, morën fuqinë në dorë. Ky ishte një moment i rrezikshëm për mbarë popujt, për revolucionin, për luftërat nacionalçlirimtare dhe për

Shqipërinë. Partia jonë, si një parti marksiste-leniniste, luftarake e vigjilente, e pa me vend se duheshin demaskuar dhe luftuar gjer në fund tradhtarët revisionistë, të cilët vazhdonin të punonin të maskuar në Kremlin. Ajo ishte e para që iu kundërvu veprimtarisë armiqësore të revisionistëve sovjetikë, prandaj midis saj dhe atyre filloi një luftë e egër. Pas vdekjes së Stalinit u zbulua gjithnjë e më qartë karakteri i «ndihmave» që revisionistët sovjetikë i jepnin vendit tonë. Ato ishin helm, se kishin qëllime skllavëruese. Tradhtarët hrushovianë dëshironin skllavërimin tonë ekonomik, përpinqeshin që popullin dhe komunistët shqiptarë t'i sundonin kur të donin e si të donin, ata kërkonin që ne të mos e ngrinim zërin, përkundrazi, t'u nënshtron heshim, se gjoja rronim në sajë të tyre, sikur ata na mbanin me bukë, siç na e thanë haptazi në mbledhjen e vitit 1960 në Moskë.

Partia që i njihte mirë taktikat dhe tradhtinë e tyre, mori parasysh çdo gjë dhe e demaskoi tradhtinë revisioniste. Për këtë arsyе hrushovianët shkelën në mënyrë arbitrale të gjitha marrëveshjet ekonomike dhe ushtarake e filluan luftën politike kundër nesh. Por populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, nuk u tremb. Shqipëria e vogël u ngrit e tëra në këmbë kundër tradhtisë së madhe të revisionistëve sovjetikë. Kjo i frymëzoi revolucionarët dhe mbarë popujt e botës, që pyetnin veten të habitur se si është e mundur që një vend i vogël si Shqipëria t'i qëndrojë një kolosi aq të madh. Shqipëria jo vetëm qëndroi, por zhvilloi e zhvillon me konsekuençë një luftë të gjatë e të ashpër kundër revizionizmit, pse forcën e gjen tek ideologjia

jonë e pamposhtur, marksizëm-leninizmi. Krerët e Kremlinit që e tradhtuan këtë ideologji, na «qanë hallin» në Moskë se gjoja ne nuk mund të qëndronim në fuqi as pesë ditë pa përkrahjen e tyre dhe na kërcënuan të mendoheshim mirë, mbasi ata janë fuqi e madhe. Por ne, duke u mbështetur në guximin, në patriotizmin e lartë, në dashurinë e popullit tonë për Partinë dhe në besimin e patundur te marksizëm-leninizmi fitimtar, u thamë se populli shqiptar nuk nënshtronhet, se ai do të luftojë gjer në fund e do t'i ruajë të gjitha fitoret dhe, në radhë të parë, pushtetin popullor, se Partia e Punës e Shqipërisë do të forcohet e do të rrojë në shekuj, ndërsa ju do të shkatërroheni. Ne nuk kemi frikë nga fuqia juaj e madhe dhe ju paralajmërojmë që këtu në Kremlin se, po të guxonit të prekni Shqipërinë, do të gjeni vdekjen. Duke ua përplasur të vërtetën në fytyrë, u ngritëm dhe u larguam nga Mbledhja e 81 Partive.

Kur revisionistët sovjetikë e panë se nuk ia dolën mbanë as me kërcënime, filluan nga lajkat, na prem-tuan traktorë, fabrika të reja etj., etj., por ne nuk pranuam asgjë, nuk ramë në kurthin e tyre, u thamë se shqiptari nuk blihet me para, ai pranon të ushqehet edhe me bar, bile, po ta kërkojë interesit i atdheut, edhe të vdesë nga uria, por kurrë nuk përkulet dhe pushkën nuk e lëshon nga dora.

Derisa në botë do të ketë armiq imperialistë dhe revisionistë, ne duhet të qëndrojmë të gatshëm, të armatosur më së miri jo vetëm me armë, por edhe me taktkë e strategji revolucionare, të jemi të ngritur politikisht dhe të mobilizuar me të gjitha forcat në

punën për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut. Të gjitha sa përmenda Partia jonë i zhvillon në shkallë të gjerë, me temp revolucionar dhe duke mbajtur kurdoherë lart vigjilencën.

Ju, vellezër dhe motra, e shikoni vetë se me ç'vrull të madh revolucionar ndërtohen te ne me mendjen, me punën dhe me djersën tonë fabrika, kombinate e hidrocentrale të fuqishme moderne. Hov të madh ka marrë sidomos zhvillimi i minierave. Këtu afér, në Memaliaj, kemi një kolektiv minatorësh nga më të dalluarit që punojnë me vetëmohim për nxjerrjen e qymyrgurit, i cili ka rëndësi të madhe për ekonominë tonë socialiste. Memaliaj është një nga qendrat më të fuqishme të klasës sonë punëtore, me minatorë dhe me komunistë të çeliktë, që punojnë pa u lodhur ditë e natë nëpër galeri për të nxjerrë nga nëntoka qymyr për fuqizimin e mëtejshëm të Shqipërisë socialiste. Zgjerimi i minierave, që nga ato të qymyrit e deri tek ato të fosforiteve, kërkon shtimin e fabrikave e të uzinave të reja për përpunimin e këtyre pasurive të mëdha. Për këtë qëllim, përveç veprave që jemi duke ndërtuar, sipas planit të katërt pesëvjeçar, në të njëjtën kohë po studiojmë dhe po marrim masa edhe për ndërtimin në kohë të fabrikave, të uzinave e të hidrocentraleve të reja që do të ndërtojmë në vitet e ardhshme.

Plani i ri pesëvjeçar që po përpunohet tani nga Komiteti Qendror i Partisë dhe nga Qeveria parashikon të ndërtohen fabrika dhe kombinate të tjera akoma më të mëdha e më moderne se këto që kemi. Do të vijë dita që linja hekurudhore të arrijë deri këtu

në Memaliaj. Këtë e kërkon nevoja e zhvillimit të Shqipërisë së re socialiste që po ecën me vrull përpalla. Ne kemi ngritur dy-tri rafineri nafte, por këto nuk janë të mjaftueshme, mbasi nevojat e vendit kërkojnë që këtë produkt të mos e shesim më bruto në tregjet e huaja, por ta përpunojmë në vend. Pikërisht përkëtë arsyen kemi vendosur të ndërtojmë një rafineri moderne në Ballsh, e cila do të përbëhet nga një kompleks i tërë fabrikash. I gjithë prodhimi i kësaj vepre nuk mund të transportohet me automjete në të katër anët e vendit, prandaj del nevoja që hekurudha të shkojë edhe në Ballsh¹. Në vendin tonë janë zbuluar edhe rezerva fosforitesh, të cilat mendojmë të përpunohen në vend. Uzina e Plehrave Fosfatike në Laç, pavarësisht se kapaciteti i saj do të rritet, nuk do të konsumojë gjithë sasinë e fosforiteve që do të nxjerrim, prandaj koha do të kërkojë ndërtimin e një uzine tjetër për prodhimin e plehrave fosforike.

Zhvillimi i minierave dhe përpunimi i mineraleve të nxjerra prej tyre kërkon ngritjen e degëve të reja të industrisë. Ky zhvillim do të arrihet me një ritëm akoma më të shpejtë në vitet që vijnë, por të gjithë e kuptojmë se këto vepra madhështore nuk realizohen lehtë, për ndërtimin e tyre duhen shumë punë, djerësë, po edhe njojuri të thella shkencore.

Zhvillimi i industrisë sonë të re moderne e karritur shumë forcën ekonomike të vendit, gjë që do të ndihmojë edhe përparrimin me ritme akoma më të shpejta të bujqësisë në këta pesë vjet dhe në pesë

vjetët e ardhshëm, pse po krijohen mundësi për t'i marrë tokës më shumë prodhime në drithëra, në bimë industriale, në pemëtari, në lëndë druri nga pyjet etj. Përparimi i bujqësisë sonë është bërë kryesisht në sajë të procesit të kolektivizimit, i cili te ne u zhvillua dalngadalë, por me pjekuri. Tani Partia po vazhdon me kujdes punën për bashkimin e kooperativave të vogla në më të mëdha. Kjo masë do të ndihmojë që në kooperativat e zmadhuara të bëhet një kombinim më i mirë i bujqësisë me blegtorinë, bimët e ndryshme të harmonizohen dhe, si rrjedhim, të ngrihen më lart rendimentet. Ky proces do të vazhdojë me vite, derisa të kemi një bujqësi me të vërtetë moderne. Për t'ia arritur këtij qëllimi ne duhet të shtojmë akoma më shumë mekanizimin, sipërfaqet e ujitshme dhe plehrat kimike.

Në planet aktuale kemi parashikuar dyfishimin e prodhimit të plehrave azotike e fosforike, jemi duke shtuar e duke përmirësuar, gjithashtu, bagëtitë e, në radhë të parë, lopët, por kjo s'do të thotë që të lëmë pas dore delet e dhitë. Duhet kuptuar drejt se ato ne i mbajmë për të na dhënë qumësht, por meqenëse lopët na sigurojnë prodhime shumë më të mëdha e më të lira se kafshët e tjera të qumështit, Partia do t'u krijojë mundësi të gjitha kooperativave, si të fushës, edhe të malit, që t'i shtojnë lopët. Kur t'i mbushim me fruta të shumëllojta të gjitha kodrat e bregoret, atëherë vetë fshatari, dhinë që e ka dashur aq fort, nuk do ta mbajë më në fshat, por do ta shtyjë malit për të kullotur nëpër shkurre, që të mos dëmtojë plantacionet e mbjella me pemë.

Për t'i veshur me pemë frutore kodrat e tokat jo të përshtatshme për drithëra buke, duhet t'i vihemë punës me vrull të madh, se në të ardhmen do të bëjmë shumë investime për këtë qëllim, mbasi frutat kanë rëndësi për shëndetin e njeriut dhe u sigurojnë të ardhura të mëdha kooperativave e shtetit tonë.

Siq shihet, pra, edhe në bujqësi kemi perspektiva të ndritura, të cilat do t'i arrijmë me punën dhe me mendjen tonë, prandaj Partia i ka këshilluar vazhdimi shqiptar të gjithë punonjësit që të bëjnë përpjekje për zotërimin e fushave të ndryshme të diturisë e të shkencës nëpërmjet shkollave, kurseve dhe studimit të pandërprerë individual.

Ju e dini se porsa përfundoi diskutimi populor për problemet e shkollës, që ka një rëndësi të jashtëzakonshme për të ardhmen tonë, për socializmin dhe komunizmin, mbasi është e domosdoshme dhe jetike që niveli politik, ideologjik, arsimor e kulturor i gjithë popullit të ngrihet çdo ditë e më lart. Pa dituri Shqipëria nuk mund të përparojë me ato ritme të shpejta që kërkojnë Partia dhe zhvillimi i vendit. Veprat e shumta, ndërtimet e mëdha që po bëjmë e do të bëjmë në të ardhmen, zhvillimi i vrullshëm i industrisë, i bujqësisë etj. nuk mund të realizohen pa mësim, pa shkencë, pa teknikë. Tani kemi me mijëra njerëz që kanë mbaruar universitetin, me dhjetëra mijë të tjerë, kanë mbaruar shkollat e mesme dhe 8-vjeçare. Të gjithë të rinjtë e të rejat ndjekin rregullisht shkollat 8-vjeçare e të mesme me dhe pa shkëputje nga puna. Megjithatë Partia konstaton se nevojat për njerëz të mësuar janë të mëdha dhe vazhdimisht në rritje. Në

qoftë se nuk mësojnë, nuk edukohen, nuk kalojnë në-për kurse e nëpër shkolla të gjithë punonjësit, sipas gjendjes, nevojave, mundësive dhe situatës, problemet e shumta që kemi përpara nuk do të zgjidhen me atë shpejtësi dhe ashtu siç kërkon Partia për të mirëën e popullit. Ja, për këtë qëllim, u bë reforma arsimore.

Së shpejti, aty nga muaji qershor, Komiteti Qendror do të bëjë një mbledhje të veçantë Plenumi¹, ku do të vendoset çfarë shkollash duhen hapur, çfarë do të mësohet në to etj. Do të merren, gjithashtu, masa të shumta pér të ndërtuar shkolla të reja dhe pér të përgatitur qindra e mijëra mësues e pedagogë të rinj që do t'i bëjnë ballë këtij plani të madh të Partisë.

Qëllimi kryesor është që njerëzit tanë të fitojnë dituri, por këto t'i gërshetojnë edhe me punën. Partia nuk mendon vetëm të përgatitë njerëz të mësuar, të cilët t'u japid urdhra të tjerëve dhe vetë të mos bëjnë gjë. Ajo nuk do njerëz sa pér të dhënë mend. Jo, ka kaluar ajo kohë kur njerëzit e mësuar rrinin me kalem në dorë dhe pjesa tjetër punonte. Ata që do të mësojnë duhet të pajisen që në bankat e shkollës me tiparet e klasës punëtore, që të bëhen të aftë të punojnë edhe brenda në miniera në thellësitetë e nëntokës, nëpër uzina, fabrika, kantiere ndërtimi, kooperativa bujqësore e kudo. Kjo do të arrihet kur njerëzit tanë, të cilët ndjekin shkollat, të marrin pjesë edhe në

1 Ky Plenum, që u zhvillua më 26-28 qershor 1969, shqyrtoi konkluzionet e diskutimit populor pér revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë.

punën prodhuese, ku të fitojnë karakteristikat e klasës punëtore, si metalurgët, minatorët e të tjerë, të cilët ndeshen vazhdimisht me vështirësi, i përballojnë e i kapërcejnë ato me vendosmëri, janë kurdoherë optimistë pér jetën, të zotë dhe të zgjuar, punojnë e djersijnë pér ndërtimin e socializmit dhe përbëjnë kështu shtyllën kurrizore të Partisë e të shtetit tonë të diktaturës së proletariatit.

Pér të gjitha këto arsyе programi i ri i shkollave tona bazën e vet nuk do ta ketë vetëm te mësimi, po edhe në punën prodhuese e në kalitjen fiziko-ushtarake e mbi të gjitha tek ideologjia e Partisë, te marksizëm-leninizmi. Njerëzit në shkollën e re do të edukohen të mësojnë dhe të punojnë, të jenë njëkohësisht ushtarë të zotë dhe të aftë, që, nën udhëheqjen e Partisë së klasës punëtore, mësimin dhe diturinë t'i vënë në shërbim të popullit.

Reformën arsimore ne e bëjmë me qëllim që të zhduken sa më shpejt mbeturinat mikroborgjeze nga ndërgjegjja e njerëzve, pse kështu do të ecim me siguri më shpejt drejt ndërtimit të plotë të socializmit dhe të komunizmit.

Në shoqërinë komuniste nuk do të ketë klasa, atëherë nuk do të ekzistojnë as shteti, as partia. Këto gradualisht do të shuhen, mbasi njerëzit parashikohet të ngrihen në një nivel të lartë zhvillimi të gjithanëshëm, kështu ndërgjegjja e tyre do të jetë spastruar nga mbeturinat, pastërtia shpirtërore do të jetë karakteristika dalluese e tyre. Secili që do të ketë nevojë pér diçka, do të vejë ta marrë lirisht në dyqan dhe para. Në atë kohë askujt nuk do t'i shkojë në mendje

që të marrë më shumë nga sa i duhen, pse mirëgenia dhe bollëku do të jenë në atë nivel që çdo nevojë do të jetë e garantuar plotësisht për cilindo. Ndryshe qëndron çështja tani që njerëzit trashëgojnë akoma mbeturina të së vjetrës, sidomos ndjenjën e vënies së interesit personal mbi interesin e përgjithshëm, që nuk zhduket lehtë, dhe pikërisht për këtë arsyе edukimi është një proces i gjatë që do të kërkojë akoma shumë kohë. Ky edukim do të arrihet duke përvetësuar teorinë marksiste-leniniste, duke u përpjekur për t'i kupltuar gjërat politikisht. Ne duhet të luftojmë që tani në të gjitha frontet, për të arritur sa më shpejt që njerëzit tanë të jenë të ngritur në nivelin e kohës politikisht e ideologjikisht, që të jenë të lirë e të lumen dhe t'u sigurohen ato për të cilat kanë nevojë.

E tillë do të jetë shoqëria e ardhshme komuniste që kanë parashikuar Marks, Engels, Lenini e Stalini. Po për të ndërtuar këtë shoqëri, do të duhen akoma shumë e shumë punë dhe luftë. Në radhë të parë duhet një punë e madhe për kalitjen e ndërgjegjes së njerëzve dhe kjo bëhet vazhdimisht e çdo ditë në rrugën e drejtë që ka caktuar Partia. Është kjo arsyëja që populli e do me gjithë shpirt Partinë dhe nën udhëheqjen e saj, i madh e i vogël mobilizohen e realizojnë me përpikëri detyrat.

Në këto situata revolucionare, si gjithë populli shqiptar, edhe ju, të dashur vëllezër dhe motra të Tepelenës, keni detyra të mëdha për të kryer në rrethin tuaj, që është edhe industrial, por më shumë bujqësor. Partia dhe Qeveria mendojnë se bujqësia e blektoria kanë përparuar shumë edhe këtu te ju, janë bërë

ndryshime të mëdha, por ato dëshirojnë që i gjithë populli të mobilizohet edhe më mirë që në bujqësi t'i ngremë kudo rendimentet për çdo lloj bime dhe një-kohësisht të zhvillojmë akoma më shumë blegtorianë. Partia dhe Qeveria kanë tanë mundësi që të ndihmojnë më shumë për zhvillimin dhe përparimin e zonave të malësisë, siç është edhe Tepelena. Deri tanë janë dhënë ndihma, janë bërë investime, vetë populli ka ndërtuar vepra madhështore; këtej e tutje këto ndihma do t'i shtojmë.

Veçanërisht në rrëthim tuaj do të merren masa të rëndësishme për ujitjen. Prandaj të gjithë duhet të mendojnë e të bëjnë përpjekje për të gjetur sa më shumë pika për grumbullimin e ujërave kudo ku ka mundësi, për të ujitur më shumë sipërfaqe tokash. Në këtë drejtim janë bërë shumë përpjekje, si kudo, edhe te ju, janë ndërtuar e po ndërtohen rezervuarë të fuqishëm, megjithatë mbetet akoma shumë për të bërë. Është e domosdoshme të bëhen kërkime e studime të kujdeshme, të shpejta e konkrete, edhe atje ku tash na duket sikur nuk ka mundësi për të grumbulluar ujë, në mënyrë që të përcaktojmë mirë kohën dhe mënyrat e zbatimit në jetë të studimeve e të planeve për rezervuarë.

Vjosën këtu pranë jush nuk po e shfrytëzojmë sa duhet. Por, në të ardhmen e afërt, këtë «armik» shekullor do ta bëjmë mikun tonë pérjetë.

Lenini ka thënë që pushteti i këshillave plus elektrifikimi i gjithë vendit është baras me komunizmin. Duke u nisur nga ky mësim, Partia ka vendosur që brenda vitit 1971 të marrin dritë elektrike të gjitha

fshatrat e Shqipërisë¹. Gjer tani një hap si ky nuk është marrë në asnjë vend tjeter të botës. Dhe këtu s'është çështja vetëm për ndriçimin elektrik të të gjithë vendit, duke përfshirë, veç qytetit, edhe fshatin, por sidomos për gjallërimin e industrisë, të bujqësisë dhe të të gjithë ekonomisë.

Në funksion të këtyre qëllimeve, duke filluar që sivjet, do të shkojnë në Fierzë ekipe për të projektuar ndërtimin e një hidrocentrali tjeter, që do të jetë më i madhi i vendit tonë, bile një nga më të mëdhenjtë e Evropës. Ky hidrocentral do të pasohet më vonë edhe nga të tjerë, gjithashtu të mëdhenj, kështu i gjithë lumi Drin do të kthehet në një zinxhir të gjatë hidrocentralesh. Këta do t'i ndërtojë populli me mendjen dhe me punën e vet, nën udhëheqjen e Partisë.

Ne luftojmë dhe përpinqemi sidomos për të ardhmen e ndritur të rinisë, për ju të rinj e të reja, që të jetoni të lumtur e të gëzuar, të mos vuani si dikur prindërit, gjyshërit e stërgjyshërit tuaj.

Krahas punës së madhe për ujitjen, i vini rëndësi sidomos blegtorisë, për të cilën nuk dua të zgjatem, pse ju jeni vetë specialistë. Megjithatë më lejoni t'ju jap një këshillë: sado që të dijë njeriu, motra dhe vëllezër, dituria nuk ka fund. Prandaj eksperiencës suaj të madhe në blegtori i shton edhe mësimet që Partia po jua jep me shumë mënyra: me shkolla, me kurse, me libra etj. Çështjen e kam sidomos te kujdesi që duhet të tregoni për rritjen e lopës. Nga raca e lopës që mba-

¹ Elektrifikimi i të gjitha fshatrave të vendit përfundoi më 25 tetor 1970.

ni ju, merrni jo më tepër se 200 litra qumësht në vit, në një kohë që mund të merrni më shumë, por për këtë kërkohen dituri. Natyrisht, me kohë duhet të punoni për të bërë hauze, me ujin e të cilave do të ujitni tokat, që atje ku gjer tanë keni marrë 10 kuinalë, të arrini të merrni 40 e 50 kuinalë misër për hektar. Kjo do t'ju japë mundësi të ekonomizoni një sasi toke për ta mbjellë me tërfil ose me jonxhë, kështu që, kur t'ju vijnë mëshqerrat e racës, këtyre t'u keni siguruar plotësisht gjithë ushqimin për të cilin kanë nevojë, se vetëm në këtë rrugë do të merrni sasi të madhe qumështi. Baxhot që keni tanë, jo vetëm do të shtohen, por ato do t'i kthejmë në pikë moderne përpunimin e qumështit.

Një detyrë tjetër shumë e rëndësishme për ju është shtimi i drithërave. Për të siguruar bukën ka luttuar vazhdimisht Partia, pse në të kaluarën populli ynë ka vuajtur shumë deri edhe për kafshatën e gojës. Vitin që shkoi patëm prodhime aq të mira, sa shumë fshatarë u habitën dhe thoshin: «Si është e mundur që u arrit një gjë e tillë?». Kjo u arrit se punuat mirë ju, se zbatuat këshillat e Partisë, fituat besim në forcat tuaja, mësuat agroteknikën. Prodhimet e bollshme nuk ranë nga qielli, por i bëri toka jonë, në radhë të parë, në sajë të punës, të kujdesit tuaj dhe të zbatimit të agroteknikës. Në qoftë se i zbatojmë me përpikëri e me vrull revolucionar porositë e Partisë, bukën do ta kemi të siguruar, planin jo vetëm do ta realizojmë, por do të prodrojmë edhe më tepër.

Vëllezër e motra të Tepelenës, jujeni njerëz të zgjuar, revolucionarë dhe me një eksperiencë të ma-

dhe në punë e në jetë. Partia, që e doni me gjithë shpirt, do të jetë kurdoherë pranë jush, se është juaja. Ajo do të përqendrojë të gjitha dituritë dhe forcat që populli shqiptar të përparojë, të lulëzojë dhe të realizohet kështu me sukses për të gjithë qëllimi i lartë i Partisë, ngritja e nivelit ekonomik, politik, ideologjik e kulturor të mbarë popullit shqiptar dhe forcimi i mbrojtjes së vendit.

Ne jemi të rrethuar nga të katër anët nga armiq të egër e dinakë, por nuk trembemi. Ata nuk duhet ta harrojnë paralajmërimin e rreptë të Partisë sonë, se kush prek kufijtë e Shqipërisë, do të gjejë vdekjen. Të jemi kurdoherë vigjilentë, sepse në botë ekzistojnë imperializmi dhe revizionizmi. Të gjithë këta janë të bashkuar kur është çështja për të sulmuar vendin tonë dhe gjithë popujt revolucionarë të botës. Mirëpo ne nuk tundemi, pse jemi të fortë si çeliku. Shqipëria, revolucionarët dhe popujt e mbarë botës zhvillojnë një luftë të pandërprerë, të rreptë e fitimtare kundër dy fuqive botërore: imperializmit amerikan dhe revizionizmit sovjetik, që kërkojnë të sundojnë në të katër anët. Megjithatë imperializmi amerikan dhe revizionizmi sovjetik janë në krizë; ata janë vërtet në aleancë kundër nesh, por kanë edhe kontradikta të mëdha midis tyre, të cilat përpilen t'i zgjidhin për të fuqizuar më shumë luftën kundër marksizëm-leninizmit. Po kot e kanë, ata kurrë nuk do të arrijnë t'i zgjidhin kontradiktat, për arsyen të luftës që u bëjmë ne dhe revolucionarët e popujt e ndryshëm brenda dhe jashtë shteteve të tyre. Imperialistët dhe revisionistët bëjnë mbledhje, parada dhe manovra ushtarake, për-

gatiten si në ethe për luftë. Por as përgatitjet që bëjnë për luftë, as politika e tyre e frikësimit nuk u shkon me ne. Ne nuk rrimë duarlidhur, përgatitemi vazhdimi misht për mbrojtje, se e dimë që armiqtë janë të pabesë. Ne nuk i lejojmë vetes që armiqtë imperialistë dhe revisionistë të na gjejnë në gjumë, prandaj qëndrojmë kurdoherë vigjilentë ndaj cilitdo armiku, të brendshëm apo të jashtëm.

Çdo mendim e veprim të njerëzve tanë duhet ta gjykojë populli. Kush mendon e punon mirë, jo vetëm duhet të lavdërohet, po prej tij të marrin shembull edhe të tjerët. Atij që flet keq, t'i hiqet veshi, të këshillohet një, dy e tri herë, pastaj, në qoftë se vazhdon në rrugë të shtrembër, të merren masa të rrepta, sepse jetën, lirinë e popullit nuk lejojmë në asnje mënyrë që ta prekë askush. Partia ka zemër të gjerë, populli, gjithashtu, është zemërgjerë ndaj atyre që akoma kanë paqartësi në kokë dhe bëjnë përpjekje të ndreqen, por, kur nuk duan të ndreqen, atëherë le të marrin atë që meritojnë dhe në asnje mënyrë të mos lejohen të dëmtojnë çështjen e popullit dhe të Partisë, se Shqipëria duhet të rrojë dhe do të rrojë në shekuj.

Me besim të patundur në vijën e drejtë të Partisë, në forcat e popullit, le të ecim përpëra me vrull revolucionar, të realizojmë çdo detyrë që çon në plotësimin e dëshirave të popullit tonë. Ju siguroj, motra dhe vellezër, se Partia dhe Komiteti i saj Qendror kanë besim të patundur dhe një dashuri të zjarrtë për popullin heroik të Tepelenës e për organizatën e Partisë të rrethit tuaj, që i konsiderojnë si një nga kolonat e çelikta të Partisë e të shtetit të demokracisë sonë popullore.

Në emër të Partisë dhe timin ju uroj ju të gjithë -ve që jeni mbledhur në këtë miting, si dhe gjithë të dashurve të zemrave tuaja e tonave nëpër fshatra, punë të mbarë e shëndet të plotë. Të gjithë atyre që s'patën mundësi të vijnë në këtë takim, u çoni të falat e mia më të përzemërtë dhe u thoni se më erdhi keq që s'u poqa dot me ta, por ne do të shihemi përsëri së bashku, sepse ky nuk është as takimi i parë, as i fundit.

Rroftë Partia!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë populli heroik i Tepelenës!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botohet për herë të parë, me
disa shkurtime, sipas origji-
nalit që gjendet në Arkivin
Qendror të Partisë*

STRUKTURA E SHKOLLËS T'U PËRGJIGJET NEVOJAVE TË NGUTSHME TË EKONOMISË SONË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

5 qershor 1969

Në përgjithësi jam dakord si me përmbajtjen e raportit, ashtu dhe me diskutimet e shokëve rreth këtij problemi të rëndësishëm, që e plotësuan raportin, prandaj nuk dëshiroj të hyj në hollësi. Megjithatë kam edhe unë vërejtje për disa çështje, që, nëse ka mundësi, t'i përcaktojmë më mirë, si në kuadrin e përgjithshëm, ashtu edhe në detaje.

Direktivat e Komitetit Qendror për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës kanë vënë në lëvizje masat e gjera punonjëse e kuadrot tanë dhe janë bërë objekt i një diskutimi të madh popullor. Ne, tani, natyrisht, duhet të japim disa orientime e përcakttime, ndry-

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga Komisioni Qendror i Arsimit pranë KQ të PPSH për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë.

she nuk mund ta zhvillojmë më tej si duhet punën e nisur në këtë drejtim. Kjo është e para, kurse e dyta është çështja e zbatimit të orientimeve e të përcaktimeve që kanë të bëjnë me shumë probleme, si me programet, me tekstet, me masat organizative, materiale e financiare, me afatet e vazhdimit të shkollës etj.

Unë bashkohem me orientimet e dhëna në raport, por dëshiroj të shfaq mendimin tim për afatet e vazhdimit të shkollave. Afatet që na propozohen në raport, sigurisht, janë përcaktuar në bazë të mendimeve të shprehura nga masat e nga specialistët, që kanë punuuar qysh më parë me programet, të cilat, sado që nuk janë definitive, në vija të përgjithshme janë skicë-programë. Por ashtu siç është paraqitur çështja në raport, krijuhet përshtypja sikur nuk ka asnje mundësi për të bërë ndryshime në drejtim të shkurtimit të këtyre afateve.

Reforma e shkollës që po përgatitim, për të cilën duhen bërë përpjekje që të realizohet me sukses, është një ngjarje e madhe historike për vendin tonë. Qëllimi i kësaj pune të rëndësishme është që njerëzit, të cilët do të kryejnë shkollat tona, të dalin prej tyre të mësuar e të edukuar dhe, njëkohësisht, t'i mbarojnë ato brenda një kohe relativisht jo të gjatë, se ekonomia jonë ka nevojë të madhe për këta njerëz. Kjo duhet të na bëjë të mendojmë që zhvillimi i arsimit dhe struktura e shkollës që po revolucionarizojmë, t'u përgjigjen nevojave të mëdha e të ngutshme që ka zhvillimi i ekonomisë sonë. Kryesorja për ne është që njerëzit të futen në prodhim vërtet të mësuar, por

edhe sa më parë, që me punën e tyre të kontribuojnë për të përmirësuar jetën e popullit.

Është një gjë shumë e mirë që fëmijët ta fillojnë shkollën në moshën 6-vjeçare. Kjo reflekton mirëqenien e krijuar nga pushteti popullor qysh pas Çlirimt, por ka rëndësi edhe nga ana ekonomike, pse njerëzit tanë do të futen një vit më parë në punë.

Përveç masës së madhe të punonjësve, që do të na duhet për ta hedhur sa më parë në prodhim, ne kemi e do të kemi, gjithashtu, nevoja përherë e më të mëdha edhe për kuadro. Për plotësimin e këtyre nevojave mendoj se duhet të punojmë në dy drejtime: për përgatitjen e kuadrove që do të punojnë në prodhim dhe për përgatitjen e atyre që do t'i mësojnë kuadrot e prodhimit, domethënë të kuadrove që do të na nevojiten për zbatimin si duhet të të gjithë këtij programi të madh për shkollat që po diskutojmë. Duke e parë problemin në këtë prizëm dhe sipas çështjeve të tjera të paprogramuara, që kanë lidhje me zhvillimin industrial, bujqësor dhe kulturor, edhe një humbje e vogël kohe ndikon në zhvillimin e vendit tonë, dobëson si cilësinë e prodhimit, edhe të arsimit.

Jam plotësish dakord me mendimet e paraqitura në raport për shkurtimin e afateve nga pesë e gjashtë vjet, që zgjatin studimet në disa degë e fakultete, në katër vjet. Megjithatë, ka përsëri degë, siç janë ato të Institutit të Lartë të Arteve, ku afati i studimeve më duket tepër i gjatë e me teprime. Në këtë drejtim po marr si shembull kohën prej pesë vjetësh të propozuar për përgatitjen e kompozitorëve. Ne kemi kompozitorë e artistë të mirë, që s'kanë bërë fare shkollë

të lartë ose që kanë bërë vetëm një apo dy vjet në Moskë. Kurse tani, përveç shkollës së mesme, e futim të riun ose të renë të mësojë edhe pesë vjet që të bëhet aktor estrade! Duke vepruar kështu, në një kohë që kemi me mijëra e mijëra njerëz nga të katër anët e vendit që presin t'u vejë një regjisor për t'i drejtuar, frenojmë hovin e madh që dëshirojmë t'i japim kulturës. Duke e gjuquar çështjen në këtë prizëm, mendoj që afati i studimeve në këtë degë të shkurtohet. Ky sugjerim mund të mos jetë shumë i drejtë e me baza, pse unë specialist nuk jam, megjithatë të mbahet parasysh në hartimin e programeve që pastaj të vendosim përfundimisht si të shihet më e arsyeshme. Çështja është të luftohen tendencat e skematizmit. Të mos kënaqemi me skemën e menduar për shkollën e mesme, për shembull, gjashtë muaj e gjysmë do të lihen për mësim, kurse pjesa tjetër e kohës do të përdoret për punën në prodhim dhe përgatitjen fizike e ushtarake të rinisë, dhe të mos lëvizim prej saj pa parë esencën e problemit.

Jam dakord që parimet për ndërtimin e programeve të shkollave të mesme të janë të njëlllojta, që kultura e përgjithshme shkencore në shkollat e mesme profesionale të jepet si në gjimnazet, por më preokupon vetëm çështja e kohës, të cilën duhet ta përcaktojmë me kujdes. Gjatë hartimit të programeve e të teksteve shkollore të shikojmë, në radhë të parë, mundësinë e kursimit të kohës pikërisht për hir të të dyja arsyeve të mëdha që përmenda, të cilat më dukën shumë të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë sonë. Veç kësaj, kursimin e kohës së vazhdimit të

studimeve në të ardhmen duhet ta shohim jo vetëm në çështjen e teksteve e të programeve, por edhe në shumë aspekte të tjera, si, për shembull, në lehtësimin gradual të ngarkesës së mësuesve e të pedagogëve, gjersa ta shpiem në gjendjen normale që duhet të jetë. Kjo ka për të ndihmuar me siguri për ngritjen e cilësisë së punës së mësuesve dhe të pedagogëve, pra edhe të nivelit të përgatitjes së nxënësve e të studentëve. Në këtë çështje rëndësi të madhe kanë, gjithashtu, rritja e numrit të pedagogëve, përmirësimi i stilit dhe i metodës së punës së tyre pedagogjike, që, natyrisht, kërkojnë përpjekje të vazhdueshme nga ana e tyre, se nuk arrihen lehtë. Shkurtimi i afateve të mësimit në disa fakultete nga katër, pesë e gjashtë vjet, që i kemi tanë, në tre, katër vjet, varet nga zgjidhja e drejtë e gjithë problemeve që përmenda.

Kurdoherë duhet të kemi parasysh që programet t'ia përshtatim perspektivës sonë të afërt, imediate. Të mos mendojmë se do të na cungohet procesi mësimor ngaqë lëndëve të tjera do t'u merret ca kohë për orët e mësimit të marksizëm-leninizmit, të punës në prodhim dhe të stërvitjes ushtarake. Në fakt këto do të marrin një sasi orësh, por janë jashtëzakonisht të vlefshme dhe të domosdoshme për përgatitjen e kuadrove tanë revolucionarë. Veç kësaj, ato do të shërbejnë edhe për çlodhjen mendore të nxënësve e të studentëve që do të ndërrojnë ca ambientin, do të freskohen dhe do të tërhiqen shumë prej tyre.

Afatin e punës në prodhim të mos e lëvizim, mendoj unë, megjithatë mund të bëjmë ndonjë gërshetim midis punës në prodhim dhe aksioneve, që tashmë janë

bërë traditë shumë e mirë për kalitjen revolucionare të rinisë sonë. Aksionet i do shumë rinia, ato kanë karakter edukativ masiv dhe, pa nënveftësuar rëndësinë e praktikës, në aksione të rejat e të rinxjtë edukohen politikisht e ideologjikisht.

Një çështje tjetër, që mendoj ta kemi parasysh, është edhe kualifikimi i kuadrove pas mbarimit të universitetit. Unë jam dakord me shokun Manush [Myftiu] që kësaj çështjeje t'i vëmë rëndësi të madhe në të ardhmen. Në universitet kuadrit i jepet teoria bazë, e domosdoshme për të punuar në jetë, kurse pas mbarimit të shkollës duhet t'i vëmë rëndësi të madhe kualifikimit me etapa, sipas nevojave që do të paraqiten për kategori të ndryshme kuadrosh për periudha gjashtëmuore, njëvjeçare etj. Kjo do të na japë mundësi t'i kualifikojmë gjithnjë e më mirë në punë e sipër kuadrot e rinj dhe me këtë praktikë të realizojmë njëkohësisht orientimin që nuk mësohet vetëm në shkollë, por edhe në punë.

Pas mbarimit të shkollës kuadri vazhdon të mësojë nga dy burime: nga puna e përditshme praktike dhe nga kurset e kualifikimit e të specializimit, që, sipas mendimit tim, s'duhet të hapen vetëm një herë, por të jenë të vazhdueshme e për vite të tëra. Në qoftë se mund ta realizojmë një gjë të tillë pa zvogëluar aspak nivelin e cilësisë së mësimit gjatë shkollës, do të kemi bërë një gjë të madhe për plotësimin e nevojave gjithnjë në rritje jo vetëm për punonjës të thjeshtë, por edhe për kuadro, nevoja që, siç thashë, për ne janë shumë të mëdha.

Duke pasur parasysh zhvillimin e vrullshëm të

ekonomisë, planet tona të ngjeshura aktuale dhe perspektive, del qartë nevoja për specializimin dhe ngrijtjen e mëtejshme të nivelistët kuadrit përritjen e rendimentit në punë jo vetëm në sektorët shtetërorë, por edhe në kooperativat bujqësore, të cilat nuk mund të ecin si duhet përparrë me një numër të vogël e të kufizuar kuadrosh me arsim të lartë. Prandaj, që të arrijmë rezultatet e dëshiruara në prodhim, do të na duhet të përgatitim një mori kuadrosh, përvèç atyre që do të na nevojiten për t'i mësuar të gjithë këta në shkolla e më vonë në kurse. Pas 10-15 vjetësh, një numër i madh kuadrosh, që aktualisht kanë mbaruar shkollat tona të larta me programet e vjetra, do të kenë stazh dhe eksperiencë të gjatë në prodhim dhe, duke qenë vetë të kualifikuar, do të na shërbejnë për të kualifikuar më tej gjithë atë mori kuadrosh, që do të hedhim në të ardhmen në prodhim. Duhet të pranojmë se kuadrot që do të mbarojnë disa degë të shkollave të larta, qofshin këto tre apo katërvjeçare, do të kenë edhe boshillëqe, por këto do t'i plotësojnë nëpërmjet kurseve të kualifikimit gjatë praktikës pas mbarimit të studimeve, kur të kenë fituar njëfarë eksperiencë në prodhim.

Kërkesa e shfaqur nga prindërit, që afati i mësimmeve në shkollat tona të jetë trevjeçar, siç shënohet në raport, duhet të na bëjë të reflektojmë, pikërisht për arsyet që thashë më lart. Mendimi i shfaqur nuk niset vetëm nga interesat individualë, megjithëse edhe këta duhet t'i kemi parasysh, por shpreh edhe rezultatin e një mendimi të thellë e të drejtë popullor. Një kërkësë e tillë nuk bëhet nga prindërit thjesht për të

hequr qafe sa më parë djemtë dhe vajzat që ndjekin shkollat, por që fëmijët edhe të mësojnë, edhe të futen në punë një vit më parë për të nxjerrë bukën e tyre, pér të ndihmuar edhe prindërit që punojnë vetë dhe pér të përmirësuar të gjithë së bashku nivelin e jetësës, që është qëllimi i përgjithshëm e më i lartë i Partisë.

Lidhur me shkurtimin e afateve të studimit, mund të vihet pyetja: do të dalin vallë nxënësit dhe studentët nga shkollat të kualifikuar si duhet? Kjo çështje zgjidhet po të bëhen të gjitha përpjekjet pér t'i ndërtuar programet dhe tekstet shkollore, metodën dhe stilin e të dhënët mësim, si dhe gjithçka tjetër që nevojitet, në mënyrë të përshtatshme dhe jo duke i ngarkuar nxënësit e studentët jashtë masës. Mua nuk më duket i drejtë mendimi që vetëm me orët e caktuara në program ata s'mund të mësojnë gjë. Natyrisht, ulja e orëve të mësimit tej kërkesave të domosdoshme nuk është e drejtë, pse në fakt dobëson përgatitjen e kuadrove tanë.

Si konkluzion, mendoj që, po të mos na dalin llogaritë dhe të na preket niveli i përgatitjes së studenteve, mund të mbajmë sistemin katër ose pesë vjeçar, por duke pasur parasysh edhe atë që shpjegova, se dijet e tyre pas mbarimit të shkollës do të kompensohen vazhdimisht nëpër kurset dhe format e tjera të kualifikimit, që do të organizohen pér këtë qëllim, atëherë do të ishte mirë të shikohej se pér cilat degë ose fakultete mund ta ulnim në tre vjet kohën e studimit, pér t'i dhënë prodhimit më shpejt kuadro të mësuar.

Prodhimi ynë po ngrihet vazhdimisht, prandaj në çështjen e shkollës nuk mund të ecim me normat e gjertanishme. Jeta tregon përditë se kuadrot tanë të dalë nga shkollat ekzistuese, të cilat tani po i kritikojmë se kanë pasur teprime, po tregojnë aftësi të mëdha dhe të lavdërueshme në punë. Ata mbajnë mbi shpinë detyra jo të lehta, të cilat vazhdimisht i kanë kryer me sukses dhe, njëkohësisht, luftojnë për të perfeksionuar dijenitë e tyre.

Tani, me sistemin e ri shkollor, që shkon drejt politeknizimit, dhe në sajë të të gjithë faktorëve që përmenda, nxënësit dhe studentët do ta plotësojnë edhe atë mungesë njohurish që mund t'u krijohet nga kufizimi i orëve të lëndëve të ndryshme. Ajo që u tha këtu, se nxënësit kërkojnë andej-këtej edhe materiale të tjera për të kompletuar punët laboratorike të shkollës, flet për zhvillimin dhe interesimin e shumanshëm të tyre për të plotësuar dijenitë.

Ne duhet të japim udhëzime që gjatë punës për hartimin e programeve e të teksteve të mbahet mirë parasysh si ngarkesa e nxënësve, ashtu edhe ajo e mësuesve, problem ky që lidhet edhe me buxhetin dhe ka rëndësi të madhe. Kur mësuesi ka, ta zëmë, 25 ose 30 nxënës në klasë, ai arrin t'i pyesë të gjithë dhe t'u japë shumë njohuri plotësuese, ndërsa po të ketë 50 nxënës, cilësia e punës mësimore me siguri bie.

Afati i shkollës së mesme pedagogjike mendoj të mbetet aq sa është, katër vjet, dhe të mos zgjatet në pesë vjet. S'e mbaj mend ku e kam dëgjuar, po më duket e drejtë ideja që një nxënës, që mbaron gjimnazin ose një shkollë të mesme teknike, me një kurs

specializimi gjashtëmujor mund të bëhet mësues i shkollës 8-vjeçare për të dhënë lëndët e kimisë, të fizikës, të agronomisë etj. Mësues të përgatitur në këtë mënyrë e bëjnë mirë punën.

Gjithashtu mendoj të shihet edhe një herë mundësia që disa degë të Fakultetit Ekonomik të mos jenë katër, por tre vjet. Kjo kohë më duket e mjaftueshme për të përgatitur specialistë si për industrinë, ashtu edhe për bujqësinë, për qarkullimin etj., etj.

Vend që të diskutohet për shkurtimin e kohës më duket se ka edhe në Fakultetin e Shkencave të Natiyrës, ku afati i studimeve tanë zgjat katër-pesë vjet. Unë mendoj, për shembull, se koha për përgatitjen e kuadrove në degën e fizikës bërthamore mund të jetë katër vjet, plus një vit specializim. Afatet e parashikuara në raport për përgatitjen e këtyre specialistëve më duken pak të ekzagjeruara.

Për degën e agronomisë së përgjithshme nuk kam ndonjë vërejtje, kurse specialistët që do të përgatitim për pemëtarinë ose për mbrojtjen e bimëve, në qoftë se nisemi nga parimi që t'i profilizojmë agronomët, është mirë t'i nxjerrim më shpejt në prodhim, prandaj të shikohet mundësia e shkurtimit të kohës së studimeve.

Kuadrot do t'i mbarojnë shkollat e larta në moshë të re, 23-vjeçare, domethënë do të kenë rast e mundësi një jetë të tërë të mësojnë. Po të pranojmë çështjen e kualifikimit të mëtejshëm të tyre pas shkollës (dhe mendoj që këtë duhet ta pranojmë, se është e drejtë), atëherë do të pranojmë edhe shkurtimin e afatit të studimeve, që kuadrot tanë t'i hedhim sa më shpeit në

prodhim, në jetë. Shkolla do t'u japë atyre teorinë bazë të domosdoshme, kurse më vonë, gjatë punës në prodhim, do t'u jepet mundësia të ndjekin kurse specializimi për t'u bërë njerëz përherë e më të zotë. Duke ecur në këtë rrugë, do të plotësohen më mirë nevojat e mëdha që kemi e do të kemi për kuadro.

E përsëris që jam plotësisht dakord me materialin, për përgatitjen e të cilët është bërë një punë shumë e madhe. Problemi është studiuar mjaft mirë dhe përkëtë meritë të veçantë ka i gjithë komisioni, i cili duhet ta vazhdojë punën edhe në të ardhmen për të udhëzuar e për të kontrolluar zbatimin e orientimeve të dhëna. Një rol shumë të rëndësishëm duhet të luajnë në këtë drejtim edhe Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, propaganda e Partisë, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste etj. Kujdes i veçantë i duhet kushtuar, në radhë të parë, diskutimit rrëth çështjeve të brendisë së shkollës, para ardhjes së materialeve në Byronë Politike ose në Komitetin Qendror. Në të ardhmen do të bëjmë përsëri një ose dy mbledhje të tjera, bile çdo vit mund të bëjmë nga një mbledhje të veçantë për probleme të shkollës, megjithatë, shokët e ministrisë dhe të institucioneve që përmenda duhet të merren edhe vetë me këto çështje. Për këto arsyen jam dakord edhe për sa u tha lidhur me strukturën e Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës.

Jam dakord, gjithashtu, edhe me vërejtjet që bënë këtu shokët lidhur me çështjen e ushtrisë, për të cilat shokët e Ministrisë së Mbrojtjes duhet të reflektojnë mirë, se janë të rëndësishme dhe njëkohësisht mjaft delikate. Që të realizohet orientimi për përgatitjen ush-

tarake të nxënësve e të studentëve do të angazhohen mjaft kuadro oficerë, që deri tani s'janë marrë me punë pedagogjike, prandaj këtyre duhet t'u bëhet një instruktim i plotë dhe i mirë, se nuk mund të punojnë si duhet me rininë shkollore e studenteske pa qenë të instruktuar mirë nga ana pedagogjike. Është e drejtë që nga të rinjtë të kërkohet disiplinë e fortë gjatë kohës së përgatitjes së tyre ushtarake, por kjo nuk do të jetë njëlloj si ajo që kërkohet nga ushtarët. Disiplina në rininë shkollore e studentore duhet t'u përshtatet moshës dhe kushteve të saj, prandaj kuadrot ushtarakë që do të caktohen të punojnë me të, të përgatiten mirë, të mësohen si të ambientohen me rininë dhe të kenë parasysh që kohën të mos ua humbasin të reja e të rinjve kur s'është nevoja.

Dëshiroj ta vë theksin sidomos te kujdesi që duhet treguar për stërvitjen ushtarake të vajzave. Programi i stërvitjes për këto duhet të jetë i veçantë dhe të ketë parasysh momentet fiziologjike të femrës së rritur. Gjatë stërvitjes përgjithësisht duhet pasur kujdes që vajzat të mos futen në ujë të ftohtë, të mos ngrenë pesha të rënda etj., etj., ndryshe nxënëset dhe studentet do të na dëmtohen nga shëndeti dhe do të na sëmuren.

Mendoj, gjithashtu, të mos praktikojmë turn të tretë për të rinjtë, pse kjo do të ndikonte keq në zhvillimin e fizikut të tyre akoma të paformuar mirë. Të rinjtë të punojnë vetëm në turnin e parë dhe të dytë e jo edhe në atë të natës.

Këto vërejtje, si dhe ato që bënë shokët, të reflektohen në raportin që do t'i paraqitet Plenumit të Ko-

mitetit Qendror të Partisë më 27 ose më 28 qershor, të cilin do ta aprovojmë në mbledhjen e Byrosë Politike nga data 20 qershor.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

KËSHILLI POPULLOR ËSHTË PËRFAQËSUES I VULLNETIT TË POPULLIT

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit
të Kuvendit Popullor¹*

7 qershor 1969

Në fillim shoku Enver Hoxha i drejtoi disa pyetje shoqes Drita Dika², që merrte pjesë në këtë mbledhje:

SHOKU ENVER HOXHA: Sa shtëpi ka fshati juaj?

SHOQJA DRITA DIKA: Ka 290 shtëpi me rreth tre mijë banorë.

SHOKU ENVER HOXHA: Në ndërmarrje bujqësore punojnë?

SHOQJA DRITA DIKA: Një pjesë në ndërmarrjen bujqësore, kurse një pjesë punon në ndërmarrje të tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Ku e ke mbaruar shkollën?

SHOQJA DRITA DIKA: Në Shkodër.

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur për pjesëmarrjen dhe aktivizimin e grave të zgjedhura në këshillat popullorë.

2 Në atë kohë kryetare e këshillit popullor të fshatit Sankak të rrëthit të Krujës.

SHOKU ENVER HOXHA: Përveç arsimtarëve, ka shumë shoqe të tjera në fshat që kanë mbaruar shkollën e mesme?

SHOQJA DRITA DIKA: Jo, nuk kemi.

SHOKU ENVER HOXHA: Komunizmi, — na mëson Lenini, — është pushteti i këshillave plus elektrifikimi i të gjithë vendit. Këshillat popullorë janë organe lokale të pushtetit shtetëror që realizojnë qeverisjen e vendit. Kjo çështje me rëndësi të madhe parimore dhe praktike nuk është kuptuar mirë. Kur bëhen zgjedhjet e këshillave popullorë, i jepet rëndësi më tepër zgjedhjes së kandidaturave për këshillin popullor të rrethit dhe nënvlerësohen ato të këshillave të instancave më të ulëta. Këshillat popullorë në bazë duhet të kuptojnë thellë detyrat që kanë për drejtimin e gjithë jetës shoqërore në fushën politike, socialkulturore, të mbrojtjes së vendit dhe të ruajtjes së rendit në njësitë administrative përkatëse. Neve na duhet që në këshillat popullorë të fshatrave, të lagjeve, të qyteteve etj. të vijnë njerëzit më të mirë. Në goftë se i kushtojmë kujdes zgjedhjes së këshilltarëve në bazë, ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit do të bëhet në baza më të shëndosha.

Këshillat popullorë kanë rëndësi të madhe, sepse, në bashkëpunim me masat punonjëse dhe nën udhëheqjen e Partisë, ata drejtojnë jetën shoqërore dhe ushtrojnë pushtetin e diktaturës së proletariatit duke pajtuar interesat lokalë me interesat e përgjithshëm shtetërorë. Në goftë se këshillat popullorë i shikojnë problemet *ex cathedra* dhe bëjnë mbledhje me materiale që nuk përfaqësojnë realitetin e bazës, domethënë

nuk paraqitin nevojat, dëshirat dhe kërkesat e bazës, atëherë do të diskutojnë kot.

Do të preferohej më mirë të flitej thjesht dhe konkretnisht në mbledhje, kështu siç folën sot këtu shoqet Drita dhe Marika¹, sesa të përdoren fraza të gjata dhe boshe, që mjaft herë dëmtojnë. Kërkimi i fjalëve të zgjedhura i pengon shoqet për të thënë qartë mendimet e tyre të pjekura që lidhen me problemet e popullit. Kur janë në ambientin masiv, ato nuk emocionohen, por punojnë e drejtojnë me shkathësi, ndërsa kur vijnë te ne, flasin të emocionuara. Kjo shpjegohet, në radhë të parë, me respektin që kanë këto shoqe për Presidiumin e Kuvendit Popullor, por nuk mund të mohohet edhe njëfarë inferioriteti që ndiejnë ndaj nesh, sepse punën e tyre në lagje, në fshat e quajnë të vogël e të thjeshtë përpëra punës së shokëve të rrëthit, të Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe të Komitetit Qendror të Partisë.

Ajo që tha shoqja Vito [Kapo] është shumë e drejtë. Ne, që populli na ka zgjedhur në instancat më të larta të pushtetit shtetëror, duhet të marrim shembullin e bazës për sa u përket stilit dhe metodës në punë, që të udhëhëqim dhe të drejtojmë mirë. Ta kuptojmë thellë se konkluzionet që nxjerrin këshillat popullorë të bazës nuk janë të kota, përkundrazi, ato pasqyrojnë realitetin objektiv.

Çështje tjetër me rëndësi është ajo që këshilltarët popullorë duhet të kuptojnë mirë se ligjet, dekre-

¹ Marika Zhapa, në atë kohë kryetare e Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Qytetit të Gjirokastrës.

tet, vendimet dhe urdhëresat që dalin përkatësisht nga organet e larta të pushtetit dhe të administratës shtetërore përfaqësojnë qëllimet, detyrat, nevojat dhe mundësitet që ka shteti ynë socialist në fushën politike, ideologjike, ekonomike, shoqërore, kulturore, të mbrojtjes etj., në përputhje me politikën parimore të Partisë, me realitetin dhe me kushtet tona konkrete. Këtej del rëndësia e madhe e zbatimit me rreptësi të ligjeve. Në fushën e zbatimit të ligjeve këshillat popullorë të instancave të ndryshme nuk kanë përse të ndiejnë inferioritet. Në krye të pushtetit janë këshilltarët, pastaj vjen administrata që zbaton detyrat e vëna nga organet lokale të pushtetit. Janë më parë organet shtetërore, pastaj vijnë drejtuesit e ndërmarrjeve ekonomike, të kooperativave etj., sepse është shteti ai që organizon dhe drejton jetën ekonomike e shoqërore në bazë të planit. Organet ekonomike udhëhiqen nga pushteti i këshillave popullorë, nga shteti i diktaturës së proletariatit, që shpreh vullnetin e klasës punëtore dhe mbron interesat e tërë punonjësve. Prandaj, në qoftë se këshillat popullorë, që nga ata të fshatrave dhe deri tek ata të instancave më të larta, nuk e kuptojnë mirë, për shembull, që drejtori i ndërmarrjes apo kryetari i kooperativës duhet të japë llogari përparratyre, atëherë ka rrezik të zhvillohet burokratizmi.

Kur vete një kryetare e këshillit popullor te drejtori i ndërmarrjes për të shtruar e për të diskutuar me të probleme të pushtetit, pavarësisht se ai është shok me përgjegjësi, duhet ta dëgjojë atë me respekt e me vëmendje. Këtë gjë është i detyruar ta bëjë, ngaqë kryetarja e këshillit popullor të fshatit vete si

përfaqësuese e pushtetit, paraqitet për të ushtruar funksione pushteti, për të parashtruar nevojat e popullit. Drejtorit t'i dridhen këmbët, në qoftë se nuk zbaton vijën e Partisë dhe ligjet e shtetit.

Në qoftë se një drejtor përpinqet t'u shpëtojë udhëheqjes dhe kontrollit të shtetit të diktaturës së proletariatit, ai nuk e ka drejt, por edhe një drejtor që, me gjithëse i njeh nevojat e popullit, nuk bën përpjekje për t'i plotësuar brenda ligjit dhe kompetencave që ka, gjithashtu nuk e ka drejt, se ai zbaton formalisht e në mënyrë burokratike ligjet dhe, duke dashur të jetë «në rregull» me eprorët, nuk përfill masat dhe organet lokale të pushtetit në bazë. Kjo ndodh sepse këta kuadro e shikojnë si burokratë pushtetin e diktaturës së proletariatit dhe organet e administratës shtetërore, në fakt, i vënë mbi organet e pushtetit shtetëror, bile edhe detyrën e tyre e shikojnë thjesht si administratorë, si teknokratë. Drejtues të tillë, qofshin ose jo anëtarë partie, duhet ta dinë që, para se të jenë administratorë, janë shtetas të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe si të tillë kanë të drejta e detyra ligjore. Secili duhet të kuptojë se ligjet e diktaturës dhe respekti ndaj popullit e përfaqësuesve të tij të zgjedhur janë të detyrueshëm.

Diskutimet e të dyja shoqeve më pëlqyen, sepse këto folën konkretisht për problemet e bazës. Nga diskutimet e tyre duket se shoqet kanë një preokupim të madh për zgjidhjen e problemeve që u dalin përpara. Përveç kësaj, ne shikojmë me kënaqësi se si një shoqenga fshati ka arritur të bëhet po aq e zonja sa shoqet e saj nga qyteti dhe, me punën e bërë për emancipi-

min e për ngritjen e nivelit ideopolitik të vetes, ka zhvilluar aftësitë krijuese për të shmangur metodat e vjetra të punës dhe për të krijuar në vend të tyre metoda të reja. Kështu mendoj se vepron shoqja Drita e rrethit të Krujës, e cila, me sa duket, punon pa u lodhur për të luftuar ngecjen në vend të punëve dhe shabllonizmin në kryerjen e detyrave. Kur ajo e shikon se nuk i ecën një formë pune, e zgjidh detyrën që ka me një formë tjetër. Çështjet kryesore që duhen respektuar rigorozisht janë vija dhe qëllimi. Format që praktikohen mund të ndryshohen në përshtatje me detyrat që dalin.

Këshilltarët, që i shërbejnë popullit, që mbajnë lidhje të ngushta e të drejtpërdrejta me të, duhet të jenë të tillë që, kur puna nuk ecën, të flakin tutje skemën dhe format e vjetruara e të kapërcyera dhe t'i zëvendësojnë këto me të tjera. Vetëjeta, vetë zhvillimi ynë i vrullshëm revolucionar kërkojnë forma të reja pune. Por këto forma e praktika të reja gjen den vetëm kur lidhesh me bazën, me punën, me prodhimin. Ai që ka gjetur një metodë të re të përshtatshme pune, e ka arritur këtë në bazë të studimit të eksperiencës, mirëpo duke kaluar një kohë të gjatë, gjérat ndryshojnë, kështu që edhe metodat e format e punës duhet të ndryshohen në përputhje me to. Në qoftë se i përbahesh vazhdimesh një forme të caktuar, pavarësisht nga ndryshimet e nevojat që shtronjeta, kjo formë, me kalimin e kohës, bëhet pengesë. Këshilltarët duhet t'i kenë parasysh këto gjëra.

Është e drejtë dhe e dobishme që të zgjidhen sa më shumë shoqe në këshillat popullore. Kjo duhet bërë

jo për sytë e bukur, por për zotësinë, kujdesin, mençurinë, korrektësinë dhe vendosmërinë e tyre. A ka vështirësi për zgjedhjen e grave në organet e pushtetit? Sigurisht që ka, por megjithëkëtë vetë shoqet këshilltare duhet të luftojnë më shumë kundër zakoneve prapanike, duke u mbështetur në vijën e Partisë. Për këtë qëllim ato të ngrihen nga ana politike, ideologjike, arsimore dhe kulturore. Këto detyra shtrohen për të gjitha shoqet që caktohen me detyra në pushtet, qofshin anëtare partie ose jo, me qëllim që të realizojnë vijën leniniste të Partisë për qeverisjen e vendit nga masat e gjera punonjëse. Me këtë mendim që po shpreh, nuk dua të them që në këshillat popullorë të mos ketë më burra, por e kam idenë që në këto organe të zgjidhen burra dhe gra. Ne duhet të përpinqemi të tërë që të arrihen një vlerësim më i drejtë i grave, një barazi e ndërgjegjshme, me qëllim që si burri, ashtu edhe grua ja të kuptojnë se janë të barabartë në punë, në shpërblim, në arsim, në veprimtarinë politiko-shoqërore, në familje, në pushim etj.

Në këshillat popullorë duhet të zgjidhen ata që punojnë më mirë në interes të popullit, që janë më të ndershëm, e besnikë, që zbatojnë e krijojnë, dhe jo njerëz me një të kaluar të mirë, por që tanë i kanë lidhur duart, duke u mbajtur me të kaluarën.

Këshilltarët, në përgjithësi, dhe shoqet këshilltare duhet t'i kuptojnë mirë këto kërkesa. Syrit të tyre të mos i shpëtojë asgjë. Partia i ka armatosur njerëzit ideologjikisht e politikisht dhe i ka besuar secilit detyra të caktuara me qëllim që t'i zbatojë sa më mirë. Këshilltari duhet të çmohet, sepse nga vlerësimi i tij rri-

tet edhe autoriteti shtetëror. Këshilltaret gra duhet të interesohen vetëm për disa probleme specifike, apo për të tëra detyrat? Ato, kur janë në detyrën e kryetarit të këshillit popullor, duhet t'i kenë sytë kudo: në fu-shën politike, ekonomike, sociale, kulturore, të mbrojtjes së vendit, të ruajtjes së rendit etj. Natyrisht që këto detyra nuk do t'i bëjnë vetëm këshilltarët, por ata do të ndihmohen nga masat e gjera të punonjësve, nga kuadrot, nga organizatat-bazë të Partisë etj. Pra, rëndësi të madhe kanë kuptimi i problemeve dhe organizimi i punës për zgjidhjen e tyre.

Në organizimin e punës për ndjekjen dhe për zgjidhjen e problemeve, ju shoqe mos mendoni se luan rol forca fizike. Rol luajnë pjekuria, zgjuarsia, metoda e administrimit. Për sa i përket forcës fizike, ata që janë më të fuqishëm, natyrisht, duhet të derdhin më tepër djersë, pra, këtej del se burrat duhet të merren me punët më të rënda. Kjo gjë nuk varet nga fakti nëse do apo nuk do drejtori i ndërmarrjes, por nga ligji i Partisë, sipas të cilët punët e rënda duhet t'i kryejnë burrat. Në qoftë se drejtori i ndërmarrjes nuk e zbaton këtë ligj, t'i kujtohet nga këshilltarja popullore dhe t'i kërkohet zbatimi pa hezitim.

Këshilli popullor në bazë është përfaqësues i zërit të popullit, është zbatues i vijës së Partisë, është organ i pushtetit shtetëror që zbaton ligjet e shtetit etj. Duke e kuptuar kështu këtë çështje, do të punohet më mirë për zbatimin e detyrave që u ka ngarkuar populli këshillave.

*Botohet për herë të parë si-
pas originalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

ZJARR KUNDËR TRADHTISE REVIZIONISTE

Artikull i botuar në gazeten «Zëri i popullit»

10 qershor 1969

Zhvillimi i mbledhjes revizioniste të Moskës po tregon qartë karakterin e saj antimarksist. Duket shëshitet se organizatorët e saj synojnë për krijimin e një bloku kundërrevolucionar, të një internacionaleje të verdhë në shërbim të revizionistëve sovjetikë dhe në bashkëpunim me imperializmin kundër revolucionit e komunizmit, kundër lirisë e pavarësisë së popujve. Mbledhja aktuale e revizionistëve do të vulosë tradhtinë e tyre ndaj komunizmit, ndarjen përfundimtare të marksistë-leninistëve nga revizionistët. Me këtë revizionistët marrin një përgjegjësi të rëndë përparë klasës punëtore ndërkombëtare, përpara lëvizjes revolucionare e antiimperialiste botërore. Ata e vënë veten përpara dënimit suprem e të pamëshirshëm të historisë.

Karakteri antimarksist i kësaj mbledhjeje të revizionistëve, që këtyre u pëlqeu ta quajnë «mbledhje të komunizmit ndërkombëtar», duket edhe nga fakti se as Brezhnjevi, as ndonjë nga 20 e ca oratorët, të

cilët kanë folur deri tani, nuk zunë fare në gojë deklaratat e Moskës të viteve 1957 e 1960. Një mbledhje e vërtetë komuniste nuk mund t'u shpëtojë dot as analizës se kush i ka zbatuar e kush jo parimet e deklaratave, as autokritikës, as kritikës leniniste serioze ndaj atyre që i kanë shkelur.

Që nga 1957-a e 1960-a ka rrjedhur shumë ujë. Tradhtia e Hrushovit dhe e hruščovianëve është zhviluar dhe i ka sjellë dëme shumë të mëdha komunizmit ndërkombëtar. Aleanca imperialiste sovjeto-amerikane, ngjarjet e Kubës, pushtimi fashist i Çekoslllovakisë, qëllimet dhe fushatat antikinezë e antishqiptare, tradhtia ndaj luftës së popullit vietnamez e popujve arabë, diversioni në lëvizjen komuniste dhe sabotimi i luftës revolucionare e nacionalçlirimtare të popujve etj. janë disa hallka të zinxhirit të tradhtisë revizioniste. Pse nuk bëhet analiza e këtyre ngjarjeve? A nuk kanë këto karakter të rëndësishëm për lëvizjen komuniste?

Revizionistëve, që kanë tradhtuar komunizmin, që janë antileninistë të tèrbuar, nuk u intereson kjo. Ata duan t'i varrosin deklaratat e Moskës të viteve 1957 e 1960, që janë pengesë për rrugën e tyre të tradhtisë. Po të bëhet analiza e zbatimit të këtyre dokumenteve, do t'i hiqet cipa qelbësirës revizioniste, tradhtisë hruščoviane, si në Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe në lëvizjen komuniste botërore.

Revizionistët e mbledhur në Moskë kanë qejf ta quajnë veten leninistë. Por si mund të jenë leninistë njerëz të tillë, që nuk kanë guxim të analizojnë pse lindëن kontradiktat në lëvizjen komuniste, burimi i të

cilave është te tradhtia e hrushovianëve, te shkelja pa skrupull nga ana e tyre e deklaratave të viteve 1957 e 1960, te veprimitaria e tyre armiqësore kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe kundër gjithë partive e revolucionarëve që u qëndrojnë besnikë mësimeve të marksizëm-leninizmit dhe deklaratave të Moskës?

Si mund të jenë leninistë këta njerëz që nuk kanë guxim të kritikojnë hapur gabimet dhe tradhtinë? Deri tani vetëm i ashtuquajturi udhëheqës i 300 revizionistëve australianë «guxoi» të thoshte se veprimi i revizionistëve sovjetikë në Çekosllovaki ishte i gabuar. Por vetëm kaq. Ai jo vetëm nuk foli për «gabime» të tjera, por edhe për atë që përmendi, nuk tha se ku ishte burimi që revizionistët sovjetikë e detyruan ushtarët e kuq të shkojë në Çekosllovaki si pushtues, si shtypës i lirisë dhe i pavarësisë së një populli vëlla. Mundet që pas kreut të revizionizmit australian të flasë edhe ndonjë tjetër, por, sigurisht, «brenda normës», aq sa të mos rrezikojë të humbasë fondin e rublave. Dhe këta «leninistë», që s'kanë guxim as të kritikojnë shokët e tyre, betohen se do të jenë luanë në luftën kundër imperializmit! Tezës antiimperialiste të revizionistëve nuk i beson kush. Asaj vështirë se i besojnë edhe vetë pjesëmarrësit e mbledhjes revizioniste. Por udhëheqësve revizionistë sovjetikë u duhet kjo tezë për të mbuluar të gjitha të palarat e tradhtisë së tyre, bashkë-punimin me imperialistët amerikanë, si dhe për të angazhuar akolitët¹ në vijën e tyre, pavarësisht se shumë nga këta përfaqësojnë vetëm vetveten.

1 Shërbëtorët.

A münd të quhen «leninistë» pjesëmarrësit e mbledhjes tradhtare të Moskës, të cilët, duke pranuar se ekzistojnë divergjenca në lëvizjen komuniste, mbrojnë teorinë false «t'i lëmë mënjanë ato çka na ndajnë dhe të kapemi nga ajo çka na bashkon»? Kjo është shprehje e qartë e oportunizmit, kundër të cilit ka luftuar me vendosmëri gjithë jetën e tij V. I. Lenini. Ç'mund t'i bashkojë marksistë-leninistët me tradhtarët e komunizmit? Asgjë. Çdo gjë i ndan. Këtë të vërtetë e dinë në praktikë dhe në teori edhe vetë mbrojtësit e kësaj teze të huaj. Situatat nuk shpëtohen duke u konformuar. Ata që mendojnë kështu, herët a vonë do t'i ndiejnë mbi kurrriz pasojat, kur mbi ta do të bjerë grushti i rëndë i socialimperializmit revisionist.

Përpara se t'i mbledhnin në Moskë përfaqësuesit e partive revisioniste, krerët hrushovianë të Bashkimit Sovjetik bënин be e rrufe se qëllimi i mbledhjes së tanishme do të ishte diskutimi demokratik i çështjes së «luftës kundër imperializmit», forcimi i «unitetit», bashkërendimi i «veprimtarisë së përbashkët» të të ashtuquajturave parti komuniste dhe se nuk do të ngri-nin asnje çështje që ka të bëjë me politikën e jashtme e të brendshme të ndonjë partie që nuk merr pjesë në mbledhje dhe në mënyrë të veçantë çështjen e Kinës. Por tanë që i futën në shtrungë dhe s'kanë më nga t'u ikin, ata i hapën kartat dhe treguan se premtimet e sigurimet e tyre ishin blof, një taktikë mashtruese për të térhequr në kurth ato parti që lëkundeshin ose që nuk aprovonin gjithë aspektet e politikës së jashtme të krerëve të Kremlinit. Këta u qëndruan besnikë planeve dhe synimeve të Nikita Hrushovit, i cili ndër-

mori pesë vjet më parë iniciativën për mbledhjen e përgjithshme të partive revizioniste.

Fjalimi që mbajti të shtunën Brezhnjevi, vërtetoi edhe një herë tjetër atë që ka thënë që në fillim Partia e Punës e Shqipërisë, se qëllimi i vërtetë i mbledhjes revizioniste, të organizuar nga krerët hruščovianë të Bashkimit Sovjetik, është vendosja dhe forcimi i hegemonisë sovjetike mbi partitë revizioniste dhe kthimi i tyre në një instrument të thjeshtë të politikës së tij të jashtme, tërheqja e tyre në fushatën shoviniste anti-kineze dhe thellimi i luftës kundër marksizëm-leninizmit, socializmit e revolucionit.

Ajo që bie më shumë në sy në fjalimin e Brezhnjevit është synimi për t'u imponuar partnerëve të tjerë diktatin e vet dhe për t'i lidhur ata kokë e këmbë pas politikës agresive imperialiste të revizionistëve sovjetikë. Në fjalën e tij të gjatë sekretari i përgjithshëm i partisë revizioniste të Bashkimit Sovjetik preku mjaft çështje të situatës së sotme ndërkombëtare dhe të marrëdhënieve midis partive revizioniste, por, duke mos qenë në gjendje të gjejë asnje argument të përshtatshëm për të mbrojtur tezat e veta, përdori gjuhën më të keqe të nxitësve të luftës, të mbushur me kërcënime e vrangëllime armësh, që do t'ia kishte zili dhe Xhon Foster Dallesi, po të ishte gjallë. Ai i kërcënoi RP të Kinës dhe popullin kinez si «me luftë të zakonshme, ashtu edhe me luftë të madhe bërthamore» dhe u mburr me potencialin ushtarak të Bashkimit Sovjetik.

Prej kohësh revizionistët sovjetikë kërcënojnë me luftë edhe Jugosllavinë, Shqipërinë e Rumaninë. Për

këtë qëllim agresiv ata kanë grumbulluar forca të armatosura në Bullgari, e cila është bërë një plasdarm i rrezikshëm i klikës së Brezhnev-Kosiginit në Ballkan, kanë shtuar dislokimin e trupave ushtarake në kufijtë e Rumanisë dhe kanë nxjerrë flotën e tyre në Mesdhe.

Por armiqjtë s'mund të na trembin. Populli shqiptar i ka nervat të çeliktë. Çdo rreziku, ngado që t'i vijë, ai është në gjendje t'i bëjë ballë dhe të shkatërrojë plotësisht çdo armik që do të guxojë ta sulmojë.

Ngjyra antikineze që krerët sovjetikë kërkijnë t'i japid asamblesë revizioniste të Moskës, është një manovër në stil të gjerë shumëpalëshe, me anë të së cilës ata kërkijnë të arrijnë të zënë pozita të caktuara si brenda mbledhjes ashtu dhe jashtë saj. Në fakt, Brezhnevi nuk bëri tjeter veçse vuri në dukje përsëri se tanimë tehu kryesor i politikës socialimperialiste të revizionistëve sovjetikë është drejtar kryesish dhe tërësisht në kundërshtimin e Kinës. Aleatë të klikës revizioniste të Bashkimit Sovjetik sot mund të jenë vetëm ata që pranojnë këtë vijë, aleancat mund të lidhen e të mbahen me të vetëm brenda këtij kuadri. Prandaj drejtimi antikinez që krerët e Kremlinit kërkijnë t'i japid mbledhjes së partive revizioniste; lidhja e këtyre të fundit me aventurat antikineze që ata përgatitin, imponohet nga vetë vija e tyre imperialiste, përbën një kusht të ekzistencës e të zbatimit të saj. Qëllimin antikinez të mbledhjes revizioniste e vërtetoi edhe Valter Ulbrihti me fjalimin e tij të djeshëm në këtë mbledhje.

Është e vërtetë se ekziston urrejtja e përbashkët kundër marksizëm-leninizmit dhe të gjitha partitë re-

visioniste punojnë me zell për sabotimin e revolucionit e të luftës çlirimtare të popujve. Por kjo, siç rezultoi nga praktika, nuk ishte e mjaftueshme për të ruajtur kohezionin e tyre nën drejtimin e Moskës. Këtë nuk mund ta bëjnë as parullat demagogjike e false, si «uniteti i veprimit» kundër imperializmit. Përderisa në të vërtetë nuk i bëhet luftë imperializmit, s'mund të ekzistojë as «unitet veprimi» kundër tij. Vetëm një aksion konkret, për të cilin do të ishin të interesuara të gjitha palët, vetëm tërheqja në një aventurë të madhe të përbashkët mund t'i mbajë partitë revisioniste të lidhura pas qerres së Moskës.

Shpërthimet antikineze në mbledhjen botërore revisioniste i nevojiten klikës së Brezhnev-Kosiginit edhe për t'u dhënë imperialistëve të SHBA-së një provë të besnikërisë autentike ndaj aleancës sovjeto-amerikane dhe për t'i sigruuar qarqet sunduese të borgjezisë ndërkombëtare se atyre nuk u vjen asnje rrezik nga frazeologjia «revolucionare» e fjalimeve që mbahen tanë në sallën Georgievskaja të Kremlinit. Kjo u duk edhe në mburrjet që Brezhnev i bëri imperializmit amerikan e botëror, kur ai nuk i kurseu fjalët për të ngritur lart forcën e tij ekonomike e ushtarake, «mekanizmin e tij të fuqishëm të prodhit, me një organizim të lartë».

Fjalimi i Brezhnevut ishte i mbushur me parime të përgjithshme të shkëputura nga realiteti, nga ngjarjet e ditës. Kjo është një taktkë tanimë e njohur e revisionistëve sovjetikë. Me frazeologji marksiste ata duan të mbulojnë veprimtarinë e tyre kundërrevolutionare dhe të mashtrojnë të painformuarit, sidomos

popullin sovjetik, që e mbajnë në një karantinë të rrepëtë, për të mos rënë në kontakt me të vërtetën. Kështu, për shembull, kreu i klikës renegade të Bashkimit Sovjetik, ndërsa foli gjerë e gjatë për gjithë botën, për Çekoslovakinë heshti, sikur të mos kishte ndodhur gjë. Ai fshehu kryekëput veprimet e imperialisto-revizionistëve në Çekoslovakia.

Brezhnjevi deklaroi plot hipokrizi se gjoja nuk kishte ndër mend të përqendrohej në «çështjen kinez», porse u detyrua ta bënte këtë për shkak të vendimeve që mori Kongresi i 9-të i Partisë Komuniste të Kinës. Ky është një pretekst.

Të flasë me tërbim kundër Kinës Brezhnjevin e detyruan situatat e vështira politike dhe kriza ideologjike në të cilat ndodhen kërret e Kremlinit. Dhe këtë situatë nuk e krijoj Kina, as Kongresi i 9-të i PKK, as PPSH, por tradhtia revizioniste, pushtimi i Çekoslovakisë, zemërimi dhe revolta që këto shkaktuan në të gjithë botën. Duke ngritur çështjen kineze në mbledhjen e Moskës, Brezhnjevi kërkon që me një gur të vrasë dy zogj: të mbulojë të palarat, të largojë vëmendjen nga pushtimi i Çekoslovakisë dhe të kthejë zjarrin nga Kina, duke angazhuar në këtë luftë edhe aleatët e vet revizionistë.

Shtypi sovjetik i quan si pretendues «të favoreve të borgjezisë kombëtare», ata që do të guxojnë të bëjnë ndonjë kritikë, qoftë edhe fare të lehtë, për ndërhyrjen e armatosur të revizionistëve sovjetikë kundër popullit çekoslovak. Siç duket, rublat dhe peshqeshet nuk bënë efekt për t'i detyruar të gjithë të mbajnë heshtje për Çekoslovakinë.

Radha për të folur tani po i vjen Husakut, shërbëtor besnik i revizionistëve çekoslovakë dhe aleat i lëkundur i revizionistëve sovjetikë, të këndojoë hosananë e pushtimit të vendit të tij me termat brezhanjvianë. Ky do t'u japë carëve të rinj të Kremlinit «argumente» për të thënë se e kanë koto ata që ngrenë çështjen çekoslovakake, kur «i zoti e shet, tellalli s'e jep».

Këmbëngulja e klikës renegade revizioniste sovjetike për të ndjekur deri në fund politikën e saj hegemoniste e ekspansioniste, u vu re edhe në mbrojtjen me kryeneçësi nga Brezhanjevi të teorisë tanimë të njo-hur të të ashtuquajturit sovranitet i kufizuar. Megjithëse, për shkak të famës së keqe që ka marrë kjo politikë kriminale, ai u detyrua ta kamuflojë atë me kujdes, përsëri nuk e fshehu qëllimin e sundimtarëve hrushovianë të Bashkimit Sovjetik për të mos hequr dorë nga synimet e tyre për të nënshtruar e për të mbajtur nën zgjedhë popuj e vende të huaja. Ai foli shumë për «nacionalizmin» dhe për parimet e «internacionalizmit proletar», por tanimë është e qartë se ç'kuqtojnë revizionistët sovjetikë me nacionalizëm e internacionalizëm. Për ta është nacionalizëm çdo përpjekje e popujve të Evropës Lindore, ku sundojnë, për të mbrojtur lirinë e pavarësinë kombëtare të grabitur, çdo kundërshtim ndaj shfrytëzimit kolonialist që u bëhet. Krerët e Kremlinit quajnë «nacionalist» çdo njeri që kundërshton pushtimin e Çekoslovakisë ose denonçon politikën agresive e ekspansioniste të tyre, çdo komunist të ndershëm që hedh poshtë revizionizmin dhe mbron marksizëm-leninizmin.

Por demagogjia dhe fariseizmi i revizionistëve sovjeticë nuk mashtrojnë njeri. «Teoritë» e tyre se gjoja ata ndërhyjnë për të mbrojtur socializmin e popujt nga «veprimtaria e imperializmit», janë gënjeshtra të trasha, që nuk futen dot në thes. Intrigat që ata bëjnë rreth Vietnamit, ose sabotimi i luftës së popujve arabë janë dy shembuj konkretë që kushdo mund t'i shikojë çdo ditë dhe në çdo orë. Prandaj, si fjalët që thanë Brezhnjevi e aleatët e tij për Vietnamin, ashtu edhe rezoluta që u adoptua në mbledhje në lidhje me vendet arabe, janë blofe, manovra për ta fshehur manipulimin e këtyre çështjeve në kuadrin e aleancës sovjeto-amerikane për ndarjen e zonave të influencës. Por mos kujtojnë revizionistët sovjetikë se do të mposhtin luftën e popujve arabë me atë rezolutë të firmosur nga njerëz si Larbi Buhali, i cili, në kohën kur populli i tij algjerian derdhë gjakun lumë për lirinë e pavarësinë kombëtare, bënte ski dhe thyente këmbët në malet piktoreske të Tatrës?

Taktika që ndoqi klika revizioniste e Bashkimit Sovjetik gjatë përgatitjes së mbledhjes së Moskës dhe qëndrimi që po mban në të, tregojnë se ajo kërkon me çdo kusht të angazhojë në rrugën e saj të aventurave kundërrevolucionare klikat në fuqi të partive revisioniste, që u janë shitur me trup e me shpirt carëve të rinj të Kremlinit. Qëndrimi i këtyre në mbledhjen e Moskës do të vërtetojë edhe një herë se deri në ç'shkalë ato janë bërë shërbëtore të Brezhnjevit. Këto klika po i futin në një rrugë të rrezikshme ata që u venë pas në mënyrë naive. Masat e anëtarëve të partive të tyre vihen përpara alternativës: o luftë me marksizëm-

-leninizmin, me Shqipërinë, me gjithë forcat revolucionare, o zjarr mbi tradhtinë revizioniste.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe gjithë marksistë-leninistët e botës do t'i kryejnë kurdoherë detyrat e tyre internasionaliste. Ata do të luftojnë deri në shkattërimin e plotë të revizionizmit modern. Ne do t'i kthehem e do t'i rikthehem përsëri demaskimit të planeve dhe të veprimeve kriminale të revizionistëve sovjetikë e të aleatëve të tyre, siç janë ato që po thuren tani në mbledhjen e Moskës. Në nuk do të lëmë asnjëherë që udhëheqësit hruščovianë sovjetikë, me demagogjinë e tyre, të mashtrojnë klasën punëtore ndërkombe të. Dhe jemi të bindur se opinioni publik kudo në botë, dhe, në radhë të parë, revolucionarët, do të ngrihen me forcë kundër revizionizmit modern, për të përmbysur e për të varrosur tradhtinë e tij të madhe. E drejta është me ne, prandaj edhe fitorja do të jetë në anën tonë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 137 (6489), 10 qershor 1969

*Botohet, me ndonjë shkurtim,
sipas librit: Enver Hoxha.
«Kundër revizionizmit modern
(Përbledhje veprash)
1968-1970», f. 406*

PSE REVIZIONISTËT SOVJETIKË KANË FRIKË TË FLITET PËR ÇEKOSLLOVAKINË NË MBLEDHJEN E MOSKËS?

Artikull i botuar në gazeten «Zëri i popullit»

14 qershor 1969

Dihej dhe pritej shumë kohë përpara se të fillonte punimet mbledhja e partive revizioniste në Moskë, se krerët e Kremlinit do të ndiqnin aty taktikën e heshtjes lidhur me agresionin fashist që ndërmorën gushtin e kaluar kundër Çekoslovakisë. Ishin të njoitura presionet e tyre brutale mbi partnerët revizionistë, që ata të mos bënинasnje fjalë, asnje aluzion për një nga aktet më të ulëta të banditizmit ndërkombëtar, që tronditi thellë ndërgjegjen e popujve dhe indinjoi pa masë internacionalistët e vërtetë kudo në botë. Krerët e Kremlinit donin që «çështja çekoslovakake» të kalohej lehtë-lehtë, sikur të ishte një gjë e rastit, një episod i thjeshtë në marrëdhëni midis «vendeve vëllezër» e «partive motra», një ngjarje pa rrjedhim.

Vetë fakti që revizionistët sovjetikë nuk sajuan as gjë më të mirë për veten e tyre veg këtij qëndrimi burracak, éshtë prova më e gjallë dhe një pranim i tër-

thortë i kalbësisë së themeleve mbi të cilat është ngritur gjithë «argumentimi» i tyre zyrtar për «nevojën» dhe «domosdoshmérinë» e ndërhyrjes në Çekoslovakia, për «ndihmën internacionaliste» që ata gjoja i dhanë popullit çekoslovak kundër «armiqve të klasës» etj. Në realitet çështja shtrohet pa terma gjysmakë e ekuvokë, në trajtën e një alternative të vetme: ose ndërhyrja ka qenë vërtet «e domosdoshme», një «ndihmë» vërtet «vëllazërore», pra një gjë pozitive, dhe atëherë autorët mund të dalin ballëhapur e me ndërgjegjen të pastër përparrë mbledhjes dhe gjithë botës; ose ka qenë një agresion barbar kundër një vendi tjetër, një shkelje flagrante e sovranitetit dhe e pavarësisë së tij dhe atëherë fajtorët duhet të vihen ballë për ballë me vepren e tyre të fëlliqur, me turpin e tyre të zbuluar. Duke kërkuar «fletën e fikut», revizionistët e Kremlinit sikur e thanë me gojën e tyre se janë mbërthyer në shtyllën e turpit.

Udhëheqësit sovjetikë do të kishin dëshirë të jepnin në mbledhje spektakle pompoze «solidariteti proletar», duke pasur si temë pikërisht çështjen çekoslovakë, ta kthenin atë në një festival himnesh panegjrike për të ngritur në qzell «meritat» e shtetit «udhërrëfyes» dhe të partisë «mëmë». Në qoftë se vendosën të mbështillen rreth vetes dhe tamam si një bandë gangsterësh të regjur, që kryejnë krimin dhe pastaj përpiken të fshehin gjurmët, këtë nuk e bënë nga e mira.

Puna është se aventura çekoslovakë u kushtoi shumë shtrenjtë. Operacioni i invadimit, nga pikëpamja politike, u kthye në një disfatë katastrofike për agreso-

rët. Rezistenca e popullit çekoslovak ua prishi planet pushtuesve: listat emërore të përbërjes së «qeverisë punëtore revolucionare», të përgatitura që më parë, iu dogjën në dorë. Deshën s'deshën ata u mbyllën në sallat e Kremlinit me jesirët çekoslovakë dhe inskenuan aty, prapa një perdeje të hekurt, farsën e bisedimeve «të të barabartit me të barabartin». Klika e Brezhnjev-Kosiginit, në vend të përmbyssjes së ekipit revisionist të Dubcek-Svobodës, që e kishte shpallur bile vetë që ditën e parë të pushtimit, u detyrua të bëjë mbrapsht e të kënaqet hëpërhcë me kapitullimin e tij.

Një e papritur tjetër, e lidhur ngushtë me të parën, ishte jehona që patën ngjarjet e Çekoslovakisë në radhët e partive revisioniste të vendeve të tjera. Një valë e madhe hutimi i pushtoi ato dhe fronti revisionist filloj të japë shenja të rrezikshme shthurjeje. Parullat false të «larmisë së rrugëve për në socializëm», të «liberalizimit», të «humanizmit» lindën jo pak iluzione e tendencia shkëputjeje nga tutela e më të madhit. Mirëpo revisionizmi sovjetik nuk do të ishte revisionizëm, po të hiqte dorë nga lufta për hegemoni. Bile kjo është një nga tiparet më karakteristike të procesit të transformimit kapitalist. Padronët e rinj të Moskës e treguan qartë se kanë vendosur që kontradiktat me partnerët e tyre, atje ku u shkon, t'i zgjidhin me anë të «dubinkës» (kopaçes).

Revisionistëve sovjetikë iu desh të bënin një punë plot mundime për të kthyer tufën në vathë. Mbledhja, që ishte planifikuar të mbahej që vjet, u la dhe në vend të saj filluan takimet një për një, bisedimet në grupe, shkëmbimet e mendimeve në komisione përga-

titore, të cilat arritën dalngadalë në një marrëveshje kompromisi për të mos e hapur plagët çekoslovake. Por gjithë Mizanskena kishte rrezik të binte poshtë e të bëhej copë e thërrime, po të mos sigurohej «normalizimi» çekoslovak. Rezistenca këmbëngulëse e klassës punëtore dhe e rinisë në Çekoslovakia jo vetëm kundër pushtimit të huaj, por edhe kundër kapitullimit të partisë revizioniste çekoslovake, e bënte praktikisht të pamundur çdo marrëveshje që mund të arrihej jashtë Çekoslovakisë e në kurrit të saj.

Në këto rrethana Kremlini vendosi se Dubçeku nuk ia bënte më punën. Ky e tregoi se ishte i paaftë të vinte «rregull» në vend dhe të zbatonte deri në fund «normalizimin» revizionisto-fashist të pasgushtit. I mbërthyer siç ishte në kaiken që lëkundej pa pushim midis valëve të rezistencës popullore dhe të presioneve të pushtuesit, Dubçeku nuk jepte asnje siguri për qëndrimin që do të mbante në mbledhjen e ardhshme të Moskës. Kështu një tjetër limon i shtrydhur u hodh në kosh dhe zgjedhja e Brezhnjevit ra mbi Husakun. Natyrisht, kjo nuk do të thotë se për sundimtarët e Kremlinit Husaku është qind për qind i sigurt. Por ai është njeriu i kësaj etape, një njeri që ka marrë përsipër, ndër të tjera, një rol delikat për funksionimin e komplottit të heshtjes në mbledhjen e Moskës. Në qoftë se është gati të kryejë detyrën që i është caktuar, ai mund të lejohet t'i shijojë «gëzimet e push-tetit». Më vonë? Edhe për më vonë janë gati «pjesët e këmbimit».

Është e qartë tani se ndërrimi i rojës që u bë në Pragë dy muaj më parë, hynte në kuadrin e masave

përgatitore të mbledhjes që po zhvillohet në Moskë. Është e qartë, gjithashtu, se i vetmi orator i autorizuar, në bazë të programit sovjetik të zhvillimit të punimeve të mbledhjes, për të zënë në gojë «çështjen çekoslovake» ka qenë kreu i ri i revizionizmit çekoslovak, Husaku. Kuptohet se kjo «e drejtë» e tij ishte që në fillim dyfish e kondicionuar: nga njëra anë, ai do të hapte gojën vetëm në rast se bëhej i gjallë ndonjë i pabindur, nga ana tjetër, lejohej të fliste jo për të qarë hallet e popullit të tij, viktimë e agresionit, por për t'i dhënë dorë taktilës sovjetike të justifikimit të agresionit.

Qysh përpara hapjes së mbledhjes, revizionistët e Pragës, të gjunjëzuar përpara pushtuesit, nxorën rezoluta e deklarata në të cilat cilësonin si «ndërhyrje në punët e brendshme» të Çekoslovakisë qdo orvatje për të shtruar në mbledhje çështjen çekoslovake.

Nga ana e saj gazeta sovjetike «Pravda», me një ton haptazi kërcënues, paralajmëronte delegatët në mbledhje që «të mos tërhiqen nga tundimi për të shtuar popullaritetin në vendet e tyre duke mbajtur qëndrime antisovjetike». Aluzioni për ata që kishin tendencë të përmendnin, sadopak, çështjen çekoslovake, ishte më se i qartë.

Shumica e partive revizioniste nxituan t'i përgjigjen «thirrjes» dhe përfaqësuesit e tyre në mbledhje, për turpin e tyre dhe të mbledhjes vetë, ndonëse folën mbarë e prapë, iu përbajtën porosisë dhe e qepën gojën për çështjen çekoslovake. Vetëm aty-këtu u dëgjuan zëra «disidentë», bile edhe këta të ngjirur e të venitur. Kështu australiani, zvicerani, norvegjezi e ndonjë tjetër morën «guximin» të thoshin se agresioni

kundër Çekoslovakisë ishte një «gabim». Revizionistët italianë, të preokupuar siç janë për të dhënë prova autonomie në kuadrin e gjithë fushatës së tyre për të hyrë në qeverinë borgjeze, shprehën edhe një herë të ashtuquajturin mosaprovim të thellë për ndërhyrjen në Çekoslovakia. Kaq mjaftonte pér të vënë në lëvizje gjithë mekanizmin e përgatitur me kohë. Ka lajme se midis delegatit italian dhe atij çekoslovak tërë këto ditë u zhvillua një luftë proceduriale në prapaskenë kush e kush të fitonte të drejtën të fliste pas tjetrit. Organizuesit e mbledhjes, sovjetikët, natyrisht, menduan edhe pér këtë dhe, siç mund të pritej, lufta proceduriale mbaroi në favor të Husakut.

Fjalimi i Husakut në mbledhje është një dokument që pasqyron me saktësi gjithë humnerën e tradhësisë dhe të degjenerimit ku mund të çojë revizionizmi modern. Ky lake pa princip, që ka bërë brenda një kohe të shkurtër një karrierë të rrufeshme duke kaluar nga burgu në fron, pranon t'u shërbejë padronëve të tij të Kremlinit.

«Ajo që na çudit më shumë, — tha kuislingu çekoslovak, — është fakti se disa parti motra, bile edhe këtu, duke pasur njoftime të sipërfaqshme për punët tona... nxjerrin konkluzione të papjekura për çështjen çekoslovake, gjë kjo që është në kundërshtim me interesat tanë». Prandaj, vazhdoi ai, «të tjerët duhet të jenë më të duruar, të tregojnë mirëkuptim». Shkurt, duhet të mbyllin gojën dhe të bashkohen të gjithë pa rezerva me komplotin e heshtjes.

Kështu, pra, sipas logjikës revizioniste, divisionet, tanket dhe aeroplanët sovjetikë në tokën çekoslovake

na qenkan «njoftime të sipërfaqshme». Pushtuesit i kanë vënë shqelmin në fyt popullit çekosllovak dhe po e rrënojnë vazhdimisht vendin në çdo drejtim, duke e katandisur në gjendjen e një kolonie të thjeshtë, kurse kuislingu Husak bërtet në mbledhje se s'ka «çështje çekosllovake»! Sipas kësaj logjike, del se disa parti nuk duhet të nxitohen të nxjerrin «konkluzione të papjekura» për punët në Çekoslovakia, kurse disa të tjera duhet të vrapojnë të dërgojnë trupa për ta okupuar ushtarakisht Çekoslovakianë. «Mos ndërhyni në punët tona të brendshme, kjo është çështje që na përket neve» thërret Husaku sipas formulave të mësuara përmendsh. Po si mund të merret seriozisht një pohim i tillë kur gjithë bota e sheh me sy se Çekoslovakia sot është katandisur në nivelin e një vendi pa «punë të brendshme», se ato i kanë nxjerrë jashtë në rrugë e me to bëjnë si duan revizionistët sovjetikë? Kush nuk e di se klika e Brezhnev-Kosiginit është në gjendje, në rrethanat e tanishme, t'i luajë fijet në Çekoslovakia sipas interesit të saj: edhe parlamentin mund ta shpërndajë, edhe qeverinë mund ta ndërrojë, edhe plenumi të partisë mund të organizojë, edhe deklarata e komunikata mund të sajobjë.

Fjalimi i Husakut, pra, nuk është dhe nuk mund të jetë kurrë shprehje e vullnetit të klasës punëtore çekosllovake, e ndjenjave dhe e aspiratave të popullit çekosllovak, e gjendjes shpirtërore të rinisë çekosllovake, që vuajnë që të gjithë nën thundrën e okupatorit të huaj.

Një shërbim tjetër deshi t'u bëjë Husaku padronëve të tij me trajtimin që i bëri tezës famëkeqe të

«sovranitetit të kufizuar». Prej çorbës që ai gatoi, me fjalë të varfra del pak a shumë kjo: qdo vend socialist ka sovranitet të brendshëm, për sa u përket marrëdhënieve me jashtë, veçanërisht kur shtrohet çështja për ta mbrojtur këtë sovranitet; nocioni i sovranitetit lidhet në mënyrë të pazgjidhshme me interesat dhe me politikën hegemoniste të klikës Brezhnjev-Kosigin.

Në ndihmë të tij për një argumentim më «bindës» të kësaj teze antimarksiste e kundërrevolucionare revisionistët sovjetikë shtinë në skenë një personazh rezervë, kreun famëkeq të revizionizmit hungarez Janosh Kadar. Revisionisti me damkë Janosh Kadar, ai që, pasi doli nga burgu, u bashkua me fashistin Imre Nagi e së bashku me të më 1956 udhëhoqi kundërrevolucionin kriminal në Hungari, likuidoi partinë hungareze, tanë bëhet «ideologu» i teorisë brezhanjeviane të «sovranitetit të kufizuar», të agresionit fashist kundër Çekoslovakisë. «Ne duhet ta dimë, — tha ai, — dhe përvuja e provon se, kur është çështja përfat e një vendi socialist, atëherë të gjithë ndërhyjnë».

Dhe q'fjalë të tjera mund të priten nga një kundërrevolucionar i regjur që ka shitur, bashkë me marksi-zëm-leninizmin, edhe sovranitetin e vendit të vet, ku lulëzon kapitalizmi me të gjitha ngjyrat, që qëndron në fuqi në sajë të bajonetave të forcave pushtuese të padronëve të tij të Moskës dhe që si mercenar profesionist dërgoi trupat hungareze përfi grabitur lirinë popullit çekoslovak? Kuptohet se kuislingu veteran Kadar edhe për krerët e Kremlinit është më pak i kualifikuar përfi mbrojtur teoritë e tyre agresive, por, si i thonë fjalës, «kur s'ke pulën, ha sorrën».

Sa më shumë shkojnë ditët, aq më qartë del edhe për vetë pjesëmarrësit se në planet e klikës Brezhnjev-Kosigin që e organizoi atë, mbledhja revizioniste e Moskës ka për detyrë të përligjë politikën e saj kundërrevolucionare të kompleteve e të agresioneve, të hegjemonisë në frontin revizionist e të strategjisë globale imperialisto-revizioniste.

Një mbledhje partish të vërteta marksiste-leniniste nuk do të kishte lënë pa vënë në bankën e të akuzuarve Brezhnjevin e Kosiginin me shokë për krimet që kanë bërë në dëm të kauzës së madhe të komunizmit, pér degjenerimin kapitalist të jetës politike, ekonomike, shoqërore në Bashkimin Sovjetik, pér bashkëpunimin me imperializmin amerikan, pér qëndrimin tradhtar në problemet më të mëdha të kohës: Vietnam, Lindje e Mesme etj., pér politikën armiqësore kundër RP të Shqipërisë etj. Një mbledhje e vërtetë komuniste do të ishte kthyer në një gjyq të rreptë pér agresionin sovjetik kundër Çekosllovakisë. Sepse çështja shtrohet edhe pér mbledhjen pa terma gjysmakë, në trajtën e alternativës, që u përmend më lart: **ose** ndërhyrja në Çekosllovaki ishte një vepër e mirë dhe atëherë duhet të përkrahet e të lavdërohet; **ose** përkundrazi, ka qenë një krim dhe atëherë detyra e komunistëve është që ta stigmatizojnë atë me forcë si një akt të papajtueshmëm me marksizëm-leninizmin dhe me marrëdhëni midis partive komuniste e shteteve socialiste. Dhe e vërteta gjendet jo duke i zënë besë Husakut, që s'është veçse një qehaja pa skrupull, por duke i vënë veshin popullit të Çekosllovakisë, që lëngon nën zgjedhën e huaj. Një mbledhje e vërtetë komuniste nuk do të

mbante kurrë heshtje kundrejt një problemi kaq serioz, por do të damkoste me vulën e tradhtisë e të krimit klikën agresore e imperialiste të Kremlinit.

Me gjithë përpjekjet e klikës revizioniste të Moskës, me gjithë konferencat dhe deklaratat «ndërkombe-tare», kauza e popullit çekoslovak nuk mund të varroset. Agresioni fashist kundër Çekoslovakisë qëndron si një aktakuzë e gjallë e dërrmuese kundër klikës së Moskës dhe gjithë atyre që janë lidhur pas qerres së saj. Asnjë komplot heshtjeje nuk mund t'i shpëtojë agresorët revizionistë sovjetikë nga përgjegjësia që kanë përpara popullit çekoslovak, përpara marksizëm-leninizmit dhe klasës punëtore të të gjitha vendeve, përpara forcave të gjalla revolucionare që shprehin aspiratat dhe interesat e vërtetë të popujve. Pushtuesit sovjetikë në Çekoslovakia janë ulur mbi vullkanin e zemërimit e të hakmarrjes së një populli që lufton për të drejtat e tij themelore. Populli çekoslovak do të dijë t'i fitojë këto me rrugë revolucionare. Me dhunën e armëve u shtyp, me forcën e armëve ai do të çlirohet nga zgjedha e urryer e pushtuesve fashistë revizionistë dhe e tradhtarëve të vendit dhe do të riven-dosë diktaturën e proletariatit nën udhëheqjen e klasës punëtore e të pararojës së vërtetë marksiste-leniste që ka për të dalë nga gjiri i saj në luftë e sipër.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zeri i popullit»,
nr. 141 (6493), 14 qershori 1969*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përbledhje
veprash) 1968-1970», f. 415*

EFEKTET E PUNËS EDUKATIVE TË PARTISË DUKEN NË QËNDRIMIN E NJERËZVE NDAJ PUNËS

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

20 qershor 1969

Për çështjet që lidhen me riedukimin dhe luftën kundër elementeve të deklasuar e me qëndrim të keq politik Partia ka folur vazhdimesht. Orientimet që ka dhënë ajo për këto çështje janë të qarta, por, kur vjen puna për t'i vënë në zbatim, ka njerëz që gabojnë. Në parim drejtues të bashkimeve profesionale i dinë orientimet, por shokëve të bazës u thonë shumë fraza, shumë parime, prandaj, kur vjen puna në praktikë, këta nuk veprojnë si duhet dhe shkojnë ose djath-tas, ose majtas. Gjëra të tillë ngjasin se as drejtuesit e bashkimeve profesionale, as punëtorët e Partisë në

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rrëth raportit «Mbi identifikimin, kontrollin, riedukimin dhe luftën kundër elementeve të deklasuar e me qëndrim të keq politik, që janë në organizatën profesionale dhe jashtë saj», paraqitur nga Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë.

bazë nuk i kanë shtruar si duhet këto çështje kaq të rëndësishme politike.

Shoku i Minierës së Pishkashit pak më parë pyeti se si duhet të veprojnë konkretisht, për shembull, kur në ndërmarrje kanë një inxhinier, që shteti i ka besuar një sektor të tërë të minierës, i cili, ta supozojmë, është bir kulaku, ose ka gjyshin kulak. Veç përbërjes jo të mirë politike, ky inxhinier ka edhe disa të meta, disa shfaqje mikroborgjeze më të theksuara se të tjerrët, dy herë i është hequr vërejtje për mungesë disipline, ndërsa në punë jep një rendiment të madh. Në këto kushte, ky njeri duhet përjashtuar nga organizata e bashkimeve profesionale, apo kjo organizatë duhet të vazhdojë punën edukative me të që të ndreqet? Këtë kërkon të dijë, më duket, shoku i Pishkashit.

Detyra jonë është që njerëzit t'i edukojmë dhe t'i riedukojmë, prandaj duhet të shikojmë vazhdimisht si qëndron politikisht e sa përpinqet të rehabilitohet një person i deklasuar ose me të kaluar jo të mirë, sa ka zënë vend tek ai puna e Partisë, c'prova ka dhënë etj. Vetëm duke gjykuar drejt për të gjitha këto, mund të formojmë bindjen nëse duhet pranuar një njeri i tillë në organizatën e bashkimeve profesionale ose jo. Po nuk i pamë kështu problemet, atëherë të gjitha ato që themi për punën edukative që bën dhe duhet të bëjë Partia, mbeten fraza, sloganë.

Shoku Hysni dhe shoku Ramiz në diskutimet e tyre e ritheksuan edhe një herë çështjen e edukimit dhe të riedukimit të elementeve të deklasuar e me qëndrim të keq politik, duke e argumentuar drejt nga pikëpamja politike dhe ideologjike. Tani ju takon ju-

ve, në radhë të parë, shokë të bashkimeve profesionale, që ta kuptoni vetë dhe ta kuptoni drejt, siç na mëson Partia, këtë çështje, ta shtroni atë në organizatat e bashkimeve profesionale dhe, njëkohësisht, të organizioni punën për të kontrolluar zbatimin e saj të plotë në praktikë, duke vepruar kurdoherë me vigjilencë revolucionare, pa qenë as sektarë dhe as oportunistë. Njerëzit e deklasuar, që nuk kanë mbajtur qëndrim të mirë politik në të kaluarën, por që nga puna e vazhdueshme e Partisë edukohen dhe riedukohen, mbahen afër; ndryshe veprohet me të tjerët, që vazhdojnë të mbajnë qëndrim armiqësor. Tjetër rrugë nuk ka. Partia e ka theksuar kurdoherë se puna e saj kryesore është edukimi i të gjithë njerëzve, pra edhe i elementeve të tillë. Në punë e sipër, nëpërmjet qëndrimit të secilit, do të duken edhe efektet e kësaj pune.

Marksit na mëson se mjaft nga elementët që rrjedhin nga klasat shfrytëzuese shkëputen prej tyre dhe bashkohen me klasën e proletarëve, përqafojnë me ndërgjegje ideologjinë e kësaj klase, bëhen të vendosur dhe luftojnë së bashku me proletarët. Në fakt, njerëz me prejardhje nga klasat shfrytëzuese, por që i kanë braktisur ato, janë bashkuar në mënyrë të vendosur me klasën punëtore, kanë dhënë prova besnikërie dhe zotësie në luftë e në punë dhe janë bërë të vlefshëm për atdheun. Mjaft nga intelektualët e së kaluarës, edhe djem të borgjezisë, që u bashkuan me proletarët dhe me popullin e luftuan për qëllimet e Partisë, dhanë prova besnikërie ndaj saj, prandaj mjaft nga ata u bënë edhe komunistë. Në qoftë se dikush vepron në të kundërtën, Partia e qeron, por më parë

ajo e ka për detyrë ta edukojë, ta kritikojë, ta mësojë, dhe vetëm po ta mbushë kupën e s'ka ç'të bëjë më me të, atëherë merr masa, e ul në përgjegjësi, e transferon, ose, kur është në Parti, e përjashton si njeri të padëshirueshëm nga radhët e saj.

Mësimet e Partisë për punën që lypset bërë me njerëzit, t'i kemi kurdoherë parasysh që t'i vëmë mirë në jetë, se po të mos zbatohen si duhet, s'bëjmë tjetër veç shtojmë radhët e armikut. Edhe kur pesë artizanë, fjala vjen, nuk janë anëtarë të bashkimeve profesionale, ndaj tyre nuk duhet vepruar në mënyrë diskriminuese, por t'u sqarohet ç'është organizata e bashkimeve profesionale, për ç'arsye në rastin konkret, ata nuk mund të bëhen anëtarë të saj dhe t'u thuhet se perspektiva për t'u futur në të nuk u është mbyllur. Gjithashtu të tregohet kujdes që organizata e bashkimeve profesionale t'i ndihmojë e t'i këshillojë vazhdimisht që edhe ata vetë të punojnë e të japid prova që në të ardhmen ta meritojnë anëtarësinë. Ndihma për këta elementë të mos jetë vetëm me fjalë, po e shumanshme, ndryshe do të biem në sektarizëm, gjë që Partia nuk duhet ta lejojë.

Në ndonjë rast diskutohet nëse një njeri i kësaj kategorie duhet pranuar anëtar dhe nëse mund të zgjidhet në drejtim të organizatës së bashkimeve profesionale. Sigurisht, njerëz të pakontrolluar, elementë armiq e me qëndrim të keq politik nuk duhen pranuar në këtë organizatë, pale të dalin në udhëheqje të saj, por, në qoftë se ndodh që një punonjës i tillë, ta zëmë, futet tri herë në zjarr, duke vënë jetën në rrezik për interesat e atdheut e të socializmit, atë mund edhe ta

dekorojmë, prandaj edhe në udhëheqje të organizatës së bashkimeve profesionale mund ta zgjedhim.

Kur shkova para një muaji për vizitë në një fshat, pa e njojur kush ishte, m'u sul një vajzë dhe më puthi, siç më puthën edhe shumë të tjerë. Më pas mësova se ajo ishte vajza e një hajduti, kusari dhe ballisti të poshtër, që ne e kemi pushkatuar. Mirëpo shokët më treguan se kjo vajzë punon mirë, tregohet revolucionare. Atëherë, çfarë t'i bëjmë ne kësaj vajze, t'i përsëritim çdo mëngjes emrin e të atit dhe t'i themi që ti je çupa e tij? Po të veprohej në këtë mënyrë me një vajzë të tillë, nuk do të ishte aspak e drejtë, dhe Partia nuk na mëson kështu. Gjersa ajo e dënon babin, punon me mish e me shpirt dhe jep prova për popullin, për Partinë, për socializmin etj., atëherë ta inkurajojmë, ta mbajmë afër, ta bëjmë gjithnjë e më të vendosur.

Ne duhet ta ndajmë çështjen e vendosjes në punë të elementeve të deklasuar e me qëndrim të keq politik, nga ajo e anëtarësisë në organizatën e bashkimeve profesionale, ose e qenies së tyre në udhëheqje të kësaj organizate. Këta zakonisht dërgohen për të punuar në vende të vështira pune, por të mos na thuhet me frikë se me elementë të tillë është mbushur kjo ose ajo ndërmarrje, sepse edhe për njerëzit e deklasuar duhet të mendojmë që t'i vendosim diku, se pa punë nuk mund t'i lëmë.

Kur isha kohët e fundit në një qytet, pyeta, ndër të tjera, edhe se ku ndodhej djali i një armiku me damkë dhe më thanë që punon marangoz në një rrëth tjetër. Çfarë duhet t'i bëjmë ne këtij djali që

punon marangoz? Ta heqim nga ndërmarrja? Po ku ta çojmë? Dy rrugë ka për të, ose ta lëmë të punojë si marangoz apo ta shpiem të hapë kanale, ose ta futim në burg. Në burg nuk mund ta futim për krimet që ka bërë babai i tij. Në qoftë se vetë nuk qëndron mirë, çështja nuk diskutohet, në bazë të ligjeve kemi të drejtë të veprojmë kundër tij, por gjersa ai nuk vepron kundër nesh, medoemos do ta caktojmë të punojë diku. Ndonjëri mund të thotë se është më mirë që ky djalë të shkojë të punojë për hapjen e kanaleve. Në qoftë se këtë masë e marrim me kuptimin që puna në kanal, si një punë e rëndë, ndihmon për t'i edukuar më mirë njerëz të tillë, jam dakord, po jo t'i themi që, meqenëse ti je djali i këtij ose i atij armiku, shko të punosh në kanal. Kështu do të dukej sikur puna në kanale është dënim dhe sikur të gjithë njerëzit tanë që punojnë atje, fshatarët, punëtorët e bashkë me ta edhe komunistët, janë njëlloj me djalin e një armiku.

Këto çështje që diskutuam, shokë, kanë rëndësi të madhe, prandaj merrni masa që për zgjidhjen e tyre të mos shkohet as nga e djathta, as nga e majta, por të zbatohet drejt e me përpikëri vija e Partisë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

ÇDO FORUM I PARTISË MË PARË DUHET TË USHQEHET QË TË USHQEJË EDHE AI

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

20 qershor 1969

Kam disa pyetje për shokët sekretarë të komiteve të Partisë të rretheve që kemi ftuar në këtë mbledhje dhe për shokët instruktorë të Komitetit Qendror të Partisë:

1. Si punojnë shokët e rinj që janë zgjedhur në udhëheqje të organizatave-bazë dhe të komiteteve të Partisë?
2. Si i kanë organizuar komitetet e Partisë lidhjet e punës me bazën në drejtim të orientimeve të dhëna?
3. Si është organizuar studimi i Historisë së Partisë për agjitatorët, propagandistët dhe për bazën e Partisë?

Ju shokë sekretarë të komiteteve të Partisë të rre-

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth punës së Partisë për edukimin ideologjik të punonjësve dhe për trajtimin e punëtorëve në minierat e Memaliajt e të Pishkashit.

theve, që jeni të pranishëm në këtë mbledhje, mund t'u përgjigjeni këtyre pyetjeve në dy mënyra: E para, me disa fraza të përgjithshme stereotipe, që mund të zgjatin vetëm dy-tri minuta. Një mënyrë si kjo nuk na thotë gjë, prandaj as që kemi nevojë për të. E dyta, mund të na bëni një analizë konkrete, me anët pozitive dhe negative të çështjes, duke na svaruar ku jemi me këto probleme dhe ç'masa të mëtejshme mendoni të marrim. Kjo mënyrë na duhet neve, vetëm se përgjigjja nuk duhet të zgjatë shumë.

Në dukje këto pyetje janë jashtë temës për të cilën jeni thirrur të raportoni, por, po ta gjykojmë çështjen më thellë, ato kanë të bëjnë me të.

Pyetjet jua bëj jo vetëm pse jeni kompetentë të flitni për këto probleme dhe Sekretariati i Komitetit Qendror, më parë se t'ju ndihmojë, kërkon ndihmën tuaj, por jua bëj edhe për një arsyе tjetër, se ka gati gjashtë muaj që instruktorët e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë nuk po e vënë në dijeni Sekretarin për këto probleme. Në lidhje me këtë dëshiroj t'i pyes shokët instruktorë: Përse ngjet një gjë e tillë? Bëni, ju lutem, një analizë kritike të metodës suaj të punës!

Shokë instruktorë, shumë herë e kemi shtruar çështjen e metodës së punës suaj si për përgatitjen që bëni këtu para se të niseni, ashtu edhe për ndihmën që i jepni bazës, për kontrollin e zbatimit të vendimeve dhe, më në fund, për mënyrën e raportimit të problemeve përrpara Sekretariatit të Komitetit Qendror, punë kjo që nuk duhet konfonduar aspak me bashkëpunimin e ngushtë që ka secili nga ju me sekretarin përkatës të Komitetit Qendror.

Byroja Politike dhe Sekretariati i Komitetit Qendror marrin vendime të rëndësishme, për zbatimin e të cilave duhet t'i raportohet medoemos Sekretariatit. Dhe këtë punë duhet ta bëni ju, me ndihmën e sekretarëve përkatës të Komitetit Qendror. Nuk duhet të konfondohet metoda e raporteve, e diskutimeve dhe e këshillimeve të përditshme shumë të nevojshme që bëni ju me sekretarët e Komitetit Qendror, me raportet që duhet të jepni përpara Sekretariatit për problemet kyç, sepse këto janë dy çështje krejt të veçanta. Këtë detyrë, më vjen keq që po e them, ju nuk po e kryeni si duhet. Ju mungon vallë zotësia dhe eksperiencia? Unë mendoj se jo; arsyaja është se ju nuk e keni fituar akoma si duhet atë metodë të mirë pune që rekmandoher në vija të trasha, të cilën e pasurojnë vëmendja, kujdesi dhe eksperiencia.

Nuk rekandoj që tani të na mbuloni me karta, por për ato lloj problemesh kyç që thashë, si dhe për mjaft të tjera, këtu në Sekretariatin e Komitetit Qendror duhet të na paraqiten raporte konkrete edhe me shkrim, por më shumë me gojë, të shkurtra, me plot ide, mendime, sugjerime dhe eksperiencë.

Prandaj nuk është e drejtë të flihet mendja për këto çështje, duke menduar se, mbasi Sekretariati ka një plan pune vjetor, mjafton të bëjmë përpjekje për ta zbatuar atë dhe me kaq të kujtojmë se e kemi kryer detyrën. Në qoftë se nuk gabohem, kështu mendojnë shokët instruktorë. Punojnë këta ose jo për një temë të caktuar që parashikon plani vjetor, kjo është një çështje tjetër, po detyrën nuk duhet ta konsiderojnë të kryer vetëm me kaq.

Më lejoni të bëj këtu një parantezë të vogël. Tema e rendit të ditës sot ishte: «Mbi punën e Partisë për edukimin ideologjik të punonjësve dhe për trajtimin e punëtorëve në minierat e Memaliajt e të Pishkashit».

Pjesën e parë e preku pak vetëm shoku Xhafer [Spahiu]¹, me të cilin jemi dakord edhe ne sekretarët e tjerë, mbasi s'kemi ç'të shtojmë më tepër nga ato që tha ai, ndryshe nuk do të bënim tjetër, veç të thoshim gjëra të përgjithshme. Kurse nga ju, shokë instruktorë, asnje nuk ngriti dorën të kërkonte leje që të fliste për këtë çështje. As ju, shokë të Frontit, të Bashkimeve Profesionale nuk patët gjë për të na thënë? Ju shkoni kudo për të parë konkretisht si edukohet klasa punëtore, nuk na thatë ç'veshtirësi ka, ç'sugjerime bëhen prej saj etj. Por në qoftë se ka shokë që duhet të flasin për këtë problem, jeni ju dhe shokët instruktorë të Komitetit Qendror e, megjithëkëtë,asnje nuk e mori mundimin të diskutonte. Është i drejtë ky qëndrim? Natyrisht, jo, ca më tepër që gjatë diskutimeve ju patë se u trajtua vetëm ana ekonomike e problemit.

Këtë vërejtje duhet ta kuptioni mirë ju, shokë instruktorë, prandaj mos e flini mendjen vetëm me paraqitjen në udhëheqje të problemeve që parashikon plani vjetor. Ju vetë i keni konstatuar të gjitha sa thuhen në raport, por jeni kënaqur se për ato i keni raportuar sekretarit të Komitetit Qendror. Kjo është arsyja që nuk diskutoni kur shtrohet këtu një problem si ky dhe mjaftoheni vetëm të dëgjoni, në vend

1 Në atë kohë sekretar i Komitetit Qendror të Partisë.

që të na informoni edhe vetë për anët e mira dhe për dobësitë që ekzistojnë rreth problemit në diskutim, me qëllim që çështja të bëhet e qartë, që pastaj edhe ne të mund të diskutojmë dhe të nxjerrim konkluzione të drejta.

Veç kësaj, problemet që na paraqiten në Sekretariat, ka raste që jo vetëm nuk trajtohen si duhet, por nuk na vijnë as në kohë dhe kështu u humbet aktualiteti. Sa herë që kemi hartuar planin tonë vjetor të punës, kemi theksuar se ky është orientues, mbasijeta nxjerr plot probleme të tjera që s'i parashikon dot të gjitha. Bëj pyetjen: ku janë këto probleme për Sekretariatin? Unë asgjë nuk shoh të na paraqitet. Këto probleme duhet të na i rekomandoni pikërisht ju, shokë instruktorë, jashtë planit të hartuar vjetor.

Ju punoni, lodheni dhe unë e çmoj lart punën që bëni, por nuk mund të mos ju tërheq vëmendjen për ndonjë dobësi të punës suaj. Ju vë, gjithashtu, në dukje që të mos kënaqeni duke menduar se për këtë ose për atë problem keni informuar sekretarin përkatës të Komitetit Qendror, jeni këshilluar dhe keni marrë ndihmën e tij. Kjo është një gjë shumë e mirë dhe duhet të vazhdoni medoemos me këtë praktikë. Sekretarët e Komitetit Qendror më vënë edhe mua në dijeni për problemet që u ngrini ju, edhe ne sekretarët diskutojmë bashkërisht po për këto probleme, megjithatë duhet të njohim se nuk është kjo forma më e mirë e punës kolegiale. Një mënyrë e tillë pune ndihmon për zgjidhjen e çështjeve korente, për marrjen e masave të nevojshme ose urgjente, kurse shqyrtimi i një problemi në Sekretariatin e Komitetit Qe-

ndror, ku marrin pjesë në debate shumë kuadro, është një formë më e lartë e punës dhe e mendimit kolektiv.

Sekretariati i Komitetit Qendror dhe çdo forum i Partisë më parë duhet të ushqehet, që të ushqejë edhe ai. Çdo shok, kur thirret për të raportuar këtu, zakonisht thotë se ardhja e tij në Sekretariat do ta ndihmojë në punë. Kjo është e drejtë, ndihmën e kërkon baza nga udhëheqja e Partisë. Por duhet që edhe udhëheqja të ndihmohet nga baza që ajo të mund të ndihmojë, ndryshe, po të shkëputet nga baza jetëdhënëse, udhëheqja do të shterojë dhe pastaj do të fillojë të flasë *ex cathedra*. Në mbledhjen e Sekretariatit të gjithë ne nuk vijmë sa për të thënë ndonjë fjalë, por për të shtruar probleme, për t'i diskutuar ato mbarë e prapë, për të sjellë mendime, për t'u dhënë rrugë shumë çështjeve.

Në Sekretariat, përveç raportuesve nga baza dhe shokëve të aparatit të Komitetit Qendror, marrin pjesë edhe drejtuesit kryesorë të organizatave të masave. Pjesëmarrja e këtyre shokëve në mbledhjet e Sekretariatit të Komitetit Qendror ka një domethënë të madhe. Ajo nuk kufizohet vetëm në të drejtën e marrjes së fjalës për të thënë ndonjë mendim për problemet që kanë lidhje me rendin e ditës. Nga shokët e ftuar kërcohët që t'i ngrenë Sekretariatit të Komitetit Qendror probleme të rëndësishme, të cilat preokupojnë organizatat që ata drejtojnë. Nuk kanë vallë probleme të rëndësishme për t'ia paraqitur Sekretariatit të Komitetit Qendror për shqyrtim Bashkimet Profesionale, Fronti, Rinia apo Gruaja? Sigurisht, kanë, dhe plot bille, por asnjë problem të tillë nuk shohim të na sje-

llin këtu jashtë radhës së caktuar në planin vjetor të Sekretariatit të Komitetit Qendror shokët drejtues të këtyre organizatave. Një herë në vit merret në shqyrtim ndonjë problem i tyre, por mundet që problemi të caktuar qysh në fillim të vitit, t'i ketë kaluar koha. Mendoj, shokë, se nuk duhet të vazhdojmë të punojmë më në këtë mënyrë, por të përpinqemi ta përmirësojmë çdo ditë e më shumë punën tonë. Forumet e larta të Partisë kanë nevojë për eksperiencën e bazës, ashtu sikurse baza ka vazhdimi nevojë për ndihmën tonë më të kualifikuar.

Do të marr disa çështje për të ilustruar sadopak ato që thashë më lart.

E para, nuk ka shtruar Partia çështjen me rëndësi të madhe se, që të drejtohet dhe të ecë përpara ekonomia jonë socialiste, duhet të njihen mirë ligjet e zhvillimit ekonomik të socializmit? Sigurisht që e ka shtruar! Në këtë drejtim po punohet dhe ne shohim që kemi rezultate, por kemi edhe të meta, gabime e shfaqje të dëmshme në punë. Të gjithë duhet të njohim se në edukimin socialist të punonjësve, në qëndrimet e tyre ndaj punës, në kuptimin e ligjeve të ekonomisë sonë socialiste kemi akoma boshllëqe të mëdha, të cilat duhet t'i plotësojmë. Por ato nuk mund t'i plotësojmë pa njojur konkretisht arsyet që i shkaktojnë, ndryshe do të marrim masa të çala. Po kush do të na informojë për këto probleme? Partia dhe bashkimet profesionale. Janë në gjendje ato ta bëjnë këtë punë? Unë mendoj që ose janë ato, ose nuk është asnjë tjetër. Por fakt është se ne nuk kemi të dhëna sa duhet nga këto burime mëmë. Bashkimet

profesionale, për të qenë në rregull, kënaqen duke iu përbajtur me rreptësi problemit të caktuar për kriteret e pranimeve në këtë organizatë, problem ky i rëndësishëm ideologjik që morëm në shqyrtim sot këtu. Por, siç duket edhe nga raporti që na është paraqitur, vija e Partisë për këtë çështje ka qenë dhe është e qartë, prandaj nuk ka ç'të shtohet më, veç të bëhen përpjekje që, në radhë të parë, të kuptohet dhe pastaj të zbatohet drejt, pse duket që nuk është kuptuar, prandaj edhe nuk është zbatuar si duhet.

Për problemet e ekonomisë dhe të qëndrimit socialist ndaj punës udhëheqja informohet edhe në rrugë shtetërore, por, siç është e natyrshme, në këtë rrugë mbizotëron ana tekniko-ekonomike e problemit që nuk ekskludon as politikën, as ideologjinë. Mirëpo në qoftë se Partia, në bazë dhe në udhëheqje, nuk i sqaron këto probleme shtetërore nga ana politike dhe teorike, në qoftë se nuk i verifikon ato teorikisht e në praktikën revolucionare, kuptimi dhe zgjidhja e tyre do të bëhen në mënyrë gjysmake dhe rezultatet do të lënë për të dëshiruar. Ne kemi nxjerrë ligje, rregullore etj., të cilat konstatojmë se nuk po zbatohen si duhet. Siç do ta shpjegoj edhe më poshtë, në më të shumtata e rasteve kjo ndodh se masave punonjëse ato nuk u janë shpjeguar si duhet, prandaj dhe nuk janë kuptuar sa duhet e, si rrjedhim, edhe nuk po zbatohen mirë.

Le të marrim edhe këtë çështje: llogaritja e nevojave për fuqi punëtore nuk mbështetet në kohën e punës të domosdoshme për prodhimin e gjithë artikujve dhe asortimenteve dhe nuk merren parasysh

rezervat për rritjen e rendimentit, por këto nxirren nga plotësimi i planit të rendimentit mesatar të punës, të shprehur në vleftë e të realizuar një vit më parë, duke i shtuar këtij një minimale të vogël. Shtruarja e planit dhe e treguesve të punës në kolektivat punonjës përqendrohet kryesisht në treguesit e përgjithshëm të prodhimit, në numrin mesatar të punëtorëve dhe në rendimentin mesatar në vleftë, ndërsa si tregues analistik shtrohet kryesisht përmirësimi i normave të punës, duke u nisur nga normat mesatare të caktuara në librin e normave dhe jo nga ato që janë realizuar në fakt. Siç na njoftojnë organet shtetërore, ato tejkalojen me lehtësi në një masë të konsiderueshme. Në këtë drejtim organet dhe organizatat e Partisë dhe të masave duhet ta përqendrojnë më shumë vëmendjen. Në të njëjtën kohë kërkohet kujdes që masat e marra për eksperimentimin e metodave të reja të përllogaritjes së rendimentit të punës të zbatohen në mënyrë sa më të plotë.

Ne kemi kaq kohë që punojmë për vendosjen e normave teknike dhe për zgjerimin e tyre, por konstatojmë, gjithashtu, që nuk kemi asnjë të dhënë përfatin e tyre, si po zbatohen, çfarë vështirësish ka, si kujdesen organet shtetërore, por edhe ato të Partisë dhe organizatat e bashkimeve profesionale. Këto duhet të shkojnë të gjitha paralel. Mua më duket se nuk po punohet si duhet për përsosjen e nivelit të normave eksperimentale statistikore që zbatohen në punë, përtë ndjekur si shkojnë normat kolektive etj. Këto probleme udhëheqjes i interesojnë jashtëzakonisht që t'i dijë, të njohë si i presin ato punëtorët jo vetëm nga

ana teknike, por sidomos nga ana ideologjike. Probleme të tilla nuk janë vetëm teknike, mbasi brenda ato kanë edhe ideologjinë, edhe politikën, të cilat duhet t'u përshtatim situatave e strukturës dhe pikërisht për këtë arsyе i quajmë superstrukturë. Në qoftë se këto nuk i verifikojmë, atëherë mund ta dëmtojnë strukturën. Ka edhe plot probleme të tjera lidhur me normat, që s'është nevoja t'i numëroj këtu.

Kemi folur dhe shumë herë e kemi bërë problem çështjen e organizimit të punës. Edhe në këtë drejtim ka plot gjëra për të thënë. Nga pikëpamja shtetërore ne duam të jemi në dijeni për vëllimin e humbjeve, por duam ta dimë këtë, gjithashtu, edhe për të vlerësuar punën politike të Partisë dhe të bashkimeve profesionale, që të mund të kuptojmë përsë na ngjet një gjë e tillë, të marrim masa për mënyrën, për format dhe për metodat e shtruarjes së problemit, për zgjedhjen e agjitarorëve dhe të propagandistëve etj.

Ne kemi ngritur kurdoherë me forcë çështjen e përgatitjes që duhet bërë në vendin e punës, para se të fillohet nga puna, megjithatë konstatohet se shpesh në bazë mungojnë organizimi, ndërgjegjja, disiplina proletare etj. Këto janë probleme serioze. Në qoftë se vetëm flitet për ndërgjegje dhe disiplinë proletare, kur në fakt mungojnë përgatitjet organizative në vendin e punës, s'kanë asnjë vlerë ato që thuhen, fjalët duhet të shkojnë krahas me zbatimin e detyrave. Mund të ngarkohet Ministria e Industrisë dhe e Minierave me shumë faje, por mua më duket se nuk janë pa faj edhe organizata e Partisë, ajo e bashkimeve profesionale dhe drejtoria e ndërmarrjes; kanë faj, më së

fundit, edhe vetë punëtorët, sepse, kur venë në bazë për kontroll e ndihmë shokët përgjegjës të dikastereve ose të Qeverisë dhe u bëjnë vërejtje dhe kritika shokëve drejtues të Partisë ose të ndërmarrjeve përse s'i kanë marrë këto ose ato masa, kur çdo gjë ekziston në vend dhe varet nga ata, të gjithë vihen menjëherë në lëvizje dhe brenda një kohe të shkurtër, ndonjëherë vetëm për disa orë, kryejnë detyra të lëna në harresë për muaj me radhë. Prandaj duhet t'i kuptojmë mirë këto çështje.

Ka, pra, një sërë problemesh për të cilat ne mund të japim mendimin tonë si Sekretariat, natyrisht, në goftë se na thuhen arsyet. Ne nuk kemi nevojë të na raportohen gjëra të përgjithshme që i dimë, por për t'i njojur konkretisht problemet. Partia ka një mori kuadrosh që shkojnë në bazë dhe ndjekin si zbatohen në jetë këto çështje, kontrollojnë dhe ndihmojnë për zbatimin e vendimeve që marrim. S'ka dyshim se, sa jeni ju në korent për këto çështje, nuk mund të jemi ne që dalim më rrallë në rrethe, mirëpo ju nuk na informoni sa duhet. Kështu s'mund të ecet, shokë. Këto informime, për të cilat po flas, janë të nevojshme të bëhen jo vetëm nga ju, por edhe nga shokët e bazës që luftojnë konkretisht për zbatimin e vendimeve të Partisë. Por ata, kur vijnë të na raportojnë, të na flasin për arsyet dhe për masat e mëtejshme që duhet të marrim, dhe jo për gjëra të vogla, si fjala vjen për të çuar në një pus tre kuintalë gëlqere apo dy metra kub lëndë druri etj., çështje me të cilat duhet të merrin shokët përgjegjës në vend. Këtu të na flitet për masa me të vërtetë serioze, politike dhe ideologjike që

duhen marrë, që do të forcojnë situatën dhe do të ndihmojnë për zbatimin e vendimeve.

Të metat që ekzistojnë në punën tonë, Partia, pushteti, ndërmarrjet ekonomike dhe bashkimet profesionale në bazë duhet t'i studiojnë më thellë, t'i zgjidhin problemet dhe të kontrollojnë vazhdimeshit zbatimin e detyrave. Për t'ia arritur qëllimit këto duhet të bëhen probleme të masave të punëtorëve, të mos mbeten si çështje të myllura vetëm për drejtoritë e ndërmarrjeve dhe për normistët.

Meqë ra fjala për këta, natyrisht, edhe puna e tyre ka rëndësinë e vet. Në rast se me përgatitjen e normistëve jemi dobët, kjo mund të bëhet objekt i një diskutimi të veçantë deri në Sekretariatin e Komitetit Qendror për të analizuar dhe për të gjetur arsyet e kësaj gjendjeje, për të parë si është përgatitja e tyre tekniko-profesionale, si bëhet edukimi i tyre ideologjik e politik, a janë ata të mjaftë apo s'janë, ç'shkollë kanë kryer etj. Çështja e normave është diçka me rëndësi të madhe dhe jo një problem thjesht teknik, prandaj duhet punuar që edhe normistët të përgatiten me kujdes e jo vetëm nga ana ekonomike, po sidomos politikisht dhe ideologjikisht, ndryshe do të dëmtohem shumë gjatë ecjes përpara të ekonomisë sonë. Një mungesë në këtë drejtim do të kishte pasoja të rrezikshme.

Kam përshtypjen se organizatat-bazë të Partisë dhe bashkimet profesionale punën politike dhe edukative me masat në ndërmarrje nuk e lidhin sa duhet dhe si duhet me këto probleme kyç të ekonomisë. Të tilla probleme shpesh ato i konsiderojnë gabimisht si thjesht teknike, sikur me to duhet të merren vetëm spe-

cialistët dhe punonjësit e administratës. Prandaj mendoj që nëpërmjet seminareve të përgatitura mirë, me referate të faktuara me të dhëna konkrete dhe me sqarime teorike, duhet të rifreskohen e të ndreqen shumë çështje. Ne si Sekretariat i Komitetit Qendror kemi për detyrë të ndihmojmë në këtë drejtim, por vij edhe një herë në atë që thashë se, që të mund të ndihmojmë, më parë duhet që vetë ne të ndihmohemi nga shokët e bazës.

Le të marrim tani një çështje tjetër, studimin e Historisë së Partisë. Byroja e komitetit të Partisë dhe sekretarët, siç na tha shoku i Tepelenës, e gjetën të mjaftueshëm dërgimin e pesë instruktorëve për instruktazh në Shkollën e Partisë, të cilët, porsa u kthyen, pa asnjë udhëzim serioz, morën porosinë të nisen për punë, duke u thënë se pas tyre do të venë edhe shokët kryesorë t'i shohin e t'i dëgjojnë. Kjo nuk është aspak e mjaftueshme, nuk është një metodë pune e shëndoshë. Studimi i Historisë së Partisë është një problem me rëndësi të madhe ideologjike, organizimi dhe didaktike. Me këtë nuk e kam fjalën për mësimin e Historisë së Partisë në shkolla, por në format e arsimit të komunistëve dhe të masave.

Mos është vallë ky një problem i ri për Partinë, siç lihet përshtypja në disa artikuj që boton shtypi ynë? Jo, ky s'është një problem i ri. Të mësojnë komunistët, të mësojnë masat tonë punonjëse Historinë e Partisë, ky ka qenë një problem i vazhdueshëm i Partisë. E re dhe historike këtu është vetëm botimi i librit të Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë, që është një sintezë e shkëlqyer e veprimtarisë dhe e

luftës së Partisë, një armë e fuqishme në duart e komunistëve dhe të masave punonjëse në luftën për socializëm dhe komunizëm, një vepër tani komplete dhe jo si më parë në pjesë të shkëputura. Këtë sintezë e kanë tani që të gjithë në dorë. Botimi i këtij libri na jep mundësi të mëdha për të organizuar me baza të përcaktuara qartë studimin masiv të Historisë së Partisë. Nuk është se ne nuk kemi eksperiencë në këtë çështje, por tani na vihet detyra që në bazë të situatave dhe të zhvillimit të mëtejshëm të vendit, të arrițur nga masat tona punonjëse, nën udhëheqjen e Partisë, t'u bëjmë një rishikim formave dhe metodave të punës të përdorura deri tash për këtë qëllim dhe t'ua përshtatim këto situatave të reja të krijuara që janë shumë të favorshme. Kjo çështje lyp, natyrisht, një studim të kujdeshëm. Në Komitetin Qendror ne kemi marrë një vendim për këtë qëllim dhe ua kemi bërë të ditur Partisë dhe masave, megjithatë mua më duket se kjo çështje lyp përsëri studim, pse Partia ka nevojë për orientime, të cilat tani na vihet detyrë t'i japim. Iniciativat e bazës janë shumë të mira dhe interesante, por ato kërkojnë akoma një përpunim të mëtejshëm. Kjo punë duhet bërë nga baza dhe nga ne.

Eshtë një gjë e mirë dhe e domosdoshme, në radhë të parë, që të rekomandohet leximi në mënyrë individuale ose në grupe i tekstit të Historisë së Partisë, pavarësisht se ky do të jetë një lexic i thjeshtë, i përgjithshëm. Por Historia e Partisë të jetë një libër që duhet mbajtur nën jastëk. Me këtë dua të them që anëtarët e Partisë të mos i bëjnë asaj vetëm një lexic, por ta kenë parasysh vazhdimesh e vazhdimisht e vazhdi-

misht, çdo ditë. Njerëzit në format ekzistuese të studimit bëjnë pyetje, debate, diskutime për çka kanë lexuar dhe kjo është një punë e mirë dhe e frytshme, por nuk është e tërë metoda, mbi këto baza duhet perfekcionuar më tej puna për studimin e Historisë së Partisë. Unë mendoj se do të bëhej më i frytshëm studimi në qoftë se lexuesit do të ndihmohen e do të orientohen për të përfituar sa më shumë.

Të mos merret kjo që do të them si metoda më e mirë për të mësuar Historinë e Partisë, pse mënyra e studimit të saj, siç thashë, duhet perfekcionuar vazhdimisht më tej, se edhe materiali është voluminoz dhe duhet bërë mirë kombinimi i tij, në mënyrë që studimi të mos reduktohet në mësimin e thjeshtë të ngjarjeve historike që janë rezultat konkret i vijës së drejtë ideologjike, politike, organizative, ushtarakë dhe ekonomike të Partisë. Prandaj, për të mësuar si duhet Historinë e Partisë, na vihet detyrë të punojmë që të kuptohet mirë vija e Partisë në të gjithë madhështinë, gjerësinë dhe thellësinë e saj. Nuk mjafton të organizohen disa konkurse, ku mund të bëhen pyetje, si, fjala vjen, në ç'datë u bë Konferenca e Pezës apo ajo e Labinotit etj., dhe, pasi të merret përgjigjja, të vlerësohet kjo me pikë, siç bëhet në konkurset që zhvillon Radio Tirana. Kjo është një çështje shumë serioze, shokë.

Kur themi se materialet për studimin e Historisë së Partisë janë të shumta, mendoj që krahas librit, i cili është një sintezë shkencore, duhet të përdoren edhe dokumentet e tjera të Partisë relativisht në të gjitha etapat, duke përfshirë në këto edhe literaturën,

deri folklorin dhe tregimet e ndonjë patrioti apo partizani. Ka rëndësi shumë të madhe përdorimi me vend i të gjitha këtyre materialeve. Kjo është një punë e tërë që duhet bërë në mënyrë të kombinuar mirë, dhe, siç e shtroj unë problemin, kjo punë lyp një përpunim të kujdeshëm, lyp edhe një gradacion në ciklet e studimit, sepse kemi të bëjmë me një edukim masiv dhe pikërisht se ka një karakter të tillë, kjo punë duhet parë me shumë kujdes. Kjo kërkon, gjithashtu, një përgatitje të veçantë dhe shumë serioze të agjitatorenëve dhe të propagandistëve, pse me një të thënë nuk arrihet të bëhet menjëherë ajo që kërkojmë. Pastaj duhet gjetur më në fund metoda më e mirë me kriteret që përmenda më lart për ta mësuar Historinë e Partisë, për të njojur thellë politikën dhe ideologjinë e saj. Nuk ka rëndësi të mësohen në këto forma ngjarjet si janë zhvilluar, pse këto kushdo i mëson edhe vetë me leximin e tekstit, po duhen shpjeguar pse kanë ndodhur këto apo ato ngjarje. Prandaj lidhur me këtë duhet t'u përgatitet mirë terreni diskutimeve, pyetjeve e debateve.

Për t'ia arritur këtij qëllimi ka shumë forma dhe metoda, që duhen praktikuar, prandaj, duke nxitur e duke inkurajuar për të vazhduar më tej hovi i mirë që ka filluar, mendoj që në Sekretariatin e Komitetit Qendror ta studiojmë këtë çështje, natyrisht, jo sot, por kjo të na përgatitet për një herë tjetër. Ajo që mendoj të praktikojmë më shumë është që studimi i Historisë së Partisë dhe i dokumenteve përkatëse të bëhet vazhdimisht dhe vazhdimisht në mënyrë individuale. Bazuar në këtë studim, agjитatori i Partisë du-

het të vijë i përgatitur mirë në formën e studimit, në mënyrë që ai të mos trajtojë aty historikun e ngjarjeve, por filozofinë e tyre, të shpjegojë teorinë e ngjarjeve historike, përbajtjen teorike politike të organizimit e kështu me radhë për çdo problem, pse për këtë ka më shumë nevojë dëgjuesi ynë. Ai ka nevojë t'i shpjegohet ajo që nuk kupton, që nuk e kap dot si duhet sepse ngjarjet historike secili i kap më lehtë, shumë njerëz ato i kanë jetuar vetë ose i kanë lexuar.

Kur diskutohet për tema nga historia e Partisë, propagandisti, sipas nevojës, mund t'i ilustrojë disa herë edhe me pjesë të zgjedhura nga dokumentet e Partisë që lidhen me temën. Ai mund të lexojë edhe ndonjë pjesë letrare ose nga folklori, që ka lidhje me atë çështje, pse të gjitha këto kanë rëndësi të madhe. Duke vepruar kështu, nxiten, mësohen dhe stërviten dëgjuesit që t'i përdorin edhe vetë dokumentet plotësuese.

S'ka dyshim se gjatë punës së madhe që po bëhet për këtë qëllim, ka e do të ketë forma të ndryshme pune, prandaj mendoj se, jashtë radhës së çështjeve të parashikuara në planin vjetor, duhet të paraqiten për shqyrtim në Sekretariatin e Komitetit Qendror probleme të tillë, se për këtë punë na ka zgjedhur Partia: të punojmë pareshtur dhe t'u japim problemeve rrugën e zgjidhjes më të mirë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

**NË GURRËN E PASHTERSHME
TË KRIJIMTARISË SË POPULLIT DO TË GJEJME
FRYMËZIM TË MADH PËR VEPRA
TË BUKURA**

*Letër drejtuar skulptorëve Kristaq Rama,
Muntaz Dhrami e Shaban Hadëri*

26 qershor 1969

Të dashur shokë skulptorë Kristaq Rama, Muntaz Dhrami e Shaban Hadëri,
Ju bëj shumë të fala.

Ditën që vizitova studion tuaj për të parë maketin e Monumentit të Shpalljes së Pavarësisë në Vlorë, ju dhashë disa këshilla dhe ju bëra disa vërejtje shoqërore. Qëllimi ishte që frymëzimin tuaj patriotik ju ta pasuroni akoma më shumë me studimin më të thellë të historisë së Shqipërisë, të folklorit të madh të popullit dhe të dokumenteve të Partisë.

Natyrisht, ju e dini ç'rëndësi të madhe ka kjo përmendore për popullin dhe për brezat e ardhshëm, pra-

ndaj ajo duhet të bëhet e atillë që, duke përjetësuar në bronz ngjarjen historike të Vlorës, të bëjë sintezën e gjallë dhe dinamike të luftërave heroike të popullit shqiptar, të luftërave të lavdishme çlirimtare kundër pushtuesve, për liri, pavarësi dhe sovranitet kombëtar.

Populli në këtë monument të shikojë kurdoherë se liria fitohet dhe mbrohet me pushkë, ashtu siç u fitua me Luftën Nacionalçlirimtare të udhëhequr nga Partia, ashtu siç mbrohet sot nga diktatura e proletariatit.

Sigurisht, ju më kuptioni se në kompozimin e monumentit unë nuk mendoj të futen motive të Luftës Nacionalçlirimtare, bile edhe kur ju thashë nëse ka mundësi të shkrihen disa motive nga Lufta e Vlorës e vitit 1920, mendimi im konsistonte në atë që Monamenti i Pavarësisë të përfaqësojë jo vetëm arritjen e një caku, por sulmin përpëra për të arritur caqe të tjera akoma më të rëndësishme, që të shihet në të se revolucioni ynë ecën përpëra, është në ngjitje; imaginata e popullit të shohë në veprën që do të bëni ju, atë që ai realizoi në Luftën e lavdishme Nacionalçlirimtare, atë që po realizon sot gjatë ndërtimit të socializmit.

Një gjë e tillë nuk është aspak e domosdoshme të bëhet duke përzier motivet e periudhave të ndryshme, se atëherë do të ndryshonte subjekti i monumentit, por, duke ruajtur subjektin e periudhës së caktuar historike në të, nëpërmjet talentit tuaj të lavdërueshëm, të dalin të gjallë në relief forca e madhe e

karakterit të shqiptarit, trimëria, heroizmi, shpirti i sakrificës, zgjuarsia, hovi i tij luftarak dhe revolucionar i vazhdueshëm, karakteristika këto për të gjithë brezat e Shqipërisë, për të kaluarit, të tashmit dhe të ardhshmit. Se si mund të dalin këto në një monument, atë e dini ju, pse ju jeni skulptorë dhe një skulptor i mirë, mendoj unë, duhet të jetë njëkohësisht jo vetëm artist, por edhe poet, edhe shkrimtar, edhe luftëtar revolucionar, edhe dijetar i lidhur ngushtë me popullin. Të tëra këto ju i keni, atëherë veproni!

Më falni, në qoftë se gabohem, por kompozimi i ansamblit të monumentit, vendosja e personave dhe e simbolit, ekspresionet e personazheve janë ato që mund t'i japin monumentit ato kuptime dhe shprehje për të cilat fola më lart.

Kam reflektuar për këtë çështje që nga dita që ju vizitova në studion tuaj dhe më lejoni tani të shfaq disa mendime të miat. Qysh në fillim po ju them se ato mund të mos jenë edhe aq të bazuara, imaginata ime mund të më gabojë, mbase s'pata edhe shumë kohë për të vërejtur me kujdes maketin tuaj, të cilin e gjej kurdoherë të vlefshëm. Ju më thatë se do ta përpunoni e do ta përpunoni më tej atë, prandaj po jua them këto mendime modeste të miat.

I tërë ansambli i monumentit duhet të japë ndjenjën e unitetit të çeliktë të popullit tonë dhe të forcës së tij për të mposhtur robërinë shekulllore e çdo pengesë që has përpara.

I tërë ansambli i monumentit duhet të jetë në sulm, kështu edhe personazhet që do ta përbëjnë atë

duhet të mos janë në gjendje statike. Përveç kosovarit ose shqiptarit të Veriut, dy të tjerët, shqiptarët e Jugut, janë në poza statike, pushka e tyre është «në pushim». Këta ndiejnë satisfaksionin se me luftë u ngrit flamuri dhe kjo është një gjë e domosdoshme që duhet shprehur, pse përfaqëson idenë e pavarësisë, por nuk është e tëra, duhet mbrojtur kjo pavarësi, duhet vazhduar lufta, duhet të ngjitet revolucioni.

Figurat e personave, përveç atij plakut të Vlorës, që më duket se është vënë drejt, janë ca konvencionale; për të dalluar krahinat e ndryshme, është dashur të stilizohen kostumet më tepër nga sa duhet. Jo vetëm që luftëtarët e atyre kohëve nuk visheshin të gjithë me fustanella, por lufta hidhte tej stilin dhe paradat. Personazhi i kosovarit me gjoksin hapur është më real.

Flamurit që valëvitet, më duket i është dhënë një formë e trashë, e fryrë, nuk ka ngjyrën e flamurit të betejave heroike që ka kaluar zjarre e furtuna. Kjo ka rëndësi, pse është një figurë qendrore, ai duhet të jetë, si me thënë, i shkathët e i mprehtë, si shqiptari, si shqiponja që ka në mes.

Unë jam dakord me ju që në tërë ansamblin e monumentit figura e Ismail Qemalit të jetë një figurë qendrore, ashtu siç e keni vënë ju, por nga i gjithë ansamlli të dalë se vepra e tij është si konsekuençë e luftës legjendare të popullit.

Më në fund në ansamblin e monumentit nuk del gjykundi lufta e madhe e rilindasve tanë me penë, luftë kjo që nuk mund të harrohet, as të shkëputet nga

ajo me armë, pse është pjesë integrante e periudhës për të cilën ne ngremë monumentin. Prandaj studiojeni edhe një herë këtë moment për statutin.

Të dashur shokë,

Kur isha në studion tuaj, ju fola për rëndësinë e folklorit të mrekullueshëm të vendit tonë. Unë përveten time jam një admirues i folklorit të popullit dhe i të gjithë atyre skulptorëve, artistëve, poetëve, shkrimtarëve e dijetarëve që kridhen në të e frymëzohen nga ai. Në gurrën e pashtershme e jetëdhënëse të kri-jimtarisë së popullit, ne do të gjejmë atë frymëzim të madh për të realizuar vepra të bucura e madhështore për popullin tonë. Nga veprat që nxirrni prej duarve tuaja, njerëzit tanë frymëzohen, prandaj frymëzohuni edhe ju nga inspirimet e tyre.

Në numrin e fundit të «Dritës» lexova baladën e poetit të talentuar Agim Shehu «Përpara bustit të Selam Musait». Lexoni ç'thotë ai për veprat tuaja:

*Ja, kështu në bronz
Ty të ka liria.
Lule, Selam labi,
Selam Salaria.*

Frymëzohuni edhe ju për monumentin tuaj nga frymëzimi i tij:

.

*Rri, po nuk të rrighet,
Ndaj të vijnë mornica...
Vrapi yt po endet
«Poshtë nga Babica».*

*Lugjesh, në ato netë
Zbrite si veri,
Projektorët ndiqnin
Sharkun tënd të zi.*

*Flaka nëpër duar
Me rrëmbim të futej.
Gjalmi mbi dyfek
Dridhej, mos këpuntej.*

Dëgjoni ç'thotë më tej:

.

*Çdo tufan, zbërthyer
Gjoksin ty ta gjeti.
Sharku si legjendë
Përmbi tel të mbeti.*

Nuk do t'i citoj të gjitha vargjet e kësaj poezie të bukur, por këtë e bëj pse të gjithë duam që monumenti për të cilin po punoni të jetë një kryevepër frymëzimi popullor për heroizmat e të parëve tanë, për ne dhe për brezat e ardhshëm që edukon dhe frymëzon Partia.

Edhe një herë po jua përsëris se vërejtjet e mia kanë karakter shoqëror. Unë kam besim të madh te patriotizmi, partishmëria, fryshtëzimi e talenti juaj dhe jam i sigurt se ju do të nxirrni një vepër të bukur, me një nivel më të lartë nga veprat tuaja të bukura që i keni dhënë deri tash atdheut.

Juaji

Enver

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Drita», nr. 29
(487), 13 korrik 1969*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Raporte e fja-
lime 1969-1970», f. 84.
Tiranë, 1970*

TERRORI RANKOVIÇIAN MAQEDONAS

Artikull i botuar në gazeten «Zëri i popullit»

28 qershor 1969

Po bëhen disa muaj që në Maqedoni ka shpërthyer një inkvizicion i vërtetë ndaj popullsisë shqiptare. Gjyqet po bëjnë kërdinë, jepen dënimë mbi dënimë, bëhen shpifje e sulme gjithfarësh antishqiptare. Nga disa të dhëna jo të plota, të njoftuara nga shtypi jugosllav, që nga fillimi i këtij viti e deri sot janë zhvilluar 13 gjyqe dhe janë gjykuar e janë dënuar mbi 170 persona. Të tjera procese, që kanë vënë nën akuzë me dhjetëra veta, janë akoma në vazhdim. Sa njerëz ndodhen në burgje dhe presin të dalin në gjyq dhe sa të tjerë kanë humbur pa nam e pa nishan, asnje nuk e di.

Këto gjyqe terroristë dhe persekutimet në masë të shqiptarëve të Maqedonisë janë kopje identike të metodave brutale e kriminale që për më se 20 vjet u përdorën për të terrorizuar dhe për të gjakosur rëndë popullsinë shqiptare të Kosovës, në Maqedoni e në Mal të Zi. Ato të kujtojnë makinacionet monstruoze që u kurdisën për shtypjen, për grabitjen e për shpër-

nguljen me dhunë të shqiptarëve nga trojet ku kishin lindur e kishin vdekur stërgjyshërit e tyre. E kush mund t'i harrojë gjithë ato gjyqe të stisura, të cilat ishin preludi i terrorit masiv për zhdukjen dhe për shkombëtarizimin e shqiptarëve? Plagët e vjetra kullojnë akoma gjak dhe mbi to po hapen akoma të reja.

Pikërisht sipas metodave rankoviçiane, në këto gjyqe flitet për «komplotë kundër integritetit të Maqedonisë», për «shovinizëm shqiptaromadh», për përpjekje të shqiptarëve të Maqedonisë që «të bashkohen me Kosovën dhe pastaj me RP të Shqipërisë», për «agjenturë» lidhur me ambasadën shqiptare në Beograd etj. Por këto avaze janë shumë të vjetra e të demoduara. Bile edhe vetë në Jugosllavi janë cilësuar si trillime dhe provokacione për të mbuluar komplotet shoviniste kundër popullsisë shqiptare.

Të dënuarve shqiptarë në gjyqet e Shkupit, të Tetovës, të Manastirit etj. u sjellin «prova» të tillë, si pjesëmarrja ose përpjekja për të organizuar demonstrata. Por me gjithë mundimet e prokurorëve, të gjykatesve dhe të jallanshahitëve, siç del nga reportazhet gjyqësore të botuara në shtypin jugosllav, gjyqet nuk kanë mundur të vërtetojnë se të akuzuarit kanë bërë ndonjë gjë të jashtëligjshme.

Shqiptarët e dënuar akuzohen se kanë ngritur flamurin shqiptar dhe ky veprim, sipas ruajtësve të «drejtësisë» në Maqedoni, përbëka një krim të pafalshëm. Por a nuk është ngritura e flamurit kombëtar shqiptar në qytetet dhe në fshatrat e banuara nga shqiptarët një e drejtë e njojur nga kushtetuta jugosllave? Mos vallë kjo e drejtë është vetëm për shqipta-

rët e Kosovës dhe nuk qenka për shqiptarët në Maqedoni, në Mal të Zi apo në Serbi?! Me të drejtë shtrohet pyetja: Ekziston apo jo Federata në Jugosllavi, ekziston apo jo kushtetuta e saj, janë apo jo të barabartë përparrë saj nënshtetasit jugosllavë?

Shovinistët maqedonas, duke kopjuar metodat e Rankoviçit, mund të bëjnë çfarëdolloj akuzash që të duan, por ata nuk mund të mbulojnë dot politikën e tyre shoviniste ndaj shqiptarëve, trajtimin çnjerëzor, mohimin e të drejtave më elementare dhe përpjekjet e vazhdueshme për shkombëtarizim. Diskriminimi kombëtar i rreth 300 000 shqiptarëve në Maqedoni është i pashebullt. Atyre edhe sot e kësaj dite u mohohet arsimi në gjuhën amtare dhe u ndalohet gati çdo vepriptari për zhvillimin e kulturës kombëtare, u bëhen një mijë e një të zeza për t'i detyruar ta quajnë veten turq dhe për t'i shpërngulur.

Në këtë vijë shoviniste antishqiptare hyn edhe organizimi i gjyqeve të fundit. Me anë të tyre synohen të persekutohen shkollat shqipe (shumica e të dënuarve janë mësues e intelektualë), të mbyllen edhe ato që ekzistojnë dhe, më në fund, t'u bëhet njerëzvejeta e padurueshme dhe të nxitet me dhunë shpërngulja e shqiptarëve nga toka e tyre. Shovinistët maqedonas, me bandën e Crvenkovskit në krye, kanë me vete edhe ca renegatë shqiptarë, që duartrokasin gjyqet kundër popullsisë shqiptare.

Provë që këtu kemi të bëjmë me një terror të egër, është fakti se edhe vetë gjykata e lartë e Maqedonisë, në pamundësi që t'i hidhte poshtë krejtësisht si të kurdisura proceset ë fundit, uli në minimum mjaft

nga dënimet që u ishin dhënë të akuzuarve. Siç duket, ajo e pa se fushata kundër shqiptarëve ishte fryrë deri në atë shkallë sa organizatorëve të saj do t'u sillte më shumë dëm se fitim.

Vala e gjyqeve dhe e persekutimeve ka shqetësuar shumë jo vetëm shqiptarët në Maqedoni, por të gjitha krahinat e banuara nga ata. Shqiptarët e Kosovës e në Mal të Zi janë të indinjuar për këtë terror, i cili mund të jetë vetëm një fillim, që nesër mund të kërcënojë edhe ata. Populli shqiptar ka mjaft respekt për popullin maqedonas, por zemërohet me të drejtë për valën e re të diskriminimit që ka shpërthyer në Maqedoni kundër shqiptarëve, për gjyqet dhe për persekutimet që u bëhen atyre, për shpifjet që bëhen kundër RP të Shqipërisë. Ai kërkon që t'u jepen fund këtyre veprimeve të egra shoviniste, të respektohen të drejtat e ligjshme të shqiptarëve.

Ne nuk dimë sa larg do të shkojnë Crvenkovskët në tèrbimin e tyre antishqiptar, por një gjë është e sigurt: populli shqiptar në Maqedoni është një popull trim, me tradita të larta patriotike e liridashëse, të cilin nuk kanë mundur ta thyejnë as sultani e Turqisë, as kralët serbë, as nazistët gjermanë e as push-tuesit bullgarë. Atë me siguri nuk do ta thyejnë e nuk do ta mposhtin kurrë as rankoviçianët maqedonas. Kohët e fundit sundimtarët e Shkupit thonë se janë të preokupuar me çështjen e kombësisë maqedonase dhe flasin shumë për të drejtat kombëtare të popujve, për traditat e për historinë kombëtare. Por në qoftë se pikëpamjet e tyre duan t'i vërtetojnë duke shtypur e duke persekutuar shqiptarët, vështirë është se do t'ia

dalin mbanë. Fjalët e Marksit se asnje komb nuk mund të jetë i lirë kur shtyp një komb tjetër, tanimë i ka vërtetuar historia.

Duke persekutuar shqiptarët, rankoviçianët maqedonas mos bëjnë vallë lojën e tjetërkujt? Mos vallë bëjnë lojën e atyre që rivendikojnë Maqedoninë dhe përgatitin sulme kundër Republikës Popullore të Shqipërisë? Koha do ta tregojë.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i popullit»,
nr. 153 (6505), 28 qershor 1969*

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i popullit», nr. 153 (6505), 28 qershor 1969

NË ÇDO PUNË TË ZBATOJMË NJË METODË DHE STIL LENINIST REVOLUCIONAR

Fjala në Plenumin e 8-të të KQ të PPSH¹

28 qershor 1969

Raporti «Mbi konkluzionet e diskutimit popullor për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë» përbën pikërisht sintezën e diskutimit të gjerë popullor të këtij problemi të madh dhe përcakton në mënyrë të qartë vijat kardinale politike, ideologjike, shkençore, pedagogjike dhe organizative nëpër të cilat duhet të kalojë shkolla jonë e re.

Partia jonë, si në të gjitha problemet dhe detyrat e dorës së parë, tezat e veta ia parashtroi diskutimit kritik revolucionar të masave të gjera punonjëse, ajo tërhoqi në gjerësi dhe në thellësi mendimet e tyre të vlefshme për këto probleme jetike të popullit, siç janë arsimi dhe edukimi.

Natyrisht, Byroja Politike dhe Komiteti Qendror,

¹ Plenumi i 8-të i KQ të PPSH, që u mblohdh më 26-28 qershor 1969, mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi konkluzionet e diskutimit popullor për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë».

që analizuan dhe diskutuan këto të dhëna me një vlerë të madhe, arritën në konkluzionet që përcaktojmë sot, por nuk mund të quhet i shteruar ky burim i madh, i paçmuar i masave popullore për këtë problem, burim që do të freskojë e do të gjallërojë vazhdimit mendimet e Partisë për ta përmirësuar e për ta përsosur sistemin revolucionar të shkollës sonë. Prandaj, megjithëse ne sot marrim vendime të rëndësishme për shkollën, as Partia, as pushteti dhe as masat e gjera punonjëse nuk duhet të mendojnë se ky problem tashmë është ezauruar, se çdo gjë u vendos mirë e drejt dhe puna këtej e tutje do të ecë vetvetiu.

Partia dhe organet e pushtetit tashmë duhet ta kenë të qartë se janë pikërisht mobilizimi dhe interesimi kaq i gjallë i masave punonjëse që bënë të arriheshin këto rezultate pozitive. Hovi revolucionar i masave për këtë problem zgjoi të fjeturit, shkundi pluhurin, spastroi shumë haure, rrëzoi shumë koncepte mikroborgjeze, ai fuqizoi dhe inkurajoi të renë përparrimtare dhe revolucionare, tregoi kompetenca të mrekullueshme në një fushë që konsiderohej si e myllur, ku fjalën e kishin vetëm njerëzit e mësuar, njerëzit «me kulturë».

Veçanërisht për organizatat e Partisë ky diskutim i madh popullor duhet të jetë një mësim me vlerë jo vetëm për të ndjekur e për të ndihmuar në zgjidhjen e këtij problemi shumë të rëndësishëm, por ai të na shërbejë në të ardhmen si nxitje, si mësim stili dhe metodë pune edhe për të gjitha problemet e tjera. Me vijën e masave dhe e mbështetur në diturinë e në zotësinë e tyre, Partia do të zgjidhë kurdoherë drejt, mi-

rë dhe shpejt çdo problem, sado i rëndë dhe i koklavitur që të jetë ai.

Gjithë ky organizim i madh për diskutimin popullor të këtij problemi kaq të rëndësishëm i detyrohet Partisë. Kjo tregon një hop të madh cilësor në punën e saj, por njëkohësisht vë në dukje edhe metodën e interesimin jo të plotë dhe jo të kualifikuar të disa komunistëve para këtij diskutimi revolucionar. Duhet ta njo him sinqerisht dhe hapur këtë të metë serioze në punën tonë dhe t'i bëjmë analizën kritike, ndryshe mund ta flemë mendjen përsëri, ta nënvleftësojmë këtë problem dhe të na marrin zvarrë probleme të tjera.

Të kemi kurdoherë parasysh se arsimimi dhe edukimi i masave është një problem kyç për socializmin dhe komunizmin, i pleksur ngushtë me të gjitha problemet e tjera të mëdha, zhvillimi i harmonishëm i të cilave, të marra së bashku, varet nga zgjidhja e të gjitha pjesëve përbërëse.

Interesimi i mbarë Partisë për këtë problem duhet të jetë i vazhdueshëm dhe çdo ditë e më i kualifikuar. Komunistët të hedhin tej plogështinë, ngurrimin dhe frikën që vihet re akoma te disa për t'iu futur problemeve të arsimit, gjoja për mungesë diturie apo kompetence. Një shembull të shkëlqyer, si kurdoherë, edhe në këtë çështje, na e dha klasa punëtore, na e dhanë masat e gjera punonjëse të vendit tonë. Punë e madhe duhet të bëhet tani për ta përgatitur tërësisht këtë sistem, për ta vendosur dhe pastaj për ta përsosur vazhdimisht më tej. Kjo punë do të kalojë nëpër tri etapa të rëndësishme dhe vendimtare.

Në radhë të parë, duhet të kuptohen mirë orienti-

mi politiko-ideologjik i sistemit dhe përshtatja e strukturës dhe e organizimit të shkollës sonë të re me këtë orientim revolucionar të saj në të gjitha pjesët që e përbëjnë. E tërë kjo është pranuar, por do të jetë gabim të mendojmë se e kanë kuptuar thellë dhe si duhet të gjithë. Partisë i bie detyra ta sqarojë vazhdimisht dhe me këmbëngulje këtë problem, sepse do të ketë dhe do të dalin si në parim, ashtu edhe në praktikë, keqkuptime, ngurrime, vështirësi materiale dhe pikëpamje të vjetra që do të shfaqen në forma të ndryshme. Shkolla e vjetër ka lënë gjurmë te shumë intelektualë, mësues, pedagogë dhe njerëz të shkencës. Kundër këtyre mbeturinave duhet të luftohet nga Partia që të zhduken me një punë të thellë e të vazhdueshme politike dhe ideologjike. Në asnjë mënyrë të mos mendohet se mbeturinat e botëkuptimeve të vjetra për shkollën do të zhduken duke lidhur duart e duke fjetur mendjen.

Ashtu si në çdo sektor pune, edhe në këtë sektor jetik të revolucionit tonë duhet të ruhemë shumë nga dogmatizmi dhe vetëkënaqësia. Të ruhemë, gjithashtu, nga tendencat intelektualiste të mësuesve, të pedagogëve e të profesorëve, të cilët do të luajnë një rol të madh në zbatimin e praktikave arsimore. Dituritë e tyre të mos mbivlerësohen, pse kjo të çon në dogmatizëm dhe në nënvleftësimin e kontrollit të diturive, të praktikave, të metodave dhe të stilit në punë që lind nga praktika revolucionare, nga eksperiencia e pasur dhe e gjerë e masave punonjëse dhe, në radhë të parë, e klasës punëtore. Dituria është një ushqim i domosdoshëm, një mjet, një armë e rëndësishme që çon për-

para përparimin dhe zhvillimin, por te ne ajo asnijëherë nuk duhet të kthehet në një stoli mikroborgjeze, që të ushqejë ndjenjën e fodullëkut dhe të epërsisë, as në një mjet sundimi mbi masat, siç ndodh në vendet kapitaliste dhe revizioniste. Njerëzit e ditur në vendin tonë duhet t'i karakterizojnë thjeshtësia proletare dhe meritat konkrete në punën krijuar e prodhuese. Vetëm njerëz të tillë meritojnë respekt dhe përkrahje, se vetëm këta e kuptojnë drejt që nuk mund të ndahet apo të shkëputet teoria nga praktika revolucionare.

Klasikët e marksizëm-leninizmit dhe praktika revolucionare e Partisë sonë na mësojnë se në punë, në çfarëdo pune, mendore dhe prodhuese, duhet të zbatojmë një stil e një metodë leniniste revolucionare. Stalini thotë se leninizmi është një shkollë teorike dhe praktike që formon një tip njeriu të veçantë në parti, në aparatin e shtetit dhe të ekonomisë. Stili leninist, na mëson ai, është ilaqi kundër plogështisë, rutinës, konservatorizmit, servilizmit, kundër traditave dhe mendimeve të fjetura. Stili leninist në punë, vazhdon më tej Stalini, është ajo forcë jetëdhënëse që zgjon mendimin, që shtyn përpara, thyen të kaluarën, hap perspektivën. Pa këtë hov asnijë lëvizje progresiste nuk është e mundur.

Kur trajton çështjen e mbrojtjes së principeve të leninizmit, Stalini, duke folur për metodën leniniste, përcakton kërkesat e kësaj metode: verifikimin e dogmave teorike në zjarrin e luftës revolucionare të mësive, në zjarrin e praktikës jetëdhënëse. Për verifikimin e politikës së partive të Internacionales së Dytë leninizmi nuk bazohet në parullat e rezolutat e tyre,

të cilave nuk duhet t'u besohet, por në veprat dhe në aktet e tyre. Vetëm në lidhjen e ngushtë të politikës me praktikën revolucionare partia do të fitojë e do të meritojë besimin e masave proletare.

Riorganizimi i gjithë punës së Partisë për një metodë të re revolucionare dhe, më në fund, autokritika e partisë proletare për edukimin nga gabimet e veta dhe të tjera përcakttime teorike e praktike që nuk i kam cituar *in ekstenso* për stilin dhe metodën leniniste, duhet të na udhëheqin në çdo punë e veprim tonin dhe, në mënyrë të veçantë, në punën për edukimin e brezit të ri në shkolla. Këto përcakttime filozofike marksiste-leniniste janë të qarta dhe të kuptueshme, por duhen kuptuar thellë në gjerësinë e në thellësinë e tyre dhe e rëndësishme e vendimtare është që ato të zbatohen në jetë, në praktikë. dhe veprimet tona të maten në prizmin e pagabueshëm të tyre.

Metoda dhe stili leninist, të dy këta të ndërtuar në mënyrë të harmonishme, të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin dhe të frymëzuar në rrugën revolucionare të masave për krijimin dhe për kalitjen e brezave të rinj të devotshëm ndaj çështjes së popullit, Partisë, socializmit dhe komunizmit, duhet të ndritin rrugën e shkollës sonë të re si në teori ashtu edhe në praktikë, në organizimin e brendshëm të shkollës dhe në punën e brezit të ri jashtë saj. Kjo metodë dhe ky stil leninist në punën e Partisë ndihmuan shumë për studimin e problemit të shkollës, ashtu siç po ndihmojnë dhe jepin fryte edhe në zgjidhjen e një numri të madh problemesh të tjera të rëndësishme.

Raporti që u paraqit në këtë mbledhje të Komi-

tetit Qendror duhet të konsiderohet si hapi i parë i rëndësishëm i një pune të madhe, por të pambaruar plotësisht, i një pune të atillë që kërkon zërthimin e një sërë problemesh të tjera të lidhura ngushtë me këtë çështje, siç janë programet, tekstet, masat e shumta organizative, përgatitja e kuadrit dhe përsosja e vazhdueshme e gjithë këtij kompleksi të madh. Prandaj në të ardhmen unë parashikoj edhe mbledhje të tjera të kësaj natyre, si kjo që po bëjmë, sepse problemi i arsimit nuk është as i vogël, as i thjeshtë, ai nuk është i veçantë dhe i mbyllur në vetvete, por është problemi i arsimit dhe i kulturës së të gjitha masave të gjera punonjëse dhe, në radhë të parë, të brezit tonë të ri. Këto mbledhje të Komitetit Qendror, që parashikoj të bëhen në të ardhmen për këtë problem, nuk do të kenë për qëllim vetëm përcaktimin sa më drejt të praktikave në shkolla, kontrollin e realizimeve të tyre, por duhet ta vërtetojnë qenien e tyre nga praktika revolucionare, e cila do të na mësojë e do të korrigojë pasaktësitë, të metat dhe gabimet e sistemit e të praktikave që vendosim, që me siguri do të ndryshojnë drejt përsosjes së tyre të mëtejshme.

Le të marrim çështjen e programeve të reja të shkollave, të ciklit të plotë të tyre. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe një grup i madh specialistësh të kualifikuar kanë hartuar projektprograme të mbësh-tetura në parimet dhe në tezat që ka dhënë Partia. Rreth tyre janë zhvilluar debate të zjarrta dhe kjo është një gjë shumë e mirë. Natyrisht, midis pjesëma-rresve në këtë punë ka pasur, ka dhe do të ketë mendime të ndryshme, sidomos nga specialistët, të cilët i

pranojnë si të drejtë, të domosdoshëm e revolucionarë trekëndëshin dhe boshtin ideologjik marksist-leninist të shkollës, por kanë frikë se mos ulet niveli teorik i saj. Ne nuk mund të themi se ky shqetësim i tyre është i padrejtë. Për ta zbutur këtë shqetësim ata përpiken të shtojnë orët në praktikat e teorisë dhe vitet për shkollën. Në qoftë se duhet, edhe kjo mund të bëhet, por duke pasur kurdoherë parasysh jo vetëm njérën, por të tria anët e problemit — anën teorike, në mënyrë që njohuritë e marra në shkollë të jenë të shëndosha dhe të plota, çështjen që nxënësit dhe studentët të hyjnë sa më shpejt në prodhim dhe, së treti, nevojën e madhe që ka vendi ynë për kuadro me arsim të lartë.

Duke u bazuar në tezat që dha Partia për revolucionarizimin e shkollës, punonjësit e arsimit filluan të reflektojnë më thellë për programet dhe tekstet e shkollës aktuale dhe gjetën në to shumë gjëra të tپërtë, orientime të gabuara, teori të vjetruara që nuk hyjnë në punë dhe shumë përkufizime të panevojshme. Edhe në praktikat e ndryshme ata gjetën trajtime të problemeve jo vetëm të mbetura trashëgim nga shkolla borgjeze me përbajtje teorike regresive, por edhe të programuara e të zhvilluara gjërësisht me tendencia eruditizmi dhe enciklopedike të tepruara për degët e ndryshme të shkollave. Dhe, konkretisht, filloj spastrimi i tyre. Por do të jetë gabim po të mendojmë se spastrimi që u bë është i përsosur. Jo, ne jemi akoma larg kësaj; do të na duhet akoma shumë për të bërë. Sidomos Partisë do t'i duhet një punë e madhe për t'ua bërë të qartë njerëzve që merren me shkollat anën teorike dhe zbatimin pastaj në praktikë të meto-

dës leniniste që parashtron Stalini dhe të cilën e përmenda shkurtimisht pak më lart. Metoda leniniste, që na mëson ai, nuk është specifike vetëm për verifikimin e dogmave dhe të politikës së partive të Internacionales së Dytë; ajo është për riorganizimin e gjithë punës së Partisë në bazë të një metode të re revolucionare.

Dhe një nga punët e Partisë është edhe çështja e shkollave. Në shkollën e vjetër ka dogma, ka politikë tendencioze reaksionare, mbeturina të shumta ekzistojnë në ndërgjegjen e njerëzve. Borgjezia e konsideron shkollën si një instrument seleksionimi, që çon në kri-jimin e një elite, kurse shkolla jonë synon të kundërtën e qëllimit të shkollës borgjeze, e cila, me anën e seleksionimit, përpinqet të krijojë kategori të veçanta shqërore.

Drejtimi laik dhe antifetar i shkollës sonë është në kundërshtim me pseudolaicitetin e shkollave borgjeze. Karakteri laik dhe antifetar i shkollës sonë nuk frymëzohet nga antikiteti greko-latin, siç ka bërë borgjezia, duke e gërshetuar këtë frymëzim me idealizmin mistiko-fetar si në teori, edhe në praktikë, por nga idetë jetëdhënëse revolucionare e antifetare të popujve, nga filozofia materialiste shkencore marksiste-leniniste.

Të gjitha këto e të tjera duhen njojur e luftuar, lypset që ato t'i spastrojë autokritika, që të mund të dalim atje ku synojmë, në riorganizimin revolucionar të shkollës, e cila duhet të edukojë të rinj me koncepte teorike shkencore, me realizimet teknike, me pjesë-marrjen drejtpërdrejt në punë prodhuese për zbatimin material të këtyre koncepteve dhe me përgatitje fiziko-ushtarake.

Duhet t'i bëjmë më parë këto spastrime e pastaj të fillojmë punën? Jo. Edhe në këtë çështje të veprojmë në mënyrë revolucionare, siç bëjmë në Parti: veprojgmë, thellohemë në çështjen, bëjmë spastrimin, krijojmë të renë dhe hedhim tej të kaluarën. Kjo është esenca, këto janë rezultatet e metodës leniniste, kjo është rruga që duhet të ndjekim të gjithë. Dhe përtakta kuptuar thellë e përtakta zbatuar si duhet këtë metodë, kanë nevojë shumë të madhe veçanërisht intelektualët, mësuesit, pedagogët, profesorët, kërkuesit shkençorë.

Duke e shikuar çështjen në këtë prizëm, jam i mendimit se, ashtu si në programet, edhe në tekstet ne do të gjejmë mjaft rezerva orësh përtakta qartësuar dhe përtakta fuqizuar më shumë teorinë në shkolla.

Rëndësinë që i vihet teorisë së një lënde, specialisëtët e matin me orët që lihen në dispozicion të kësaj lënde. Orët janë një masë e domosdoshme si në shkollë, ashtu edhe në prodhim. Unë mund edhe të gabohem, sepse specialist i çështjeve të arsimit nuk jam, pavarësisht se 31 vjet më parë kam qenë një mësues i thjeshtë, por në kriteret e caktimit të orëve nga ana e specialistëve, pa thënë se ato janë të pabazuara, mendoj se duhet të ketë rezerva, pasi llogaritë janë bërë duke u mbështetur në numrin e orëve që ata kishin në dispozicion më parë. Patjetër, është bërë njëfarë zbritjeje në to, por më duket e truar dhe me frikë, pa marrë parasysh shumë gjëra që kanë ndryshuar dhe do të ndryshojnë nga zhvillimi revolucionar i masave, që do të ndikojnë vazhdimisht edhe në shkollën e re, në vetë arsimtarët, në metodën dhe në stilin e punës së tyre, të

cilët nuk mund të llogariten me masën e orës, por që e ngrenë shumë vlerën e saj, duke bërë një kthesë drejt përmirësimit të tyre cilësor, i cili do të jetë në favor të fondit të orëve që i përkasin anës teorike.

Le të marrim një problem kyç të prodhimit: vlerën e orës së punës, që në këtë rast materializohet me prodhimin. Po ta matim vlerën e orës së punës aktuale të një punëtori (edhe këtu ka akoma shumë rezerva) me vlerën e orës së punës të të njëjtit punëtor, për të mos shkuar më larg, por dhjetë vjet më parë, me llogari do të na dalë një ndryshim i madh. Për të realizuar prodhimin e orës aktuale, 10 vjet më parë të njëjtit punëtor do t'i duheshin dy, ndoshta edhe tri orë më shumë. Kjo ngjet për arsyen e shumë faktorëve, siç janë: ngritja e tij politike, ideologjike, teknike, mekanizimi i prodhimit, përmirësimi i metodës dhe i stilit të tij në punë dhe një sërë formash emulacioni, të cilat, të gjitha së toku, ndihmojnë të ngrihet rendimenti, të thyhen normat e vjetra dhe të rritet, me një fjalë, vlera e orës së punës. Objektivi kryesor në të gjithë këtë proces është shtimi i të mirave materiale, në sasi dhe në cilësi, me shpenzime dhe me kosto sa më të ulët në prodhimin e mallrave, ruajtja e makinerive dhe, në radhë të parë, ruajtja e shëndetit të punonjësve.

Më duket se edhe nga mësuesit e pedagogët, nga nxënësit dhe studentët duhet të bëhen hapa të tillë revolucionarë dhe ky orientim e kjo eksperiencë e klasës punëtore të kihen parasysh në detyrën e tyre. Pra, zotësia e arsimtarit dhe stili i tij në punë ndihmojnë shumë për ta ngritur vlerën e orës së mësimit në lën-

dën që jep ai, ato ngrenë njëkohësisht edhe aftësitë e nxënësit e të studentit për përvetësimin e lëndës benda në shkollë dhe jashtë saj gjatë studimit individual. Këto përbëjnë një disiplinë të domosdoshme në dhënen dhe në përvetësimin e mësimit, pa to teoria dhe shkenca nuk mund të përvetësohen si duhet, ashtu sikundër edhe punëtori, që pa i zbatuar në mënyrë të disiplinuar proceset, për të cilat fola më lart, nuk mund të ngrejë as veten e tij, as nivelin e prodhimit që ngarkohet të realizojë.

Ne duhet të luftojmë për ekonomizimin e kohës, jo për të ulur nivelin e teorisë në shkolla dhe jo për të nxjerrë njerëz prakticienë të thjeshtë, detyrë kjo që nuk i përgjigjet orientimit marksist-leninist të shkollës sonë, por të përpinqemi që teorinë e domosdoshme ta japim të plotë, të qartë, të kuptueshme dhe, mundësish, brenda një periudhe jo shumë të gjatë. Pikërisht për t'i zbuluar këto mundësi duhet të punojmë ne. Metoda dhe stili leninist në punë do të na ndihmojnë t'i zbulojmë këto. Mundësitë, përveç atyre që përmenda më lart, duhet t'i gjejmë edhe në luftën kundër verbalizmit në dhënen e mësimit, në vrojtimet, në eksperimentet, në punën laboratorike të përgatitur me kulturë të lartë, në shtimin e iniciativës dhe të aktivitetit të nxënësve, të studentëve dhe të arsimtarëve, në kombinimin e dhënies së mësimeve jo vetëm në klasë, por edhe në natyrë, edhe në fabrikë e në fushë, në futjen e kinemasë, të radios e më vonë të televizionit në procesin mësimor, në përgatitjen me kulturë të lartë të leksioneve, të seminareve, të teksteve, që kanë të gjitha një rëndësi të jashtëzakonshme, gjatë përpilimit të të

cilave duhet të kihen parasysh shkenca vetë dhe disiplina e mësimit, zgjedhja si duhet e materialeve dhe ruajtja e nxjerrja në evidencë në mënyrë të qartë e principeve bazë të lëndës në fjalë.

Duhet të kihen mirë parasysh lidhjet reciproke të materialeve mësimore me njëri-tjetrin, të mos figurojnë në materialet e praktikave të ndryshme të njëjtat të dhëna joprodhuese ose të tjera që zënë vend, hanë kohë dhe bëhen të mërzitshme. Për këtë kanë rëndësi të madhe mënyra e paraqitjes së materialeve mësimore dhe shtypja e tyre pastër. Me pak fjalë, në të gjitha tekstet shkollore duhet të jemi këmbëngulës në ekzigjencat shkencore dhe pedagogjike të përbajtjes e të paraqitjes.

Futja e punës në jetën e shkollës duhet shikuar jo si një faktor që ul nivelin e teorisë, për arsy se i merr kësaj një numër të orëve, por si një mjet i rëndësishëm që do të ngrejë nivelin e teorisë, për arsy të kalitjes politike, ideologjike dhe të pjesëmarrjes direkt në prodhim dhe në punë, e cila të gjallëron shpirtërisht e fizikisht, për arsy se nxënësi, studenti dhe arsimtari, nëpërmjet punës në prodhim, do të përvetësojnë atë stil dhe metodë pune të klasës, aq të nevojshëm e të domosdoshëm për shkollën tonë revolucionare.

Futja e punës në shkollë kërkon, natyrisht, ndryshimin e metodave të punës të mësuesve e të pedagogëve, të nxënësve dhe të studentëve. Shkolla jonë lufton, në parim dhe në praktikë, për atë edukim të plotë që rekomandon Marks, domethënë për edukatën politeknike, e cila duhet të vërë në dispozicion të njerëzve kulturën përparimtare të kohës. Të punosh në uzinë,

kjo të nxit nevojën e domosdoshme për të njohur fizikën, kiminë, vizatimin teknik, matematikën. Kështu ndodh edhe kur punon në fusha, të ngjallet dashuria për mësimin e biologjisë, të kimisë, të matematikës, të gjeografisë etj. Puna prodhuese aktivizon studimet teorike, ajo ia zgjeron horizontin studimit, u zhvillon nxënësve e studentëve aktivitetin dhe iniciativën.

Mësimi në klasë nuk duhet të ketë për objekt studimin e përkufizimeve, sepse kjo do të ishte një gjë krejt formale dhe verbalizëm. Përkufizimet duhet t'i plotësohen nxënësit apo studentit me çështje konkrete, që ua japid kërkimet dhe aplikimi i tyre në punën prodhuese. Prandaj është e domosdoshme që në tekstet, si dhe në leksionet e arsimtarëve, të pasqyrohen të dhëna të tillë si në fizikë, në matematikë, në biologji etj., që bazat teorike nxënësi apo studenti t'i gjejë të aplikuara në punën prodhuese, ku do të caktohet të punojë. Vetëm kështu mësimi në klasë do të bëhet i gjallë dhe teoria do të lidhet si duhet me praktikën.

Por një gjë e tillë kërkon, natyrisht, një vëzhgim të vazhdueshëm, kërkon përpjekje për koordinim dhe perfeksionim, që nuk mund të realizohen si duhet në rast se mësuesit dhe pedagogët nuk punojnë tok me nxënësit e studentët në të njëjtat praktika pune. Këto lidhje organike dhe një pedagogji e vërtetë e lypin një gjë të tillë, ato lypin një reflektim të thellë teorik dhe në punë, pse mungesa në këto drejtime mund të na sjellë perturbacione. Në zbatimin dhe në perfeksionimin e sistemit mund të dobësohen praktikat teorike në shkolla dhe të mos përfitohet kështu sa duhet dhe si duhet nga puna prodhuese. Duhet të ruhem i nga lidh-

jet artificiale të punës me teorinë. Të lidhur ngushtë me nxënësit e studentët, arsimtarëve tanë puna prodhuese do t'u shërbejë të grumbullojnë një eksperiencë të madhe nga puna, e cila do t'u forcojë mendimin teorik, do t'i ndihmojë të përmirësojnë metodën e dhëniec së mësimit; ajo do të nxitë, gjithashtu, te nxënësit e studentët dashurinë për punën, lidhjet e drejta të teorisë me praktikën, si dhe iniciativën krijuese.

Puna e arsimtarit në prodhim deri tash gati nuk ka ekzistuar fare, por edhe ajo pak që është bërë, ka qenë e shkëputur nga profili i tij si specialist dhe nga nxënësit e studentët. Ky është një minus që do të ndihet nga ne gjatë zbatimit të reformës. Këtë minus nuk duhet ta neglizhojmë e ta nënvleftësojmë. Në këtë drejtim të bëhet një kthesë e madhe, të kuptohet thellë kjo çështje nga arsimtarët tanë, sepse nuk është diçka formale dhe vetëm për nxënësit e studentët, por do të ndihmojë për të revolucionarizuar mendimin teorik të vetë mësuesve e pedagogëve, për të revolucionarizuar parimet pedagogjike dhe didaktike, për të ndryshuar stilin dhe metodën e punës së tyre në perfeksionimin dhe në dhënien e lëndëve. Arsimtarët do të pengojnë në rast se do të mendojnë që çdo gjë ka ndryshuar për nxënësit e studentët dhe asgjë për ata vetë, në rast se do të mendojnë të shkojnë në klasë me atë bagazh që kanë dhe me metodat e vjetra. Jeta libreske e arsimtarit dhe metoda e vjetër verbale nuk mund të jenë të mjaftueshme, bile ato mund të kthehen në pengesa, në rast se ai nuk lidhet me jetën, me zhvilimin tekniko-shkencor, në qoftë se nuk bëhet pjesëtar aktiv e me iniciativë krijuese i revolucionit të madh që

po zhvillohet në vendin tonë, i cili po rrëzon forma e koncepte të vjetruara dhe vendos në vend të tyre forma e koncepte të reja e progresive.

Hartimi i programeve, përpilimi i teksteve të reja të përshtatshme me këto programe dhe me orientimin e ri të shkollës sonë, studimi i metodave e i stilit të punës, qoftë nga mësuesit e pedagogët, qoftë nga nxënësit e studentët, kanë një rëndësi vendimtare. Kjo punë e madhe duhet t'u shpëtojë rutinës, dogmatizmit, shabllonizmit, konformizmit dhe ndikimit subjektivist.

Është e vërtetë se këto janë kryesisht probleme specialistësh, prandaj duhet të jenë rezultat i një diskusioni të gjerë nga ana e tyre. Megjithatë, nuk duhet hequr dorë për t'ua nënshtruar ato edhe një kontrolli e verifikimi të gjithanshëm të masave dhe veçanërisht mendimit të nxënësve e të studentëve. Këta, nga eksperiencia e tyre, kanë shumë për të thënë në të gjitha këto punë.

Unë dua të theksoj veçanërisht se, përvçe komisioneve të veçanta të specialistëve që do të merren me këto çështje, qoftë brenda në Ministrinë e Arsimit e të Kulturës ose rrrotull saj, duhet që edhe brenda vëtë shkollës së çdo tipi e shkalle ato të bëhen objekt diskutimi të rëndësishëm në mes mësuesve, pedagogëve, nxënësve e studentëve. Të mos ndjekësh në mënyrë të organizuar dhe me fryshtë kritike tekstet, programet, t'i konsiderosh këto, ashtu si edhe format e metodat e punës të vendosura, si të dhëna një herë e përgjithmonë ose të zorshme për t'i ndryshuar drejt plotësimit dhe përmirësimit të tyre, kjo përbën pikëpamjen

që theksova më lart, të servilizmit, të shabllonizmit, të rutinës etj.

Shkolla nuk është një makinë pa shpirt, ajo nuk krijon robotë, por është një institucion i lartë i një edukimi revolucionar, i një pedagogjie dhe një didaktike revolucionare. Duhen vundosur dhe duhen zbatuar programet, por duhet organizuar puna edhe për t'i kontrolluar si zbatohen ato, për të nxjerrë vazhdimisht mësime dhe eksperiencë nga të mirat e nga gabimet. Ky vëzhgim i përhershëm e i pandërprerë nuk duhet të jetë i njëanshëm dhe vetëm në drejtimin se si i zbaton programet nxënësi apo studenti, por edhe si i përvetëson dhe pse i përvetëson mirë ose keq, sepse në këtë pikë të fundit qëndron qëllimi i madh i shkollës. Prandaj gjendja dhe formimi psikik i nxënësit dhe i studentit jo në mënyrë diletante, por shkencore, duhet të jetë një nga preokupimet e veçanta, të shkollës sonë.

E njëjtë gjë duhet thënë edhe për tekstet. Edhe kur të përpilohen ato duhen ndjekur me kujdes të madh, pasi vazhdimisht kanë nevojë për azhurnime, pavarësisht se nga ana teknike nuk kemi mundësi t'i rishtypim shpesh.

Për sa u përket moralit dhe psikologjisë së re që duhet t'i ngulim në ndërgjegje rinisë sonë, më shumë se deri tash duhet të na preokupojë, përveç të tjerave, edhe çështja e argëtimit dhe e lodrave si në shkollë, ashtu edhe jashtë shkollës. Në qoftë se këtë problem nuk e shikojmë drejt dhe nuk e zbatojmë si duhet, në parim ne mund të flasim shumë për pedagogjinë dhe psikologjinë e re, por në fakt nuk kemi parasysh se një

nga faktorët që ndikojnë për formimin e plotë të karakterit, të moralit dhe për zhvillimin fizik të rinisë janë dhe lojërat e argëtimet e shëndetshme nga çdo pikëpamje. Pra, krahas mësimit, teorisë, punës në prodhim dhe edukatës fiziko-ushtarake, janë edhe lojërat e organizuara nga shkolla, brenda dhe jashtë saj, që kanë një rëndësi të veçantë. Të tjerat nuk duhet të na bëjnë ta harrojmë këtë çështje, që disa herë mund të na duket e dorës së dhjetë për shkollën.

Faktorë të rinj hyjnë në shkollën tonë, faktorë jo të veçuar nga dhënia e teorisë ose e praktikave laboratorike, prandaj mendoj se do të bëjmë gabim në teori dhe në praktikë, po s'e konsideruam këtë si një kompleks unik. Dhe kjo kërkon një ndryshim revolucionar cilësor, kërkon studime e kërkime për thellimin e një pedagogjie, të një psikologjie e didaktike të re revolucionare marksiste-leniniste, krejt në kundërshtim me ato borgjeze dhe revizioniste. Këtë e lyp ndërtimi i vrullshëm e i plotë i socializmit, e kërkon ky revolucion i pandërprerë që krijon dhe udhëheq Partia dhe që konkretizohet në masat e gjera të popullit tonë me dashurinë e tyre të zjarrtë për Partinë dhe për atdheun socialist, për punën dhe për mësimin, për shpirtin kolektivist, për miqësinë e singertë me njëri-tjetrin. Ajo konkretizohet, gjithashtu, me këmbënguljen në luftën e pamëshirshme që u bëhet njollave të së kaluarës në shoqëri dhe në ndërgjegjen e njerëzve, në luftën që i bëhet fesë dhe në përpjekjet për përvetësimin rrënjësor të edukimit ateist, për vendosjen e normave të reja të jetës proletare, me një fjalë, për konceptin komunist për botën.

Unë nuk do të zgjatem në parimet dhe në konkluzionet që u arritën pas një pune një e më shumëvjeçare në bazë të tezave të drejta të Partisë, në rezultatet dhe në orientimet për veprim që u vunë kaq mirë në dukje nga raporti i Byrosë Politike dhe nga diskutimet e shumta e të plota që u bënë këtu në këtë mbledhje të Komitetit Qendror. Dëshiroj vetëm të theksoj se sistemi arsimor që po ndërtojmë, pavarësisht nga disa gjëra në dukje të ngjashme ose lëndë të njëllojta, pavarësisht nga mjetet mësimore ende të dobëta, të cilat ne do t'i përmirësojmë vazhdimisht, është në kundërshtim me sistemet borgjeze dhe revizioniste në parimet, në strukturat, në sistemin, në qëllimet, në format organizative të punës dhe të mësimit, në stilin e në metodën, në pedagogjinë, psikologjinë dhe didaktikën.

Partia jonë bën një luftë të madhe që diturinë dhe shkencën botërore, këtë pasuri të të gjithë njerëzimit, ta bëjë pasuri edhe të popullit tonë, ta bëjë një ushqim të shëndetshëm për mirëqenien e njerëzve tanë. Nga masat tona punonjëse përvetësimi i kësaj diturie botërore po bëhet me etje të madhe, progresivisht dhe kurdoherë në ngjitje, me gjithë prapambetjen që trashëguam për arsyet e njoitura të së kaluarës së errët dhe të mjeruar të popullit tonë. Por këto etapa të vështira tashmë janë kaluar qysh me çlirimin e atdheut nga Partia dhe populli.

Partia jonë përvetëson nga dituria dhe shkenca botërore pjesën më të shëndoshë e progresive të saj. Ajo e bën këtë zgjedhje në prizmin e teorisë marksiste-leniniste dhe me qëllim që t'u shërbejë interesave të popullit, ndërtimit të shoqërisë sonë socialiste dhe ko-

muniste. Një shfrytëzim dhe një zgjedhje e tillë hedh poshtë kalbësirën, vjetërsirat e panevojshme, lufton interpretimet idealiste të ligjeve dhe të fenomeneve si në teori, ashtu edhe në zbatimin praktik të tyre, zgjedh format dhe metodat më të përshtatshme me situatat e reja për zbatimin dhe zhvillimin e tyre dialektik.

Një shfrytëzim dhe një zgjedhje e tillë lufton dogmatizmin, servilizmin dhe fetishizmin në shkencat borgjeze e revizioniste dhe u hap njerëzve tanë horizonte të gjera pune e mendimi, zhvillon iniciativat e tyre krijuese, të cilat, me rrugën e materializmit shkencor, sjellin për atdheun socialist, për Shqipërinë dhe për shkencën botërore kontributin e çmuar krijuar e përparimtar të diturisë dhe të shkencës së pararojës.

Përvetësimi i diturisë dhe i shkencave në vendintonë fillon që me hyrjen e fëmijës në shkollë dhe mbaron gjersa ai plaket, duke lënë pas për shoqërinë një kontribut të shquar, me synimin që të arrihet qëllimi i madh i një jete me nder dhe plot dinjitet për popullin.

Prandaj Partia i vë një rëndësi të madhe shkollës revolucionare, për të përgatitur çlirimtarë, patriotë, revolucionarë, ndërtues të lavdishëm të botës komuniste.

Ndryshimet rrënjosore parimore të shkollës sonë me ato borgjeze e revizioniste, si në teori, edhe në praktikë, duhet të përbëjnë objektin e një pune sqaruese nga ana e Partisë, sepse kështu do të kuptohet themelë e pa lëkundje shkolla jonë revolucionare, do të zbatohet drejt e pa lëkundje reforma që po bëjmë dhe do të luftohen me efikasitet teoritë borgjeze e revizioniste për shkollën dhe për gjoja epërsinë e tyre.

Sidomos ne duhet ta ruajmë shkollën tonë nga ndikimi i shkollës revizioniste sovjetike, e cila, në mënyrë demagogjike dhe për të maskuar degjenerimin e saj të plotë në një shkollë borgjeze, përdor formula dhe forma pseudosocialiste. Ne duhet të luftojmë konceptet e reja revizioniste të pedagogjisë sovjetike, e cila, nga njëra anë, gjoja supozon se në Bashkimin Sovjetik po ndërtohet komunizmi dhe, nga ana tjetër, i vë më pak rëndësi punës prodhuese në shkolla, të cilën gati e ka hequr fare, për t'u dhënë një rëndësi më të madhe «kohës së lirë» dhe «edukimit estetik» të rinisë, e mbështjellë e gjithë kjo me të ashtuquajturin zhvillim të harmonishëm, për t'i kushtuar kujdes zhvillimit të «prirjeve», të «talenteve», të «individualiteteve», veçanërisht të atyre që «shquhen në fushën e teorisë dhe të shkencës», duke ushqyer kështu me të gjitha mënyrat në rini intelektualizmin dhe karrierizmin.

Sistemi që po vendosim ne nuk synon, siç preten dojnë teoritë revizioniste sovjetike, «të ulë nivelin e njojurive të përgjithshme» dhe as që këto njohuri t'i qepë si «karaktere episodike» ose si «ilustrim i thjeshtë i punës në prodhim». Revisionistët sovjetikë thëniet e Leninit se

«...as arsimi dhe edukimi pa një punë prodhuese, as puna prodhuese pa arsimin dhe edukimin nuk do të mund të viheshin në atë lartësi, që kërkohet nga shkalla e sotme e teknikës dhe nga gjendja e dijeve shkencore»¹,

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 2, f. 549.

i interpretojnë vetëm si një aspekt social-ekonomik dhe jo edhe ideopolitik e pedagogjik njëkohësisht. Në programin tonë të sistemit të ri të shkollave ne gërshetojmë pikërisht, në mënyrë të harmonizuar dhe në bazë të zhvillimit të jetës materiale e psikike të rinisë, brendinë e lartë marksiste-leniniste të njoħurive teoriko-shkencore, politikën dhe ideologjinë, punën prodhuese, kulturën fizike, përgatitjen ushtarake dhe pushimin normal e të nevojshëm pér të rintjtë.

Sistemi ynë ndryshon nga sistemi revizionist në drejtimet themelore, se në të gjithë sistemin e shkolllave ne futim lidhjen e mësimit me punën, lidhjen e arsimit politeknik me përgatitjen profesionale dhe zhvillojmë dashurinë e rinisë shkollore e studenteske pér punën. Njëkohësisht, hedhim baza të shëndosha teorike dhe tekniko-manuale pér të ngritur më tej e vazhdimishit zotësitë e njerëzve në krijimtarinë shkenccore. T'i ndash këto elemente nga shkolla, veçanërisht ta shkëputësh atë nga praktika, siç bëjnë revizionistët sovjetikë duke filozofuar, të frysmezuar, natyrisht, nga teorira false «marksiste-leniniste» pér pedagogjinë «e vërtetë», atëherë shkolla nuk mund të quhet kurrsesi e avangardës revolucionare. Duke bërë këtë shkollë që po ndërtojmë, ne nuk i harrojmë dhe nuk i konfondojmë nocionet që përcakton Lenini pér politeknikën dhe monoteknikën. Janë pikërisht revizionistët që i konfondojnë këto dhe i shkëputin pér të ndryshuar rrënjësisht karakterin leninist të shkollës, duke pretenduar në mënyrë demagogjike se «i bashkërendojnë» ose «i shkrijnë në një». Në bazë të pedagogjisë së tyre, revizionistët sovjetikë dalin në rrugën se gjoja logjika

dhe sistemi i njojurive të përgjithshme, me fjalë të tjera baza e shkencave, ndryshon kryekëput ose në mënyrë të konsiderueshme me logjikën dhe me sistemin e shkencave teknike. Në ndërtimin e shkollës sonë ne nuk mund të udhëhiqemi nga këto parime. Ne do të dimë, dhe këtu qëndron merita e Partisë sonë, të ndërtojmë një sistem të atillë marksist-leninist dhe një pedagogji e didaktikë të përshtatshme marksiste-leniniste, ku t'i përcaktojmë si duhet këto logjika dhe metoda, në harmoni me zhvillimin e teknikës së re, me vrullin revolucionar dhe me rritjen e rinisë në kushtet e ndërtimit të socializmit.

E gjithë eksperienca e fituar dhe ajo që do të fitohet në të ardhmen, duhet të ndiqet e të përpunohet nga institute të specializuara të Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës, përpunim ky që duhet të bëhet një ushqim plot kalori për shkollat tona. Ne kemi e do të kemi me mijëra kuadro të arsimit me një kualifikim të lartë e me zotësi të shquar, për të mos folur për patriotizmin dhe partishmërinë e tyre të madhe. Këta janë një thesar i paçmuar për shkollën tonë. Të gjithë këta janë të gatshëm, ditën dhe natën, të vihen në dispozicionin absolut të popullit, të Partisë, të rinisë. Prandaj Ministria e Arsimit dhe e Kulturës duhet të ngrejë nivelin e punës, organizimi i saj në shumë drejtime duhet të jetë i atillë që t'u përgjigjet si duhet detyrave kaq të gjera e të rëndësishme që vë përpara Partia.

Ne duhet të njohim, megjithatë, se punonjësit e Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës kanë një meritë të madhe në gjithë këtë punë kolosale që është bërë

në shkollën tonë. Merita kolosale kanë gjithashtu për këtë problem jetik mësuesit dhe pedagogët tanë të talentuar e me partishmëri të lartë. Partia dhe Komiteti i saj Qendror, i falënderojnë të gjithë këta dhe i përgëzojnë nga zemra. Mbarë populli ynë do t'i dojë dhe do t'i respektojë kurdoherë me mirënjojje për punën e madhe që kanë bërë e do të bëjnë edhe në të ardhmen.

Si konkluzion, mendoj se ne kemi vendosur drejt për këtë problem të madh, prandaj shkolla jonë do të ecë me sukses në rrugën e mëtejshme të revolucionarizimit që po i tregon Partia.

Duke qenë plotësisht dakord me të gjitha vendimet e Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror, dëshiroj të theksoj edhe një herë se na pret një punë e madhe dhe e vazhdueshme për ta përsosur si duhet këtë sistem në të gjitha pjesët që e përbëjnë. Udhëheqja e drejtë e Partisë, hovi revolucionar i masave, zotësia dhe patriotizmi i madh i arsimtarëve, i nxënësve e i studentëve, i gjithë inteligjencies sonë popullore, ndihma e paçmueshme e klasës punëtore, e fshatarësisë dhe e mbarë masave punonjëse, zotësia dhe forca e organizuar e Ushtrisë sonë Popullore, të gjitha këto së bashku janë garancia e madhe e suksesit të plotë në revolucionarizimin e shkollës sonë.

Me besim të patundur në të gjitha këto që vendojmë, të punojmë për të kapërcyer me sukses çdo vësh-tirësi që mund të hasim në rrugë, të mobilizohen plotësisht Partia, pushteti, organizata e rinisë dhe organizatat e tjera shtetërore dhe të masave në një punë politike, ideologjike dhe organizative të madhe dhe

mirë e drejt të harmonizuar e të kontrolluar, pse vetëm kështu do të korrim edhe në këtë lëmë fitoren e dëshiruar nga Partia dhe nga populli ynë. Partia po i përgatit popullit një të ardhme akoma më të ndritur dhe çdo shqiptare e shqiptar duhet ta ndiejë për nder dhe për detyrë të kontribuojë në ndërtimin e shkollës sonë revolucionare, për t'i dhënë një hov të mëtejshëm revolucionit ideologjik e kulturor që udhëheq Partia jonë marksiste-leniniste.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i popullit»,
nr. 159 (6511), 5 korrik 1969*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Raporte e fjalime
1969-1970», f. 90.
Tiranë, 1970*

FUTJA E KOMUNISTIT NË MASA DHE TËRHEQJA E TYRE NË REVOLUCION KËRKOJNË ZGJUARSI DHE MPREHTËSI MARKSISTE-LENINISTE

Nga biseda me një delegacion të PK të Italisë (m-l)

12 korrik 1969

Pasi u përshëndet me miqtë, shoku Enver Hoxha tha:

Për mua, shokë,është një gjësim i madh që takohen me ju, se jemi shokë dhe vëllezër, se jemi nga dy vende afér njëri-tjetrit dhe se lufta e përpjekjet tonë dhe tuajat janë për të njëjtat çështje e kanë të njëjtin qëllim.

Nëpërmjet shtypit tuaj ne i ndjekim me vëmendje përpjekjet dhe punën tuaj revolucionare. Ne e kuptojmë se ju punoni dhe luftoni në kushte të vështira, por puna dhe lufta juaj bëjnë pjesë në kontributin që japid bashkërisht të gjitha partitë marksiste-leniniste dhe revolucionarët e botës për çështjen e revolucionit. Nuk ka dyshim se në punën tuaj ju hasni e do të hasni vështirësi edhe në të ardhmen. Të tilla vështirësi revolucionarët hasin vazhdimisht, po në luftë e me luftë i kapërcejnë.

Ju, në radhë të parë, keni një klasë punëtore revolucionare dhe një fshatarësi të madhe, faktorë vendimtarë këta që përbëjnë një plus të madh për punën e partisë suaj. Për shumë muaj me radhë, por sidomos ditët e fundit, në mbarë Italinë po zhvillohen greva e demonstrata të pandërprera nga ana e punëtorëve, e fshatarëve dhe e studentëve. Këto demonstrata e greva, sipas mendimit tonë, nuk kanë për objektiv vetëm arritjen e disa fitoreve në fushën ekonomike, megjithëse borgjezia dhe revizionistët përpiken të tregojnë sikur ato synojnë vetëm qëllime të tilla. Në fakt, demonstratat e grevat në vendin tuaj kanë në radhë të parë synime politike. Unë mendoj se drejt i keni vlerësuar edhe ju në shtypin tuaj si lëvizje që, përvèç qëllimeve ekonomike, kanë synime politike, në radhë të parë, pse drejtohen kundër regjimit borgjez «të qendrës së majtë» e të korrenteve të tjera. Por ne mendojmë se asnë manovër e regjimit të sotëm borgjez në Itali nuk mund t'i gabojë revolucionarët e vërtetë.

Punëtorët, fshatarët, studentët etj., me një fjalë mbarë populli italian, është një popull i gjallë, por përpara këtij hovi të madh revolucionar, së bashku me borgjezinë, janë duke manovruar edhe udhëheqësit e partisë revizioniste dhe ata të të gjitha rrymave të tjera trockiste, antimarksiste, të krijuara nga kapitali monopolist italian për të ulur e pér të dëmtuar vepritarinë e vërtetë revolucionare të masave. Natyrisht, këto janë minuse pér ju. Revizionistët modernë në Itali kanë akoma influencë në masat e punëtorëve. Është e qartë që kjo influencë nuk mund të jetë pér një kohë të gjatë me themelë të shëndosha politike,

megjithatë fakt është se ata kanë forca të mjaftueshme, kanë përvojë dhe tradita organizimi. Duke shfrytëzuar këto avantazhe, ata përpiken të mbajnë masat punonjëse nën ndikimin e tyre, nën obskurantizmin politik. Me anën e parullave të tyre, në kushtet ekonomike ku ndodhet Italia, revisionistët i pengojnë punëtorët të njohin situatën, të shohin qartë rrugën që duhet të ndjekin.

Natyrisht, lëvizjet e fuqishme masive në Itali e kanë burimin në vështirësitë ekonomike që po kalon ajo. Në kushtet aktuale klasa punëtore has vështirësi të mëdha, ajo gjen përpara gjithfarë pengesash në përpjekjet e saj deri edhe për sigurimin e bukës së gojës. Në këto rrethana, gjer në njëfarë mase, ne mund të themi që çështjet ekonomike mbisundojnë, por është me rëndësi që kërkesat ekonomike të masave të lidhen me kërkesa politike dhe kjo detyrë i takon partisë suaj ta bëjë.

Ne jemi dakord me atë që mendoni ju dhe partia juaj se në luftën tonë duhet gjakftohtësi dhe kujdes në përpunimin e vijës, duhen përpjekje për të gjetur rrugën e drejtë në bazë të marksizëm-leninizmit. Por nuk mund të pretendohet që kjo rrugë të arrihet menjëherë, sepse kjo kërkon një punë dhe një luftë të gjatë.

Për të realizuar këtë qëllim, para së gjithash është e domosdoshme të kesh një parti të fortë dhe përreth saj e nën udhëheqjen e saj një front të gjerë që të përmbledhë masat e gjera të punëtorëve e të fshatarëve, si dhe shtresa të tjera të varfra e përparimtare. Për të arritur objektivat, partitë marksiste-leniniste nuk mund

të luftojnë vetëm, pa masat, por së bashku me to dhe në krye të tyre. Ato pa masat nuk mund të bëjnë absolutisht asgjë. Pa u lidhur me masat dhe pa u vënë në udhëheqje të tyre, ato kthehen në bërthama sektare. Një parti që pretendon të bëhet e fortë, e çeliktë, në radhë të parë duhet të përpunojë një vijë të drejtë, të grumbullojë rrëth saj, të organizojë dhe të përfshijë në lëvizje të gjitha masat. Vetëm një parti e tillë lufton me sukses dhe pa frikë ndikimet që përpiken të ushtrojnë nga jashtë mbi të partitë borgjeze e revizioniste.

Nuk ka dyshim se sa më e fortë të jetë partia juaj, aq më të mëdhenj do tëjenë presioni, lufta dhe terrori kundër saj nga ana e borgjezisë dhe e revizionistëve modernë. Në këtë drejtim rreziku ekziston gjithmonë. Natyrisht, sa më i madh të jetë rreziku që i kanoset partisë, aq më shumë pengesa mund të hasen, pse partia do të gjendet edhe përpara njerëzve të lëkundshëm. Vetëm kur ajo të ketë përpunuar një vijë të drejtë që t'i prekë masat në zemër dhe të jetë në gjendje t'ua tregojë e t'ua bëjë të qartë atyre këtë vijë, t'i bindë ato për drejtësinë e saj, vetëm atëherë masat do ta ndjekin dhe do ta mbrojnë partinë e klasës punëtore gjer në fund.

Ne vëmë re me kënaqësi se partia juaj përpinqet të punojë në këtë drejtim. Kjo është me shumë rëndësi. Revisionistët modernë që po bëjnë një punë minuese kundër partisë suaj, gjë që ndihmon kapitalin, tanë po orvaten të marrin pjesë në qeverinë borgjeze. Ata po përpinqen të shuajnë rezistencën e masave punonjëse që kanë nën influencën e tyre. As revisionistët nuk e lënë

pas dore politikën e «thithjes» së masave. Përkundrazi, nëpërmjet demagogjisë dhe pseudomarksizmit të tyre, edhe ata përpiken në këtë drejtim. Revisionistët kanë akoma një numër të madh prej disa milionë votuesish, pra një masë të madhe njerëzish që i ndjekin. Kjo ndodh se punëtorët kanë akoma shpresë te «socializmi» që predikojnë ata, kanë akoma besim te disa krerë tradhtarë të tillë si Longo, Berlinguer, Amendola e të tjerë. Këtë punë renegatët e bëjnë nëpërmjet një organizate partie të krimbur që kurrsesi nuk është e nuk mund të jetë marksiste-leniniste.

Kjo çështje duhet të na bëjë të mendohemi thellë dhe të nxjerrim mësimë të vlefshme se si ta forcojmë më tej punën e partisë pér të bërë me vete masat e gjera të punëtorëve dhe të fshatarëve dhe shtresa të tjera të varfra. Pér t'ia arritur këtij qëllimi ju keni përvojë konkrete nga veprimitaria juaj. Ne dimë, pér shembull, se në Napoli partia juaj u hodh në aksion dhe doli me parulla të drejta, me të cilat mundi të tërheqë mjaft njerëz që u vunë krah pér krah saj. Ve-tëm në Napoli dolën në favorin tuaj 2-3 mijë punëtorë. Kjo është një gjë e madhe. Natyrisht, kjo shifër është shumë larg asaj që synoni ju, po të krahasohet me masën e gjerë të proletariatit italian. Sidoqoftë, vija juaj vetëm në një qytet u arrit të përqafohet nga disa mijëra njerëz. Kjo tregon se, kur punohet me këmbëngulje, vija e partisë bëhet e njohur kudo dhe nga të gjithë. E njëjta gjë ndodhi edhe në disa vende të tjera të Italisë. Natyrisht, forcimi i partisë suaj do t'i bëjë reaksionin italian dhe revisionistët modernë t'ju kenë frikën, po njëkohësisht kjo do t'i bëjë ata

edhe më të egër ndaj jush. Megjithatë, rritja e veprimtarisë revolucionare do të vlejë për ta çelikosur më shumë partinë.

Por një gjendje e tillë si në Napoli nuk po duket akoma në Milano. Dhe kjo kuptohet, borgjezia në Veri është më e fortë, prandaj puna e partisë suaj në këtë qytet ecën ngadalë. Milanoja është qendra më e madhe industriale italiane. Kapitalistët atje kanë eksperiencë dhe mundësi për të manovruar dhe për të hedhur parulla të stërholluara për të gënjen punëtorët. Ju e njihni më mirë se unë gjendjen, por mendoj se në Milano aristokracia punëtore duhet të ketë rrënëjë më të thella se kudo dhe kjo është logjike, për arsy se borgjezia nga fitimet që nxjerr ka mundësi t'u japë disa thërrime më shumë një pjese të vogël të klasës punëtore dhe sidomos krerëve të saj që t'i korruptojë. Megjithatë mendoj se edhe në Milano ekzistojnë kushte të mira për zhvillimin e punës së partisë. Prandaj drejtuesit e partisë në këtë qytet po përpilen për të krijuar e për të forcuar organizatën e partisë atje dhe nuk kufizohen vetëm me gjetjen e disa miqve apo simpatizantëve. Puna më e rëndësishme, por edhe më e vështira, është të krijosh organizatën e partisë dhe jo të kapesh pas disa njerëzve. Ç'kujdes të madh kërkon veprimtaria e shokëve që punojnë në atë rajon me proletariat aq të zhvilluar! Ne kemi besim se partia juaj do të ecë përpara edhe atje si në gjithë Italinë, pse edhe atje kushtet janë të favorshme.

Kur në bisedë e sipër njëri prej miqve nga Italia tha se ishte impresionuar shumë nga një artikull i bo-

tuar në gazetën «Zëri i popullit»¹ për Tercilio Kardinalin, ish-partizanin italian, komandant i batalionit «Antonio Gramshi», inkuadruar në Brigadën I Sulmuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, i cili në korrik 1944 ra dëshmor për lirinë e Shqipërisë, dhe se botimi i këtij artikulli ishte një shprehje e ndjenjave të internacionalizmit proletar nga ana e Partisë së Punesë të Shqipërisë, shoku Enver Hoxha tha:

Kardinali ka qenë një shok i mirë, një luftëtar i vendosur që ka luftuar në radhët e Brigadës I Sulmuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare. Atë nuk e dalloje nga luftëtarët tanë të tjerë të mirë. Në kuadrin e 25-vjetorit të Çlirimtës së Atdheut dhe të fitores së revolucionit populor ne kemi filluar të botojmë në shtypin tonë artikuj për figurat më të dalluara, për luftëtarët më të mirë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare Shqiptare. Midis këtyre luftëtarëve bën pjesë edhe Kardinali, i cili, si shumë italiane të tjerë, në ato çaste të vështira, por heroike, pranoi të bënte pjesë në Lëvizjen Nacionalçlirimtare të vendit tonë, u fut në radhët e Ushtrisë sonë Partizane dhe luftoi për lirinë e Shqipërisë kundër nazistëve gjermanë. Pati edhe kuadro të ushtrisë italiane që u penduan, siç ishte gjeneral Aci, i cili pas Çlirimtës së Atdheut disa herë në Shqipëri dhe, kur kthehej në Itali, fliste mirë për vendin tonë. Edhe pse nuk ishte marksist, edhe pse nuk pranonte rrugën tonë të ndërtimit socialist, ai ruante

¹ «Tercilio Kardinali — një luftëtar internacionalist», 8 korrik 1969.

një simpati të madhe për popullin shqiptar. Njerëz si ky ne i quajmë miq të Shqipërisë. Ne mendojmë se përveç proletariatit, në Itali ka mjaft njerëz si Aci në radhët e borgjezisë, por sidomos të borgjezisë së vogël e të mesme që, jo nga motive politike, por për arsyet traditash e sentimentesh, ushqejnë simpati për Shqipërinë.

Ka shumë njerëz që vrasin mendjen se si jeton një shtet i vogël prej 2 milionë njerëzish në Evropë, i cili përballon me vendosmëri rrithimin imperialisto-revisionist, një vend që është kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kundër Bashkimit Sovjetik, kundër borgjezisë italiane, monarko-fashistëve grekë, klikës së Titos etj. Ata çuditën se si është e mundur të bëjnë këtë qëndresë këta njerëz. Ndonjë mund të thotë se «shqiptarët janë satelitë të Kinës», por sado borgjezë që janë, kur mendojnë se Kina është larg, dhe, në rast sulmi nga armiqjtë mbi Shqipërinë, ajo nuk do ta ndihmojë dot drejtpërdrejt, ndryshojnë mendim dhe shohin me admirim Shqipërinë që u qëndron me heroinë zëm dallgëve të kohës. Dhe, dalngadalë, te këta njerëz lindin simpatia dhe respekti për vendin tonë të vogël. Po ka edhe të tjerë që, megjithëse nuk janë dakord me rrugën që ndjekim ne, ushqejnë, ashtu thjesht, një simpati për Shqipërinë.

Atëherë ç'duhet bërë? T'i godasim me gurë këta njerëz që thonë fjalë të mira dhe gjykojnë drejt se Shqipëria nuk paraqet asnjë rrezik për vendin e tyre? Jo. Njerëz të tillë nuk gjejnë arsyet përsë të mos e simpatizojnë vendin tonë dhe ne ata i konsiderojmë miq. Sot ndoshta nuk bëjnë asgjë, por nesër në kohë rre-

ziku, po të paraqitet nevoja, ata mund ta thonë një fjalë të mirë për Shqipërinë, së cilës mund t'i vlejë shumë. Dhe rreziku për Shqipërinë ekziston vazhdimiشت nga vendet anëtare të NATO-s dhe nga socialimperialistët sovjetikë. Sot ndofta ky rrezik nuk është iminent, por momentet e vështira nuk janë zhdukur për ne. Ka pasur raste në të kaluarën kur patriotët dhe proletariati italian kanë protestuar kundër politikës së qeverive borgjeze të vendit, duke dalë përkrah Shqipërisë, siç është rasti pas Luftës së Parë Botërore, më 1920, duke e lehtësuar luftën e popullit shqiptar për liri. Edhe në të ardhmen njerëz të tillë do ta thonë një fjalë të mirë për vendin tonë dhe ky është një plus për ne.

Dua të them edhe pak fjalë për eksperiencën që kemi ne në lidhje me problemet e Frontit. Të ndjekësh vijën e Frontit, do të thotë të ndjekësh mësimet marksiste-leniniste për zbatimin në praktikë të vijës së masave. Në punën tonë në lidhje me Frontin ne kemi ndjekur eksperiencën e Bashkimit Sovjetik të periu-dhës së Lenin-Stalinit. Kjo punë duket kudo në gjithë veprimtarinë tonë dhe këtë ne nuk e fshehim. Të mohosh mbështetjen e Partisë sonë në mësimet e Leninit dhe të Stalinit, nuk është e drejtë, nuk është marksiste. Në kushtet e vështira të Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare, nën zjarrin e fashizmit italian e gjerman, ne kemi bërë të gjitha përpjekjet për t'i larguar njerëzit nga radhët e armikut. Unë personalisht, në ilegalitetin më të madh, kam marrë takim, bile edhe me disa nga ata që më vonë u bënë kuislingë të fashizmit, siç ishin Faslli Frashëri, Mehdi Frashëri, Abaz Kupi (Bazi i Ca-

nës) e të tjerë. Këtë e bëja me qëllim që, në goftë se nuk do të ishte e mundur t'i futnim këta në luftë kundër pushtuesve, të paktën t'i neutralizonim. Ne e dinim që ishte e vështirë të qëndronin në Frontin Nacional-çlirimtar elementë të tillë. Pati nga këta që arritëm t'i futnim në Front, megjithëse e kishim të qartë se më vonë do të vinte koha të na tradhtonin, por këtë nuk e bëmë pér të térhequr këta si persona, por pér të térhequr me Partinë masat e mashtruara që ata kishin me vete.

Po sjell një shembull. Zogisti Abaz Kupi, një bajraktar i regjur, të cilin e dinim që ishte jo vetëm njeri i Zogut, po edhe agjent i Intelixhens Servisit, kishte ardhur në ilegalitet nga Jugosllavia. Dinim, gjithashtu, se ai ishte kundër pushtuesve italianë dhe kuislingut, kryeministrat të atëhershëm, Mustafa Kruja. Të nisur nga këto të fundit ne dërguam njerëzit tanë atje ku qe vendosur dhe i bëmë thirrje të bashkohej me ne në luftë kundër fashizmit e tradhtarëve. Këtë ai e pranoi. Mirëpo ne e kishim të qartë se sa e si do të luftonte Abaz Kupi kundër pushtuesve dhe tradhtarëve. Partia e kuptonte pse u bashkua me ne dhe sa do të zgjaste kjo manovër e tij, megjithatë ajo veproi me durim me të. Dhe vërtet, siç kishte parashikuar Partia, ashtu doli. Ai ndoqi synimet e tij.

Kur po piqeshin kushtet, para se të ndanim përfundimisht llogaritë, ne përsëri kërkuan të bisedonim me të. Për këtë qëllim shkova në Shëngjergj, fshat afër Tiranës, ku ai qe vendosur. Për t'i treguar se ishim miq dhe nuk kishim frikë, në shtabin e tij shkova i shoqëruar vetëm me 4-5 veta. Kjo ishte pak e guximshme,

ishte një pakujdesi e madhe nga ana jonë, pse, rrreth e përqark shtëpisë ku bëmë takimin, ai kishte vendosur njerëz të shumtë nga të bandave të tij. Në strofkën e tij zhvilluan debate të ashpra. Gjatë diskutimeve ai shkonte shpesh pranë dritareve, të lëna apostafat hapur, që fshatarët e armatosur të bandës së tij, të cilët ishin jashtë në oborr, ta dëgjonin ç'thoshte ai. Në një rast, duke m'u drejtuar me zë të lartë më tha: «Dëgjo, zoti Hoxha, tokën fshatarëve do t'ua jap unë dhe jo ju, komunistët». Po dhe unë u ngrita e i thashë me zë më të fortë: «Tokën fshatarët e varfër do ta marrin vetëm nga komunistët, ata s'kanë për ta marrë kurrë nga ju, zogistët, pse Zogu, që për 15 vjet me radhë qe në fuqi, s'mendoi kurrë pér popullin dhe asgjë nuk bëri pér këtë çështje». Pas një lufte të ashpër me të, u largova. Me këtë doja t'ju thosha se bisedimet me njerëz të tillë janë të vështira, por interesit e do të bëhen patjetër, pér hir të njerëzve të thjeshtë që i ndjekin, të cilët ne duhet t'i kthejmë me Partinë. Puna që bëmë në Front, pak nga pak, i minoi themelet e këtyre njerëzve me influencë. Dhe kur erdhi koha pér t'u dhënë goditjen e fundit, ata u zhdukën si një kështjellë prej letre, pse pozitat e tyre në popull i kishim goditur me kohë, ata ishin izoluar, kishin mbetur vetëm, pa masa.

Partia duhet patjetër të heqë dorë, të shkëputet definitivisht nga fryma e grupeve. Ç'na ndihmoi ne që të kishim sukses në bashkimin e grupeve? Suksesin, natyrisht, nuk e arritëm menjëherë, por pasi hodhëm jashtë ata elementë që na pengonin, me të cilët ne punuan pér mjaft kohë, jo pér ata vetë, se i njihnim ç'ishin, po pér masat e mashtruara që kishin me vete.

Ne e bëmë këtë që ata të cilët i ndiqnin qorrasi, por në të vërtetë e donin komunizmin, të kuptionin tradhtinë e krerëve dhe të hidheshin me Partinë në luftën e saj të drejtë që udhëhiqte kundër pushtuesve e tradhtarëve. Kur u siguruam se masat e gjera të pasesve të tyre e kishin kuptuar drejtësinë e vijës sonë, vetëm atëherë ne filluam t'i demaskonim me të gjitha forcat krerët si tradhtarë që ishin.

Nuk mund të themi se njerëz si Anastas Lula me shokë ishin që në fillim agjentë të armikut, sepse, potë qe kështu, do të na kishin dorëzuar te fashistët, mbasi i njihnin gjithë shokët tanë. Ata ranë në prehrin e armikut dhe u bënë agjentë të tij më vonë, por atëherë Partia jonë ishte forcuar shumë, kishte krijuar baza të shumta, qe shtrirë gjerësisht në popull. Kështu, kur celulat tona bënин mbledhje në lagje, vetë masat e paorganizuara në Parti bënин rojë dhe i ruanin anëtarët e Partisë nga spiunët e xhandarët. Me këtë doja të thosha që një gjë e tillë ka mundësi të ndodhë edhe te ju, mbasi armiku punon veçanërisht te komunistët e paformuar mirë politikisht dhe ideo-logjikisht. Prandaj duhen njobur mirë shokët e duhet bërë çmos që të sqarohen ata për çdo problem dhe të punohet me durim me ta.

Do t'ju flas për eksperiencën tonë. Në Parti kishim edhe njerëz që ishin luftëtarë, por që në momente të ndryshme lëkundeshin. Të tillë ishin Tuk Jakova, Bedri Spahiu, Koço Tashko e të tjera, njerëz vazhdimisht të lëkundshëm, të cilët më në fund ranë në batakun revisionist. Ne bëmë çmos t'i shpëtonim. Kur konstatonim mendime a veprime të gabuara, u

vinim në dukje anët pozitive, po kritikonim njëkohësisht edhe gabimet dhe aspektet e tyre negative, natiyrisht në fillim jo në mënyrë shumë të rreptë. Pasi i linim të vazhdonin punën, kur shihnim se përsëri shfaqnin mendime a kryenin veprime të gabuara, kur shihnim se nuk ndreqeshin dhe kupa mbushej, çështjen e tyre e shtronim në Komitetin Qendror dhe këtë e bënim të nisur nga interesit i mbrojtjes së vijës së Partisë. Në këtë drejtim nuk bënim asnjë lëshim, në asnjë mënyrë nuk shmangeshim nga vija e Partisë.

Ne tani mund të themi se në të gjitha hallkat e Partisë, nga udhëheqja në bazë, ka diskutime të shumta, të hapëta e të sinqerta. Njeriu ndien një kënaqësi kur shkon në mbledhje partie, qoftë të Plenumit të Komitetit Qendror, të komitetit të Partisë të një rrethi, apo të një organizate-bazë. Çdo komunist shkon me dëshirë në mbledhjet e Partisë, se nuk ka meskinite, nuk shtrohen çështje individuale; komunistët nuk shkojnë atje me prapamendime. Kjo ndodh se tashmë është çelikosur situata në Parti. Por një gjendje e tillë u arrit vetëm pas një lufte të gjatë, të vështirë e paramore. Po të lexoni Historinë e Partisë sonë, do të shikoni se para 1948-s gjendja në të nuk ka qenë si sot. Vetë ne në udhëheqjen e Partisë kemi kaluar vështirësi të ndryshme. Në shumë raste mbledhjet e udhëheqjes fillonin në drekë dhe mbaronin të nesërmen në mëngjes. Në këto mbledhje shkonim me zemër të thyer, se e dinim që do të ndesheshim me pikëpamje të huaja, me qëndrime oportuniste. Kjo ishte pasojë e punës minuese të revizionistëve jugosllavë dhe e një grupei tradhtarësh të Partisë dhe të popullit tonë. Në

këto kushte për hiçgjë krijoeshin situata shumë të rënda.

Por pas një lufte të vendosur e të ashpër u këpucyё edhe kjo fazë, shkaktarët u demaskuan e u flakën, çdo gjë në Parti u sqarua dhe, duke bërë të gjitha përpjekjet, metoda e punës erdhi gjithnjë duke u përmirësuar, ndërsa udhëheqja e Partisë erdhi duke u forcuar. E vëmja rrugë e drejtë që duhet të ndjekë partia për të përballuar situatat e rënda e për të dalë prej tyre është zbatimi me rreptësi i parimeve mark-siste-leniniste. Detyrat politike dhe organizative të partisë duhet të diskutohen gjer në caktimin e vijës. Por kjo s'mjafton. Është e domosdoshme të luftohet nga të gjithë, pa përjashtim, për zbatimin e saj, pa lëshimin më të vogël. Partia jonë është nisur gjithnjë nga parimi që, po e more pushtetin, duhet të bësh përpjekje ta mbash atë gjer në fund, në asnjë mënyrë të mos lejosh t'i hapen dyert ideologjisë borgjeze, pse kjo është e ngjashme me punën që bën krimbi brenda në mollë, e cila nga jashtë mund të duket e kuqe, po në fakt brenda është e tëra e kalbur.

Jemi të bindur se partia juaj ka fituar e do të fitojë edhe më shumë eksperiencë në të ardhmen. Ne kemi njëfarë eksperience, siç e keni vënë re, por kjo nuk është e mjaftueshme, prandaj edhe neve na duhet të mësojmë akoma shumë dhe pikërisht për këtë arsyë bëjmë përpjekje që puna e Partisë të gjallërohet vazhdimit, mbasi situatat ndryshojnë, dhe në përpunthje me këto edhe puna e format e saj duhet të ndryshojnë. Ekonomia në vendin tonë zhvillohet vazhdimit, atëherë edhe puna e Partisë në të gjitha drej-

timet duhet të ndryshojë, të ecë përpara. Po kështu edhe në arsim, kulturë etj.

Në mbledhjet e Komitetit Qendror ne jemi detyruar të caktojmë vazhdimisht detyra të reja. Kështu vepruan edhe për revolucionarizimin e shkollës sonë. Puna jonë në këtë drejtim është akoma nga fillimi. Kjo do të thotë që në të ardhmen ne të bëjmë më shumë përpjekje për të vënë në jetë vendimet e KQ të Partisë për çështjen e shkollës, që të mobilizohet e gjithë Partia e ta kuqtojë ajo në radhë të parë se çështjet e arsimit futen në të gjitha hallkat e jetës sonë, natyrisht, pa lënë pas dore ekonominë dhe problemet e tjera.

Edukimi i njerëzve, sidomos i rinisë, e preokupon shumë Partinë. Tani në mbarë vendin po studiohet Historia e Partisë sonë. Përveç kësaj, neve na duhet të studiojmë edhe materiale të tjera. Ka komunistë që ankohen si do ta gjejnë kohën për të kryer të gjitha këto detyra. Partia atyre u këshillon të mendojnë vetë si ta zgjidhin këtë problem. Ajo u thotë: gjersa jeni komunistë duhet ta gjeni medoemos kohën edhe për këtë detyrë, prandaj përvishjuni punës dhe, pas orarit të punës në uzinë, në kooperativë apo në zyrë, studioni edhe Historinë e Partisë, merruni edhe me problemet e shkollës e me problemet e tjera, mbasi komunistët duhet të merren me të gjitha. Po të mos merren ata, atëherë kush tjetër do të merret?

Format dhe metodat e punës ndryshojnë e bëhen vazhdimisht më të përsosura. Komunisti duhet të mendojë vazhdimisht për çdo gjë, si të punojë dhe si ta organizojë punën më mirë për të përballuar me sukses

të gjitha detyrat që i dalin përparrë e që merr përsipër. Për këtë qëllim ai duhet të mësojë vazhdimit nga librat dhe nga jeta e gjallë revolucionare e masave, e bazës. Edhe udhëheqësit patjetër duhet të lidhen me bazën e partisë dhe të konsultohen me të se si ta zgjidhin këtë ose atë problem, pse zgjidhjen më të saktë ata do ta gjejnë në masë.

Partia i mëson komunistët të thonë atë që mendojnë qoftë mirë apo keq, nga mendimet e secilit ajo do të nxjerrë mësime e konkluzione. Le të marrim çështjen e arsimit. Për këtë problem te ne u bë një diskutim i gjerë popullor. Rreth 600 mijë njerëz morën fjalën gjatë këtij diskutimi, duke shfaqur mendime të rëndësishme. Pati edhe nga ata që thanë edhe fjalë boshe, Partia i lë njerëzit të flasin, t'i shprehin lirisht mendimet. E gjithë kjo veprimitari e masave për arsimin u bë pa i sjellë asnje pengesë prodhimit, punës 8-orëshe të secilit, pse diskutimet u bënë pas punës. Kishte njerëz, dhe këta nuk ishin të paktë, që, të zënë me problemin e revolucionarizimit të shkollës, flinin pak, ata ishin gjithnjë në lëvizje, pse e kuptionin rëndësinë e veçantë të këtij problemi të madh parimor që shtronte Partia. Pra, eksperiencia është relative, ajo fitohet duke luftuar e duke punuar.

Ne ju falënderojmë shumë për vlerësimin që i bëni eksperiencës modeste të Partisë sonë, po kini parasysh që të merrni prej saj atë që mendoni se është e domosdoshme dhe mund të vlejë për partinë e përvendin tuaj. Nga kjo pikëpamje nisuni në çdo rast.

Ju nuk duhet të dëshpëroheni pse hasni në vësh-tirësi. Kini parasysh që kur flasim ne për eksperien-

cën e Partisë sonë, nuk jemi në kushte të barabarta me ju, pse ne kemi në dorë pushtetin, kemi kuadro të shumtë dhe shumë mundësi të tjera, kurse ju nuk keni gjithnjë kohë e kushte të mira pune. Megjithatë partia do t'ju kuptojë, po për t'ua bërë të njoitura komunistëve këto vështirësi, gjatë veprimtarisë së tyre, udhëheqësit duhet të përzihen e të shkrihen me shokët e bazës. Domosdo, po të punosh me shokët e bazës nuk do të kesh kohë të mbyllesh për të përgatitur shkrime të bucura, por edhe këto duhen bërë. Përgatitja e një shkrimi ose përpunimi i një materiali nuk është një punë që mund të bëhet aq lehtë, ajo kërkon studim, fakte, kohë etj., të cilët duhet t'i gjejë kuadri, udhëheqësi. Është e kuptueshme që kur akoma nuk është kriuar një numër i mjaftueshëm shokësh për të ndihmuar udhëheqjen, detyra e saj është e rëndë, pse shumë punë do t'i duhet t'i bëjë vetë.

Për ne janë një ndihmë e madhe takimet me ju. Shoku Ramiz më vuri në dijeni për mendimet që shkëmbyet me njëri-tjetrin rrëth disa çështjeve që kanë të bëjnë me forcimin e partisë. Në këtë drejtim duhet punuar me këmbëngulje me shokët. Unë flas sipas përvojës sonë, mbasi, siç e thatë edhe ju, megjithëse Partia jonë, si më e vjetër që është, ka më shumë eksperiencë, prapë edhe te ne ka akoma shokë që nuk janë çelikosur si duhet, prandaj na bie detyra të punojmë dhe t'i edukojmë ata.

Marksizëm-leninizmi disponon një gamë të tërë metodash pune për t'i bërë masat të mendojnë si duhet. Ka mundësi që në momentet e para disa njerëz

të mos jenë të fortë, por kur të sigurojnë baza të shëndosha ideologjike e ndërgjegje klasore, edhe këta do të mendojnë mirë, do të punojnë si revolucionarë dhe do të ecin përpara. Njerëzit e thjeshtë, po të ndihmohen një herë, dy, tri me siguri do të korrigohen. Natyrisht kjo shtrohet për ata që janë të sinqertë, se përnjë që nuk është i sinqertë, edukimi është i vështirë. Punë këmbëngulëse për edukimin e shokëve duhet bërë, pra, me ata që kanë një bazë të shëndoshë marksiiste-leniniste, kurse elementët jo të korrigjueshëm duhen hedhur jashtë partisë, pse kjo duhet të ketë shumë kujdes që të mos kthehet në një parti pa ngjyrë, me gjithfarë elementësh, si ajo toliatiste te ju.

Ne nuk jemi kundër mendimeve e pikëpamjeve të ndryshme në parti, por këto duhet të nisen nga pozita të shëndosha, që të synojnë zgjidhjen drejt të problemit që diskutohet dhe forcimin e partisë. Të dalësh në parti me pikëpamje për pikëpamje, kjo nuk do të bënnte tjetër veçse do ta shtrembëronte rrugën e saj. Në këto drejtime ne mund të shkëmbejmë mendime e të ndihmohemi reciprokisht. Ne do të ishim të kënaqur t'ju pritnim më shpesh e të bënim konsultime, pse këto i shikojmë nga pikëpamja e luftës sonë të përbashkët. Luftën e popullit italian ne e konsiderojmë si luftën e një populli vëlla. Përveç kësaj, i njëjti rrezik paraqitet si për ju, ashtu edhe për ne nga ana e imperializmit, e reaksionit dhe e revisionizmit modern. Prandaj takimet, shkëmbimin e pikëpamjeve me njëri-tjetrin dhe kombinimin e aksioneve të përbashkëta ne i konsiderojmë të domosdoshëm. Rreth e qark Shqipërisë miq ne kemi popujt dhe miq e shokë vetëm marksistë-lenini-

stët. Në këtë plan e shtrojmë kërkesën për t'u takuar më shpesh me ta.

Ne dëshirojmë që në situatën e krijuar në Evropë dhe në botë partia juaj të dalë si një parti e fortë, jo vetëm në Itali, por edhe në arenën ndërkombëtare, që së bashku me partitë e tjera marksiste-leniniste të intensifikojmë luftën për zgjidhjen e problemeve të mëdha politike që ekzistojnë sot në botë, sidomos në Evropë.

Në përfundim të bisedës shoku Enver Hoxha tha:

Ju uroj shëndet tē mirë juve dhe partisë suaj suksese gjithnjë e më tē mëdha në luftën e saj. U jepni shumë tē fala nga ana ime tē gjithë shokëve tuaj dhe u shprehni atyre ndjenjat më tē mira tonat dhe tē Partisë sonë.

Botuar për herë tē parë në librin: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përbledhje veprash) 1968-1970», f. 424

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përbledhje veprash) 1968-1970», f. 424

OBJEKTIVAT ARRIHEN ME AKSIONE REVOLUCIONARE DHE JO ME DISKUTIME SHTERPE

*Nga biseda me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë
Komuniste Peruane, Saturnino Paredes Macedo*

12 korrik 1969

*Në fillim fjalën e mori shoku Enver Hoxha, që,
duke u përvendetur me mikun, tha:*

Gëzohem shumë që takohem me udhëheqësin e Partisë motër Komuniste Peruane, luftën e së cilës ne e ndjekim me admirim të madh. E them sinqerisht, shoku Paredes, se ardhja juaj në Shqipëri na ka ndihmuar së tepërm, mbasi nëpërmjet jush u njohëm me eksperiencën e madhe të luftës që bën Partia motër Komuniste Peruane kundër kapitalistëve dhe latifondistëve në vendin tuaj. Ne mendojmë se lufta që po bëni ju, e bazuar në marksizëm-leninizmin dhe në forcët e gjalla të proletariatit e të fshatarësisë peruanë, është pjesë e rëndësishme e luftës së madhe që bëjnë gjithë komunistët e vërtetë marksistë-leninistë në vendet e Amerikës Latine. Aktualisht ne dhe të gjithë komunistët e vendeve të tjera të botës ndjekim me

vëmendje e me kënaqësi të veçantë zgjerimin e lëvizjes revolucionare në Amerikën Latine, e cila është vazhdimisht në rritje, pavarësisht se atje sundojnë me egërssi kapitali i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ai i vendeve të tjera të fuqishme kapitaliste, si dhe gjithfarë armiqsh të tjerë të hapët e të maskuar.

Lufta në vende të ndryshme të kontinentit latino-amerikan tregon se lëvizja revolucionare, e udhëhequr nga marksistë-leninist, është mjaft e madhe. Ajo që ka rëndësi është se kjo luftë shkon duke u ngjitur, me gjithë ndikimin e rrezikshëm të rrymave të ndryshme armiqësore, disa nga të cilat hiqen si të majta. Edhe pse ekzistojnë këto rryma, partitë marksiste-leniniste, që kanë ndërtuar vijën e drejtë të luftës së armatosur kundër kapitalit e jankive dhe të luftës së pamëshirshme në fushën ideologjike kundër rrymave anti-marksiste të çdo marke qofshin, ecin vazhdimisht përpëra.

Ne vërejmë me kënaqësi se edhe partia juaj po e organizon mirë zbatimin e vijës së saj të drejtë. Ju, në mënyrë të veçantë, keni krijuar baza jo vetëm në qytet, po edhe në gjirin e fshatarësisë. Kjo është një punë e domosdoshme, pse përfitoren e revolucionit proletar nuk mjafton të kesh vetëm një vijë korakte, po duhet të organizosh edhe zbatimin e saj drejt në jetë, në përputhje me kushtet konkrete të vendit.

Rolin e fshatarësisë në lëvizjen revolucionare, ne shqiptarët sidomos e kuqtojmë mirë, pse vendi ynë shumicën e popullsisë e ka edhe sot të tillë. Si para edhe gjatë kohës së Luftës Nacionallirimtare, fshatarësia shqiptare ka qenë një klasë revolucionare. Ajo

ishte shumë e shtypur, e varfër dhe e mjeruar e, një-kohësisht, ishte shumë patriote, trime e vendosur dhe e sakrificës. Fshatarësia jonë e pranoi menjëherë vijën proletare të Partisë. Edhe pse në Shqipëri nuk ekzistonë akoma një numër i madh punëtorësh, ajo e kuptoi se vija e Partisë e kishte bazën te klasa punëtore. Që në fillim fshatarësia shqiptare pa se në qytet pushtuesit po goditeshin çdo ditë nga komunistët, se lufta e programi i Partisë Komuniste të Shqipërisë kënaqnin kërkesat e saj shekulllore. Partia jonë i porosiste vazhdimisht anëtarët e saj që, krahas luftës kundër pushtuesve në qytet, të punonin dhe të luftonin edhe në fshat. Dhe kështu u bë. Lufta u ndez edhe në Pezë e në malet e Krujës, në Kurvelesh e në Korçë, në Vlorë e në Berat, në malësitë e Matit dhe të Shkodrës, të Dibrës dhe të Tropojës. Ne gjetëm atje jo vetëm prapavija të shëndosha, por kudo fshatarët rrokën armët dhe dolën partizanë.

Edhe ju, duke e kuptuar drejt këtë problem bazë, po tregoni një kujdes të veçantë për çështjen e fshatarësise. Kjo i detyrohet udhëheqjes së drejtë të partisë suaj. Ju keni një eksperiencë të madhe në lidhje me fshatarësinë. Të udhëheqësh një sindikatë aq të madhe të proletariatit të fshatit që përfshin në gjirin e vet një milion e ca fshatarë, siç është ajo juaja në Peru, do të thotë që partia juaj marksiste-leniniste e kpton si duhet çështjen e madhe të aleatëve të proletariatit. Prandaj format e punës që përdorni ju dhe rezultatet që keni arritur në luftën për zbatimin e zhvillimin në jetë të marksizëm-leninizmit në Peru, përbëjnë një thesar të madh për të gjithë ne mark-

sistë-leninistët e kontinenteve të tjera e na bie detyra ta studiojmë atë me shumë kujdes.

Edhe takimet në mes nesh për shkëmbim mendi-mesh, për të fituar nga eksperiencia e njëri-tjetrit, kanë rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Kur ne takohemi me shokët e vendeve të tjera dha mësojmë për luftën e përvojën e tyre, forcohem. Ne takohemi me shumë shokë të partive e të grupeve të ndryshme marksiste-leniniste që punojnë në ilegalitet ose në legalitet, kjo, sipas kushteve ekzistuese të secilit vend. Me ta bisedojmë për probleme të ndryshme. Gjatë bisedave, por edhe në praktikë, kemi vënë re se disa prej tyre i kuptojnë deri diku ngushtë rolin dhe detyrën e komunistit.

Disa mendojnë se i gjithë preokupacioni i partisë ose i lëvizjes revolucionare marksiste-leniniste duhet të përqendrohet vetëm te puna me punëtorët e uzinave e të fabrikave, duke injoruar kështu aleatët më të ngushtë të proletariatit, fshatarësinë e varfër dhe të mesme, në përgjithësi, dhe argatët e fshatit, në veçanti. Gjendja e fshatarësisë është kudo e mjeruar. Bazat e partisë dhe të luftës revolucionare që ajo udhëheq, kurdoherë në rrugën marksiste-leniniste, kur në qytet është më vështirë, mund të krijoheshin edhe më shpejt dhe, në shumë raste, të ishin edhe më të sigurta në fshat.

Po ka edhe shokë që bëjnë të kundërtën, përsëri duke e parë problemin ngushtë. Tërë punën e partisë këta e përqendrojnë vetëm në fshat dhe harrojnë qytetin, ku ekziston organizimi i madh kapitalist dhe proletariati i fuqishëm që ka misionin historik të përmbyshë me revolucion shoqërinë e kalbur kapitaliste.

Po ka edhe «komunistë» që thonë se s'kemi mundësi të ndjekim vijën e luftës. Në bisedat me ta ne u sjellim si shembull qëndrimet revolucionare të shokëve të Partisë Komuniste Peruane e të Partisë Komuniste të Brazilit, që ndjekin me sukses rrugën e drejtë të luftës, të organizimit e të mobilizimit të klassës punëtore dhe të fshatarësisë. Si ju, shokë të Perusë, që i keni hedhur bazat edhe në fshat, kanë vepruar dhe shokët e Brazilit. Edhe shumë parti të tjera luftojnë ta përgatitin këtë situatë, e cila nuk është aventurë, por një veprim i drejtë marksist.

Kur na takon të bisedojmë me njerëz që gjithë punën e komunistëve e kufizojnë vetëm në qytet, siç ju thashë edhe më lart, ne u japim si shembull eksperiencën e mirë të partive motra të Amerikës Latine. Me këtë nuk duam t'u themi atyre aspak që në kundërshtim me rrethanat konkrete të vendeve të tyre të hidhen në aventurë, të sulen para kohe për të rrëmbyer armët, jo, por, bazuar në kushtet konkrete, mendojmë se fshatarësia është një forcë e madhe revolucionare. Mirëpo në fshatin e iks vendi, për shembull, ku rrojnë miliona fshatarë të varfër, sundon kapitali i egër latifondist, prandaj komunistët atje nuk duhet ta përqendrojnë luftën vetëm në qytet, ku, ç'është e vërteta, reaksiioni është më i organizuar, po të luftojnë njëkohësisht edhe në fshat. Tani, ndoshta, atje nuk është akoma koha të luftohet me pushkë, por që të vijë momenti për t'u hedhur në luftë të armatosur, duhet ta përgatitësh situatën, siç po bëjnë shokët komunistë në disa vende të Amerikës Latine, të cilët kanë filluar ta përgatitin terrenin në këtë drejtim. Ja

përse, të dashur shokë, ne e vlerësojmë lart luftën tuaj konsekiente marksiste-leniniste dhe për këtë na vjen shumë mirë. Njëkohësisht ne e ndiejmë veten shumë të detyruar ndaj shokëve revolucionarë si ju që luftoni në kushte të vështira.

Ne na gjëzon edhe fakti që ju po e kalitni partinë me anën e spastrimit të radhëve të saj nga elementët revizionistë. Kjo që po bëni është një tjetër punë e madhe. Këtë sëmundje e kemi hequr të tërë, prandaj nuk bën përjashtim në këtë drejtim as partia juaj. Ne duhet të jemi kurdoherë vigjilentë në luftën kundër armiqve të partisë, pse ata përpiken vazhdimisht të na dobësojnë ose të na likuidojnë, po na gjetën rastin dhe në qoftë se ne do ta shuajmë vigjilencën. Kush mbyll sytë dhe fle para këtij rreziku, ai do të shkatërrrohet, atij do t'i ngjasë pikërisht si në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste. Prandaj është e domosdoshme të forcohet vazhdimisht vigjilenca jonë revolucionare.

Edhe Partia jonë nëpër këtë rrugë ka ecur. Ajo është përpjekur që t'i sqarojë me durim ata që gabojnë, t'i ndihmojë një herë, dy, tri, duke përdorur të gjitha format e punës, me qëllim që ata të ndrezen, në interes të Partisë dhe të revolucionit. Kur ka ardhur puna që ky interes të dëmtohej dhe kur është parë se përpjekjet e bëra me këta njerëz nuk jepnin rezultat, atëherë ata i kemi hedhur pa hezitim jashtë Partisë, pse krimbin nuk duhej ta linim brenda në mollë, ndryshe ajo, megjithëse nga jashtë mund të dukej e bukur, gradualisht do të kalbej dhe, pas një kohe, do të bëhej krejtësisht jo vetëm e pavlefshme, po edhe

e rrezikshme për të infektuar të tjerat. Prandaj si ju, ashtu edhe ne dhe gjithë partitë e vërteta marksiste-leniniste, bëjmë mirë që i pastrojtmë radhët tona nga elementët antiparti, pse kjo mënyrë veprimi i forcon këto radhë. Ne kemi vërtet nevojë për numër, por në radhë të parë kemi nevojë për cilësinë e përbërjes së partisë. Një parti, në të cilën ekziston një unitet monolit, është në gjendje të bëjë me vete masat e gjera të popullit dhe të zëvendësojë jo një, dhjetë apo një-qind persona të pavlefshëm apo armiq që ajo përjashton, por në vend të tyre mund të pranojë në radhët e veta dhjetëra mijë të tjerë të rinj, të sprovuar në luftë dhe në aksion.

Duke marrë fjalën, miku peruan tha:

Ashtu është, shoku Enver. Unë e ndiej veten jashtëzakonisht të gëzuar që m'u dha rasti të vij në tokën shqiptare dhe të takohem e të bisedoj me ju. Gjatë qëndrimit në vendin tuaj unë u takova me shokë të Partisë, të rinisë, me masat e popullit, me punëtorë e me kooperativistë, me të rinj e të reja, të cilët, siç konstatova, po bëjnë kudo një punë të vrullshme. Më kanë bërë përshtypje të thellë të gjitha këto takime dhe kam mbetur shumë i kënaqur prej tyre. Edhe ne po luftojmë për zbatimin e vijës së partisë. Me orientimet që dhamë dhe me masat që morëm, hoqëm elementët që qëndronin formalisht në parti dhe lamë në radhët tona njerëzit e shëndoshë, më të mirë e më të devotshëm. Kjo është një kënaqësi e madhe për ne.

Pastaj shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Ne e kuptojmë dhe gëzohemi shumë që keni ve-

pruar drejt dhe në rrugë marksiste-leniniste për ta bërë partinë me të vërtetë bolshevikë, ashtu siç na këshillojnë Lenini dhe Stalini. Sipas gjykimit tim të thjeshtë, mendoj se po të kishit vepruar ndryshe, çështja e revolucionit në Peru nuk do të ekte përpara.

Forcimi i Partisë Komuniste Peruane përbën garancinë që ajo të përparojë dhe të ecë kurdoherë me hapa të sigurt. Veprimitaria që zhvillon ju është inkurajuese. Nga sa dimë, puna bazë juaja nuk priret nga tendenca subjektiviste, po bazohet në ide revolucionare marksiste-leniniste, që kanë kurdoherë për qëllim të kalitin partinë.

Gjatë spastrimit revolucionar të partisë, me sa dimë ne, ju keni zbatuar disa forma pune revolucionare, marksiste-leniniste, që janë të drejta dhe të domosdoshme jo vetëm për ju që jeni duke punuar përgatitjen e revolucionit, por edhe për ne, që e kemi fituar atë dhe tani po e thellojmë më tej. Pa marrë masa, pa revolucionarizimin e vazhdueshëm të partisë, revolucioni fishket. Çështjen e kam veçanërisht te tendencat e disa njerëzve tuaj që, siç kemi dëgjuar, kishin prirje për diskutime të pambaruara në organizatbazë, duke lënë kështu në harresë problemet kryesore të partisë. Debatet me frymë të sëmurë nuk e kanë burimin në ndjenjat e vërteta dhe në mendimet realiste marksiste-leniniste, po në ndjenja dhe në mendime subjektiviste. Kritikat e nisura nga pozita të sëmura nuk janë kurrë konstruktive, përkundrazi, ato demoralizojnë revolucionarët dhe frenojnë revolucionin. Një fenomen i tillë, megjithëse rrallë, ndodh edhe te ne në ndonjë organizatë-bazë partie, ku ka ndonjë

element që u vë më shumë rëndësi çështjeve të dorës së dytë dhe atyre personale. Kështu, kur dikush bën një gabim dhe në organizatën-bazë fillojnë diskutimet jo për gabimin, por «për sytë e bukur» të dikujt dhe diskutimet vazhdojnë me radhë mbledhje pas mbledhjeje e në frymë jo të shëndoshë, problemet e mëdha kryesore që ka organizata-bazë patjetër harrohen, komunistët futen në grindje me njëri-tjetrin dhe ndahen në grupe e tarafe. Këto grupe apo tarafe në pamjen e parë mund të mos kenë karakter politik, po personal, për arsy se në fillim ato nuk drejtohen kundër Partisë. Mirëpo, duke kaluar nga personi në person, diskutimi parimor zbehet e mosmarrëveshjet shtrihen në një rreth më të gjerë njerëzish dhe atëherë ato e dobësojnë ose e rrezikojnë Partinë. Kështu organizata-bazë ndahet më dysh, lind frenimi i përpjekjeve të Partisë për problemet që e preokupojnë, njerëzit merren vetëm me çështje personale e me diskutime të vogla, lihen kështu pas dore problemet kryesore, organizata dobësohet.

Partia na mëson se nuk duhen lejuar të meta e gabime në radhët tona. Ato, porsa të zbulohen, duhen kritikuar e korrigjuar me kohë, pa u zgjatur gjer në masën sa të krijohet një përçarje. Me këtë dua të them që ju, duke u mbështetur në metodën dhe në parimet e drejta revolucionare, i keni zgjidhur drejt çështjet që ju kanë preokupuar.

Sic kemi marrë vesh, elementët që pastruat, ishin të influencuar nga aventuristët e majtë kastristë, të cilët u vinin përreth sidomos studentëve. Nga sa dimë ne, duke lexuar «teoritë» e Kastros e të të tjerëve si

ky për partinë, për luftën e armatosur, për rolin e fshatarësisë dhe për besimin që duhet të ketë partia tek ajo, konstatojmë se të gjitha këto «teori» të tyre nuk janë aspak marksiste. Duke lexuar defterin e Çe Guevarës që u botua në Kubë, bëjmë pyetjen: Ç'marksist mund të jetë ai që rron si një njeri i egër në Sierra dhe punën e organizon fshehtazi nga masat, te të cilat nuk ka besim?

Prandaj ju keni vepruar shumë mirë që i keni goditur tendencat aventuriste kastriste dhe elementët e sëmurë i pastruat nga radhët tuaja, për arsyen se ata me siguri kishin në plan sabotimin e bazave të shëndosha të Partisë Komuniste Peruane në masat fshatare.

Reaksionarët dhe kapitalistët nuk janë budallenj, ata e shikojnë se në fshatrat e vendeve të Amerikës Latine ekziston një forcë e gjallë, siç janë fshatarësia e varfër dhe ajo e mesme, që dita-ditës po organizohen e po bëhen një forcë që u fut tmerrin. Është kjo arsyjeja që kapitalistët bëjnë çmos për të vendosur qetësi në prapavijat e industrisë. Ata e dinë se, po nuk patën qetësi në fshat, po nuk qenë në gjendje të shfrytëzojnë tokat pa kokëçarje dhe po nuk i patën mirë nën sundimin e tyre ata që i punojnë këto toka, ku prodhohen drithërat, pambuku, panxhari, frutat, ku rriten bagëtitë etj., industria paralizohet dhe atëherë me siguri kapitalistëve u krijohen turbullira e çregullime të mëdha. Këtë e kanë parasysh mirë kapitalistët dhe gjithë reaksioni.

Imperializmi amerikan sot ka hedhur rrënësë në të katër anët e botës për të sigruar lëndë të parë

bujqësore dhe minerale për ekonominë e vet. Për t'i siguruar këto privilegje ai mban në këmbë një ushtri të madhe me të cilën shtyp me forcë punonjësit e vet dhe të vendeve të tjera, bile ka arritur të blejë deri mendjen e njerëzve në vendet që i konsideron «aleate». Ai u jep kredi dhe armë të gjitha klikave sunduese reaksionare që kanë tradhtuar interesat kombëtarë për të mbajtur popujt e tyre nën zgjedhë. Për këto arsyе lëvizja fshatare luan sot kudo një rol të madh kundër synimeve grabitqare të imperialistëve, prandaj edhe partitë marksiste-leniniste duhet të mbështeten në këtë lëvizje. Këto parti mbështetjen kryesore duhet ta kenë dhe e kanë, në radhë të parë, te klasa punëtore, por ato duhet të kenë baza edhe në fshat, ku është aleati kryesor dhe i natyrshëm i proletariatit.

Ju keni bërë shumë mirë që i pastruat radhët e partisë nga elementët antiparti, të cilët përdornin lloj-lloj mënyrash për të dobësuar dhe për të likuiduar partinë. «Ç'na duhet partia, në radhë të parë kemi ushtrinë», thotë Fidel Castroja. Ai flet me një gjuhë me të cilën dëshmon se nuk ka qenë kurrë ndonjëherë marksist. Po si mund të qëndrojë në këmbë një ushtri popullore pa udhëheqjen e partisë? Ushtri kishte në Shqipëri edhe në kohën e ish-mbretit Zog, po ajo ishte e dobët, reaksionare, kurse ushtria jonë sot është e fortë e popullore, pikërisht sepse udhëhiqet nga një Parti marksiste-leniniste. Ja përse, me pak fjalë, konceptet e Kastros për partinë dhe ushtrinë nuk janë marksiste.

Sic e patë edhe vetë, ne kemi arritur disa sukses-

se, po kemi akoma shumë për të bërë. Kryesorja është që njerëzit tanë po luftojnë me një entuziazëm të madh për zbatimin e vijës së Partisë dhe që populli ynë politikisht është i formuar. Tani po bëhen përpjekje të mëdha që bashkë me formimin ideologjik e politik, masat t'i ngremë edhe nga ana arsimore, shkençore dhe teknike. Në këtë fushë, sigurisht, kemi akoma shumë për të bërë, për arsy se çlirimi i atdheut na gjeti shumë të prapambetur në të gjithë sektorët. Ne duhet të punojmë për të ecur me hapa më të shpejtë përpara në të gjitha drejtimet: për modernizimin e industrisë sonë, për elektrifikimin e gjithë vendit, për intensifikimin e bujqësisë dhe për mekanizimin e saj, për ujitjen e tokave dhe për ngritjen e nivelit agro-teknik të bujqësisë sonë kooperativiste, për zhvillimin e arsimit e të kulturës etj. Për arritjen e gjithë këtyre objektivave, natyrisht, duhen një punë dhe një luftë e gjatë, por ne kemi besim të plotë, se tani kemi krijuar edhe kushte më të favorshme.

Në radhë të parë, në popull ekzistojnë një hov i madh dhe një dëshirë e zjarrtë për të ecur përpara, bile dua të them se kërkesat për planifikim janë të tilla që i kapërcejnë shumë mundësitë tona reale. Ne na gëzon shumë fakti që kërkesat për të ecur përpara kryesisht vijnë nga vetë masat, të cilave detyrohem i t'u shpjegojmë gjer ku i kemi mundësitë për realizimin e tyre si dhe rrugët që duhen ndjekur për të krijuar mundësi të reja që të ecim edhe më përpara. Vrulli i madh i masave dhe besimi i tyre në vijën e drejtë të Partisë është një anë shumë pozitive. Kjo ndikon edhe në nivelin ekonomik, i cili në vendin

tonë jo vetëm nuk është ulur, po, përkundrazi, ka ardhur vazhdimisht duke u ngritur. Po ta krahasojmë nivelin ekonomik të sotëm me vitet e para të pasçlirimt, ai ndryshon si dita me natën. Por duhet ta kesh njohur Shqipërinë përpara Çlirimit, që të mund të konceptosh ndryshimet që janë bërë te ne.

Në vitet që do të vijnë s'ka dyshim që niveli ekonomik i popullit tonë do të ngrihet më lart. Duhet pasur parasysh, shokë, se çmimet te ne kurrë nuk janë ngritur, përkundrazi, ato janë ulur vazhdimisht. Këtë ka synuar vazhdimisht politika e Partisë dhe e Qeverisë sonë. Kjo politikë bazohet në situatën reale të vendit tonë, në kundërshtim me vendet e tjera të botës, duke përfshirë edhe vendet revizioniste, ku çmimet ngrihen nga koha në kohë.

Në Shqipëri kanë marrë një zhvillim të mirë si industria, ashtu dhe bujqësia. Kurdoherë kemi pasur parasysh që fabrikat dhe uzinat t'i ndërtojmë kryesisht pranë lëndës së parë. Në shumicën e qyteteve ka me dhjetëra vepra, po ka edhe qytete që kanë vetëm një, dy, deri tri fabrika apo uzina. Në të gjitha rrethet dhe rajonet tani kemi inxhinierë, ekonomistë, veterinerë e zooveterinerë, pa përmendur arsimtarët, mjekët dhe specialistët e tjerë me arsim të lartë. Në këtë vrull revolucionar, komitetet e Partisë po bëjnë plane për mobilizimin e gjithë këtyre kuadrove që tani janë me qindra në çdo rreth. Këta, së bashku me masën, kanë diskutuar dhe kanë vendosur për të ngritur teknikume me forcat e veta dhe kanë pasur sukses. Kështu në shumë rrethe, me iniciativën e tyre, janë ngritur edhe filiale të Universitetit të Tiranës dhe të

Institutit të Lartë Bujqësor për inxhinieri mekanike, elektrike, për agronomi etj.; këto, në shumë raste, janë ngritur jashtë parashikimeve të Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës. Te ne është duke u ngritur gjithnjë e më shumë sidomos niveli ideologjik, politik, arsimor dhe kulturor i popullit.

Duke përfunduar këtë bisedë, shoku Enver Hoxha falënderoi mikun për fjalët e mira që tha për Partinë tonë dhe shprehu gjëzimin për sukseset e Partisë Komuniste Peruane.

Ne ju lutemi, — tha shoku Enver Hoxha, — t'u çoni të falat tona të përzemërta gjithë anëtarëve të Partisë Komuniste Peruane dhe t'u thoni atyre se te Partia e Punës e Shqipërisë dhe te populli shqiptar ata kanë shokë dhe vëllezër besnikë gjer në fund, derisa të triumfojnë idetë tona të përbashkëta të socializmit dhe të komunizmit në të gjithë botën.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha.
«Kundër revizionizmit mo-
dern (Përbledhje veprash)
1968-1970», f. 440*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Kundër revizio-
nizmit modern (Përbledhje
veprash) 1968-1970», f. 440*

ANTIIMPERIALIZMI FALS — MASKE KUNDËREVOLUCIONARE E REVIZIONIZMIT HRUSHOVIAN

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

15 korrik 1969

Nuk ka shumë që në sallën Georgievskaja morën fund fjalimet oratorike të krerëve të partive revizioniste dhe u bënë publike vendimet e tyre «për të forcuar unitetin» dhe «për të luftuar imperializmin». Tani udhëheqësit revizionistë sovjetikë përpinqen t'i mbushin mendjen botës se pas pesë vjet përpjekjesh e mundimesh të jashtëzakonshme ata arritën gjoja një sukses të madh, të mbledhin në Moskë koncilin aq të dëshiruar revizionist dhe t'i detyrojnë shumicën e sundimtarëve të vegjël të partive pjesëmarrëse, kë me kërbaç e kë me rubla, të këndojnë sipas avazit të tyre.

Por gjëmimet e fanfarave dhe ditirambet e shtypit sovjetik nuk mund ta fshehin dot të vërtetën e hidhur se trojka brezhnjeviane mori shumë pak fitime për gjithë atë kapital që kishte vënë në mbledhjen revizioniste.

Ajo mbeti shumë prapa nga realizimi i qëllimeve që udhëheqësit revizionistë sovjetikë kërkonin të arriuin nëpërmjet saj. E parë në përgjithësi, mbledhja nuk arriti të bëhet një kor i unisuar i reklamimit të pakondicionuar të politikës shoviniste rusomadhe të socialimperialistëve sovjetikë. Diferenca e dukshme për ato që thuhen e për ato që nuk thuhen midis fjalimit të Brezhnjevit dhe dokumentit përfundimtar të mbledhjes, dëshmon se patriarkët revizionistë të Moskës nuk mundën t'u imponojnë bashkëbiseduesve të tyre të gjitha tezat teorike dhe konceptet e veta politike. Falimentimi i përpjekjeve të udhëheqësve të Kremlinit për të ruajtur kohezionin ideologjik, politik e organizativ të frontit revizionist nën kontrollin dhe drejtimin e tyre doli krejtësisht në evidencë.

Dokumenti përfundimtar, me gjithë drejtimin e tij të theksuar antikomunist e kundërrevolucionar, nuk ka mundur të arnojë të gjitha shthurjet dhe shembjet e gardhit brenda të cilit krerët sovjetikë kërkojnë ta mbajnë të myllur kopenë revizioniste. Është fakt se paçavurja që nënshkruan në Moskë krerët e regjur oportunistë të partive revizioniste, po interpretohet qysh tani në mënyra mjaft të ndryshme nga pjesë-marrësit e tij. Dhe nuk mund të ndodhë ndryshe. Ajo është rezultat i kompromiseve e i lëshimeve reciproke, që kanë gjetur shprehjen në një grumbull formulimesh akrobatike që kënaqin të gjithë dhe nuk angazhojnë njeri. I vetmi detyrim i qartë që ata morën vullnetarisht përsipër, janë intensifikimi i luftës kundër marksizëm-leninizmit, revolucionit e socializmit, besëlidhja për të sabotuar lëvizjen revolucionare e çirimitare të

popujve dhe për të shpejtar vrapin e tyre drejt integrimit përfundimtar me borgjezinë. Për sa i përket çështjes së zgjedhjes se me cilin imperializëm do të lidhen, me atë perëndimor apo me atë sovjetik, ata ia lanë vetes duart krejtësisht të lira.

Tezat dhe qëndrimet që përmban i ashtuquajturi dokument kryesor i mbledhjes revizioniste, kanë për qëllim të shtrembërojnë në mënyrë të stërholluar mësimet e lavdishme të marksizëm-leninizmit për revolucionin e diktaturën revolucionare të klasës punëtore. Dokumenti kërkon t'i japë një mbështetje teorike qëndrimit prej renegatësh, grevëthyesish e kapitulluesh të revizionistëve modernë ndaj problemeve të mëdha që kanë nxjerrë sot në plan të parë lufta revolucionare e klasës punëtore ndërkombëtare dhe betejat e mëdha antiimperialiste e çlirimtare të popujve në të gjitha kontinentet. Revisionistët kërkojnë me çdo kusht pajtimin klasor dhe tërhiqen me bisht në shalë përparrë kërcënimeve dhe presioneve të borgjezisë. Me dokumentin e vet ata i luten borgjezisë që tradhtisë së tyre t'u përgjigjet me disa koncesione, në mënyrë që të takohen në rrugë dhe të ruajnë së bashku sistemin e shfrytëzimit kapitalist, të shtypin proletariatin dhe të mënjanojnë revolucionin.

Nuk nevojiten shumë përpjekje për të konstatuar faktin se në kartën revizioniste të Moskës bëhet fjalë jo për të luftuar imperializmin, po për ta sabotuar luftën kundër tij, jo për të ndezur më tej flakët e revolucionit, po për t'i shuar ato. Tema e bujshme «detyrat e luftës kundër imperializmit në etapën e tanishme dhe uniteti i veprimit i partive komuniste

e punëtore e i të gjitha forcave antiimperialiste», e zgjedhur me shumë mundim nga revizionistët sovjetikë, është një blof i keq që nuk mbulon dot synimet kundërrevolucionare të tyre.

Partitë politike, forcat e ndryshme shoqërore, vetë politika e shteteve gjykohen e vlerësohen jo nga fjalët, jo nga deklaratat, por nga veprat, nga aksionet e tyre praktike. Ç'tregojnë faktet?

Thelbi i tërë luftës midis marksizëm-leninizmit e revizionizmit ka qenë dhe është i lidhur me qëndrimin ndaj imperializmit, dhe sidomos ndaj imperializmit amerikan, armikut më të madh e më të egër të popujve të të gjithë botës. Karakteri reaksionar i revizionizmit hrushovian shprehet pikërisht në vijën e bashkëpunimit sovjeto-amerikan për sundimin e botës. Çdo hap, çdo qëndrim i tyre në arenën ndërkombëtare bëhet në kuadrin e kësaj aleance dhe u shërben qëllimeve të saj kundërrevolucionare.

Antagonizmi e lufta midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit modern janë një shprehje e antagonizmit dhe e luftës klasore midis proletariatit e borgjezisë, midis rrugës socialiste e rrugës kapitaliste, midis vijës së luftës kundër imperializmit, për triumfin e revolucionit e të socializmit, dhe vijës së bashkëpunimit me imperializmin, për shtypjen e revolucionit dhe për shkatërrimin e socializmit.

Revizionistët modernë, me klikën hrushoviane sovjetike në krye, jo vetëm që vetë kanë hequr dorë nga çdo lloj lufte kundër imperializmit, por me tërë vijën dhe veprimtarinë e tyre përpiken të minojnë të gjitha forcat antiimperialiste, të shuajnë flakët e luf-

tës së tyre revolucionare. Si në vijën e përgjithshme, ashtu edhe në qëndrimet për çështjet konkrete pozitat e revisionistëve janë fund e krye kundërrevolucionare e proimperialiste.

Për të fshehur kapitullimin dhe bashkëpunimin e tyre me imperializmin, për të larguar vëmendjen e popujve nga planet dhe nga veprimet e imperializmit e të revizionizmit sovjetik, në mbledhjen e Moskës dhe në dokumentin që aprovuan, revisionistët bënë një demagogji të madhe «antiimperialiste» dhe shumë zhurmë, sidomos rreth disa problemeve të rëndësishme të politikës së sotme botërore, siç janë: çështja e Vietnamit, ajo e «sigurimit evropian», e Lindjes së Mesme, e çarmatimit etj., etj.

Por, ndërsa llomotitin për antiimperializëm, revisionistët modernë asgjë s'i pengon që në praktikë të marrin masa, njëra pas tjetrës, për të forcuar lidhjet dhe bashkëpunimin e gjithanshëm me fuqitë imperialiste, sidomos me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me kreun e tyre, Niksonin. Dy fuqitë e mëdha — imperializmi amerikan dhe revizionizmi sovjetik, po lidhen në një aleancë të ngushtë ushtarake bërthamore, të drejtuar kundër popujve revolucionarë të botës. Traktati famëkeq për ndalimin e pjesshëm të provave të armëve bërthamore midis Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës i vitit 1963, traktati tjetër për mospërhapjen e armëve bërthamore, i përgatitur bashkërisht nga SHBA dhe BS vitin e kaluar etj., synojnë të ruajnë monopolin bërthamor të këtyredy fuqive të mëdha, ta përdorin atë si mjet shantazhi

për të kërcënuar e për të nënshtruar popujt në emër të vendosjes së sundimit të tyre në botë. Këtij qëllimi i shërbejnë edhe pazarllëqet aktuale midis imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve sovjetikë për kufizimin e raketave e për probleme të tjera, të cilat kanë për qëllim të koordinojnë dhe të zbatojnë së bashku planet agresive kundërrevolucionare. Hija e bisedimeve me Niksonin, që do të zhvillohen së afërmë, dominoi edhe mbledhjen revizioniste të Moskës, e cila i la të gjitha dyert të hapëta për manovra e marrëveshje. Fakt është se «rezolutat antiimperialiste» të kësaj mbledhjeje nuk krijuan as shqetësimin më të vogël përtej Atlantikut. Amerikanët ishin në dijeni të plotë e të informuar hollësisht nga sovjetikët për anën e jashtme dhe të brendshme të farsës së Moskës.

Qëndrimi ndaj luftës së popujve dhe të kombeve të shtypura ka qenë kurdoherë një vijë demarkacioni midis marksistë-leninistëve e revizionistëve. Me një forcë akoma më të madhe shtrohet kjo në kohën tonë. Në fund të fundit, çështja revolucionare e proletariatit botëror varet drejtpërsëdrejti nga rezultatet e luftës së popujve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine, e cila minon nga themelët sundimin e imperializmit botëror si në prapavijat, ashtu edhe në metropolet. Sot janë më aktuale se kurrë fjalët e Leninit se

«Lëvizja revolucionare në vendet e përparuara do të ishte praktikisht një mashtrim i thjeshtë pa bashkimin e plotë dhe më të ngushtë të punëtorëve në luftën kundër kapitalit në Evro-

pë dhe në Amerikë dhe të qindra e qindra miliona skllevërve «kolonialë», të shtypur nga ky kapital»¹.

Megjithëse me fjalë e konsiderojnë lëvizjen nacionalçlirimtare si një forcë antiimperialiste, revizionistët me vepra e minojnë atë.

Çfarë ndihme mund t'i japid revisionistët hrušovianë çështjes së çlirimit të Vietnamit, kur ata mbajnë lidhjet më të ngushta e forcojnë vazhdimisht aleancën me vrasësit e popullit vietnamez, kur, në interes të agresorëve amerikanë, përpiken me të gjitha mjetet e mënyrat të detyrojnë popullin heroik vietnamez të kapitulojë, të pranojë planin amerikan të së ashtuquajturës zgjidhje politike paqësore, për të përjetësuar sundimin amerikan dhe të kukullave të Sajgonit në Vietnamin e Jugut?

Le të marrim si shembull tjetër Lindjen e Mesme. Për nevojat e strategjisë globale e kundërrevolucionare, socialimperializmi sovjetik po zhvillon një veprimitari të gjithanshme për të përfunduar një marrëveshje politike me imperializmin amerikan për të sabotuar luftën çlirimtare të popujve të kësaj zone. Të gjitha përpjekjet e tyre kanë për synim t'u imponojnë arabëve kapitullimin përpara agresorëve izraelitë, të shuanjë flakët e luftës së armatosur të popullit palestinez, të realizojnë planin kriminal sovjeto-amerikan për ndarjen e sferave të influencës, për të përçarë e për të grabitur popujt e Lindjes së Mesme.

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 301.

Synimi themelor i veprimeve të bashkuara «anti-imperialiste», thuhet në dokumentin kryesor të mbledhjes revizioniste të Moskës, «si gjithnjë mbetet lufta kundër rrezikut të luftës, rrezikut të luftës botërore termobërthamore, e cila vazhdon t'i kërcënojë popujt me shfarosje në masë, lufta për paqe në të gjithë botën». Vendet socialiste, klasa punëtore, partitë komuniste, popujt e kombet e shtypura, që janë forcat antiimperialiste të kohës sonë, sipas revizionistëve duhet të braktisin të gjitha idealet e tyre revolucionare, duhet të heqin dorë nga çdo lloj lufte kundër imperializmit e reaksiyonit për çlirimin kombëtar e shoqëror dhe të bëjnë si qëllim të tyre kryesor luftën për paqe kundër rrezikut të luftës. Dhe për t'u mbushur mendjen atyre thonë se «lufta për paqe shkrihet me luftën për lirinë e popujve, përparimin e demokracinë, për të shpëtuar nga dhuna e huaj, nga kolonializmi e neokolonializmi, nga reaksiioni e diktatura fashiste». Na del kështu se lufta për paqe na qenka «shkopi magjik» për të zgjidhur të gjitha problemet e mëdha që shqetësojnë popujt.

Lufta për paqe është e pandarë nga lufta kundër imperializmit. Ta drejtoш luftën për paqe vetëm kundër rrezikut të luftës, siç bëjnë revizionistët modernë, do të thotë të luftosh kundër pasojës dhe të lësh të paprekur shkakun, burimin e saj. Rreziku i luftës nuk vjen nga qelli, por nga imperializmi. Lufta ka qenë dhe është pjellë e rendit shfrytëzues, është bashkudhëtare e tij e pandarë. Nuk mund të ketë paqe në botë përderisa do të vazhdojë të ekzistojë imperializmi. Të shpallësh si qëllim kryesor luftën për paqe dhe këtë

luftë ta drejtosh vetëm kundër rrezikut të luftës, kjo do të thotë të përjetësosh statukuonë në botë.

Objktivi kryesor i forcave antiimperialiste nuk mund të jetë lufta për paqe kundër rrezikut të luftës, por lufta për shkatërrimin dhe për likuidimin e imperializmit. Vetëm kështu mund të shmanget rreziku i luftës. Prandaj edhe rruga kryesore për mbrojtjen e paqes e për ndalimin e luftës është revolucioni. Dhe në qoftë se imperialistët do të guxojnë të shpërthejnë një luftë botërore, ajo do të mbarojë jo me shkatërrimin e njerëzimit, siç thonë revisionistët, por me varrosjen e imperializmit nga revolucioni i popujve. Në kundërshtim me pikëpamjen e revisionistëve, që thonë «ose paqe me çdo kusht, ose shkatërrim total», marksistë-leninistët i përbahen tezës revolucionare se shpëtimi i popujve, i proletariatit është i lidhur me shkatërrimin e sistemit imperialist të shtypjes e të shfrytëzimit.

«Paqja», «antiimperializmi», «uniteti i veprimit» e të tjera parulla demagogjike e false të udhëheqësve sovjetikë tingëllojnë aktualisht si një zhurmë mashtruese për të larguar vëmendjen e popujve nga realiteti, nga dalja në skenën botërore e imperializmit revisionist sovjetik, nga pretendimet dhe nga kërcënimet e tij.

Karakteristikën kryesore të politikës së jashtme aktuale të klikës udhëheqëse sovjetike e përbën tanikalimi në metodat e hapëta fashiste, në përdorimin e dhunës, në aventura ushtarake e agresione të armatosura.

Ngjarjet e fundit në Çekoslovaki treguan se klika

sovjetike nuk pyet më për parimet e lirisë e të pavarësisë, të vetëvendosjes e të sovranitetit të popujve. Për të ekziston vetëm një parim, ai që të marrë nëpër këmbë e të shqelmojë çdo parim, marrëveshje, traktat apo aleancë. Në fakt, për çfarë lirie e pavarësie, për çfarë sovraniteti kombëtar mund të bëhet fjalë për satelitet e Bashkimit Sovjetik, kur në vendet e tyre janë vodosur forcat ushtarake sovjetike, të cilat bëjnë ligjin kudo?

Por oreksi i imperializmit sovjetik i kalon kufijtë e zonës që ndodhet drejtpërdrejt nën ndikimin e tij. Politika e shantazhit ushtarak drejtohet tanj hapur edhe kundër vendeve të tjera të Ballkanit. Flota ushtarake sovjetike po e zgjeron gjithnjë e më shumë zonën e veprimit të saj në detin Mesdhe, në oqeanin Paqësor e në atë Indian. Ministri i Luftës i Bashkimit Sovjetik, mareshali Greçko, me planet e tij ushtarake në çantë, viziton njërin kryeqytet pas tjetrit — Kajron, Damaskun dhe Bagdadin, Ravalpindin e Delhin.

Mbledhja revizioniste e Moskës, pavarësisht nga lumi i fjalëve «kundër imperializmit» që u derdh në të, pavarësisht nga disonancat në gjykimet e përfaqësuesve të partive rreth disa problemeve koniunkturale të situatës ndërkombëtare, në vijat kryesore iu nënshtrua objektivave dhe synimeve të paracaktuara nga udhëheqësit sovjetikë, për të cilët ne kemi pasur rastin të bëjmë shpeshherë fjalë në këto shtylla gazete.

Krerët e partive revizioniste që u lidhën pas qerrës sovjetike, morën një përgjegjësi të madhe e të rëndë para masave punonjëse në vendet e tyre dhe para mbarë klasës punëtore ndërkombëtare. Ata hynë

në një rrugë të rrezikshme, e cila do të ketë pasoja shumë të rënda për ta.

Tipari esencial i mbledhjes ishte karakteri i saj antikinez, synimi për t'i angazhuar të gjitha partitë revizioniste në luftën kundër Kinës, Shqipërisë dhe forcave të tjera revolucionare në botë. Këtë të vërtetë nuk e vë aspak në dyshim fakti që në dokumentet e mbledhjes nuk sulmohet shprehimi as Kina, as Shqipëria. Kjo është vetëm një manovër e ulët e kusarit që hedh gurin e përpinqet të fshehë dorën, e cila ka për qëllim t'u japë njëfarë ngushëllimi atyre revizionistëve, që, duke dashur të ruhen nga aventurat më të rrezikshme, kënaqen me lugë të zbrazët.

Se ç'vlerë kanë këto dokumente për krerët revizionistë të Kremlinit dhe për veglat e tyre të bindura, këtë e vërteton edhe tërë propaganda e tyre pas mbledhjes, e cila reklamën më të madhe e kryesore ua bën fjalimeve të delegatëve që sulmuan Kinën.

Tani është bërë e qartë për tërë botën se objektivi kryesor i kësaj politike luftënxitëse e agresive të carëve të rinj të Moskës është RP e Kinës. Së bashku me imperializmin amerikan dhe me reaksionarët e vendeve të ndryshme, ata përpiqen të përfundojnë një aleancë ushtarako-politike për të kundërshtuar Kinën. Ndihma ushtarake që revizionistët sovjetikë u japid reaksionarëve indianë e indonezianë, ia kalon ndihmës së imperialistëve amerikanë. Ata po shesin interesat e vendit të tyre duke i bërë koncesione të mëdha Japonisë për shfrytëzimin e hapësirave të Siberisë, me qëllim që t'i ndërsejnjë militaristët japonezë kundër Kinës. Po forcojnë lidhjet e bashkëpunimin me regjimet reaksionarëve.

nare të Malajzisë, Tajlandës, Birmanisë e Filipineve, për të mbyllur kështu unazën e rrithimit ushtarak të Kinës. Pas provokacioneve të përgjakshme në Usuri, klika sovjetike e Brezhnev-Kosiginit ka dislokuar forca të mëdha të armatosura në kufirin sovjeto-kinez e mongolo-kinez.

Në orientimin e tyre antikinez kërret e Kremlinit kanë shkuar aq larg, saqë në mbledhjen e fundit në Moskë propozuan krijimin e një «sistemi të sigurimit kolektiv në Azi», që do të thotë se të gjitha kukullat dhe shërbëtorët e imperializmit amerikan në këtë razon, që nga Japonia e Koreja e Jugut, Malajzia e Tajlanda, Birmania e India, duhet të bashkohen në një aleancë ushtarako-politike, që do të shërbente si vegël agresioni në duart e imperializmit sovjetik për të kundërshtuar bashkërisht Kinën dhe për të shtypur lutfëtë revolucionare të popujve aziatikë.

Por të gjitha këto përpjekje nuk dëshmojnë aspak për forcën e revisionistëve. Përkundrazi, ato konfirmojnë dobësinë e pozitave të tyre, falimentimin e lutfës së tyre të paparim dhe të taktikave demagogjike.

Mbledhja e partive revisioniste në Moskë, e organizuar dhe e drejtuar nga kërret renegatë të Kremplinit, është një akt i ri i urryer diversioni kundër lëvizjes komuniste marksiste-leniniste ndërkombëtare dhe forcave revolucionare; ajo synon sabotimin e frontit të përbashkët antiimperialist të popujve, minimin e lutfës nacionalçirimitare në Azi, në Afrikë e në Amerikën Latine. Kjo mbledhje u përdor nga udhëheqësit sovjetikë si një mjet për të fshehur afrimin dhe bashkëpunimin e tyre me imperializmin amerikan, për të

larguar vëmendjen e popujve nga komplotet imperialistico-revisioniste për ndarjen e zonave të influencës dhe për sundimin e botës.

Por loja e madhe që organizuan udhëheqësit e partisë revisioniste të Bashkimit Sovjetik është e destinuar të dështojë. Partia jonë e ka vënë në dukje disa herë dhe faktet e jetës së përditshme e kanë vërtetuar se, si duke e bërë mbledhjen e përgjithshme revolucioniste, si duke mos e bërë fare, revisionizmi hrushovian nuk mund të shpëtojë kurrë nga falimentimi i plotë, i cili është i pashmangshëm. Tanimë është vërtetuar se kushdo që është bashkuar me borgjezinë dhe me armiqtë e tjerë të klasës punëtore, kushdo që ka tradhtuar marksizëm-leninizmin dhe ka ngritur dorën kundër tij, kushdo që ka braktisur çështjen e shenjtë të revolucionit e të lirisë së popujve dhe është bashkuar me imperializmin e kundërrevolucionin, është i destinuar të pësojë fatin e gjithë renegatëve, fatin e forcave regresive të dënuara nga historia.

*

* * *

Mbledhja tradhtare në Moskë u bë një dëshmi e re e luftës dhe e grindjeve të paparim midis partive e vendeve revisioniste, e kalbzimit dhe e degjenerimit të mëtejshëm të frontit revisionist.

Megjithëse dokumenti kryesor është mbushur me «parime internacionaliste» që gjoja ekzistojnë në marrëdhëni midis «partive motra» e «vendeve vëllezër»,

me gjithë euforinë e tij për «unitetin», ai nuk i fsheh dot divergjencat e thella që gjerryejnë prej kohësh kazanin e çarë revizionist. Bile ato nuk shërbejnë as për të maskuar kompromisin e kalbur, të pjesshëm, të përkohshëm e të paqëndrueshëm që pas shumë mundimesh, presionesh e shantazhesh reciproke mundën të arrijnë në momentin e tanishëm klikat revizioniste. Edhe midis krerëve revizionistë pati ankime në mbledhje, se ndërsa në letër parimet e marrëdhënieve midis «partive komuniste» e «vendeve socialiste» paraqiten drejt e tingëllojnë bukur, në praktikë veprohet krejt ndryshe dhe ato merren nëpër këmbë pa skrupull.

Por çdo njeri që ka ndjekur pak a shumë përgatitjet dhe zhvillimin e kësaj mbledhjeje famëkeqe, nuk mund të mos konstatojë se të gjitha deklaratat e bujshme të revizionistëve për unitetin që gjoja u arrit e u forcua në mbledhjen e tanishme, janë një blof i madh. Divergjencat e thella që u shprehën para e gjatë mbledhjes për shumë nga çështjet më të rëndësishme, përfundimet e vajtueshme të saj, ku një numër partish revizioniste refuzuan të pranojnë, plotësisht ose pjesërisht, dokumentin kryesor që doli nga mbledhja, janë fakte që flasin vetë. Revizionistët italianë e thanë hapur se, ndërsa ky dokument nga jashtë paraqit pamjen e unitetit, në të vërtetë fsheh mosmarrëveshje të mëdha.

Partia e Punës e Shqipërisë më se një herë e ka theksuar se në stanin revizionist nuk ka dhe nuk mund të ketë unitet të vërtetë e të qëndrueshëm. Natyrisht, të gjithë revizionistët, që nga ata hrušovianë e gjer tek ata toliatistë, të cilët, në mbledhjen e tanishme,

përfaqësonin dy polet e kundërtë më të theksuara, i bashkojnë në një front të vetëm kundërrrevolucionar ar-miqësia dhe lufta e përbashkët kundër marksizëm-leni-nizmit dhe forcave revolucionare që e mbrojnë atë, me-gjithëse edhe për këtë midis grupimeve revizioniste ka pasur e ka divergjenca në taktikat. Por kontradiktat e ashpra dhe përqarja gjithnjë më e thellë në gjirin e revizionistëve janë të pashmangshme, ato burojnë nga vetë natyra klasore dhe ideologjike e revizionizmit. Më kot përpiken tanë pjesëmarrësit e mbledhjes t'i minimi-zojnë grindjet e divergjencat, t'i fshehin shkaqet e tyre të vërteta dhe t'i paraqitin si të përkohshme e të kapërcyeshme lehtë. Ato burojnë nga baza shoqërore klasore e revizionizmit, i cili përfaqëson interesat e ngushtë egoistë të një klase a shtrese të borgjezuar: të borgjezisë së re «socialiste» në vendet ku klikat revi-zioniste kanë usurpuar pushtetin, të aristokracisë e të burokracisë «punëtore» e «komuniste» në vendet kapita-liste. Kjo shpie, e nuk mund të mos shpjerë, në po-zita nacionaliste borgjeze.

Klikat revizioniste në vendet e ndryshme kapita-liste janë të lidhura me interesat e borgjezisë së vet ko-mbëtare e të grupimeve imperialiste ku ajo bën pjesë, ndodhen nën varësinë e tyre, gjë që nuk mund të mos shpjerë në kontradikta e në konflikte me klikat revi-zioniste të vendeve të tjera, në radhë të parë me ato të vendeve ku revizionistët janë në pushtet. Këto kontra-dikta e konflikte dalin veçanërisht në pah në momente krizash e tensioni, kur klikat revizioniste marrin më hapur anën e borgjezisë së vet. V. I. Lenini ka treguar se ishte pikërisht kjo lidhje e partive oportuniste të

Internacionales së Dytë me borgjezitë imperialiste të vendeve të veta që, në krizën e shkaktuar nga Lufta e Parë Botërore, i çoi ato haptazi në anën e borgjezisë, në pozitat e socialshovinizmit e të socialimperializmit. Kalimi i revizionizmit sovjetik në socialimperializëm, që gjeti një shprehje konkrete e brutale në krizën çekoslovake, kristalizoi më tej pozitat kontradiktore në frontin revizionist. Çdo krizë e re do ta përçajë e do ta copëtojë gjithnjë më tej frontin revizionist ndërkombëtar.

Kontradiktat në gjirin e revizionistëve rrjedhin nga mungesa e një baze ideologjike të përbashkët e të përcaktuar qartë. Të gjithë ata i bashkon lufta kundër tezave e parimeve themelore të marksizëm-leninizmit. Por në teoritë revizioniste të këtij ose të atij vendi e zone ka ndikime të forta të këtyre ose të atyre rrymave të ideologjisë borgjeze, gjë që, pa dyshim, lë gjurmët e veta në pozitat teorike të revizionistëve të vendeve të ndryshme për këto ose për ato probleme. Duke qëndruar në pozitat e pragmatizmit secili i shtrembej-ron parimet marksiste-leniniste në atë shkallë, në atë frymë e në atë drejtim që u përgjigjet më mirë interesave, nevojave e koniunkturave të çastit të çdo grupei revizionist. Shembulli më i qartë për këtë janë lëkundjet teorike të udhëheqjes revizioniste sovjetike nga pozitat liberale hrushoviane gjer te pozitat e ashpra pseudomarksiste, socialfashiste e socialimperialiste të tanishme.

Në mbledhjen revizioniste të Moskës doli i qartë kristalizimi i dy vijave kryesore ndërluftuese në frontin revizionist ndërkombëtar: i vijës së përfaqësuar

nga klika udhëheqëse revizioniste sovjetike e nga përkrahësit e saj dhe i vijës së përfaqësuar nga toliatistët italianë e nga mjaft të tjerë. Që të dyja ato janë krejtësisht antimarksiste e kundërrevolucionare. Thelbi i luftës midis tyre janë kontradiktat midis shovinizmit shtetomadh e socialimperializmit sovjetik dhe nacionaлизmit të ngushtë borgjez të grupimeve të tjera revizioniste, kontradiktat midis imperializmit të ri sovjetik dhe borgjezisë imperialiste perëndimore.

Udhëheqja revizioniste sovjetike synon, para së gjithash, të bashkojë nën diktatin e vet gjithë frontin revizionist ndërkombetar, të mobilizojë pa rezerva të gjitha forcat revizioniste dhe t'u imponojë atyre taktykat e saj në luftën kundër çështjes së revolucionit e të socializmit, kundër partive marksiste-leniniste.

Në mënyrë të veçantë ajo përpinqet të mos i lejojë klikat e tjera revizioniste, veçanërisht në ato vende ku këto janë në pushtet, të ndjekin një politikë të pavarrur, të ndalojë afrimin e tyre të lirë me Perëndimin, t'i mbajë ato në sferën e influencës së vet, si gjysmë-koloni të imperializmit sovjetik dhe si vegla të bindura në përshtatje me koniunkturat e politikës sovjetike, si një mbështetje për qëllimet e saj ekspansioniste e neokolonialiste.

Frazat e lustruara për «internacionalizmin», «bashkëpunimin shoqëror», «respektimin e sovranitetit» dhe «mosndërhyrjen në punët e brendshme të të tjerëve», me të cilat qenë të mbushur fjalimi famëkeq i Brezhnjevit dhe dokumenti që doli nga mbledhja, vështirë se mund të mashtrojnë njeri.

Shumë qartë u kristalizua gjatë mbledhjes edhe vi-

ja e kundërt, ajo e toliatistëve italianë dhe e mjaft të tjerëve, e cila karakterizohet nga përpjekjet për të shpëtuar nga tutela sovjetike. Ajo kërkon të fitojë një pavarësi sa më të madhe si në politikën e brendshme, ashtu edhe në atë të jashtme, për t'i pasur duart të lira në manovrimet për t'u integruar me borgjezinë e vendit dhe me imperializmin, për të ecur me këto ose me ato ritme në rrugën e degjenerimit borgjez, pa qenë e lidhur me koniunkturat e politikës sovjetike dhe as me disfatat e revisionistëve sovjetikë etj. Gjithë qëndrimi i toliatistëve në mbledhjen e Moskës synonte dobësimin e mëtejshëm të pozitave sunduese të kliksës drejtuese sovjetike në frontin revolucionar ndërkombetar.

Në përputhje me këto qëllime e synime, ata e vunë theksin me këmbëngulje te teza se në kohën e tanishme në «lëvizjen komuniste botërore» nuk mund dhe nuk duhet të ketë një parti, shtet ose qendër drejtuese, se të gjitha partitë duhet të janë të barabarta e të parvarura. «Është e domosdoshme, — tha Berlingueri, — të respektohet plotësisht pavarësia e secilës parti, jo vetëm në përcaktimin e politikës së saj në kërkimin e rrugës së vet drejt socializmit e në ndërtimin e shoqërisë socialiste, por edhe në përcaktimin e pozitave lidhur me çështjet e mëdha të lëvizjes sonë». Kjo ishte një sfidë e hapët kundër pozitave hegemoniste e të diktatit të udhëheqjes sovjetike.

Duke ua pasur frikën raprezaljeve nga ana e kliksës socialimperialiste sovjetike, toliatistët kërkuan në mbledhje të sanksionohet si parim që «mosmarrëveshjet të cilat mund të shprehen gjatë mbledhjeve ndër-

kombëtare në diskutimin dhe në votimin e dokumenteve të propozuara, si dhe mospjesëmarrja në këto mbledhje, nuk duhet të kenë pasoja në marrëdhëniet midis partive». Ky është një tregues shumë i qartë i karakterit të marrëdhënieve në stalin revizionist, ku sundon diktati brutal i klikës sovjetike, që zbatohet me anën e rublës e të kërbaçit.

Në mbledhjen e Moskës klika revizioniste sovjetike u detyrua të përballonë çështjen e vështirë çekosllovake, e cila ka mbetur në grykë.

Në fillim krerët revizionistë sovjetikë u orvatën me të gjitha mënyrat ta kalojnë atë në heshtje. Bile nuk munguan të bëjnë presione e kërcënime ndaj atyre që do të guxonin ta ngrinin këtë çështje në mënyrë kritike.

Por pasi këto orvatje nuk patën sukses, udhëheqja revizioniste sovjetike u detyrua t'i zbulojë kartat dhe, me përkrahjen e shërbëtorëve të saj të zellshëm, që nga kuislingu Husak e gjer te Kadari, u përpooq të justifikojë agresionin fashist kundër Çekosllovakisë, bile edhe të rezervojë të drejtën për përsëritjen e mundshme të të tilla veprimeve në të ardhmen nën pretestin e «ndihmës internacionaliste» për vendet «socialiste» që gjoja rrezikohen nga imperializmi. Kjo tregon fare sheshit se parimet e respektimit të sovranitetit e të mosndërrhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit, për të cilat flasin revizionistët, janë një paçavure pa vlerë, se krerët revizionistë sovjetikë ndaj të tjerëve i përbahen teorisë famëkeqe të Brezhnjevit për «sovranitetin e kufizuar», se marrëdhëniet e partive revizioniste me klikën shoviniste, socialimperialiste sovjetike

s'mund të jenë veçse marrëdhënie nënshtrimi, bindjeje servile dhe zbatimi të verbër të diktatit të saj.

Dokumenti kryesor që adoptoi mbledhja revizioniste e Moskës, në qoftë se prapa frazave të lustruara e të rrumbullakosura shihet thelbi i vërtetë i çështjes, nuk është gjë tjetër veçse një kompromis i përkohshëm e i paparim midis klaneve të ndryshme revizioniste. Ai është një pasqyrë e bilancit të tanishëm të raportit të forcave midis grupimeve revizioniste me tendenca të kundërta.

Faktet provojnë se mbledhja revizioniste e Moskës nuk i sheshoi aspak kontradiktat në frontin revizionist ndërkombetar, siç po trumbetojnë me të madhe udhëheqësit revizionistë, përkundrazi, i evidentoi, i kristalizoi e i polarizoi më tej ato, duke përgatitur kështu përçarje e kriza të reja akoma më të thella midis këtyre renegatëve të marksizëm-leninizmit, të çështjes së revolucionit e të socializmit. Ky është një proces objektiv i pashmangshëm.

Sfida që revizionistët e mbledhur në Moskë u munduan t'u bëjnë marksistë-leninistëve dhe forcave revolucionare në botë, nuk tremb njeri. Përkundrazi, ajo e shton edhe më shumë vendosmërinë e tyre për të luftuar deri në fund kundër revizionizmit modern, për të denoncuar më me forcë të gjitha manovrat e tij demagogjike, për të demaskuar pa mëshirë komplotet dhe planet e tij kundërrevolucionare. S'ka asnjë dyshim se revolucionarët, komunistët e vërtetë, kudo që ndodhen, do të dinë me siguri ta analizojnë drejt situatën e krijuar dhe të nxjerrin konkluzionet e nevojshme. Mbledhja e revizionistëve në Moskë, vendimet që mori, vija

që ajo përcaktoi, treguan se ata e kanë vënë veten përfundimisht jashtë frontit antiimperialist dhe lëvizjes komuniste ndërkombejtare. Në të gjitha frontet, si në atë politik, ashtu edhe në atë ideologjik etj., revizionistët e marksistë-leninistët ndodhen në anët e kundërtë të barrikadës.

Situata sot në botë zhvillohet në favor të forcave revolucionare dhe në dëm të imperializmit e të revizionizmit. Fronti revizionist është kalbur, të çarat e tij janë të mëdha, grindjet midis reparteve të tij po shtohen e po zgjerohen. Por të gjitha këto nuk duhet t'i qetësojnë aspak marksistë-leninistët, ata që luftojnë për socializmin, për lirinë e për pavarësinë e popujve. Armiqtë imperialistë e revizionistë, ashtu siç e tregoi edhe mbledhja e Moskës, nuk i kanë lëshuar akoma armët. Lufta e partive marksiste-leniniste u ka shkaktuar atyre goditje të rënda dhe nuk i lë të marrin frymë, por ajo duhet vazhduar me një ritëm e intensitet gjithnjë më të madh. Fitorja përfundimtare mbi oportunitzmin e ri do të kërkojë akoma shumë përpjekje e mundime dhe ajo do të arrihet nëpërmjet një vendosmërie, kuraje dhe pjekurie gjithnjë e më të madhe nga ana e marksistë-leninistëve, nëpërmjet aksioneve militante dhe taktikave të shkathëta të luftës, që t'i ndihmojnë çdo ditë e çdo orë arritjes së objektivave të strategjisë sonë revolucionare.

Fushata e madhe propagandistike që po zhvillojnë tanë revizionistët, me ata sovjetikë në krye, për të reklamuar tezat oportuniste dhe dokumentet e mbledhjes tradhtare të Moskës, duket qartë se synon të mashtrojë opinionin publik, të helmojë ndërgjegjen e atyre shtre-

save të punonjësve që ndodhen akoma nën influencën revizioniste, të largojë vëmendjen nga komplotet kriminale imperialisto-revisioniste.

Në këto rrethana, përpëra marksistë-leninistëve dhe gjithë revolucionarëve qëndron detyra e madhe që valës së re demagogjike që revizionistët shpërthyen në shkallë ndërkombëtare, t'i përgjigjen me një veprimtari të gjithanshme revolucionare, për të demaskuar dhe për të asgjësuar sulmin revizionist. Detyra të mëdha kanë përpëra populli sovjetik dhe marksistë-leninistët sovjetikë. Ata duhet të ngrihen kundër demagogjisë ciniike dhe propagandës false të krerëve renegatë Brezhnjev-Kosigin e kompani, të cilët kërkojnë ta shfrytëzojnë mbledhjen e Moskës si një aprovim nga «partitë komuniste të botës» të vijës së tyre tradhtare të restauimit të kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik dhe të politikës së tyre të jashtme imperialiste. Populli dhe marksistë-leninistët sovjetikë nuk duhet t'i durojnë më gjatë pretendimet mashtruese të klikës uzurpatore, që hiqet sikur gjoja lufton për forcimin e socializmit e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, ndërsa nxit kudo dhe me të gjitha mënyrat luftën kundërrevolucionare; që bën sikur dënon imperializmin dhe mbron lirinë e popujve, ndërsa vetë kryen agresione imperialiste, si ai kundër Çekoslovakisë, dhe tani kërcënë me luftë vendë të tjera. Interesat e revolucionit e të socializmit në Bashkimin Sovjetik kërkojnë nga revolucionarët dhe nga marksistë-leninistët sovjetikë të ngrihen me vendosmëri në këmbë dhe të luftojnë me guxim e me trimëri për demaskimin dhe për shpartallimin e fushatës antikineze që carët e rinj të Kremlinit po e ndezin për-

ditë e më tepër, me qëllim që të justifikojnë përgatitjet e tyre për luftë.

Përgjegjësi të madhe kanë tani komunistët e ndershëm që akoma bëjnë pjesë në partitë e ndryshme revizioniste. Tani që klikat revizioniste, duke ecur në rrugën e tradhtisë, thelluan përcarjen edhe në aspektin organizativ, përparrë çdo komunisti problemi shtrohet në mënyrë të prerë: o me komunizmin, me revolucionin, kundër tradhtisë revizioniste, o me krerët revizionistë në rrugën e tradhtisë. Tanimë s'duhet të ketë vend as për iluzione, as për ngurrim. Me krerët revizionistë, me revizionizmin përgjithësisht, duhen ndarë llogaritë: me ta prerja e urave duhet bërë jo vetëm nga ana ideologjike e politike, por edhe nga ana organizative. Nuk mund të militojnë më së bashku në gjirin e një partie komunistët revolucionarë dhe revizionistët. Asnjë ndjenjë sentimentalizmi, asnjë konsideratë gjoja taktkike nuk justifikon më qëndrimin në radhët e partive revizioniste. Komunistët e vërtetë, gjithë revolucionarët duhet të bashkohen dhe të krijojnë partitë e reja revolucionare marksiste-leniniste.

Mbledhja antikomuniste e Moskës është një farsë e organizuar nga revizionistët sovjetikë për qëllime të ulëta spekulimi politik e ideologjik. Pjesëmarrësit e saj nuk mund t'i shtronin dhe t'i diskutonin kurrë hapur problemet, të bënин analiza konkrete të vijës dhe të veprimtarisë së tyre. U takon marksistë-leninistëve, revolucionarëve, gjithë atyre që i qëndrojnë besnikë marksizëm-leninizmit, të kryejnë detyrën internacionliste, të dalin hapur dhe të demaskojnë me guxim tradhëtitë revizioniste. Planeve dhe bashkimit kundërrevolucionar

të revizionistëve ata duhet t'u kundërvënë unitetin e vërtetë marksist-leninist dhe të zhvillojnë një luftë të gjithanshme, të guximshme e parimore kundër klikave revizioniste në fuqi, për t'i përmbysur ato dhe për të çuar përpara kudo çështjen e lavdishme të revolucionit e të socializmit, luftën për lirinë e për pavarësinë e popujve.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i popullit»,
nr. 167 (6519), 15 korrik 1969*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përbledhje
veprash) 1968-1970», f. 451*

FORCIMI I LIDHJEVE MIDIS MOSKËS E BONIT

— PJESE PËRBËRËSE E STRATEGJISE

GOLOBALE KUNDËRREVOLUCIONARE

AMERIKANO-SOVJETIKE

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

28 gusht 1969

Krerët revizionistë të Kremlinit bëjnë politikë tipike cariste — atë të aleancës e të bashkëpunimit me forcat reaksionare e imperialiste dhe të luftës kundër popujve e revolucionit. Kohët e fundit kontaktet e marrëveshjet politike dhe ekonomike midis Moskës e Bonit kanë ardhur duke u shtuar me një ritëm të shpejtë. Arsyjeja e parë e kësaj rritjeje është në interesat e përbashkët imperialistë dhe revanshistë të këtyre dy fuqive, në kuadrin e bashkëpunimit global kundërrevolucionar imperialisto-revizonist për të shtypur luftën revolucionare të popujve në Evropë dhe në të gjithë botën.

Për këtë intensifikim të lidhjeve politiko-ekonomike midis dy shteteve nuk flasin vetëm vizitat zyrtare të personaliteteve shtetërore e politike, por edhe zgjegrimi i gjithanshëm i marrëdhënieve ekonomike midis tyre. Klika e renegatëve revizionistë të Moskës është e

interesuar që t'i zhvillojë e t'i zgjerojë këto marrëdhënie me atë fuqi që konsiderohet si favoriti kryesor i imperializmit amerikan në Evropën Perëndimore, për t'i çuar deri në fund pazarllëqet e veta kundërrevolucionare në dëm të popujve të tjerë të Evropës, qoftë edhe duke sakrifikuar të drejtat sovrane dhe interesat jetikë të vendeve të tilla si: RD Gjermane, Polonia, Çekoslovakia etj. Dhe në rast se ndonjëherë propaganda bajate e Kremlinit tund gogolin e revanshizmit gjermanoperëndimor, këtë e bën me qëllime të caktuara, për të trembur dhe për të mbajtur në zap aleatët që kanë tendenca centrifugale dhe gjithë forcat patriotike, antiimperialiste dhe revolucionare në ato vende që janë dhe veprojnë kundër hegemonizmit të revisionistëve sovjetikë, kundër socialimperializmit të Moskës. Sigurisht, në kushtet aktuale politike të Evropës dhe të zhvillimit të sotëm politik të Gjermanisë Perëndimore nuk duhen nënveftësuar forcat militarishte e revanshiste në këtë vend, veprimtaria e tyre gjatë fushatës elektorale, orvatjet për të ringjallur e për të riorganizuar partinë naziste dhe organizatat e saj të sulmit, pasi përbëjnë rrezik serioz për sigurimin dhe për stabilitetin në Evropë. Mësimet e periudhës hitleriane nuk janë harruar nga popujt. Kurse politika e afrimit me Bonin që bën klika e Kremlinit, objektivisht përkrah dhe inkurajon ringjalljen e forcave militariste e fashiste në zemër të Evropës, nxit ambiciet e tyre ekspansioniste në kurriz të popujve të tjerë.

Faktet që flasin për këtë proces të pajtimit e të afrimit të gjithanshëm politiko-ekonomik të carëve të rinj të Kremlinit me sundimtarët e Bonit janë të shum-

ta. Në rast se vite më parë politika kapitulluese dhe tradhtare e Hrushovit çeli rrugën e këtij procesi, tanë pasardhësit e tij në Kremlin e kanë thelluar këtë rrugë, duke i ngritur militaristët e Bonit në rangun e partnerëve të barabartë dhe duke qenë të gatshëm që në altarin e këtij bashkëpunimi kundërrevolucionar, të cilin kërkojnë ta mbulojnë me perden e tymit të «sigurimit evropian», të sakrifikojnë interesat jetësorë të popujve të tjerë. Vitet e fundit, e sidomos muajt e fundit, midis Moskës e Bonit ka një vërshim të vërtetë mesazhesh, delegacionesh, shkëmbim projektesh për marrëveshje dhe përfundim marrëveshjesh të llojeve të ndryshme. Përfaqësuesi i klikës revizioniste sovjetike, Patoliçev, si ministër i Tregtisë së Jashtme viziton Gjermaninë Perëndimore, duke u ofruar afaristëve të Bonit mundësi maksimale për tregjet sovjetike. Ndërkaq, u përfundua marrëveshja për prodhimin e përbashkët të tubave të gjërë, projekt, për të cilin do të shpenzohet një shumë kolosale prej 1 miliard markash. Nga ana e vet pala sovjetike është e gatshme të vazhdojë ndërtimin e naftë e gazsjellësit «Druzhba» (që dikur ka qenë i destinuar vetëm për RD Gjermane, Poloninë, Çekoslovakinë e Hungarinë) deri thellë në tokën e Gjermanisë Perëndimore, për t'u shitur kapitalistëve gjermanë me çmim të lirë naftën e gazin sovjetik. Përfaqësuesi i monopoleve gjermane, zëvendësministri i Ekonomisë së Bonit, Klaus fon Dohnani, që vizitoi për këtë qëllim Moskën majin e kaluar, formoi bindjen se Kremlini kishte «interes konkret dhe serioz» për forcimin e lidhjeve të tij ekonomike me Gjermaninë Perëndimore.

Bisedimet për hapjen e vijës ajrore Frankfurt-

-Moskë duhen parë në kontekstin e afrimit të gjithanëshëm me Bonin, ndërsa pala gjermanoperëndimore, duke shfrytëzuar gatishmërinë e klikës revisioniste sovjetike për lëshime, ngul këmbë që kjo vijë, në një të ardhme jo të largët, të shtrihet edhe nëpër Siberi, për t'u lidhur më shkurt me Tokion, duke e lehtësuar praktikisht mundësinë e krijimit të boshtit Bon-Tokio dhe duke e bërë kështu Siberinë një «urë» të lidhjes dhe të aleancës së ardhshme ushtarake të militarizmit evropian gjermanoperëndimor e të militarizmit aziatik japonez.

Natyrisht, të gjitha këto marrëveshje, që në dukje janë «thjesht ekonomike» dhe «me leverdi reciproke», mbështeten në interesa dhe në orientime të caktuara politike. Ministri sovjetik i Punëve të Jashtme, Gromiko, deklaroi në Sovjetin Suprem se qeveria e tij kërkon të ketë «marrëdhënie normale» me Gjermaninë Perëndimore. Për këtë «vullnet» dhe «gatishmëri» të rene-gatëve të Moskës flasin qartë një varg provash bindëse: gjatë provokacioneve të përgjakshme antikinezë të Usurit marsin e kaluar, ambasadori revizionist në Bon, Carapkin, vrapi «të informojë» qeveritarët e Bonit duke e paraqitur të bardhën të zezë, ashtu siç bënë kollegët e tij në kryeqytetet kryesore të botës kapitaliste. Ky qe një sinjal i qartë për forcat militariste e revanshiste gjermanoperëndimore që të vazhdonin pa u shqetësuar provokacionin e kurdisur prej tyre për të zgjedhur presidentin në mënyrë të paligjshme në Berlinin Perëndimore, pasi vetë ata ishin angazhuar me një provokacion shumë më të rëndë ushtarak antikinez në frontin e Lindjes së Largme. Me këtë angazhim revi-

zionistët sovjetikë u thoshin partnerëve të tyre të Bonit: «Mos kini frikë nga zhurma e fjalëve. Veproni në Berlin, atje nuk do t'ju hyjë asnjë gjemb në këmbë». Dhe kështu ndodhi. Ndërsa në këtë qytet përfaqësuesit e Bonit silleshin si në shtëpi të vet, duke shkelur hapur kushtet e konferencës së Potsdamit dhe të marrëveshjeve të tjera ndërkontinentare, edhe një herë kapitulluesit revizionistë sovjetikë e linin në baltë Republikën Demokratike Gjermane dhe mbanin qëndrim tradhitar ndaj interesave të popullit gjerman. Ky qëndrim u përsërit edhe kohët e fundit, kur tri fuqitë perëndimore morën iniciativën më 7 gusht për të bërë një pazarllëk tjetër të ndyrë me revizionistët sovjetikë «për të lehtësuar» gjendjen e Berlinit Perëndimor. Duke i bërë jehonë këtij propozimi, agjencia TASS ngutej t'i qetësonte partnerët perëndimore dhe i siguronte se «Bashkimi Sovjetik nuk i ka kundërshtuar kurrë bisedimet në lidhje me çështjen e Berlinit Perëndimor» dhe «mëndimi ynë është se Berlini Perëndimor nuk duhet të bëhet pengesë për zgjidhjen e çështjes evropiane, por duhet, në sajë të pozitës së tij, të bëhet urë midis Lindjes dhe Perëndimit». Natyrisht, ky nuk është as i pari dhe as i vërtmi rast që shfrytëzon klika revizioniste e Kremilit për të shitur interesat e popullit gjerman, qoftë edhe duke e përdorur atë si «urë» lidhjeje me Perëndimin kapitalist.

Por nuk ndalet deri këtu gatishmëria e kësaj klike për të luajtur me fatet e popullit gjerman dhe të popujve të tjerë. Ajo nuk lë rast pa shfrytëzuar për të vazhduar flirtin e saj me klikën militariste e revanchiste të Bonit. Kryeministri revizionist Kosigin zhvi-

llon bisedime sekrete me ambasadorin e Bonit në Moskë dhe pret e përcjell me përzemërsi të veçantë politikanë të ndryshëm gjermanoperëndimorë. Një delegacion i Partisë së Lirë Demokrate të Gjermanisë Perëndimore, me kryetarin e kësaj partie, Shil, në krye, para disa ditësh zhvilloi bisedime të dendura në Moskë, ndërsa javën e kaluar përfundoi bisedimet me Gromikon e me Polianskin një delegacion i rëndësishëm i Partisë Socialdemokrate, i kryesuar nga Helmut Shmid, udhëheqës i fraksionit socialdemokrat në Bundestag, që bën pjesë në qeverinë e koalicionit. Më në fund, sot arrin në Moskë një delegacion i rëndësishëm qeveritar gjermanoperëndimor, i cili do të përfundojë një marrëveshje të re tregtare dhe do të bisedojë për krijimin e një komisioni të përbashkët për bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik. Ka të ngjarë që ky delegacion të shtrojë edhe çështjen e vizitës së ardhshme të Kizingerit në Moskë, e cila pritet me interesim të gjallë nga krerët revizionistë të Kremlinit. Kjo vizitë do të kurorëzojë afrimin dhe integrimin e mëtejshëm të tyre me Bonin nëpërmjet bisedimeve të drejtpërdrejta me njérin nga drejtuesit kryesorë të klikës sunduese gjermanoperëndimore, prejardhja dhe veprimitaria fashiste e të cilat është, tanimë, mjaft e njojur. Fashistët e djeshëm dhe revanshistët e sotëm janë bashkëpunëtorët dhe partnerët e preferuar të klikës Brezhnev-Kosigin.

Të pesëdhjetë trëndafilët e kuq që klika renegate revizioniste sovjetike i dërgoi presidentit gjermanoperëndimor me rastin e ditëlindjes së tij, nuk tregojnë për një mirësjellje të thjeshtë diplomatike, por janë

një gjest kuptimplotë politik. Këtë e çmon dhe e shpreh me mirënjojje vetë kancelari i Bonit, Kizinger, kur shpjegon hapur rrënjet e vërteta të këtij qëndrimi. «Ata (revizionistët sovjetikë), — thotë Kizingeri, — duan marrëdhënie më të mira me Perëndimin, duke pasur parasysh gjendjen e tyre me Kinën». Duke folur me gazetarët, pasi u kthye nga takimet e tij me Niksonin në Uashington, Kizingeri pohoi se edhe presidenti amerikan ishte i një mendimi me të (dhe me revizionistët sovjetikë) se problemi kryesor i ardhshëm që shqetëson Perëndimin éshtë fuqia në rritje e Kinës.

Nuk éshtë e rastit që një ndër pikat kryesore të programit qeveritar të «koalicionit të madh» Kizinger-Brand (domethënë të aleancës midis kristiandemokratëve dhe socialdemokratëve) ka qenë për të bërë një «hapje» drejt Lindjes evropiane, një «politikë të re», siç e pagëzuan ata, drejt vendeve revizioniste. Natyrisht, kjo «politikë e re» ishte në funksion të synimeve imperialiste të Perëndimit, duke i dhënë një impuls të ri procesit të shthurjes e të degjenerimit kapitalist që kishte filluar në këto vende. Ky afrim me vendet revizioniste ka qenë inauguruar vite më parë midis Bonit e Moskës, qysh në kohën e Adenauerit e të Hrushovit, por tani mori një bazë zhvillimi më «shkencor», duke u ruajtur sidoqoftë që të mos tregohet zell i tepruar dhe të mos provokohet pa vend xhelozia e Moskës nga tendencat autonomiste të satelitëve të saj.

Klika revizioniste e Moskës éshtë e interesuar që t'i intensifikojë marrëdhëniet e saj politiko-ekonomiko-kulturore me Bonin jo vetëm për faktin se ky po bëhet një fuqi dominuese në Evropën Perëndimore;

këtë e kërkon koncepti i saj politik kundërrevolucionar për «sigurimin evropian», për ruajtjen e statukuosë në këtë zonë, qoftë edhe me bashkëpunimin aktiv me forcat militariste e revanshiste të Gjermanisë Perëndimore. Por, në të njëjtën kohë, ky koncept politik i revisionistëve sovjetikë është pjellë e strategjisë së tyre kundërrevolucionare për paqen false në Evropë dhe për luftën e vërtetë në Azi, për të pasur shpinën të sigurt në Evropë dhe duart të lira në Azi, për të shtypur luftën revolucionare të popujve në të gjithë botën.

Ky kurs, natyrisht, është shprehje dhe pasojë e bashkëpunimit kundërrevolucionar sovjeto-amerikan për ta ndarë botën midis këtyre dy superfuqive, për t'i mbajtur popujt nën zgjedhën e tyre dhe për të shtypur revolucionet.

Populli sovjetik, i cili gjatë Luftës së Dytë Botërore ka njojur barbarizmat dhe egërsinë çnjerëzore të pushtuesve hitlerianë, me luftën e tij heroike, me 20 milionë viktimat e tij, dha kontributin vendimtar për asgjësimin e bishës fashiste, për fitoren e popujve kundër fashizmit. Nuk ka dyshim se ai nuk mund të aprovojë asnjë politikë afrimi me trashëgimtarët dhe me pasardhësit e hitlerianëve dhe hedh poshtë me urrejtje politikën tradhtare të klikës së Brezhnev-Kosiginit për bashkëpunimin me forcat militariste revanshiste të Bonit, pasi një bashkëpunim i tillë është një përsëritje e kursit famëkeq të Munihut, është një nxitje dhe inkurajim për oreksin dhe për ambiciet ekspansioniste të këtyre forcave reaksionare. Më në fund, një politikë e tillë ia gris maskën përfundimisht kësaj klike, si

tradhtare e interesave jetikë të vetë popullit sovjetik dhe të popujve të tjerë të Evropës, e sidomos të popujve të Polonisë, të Çekoslovakisë, të RD Gjermane, të cilët nuk mund të lejojnë dhe nuk do të lejojnë kurrë që të ringjallet Rajhu hitlerian, të ringjallen e të veprojnë ato forca politike të reaksionit e të fashizmit që dikur u vunë flakën Evropës e botës.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i popullit»,
nr. 205 (6557), 28 gusht 1969*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Kundër revizio-
nizmit modern (Përbledhje
veprash) 1968-1970», f. 470*

**FITORJA SIGUROHET VETËM
PO TË UDHËHIQESH NGA TEORIA
MARKSISTE-LENINISTE**

Nga biseda me disa komunistë francezë

28 gusht 1969

Pasi u uroi mirëseardhjen dhe u përshëndet me miqtë, shoku Enver Hoxha i njohu ata me situatën dhe me gjendjen e vendit tonë:

Gjatë këtyre ditëve që qëndruat në vendin tonë, me siguri, shokët tanë ju kanë vënë në dijeni për sukseset që kemi arritur në ndërtimin e socializmit dhe për detyrat që kemi për të zgjidhur në të ardhmen. Gjatë punës, veç sukseseve, ne kemi edhe të meta. Në të ardhmen, duke organizuar dhe duke kombinuar mirë punën, duke rritur përpjekjet e sakrificat, ne do të kemi suksese edhe më të mëdha dhe do të mundim të fitojmë pozita gjithnjë e më të forta për ndërtimin e plotë të shoqërisë sonë socialiste.

Sot Partia jonë po punon në mënyrë të atillë që fryma revolucionare, e cila vlon te të gjithë komunistët dhe te populli shqiptar pas Kongresit të 5-të të Partisë, frysme që vërehet në të katër anët e vendit

deri në skajet më të largëta të tij, të thellohet dhe të forcohet më shumë, me qëllim që të ndihmojë për zhvillimin akoma më mirë, në mënyrë ritmike e normale të të gjithë sektorëve të ekonomisë dhe të mos ndodhë që njëri prej tyre të bëhet pengesë për të tjerët.

Duke analizuar në mënyrë të përgjithshme punën dhe përpjekjet që bën Partia jonë për përmirësimin në shkallën e duhur të kushteve ekonomike të vendit, për ndërtimin e socializmit në Shqipëri, duhet të themi se nuk mund të arrihen rezultatet që dëshirojmë pa një revolucion të pandërprerë ideologjik, politik dhe ekonomik. Për të arritur këto rezultate në ekonomi, kryesorja është që nga ana e Partisë të bëhen përpjekje akoma më të mëdha për ngritjen ideopolitike të masave.

Vendimet e Kongresit të 5-të të Partisë kanë qenë një ndihmë jashtëzakonisht e madhe për Partinë dhe për masat punonjëse të vendit tonë, për të shpënë përrapa zhvillimin e ekonomisë. Si rezultat i vrullit revolucionar që shpërtheu në të katër anët e vendit pas Kongresit, si në industri, ashtu edhe në bujqësi, në arsim e në kulturë etj. kemi pasur suksese shumë më të mira në punë, kemi pasur rezultate të dukshme në zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë, në hapjen e tokave të reja, në bonifikimet dhe ujitjen etj. Të gjitha këto rezultate shpunë në forcimin e mëtejshëm të kooperativave bujqësore si nga ana organizative, ashtu edhe nga ana ideopolitike. Tani mund të themi se fshatarët tanë janë bindur dhe e shikojnë qartë sa e drejtë është rruga e kolektivizimit që u tregoi Partia. Shkurt, në të gjitha fushat e jetës janë bërë përpjekje

të mëdha për të arritur hap pas hapi suksese të reja në forcimin e pozitave të socializmit.

Faktori vendimtar për arritjen e këtyre sukseseve është populli, i udhëhequr dhe i edukuar nga Partia, i cili na kupton shumë mirë dhe punon me të gjitha energjitet për të vënë në jetë detyrat që i shtrohen, që vendi ynë të ecë përpara, që Shqipëria socialiste të forcohet dhe të lulëzojë nga dita në ditë.

Një aksion të madh kemi shtruar sot përpara vetes, Partisë dhe popullit — revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë, boshti i së cilës do të jetë ideologjia marksiste-leniniste. Për t'ia arritur këtij qëllimi na duhet të rishikojmë me këtë sy e në mënyrë rrënjosore të gjitha tekstet dhe programet shkollore. Kjo punë do të bëhet jo vetëm për universitetin, por për të gjitha kategoritë e shkollave.

Revisionistët sovjetikë kanë filluar të cirren, duke na akuzuar se ne po militarizojmë gjithë popullin, duke filluar nga pionierët dhe deri te të moshuarit. Po ne s'duam t'ia dimë nga akuzat që na bëjnë ata, po shikojmë punën tonë. Ne duam që rininë ta edukojmë me frymën e dashurisë për atdheun, për shkencën, për popullin, për Partinë. Le të vazhdojnë të cirren sa të duan revisionistët se ne po militarizojmë rininë, kjo nuk na prish asnjë punë. Për revolucionarizimin e shkollës na dalin detyra shumë të mëdha përpara, për realizimin e të cilave duhet të bëjmë një punë shumë të madhe.

Partia ka punuar dhe punon vazhdimesht për edukimin e kuadrove, sepse ne kemi përasysht faktin se jo

të gjithë janë të aftë, ka edhe te ne komunistë që bëjnë gabime, të cilat përpinqemi t'ua korrigojmë.

Një faktor me rëndësi që po na jep rezultate të mëdha në drejtim të edukimit të kuadrove të Partisë, është vënia kurdoherë në jetë e vijës së masave. Në qoftë se nuk do ta kishim bërë këtë rezultatet e punës sonë do të ishin më të dobëta. Pra, duke u mbështetur mbi këtë bazë, rezultatet janë më të mëdha në të gjithë sektorët e jetës së vendit.

Për të ilustruar këtë mund t'ju sjell disa shembuj.

Kohët e fundit u bënë disa ndryshime në metodën e punës së gjykatave tona popullore. Edhe para këtyre masave që morëm, gjykatat tona kanë qenë popullore, por tani ato u bënë akoma më popullore. Sot në gjyq, veç funksionarëve të gjykatave, merr pjesë edhe populli, i cili gjykon çështjen në shqyrtim dhe jep drejt-përdrejt mendimin e vet për të. Te ne janë krijuar të gjitha mundësitë që ligjet të janë të ashpra për tradhtarët, për vjedhësit e të tjerë, ndërsa për ata që bëjnë faje të vogla, praktikojmë metodën e bindjes. Kjo ka për qëllim ta bëjë fajtorin të kuptojë fajin që ka kryer dhe pas mbarimit të procesit gjyqësor, ai të dalë i bindur se faji u gjykua drejt nga njerëz që janë zgjedhur nga vetë populli. Pra, nga një metodë e tillë e gjykimit të çështjes, fajtori ka mundësi të korrigjohet më shpejt.

Duke vepruar në këtë mënyrë për gjykimin e çështjeve, kemi pasur rezultate të dukshme, si rrjedhim është ulur numri i të dënuarve. Po të shikojmë statistikat e vjedhjeve, për shembull, na del se nga viti në vit ato shkojnë duke u ulur vazhdimesht.

Rezultate të mira kemi arritur, gjithashtu, në çësh-tjen e divorceve, numri i të cilave vitet e fundit është ulur shumë. Përse ndodh kjo? Sepse në çdo aktivitet dhe për zgjidhjen e çdo problemi ka filluar të marrë pjesë masa, populli. Në qoftë se ndonjë burrë kërkon të ndajë gruan dhe puna arrin deri në gjyq për divorc, masa, banorët e lagjes i kërkojnë sqarime paditësit përse përpinqet të ndahet nga gruaja. Ata flasin hapur me të për sjelljen e tij jo të mirë ndaj gruas, me të cilën ky ose ai e ka parë që grindej pa të drejtë. Popu-lli, banorët e pallatit ose të lagjes e njohin mirë njëri-tjetrin, pse jetojnë bashkërisht, prandaj flasin të vërtetën, të drejtën dhe dinë ta gjykojnë mirë çështjen. Kur e dinë që një grua është e ndershme, të gjithë i dalin në mbrojtje e dënojnë qëndrimin dhe synimet e burrit. Si rezultat i këtyre masave është krijuar një atmosferë jo e favorshme për ata që kërkojnë të bëjnë divorce pa baza, prandaj çështja e shkurorëzimeve zgji-dhet tanë shumë drejt te ne, gjë që forcon mirëkuptimin familjar. Kështu shpjegohet shkaku i uljes së tyre.

Për vënien në jetë të vijës së Partisë rëndësi të madhe ka puna që bëhet me komunistët, të cilët duhet të jenë të parët që ta kuptojnë mirë atë dhe të luftojnë me të gjitha forcat për ta zbatuar. Ne kemi parasysh faktin se jo të gjithë janë të aftë të kryejnë si duhet detyrat që u ngarkohen, prandaj është e nevojshme që Partia të punojë shumë që këta ta kuptojnë thellë vijën e saj dhe të vënë të gjitha forcat për ta zbatuar në jetë. Për këtë qëllim punohet vazhdimi-sht nga ana e Partisë për edukimin e komunistëve, punë kjo që

bëhet në radhë të parë në organizatat-bazë, në format e edukimit etj.

Ne kemi vendosur që kandidatët e Partisë, që vijnë nga administrata apo nga radhët e intelektualëve, stazhin e kandidatit ta bëjnë në prodhim, në miniera apo në qendra të tjera prodhimi, si në kooperativa bujqësore etj., nën vëzhgimin direkt të masës, të klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste apo të ushtarëve. Kur organizata-bazë shqyrton kërkesën e kandidatit për t'u pranuar si anëtar partie, ajo merr mendimin e punonjësve të qendrës së punës ku ai ka bërë ose bën stazhin. Masat japin mendimin e tyre, analizohen me kujdes atje puna dhe qëndrimi i tij, dëgjohen punonjësit të thonë fjalën nëse kandidati i ka cilësitet të bëhet anëtar partie apo jo. Në qoftë se masat, veçanërisht punëtorët, nuk shohin te ky person tiparet e komunistit, ata ia thonë troç Partisë se ai nuk meriton të futet në radhët e saj, pse e dinë që në Parti njerëzit nuk futen për sytë e tyre të bukur, por pranohen pikërisht ata që dallohen nga masa për cilësi të larta moralo-politike, si njerëz të pararojës në punë, në shoqëri e kudo. Pasi merren të gjitha të dhënat atje ku kandidati ka kryer stazhin, atëherë vendos organizata-bazë ta pranojë atë apo jo.

Të gjitha këto masa ne i marrim me qëllim që Partinë ta kemi të fortë dhe të lidhur me popullin si mishi me kockën, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të ndërtojmë socializmin dhe të rritim fuqinë mbrojtëse të vendit.

Megjithëse gjendja në vendin tonë është e shëndoshë dhe revolucionare, ne mbajmë kurdoherë pa-

rasysh faktin se brenda dhe jashtë kemi armiq, të cilët nuk duhet t'i nënvleftësojmë për asnjë çast. Ne kemi armiq të mëdhenj, siç janë imperialistët amerikanë e të tjerë. Po aq të rrezikshëm janë për ne edhe revizionistët modernë, me ata sovjetikë në krye. Këta nuk mund e nuk duhet t'i neglizhojmë apo t'i nënvlef-tësojmë kurrë. Neglizhimi i tyre, qoftë edhe fare i vogël, do të ishte me pasoja shumë të rrezikshme për ne.

Si imperialistët, ashtu edhe revizionistët, sot po kalojnë situata të vështira. Ata janë në krizë të rëndë, efekti i së cilës shikohet, si në vetë këto vende, ashtu edhe në marrëdhëniet midis tyre. Kjo krizë ka aspekte ushtarake, politike, ekonomike etj. Natyrisht kjo shkakton reagimin e masave punonjëse, i cili shprehet në grevat, në protestat e në demonstratat e tyre të shpeshta. Kështu shpjegohet fakti që sot në Itali, Francë, Angli, Amerikë e gjetkë ka një ngritje të madhe të hovit revolucionar të masave punonjëse.

Kriza të kësaj natyre ka edhe në vendet revizioniste, të cilat i detyruan revizionistët sovjetikë të ndërhyjnë vitin e kaluar ushtarakisht në Çekosllovaki për ta mbajtur nën tutelën e tyre, sepse Dubçeku dhe banda e tij po shpejtonin të shkëputeshin dhe ta kthenin vendin e tyre në një kryeurë të imperializmit. Kjo ndërhyrje tregoi qartë kalbëzimin e regjimit revizionist sovjetik, që po degjeron në një regjim ushtarak fashist. Ne kjo nuk na çudit aspak, sepse është pasojë e tradhtisë së krerëve revizionistë sovjetikë. Si rezultat i politikës tradhtare, satelitetët e Bashkimit Sovjetik kanë filluar të luftojnë për shkëputjen nga tutela sovjetike. Gjendja tani është e tillë që tradh-

tarët e Kremlinit nuk i mbajnë dot më në fre vasalët e tyre, përvçese me anën e armëve.

Revizionistët sovjetikë përpiken t'i mbajnë satelitët nën tutelë, duke filluar nga Polonia e Çekoslovakia e deri në Bullgari, sepse synojnë të sigurojnë në radhë të parë kufijtë e tyre. Kështu shpjegohet fakti që sot revizionistët sovjetikë, në të gjitha këto vende, përvç Rumanisë, kanë vendosur trupat e tyre të pushtimit. Por edhe në kufijtë e kësaj ata kanë grumbulluar divizione të tëra, kurse në Çekoslovakia ndofta kanë rreth 60 divizione etj.

Revizionistët sovjetikë mendojnë se vetëm nëpër-mjet pushtimit ushtarak mund t'i mbajnë rreth vetes «të rebeluarit». Me qëndrimin që kanë filluar të mbajnë, ata nuk bëjnë tjetër veçse vënë në qafën e tyre një peshë akoma më të rëndë. Ky qëndrim ka ngjallur urrejtjen e popujve të të gjitha këtyre vendeve. Këtë ne e shikojmë shumë qartë në Çekoslovakia, ku militaristët fashistë sovjetikë janë vënë në pozita shumë të vështira, pse atje ka filluar një rezistencë pasive në rritje që është bërë serioze për ta. Kjo rezistencë është e organizuar nga borgjezia për interesat e saj, nga populli patriot dhe nga revolucionarët.

Kur ndodhen përpara situatash të jashtëzakonshme, si në Çekoslovakia, revizionistët sovjetikë nuk ngurrojnë edhe të ndërhyjnë ushtarakisht dhe të shkar-kojnë nga udhëheqja e vendit të pushtuar të gjithë ata që nuk u shërbejnë verbërisht, duke i zëvendësuar kështu me vasalë të tjerë më të bindur të tyre. Kështu vepruan ata me Dubçekun, në vend të të cilit vunë Husakun. Por siç hoqën Dubçekun, nesër mund të

heqin Husakun dhe të sjellin në vend të tij, ta zëmë, Strugalin, i cili është po aq tradhtar. Megjithatë, renegatët e Moskës nuk do të mundin ta stabilizojnë situatën në Çekosllovaki.

Zhvillimi i ngjarjeve në Çekosllovaki ka bërë që udhëheqësit revizionistë që sundojnë në të gjitha vendet e «demokracisë popullore», të kenë frikë nga sovjetikët. Pas pushtimit të Çekosllovakisë, sovjetikët po u bëjnë presion të madh rumunëve. Udhëheqësit rumunë janë revizionistë me damkë, por jo agresivë. Ato që thonë ata janë vetëm fjalë.

Në radhë të parë udhëheqësit revizionistë rumunë nuk janë trima, siç tregohen. Nëse sot mbajnë qëndrim antisovjetik, kjo vjen se aktualisht përfitojnë nga vështirësitet që u janë krijuar tradhtarëve hrushovianë nga ngjarjet në Çekosllovaki. Ne mendojmë se për udhëheqësit revizionistë sovjetikë Rumania është sot pika më e dobët, prandaj përpiken t'i kthejnë rumunët në skllevër, te të cilët ata po gjejnë njëfarë rezistence. Rumunët mbrojnë atdheun e tyre jo si socialistë, por si nationalistë, ata nuk e mbrojnë atdheun nga social-imperialistët sovjetikë duke u nisur nga pozitat mark-siste-leniniste, por nga pozita nationalistë, se e dinë që revizionistët sovjetikë janë shumë të rrezikshëm dhe e marrin me mend ç'do të ngjasë në Rumani, po të futen ata.

Ajo që duhet pasur parasysh, në radhë të parë, është nëse rumunët do të rezistojnë në rast se futen trupat sovjetike në Rumani apo jo. Deri tani asgjë nuk merret vesh, por ne dimë se sovjetikët mundohen ta bindin udhëheqjen rumune të pranojë që të zhvillo-

hen manovra ushtarake të trupave të Traktatit të Varshavës brenda në Rumani. Hallin ata e kanë sa të futin këmbët, pastaj dihet se nuk kanë për të dalë andej, prandaj rumunët rezistojnë në këtë pikë. Me fjalë këta pohojnë se janë anëtarë të Traktatit të Varshavës, por nuk dëshirojnë që manovrat të bëhen në territorin e tyre, ndërsa sovjetikët ngulin këmbë shumë në këtë çështje; ata i ftojnë rumunët të marrin pjesë në manovrat e këtij Traktati që bëhen në vendet e tjera, por ata nuk venë, sepse e dinë që më vonë do t'u kërkohet që ato të zhvillohen në territorin e Rumanisë.

Në kongresin e partisë që bënë kohët e fundit, rumunët përjashtuan nga udhëheqja të gjithë ata që ishin prosovjetikë. Këto tregojnë se në Rumani gjendja nuk është e qëndrueshme, se rumunët ndodhen nën presionin e vazhdueshëm të sovjetikëve.

Ne ndoqëm me vëmendje vizitën që bëri në fillim të këtij muaji në Rumani presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Riçard Nikson. Me këtë vizitë rumunët u përpoqën të trembnin sovjetikët. Po do ta mbrojë në të vërtetë Rumaninë Niksoni? Zor është të besohet një gjë e tillë, sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë lidhur marrëveshje dhe aleanca të shumta, të fshehta e të hapëta, me udhëheqjen revizioniste sovjetike, prandaj logjika ta do të besosh që Niksoni do, më parë, të mos prishet me sovjetikët.

Rumunët mbajnë lidhje edhe me Titon. Revisionistët sovjetikë kërcënojnë edhe Jugosllavinë. Pikërisht, në ditët kur këta pushtuan Çekosllovakinë dhe filluan të kërcënojnë Rumaninë dhe Jugosllavinë me përqe-

ndrimin e forcave të mëdha, përvëç në vendet e tjera revisioniste, edhe në Bullgari, ne botuan një artikull në organin e Partisë sonë «Zëri i popullit», në të cilin bëmë të njojur para gjithë popujve të botës se, në rast të një sulmi eventual nga socialimperialistët sovjetikë kundër Rumanisë dhe Jugosllavisë, populli shqiptar do të jetë përkrah popujve rumunë dhe jugosllavë. Kjo ishte një deklaratë e drejtë. Pavarësisht nga divergjencat e papajtueshme ideologjike që kemi me Titon dhe me titizmin, qëndrimi ynë u mirëprit si nga populli, ashtu dhe nga udhëheqja jugosllave. Por, vallë, ka frikë Titoja nga një sulm nga ana e revolucionistëve sovjetikë? Jo. Ai nuk beson se do të sulmohet nga kjo anë, por, nën këtë maskë, merr masa ushtarake efektive për të forcuar pozitat e veta brenda në Jugosllavi. Titoja ka frikë se mos e përbësin nga brenda hrushovianët e Moskës, duke shfrytëzuar gjendjen e vështirë që ekziston në Jugosllavi.

E vërteta është se atje zien kazani. Kontradiktat midis nacionaliteteve që përbëjnë këtë vend janë acharuar mjaft: serbët janë hedhur kundër kroatëve, këta kundër sllovenëve, sllovenët kundër serbëve, malazeztë kundër maqedonasve, serbët kundër shqiptarëve etj. Brezhnjevi i njeh këto kontradikta të mëdha që ekzistojnë midis nacionaliteteve që përbëjnë shtetin jugosllav dhe janë pikërisht këto që Titoja i ka shumë frikë, prandaj përgatitet dhe po merr masa për të forcuar gjendjen e brendshme. Ai njëkohësisht u thotë revolucionistëve sovjetikë se e kupton shumë mirë qëndrimin e tyre.

Me masat që po merr Titoja u tregon brezhnje-

vianëve se do të luftojë, nga ana tjetër paralajmëron njëkohësisht kundërshtarët e brendshëm të rrinë urtë, të mos lëvizin, pse ka në dorë forca të mëdha të rëndësishme, të cilat do t'i përdorë kundër të gjithë atyre që do të guxojnë të ngrihen kundër tij. Me një të shtënë Titoja mendon, pra, të vrasë dy zogj, në radhë të parë të konsolidojë pozitat e tij politike në vend, njëkohësisht të mobilizojë popullin jugosllav kundër një agresioni nga ana e revizionistëve sovjetikë.

Për këto arsyе e pëlqeu Titoja deklaratën tonë. Dhe neve na intereson që ai të mos lejojë futjen e trupave agresive sovjetike në rast se Brezhnjevi i kërkon që ata të kalojnë nëpër Jugosllavi për të sulmuar Shqipërinë.

Në Jugosllavi ndodhen rreth një milion e gjysmë shqiptarë ndaj të cilëve Titoja ka filluar të mbajë tanë një qëndrim më të matur, duke u dhënë disa të drejta, si atë të ngritjes së flamurit etj. Përse i bën tanë ai këto lëshime ndaj shqiptarëve të Kosovës? Për arsyе se situatën brenda nuk e ka të favorshme. Në Jugosllavi janë ashpërsuar shumë kontradiktat midis komësive. Duke i shtuar kësaj situate edhe rrezikun e jashtëm të ndërhyrjes nga ana e revizionistëve sovjetikë, Titoja u detyrua t'u bëjë disa lëshime shqiptarëve të Kosovës, të cilët po luftojnë t'i shfrytëzojnë këto kushte duke bërë presion për të fituar të drejtat e tyre.

Ne nuk e dimë nëse Jugosllavia do të sulmohet apo jo. Në qoftë se nuk sulmohet nga ana e revizionistëve sovjetikë, kjo është në favorin tonë, por edhe po të sulmohet nga sovjetikët, agresorët do të ndeshen me rezistencën e popujve jugosllavë para se të na

sulmojnë ne. Po ta bëjnë hruščovianët një orvatje të tillë, popujt e Jugosllavisë do t'i godasin ata. Po edhe në rast se Titoja kapitullon, ne jemi të vendosur kundër çdo sulmi që mund të na vijë nga ana e revizionistëve sovjetikë. Ne jemi përgatitur për të gjitha variantet dhe jemi në gjendje t'i bëjmë ballë çdo agresioni. Prandaj pushtimi i Shqipërisë nuk mund të bëhet lehtë. Ne jemi të përgatitur të përballojmë edhe në rast të një sulmi nga ana e NATO-s. Sidoqoftë, jemi të bindur se revisionistët sovjetikë nuk mund të veprojnë aq lehtë kundër vendit tonë siç e patën me Çekoslovakinë, ku hynë fare pa rezistencë. Atyre mund të mos u bëjnë rezistencë as rumunët, në qoftë se sulmojnë Rumaninë, kurse nga ana e popullit shqiptar ata e dinë se do të gjejnë një rezistencë të madhe dhe të vendosur.

NATO-ja nuk mund të mos e konsiderojë vendin tonë si një vend me rëndësi strategjike. Prandaj, për interesat e saj nuk do të rrrijë pa reaguar fare ndaj një sulmi të socialimperialistëve sovjetikë ndaj vendit tonë. Po edhe po të ndodhë një gjë e tillë, prapë ne nuk kemi frikë, pse kemi në radhë të parë popullin të organizuar dhe të armatosur. Ata që do të guxojnë të sulmojnë vendin tonë, vështirë do ta kenë të fitojnë, në mos të pamundur.

Që të sulmojnë Shqipërinë, ushtritë e tradhtarëve revizionistë sovjetikë duhet të kalojnë nëpër Jugosllavi. Kjo do të jetë shumë e vështirë për ta, sepse do t'u duhet të sulmojnë me mijëra avionë përnjëherësh, pse e llogaritin që kanë të bëjnë me një popull të vendosur. Ndryshe nga do të na sulmojnë? Që të vijnë

në Shqipëri, mund të kalojnë edhe nga Greqia apo Adriatiku. Për të gjitha variantet ne i kemi bërë llogaritë. Nga çdo anë që të mendojnë të na godasin armiqjtë, sot ose nesër, ne jemi të përgatitur t'u bëjmë ballë. Revisionistët sovjetikë e dinë këtë, ata i dinë mirë kokën dhe vendosmërinë tonë.

Del qartë se gjendja e revisionistëve sovjetikë nuk është e shkëlqyer, njerëzit kudo në botë kanë filluar t'i kuptojnë gjërat siç janë. Sot nuk janë kohët e kaluara, kur të mëdhenjëtë bënin si të donin.

Sundimtarët e Kremlinit e treguan fytyrën e tyre të vërtetë edhe për problemin e Lindjes së Mesme, në luftën e Izraelit kundër vendeve arabe. Tani nga njëra anë e kanalit të Suezit janë vendosur izraelitet, po në Egjipt janë futur edhe revisionistët sovjetikë. Deri pak kohë më parë në Mesdhe lëvrinin flota amerikane dhe ajo italiane e franceze, kurse sot po vozit në këtë det edhe një flotë e fuqishme sovjetike, e cila ka krijuar bazat e saj në Egjipt, në Siri etj.

Revisionistët sovjetikë, pra, janë vendosur në Mesdhe, ata kanë në duart e tyre Kajron dhe të gjitha portet e Egjiptit. Ekonomia dhe ushtria e këtij vendi kontrollohen nga revisionistët sovjetikë dhe, në fund të fundit, edhe politika e Naserit kontrollohet prej tyre. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për disa vende të tjera arabe.

Si do të zgjidhet çështja e Lindjes së Mesme? Ne mendojmë se ky problem nuk do të zgjidhet me biseda. Zgjidhja e vetme e tij është largimi i imperialistëve amerikanë dhe i revisionistëve sovjetikë nga vendet e kësaj zone.

C'do të ngjasë në qoftë se amerikanët do të urdhërojnë Izraelin të tërhiqet nga kanali i Suezit? Ky kanal do të mbetej atëherë në duart e revisionistëve sovjetikë. Mirëpo imperialistëve amerikanë nuk u intereson një gjë e tillë. Të gjithë e dimë shumë mirë rëndësinë e madhe që ka kanali i Suezit. Po të arrijnë amerikanët ta bëjnë për vete Naserin, ky do të kërkojë të dëbohen forcat sovjetike nga Egjipti. Pra, situata në Lindjen e Mesme është serioze. E vetmja rrugë për zgjidhjen e problemit të Lindjes së Mesme është lufta e vendosur e popujve arabë kundër revisionistëve sovjetikë dhe imperialistëve amerikanë. Zgjidhje tjeter ne nuk shikojmë.

Bashkimi Sovjetik, deri para Luftës së Dytë Botërore, si i pari vend socialist në botë, ka qenë i rrethuar nga shtete kapitaliste dhe kishte vetëm Detin e Zi prej nga mund të dilte në Mesdhe, kurse sot situata ka ndryshuar. Revisionistët sovjetikë tani kanë flotën e tyre në Mesdhe, kështu që, në rast lufte, para se kjo të zhvillohet në Detin e Zi, do të zhvillohet në Mesdhe, sepse këtu ndodhet një pjesë e flotës së fuqishme sovjetike. Si rezultat i daljes së kësaj flote në Mesdhe, Greqia është futur në një darë, si nga ana e kësaj flote, ashtu edhe nga ana e Bullgarisë. Prandaj imperialistët amerikanë dhe drejtuesit e NATO-s bëjnë çmos për ta forcuar situatën në Greqi, që të mos e humbasin këtë bazë të tyre të rëndësishme.

Një problem tjeter shumë i rëndësishëm si për imperialistët amerikanë, ashtu edhe për revisionistët sovjetikë është çështja kineze. Secili prej tyre përpinqet të futë tjetrin në luftë kundër Kinës.

Në situatën aktuale gjendja e tradhtarëve sovjetikë është shumë e vështirë. Ata po përpiqen me çdo kusht të qartësojnë pozitën e tyre në Evropë, që të kenë duart të lira për të drejtuar vëmendjen kundër Kinës. Revisionistët sovjetikë e dinë mirë se e kanë shumë të vështirë të luftojnë në dy fronte. Është pikërisht kjo arsy, si dhë arsyet e tjera politike, që ata po përpiqen tani me çdo kusht për të forcuar marrëdhëni me Gjermaninë Perëndimore. Natyrisht ndjejkja e politikës së afrimit me Republikën Federale të Gjermanisë ngjall kontradikta të mëdha midis revisionistëve sovjetikë dhe satelitëve të tyre. Në radhë të parë, për këtë problem pasardhësit e Hrushovit kanë kontradikta me Gomulkën, gjithashtu me Republikën Demokratike Gjermane etj. Sidoqoftë, themelor është fakti që revisionistët sovjetikë nuk mund të ndërmarrin aventura në Lindje kundër Kinës, pa stabilizuar dhe pa pasur të sigurt situatën në Evropë.

Para një gjendjeje të tillë të ndërlikuar ne duhet të përgatitemi, të jemi të gatshëm, të mos i dobësojmë kurrë vigjilencën dhe mbrojtjen tonë ushtarake, me gjithëse nuk jemi vetëm. Me ne janë gjithë popujt revolucionarë, janë popujt që po përgatitin për revolucion kudo shokët tanë marksistë-leninistë.

Sidoqoftë, në një situatë të tillë që po kalojmë, është detyra jonë dhe e të gjithë marksistë-leninistëve të botës që të bashkojmë forcat për t'i dalë përparrë çdo të papriture.

Ne e çmojmë punën revolucionare që zhvillohet në Francë dhe e dimë mirë se atje gjendja për marksistë-

-leninistët nuk është e lehtë. Ata do të gjenden edhe për një kohë të gjatë para vështirësive të mëdha. Franca është një vend që nuk ka dalë tani nga veza, siç themi ne shqiptarët, ajo ka një histori revolucionare, por ka edhe një histori reaksionare. Franca ka një eksperiencë shumë të madhe revolucionare, po ka gjithash tu edhe një eksperiencë shumë të madhe reaksionare, prandaj eksperienca e partive të tjera është e domosdoshme për të gjithë. Përse takohemi ne? Për të shkëmbbyer eksperiencën me njëri-tjetrin. Po ne mos ju themi vallë juve të bëni siç bëjmë ne? Apo ju na thoni të bëjmë sikundër veproni ju? Jo! Ne marksistët nuk veprojmë kështu, pse një veprim i tillë nuk do të ishte i drejtë. Marksistë-leninistët duhet t'i njobin mirë dhe t'i zbatojnë drejt parimet e marksizëm-leninizmit, që janë të njëjta për të gjithë dhe të vlefshme sot dhe nësër, pavarësisht se zbatohen ndryshe në vende të ndryshme, sipas kushteve, karakteristikave dhe gjendjes reale të çdo vendi.

Ju në Francë keni pasur feudalë, por edhe ne kemi pasur të tillë në vendin tonë. Por si kanë qenë feudalët tanë, në krahasim me tuajt? Tanët kanë qenë si miza përrpara feudalëve tuaj. Ndërsa tanët kanë pasur saraje, tuajt kanë pasur kështjella. Feudalët francezë ishin zotérinj të fuqishëm që nuk vareshin as nga mbreti, kurse tanët nuk ishin kaq të fortë. Edhe ne kemi pasur borgjezi, po ç'ishte borgjezia jonë përrpara tuajës? Borgjezia dhe bejlerët tanë u likuiduan. Ju keni kaluar të gjitha fazat e zhvillimit shoqëror, me përjashtim të socializmit. Te ju janë bërë revolucionare, luftëra fshatare, revolucioni borgjez i 1789-s, është

bërë Komuna e famshme e Parisit. Në tokën e vendit tuaj janë bërë luftëra imperialiste e luftëra partizane etj., megjithatë në Francë borgjezia, baronët, fisnikët janë akoma në këmbë. Pra të tjera kushte kishim ne, krejt të tjera keni ju, prandaj zbatimi i marksizëm-le-ninizmit në vendin tuaj nuk mund të bëhet njëlloj si te ne ose në ndonjë vend tjetër me kushte të ndryshme nga tuajat. Me gjithë vështirësitë e mëdha, ne jemi të bindur se këto i kanë kalitur e do t'i kalitin marksistë-leninistët e vërtetë dhe këta do t'i kapërcejnë ato.

Ne, kur e filluam luftën, ishim një grusht njerëzish, por fituam sepse zbatuam me rigorozitet parimet marksiste-leniniste në kushtet konkrete të vendit tonë. Në punën dhe në luftën tonë u mbështetëm njëkohësisht edhe në eksperiencën e Bashkimit Sovjetik, që ishte vendi i parë që bëri Revolucionin Socialist. Si për ne, ashtu edhe për të tjerët, shembulli i Bashkimit Sovjetik është një eksperiencë e madhe. Duke u mbështetur në këtë dhe duke ua përshtatur kushteve të Shqipërisë, ne luftuam dhe arritëm të fitojmë. Ju mund të përfitonî diçka nga eksperiencia modeste e Partisë sonë, ashtu sikurse neve na vlen eksperiencia e partisë suaj.

Çështja themelore është që marksistë-leninistët të luftojnë dhe të fitojnë besimin e masave, të forcojnë lidhjet që duhet të ekzistojnë midis partisë dhe popujve të tyre. Po pate përkrahjen e popullit, ke këmbët në tokë dhe vetëm atëherë mund të fitosh.

Për partitë marksiste-leniniste themelore janë, pra, lidhjet që duhet të kenë me masat e popullit. Këto lidhje bëhen akoma më të domosdoshme sidomos kur partia punon dhe lufton në kushtet e ilegalitetit. Është

ndryshe kur populli të njeh se je komunist, por kur nuk të njeh si të tillë, partia duhet të mendojë dhe të gjejë format si të krijohen këto lidhje midis saj dhe popullit. Kjo arrihet kur vija politike e partisë paraqet dëshirat, mendimet dhe pikëpamjet e popullit. Duhet të kemi një parti të tillë, thamë ne që në fillim, që të futet në gjirin e popullit, të dëgjojë zërin dhe dëshirat e tij e të luftojë gjer në fund për plotësimin e tyre. Se menduam e vepruam kështu gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, populli i mbajti me kafshatën e gojës e me veshmbathje komunistët ilegalë dhe partizanët, i mbrojti ata si veten e tij.

Në Francë ka parti borgjeze e revisioniste me tradita të vjetra, me eksperiencë të madhe, të cilat nuk do t'i lënë marksistë-leninistët të veprojnë lirisht. Ato do të punojnë kundër tyre, do të mundohen të prishin të gjitha ato që do të ndërtojnë marksistë-leninistët.

Që të mundim të kemi partinë të lidhur me popullin dhe që të vëmë në jetë vijën e masave, kuadrot e partisë në bazë duhet të jenë të aftë për të térhequr mendimet e popullit e t'ia kalojnë udhëheqjes. Që të bëhet kjo, nuk është e lehtë, sepse në radhë të parë kuadrot duhet të edukohen mirë nga ana ideologjike dhe politike dhe të përgatiten në një shkallë të tillë që të jenë të aftë për t'iu përgjigjur të gjitha kërkeseve të kohës.

Që të kemi një parti të fortë, duhet që ajo t'u përgjigjet problemeve kryesore, të mos shkëputet nga masat dhe të mos e vërë partinë kundër tyre.

Në ç'formë duhet të bëhet lidhja e partisë me masat? Çdo parti, për të vënë në jetë këtë detyrë, men-

don vetë për të gjetur format më të përshtatshme. Partia Bolshevikë e Leninit, para revolucionit, dhe Partia Komuniste e Francës, në kohën e pushimit gjerman, adoptuan organizimin e celulave treshe. Ne, për shembull, gjatë luftës, nuk përdorëm celula treshe, paravarësisht nga kushtet e ilegalitetit, në çdo celulë tonën bënin pjesë 5 ose 6 anëtarë. Se si të organizohet mbledhja e celulës, kjo duhet parë sipas kushteve. Atje ku reaksioni është më i fortë, mundet që organizimi i një celule të jetë me treshe, po atje ku është më pak i fortë, ajo mund të jetë më e madhe. Në këtë çështje ne kemi mjaft shembuj nga organizimi i Partisë sonë gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Atje ku ka pasur reaksion të madh, ne kemi ndërtuar celula më të vogla, në vende të tjera ato kanë qenë më të mëdha. Pra organizimi i partisë në bazë mund të bëhet sipas kushteve konkrete ku ndodhet.

Në krijimin e celulave duhet të kemi parasysh dy rreziqe që mund të dalin: po të krijojmë organizata-bazë të ngushta, celula treshe, lidhjet e partisë me masat do të vështirësohen, ndërsa po të jenë shumë të gjera, ka rrezik që ato të zbulohen dhe të goditen nga armiku. Prandaj çështja duhet parë dhe duhet vepruar në çdo rast sipas kushteve që paraqiten.

Një problem tjetër shumë i rëndësishëm është puna që duhet të bëjë partia për përgatitjen ideologjike dhe politike të anëtarëve të saj. Po të krahasojmë atë që bëjmë ne sot për këtë problem, me atë që kemi bërë në të kaluarën, mund të themi se ka një ndryshim shumë të madh. Në Partinë tonë tani ka një etje të ma-

dhe për të mësuar. Për ta ilustruar këtë, mjafton të përmendim një shembull. Më parë organin e Partisë, gazetën «Zëri i popullit», e botonim në 15 000 kopje, kurse tani tirazhi i saj është rritur në rreth 90 000 kopje dhe lexohet me interesim të madh nga komunistët dhe nga gjithë populli. Megjithëse Historinë e Partisë e botuam në 200 000 kopje, të tëra u shitën menjëherë dhe vazhdon të ketë kërkesa të mëdha për të.

Partia, nëpërmjet levave të saj, lidhet me masat. Kjo nxjerr edhe domosdoshmërinë e ekzistencës të ale-atëve. Për këtë është e domosdoshme të bëhet një politikë e gjerë, me qëllim që të grumbullohen rreth partisë marksiste-leniniste forcat më demokratike të rrymave të ndryshme që luajnë njëfarë roli. Sigurisht, me anarkistët nuk duhet biseduar, por edhe në qoftë se del nevoja për bisedime me ta, t'u thuhet troç se ne jemi komunistë dhe t'u tregohen hapur gabimet që kanë. Po të mbahet një qëndrim i tillë, do të mund të tërhiqen elementët më të mirë që bëjnë pjesë në radhët e tyre, pse edhe në grupet anarkiste ka njerëz pozitivë, të gënjyer.

Veprimitaria e partisë marksiste-leniniste, për mendimin tonë, është mirë të shtrihet edhe në rrethe të anëtarëve të partisë revizioniste dhe, me punën që do të bëhet në radhët e saj, ajo do të minohet nga brenda, derisa të shkatërrrohet plotësisht. Por, për t'ia arritur qëllimit, duhet punë shumë prudente.

Gjatë Luftës sonë Nacionalçlirimtare ne kemi pasur rastin të bëjmë takime edhe me udhëheqës të organizatave reaksionare, por asnjë nuk na akuzoi përsë

vepronim kështu, kjo dihej se ishte një çështje esencale. Kur ishte një shok udhëheqës i një partie marksiste-leniniste në vendin tonë, e pyeta përse një profesor të madh me influencë dhe mik të Shqipërisë nuk e futnin në shoqatën e miqësisë me vendin tonë. Ata nuk e bëjnë këtë se e shikojnë problemin në mënyrë sektare, nuk kuptojnë si duhet rëndësinë e aleatëve. Profesori në fjalë nuk është marksist-leninist, ai nuk e aprovon politikën e Partisë sonë, por është njeri që e do Shqipërinë. Ne e dimë se, po të sulmohet vendi ynë, ai do të na mbrojë si mik i tij që është. Pra, kjo ka të bëjë pikërisht me çështjen e aleatëve.

Një rol të rëndësishëm për përhapjen e propagandës së partisë në masat luan edhe gazeta. Që ajo të bëjë efektin e duhur, duhet që në të, përveç artikujve kryesorë, të botohen edhe informacione, sidomos prej atyre që vijnë nga baza. Kjo ka rëndësi të madhe. Duke botuar informacionet e bazës, ne do të nxjerrim materiale të mira që u përgjigjen nevojave dhe kërkesave të masës.

Në kuadrin e punës së komunistëve me masat duhet përfshirë edhe ajo me ushtrinë. Ky është një problem që kërkon kujdes dhe vëmendje të madhe...

Në gjirin e lëvizjes marksiste-leniniste ekzistojnë një sërë problemesh, një nga të cilat është edhe ai i punës që duhet të bëjë partia me fshatarët. Për ta zgjidhur si duhet këtë problem, ajo duhet të veprojë jash-tëzakonisht me pjekuri, të bisedojë me fshatarët, t'u çelë atyre perspektiva, në qoftë se do të duan të ndjekin rrugën tonë. Këtë shpjegim t'ua bëjmë në mënyrë që të na kuptojnë dhe të na pasojnë.

Në punën me fshatarët ne kemi qenë shumë të kujdesshëm; punonim me ta duke mos u prekur interesat dhe, në të njëjtën kohë, u përgjigjeshim kërkesave të tyre. Ne kishim parasysh që fshatarët, ashtu sikurse ka thënë Lenini, kanë një natyrë të dyfishtë.

Fshatarët përbëjnë një rezervë të madhe për revolucionin. Hauret dhe mullarët e fshatarëve ishin depot e armëve tona, tek ata fshiheshin kuadrot e Partisë së nö dhe revolucionarët marksistë-leninistë. Interesi edhe i vetë fshatarëve është të gjejnë aleatë në luftën e tyre. Fshatarët e varfër, në radhë të parë, kanë gjithmonë mbi kokë peshkaqenët e mëdhenj, kapitalistët e tokave që i shfrytëzojnë.

Fshatarët duhen tërhequr pas vetes, duke i ngritur ata të luftojnë që kanalet ujitëse, për shembull, të bëhen me fondet e shtetit, që të mos paguajnë tatime, që të mos paguajnë asgjë në rast se shtrohen në spitalë, dhe ilaçet t'i marrin gratis etj., ashtu siç i kemi ne këtu në Shqipëri. Me një propagandë të tillë mund t'i tërheqësh me vete më vonë dhe në mënyrë graduale fshatarët, duke rrënjosur tek ata elementet e para të socializmit.

Besoj se këto bisedime shoqërore do të na ndihmojnë shumë për punën tonë të përbashkët. Ne edhe një herë ju falënderojmë së tepërmi për bisedën kaq të hapur, të sinqertë dhe të rëndësishme që zhvilluam.

Në fund miqtë francezë falënderuan shokun Enver Hoxha, Komitetin Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe popullin shqiptar për pritjen e ngrohtë që iu bë gjatë qëndrimit në vendin tonë.

Duam të vëmë në dukje, — thanë ata, — se të

gjitha vizitat që delegacioni ynë bëri në Shqipëri, kanë qenë të frytshme për ne.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Kundër revizionizmit mo-
dern (Përmbledhje veprash)
1968-1970», f. 477*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Kundër revizio-
nizmit modern (Përmbledhje
veprash) 1968-1970», f. 477*

E ARDHMJA E VLORËS

Shënimë

Gusht 1969

Vlora është një nga qytetet bregdetare më të bukurat e vendit tonë dhe të Mesdheut. Si port i mbrojtur natyror rrallë e gjen. Vlora është një port detar me rëndësi, por, për fat të keq, atë, deri tash, për pamundësi ekonomike, nuk e kemi bërë të tillë. Si port ushtarak ne kemi marrë masa të mira, si në ishullin e Sazanit, në Karaburun, në Pashaliman e gjetkë. Këto pikat e fortë të Portit të Vlorës janë bërë kala të çelikta, ku bishat që do të tentojnë të hyjnë do të lënë kokën. Kurse ana ekonomiko-detare e portit ka mbetur prapa përmungesën e vetë portit detar, tregtar. Atje ka ngelur e vëtmja kalatë që ka qenë me kohë, diçka e kemi riparuar, por porti është shumë i cekët. Ekzistojnë vetëm varkat e peshkimit, disa vaporë tanët me tonazh të vogël, ndonjëherë kthejmë ndonjë vapor të madh të huaj, por ai duhet të ankorohet shumë larg portit në gjirin e Vlorës dhe shkarkimi i tij bëhet me varka e me vaporë të vegjël. Kjo nuk është aspak ekonomike. Kështu mund të themi se Porti i Vlorës është gati i pafunkcionueshëm, gjë që përbën një humbje të

madhe për Vlorën dhe për gjithë ekonominë e vendit tonë. Vlora merr frymë vetëm me një mushkëri, me atë të tokës, ndërsa shfrytëzohet vetëm një port, ai i Durrësit. Këtë mungesë duhet ta plotësojmë, mundësisht sa më parë.

Pasi më raportuan për vështirësitet që hasen në Portin e Durrësit, ku në det të hapët presin radhën për të hyrë në port jo më pak se 6-7 vaporë, i këshilllova shokët të rifillojnë studimin e Portit të Vlorës të lënë në heshtje. Ne kemi pasë menduar për ndërtimin e tij, kishim sjellë edhe një grup «specialistësh» polakë, të cilët kanë pasë bërë edhe një skicë, që nuk duhet të ketë shumë vlerë.

Hysniu ngarkoi disa shokë për këtë studim dhe më dha një lajm të mirë. Ky është vetëm një lajm, por që ndez fantazinë time. Një grup specialistësh, me Shinasi Dragotin në krye, kishin vizituar Treportin e Zvërnecin dhe i kishin thënë Hysniut se atje ne mund të bëjmë portin e ri të Vlorës. Del i mrekullueshëm, i thanë, punohet në të thatë, nuk do të kushtojë shumë shtrenjtë. Natyrisht, tani duhet vazhduar studimi për ta pasur të qartë këtë problem. Por gjatë studimit të specialistëve të portit mund të punojë edhe imagjinata ime.

Porti i ri i Vlorës në Zvërnec do t'ua ndryshojë krejtësisht pamjen Vlorës dhe Shqipërisë së Jugut; ai do t'u japë një shtytje të mëtejshme të fuqishme ekonomisë, kulturës, përparimit.

Natyrisht, duhet të parashikojmë një port modern, për tregti, për peshkim, për ushtrinë, një port jo për një vit dhe jo për një vend që të ketë vetëm 2 mi-

lionë banorë. Shqipëria do të shtohet, ekonomia do të përparojë, porti duhet t'i përgjigjet perspektivës. Çdo gjë nuk do të bëhet përnjéherësh, por ne duhet të parashikojmë për të ardhmen. Bëjmë një port të një vendi socialist, që do të ecë me hapa të sigurt drejt komunizmit.

Porti i Vlorës do t'i shërbejë gjithë Shqipërisë, si i tillë kërkon edhe hekurudhën, prandaj na vihet detyra të lidhim Vlorën me Fierin me hekurudhë. Kjo nuk është ndonjë gjë e zorshme, por është shumë e rëndësishme. Natyrisht, hekurudha do të lidhë edhe qytetin, por këtij me portin i duhet një autostradë për automobilë dhe për autobusë.

Në drejtimin e portit ndodhet zona industriale. Atje tash është Uzina e Sodës, Fabrika e Llambave Elektrike, së cilës i duhet trefishuar kapaciteti; po ndërtohet Uzina e Polivinilkloridit, e cila duhet të shtohet në të ardhmen, dhe duhet të ndërtojmë fabrika që lënda e parë të prodhohet në vend. Në Vlorë do të ndërtohen, gjithashtu, Fabrika e Sapunit e fabrika të tjera, aty duhet të zhvendoset Kombinati i Konservimit të Peshkut, që kemi sot dhe të cilit duhet t'i shtohet dhe një fabrikë tjeter sa dyfishi ose trefishi i tij, natyrisht, duke dalë me peshkimin nga gjiri i Vlorës. Pra, në perspektivë, unë shoh rreth portit të ri një zonë të madhe industriale.

Mendoj se duhet të trefishojmë edhe kapacitetin e Fabrikës së Çimentos, po edhe të Fabrikës së Plakave e të Qyngjeve prej Eterniti. Të vendosim teleferikët për të sjellë gurë në fabrikat e çimentos, pse me ka-

mionë nuk mund t'ia dilet kësaj pune. Duhet të hapim kariera moderne të gurit në Karaburun, për brenda dhe për eksport. Pse jo, në portin e ri të parashikojmë edhe ndërtim anijesh me pishën e bregut të detit që rritet për mrekulli në këto anë dhe që duhet ta studiojmë posaçërisht për këtë degë shumë të rëndësishme të ekonomisë.

I gjithë ky përparim do t'u japë një impuls të madh kooperativave, bujqësisë, zhvillimit në përgjithësi të qytetit të Vlorës, të cilin unë e parashikoj që pas 20 ose 25 vjetësh do të ketë mbi 75 mijë banorë. Prandaj të mendojmë që tash e paralelisht për ndërtime baneshash dhe objektesh socialkulturore. Ta bëjmë Vlorën një nga qytetet më të bucura të Mesdheut, pale të Shqipërisë, një port të denjë të një vendi socialist. Për këtë duhet të bëhet kthesë në mentalitetin e vlonjatëve, në mentalitetin e ndërtuesve, të mos mendojmë ngushtë. Të shohim larg në perspektivë si do të jetë Vlora, si duhet të punojmë që ta bëjmë të bukur edhe për më vonë e përngahera.

Vlora, nga pozita e vet, do të jetë një rrëth edhe industrial, edhe bujqësor, me male, me fusha dhe me det, me port e me plazhe, vend pune, banimi dhe pushmani. Prandaj në ndërtimet aktuale dhe të ardhshme t'i kemi kurdoherë parasysh të gjitha këto karakteristika që duhen kombinuar, harmonizuar nga ana ekonomike, urbanistike, turistike, ushtarake, klimaterike, topografike etj., etj.

Ua përsëris vazhdimisht shokëve në Vlorë të bëjnë kujdes në ndërtime, të mos shpërdorojnë për gjëra të rastit vendet e bucura të këtij qyteti. Në Vlorë, sido-

mos në vendet kryesore, nuk duhet lejuar të ndërtohet pa kriter, pa plan e pa perspektivë. Ajo që do të ndërtohet sot, duhet t'i nënshتروhet më parë një kritike dhe një imagjinate të gjallë për të dalë në konkluzionin si do të duket nesër kjo që ndërtojmë sot. Sheshi i Flamurit, bulevardi i Skelës, Skela vetë, rruga që shkon në Ujin e Ftohtë, plazhi popullor, këto, midis të tjera ve, janë vende të mrekullueshme që rallë i gjen në botë, prandaj në çdo pëllëmbë vend ku do të ndërtojmë, të veprojmë siç thashë pak më lart. Në trojet bosh të bulevardit të Skelës duhet të ndërtohen godina të atilla që të rregullojnë e të zbukurojnë edhe shumë nga ato që kemi ndërtuar këtu më parë, por që nuk janë aq të bukura, sepse njerëzit tanë nuk kishin eksperiençë në ato kohë.

Skelën, me heqjen e portit andej, e shoh të transformohet në një vend të mrekullueshëm për pushim. I gjithë porti aktual spastrohet dhe bëhet një lulishte e një karëfur¹ i bukur në formë potkoi; nga një anë shtrihet plazhi popullor me kabina të bukura, në mes moli, ku të ndërtohen restorante, kafene dhe të ketë vende varkash vetëm për shëtitje në det; në krahun tjetër, prapë plazh deri në Ujin e Ftohtë dhe rruga që të çon këtu kthehet në një vend krejt të lulëzuar vetëm për shëtitje. Transporti automobilistik të kalojë pas qytetit, rrëzë kodrave.

Por vendi më i bukur i Vlorës për banesa, sipas mendimit tim, është gjatë rrugës që të çon nga skela në Ujin e Ftohtë. I gjithë ai hark të mbushet me pa-

1 Nga frëngjishtja — shesh ku kryqëzohen disa rrugë.

llate, jo më pak se pesëkatëshe, me arkitekturë të studiuar mirë. Kjo do të jetë një perlë buzë detit dhe, për t'ia arritur kësaj, nuk duhet punuar me këmbë, po me kokë. Një brez i tillë pallatesh, me kurora ullinjsh e portokajsh në kodra, me lule, me bulevardin me palma dhe me drurë të tjera ornamentalë, me plazhin e ar gjendtë dhe me detin e kaltër përpara, do të krijojë një pamje të mrekullueshme. Por për këtë duhet të punojnë dora dhe mendja e njeriut. E gjithë kjo vazhdon në Ujin e Ftohtë që e kemi kthyer në një kopsht portokajsh dhe ullinjsh. Atje tash kemi shtëpi ku pushojnë punëtorë dhe kuadro, por këto janë të pakta. Duhet hequr sa më parë Fabrika e Vajit prej andej ku është, duhet spastruar vendi dhe të transformohet në një vend të bukur, ku të vijnë të pushojnë gjithë vitin punonjësit. Vlora ka edhe vende të tjera të përshtatshme për të ndërtuar godina pushimi për punonjësit në Ujin e Ftohtë. I gjithë ky kompleks, që nga porti i ri deri te kalaja e Ujit të Ftohtë do ta bëjë Vlorën të shohë edhe nga deti, të marrë frymë edhe nga deti dhe jo vetëm nga toka. Trimat e Selam Musait dhe të Hysni Kapos luftuan që deti të jetë yni, burim shëndeti, force, begatje për njeriun e ri që rrit dhe edukon Partia në Shqipërinë socialiste.

*Botohet për herë të parë si-
pas originalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

POPUJT NUK MPOSHTEN AS NGA TANKET, AS NGA DIPLOMACIA E REVIZIONISTËVE SOVJETIKË

Artikull i botuar në gazeten «Zëri i popullit»

4 shtator 1969

Agresioni kriminal i revizionistëve sovjetikë kundër Çekoslovakisë një vit më parë zbuloi në rrënje e përfundimisht natyrën imperialiste e agresive të politikës së klikës Brezhnev-Kosigin. Synimet hegjemoniste, ekspansioniste e kolonialiste karakterizojnë sot gjithë veprimtarinë praktike të sundimtarëve të Krem-linit në marrëdhëniet e tyre me të gjitha vendet dhe me të gjitha forcat politike. Tanimë revizionistët sovjetikë edhe me aleatët e tyre më të afërt i kanë humbur të gjitha mjetet e bindjes politike e ideologjike dhe flasin vetëm me gjuhën e armëve.

Edhe pse përpiken të hiqen si «leninistë të kulluar», dhe rreth kësaj teme këto kohët e fundit nuk i kursejnë as fjalët as shkrimet, në fakt ata nuk i beson njeri. Tradhtia e tyre e përbindshme ndaj leninizmit ka fshirë çdo gjurmë komuniste në të gjitha fushat — ideologjike, politike e ekonomike, jo vetëm në

Bashkimin Sovjetik, por edhe në vendet e tjera ku sundojnë revizionistët.

Revizionistët asnjëherë e për asgjë nuk i besojnë njëri-tjetrit dhe nuk i beson njeri. Veprimet e tyre, në dukje të koordinuara, në brendi, në realitet, nuk kanë kurrfarë uniteti e koordinimi. Çdo koordinim është koniunktural dhe bazohet në interesa të veçantë, nacionalë, por krejtësisht të largët nga fryma internacionale. Megjithëkëtë, edhe ky koordinim i kalbur arrihet vetëm kur e lejojnë ose e imponojnë revizionistët sovjetikë. Tani kontradiktat midis vendeve revizioniste kanë arritur në një shkallë të atillë sa udhëheqësit revizionistë sovjetikë e kanë të pamundur të ruajnë hegemoninë e tyre mbi të tjerët me mjetet e zakonshme dhe nuk u ka mbetur tjetër rrugë veçse të përdorin forcën, të përdorin sa vjen e më shumë shantazhin ushtarake dhe Traktatin e Varshavës, i cili është një instrument sundimi e agresioni në duart e carëve të rinj të Kremlinit.

Ka më se dy vjet që, ditë e natë, në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet revizioniste po zhvillohen në mënyrë të shfrenuar manovra ushtarake të çdo lloji e të çdo rangu. Akoma nuk është shuar zhurma e topave dhe e tankeve që shtypën demonstratat e popullit çekoslovak me rastin e përvjetorit të parë të agresionit fashist revizionist, kur po bëhen përgatitje për manovra të reja ushtarake të Traktatit të Varshavës. Flitet se kësaj radhe në manovrat do të marrin pjesë trupa sovjetike, bullgare, hungareze e rumune. Thuhet se krerët revizionistë sovjetikë po bëjnë çmos që ta bindin udhëheqjen rumune jo vetëm për të marrë pjesë

në këto manovra, por që këto të zhvillohen edhe në tokën rumune. Trupa të shumta sovjetike, përveç atyre që janë dislokuar në Bullgari, janë përqendruar në kufirin sovjeto-rumun. Në Hungari tanimë ndodhen afro 40 divizione sovjetike. Në Detin e Zi luftanijet sovjetike, ashtu si edhe në Mesdhe, kanë shtuar lëvizjet dhe veprimtarinë e tyre. Flitet edhe për një mbledhje të afërt të nivitet të lartë të Traktatit të Varshavës në Bullgari.

Për ç'qëllim bëhen gjithë këto manovra, në një numër e në një shkallë kaq të madhe, në kuadrin e Traktatit të Varshavës dhe jashtë këtij kuadri, bilaterale ose vetëm nga Bashkimi Sovjetik? Kamuflazhi demagogjik i revisionistëve sovjetikë është se gjoja përgatiten kundër një sulmi eventual nga imperializmi amerikan dhe nga Gjermania Perëndimore. Por në qoftë se ka pasur ndonjëherë marrëdhënie kaq miqësore, të ngrohta e të singerta të revisionistëve sovjetikë me imperializmin amerikan e me militaristët e Bonit, këto janë sot.

Populli thotë: «Shikoji punën, jo gunën». Përgatitjet dhe manovrat ushtarake të Bashkimit Sovjetik e të satelitëve të pabindur, por të detyruar, janë përgatitje për luftë kundër RP të Kinës dhe RP të Shqipërisë, janë përgatitje për zgjerimin e perandorisë së re koloniale të revisionistëve sovjetikë, përgatitje për të shuar luftërat revolucionare në të gjithë botën. Ato janë shpata e Damokleut mbi kokën e satelitëve disidentë në kampin revisionist dhe përgatitje lufte për të shtypur çdo revolucion e kryengritje të vërtetë në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera ku sundojnë revisionistët.

Në çdo aspekt të marrëdhënieve të revizionistëve sovjetikë me satelitët e tyre janë kurdoherë të prani shëm pabesia, kërbaçi dhe dhuna ushtarake. Orvatjet që bëri vitin e kaluar klika renegade e Dubçekut për t'u çliruar, në rrugë revizioniste, nga kulari i imperialistëve të rinj sovjetikë, përfundoi me pushtimin e plotë ushtarak të Çekoslovakisë nga këta të fundit.

Tani radha, me sa duket, po i vjen revizionistit Ulbriht, të cilit udhëheqësit sovjetikë, në bashkëpunim me ata polakë, po ia përgatitin valixhet, për arsy se ai po e kundërshton në mënyrën e vet kapitullimin pa kushte ndaj komplateve të revizionistëve sovjetikë me militaristët e Bonit kundër RD Gjermane.

Janosh Kadari tani për tani rri i struktur, pasi ka në zverk divisionet sovjetike që i janë shtruar në vatër dhe pret momentin e përshtatshëm për të rritur aksionet e klubit «Petëf».

Miku më i ngushtë, por kokosh, i carëve të Krem-linit éshtë revizionisti dhe antisovjetiku me damkë Gomulka, kurse Zhivkovi, i cili e ka shndërruar Bull-garinë e Dimitrovit në një plasdarm të revizionistëve sovjetikë kundër fqinjëve të saj, éshtë miku pulë i tyre.

Ne kemi shkruar edhe herë tjetër për politikën e udhëheqjes rumune, e cila, sidomos me vizitën e Niksonit në Rumani, u dha armë revizionistëve sovjetikë të tregohen më katolikë se papa, pavarësisht se ata vetë, haptazi e në prapaskenë, po kryejnë shumë veprime e komplate të poshtra e tragjike me kreun e imperializmit amerikan Nikson.

Atdheu mbrohet me siguri vetëm duke armatosur

popullin, duke armatosur partinë me ideologjinë e vërtetë marksiste-leniniste, me frymën e internacionalizmit proletar të vërtetë, me një politikë marksiste-leniniste realiste e kurajoze kundër kujtdo qoftë që shkel parimet e marksizëm-leninizmit dhe interesat jetikë të popullit, kur merren të gjitha masat për të krijuar unitetin e çeliktë në popull dhe bëhet një politikë antiimperialiste konsekiente kundër imperializmit amerikan, armikut më të egër të socializmit, të lirisë e të pavarësisë së popujve, dhe agjentëve të tij, midis të cilëve edhe Izraelit, dhe kundër revisionistëve sovjetikë, këtyre armiqve të tërbuar të marksizëm-leninizmit, të revolucionit socialist dhe të lirisë së popujve.

Partia dhe Qeveria jonë të vërtetën ia thonë hapur kujtdo. Ata që kanë iluzionin më të vogël se do të shpëtojnë nga kthetrat e revisionistëve sovjetikë me përkrahjen e imperializmit amerikan, duhet ta braktisin këtë rrugë.

Populli shqiptar ushqen ndjenja të miqësisë për popullin vëlla rumun dhe ka besim në çdo gjë të mirë e të shëndoshë të tij. Dhe gjëra të tilla populli rumun ka shumë. Vetë fakti që ai e kupton se revisionistët sovjetikë po i kërcënojnë atdheun dhe është mobilizuar që të mbrojë lirinë dhe kufijtë e vendit të vet tregon patriotizmin e tij. Dhe për këtë ai ka jo vetëm mbështetjen e Partisë së Punës e të popullit shqiptar, por edhe të të gjithë popujve përparimtarë të botës. Populli shqiptar do të qëndrojë kurdoherë i patundur përkrah popullit vëlla rumun kundër agresionit.

Nga ana e tyre, popujt sovjetikë nuk duhet të lejojnë dorën kriminale të klikës tradhtare Brezhnjev-

-Kosigin që të përsërítë ndaj popullit rumun tragjedinë e Çekosllovakisë. Po kështu, populli bullgar dhe ai hungarez nuk duhet të lejojnë që vendet e tyre të bëhen trampolinë agresioni kundër një vendi tjetër, siç është Rumania.

Nga planet e strategjisë globale agresive të klikës renegate të Bashkimit Sovjetik nuk është e përjashtuar edhe Jugosllavia. Kërcënimet dhe presionet e saj ndaj Jugosllavisë vitin e fundit kanë qenë mjaft të shpesh-ta dhe janë ushtruar me mjete të ndryshme e në drejtime të ndryshme. Revisionistët sovjetikë, kur kanë përballë popuj me nerva të fortë, detyrohen t'i bëjnë llogaritë të shtrënguara, pasi i pret disfata. Popujt e Jugosllavisë e kanë treguar gjatë gjithë historisë së tyre se nuk tremben. Edhe në kurthet e diplomacisë revizioniste sovjetike; që diplomaci ka vetëm fjalët, por prapa ka topat, ata nuk bien, siç mund të mendojë shefi i diplomacisë revizioniste sovjetike. Dhelpra, më parë se të futet në kotec, i bie rreth e rrotull atij përt'i trembur viktimat nga jashtë, për të futur panikun e diversionin brenda, që të arrijë në dobësimin e rezistencës së tyre. Pastaj e di vetë ajo si vepron me pulat: Mirëpo popujt e Jugosllavisë s'janë as pula, as budallenj.

Populli ynë i ka njojur popujt e Jugosllavisë gjatë Luftës Nacionalçirimtare kundër fashizmit italian e nazizmit gjerman. Ne kemi luftuar krah për krah dhe kemi derdhur gjak së bashku. Brigadat tona partizane janë hedhur në Jugosllavi e kanë luftuar së bashku me partizanët jugosllavë për çlirimin e Jugosllavisë. Ne kemi parë atëherë vendosmërinë e tyre për të mbrojtur pavarësinë dhe lirinë e popullit. Prandaj, pavarë-

sisht nga kundërshtimet e papajtueshme ideologjike e politike që kemi me udhëheqjen jugosllave, ne ripohojmë se me popujt e Jugosllavisë jemi vëllezër dhe, në qoftë se u rrezikohet pavarësia, do të jemi përkrah tyre.

Republika Popullore e Shqipërisë është një kështjellë e çeliktë socialiste dhe ajo dëshiron të ketë marrëdhënie të mira me të gjithë popujt fqinjë në bazë të parimeve të barazisë, të respektimit të sovranitetit kombëtar dhe të integritetit tokësor, të mosndërhyrjes në punët e brendshme dhe të respektit reciprok. Kush prek Shqipërinë, gjen vdekjen. Shqipëria socialiste shprehet me vendosmëri kundër kujtdo që shkel integritetin, pavarësinë dhe lirinë e çdo populli. Populli shqiptar do të mbajë, si kurdoherë, anën e viktimës kundër agresorit.

Rreziku i agresioneve të reja nga ana e imperialistëve amerikanë dhe e revizionistëve sovjetikë ndaj vendeve të ndryshme është real dhe ai nuk duhet zvogëluar. Por popujt nuk duhet të tremben nga ato. Në qoftë se do të janë vigjilentë, në qoftë se shpresat përmbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së tyre nuk i mbështetin kurrë as te fati, as te kompromiset me imperialistët e vjetër apo të rinj, por në luftën e vendosur e pa kompromis kundër çdo manovre e shantazhi, popujt janë plotësisht në gjendje të shkatërrojnë të gjitha planet agresive të imperialistëve të vjetër e të rinj.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i popullit»,
nr. 211 (6563), 4 shtator 1969.*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përbledhje
veprash) 1968-1970», f. 497*

KUFITARIN TA EDUKOJMË KURDOHERE ME FRYMËN DHE ME DISIPLINËN E RREPTË TË PARTISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

12 shtator 1969

Në përgjithësi jam dakord me trajtimin që iu bë këtu kësaj çështjeje, vetëm dëshiroj të theksoj që të metat e dobësítë nuk duhet të fshihen prapa vështirësive të punës në kufi. Këto tani relativisht janë zvogëluar dhe kushtet e punës atje, në krahasim me kohët e para, janë përmirësuar e do të përmirësohen më tej, se për këtë do të marrim masa të tjera të mundshme e të përshtatshme.

Nuk duhet pretenduar që të njëjtat aktivitete kulturore-artistike, që zhvillohen në zonat e tjera, të

1 Në këtë mbledhje raportuan komitetet e Partisë të rretheve Sarandë e Dibër për punën që bëhet nga komitetet dhe nga organizatat-bazë të Partisë për edukimin ideopolitik të forcave të kufirit.

zhvillohen edhe në kufi. Veç kësaj, ta kemi të qartë që aktivitete të tillë në repartet e kufirit nuk mund të zhvillohen njëlloj si, për shembull, në qytetin e Shkodrës ose të Peshkopisë. Kufiri është kufi, atje duhet të punohet vazhdimisht për të ngritur në shkallë të lartë vigjilencën. Kjo nuk do të thotë që oficerët dhe ushtarët e kufirit të privohen ngajeta kulturore. Kur diku aty afër jepet një shfaqje ose një film, kufitarët mund të shkojnë për ta parë atë me turne, por pa e lënë kurrë postën vetëm e të pasiguruar mirë dhe plotësisht. Duke vepruar kështu, brenda këtyre normave ata mund të marrin pjesë në jetën kulturore-artistike.

Askush të mos shkojë në kufi pa lejen e organeve kompetente, që mbajnë përgjegjësi të plotë për ruajtjen e tij. Arsyetimi se ata që venë të japid shfaqje në kufi janë njerëz të popullit, nuk është i bazuar. Popullin ta mësojmë dhe ta bëjmë të ndërgjegjshëm që ta kuptojë përsë shteti, duke shprehur vullnetin e klassës në fuqi, ka vënë disa ligje të veçanta për brezin kufitar, të cilat ai duhet t'i njohë dhe t'i respektojë. Populli vetë nuk lejon kurrë që brezin kufitar ta shkelë kushdo.

Disa shokë thonë se puna në kufi është e rëndë. Mua më duket se nuk është e drejtë të nisemi nga ky koncept, nga i cili lind pastaj pikëpamja se shokët oficerë dhe ushtarë që kryejnë atje detyrën patriotike të kufitarit, qenkan të sakrifikuar. Kjo nuk është e vërtetë; vetë shokët e kufirit e kuptojnë mirë se puna e gjithë ushtarakëve të tjerë, qofshin të ushtrisë ose të organeve të punëve të brëndshme, nuk është më pak e vështirë se puna e tyre. Kushtet e jetesës së kufita-

rëve janë më të vështira se ato të shokëve të tyre të ushtrisë ose të organeve të punëve të brendshme, që jetojnë në qytet, të cilët, po të duan, sa herë që janë të lirë, mund të venë në kinema, në stadium etj. Vettëm nga kjo anë puna e kufitarëve ndryshon vërtet nga ajo e të tjerëve që punojnë larg kufirit, kurse detyra e këtyre të fundit, siç e thashë, nuk është më pak e vështirë, bile ka raste që është më e vështirë. Ndonjë oficer kufiri mund të thotë se shumë herë i takon ta kryejë shërbimin natën. Po edhe oficeri i Sigurimit të Shtetit vigjilon dhe punon natën, bile ka raste që këtij i takon të rrijë edhe disa net me radhë pa gjumë.

Oficerët dhe ushtarët e kufirit në punën e tyre të vështirë, por fisnike, nuk janë vetëm. Rreth brezit të kufirit janë populli dhe komunistët që luftojnë e vigjilojnë njëlloj me ta. Në qoftë se këto kufitarët nuk i llogaritin në punën e tyre, ose nuk e organizojnë punën mirë, siç porosit Partia, bëjnë një gabim të madh. Partia ka përcaktuar drejt nga ana organizative çdo gjë për kufirin, prandaj këto rregulla duhen zbatuar me përpikëri, ndryshe, në rast se nënvleftësohen, detyra nuk ka si të kryhet mirë.

Pakësimi i shkeljeve të kufirit nuk tregon vetëm rritjen e vigjilencës së kufitarëve, por edhe të komunistëve e të popullit në brezin e kufirit. Atje ku komunistët dhe populli nuk kanë qenë vigjilentë në nivelin e duhur, as kufitarët nuk kanë qenë vigjilentë.

Punën e Partisë me njerëzit në kufi duhet ta ndërtojmë në bazë të situatës konkrete. Në qoftë se në një postë kufitare, fjala vjen, kemi tre anëtarë partie, të vëmë të gjitha forcat që këta t'i bëjmë shpuzë për të

zbatuar si duhet të gjitha ato detyra, që i theksoi shumë mirë në diskutimin e tij shoku Hysni, dhe të vënë në lëvizje aktivin e Partisë dhe organizatën e rinisë, që këto të bëhen mbështetje e fuqishme e organizatës-bazë të Partisë. Këtë punë duhet ta bëjnë kufitarët komunistë. Teserën e Partisë mund të mos e kenë ushtarët e kufirit, se janë akoma të rinj, kurse të gjitha cilësitetë e tjera të komunistit, sidomos shpirti luftarak, dashuria e thellë për popullin, për atdheun, për Partinë, ndjenja e urrejtjes për armikun, vendosmëria, gatishmëria dhe fryma e sakrificës etj. atyre duhet t'u rrënjosni thellë në ndërgjegje njëloj si edhe anëtarëve të Partisë. Organizatat-bazë të Partisë në kufi duhet t'u mësojnë aktivit të Partisë dhe rinisë edhe ligjet e rregullat e kufirit, për t'i bërë kufitarët të ndërgjegjshëm që t'i zbatojnë me rreptësi, me përpikëri e me ndërgjegje të lartë gjatë kryerjes së shërbimit në këtë sektor me shumë përgjegjësi. Këtë punë në asnje mënyrë të mos e neglizhojmë.

Puna edukative me rininë kufitare duhet të ndryshojë nga ajo që bëhet me rininë e terrenit, prandaj është e nevojshme që, shokët e Partisë dhe të rinisë që shërbejnë në kufi, të mendojnë më mirë për këtë çështje. Nevoja e lyp që kërkesat e punës edukative me rininë kufitare të jenë më të forta dhe format e saj të ndryshojnë nga ato që përdoren zakonisht me masën tjetër të rinisë, pse vetë natyra në kufi është e tillë. Atje ka, për shembull, sektorë të tillë ku kufitari, po të mos jetë në lartësinë e detyrës, po të mos jetë vigjilët vazhdimisht, rrezikohet orë e çast të goditet befasisht nga diversanti.

Kufitarin duhet ta edukojmë kurdoherë me fryshten dhe me disiplinën e rreptë të Partisë, se ai lufton me terrenin e vështirë, me diversantë e tradhtarë. Atij i duhet të përballojë vështirësitë e motit, shiun, borën, erën, tufanin, mjegullën, në kohën që djemtë e qyteteve shëtitin bulevardeve. Natyrisht, edhe këta duhet dhe po i mësojmë të përballojnë rrethana të vështira që mund t'u paraqiten gjatë jetës, megjithatë gjendja në terren është më e lehtë. Në qytete të rinjtë ecin në asfalt, kurse ushtarët në kufi mund të bien papritur në hon e në gërxhe, prandaj edhe edukata që duhet t'u jepet këtyre kërkohet të jetë e përshtatshme për të shmhangu rreziqet, ta ngrëjë vigjilencën e kufitarëve në shkallë të lartë, të rrënjosë tek ata ndjenjën e lartë të kryerjes me rreptësi e me përpikëri të detyrës së përditshme për ruajtjen e kufijve të atdheut. Me një fryshtë tillë mund dhe duhet t'i edukojnë të rinjtë kufitarë shokët tanë të vjetër e besnikë, komunistët dhe oficerët e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që Partia i ka caktuar të punojnë dhe që vazhdojnë të punojnë me ndërgjegje të lartë në kufi.

Anëtarët e organizatës së rinisë që kryejnë shërbimin në kufi, duhet t'i konsiderojmë si anëtarë partie që vetëm teserën nuk kanë, të cilën, siç tha shoku Hysni, shumë nga ata do ta marrin më vonë, prandaj, gjatë kohës që do të shërbejnë në kufi, të merren masa që të edukohen e të ngarkohen me detyra njëlloj si edhe anëtarët e Partisë, pse kufitarët luftojnë me vështirësi të mëdha në zona ku shpesh, në pjesën më të madhe të vitit, bën dimër i egër e kallkan.

Krahas punës së mirë edukative duhet të merren edhe masa që të plotësohen nevojat e domosdoshme për repartet e kufirit. Kufitarët, për hir të detyrës së lartë të ruajtjes së kufijve të shenjtë të atdheut, nuk i gjëzojnë disa të mira që ka qyteti. Ata janë të detyruar të jetojnë në male, në gërxhe, në vende të largëta e të izoluara dhe me ndërgjegje pranojnë të bëjnë sakrifica, por edhe shteti e ka për detyrë të mos i lërë të pavesur mirë, në një kohë kur nëpër qytete shohim gra e burra të bredhin dyqaneve e të ankohen se duan të blejnë përnjëherësh nga katër bluza najlon dhe nga tri palë këpucë me taka. Por, para se t'u plotësohen këto kërkesa qytetarëve, duhet të vishen e të mbathen me këpucë dhe me rroba të ngrohta kufitarët. Këta, dhomat ku banojnë, pas shërbimit të vëشتirë, t'i kenë të ngrohta, ushqimi t'u vejë në rregull, të merren masa që brenda normave të caktuara asgjë të mos u mungojë, librat t'u venë, gjithashtu, rregullisht dhe bile më parë se të tjerëve. Për plotësimin e nevojave të tillë duhet të merren masa serioze. Ministria e Punëve të Brendshme, brenda mundësive që ka shteti ynë, t'u plotësojë çdo nevojë reparteve të kufirit nga kontingjentet e caktuara dhe, në qoftë se këto nuk mjaftojnë, t'u japë të tjera. Në këtë drejtim të mos neglizhohet, nevojat e kufitarëve duhen plotësuar.

Për sa i përket çështjes që gruaja e qytetarit gjen punë më lehtë se ajo e oficerit të kufirit, kjo është e vërtetë, por shokët tanë besnikë që shërbejnë në kufi e kuptojnë se në majë të malit të Korabit, fjala vjen, nuk gjendet lehtë punë për gratë e tyre. Në pikat kufitare gratë mund të punojnë vetëm në kooperativat

bujqësore më të afërtë dhe, në qoftë se ndonjëra nuk dëshiron të punojë atje, faji për këtë është i burrit. Ky e ka për detyrë partie të punojë politikisht me gruan e vet që ta bindë atë për të punuar në kooperativë. Në rastet kur posta kufitare ndodhet në një vend që nuk ka fare punë për gratë e oficerëve, nuk kemi ç'bëjmë, jemi të ndërgjegjshëm se përkohësisht këto gra do të qëndrojnë pa punë, çështja e burrave të tyre do të shikohet më vonë, kur t'u vijë koha e qarkullimit etj.

Oficerët që kemi në kufi janë shokë të vjetër, besnikë dhe me kulturë. Kulturën e tyre nuk duhet ta shikojmë ngushtë, duke u nisur nga fakti se shumë nga ata kanë vetëm 7 ose 8 vjet shkollë. Patjetër do të ishte mirë që të gjithë këta të kishin nga 12 vjet shkollë, por kushtet në kufi janë të tillë që nuk mund të bëhet më shumë në këtë drejtim dhe shokët e kufirit e kuptojnë drejt. Veç kësaj, nuk duhet harruar që shumica e tyre, herë pas here, kanë bërë edhe kurse, pra, nuk janë njerëz me nivel të ulët kulturor dhe as që duhet t'i konsiderojmë të tillë. Oficerët tanë të kufirit janë, në radhë të parë, njerëz politikë dhe ushtarakë, ata kanë kryer të paktën nga një shkollë 7-8-vjeçare, kanë kryer kurse speciale, lexojnë çdo ditë gazeta, libra, materiale politike etj. Natyrisht, kiminë dhe fizikën, apo disa lëndë të tjera, shumë prej tyre nuk i njohin, por fundi i fundit ato nuk u nevojiten edhe aq për detyrën që u është ngarkuar, pse të gjithë enciklopedistë nuk mund të bëhen.

Si përfundim, mendoj se puna që bëhet në kufi është e mirë. Kufitarët tanë janë treguar kurdoherë në lartësinë e detyrës, të cilën e kanë kryer vazhdimisht

me ndërgjegje. Të metat, që u vunë në dukje, organizatat-bazë të Partisë do të përpiken t'i zhdukin me një punë më të mirë edukative politike.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

TË VAZHDOJMË ME KËMBËNGULJE DHE NË MËNYRË METODIKE EDUKIMIN E GJITHANSHËM TË KLASËS PUNËTORE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

12 shtator 1969

Çdo ditë që kalon ne kemi rezultate të mira dhe tē prekshme në forcimin e klasës punëtore, në edukimin e saj ideopolitik dhe në ngritjen tekniko-professionale. Kjo vërteton se puna e Partisë, e bashkimeve profesionale dhe e organizatave të tjera të masave tanë bëhet më e kualifikuar se më parë. Por kjo nuk përjashton tē meta dhe dobësi akoma serioze në punën e tyre, që ne duhet t'i shohim në sy, t'i kritikojmë dhe t'i ndreqim.

Edukimi i klasës punëtore është një punë shumë e gjerë dhe e koklavitur, që kërkon djersë dhe kujdes tē përditshëm, qartësi në vijë, forma dhe metoda të

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga Presidiumi i Këshillit Qendror të BPSH lidhur me disa probleme të punës së bashkimeve profesionale për edukimin ideopolitik të klasës punëtore.

shumta, të përshtatshme me gjendjen reale ekzistuese, duke mbajtur kurdoherë parasysh edhe gjendjen e kalluar, por edhe atë perspektive se ku duhet të arrijmë. Kombinimi i formave dhe i metodave të ndryshme është i domosdoshëm për ta kryer me sukses këtë detyrë të madhe, të vazhdueshme e në transformim të pandërprerë, siç është edukimi i gjithanshëm i klasës punëtore dhe i tërë masave të tjera punonjëse.

Prandaj Partia dhe organizatat e masave, duke pasur të qartë qëllimin e metodës dhe të formave që përdorin për edukim, në konsultim të vazhdueshëm midis tyre, duhet t'u sjellin përmirësimë formave dhe metodës, t'i zëvendësojnë ato me të reja e më revolucionare në bazë të situatave reale të krijuara nga zhvillimi ekonomiko-kulturor i kolektivit. Të vazhdosh me forma pune arkaike dhe të mos vendosësh të reja më të përshtatshme, nuk është e mirë dhe do të thotë të mos rrosh me nevojat që nxjerrin koha dhe zhvillimi. Ose të ndërrrosh forma e metoda orë e çast, të cilat, në fakt, nuk i përgjigjen gjendjes reale të një zone në fjalë, edhe kjo nuk është gjë e mirë.

Ju shokët e bashkimeve profesionale problemin që ju ka këshilluar Partia, edukimin dhe lartësimin e propagandistëve, e keni kapur drejt. Por mos u kënaqnë me aq sa keni bërë, konsiderojeni atë vetëm një fillim. Zbatoni detyrën më tej e vazhdimit me ta. Edukimi i propagandistëve do të luajë një rol vendimtar. Ndiqni me këmbëngulje rrugën që ka ndjekur dhe vazhdon të ndjekë Partia me mësuesit dhe me pedagogët. Propagandistët janë pedagogët e klasës punëtore, prandaj në zgjedhjen e tyre duhet të udhëhiqeni kur-

doherë nga dy kritere: besimi politiko-ideologjik dhe aftësia në zanatin (në lëndën) e edukimit. Për të dyja këto drejtime bazë Partia duhet të zhvillojë me propagandistët, si edhe me të gjithë agjitorët, një punë të vazhdueshme në formë kolektive në bazë rrëthi ose qendre pune, ose sipas çdo organizate-bazë partie ku këta shokë bëjnë pjesë si komunistë. Pra, të na preokupojë shumë dhe të vazhdojmë punën me ngulm për perfeksionimin e propagandistëve dhe të agjitorëve. Dhe për t'ia arritur mirë këtij qëllimi duhet forcuar disiplina e mësimit në radhë të parë në ta dhe, që t'uа transmetojnë këtë edhe të tjerëve, është i nevojshëm organizimi i mirë i studimit.

Shoh se po u vihet rëndësi formave të studimit kolektiv dhe bëhen diskutime për të gjetur forma të reja më të përshtatshme. Kjo është një gjë shumë e mirë që duhet të vazhdohet. Por nuk është forma e vetme. E dimë se është edhe forma e studimit individual. Mirëpo duhet të kuptohet mirë një gjë: studimi individual është në bazë të çdo forme studimi. Në rast se kjo formë nuk zbatohet, ose zbatohet keq, atëherë studimi i çfarëdollojshëm nuk do të bëhet mirë. Ky studim individual kërkon vullnet dhe metodë të veçantë, të përshtatshme për cilindo, që duhet edhe të ndihmohet, por edhe të ndihmojë veten.

Nuk është i drejtë mendimi se studimi individual është i përshtatshëm dhe më i realizueshëm për ata që kanë kulturë dhe një praktikë në të mësuarit vetëm. Edhe ai që s'e ka këtë praktikë, mund ta fitojë dhe duhet medoemos ta fitojë, pse edukimi kolektiv në fakt e mëson atë me metodën e mësimit dhe i kërkon

që vetë në shtëpi të fiksojë dhe të zgjerojë ato ç'ka dë-gjuar dhe ka shënuar. Pra, po nuk studioi secili vetë, nuk ka studim serioz.

Është, gjithashtu, i gabuar mendimi se njerëzit me kulturë dhe që kanë një praktikë të fituar në studimin individual, nuk kanë nevojë për studime kolektive e për diskutime kolektive të problemeve të ndryshme. Studimi individual kontrollohet me zor, lihet pas dore me shumë pretekste, të qena e të paqena. Prandaj duhet të ngulet këmbë shumë në këtë problem, të rekomandon edhe për këtë studim bazë format dhe metodat për të kapërcyer vështirësitë e për t'u fituar dalngadalë praktika.

Të vazhdohet të studiohen me kujdes të madh Historia e Partisë dhe materialet e tjera, me forma kurdoherë të përparuara e kurdoherë lidhur dhe ilustruar me problemet e kohës ose me problemet dhe me rezultatet e kaluara e të njoitura.

Partia dhe organizatat e masave, për ngritjen ideologjike e politike të klasës punëtore dhe të të gjitha masave punonjëse, kanë në duar materialet bazë të klasikëve të marksizëm-leninizmit e të Partisë sonë, të cilat kanë një rëndësi të jashtëzakonshme, ligjet dhe urdhëresat që organizojnë e drejtojnë ekonominë sociale dhe marrëdhëniet socialiste në prodhim. Të mos harrohet ose të mos nënveftësohet çështja se ngritja ideologjike dhe politike fuqizohet me punimin, me studimin dhe me thellimin e vazhdueshëm të këtyre ligjeve dhe urdhëresave. Këto duhet të zbatohen drejt, prandaj duhet edhe të kuptohen drejt. Të kuptohet se garant për zbatimin e tyre është vetëm ana shtetë-

rore, kjo është gabim, të kuptohet se vetëm Partia dhe bashkimet profesionale janë garantë për këtë zbatim, edhe kjo nuk është e plotë. Garantë për zbatimin e plotë të tyre janë të gjithë: Partia, pushteti, klasa punëtore, punonjësit, bashkimet profesionale dhe gjithë organizatat e masave. Prandaj këto ligje dhe urdhëresa duhet të kuptohen jo vetëm nga udhëheqësit, por njëkohësisht e njëlloj nga udhëheqësit e nga punëtorët; këto ligje duhet t'i zbatojnë jo vetëm punëtorët, por duhet të jenë këta, në radhë të parë, që të mos lejojnë asnjërin nga radhët e tyre ose nga udhëheqja, qoftë e Partisë ose ajo e pushtetit, që të mos i zbatojë ose t'i shtrembërojë këto ligje. Çdo veprim jashtë këtyre normave dëmton vijën e Partisë.

Lë të marrim çështjen e normave kolektive që ju shokë të bashkimeve profesionale na ngrini në raport, bille të alarmuar me të drejtë na keni paraqitur për këtë edhe një raport të veçantë, që këtu u diskutua mirë.

Problemi i normave kolektive ka qenë një eksperiment në provë. Udhëzimi i Byrosë Politike është i qartë, atje shënohen edhe anët pozitive, edhe rreziqet. Shënohet, gjithashtu, nga mund të rrjedhin rreziqet, në ç'forma mund të shfaqen këto, përse mund të shfaqen dhe si duhen luftuar dhe kapërcyer. Në këtë udhëzim theksohet, gjithashtu, ku duhet të vendosen normat kolektive e ku nuk duhet, vihet në dukje se në radhë të parë duhet të shpjegohet thellë ky problem, që punëtorët ta kuptojnë politikisht, ideologjikisht, që ata të shohin edhe leverdinë ekonomike të shtetit, edhe të tyren personale, të shfaqin lirisht mendimet dhe të ecet me kujdes. Në udhëzim thuhet, gjithashtu, se edhe atje

ku plotësohen këto kushte dhe vendoset kjo lloj norme, puna politike dhe ideologjike me njerëzit është një kusht i domosdoshëm dhe i vazhdueshëm.

Në ato ndërmarrje ku udhëzimi i Partisë u punua mirë dhe punëtorët tanë e kuptuan thellë, ku folën e diskutuan mbarë e mbërapsht dhe gjykuan se në këtë apo në atë sektor të ndërmarrjes së tyre mund të vendosej me sukses norma kolektive, çdo gjë na shkon mirë. Por edhe këtu «zelli i gabuar» i disa udhëheqësve e shtriu këtë normë edhe atje ku s'duhej e s'e lejonte udhëzimi i Byrosë Politike dhe kritikat e drejta të punëtorëve nuk u morën parasysh. Këta njerëz shtrembëruan kështu direktivën e Partisë dhe me emrin e saj abuzuan për të imponuar diçka të shtrembër. Këta janë fajtorë, siç janë fajtorë dhe ata që pranojnë një «urdhër të deformuar të Partisë» dhe, për t'i bërë bisht këtij deformimi, bëjnë një deformim tjetër në sistemin organizativ të skuadrës. Kur Partia zbulon shtrembërimet, atëherë nga fajtorët e vërtetë gjenden «arsyet», se gjoja në këtë kategori punëtorësh ose në atë tjetrën është i theksuar «interesi personal» etj., kurse fajet e tyre i zgjedhjenë ose i fshehin. Nuk ekskludohet që në disa «interesi personal» të predominojë, por edhe në këta disa, punëtorët janë më pak se të tjerët.

Klasa punëtore dhe Partia e saj e Punës nuk pranojnë «egalitarizmin» nën maskën e normës kolektive, siç mendojnë disa burokratë që kërkojnë t'u shpëtojnë telasheve e kokëçarjeve në kurrizin e punëtorëve. Klasa punëtore dhe Partia e saj nuk pranojnë që parazitetët në brigadë të fshihen prapa normës kolektive dhe, me

gjithë përpjekjet e kolektivit, ata të vazhdojnë të sigojnë të ardhura që nuk u përkasin; nuk lejojnë të mos vlerësohet kualifikimi i gjithsecilit dhe i vendit të punës e normat individuale brenda normës kolektive ose plan-detyrës. Nuk lejohet të akuzohen këta punëtorë të ndershëm, patriotë e punëtorë të palodhur se kur kritikojnë për të mbrojtur vijën, gjoja shohin interesin personal mbi atë shtetëror. Jo, këta punëtorë e mbrojnë diktaturën e tyre. Ju lutemi, ua çoni këto fjalë të mia shokëve punëtorë dhe ua shpjegoni mirë vendimet e drejta të Byrosë Politike për këtë problem e do të shihni pastaj çfarë do të thotë klasa punëtore.

A kanë të drejtë shokët punëtorë të mendojnë edhe për interesin personal dhe të familjeve të tyre? Sigurisht, kanë. Dhe ajo që e di më mirë se çdo klasë e shtresë tjetër se ky interes personal duhet lidhur ngushtë me interesin e përgjithshëm dhe se interesin personal nuk duhet të dominojë mbi atë të kolektivit, është klasa jonë heroike punëtore, që hidhet në zjarr në çdo moment për interesat e popullit dhe të Partisë së vet.

Prandaj, pa nënvleftësuar tendencat e gabuara në elementë të veçantë të klasës punëtore, Partisë, pushtetit, bashkimeve profesionale etj. u bie detyrë t'ua korrigojnë dhe t'ua luftojnë atyre këto tendenca, por njëkohësisht duhet theksuar se është e palejueshme si për Partinë në bazë, ashtu edhe për organet e pushtetit, që të shtrembërohen direktivat e udhëheqjes, siç është konkretisht rasti për problemin e normave kolektive.

Prandaj sa më parë dhe pa humbur kohë të vihet

në vend direktiva e Byrosë Politike për këtë problem të rëndësishëm. Atje ku ajo është zbatuar drejt dhe ka dhënë rezultate të mira, të vazhdohet me forcimin e edukatës politiko-ideologjike të punonjësve; atje ku janë bërë gabime, të ndreqen këto menjëherë dhe jo vetëm në mënyrë administrative, por të shpjegohet gjerrë ku kanë qenë gabimet dhe shtrembërimet. Ndërsa në ato raste ku nuk mund të vendosen norma kolektive, por në fakt janë vendosur duke shtrembëruar direktivën, duhen hequr sa më parë pa asnje hezitim dhe të shpjegohet përsë hiqen.

Problemrit të normave duhet t'i vëmë rëndësi shumë të madhe dhe të posaçme, duke e konsideruar këtë si një politikë nga më të rëndësishmet të Partisë dhe të shtetit. Normat nuk kanë vetëm anën teknike dhe ekonomike, por edhe anën politike dhe ideologjike të tyre. Prandaj po të interesohesh përciptas për normat, ose të mos interesohesh fare dhe t'ua lësh këto t'i vendosin «disa specialistë», ky problem nuk do të zgjidhet drejt dhe do të na krijojë kokëçarje politike.

Ne konstatojmë me kënaqësi se normat tejkalohen nga punëtorët. Ky duhet konsideruar një sukses dhe një meritë nga ana e klasës sonë punëtore. Ka disa që hiqen të zgjuar, duke thënë se kjo ngjet se punëtorët udhëhiqen nga «interesi personal». Kjo nuk është e vërtetë dhe është ofenduese për punëtorët. Punëtori lufton, tejkalon normën që të ndërtojë socializmin, që të lulëzojë jetën e popullit të tij, pjesëtar i të cilit është dhe ai vetë. Brenda këtij interesi të madh ai mendon dhe ka të drejtë të mendojë për interesin e tij personal, brenda normave, ligjeve, urdhëresave e mënyrës së

jetesës që kanë caktuar diktatura e klasës së tij dhe Partia e tij. Pikërisht se kanë menduar dhe kanë vepruar kështu drejt klasa punëtore dhe gjithë punonjësit, nën udhëheqjen e Partisë, janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen gjithë këto ndryshime kolosale në vendin e në shoqërinë tonë.

Punëtori, po t'i shpjegohet çdo gjë mirë politikisht, teknikisht, organizativisht, kupton jo vetëm rëndësinë e normës, të tejkalimit të saj dhe arsyet e vërteta të tejkalimit, por, kur norma është e lartë ose e ulët, kupton drejt dhe, sipas rastit, kërkon uljen ose ngritjen e saj. Ndërsa atje ku nuk punohet mirë ideologjikisht dhe politikisht ngjet që të gjenden edhe disa punëtorë, që, megjithëse janë pjekur kushtet për ngritjen e normave, jo vetëm nuk marrin iniciativën, por bëhen edhe pengesë për këtë dhe përpilen të mbajnë normat e vjetra, më të ulëta, të cilat realizohen e tejkalojen më lehtë. Kur vjen çështja për të ngritur normat, duhet të dëgjohet zëri i punëtorëve, pse kur kushtet janë krijuar të atilla që norma e caktuar është tejkalar shumë, kjo çështje s'duhet të mbetet vetëm një problem tekniko-ekonomik i ndërmarrjes, por në radhë të parë të bëhet një problem politiko-ekonomik i udhëheqjes së rrethit, e cila duhet të vejë në ndërmarrje, të bisedojë hapur, lirisht, me fakte, me argumente me punëtorët, me kolektivin dhe jo me një apo me dy veta. Ndryshe do të dilet, mendoj, me konkluzione të gabuara. Kur problemet zgjidhen vetëm në mënyrë teknike dhe ca më keq burokratike, ato do të jenë të njëanshme dhe me gabime.

Prandaj, për ngritjen e normave, kur shihet se

ato tejkalohen, përveç procedurës teknike, duhet zhvilluar kurdoherë edhe një punë e gjerë politike për t'u shpjeguar qartë punonjësve këtë fenomen të zakonshëm në një ekonomi socialiste, ku ka rezerva kaq të mëdha, që ata ta kuptojnë si dhe përse duhet proceduar në këtë ose në atë mënyrë.

Dëshiroj të theksoj shkurtimisht edhe dy çështje të tjera:

Së pari, duhet pranuar se, megjithëse në përgjithësi kuptohen drejt interesit i përgjithshëm, i kolektivit dhe ai personal, si dhe raporti midis tyre, mjaft herë ngre veshët interesit personal ose i grupit dhe vihet ky mbi atë të përgjithshmin. Një fenomen i tillë shfaqet edhe në individë, por edhe në drejtues ndërmarrjesh apo kooperativash bujqësore, prandaj Partia duhet ta forcojë akoma më shumë punën edukative në këtë drejtim. Natyrisht, nuk është kuptuar drejt çështja e interesit të përgjithshëm, kur ndonjë kooperativë bujqësore, duke parë ngushtë interesin e grupit dhe duke e vënë atë mbi interesin e përgjithshëm, neglizon mbjelljen e bimëve, si, bie fjala, të perimeve, për të cilat kanë nevojë masat e popullit, nën pretekstin se gjoja nuk kanë leverdi. Në vend që të ndjekin këtë rrugë të gabuar dhe të mos kenë parasysh interesin e përgjithshëm, do të jetë më e drejtë që kryesitë e këtyre kooperativave të mendojnë si të përmirësojnë punën, në mënyrë që edhe perime të prodhojnë, për të plotësuar kështu nevojat e popullsisë, edhe rendimentet t'i rritin për të siguruar kështu leverdi për kooperativën.

Së dyti, për tejkalimin e planeve Partia ka theksuar vazhdimisht nevojën e përdorimit të gjerë të

stimujve moralë. Por duhet thënë se në disa raste përdorimi i tyre nuk është kuptuar si duhet. Kur stimujt moralë, si për shembull dekoratat, jepen me fushata nga 200 njëherësh, atëherë këto e humbasin vlerën, ndërsa kur ato apo fletëlavadërimet etj. u jepen atyre që dallohen, kur bëjnë një punë të lavdërueshme, pa dyshim një stimul me vend si ky bën efekt dhe ne do të shohim rrjedhimet e tij si në rritjen e rendimentit të punës, ashtu edhe në fushën e interesit të përgjithshëm e të atij personal.

Një problem tjetër që ngrihet në raportin e bashkimeve profesionale apo në atë të Kombinatit të Tekstileve në Berat është vendosja, fiksimi i klasës punëtore të re. Ne shohim një shpërdorim të keq të kohës së punës. Natyrisht, atje ku kjo ngjet është shumë serioze dhe Partia, pushteti dhe bashkimet profesionale duhet ta studiojnë me seriozitet këtë fenomen, të marrin masa dhe ta likuidojnë, se na dëmton ekonomikisht dhe politikisht. Kombinati i Tekstileve në Berat është një qendër pune e re, e madhe, që do të arrijë në rreth 7 000 punëtorë, ku shumica dërrmuese janë vajza të reja dhe gra. Lidhur me këtë kombinat ngrihen shumë probleme, veçanërisht politike, ekonomike, të banimit etj., për të cilat unë kam biseduar edhe me ministrin, edhe me sekretarin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Beratit. Problemi i strehimit për punëtorët e këtij kombinati, natyrisht, nuk mund të zgjidhet në një vit, por këtij i duhet futur seriozisht. Mirëpo vihet re se, kur prishen një së-rë dyqanesh për të zbuluar qytetin dhe kërkohen të holla për t'i zëvendësuar këto me lokale të tjera të

reja, lihen mënjanë banesat për punonjësit, nuk ruhet prioriteti dhe nuk ndërtohen çerdhet, kopshtet, mensat e një sërë objektesh të tjera të domosdoshme për këtë kombinat gjigant.

Mbi çdo gjë, ashtu si në Kombinatin e Tekstileve në Berat, si dhe kudo ku venë punëtorë të rinj në moshë, duhet intensifikuar puna politike. Një nga arsyet, veçanërisht në përdorimin e keq të kohës së punës, mendoj se është mungesa e disiplinës dhe moskuptimi i drejtë i saj si nga ana politike, ashtu edhe si disiplinë shtetërore socialiste.

Arsyeja e dytë për mosshfrytëzimin si duhet të kohës së punës duhet të jetë organizimi i dobët shtetëror i punës dhe më në fund liberalizmi i dëmshëm i udhëheqjes, i mjekëve e i të gjithë atyre që, pa qenë as liberalë, as oportunistë, duhet të jenë shembull drejtësie e mirëkuptimi në zbatimin e disiplinës në punë.

Në të gjitha këto qendra të reja pune, ashtu si dhe në të vjetrat e kudo në vendin tonë, gumëzhijnë probleme shoqërore, të cilat në përgjithësi zgjidhen mirë e me sukses, por duhet të vazhdohet një punë intensive nga Partia dhe nga levat e saj, sidomos për barazinë e plotë nga çdo pikëpamje të gruas me burrin. Shteti duhet të vazhdojë të marrë masa konkrete për ta mbështetur fuqimisht këtë aksion politiko-ideologjik dhe veçanërisht në marrëdhëniet e gruas në prodhim.

Për të bërë një punë edukative të diferencuar, bashkimet profesionale kanë vepruar mirë që kanë përcaktuar pak a shumë në vija të trasha këtë diferencim në gjendjen kulturore, sidomos të fshatarësisë,

pse vetëm kështu mund të bëhet një edukim i diferençuar për të arritur nga më i ulëti në më të lartë. Natyrisht, hasen pengesa në këtë punë dhe sidomos nga lëvizja e fshatarëve. Por këtu nuk kemi ç'bëjmë. Me shtimin e popullatës në fshat dhe në qytet, do të arrihet edhe zvogëlimi i lëvizjeve, të cilat edhe tani bëhen të organizuara. Këto i kërkojnë kushtet konkrete të zhvillimit të ekonomisë dhe format e edukimit duhet t'ia përshtatim këtij zhvillimi ekonomik dhe jo zhvillimin ekonomik t'ua përshtatim formave të edukimit.

Për karakterin ideologjik të thashethemeve

Ashtu si në gjithë punën politiko-ideologjike të përditshme, nga sa shkruhet vazhdimisht në shtyp, si dhe në raportet që na janë paraqitur, del se Partia ndeshet me thashethemet. Dëshiroj tani të them diçka ç'janë këto si shfaqje, ku e kanë burimin, ç'përfaqësojnë dhe ç'synojnë, duke menduar se kjo mund të shërbejë për t'i luftuar.

Thashethemet janë karakteristika të mikroborgjezit, kanë, pra, karakter mikroborgjez, janë shfaqje të ideologjisë borgjeze. Ato janë produkt i subjektivizmit dhe s'kanë asgjë të përbashkët me kritikën e shëndoshë realiste dhe konstruktive. Përkundrazi, karakteri i tyre është denigrues, shumë herë shpifës, me qëllim apo pa qëllim qofshin. Të shumtën e herës thashethemet janë të pabazuara dhe rrallë e tek, kur kanë njëfarë baze, ato kthehen prapë në denigruese

nga forma si zhvillohen dhe nga vetë gjykimi subjektiv i individit që bën interpretimin e një çështjeje që ka njëfarë baze. Edhe në këtë rast, interpretim pas interpretimi nga individë të ndryshëm që përdorin vesin e keq të thashethemeve, këto i kthejnë në shpifje, në denigrim. Kjo është metoda më e ndyrë e mikroborgjezit. Në këtë metodë s'ka asgjë parimore, të shëndoshë. Ajo nuk mund të quhet në asnje rast një kritikë konstruktive, pse deformon faktet, shpif gjëra të paqena, me qëllim o pa qëllim, bën interpretime të gabuara, të cilat i zhvillon vesh më vesh prapa krahëve dhe në dëm të objektit që vë në shenjë.

Thashethemet nuk kanë kurrë për qëllim korrigjimin e objektit dhe as të kolektivit, përkundrazi, si individin, ashtu edhe kolektivin ato e dëmtojnë rëndë. Ata që e praktikojnë këtë metodë, hiqen si moralistë, pse kurdoherë u japin thashethemeve ngjyrën e një «koncepti moral të lartë», kurse në realitet ai është një koncept amoral, qoftë në formimin e tij në frymën subjektiviste, qoftë në themelat ku bazohet, qoftë në format organizative që përdor dhe në qëllimet që kërkon të arrijë. Ata që i përdorin si metodë me gjoja përbajtje politike thashethemet (që në fakt mund të zhvillohen në fusha të ndryshme), nuk mund të kenë në vetvete një politikë të shëndoshë, për arsy se njerëzit me pikëpamje të tillë subjektiviste, duke përdorur metodën mikroborgjeze të thashethemeve, nuk mund të jenë kurrë në gjendje të bëjnë një analizë të vërtetë të gjendjes politike duke analizuar faktet reale dhe në mënyrë objektive. Metoda e organizimit të punës së thashethemeve nuk mund të jetë metoda e

një analize të shëndoshë politike. Ata që përdorin metodën e thashethemeve, pa u gabuar mund të themi se janë ose oportunistë, ose lajkaxhinj, ose sektarë, ose konservatorë.

Thashethemet, përveç atyre që thashë më lart, shkaktojnë grindje, zënka, mëri, deri edhe vrasje. Ato shkaktojnë një pertubacion në shoqëri, në unitetin e saj të harmonishëm ideopolitik, por janë edhe një formë lufte klasash nga ana e borgjezisë së rrëzuar nga fuqia për t'i krijuar vështirësi diktaturës së proletariatit, për të shqetësuar moralisht dhe në gjërat më intime njerëzit e shëndoshë të shoqërisë sonë. Duhet kuptuar se një metodë e tillë me përbajtje e me karakter reaksionar nuk mund të vërë në shenjë për të diskredituar e për të diskriminuar veçse ata që në radhë të parë u bëjnë një luftë të pamëshirshme thashethemeve.

Të luftosh pa mëshirë thashethemet në konceptet dhe në format borgjeze e mikroborgjeze që bëhen, nuk do të thotë të fshehësh gabimet e vërtetuara në çdo lëmë qoftë, politik, ideologjik, moral apo organizativ. Përkundrazi, kritika kundër tyre duhet të bëhet në baza të shëndosha parimore, e faktuar mirë, e hapët, sy më sy ose përpëra kolektivit, kur të shihet e nevojshme dhe jo duke bërë supozime. Kritika duhet të karakterizohet në çdo rast nga një qëllim moral, politik, ideologjik, të ketë karakter edukativ për individin ose për kolektivin, të mos ketë kurrë për qëllim ta dërrmojë moralisht të kritikuarin, përkundrazi, të synojë t'ia ngrejë moralin për t'i ndrequr gabimet. Më në fund kritika ndaj njerëzve që bëjnë gabime në

jetën private ose atje ku punojnë, nuk duhet të bëhet objekt dominues që të mbulojë, të errësojë dhe të pengojë zgjidhjen e drejtë të problemeve kryesore që preokupojnë Partinë dhe shtetin. Këtë e them se shumë herë në organizatat-bazë të Partisë hapen debate të atilla për kritika njëri-tjetrit në forma që jo vetëm bëjnë të lihen mënjanë problemet kryesore, jo vetëm shqetësojnë organizatën, por ngandonjëherë prishin edhe unitetin e saj.

Disa herë kënaqemi duke thënë se thashethemet «nuk kanë karakter politik». Ky është një vlerësim i gabuar. Ato kanë karakter politik dhe ideologjik, pikërisht se kanë futur grindjen dhe përçarjen në organizatë. Problemi vihet jo të mos kritikohen ata që gabojnë, ata duhet të kritikohen patjetër në format dhe për arsyet që thashë më lart, por ne duhet të ruhemë shumë nga kritikat e bazuara në thashethemet, në kritikat subjektiviste dhe nga qëllimet e tyre dërrmuese dhe joedukative.

Prandaj nga Partia duhet të kuptohet si duhet rrezikshmëria politike, ideologjike dhe organizative e thashethemeve, që të mund të luftohen dhe duhet të luftohen me ashpërsi. Në qoftë se nuk kuptohet mirë rrezikshmëria e tyre nga komunistët, në qoftë se këta në jetë bien në praktikën e kësaj metode mikroborgjeze, thashethemet do të kalojnë edhe në Parti, e cila pastaj nuk do të jetë dot në gjendje ta luftojë këtë ves të keq në masat. Prandaj të mprehim vigjilencën dhe ta luftojmë këtë ves të keq kur të shfaqet, në radhë të parë në veten tonë, në Parti dhe në masat.

Në përgjithësi me sharje, me thashetheme merren

njerëzit pa punë, por nuk janë vetëm këta. Në radhë të parë këtë ves të keq do ta gjejmë tek ata që nuk janë të ngritur politikisht dhe ideologjikisht, që bëjnë një jetë kulturore të zbrazët, që nuk rrojnë dhe nuk luftojnë si duhet së toku me idetë e reja që zhvillojnë Partia dhe masat. Bartës të thashethemeve janë të krimburit me paragjykime prapanike ose ata që nuk shkëputen dot nga mënyra e jetesës dhe nga format arkaikë të jetës e nga zakonet e së kaluarës. Por të tillë janë edhe ata që hiqen të modernizuar, por që ky farë modernizimi nuk është veçse një degjenerim i karakterit dhe një stërhollim akoma më i rrezikshëm i thashethemeve.

Kafetë ose kafenetë dhe vizitat te njëri-tjetri në të kaluarën kanë qenë përdorur gjérësisht për thashetheme. «Shkojmë kohën», thoshin, duke kritikuar dhe duke mbajtur nëpër gojë njërin e tjetrin, mbarë e mbrapsht. Një mënyrë e tillë jetese, megjithëse ka pësuar ndryshime të mëdha, vazhdohet akoma. Qahen me të drejtë shokët se janë hapur shumë kafene. Ndognë urdhër që të hapen shumë kafene nuk është dhënë, prandaj fajin për këtë nuk e ka kush veçse vetë shokët e rretheve, që qahen dhe që i lejojnë. Këtë çështje unë nuk e ngre që të mbyllen të gjitha kafenetë, se kjo nuk do të jetë një masë e drejtë. Kjo çështje nuk duhet parë vetëm nga ana tregtare, por edhe nga ana e nevojës që kanë punonjësit. Që kafeneja të bëhet një vend me të vërtetë çlodhjeje të kulturuar, në radhë të parë kjo varet nga vetë klientët që e frekuentojnë, nga mentaliteti, nga ngritja ideologjike dhe politike e tyre, varet nga qëllimi që i vënë vetes njerëzit

kur shkojnë në kafene. Në qoftë se ndonjë shkon në kafene për të braktisur shtëpinë dhe familjen, në rast se shkon me qëllim që të pijë e të dehet, në rast se shkon për t'u ulur dhe për të marrë nëpër gojë kush hyn e kush del atje ose për të parë kush kalon në rrugë, apo shkon atje për të bërë skandale, atëherë kafeneja kthehet në një vend korruptioni, në një vend thashethemesh. Kuptohet se fajin në këtë rast nuk e ka ndërtesa e kafenesë, po njerëzit që e frekuentojnë atë. Prandaj as kafene nuk duhet të hapim shumë, por në radhë të parë është e nevojshme të punojmë për edukimin e njerëzve, pse në rast se nuk bëhet kjo që është e para, të tillë njerëz të paedukuar medoemos do t'i zhvillojnë gjetkë veset e tyre të këqija, ata do të invadojnë institucionet tona kulturore që nuk quhen kafene, por që lehtë mund të kthehen në kafenera.

Prandaj kemi shumë për të bërë për edukimin e klasës punëtore dhe të punonjësve. Sa gabim bëjnë ata shokë që në letrat që më dërgojnë më shkruajnë fraza të tillë: «Ligjet e kanunit të Lekës i groposëm thellë dhe përgjithmonë», «kishat u mbyllën dhe prifti i fundit u zhvesh, influenca e fesë u zhduk» e të tjera fraza të tillë të papjekura. Këta shokë, natyrisht, nuk mendojnë një grimë se është zor të vënë Partinë dhe mua në gjumë me fraza bombastike si ato që përmenda, por këtu, qoftë dhe pa qëllim, ka një tentativë gjenjeshtre, mashtrimi ose mosthellimi të situatës politike, ideologjike dhe shoqërore në ato vende ku këta shokë jetojnë dhe punojnë. Rezultatet e mëdha të arriitura janë relative në krahasim me ato që duhet të arrijmë dhe që t'i arrijmë ato ne duhet të kapërcejmë

akoma shumë pengesa, të cilat zhduken me luftë e me përpjekje dhe jo me fjalë boshe e me mburrje. Ngritja politiko-ideologjike, puna e organizuar mirë dhe thjeshtësia komuniste e karakterit bëjnë që të kapërcehen vështirësitë dhe të arrihen sukseset që dëshirojmë.

*Botuar për herë të parë në
broshurën: Enver Hoxha.
«Të vazhdojmë me këmbë-
ngulje dhe në mënyrë me-
todike edukimin e gjithan-
shëm të klasës punëtore».
Tiranë, 1969*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Raporte e fja-
lime 1969-1970», f. 115.
Tiranë, 1970*

SHFRYTËZIMI I MUNDËSIVE PËR FURNIZIMIN E TIRANËS DO TË LEHTËSOJË FURNIZIMIN E MBARË VENDIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

13 shtator 1969

Pavarësisht se si do të vendosim për këtë problem, dëshiroj të shfaq edhe unë disa mendime. Më duket se, megjithëqë në studimin e paraqitur bëhet fjalë vetëm për furnizimin e Tiranës me qumësht e me perime, qëllimi është që të zgjidhet më mirë edhe problemi i furnizimit të rretheve të tjera, të cilat, duke furnizuar kryeqytetin, kanë dobësuar furnizimin e popullatës së tyre. Kjo që kërkojmë të bëjmë nuk është ndonjë privilegji i veçantë për Tiranën, por është një masë e domosdoshme, mbasi popullsia e kryeqytetit është e barabartë me atë të qyteteve Shkodër, Durrës dhe

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth studimit «Mbi rrugët më të përshtatshme për zgjidhjen e shpërpjesëtimit midis nevojave të furnizimit të Tiranës me qumësht, bulmetra e perime dhe mundësive e mbulimit të këtyre nevojave kryesisht nga vetë rrethi i Tiranës».

Elbasan, në mos edhe të ndonjë tjetri, të marra së bashku.

Më drejt çështja do të shtrohej kështu: ka apo s'ka mundësi në situatën e tanishme që tokat rreth Tiranës, duke bërë disa investime shteti, t'i shfrytëzojmë më mirë për të plotësuar nevojat e kryeqytetit, me qëllim që të lehtësojmë furnizimin e rretheve të tjera dhe të mbarë vendit? Sigurisht, kjo nuk do të thotë që tani t'i përqendrojmë të tëra investimet e caktuara për bujqësinë vetëm në Tiranë, pse, ashtu si kurdoherë, edhe këtej e tutje do të vazhdojmë të udhëhiqemi nga politika e drejtë e Partisë për zhvillimin e harmonishëm të bujqësisë në të gjitha rrethet e vendit. Investimet e parashikuara për zhvillimin e bujqësisë në shkallë republike nuk do t'i prekim, prandaj, për të rritur investimet për Tiranën, të shohim ç'mundësi të tjera materiale kemi si shtet e ç'mundësi të brendshme ka vetë rrethi dhe këto t'i inkludojmë në planin tonë të ardhshëm të bujqësisë. Kështu, pa cenuar investimet e parashikuara për rrethet e tjera, bujqësia në Tiranë do të ecë disa hapa më përpara dhe mundësitë që të bëhen këta hapa më duket se ekzistojnë.

Po për çfarë ka nevojë Tirana? Ajo ka nevojë për të gjitha ato që kanë nevojë edhe rrethet e tjera, por, duke marrë parasysh popullatën e saj të shumtë, këtu vështirësitë janë më të mëdha dhe pikërisht për t'i kapërcyer këto është e arsyeshme që të marrim disa masa të veçanta.

Ju shokë të Ministrisë së Bujqësisë ngrini çështjen se, po të zgjidhet ky problem vetëm për Tiranën, atëherë do të ankohen Elbasani apo Durrësi, që kanë

të njëjtat vështirësi. Unë mendoj që, në qoftë se ne, brenda vijës dhe normave të Partisë, marrim disa vendime të drejta për të përballuar nevojat në rritje të popullatës së madhe të Tiranës dhe ua shpjegojmë arsyet shokëve të Elbasanit dhe të Durrësit, këta jo vetëm nuk kanë ç'të thonë, por do të jenë plotësisht dakord.

Në rast se do të ngarkonim tri-katër ndërmarrje të mëdha bujqësore për ta furnizuar Tiranën vetëm me perime e me qumësht dhe do të ndryshonim strukturën dhe orientimin e tyre për këtë qëllim, nuk do të vepronim mirë. Orientimin e ndërmarrjeve bujqësore është e domosdoshme ta studiojmë mirë, se është një problem mjaft i koklavitur. Tiranës nuk i duhen vetëm qumësht e perime, por edhe drithë e prodhime të tjera, prandaj kërkohet shumë kujdes për të përcaktuar se cila nga ndërmarrjet bujqësore do të ketë orientim për prodhim drithërash, cila për drithëra e qumësht dhe cila për drithëra e lloje të tjera.

Për t'i sigruuar Tiranës qumësht e perime përtani dhe për perspektivën, kemi bërë investime jo vetëm në territorin e rrethit të saj, po edhe gjetkë, si në Ndërmarrjen Bujqësore të Thumanës e në atë të Sukthit, nga të cilat kam mendimin që edhe në të ardhmen të tërheqim një sasi prodhimesh për të furnizuar kryeqytetin. Unë nuk jam për t'i démtuar këto dy ndërmarrje, pse as Thumana, as Sukthi nuk i kanë të tepërtë prodhimet, përkundrazi, prodhimet e tyre janë akoma të pakta dhe u nevojiten shumë punonjësve të rretheve përkatëse, por derisa të krijojmë siguri në furnizimin e kryeqytetit, që aktualisht ka nevoja të mëdha, ato nuk mund t'i çlirojmë nga kjo

detyrë. Sidoqoftë, me masat që do të marrim brenda mundësive tonë, duke filluar nga viti tjetër ose pas dy vjetësh, ndërmarrjet bujqësore jashtë rrëthit të Tiranës duhet t'i lehtësojmë nga kjo detyrë, që të mund të bëhet më mirë edhe furnizimi i qyteteve dhe i rrëtheve të tjera. Kësaj do t'ia arrijmë vetëm në rast se këtë sasi prodhimesh bujqësore e blegtore, që tanë e marrim prej tyre, do ta sigurojmë nga ndërmarrjet dhe nga kooperativat bujqësore fushore të rrëthit të Tiranës. Prandaj na vihet detyra që, me investimet që do të bëjmë në ndërmarrjet dhe në kooperativat bujqësore të Tiranës, për rritjen e numrit të lopëve, për shtimin e frutave e të perimeve dhe, në qoftë se parqitet urgjente, edhe për qarkullimin e llojeve të binëve, të synojmë që qumështin, perimet dhe frutat t'i sigurojmë brenda këtij rrëthi.

Këtu u diskutua edhe çështja e kalimit të disa kooperativave bujqësore të Tiranës në ndërmarrje bujqësore. Lind pyetja: Këto kooperativa, që propozohet të shkrihen në ndërmarrje bujqësore, janë të prapambetura apo të përparuara? Unë mendoj që ato nuk janë të prapambetura, disa prej tyre janë mesatare, disa të tjera pak mbi mesataren, prandaj ministri i Bujqësisë nuk duhet të na i barazojë me ato të Labovës së Zhapës apo të Erindit në Gjirokastër. Sipas mendimit tim, këto u përmendën këtu pa vend. Shembulli që mori ai nuk mund të shërbejë si argument i përshtatshëm për të vërtetuar pikëpamjen e tij që këto kooperativa nuk duhet t'i futim në ndërmarrje bujqësore. Futja e disa kooperativave, që nuk kanë toka të mira, në një ndërmarrje bujqësore, natyrisht, e rëndon këtë, por kur ato kanë

fusha, siç është rasti i kooperativave të rrëthit të Tiranës, një masë e tillë nuk e dëmton ndërmarrjen. Nuk është as e rekomandueshme që ti ministër i Bujqësisë, të na thuash se Ndërmarrjes Bujqësore të Kamzës i qenkan ulur rendimentet mesatare, për arsyetë futjes në të tokave të ish-kooperativës bujqësore të Çerkez-Morinës. Ti vetë e di, po edhe ne gjithashtu e dimë, që rendimentet asaj i janë ulur për arsyetë tokave të hapura rishtas, që kjo ndërmarrje i mori nga ushtria, nga të cilat nuk mund të merren prodhime njëlloj si nga tokat që janë përmirësuar prej kohësh. Kurse tokat e kooperativës bujqësore të Leknasit, që, me këto masa, parashikohet të bashkohet me Ndërmarrjen Bujqësore të Kamzës, nuk janë si ato që hapi ushtria, prandaj as ky shembull nuk mund të sillet si provë për të na bindur të pranojmë tezën tënde.

Le ta shikojmë tanë këtë çështje edhe nga ana ideologjike. Po të bëhej thjesht bashkimi i këtyre 20-25 fshatrave kooperativiste me ndërmarrjet bujqësore, mendoj, siç thanë dhe shokët, që kjo do të ishte një masë e tepruar. Kur është paraqitur nevoja dhe kur kanë qenë dakord fshatarët, ne kemi futur përnjëherësh në ndërmarrje bujqësore nga një, dy, dhe, tek-tuk, nga tri kooperativa, prandaj mendimi për të futur në të njëjtën kohë 25 fshatra duket sikur nuk është i arsyeshëm. Mirëpo, po të shohim nevojat që ka Tirana, të cilat duhet t'uua shpjegojmë dhe t'uua argumentojmë komunistëve dhe masave kooperativiste, bindemi që është me vend të merren këto masa dhe kam besim se edhe kooperativistët do të na kuptojnë drejt. Vija e Partisë nuk ndryshon po të futim për-

njëherësh disa kooperativa në ndërmarrje bujqësore, sepse me këtë masë ne nuk e shndërrojmë tërësish në shkallë republike pronën kolektive të grupit në pronë shoqërore. Në rastin konkret na detyrojnë kushtet ta bëjmë një gjë të tillë vetëm pjesërisht për disa kooperativa të rrethit të Tiranës dhe ky veprim nuk është aspak në dëm të kooperativistëve.

Të flasim më konkretisht. A ka mundësi që këto kooperativa, qofshin 4 ose 25 (këtu sot mund të mos vendosim sa), në nivelin që janë aktualisht dhe me ritmin e zakonshëm të zhvillimit, t'i plotësojnë nevojat e Tiranës? Jo vetëm me ritmin aktual që ecin kooperativat bujqësore, por edhe duke e ngritur nivelin e prodhimit nga viti në vit, në mënyrë shumë më të kënaqshme nga ritmi i tanishëm, mendoj se plotësimi i nevojave të Tiranës, natyrisht, nuk e kam fjalën për të gjitha nevojat e saj, është i pamundur. Në këto kushte, që këto kooperativa të arrijnë të plotësojnë një cak furnizimi të kënaqshëm për Tiranën, pa hequr dorë, por kurdoherë duke i zvogëluar furnizimet që vijnë nga ndërmarrjet e Thumanës e të Sukthit dhe duke i ndërprerë fare furnizimet nga Korça dhe nga rrethet e tjera të largëta, duhet medoemos t'i ndihmojmë ato dhe për këtë ka dy rrugë:

Njëra rrugë do të ishte që kooperativat të mos futeshin në ndërmarrje bujqësore, por të merreshin masa konkrete për t'i ndihmuar me mjete të mekanizuara, me kafshë e bagëti, me kredi për të sistemuar fushat, me materiale për të ndërtuar stalla etj., kurse rruga tjetër do të ishte futja e tyre në ndërmarrje bujqësore.

Të supozojmë sikur ne do të ndjekim rrugën e parë. Atëherë lind problemi: Kooperativat e Tiranës do të ndërtojnë stalla moderne si ato të Kamzës? Në qoftë se mendohet që stallat ato t'i bëjnë në këtë mënyrë, kjo nuk do të ishte e drejtë, edhe sikur këto kooperativa të futeshin në ndërmarrje bujqësore. Për cilindo variant që na është propozuar të vendosim, stallat ekzistuese duhet t'i shfrytëzojmë në mënyrë maksimale, sigurisht, duke i modernizuar gradualisht gjithnjë e më shumë, kurse për viçat e rinj mund dhe duhet të ndërtojmë stalla të reja. Në qoftë se kooperativat në fjalë nuk do të futen në ndërmarrje bujqësore, stallat për viçat duhet të bëhen më moderne se ato të tanishmet, por në asnje mënyrë të mos shpenzohen qimet e kokës për ndërtimin e tyre.

Edhe po të ndiqet rruga e dytë, shpenzimet që do të bëhen do të jenë të njëjta, më duket mua. Në këtë variant mbetet për t'u studiuar çështja e pagave dhe ajo e vlerësimit të pasurive, siç janë pendët e qeve, bagëtitë etj., që do t'u blihen kooperativave, në rast se këto do t'i futim në ndërmarrje bujqësore. Ky është një problem i veçantë, që duhet llogaritur mirë, se nuk mund të fshihet me një të rënë të lapsit.

Sidoqoftë, shpenzimet në të rastet do t'i bëjë shteti, kurse kanalet e para dhe të dyta mendoj që kooperativat duhet t'i bëjnë vetë me forcat e tyre. Në vendin tonë edhe ata punonjës që nuk kanë të bëjnë fare me kanale, në fryshtë e solidaritetit socialist, shkojnë punojnë vullnetarisht larg familjes, pa i paguar njeri, për hapjen e kanaleve, të tjerë venë punojnë në hekurudha, në tarraca etj. Jo vetëm kaq,

por, edhe pasi punon 8 orë, punëtori i fabrikës ose i ndërmarrjes bujqësore vete punon vullnetarisht për të ndërtuar banesa. Atëherë, përsë të mos punojë për të bërë kanale kooperativisti i Mézezit, kur me anën e tyre do të ujiten tokat e kooperativës së tij? Me këtë dua të them, se, po t'i llogaritim këto gjëra në mënyrë shumë strikte dhe të parashikojmë që çdo gjë ta bëjë shteti, do të na duhen shumë para. Natyrisht, disa investime do t'i bëjmë patjetër në tokat e këtyre koooperativave, ndryshe rritja e prodhimit në to do të ecë përpara ngadalë dhe me shumë vështirësi.

Pra, çështja shtrohet kështu, ose këto do të vahdojnë të qëndrojnë kooperativa dhe shteti t'i ndihmojë për të ecur përpara, ose do të futen nëpër ndërmarrje bujqësore, të cilat do të fillojnë të bëjnë menjëherë një punë të mirë dhe sistematike në tokat e tyre. Ne duhet të zgjedhim një nga këto dy rrugë. Personalisht jam me mendimin e shokëve, që thonë të mos i futim në ndërmarrje bujqësore të gjitha kooperativat që propozohen në variantin e parë, prandaj çështja le të studiohet edhe një herë, pse mund të dalë që është më mirë të futim, ta zëmë, vetëm tre-katër prej tyre. Këtë, mendoj, le ta shikojë Ministria e Bujqësisë me dikasteret e tjera, që e kanë bërë studimin.

Në studimin e paraqitur ka disa çështje që në llogaritë nuk gjejnë zgjidhje. Këto llogari mund të janë të drejta, por, nga sa shoh në material, nevojat e minierave të qymyrgurit, që janë me shumë rëndësi për ne, nuk janë pasur fare parasysh. Hapja dhe funksionimi i minierave të qymyrgurit të rrethit të Tiranës,

të cilat janë nga më të rëndësishmet në vend dhe mund të na japid mundësi që shumë nga minierat tona, që nuk kanë rentabilitet, të mos i shfrytëzojmë, kërkon nga kryeqyteti shumë forca pune. Mirëpo qyteti i Tiranës, edhe tani që ka rrëth 200 000 banorë, punon akoma me muratorët e Gollbordës. Vazhdimi misht flasim që këtu kemi kaq njerëz, kaq të rinj e të tjerë, por kur vjen puna të shikojmë konkretisht sa muratorë janë përgatitur nga qyteti i Tiranës, del që nuk ka asnje dhe kështu vazhdohet të ecet edhe sot. Prandaj lind nevoja që shumicën dërrmuese të forcave të punës për minierat e qymyrgurit ta marrim nga kooperativat afër Tiranës, por, po të mos i mekanizojmë në një shkallë të lartë punimet bujqësore në fushën e Tiranës, nuk kemi si t'i nxjerrim prej tyre këta qindra ose mijëra punëtorë që duhen për këto miniera.

Të gjithë ata që punojnë sot në Minierën e Mëzezit, që janë bërë punëtorë dhe kanë marrë e po marrin dita-ditës karakteristikat e klasës punëtore, kanë dalë kryesisht nga fshatrat e fushës së Tiranës. Në të ardhmen e afërt numri i punëtorëve të minierave të Tiranës do të dyfishohet e trefishohet, bile mund edhe të pesëfishohet përsëri me fshatarë tiranas, të cilët do të bëhen në to elementi më i fuqishëm i klasës punëtore të kryeqytetit. Minatorët janë më revolucionarë dhe më të kalitur nga tekstilistët dhe nga gjithë punëtorët e tjerë, se punojnë në kushte nga më të vështirat, ata futen çdo ditë 300-400 metra nën tokë. Sigurimi i fuqisë punëtore për basenin minerar të Tiranës, ku po krijohet gjithë kjo industri e madhe

qymyrguri, është edhe një nga arsyet më të rëndësishme që sot ose nesër zonën rrëth kryeqytetit duhet ta transformojmë me ritme të shpejta në një vend të zhvilluar industrial, me bujqësi të përparuar. Kështu duhet parë çështja për një të ardhme, që ne duhet ta përgatitim duke ruajtur kurdoherë vijën e drejtë politike të Partisë. Edhe ideologjikisht na lejohet që, për të përmirësuar furnizimin e Tiranës, të futim në ndërmarrje bujqësore katër ose pesë kooperativa, sepse janë kushtet të atilla që na e imponojnë këtë.

Pra, në qoftë se nuk do të kemi mundësi të futim menjëherë në ndërmarrje bujqësore 25 fshatrat koooperativiste të Tiranës, le të futim, fjala vjen, dy, por në to, me masat që do të merren, të shohim shpejt një përmirësim të theksuar. Po të kemi mundësi të futim më shumë, atëherë t'i japim forcë punës dhe të bëjmë llogari që shpenzimet t'i nxjerrim sa më shpejt, fjala vjen, nga dy vjet që mund të jetë afati zakonisht, të bëjmë përpjekje që t'i nxjerrim në një vit e gjysmë. Kështu duhet të veprojmë edhe përritjen e prodhimit të qumështit, të mos presim deri në vitin 1975 për të marrë 2 000 litra qumësht nga çdo lopë, por të punojmë që këtë sasi ta sigurojmë që në vitin 1970 ose, e shumta, në vitin 1972, duke luftuar përshtimin e prodhimit të misrit, të jonxhës dhe të foragjereve për ushqimin e tyre. Dhe kjo ka mundësi të bëhet, gjërsa Mézezi qysh tani ka arritur të marrë sasi të mëdha misri për hektar. Këtë eksperiencë ta zbatojnë edhe kooperativat e tjera në tokat e tyre.

Kështu t'i bëjmë llogaritë për të gjitha problemet, si përrrogat, stallat etj. Kiço Ngjela kundërshton, ai

nuk është dakord të bëhet bashkimi i këtyre kooperativave me ndërmarrjet bujqësore, sepse mendon që me këtë masë do të vështirësohet furnizimi i kryeqytetit, që edhe tani bëhet me vështirësi. Unë them se po të bëhen përpjekje, po të punohet e të prodhohet, siç shpjegova, gjendja nuk do të vështirësitet, e kundërt ka për të ndodhur. Çfarë vështirësie do të ketë, në qoftë se këto shpenzime i nxjerrim shpejt nga prodhimet që do të marrim?!

Të gjitha arsyetimet dhe preokupacionet e shokëve për këtë problem kanë qenë të drejta dhe me vend. Tani duhet të vendosim cila është rruga dhe masa më e arsyeshme që duhet të zgjedhim. Unë propozoj të futim një herë në ndërmarrje bujqësore dy-tre ose katër kooperativa, t'i organizojmë mirë ato, kurse futja e të tjerave të lihet për më vonë. Njëkohësisht, kooperativave që do të mbeten jashtë, t'ua shpjegojmë çështjen si duhet, që të jenë të qarta.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byroës
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

MALËSIA MUND TË PRODHOJË MË SHUMË QUMËSHT, MISH, GJALPË, DJATHË

*Letër drejtuar malësorëve të kooperativës bujqësore
të Lëpushës të krahinës së Kelmendit*

22 shtator 1969

Të dashur shoqe e shokë,

Letra juaj e thjeshtë dhe e dëlirë, si zemrat tuaja, më gjëzoi pa masë. Mbi të gjitha më gjuan sukseset e para fillestare të punës suaj të përbashkët të palodhur që keni arritur në zhvillimin e lopës dhe në prodhimin e qumështit.

Kur u takova parvjet me ju, malësorë trima të Kelmendit, ju sapo ishit bashkuar në kooperativë, nuk e kishit krijuar ende tufën e lopëve, por pata besim se do ta plotësonit këtë porosi të rëndësishme të Partisë, pse pashë në sytë tuaj jo vetëm patriotë të zjarrtë e sypatrembur si të parët tuaj, por edhe punëtore e punëtorë të palodhur, luftëtarë besnikë e të vendosur të vijës së drejtë të Partisë sonë të lavdishme, njerëz të urtë që fjalën s'e ndajnë nga vepra, që flasin pak, por punojnë shumë e me vetëmohim. Këto janë karakteristika shumë të çmuara të malësorëve tanë. Me

njerëz të tillë, me një popull të tillë të mrekullueshëm, siç është mbarë populli ynë, Partia ka ecur dhe do të ecë kurdoherë përpara pa u ndalur, do të kapërcejë çdo dallgë e furtunë, sado të rrepta që të jenë ato.

Duke zbatuar mësimet e Kongresit të 5-të të Partisë që edhe malet tonë të bëhen burim qumështi, mishi, gjalpi, djathi etj., ju krijuat vitin e kaluar një tufë lopësh prej 24 krerësh dhe arritët të merrni 644 litra qumësht nga çdo lopë foragjere, në krahasim me 172 litra që merrnit më parë, ndërsa nga lopët e racës keni marrë deri 2 000 litra qumësht. Për këto rezultate ju sigurisht luftuat pa u lodhur për zbatimin e vijës së drejtë të Partisë kundër koncepteve të ngushta e konservatore. Nëpërmjet shembullit konkret ju arritët të bindni e të tërhiqni pas vetes edhe ata shokë e shoqe që lëkundeshin e nuk kishin besim, duke çarë kështu përpara të gjithë së bashku, si vëllezër e motra për një qëllim të përbashkët, për forcimin e ekonomisë kolektive dhe për përmirësimin e jetës suaj. Mbi të gjitha, ju po mësoni të zhvilloni një blegtori të përparuar që t'u përshtatet kushteve klimatike dhe terrenit tuaj shumë të thyer, keni luftuar dhe luftoni kundër acarit e dëborës për të rrëmbyer tokën nga shkëmbinjtë e thepisur dhe nga shpatet e maleve. Edhe masat që keni marrë për strehimin dhe për ushqimin e mirë e të pandërprerë të lopëve si në verë, ashtu edhe në dimër, do t'ju lejojnë të arrini suksese të tjera më të mëdha në të ardhmen. Unë kam bindjen se, ashtu si kurdoherë, nën udhëheqjen e drejtë të Partisë dhe me ndihmën e organeve shtetërore dhe ekonomike të rrithet, ju do të mund të ngrini edhe pu-

nishte industriale të vogla moderne për përpunimin e qumështit, si dhe të prodhimeve të tjera bujqësore.

Rezultatet e arritura dhe zotimet e guximshme që merrni, janë një nxitje e madhe dhe frymëzim për suksese të reja në luftën për forcimin e mëtejshëm organizativo-ekonomik të kooperativës suaj, për rritjen e mëtejshme të ndërgjegjes dhe të hovit revolucionar në punë, për përmirësimin e kushteve të jetesës, për përparimin arsimor, kulturor e për higjienizimin e fshatit, për të zhvilluar edhe më fort luftën kundër fesë, zakoneve prapanike e gjithçkaje tjetër të vjetër konservatore e reaksionare që pengon zhvillimin tuaj dhe për ta çuar gjithnjë përpara edhe aty, në bjeshkët alpine, revolucionin tonë të pandalshëm.

Në të gjithë vendin tonë punohet me hov revolucionar për të pritur jubileun e lavdishëm të 25-vjetorit të Çlirimt me duar plot. Nga të katër anët e atdheut, nga Kelmendi e deri në Konispol, vijnë lajme të gëzueshme për rezultatet që arrijnë masat tonë punonjëse në revolucionarizimin e jetës në të gjitha drejtimet, në rritjen e vigjilencës revolucionare kundër çdo armiku, të jashtëm apo të brendshëm, dhe në plotësimin e në tejkalimin e detyrave të planit të katërt pesëvjeçar. Atdheu ynë i dashur socialist zbukurohet e lulëzon vazhdimi shqiptar dhe po bëhet çdo ditë më i fortë e më i begatshëm. Armiqtë tanë, imperialistët, revisionistët sovjetikë, titistët jugosllavë e të tjerë do të mposhten me siguri nga revolucioni, në ballë të të cilit qëndron edhe vendi ynë, nga marksizëm-leninizmi kurdoherë fitimtar dhe nga lufta e gjithë popujve të shtypur e të shfrytëzuar të botës.

Motra dhe vëllezër të dashur të Lëpushës,

Ju përgëzoj nga zemra për sukseset që keni arri-tur. Ato gjëzojnë mbarë popullin dhe Partinë tonë. Ju uroj me këtë rast të gjithë malësoreve e malësorëve trima të kooperativës suaj e të mbarë Kelmendit punë të mbarë, fitore të reja përherë e më të mëdha për forcimin dhe për zhvillimin e gjithanshëm të kooperativës suaj bujqësore për të mirën e popullit e të atdheut tonë dhe për të mirën tuaj. Qofshi kurdoherë me shëndet, të gëzuar e të lumtur!

Ju përqafoj

Juaji

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Jeta e re», organ
i Komitetit të Partisë të
Rrethit të Shkodrës, nr. 80
(269), 4 tetor 1969*

*Botohet sipas tekstit të ga-
zetës «Jeta e re», nr. 80 (269),
4 tetor 1969*

T R E G U E S I T

TREGUESI I LËNDËS

A

Aleanca, bashkëpunimi dhe kontradiktat sovjeto-amerikane — 35, 57-58, 74-86, 116-120, 157, 171-172, 209-210, 241-242, 271, 382-384, 385, 389, 390-391, 409-411, 425-426

Amerika Latine — lëvizjet dhe luftërat revolucionare të popujve latinoamerikanë — 365-366

Armiqtë e brendshëm, armiq-të e jashtëm; lufta kundër tyre — 96, 98, 111-112, 133-134, 135, 173, 186-187, 207-209, 218, 225-226, 230-231, 417-418, 423-425, 428-429

Arsimi

- politika e Partisë për revolucionarizimin e shkolles — 72-73, 120-121, 153-154, 205-207, 235-236, 244-256, 326-345, 360, 365, 414-415
- gërshetimi i mësimit, i punës prodhuese dhe i edukimit fizik e ushtarak — 47, 153-154, 235-

- 236, 248-249, 254-255, 327-328, 331-336, 341-342
- sistemi arsimor, struktura e shkollës — 46-47, 245-248, 249-253, 323-324, 339, 341-343
- tekstet, programet e shkollës — 72, 236, 247, 252, 327-328, 330, 332-333, 334, 336-337, 414
- arsimtarët, pedagogët — metoda dhe stili në punë, kualifikimi i tyre — 247-248, 330-336, 344

B

Banka e Shtetit, Banka e Kreditit Agrar — 28-31

Bashkimet Profesionale të Shqipërisë

- detyrat dhe roli i tyre për edukimin komunist dhe mobilizimin e punonjësve në ndërtimin socialist të vendit — 286-291, 298-299, 303-304, 458, 466-467

- roli dhe detyrat e tyre për përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetesës së punonjësve — 467-469

Bashkimi Sovjetik në kohën e Leninit dhe të Stalinit. Marrëdhëni me miqësore, internacionale të tij me Shqipërinë — 110, 112-113, 138-139, 211, 226-227, 429

Bashkimi Sovjetik. Revizionizmi sovjetik

- ardhja në fuqi e revizionizmit dhe rivendosja e kapitalizmit në BS. Kriza dhe disfatat e tij — 21, 33-34, 36, 58, 75-76, 165, 209, 228-229, 341-343, 418-419
- përpjekjet e revisionisteve sovjetikë për të ruajtur dhe forcuar hegemoninë mbi partitë revizioniste dhe mbi vendet revizioniste — 35-36, 38-40, 41, 58, 65, 118, 163-165, 167, 168-170, 210, 269-270, 273-275, 278, 380-381, 388, 395-396, 418-421, 427, 445
- shndërrimi i BS në një shtet fashist socialimperialist; politika e luftës dhe e agresionit — 33-34, 63-64, 68, 116-117, 118-120, 157, 387-388, 403-

- 404, 419-420, 425, 426-427, 442, 443-444

- politika demagogjike dhe mashtruese e revisionisteve sovjetikë — 74, 79-81, 113-114, 116-118, 159-160, 165-166, 170-171, 230, 266-268, 271-275, 276-278, 389-390, 442-443
- revisionistët sovjetikë — zjarrifikës të revolucionit dhe të luftërave nacionallçirimitare të popujve; bashkëpunimi i tyre me imperializmin dhe reaksionin — 82, 383-384, 389-391, 403-411

- presionet, veprimtaria armiqësore kundër Shqipërisë — 63-64, 69-70, 113-114, 139-140, 229-230, 269-270, 414

Blegtoria — zhvillimi dhe përmirësimi racor — 145-146, 148, 149-150, 198, 199, 239-240

Britania e Madhe, imperializmi anglez — 109, 111-112, 226
Bujqësia

- politika e Partisë dhe ndihma e shtetit për zhvillimin e bujqësisë — 27-29, 44-45, 145-146, 197-198, 233-234, 477, 478-479
- drithërat e bukës; rendimentet e kulturave buj-

- qësore — 146-147, 197-198, 240
- mekanizimi i bujqësisë — 25-26, 152
- pemëtaria, perimet, farërat — 147, 148-149, 198, 199-200
- Eurokratizmi, luftha kundër tij* — 16, 71-72

C**Çekosllovakia**

- agresioni dhe pushtimi ushtarak i Çekosllovakisë nga socialimperialistët sovjetikë — 34, 74-82, 167, 267, 272, 276-285, 387-388, 397-398, 418, 419
- klikat revizioniste në Çekosllovaki dhe ndërhyrja e revizionistëve sovjetikë për ndërrimin e tyre — 34, 77, 78-81, 84-85, 279-280, 419-420
- qëndrimi i popullit çekosllovak dhe i popujve të botës ndaj agresionit ushtarak sovjetik — 34-35, 85-86, 169, 278, 279, 284-285, 419

D*Dallimet ndërmjet klasës pu-*

- nëtore e fshatarësisë dhe rrugët për ngushtimin e tyre* — 22-24
- Dëshmorët, heronjtë* — 87, 89-90, 92-93, 108, 123, 130, 134-135, 208, 221-222, 226
- Dituria, përvetësimi i saj* — 234-235, 324-325, 339-340

E

- Edukimi komunist* — 24, 94, 110-111, 120-122, 140-143, 203-204, 234-237, 242, 304-308, 323, 325-326, 328-330, 360, 375-376, 415, 416-417, 431-432, 452-453, 457-469
- Ekonomia populllore* — zhvillimi ekonomik i vendit. Zhvillimi harmonik i industrisë e i bujqësisë — 24-25, 91-92, 143, 150, 377-378
- Engels, Frederik* — 237
- Enver Hoxha* — të dhëna autobiografike — 130-132, 138-139, 190, 191, 192, 195, 199, 214, 330, 355-356
- Europa. «Sigurimi evropian»* — 40-42, 49, 56, 68, 82-84, 405, 409-410

F

- Familja — krijimi i familjes së re socialiste; martesa* — 9,

100-101, 142-143, 416

Feja, zakonet prapanike; luf-
ta kundër tyre — 10, 94-95,
 100-103, 142

Folklori — 10, 313

Forcat e kufirit — 449-456

Franca — 66, 427-430

Fronti Nacionalçlirimtar në
Shqipëri — përvoja e PKSH
 për krijimin dhe forcimin e
 tij — 354-356

Fshatarësia — puna e Partisë
 me fshatarësinë; roli dhe pje-
 sëmarrja e saj në Luftën Na-
 cionalçlirimtare dhe në ndër-
 timin socialist të vendit —
 22-23, 44-45, 143-144, 366-
 367, 434

Fuqia punëtore — 26-27, 299-
 300, 468-469, 484-485

G

Greqia — 226, 426

Gruaja shqiptare — politika
 e Partisë për emancipimin e
 plotë të saj — 51-52, 136-137,
 194-196, 224-225, 261-264

GJ

Gjermania, imperializmi gjer-
man (RFGJ). Problemi gjer-
man — 41, 66, 81, 83-34, 109-
 110, 404, 405-410

Gjykatat popullore — 415-416

H

Historia e Shqipërisë. Ngjar-
je historike; njohja dhe stu-
dimi i tyre — 126-128, 217-
 218, 309-315

Hungaria, revisionistët hun-
garezë — 59, 283

I

Imperializmi — karakteri
 agresiv; kriza dhe disfatat e
 tij — 64, 81, 418

Industria e rëndë
 — zhvillimi i industrisë në
 vendin tonë — 21-22, 151-
 152, 201-202

— industria energjetike.
Elektrifikimi i vendit —
 152, 238-239

— industria minerare —
 150-152, 201, 231, 232,
 483-485

Iniciativat, lëvizjet revolucio-
nare të masave — 45-46, 47,
 48

Interesi i përgjithshëm dhe
 interes i vetjak — 140-142, 462-
 463, 464-465, 466

Internacionalizmi proletar —
 38-39, 42-43, 49, 95, 112-113,
 114, 138-139, 157-159, 226-
 227

Italia, imperializmi italian;
qëndrimi ndaj Shqipërisë —

40, 42, 66, 225-226, 347, 348,
350-351

J

Jugosllavia, revizionizmi ju-
gosllav

- kriza politike dhe ekonomike, thellimi i kontradiktave të brendshme në Jugosllavi — 26, 36, 37, 39, 61-62, 422-423
- politika e jashtme. Klikëtitiste — agjenturë e imperializmit amerikan. Ndërhyrja e kapitalit të huaj në Jugosllavi — 37, 38, 51, 59-62
- kërcënimet ushtarake sovjetike kundër Jugosllavisë. Qëndrimi parimore i RPSH ndaj këtij problemi — 36-39, 61-64, 421-422, 423-425, 447-448

K

Kapitalizmi — 25, 26, 67
Këshillat popullorë — karakteri demokratik, përbërja, de-tyrat, metoda dhe stili i punës së tyre — 258-264
Kina — synimet sovjeto-amerikane ndaj Kinës — 270, 271, 272, 426

Klasa punëtore — edukimi komunist i saj, lufta kundër shfaqjeve të huaja — 22-23, 24, 235-236, 331, 457-468

Koha, ekonomizimi i saj — 247-248, 330-332, 333, 467-468

Kolektivizimi socialist i bujqësisë. Kooperativat bujqësore

- kolektivizimi i bujqësisë në zonat fushore e malore. Solidarësia dhe ndihma midis kooperativave — 45-46, 145-146, 158
- bashkimi i kooperativa ve bujqësore. Shndërrimi i tyre në ndërmarrje bujqësore — 44-45, 144-145, 479-483, 485-486
- të ardhurat. Shpërblimi i punës në kooperativat bujqësore — 19-20, 29-30

Komunikacioni — 231-232, 436-441

Komunisti — figura, cilësitë e komunistit; edukimi dhe kilitja revolucionare e tij — 223-224, 360-361, 416-417, 451-452

Komunizmi — 24, 222, 236-237, 238

Kongresi Antifashist Nacionallçlirimtar i Përmetit (24 maj 1944) — 87-88, 104-108

Kontradiktat në botën e sotme kapitaliste dhe revisionis-

*te — 40-42, 56-59, 109-110,
391-398, 443*

Kosova dhe popullsia shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi. Terrori, masat shkombëtarizuese të revizionistëve jugosllavë kundër tyre — 316-320, 423

Kuadrot, specialistët; përgatitja dhe kualifikimi i tyre — 4-5, 71-72, 184-185, 204-205, 245-247, 249-250, 252, 253-254, 414-415

Kultura, zhvillimi i saj; aktivitetet kulturore — 98-99, 449-450

L

Lenin, Vladimir Iliç — 112, 114, 116, 117, 158-159, 227, 238, 258, 268, 341-342, 384-385, 393-394, 434

Lëvizja marksiste-leniniste ndërkombëtare

- strategjia dhe taktikat e partive m-l — 41-42, 430-434
- forcimi dhe zgjerimi i saj. Krijimi i partive të reja m-l — 41-43, 208-209, 400-402
- uniteti, spastrimi nga elementët armiq dhe lidhjet me masat — parime të rëndësishme për forcimin e partisë m-l —

348-349, 363, 367-369, 370-374, 375, 429-434

— organizimi ilegal i partisë m-l dhe bashkërenditja e punës legale me atë ilegale — 49-51, 431

— takimet dhe shkëmbimi i përvojës ndërmjet partive m-l — 49, 346, 361-362, 363-364, 365-366, 368-370, 412, 428, 429-435

Shih edhe: Partitë komuniste në rubrikat përkatëse

Lëvizjet dhe luftërat nacionallçirimitare e revolucionare të popujve — 85-86, 156, 208-209, 210-211, 384-385

Liberalizmi, lufta kundër tij — 12-13, 17

Ligjet, legjisacioni; njohja dhe zbatimi i tyre — 259-260, 299, 415

Ligjet objektive të zhvillimit të shoqërisë — 135-136, 298, 460-461

Lindja e Mesme; pazarllëqet sovjeto-amerikane në këtë zonë — 68, 385, 425-426

Lufta Antifashiste Nacionalçirimitare e popullit shqiptar — problemi i pushtetit problem themelor i saj —

*106, 108-109, 182-183
— rëndësia, mësimet, përvoja e kësaj lufte — 132-134, 207, 220-222*

M

Marks, Karl — 114, 237, 283, 320, 333

Marksizëm-leninizmi — busull dhe udhëheqje për veprim. Zbatimi i tij në kushte konkrete — 20, 223, 230, 325-326, 328-329, 330, 339-340, 341-342, 343, 367-369, 428-429, 445-446

Mbështetja në forcat e veta — 111-115, 137

Mbrojtja e atdheut. Forcimi i aftësisë mbrojtëse. Përgatitja e masave popullore përmbrojtje — 96-97, 122-123, 135-136, 155-156, 157, 186, 206, 211-212, 254-255, 270, 424-425, 445-446

Ministratë

- Ministria e Arsimit dhe e Kulturës — 254, 327, 336, 343-344

- Ministria e Bujqësisë — 28-29, 477-478, 483

- Ministria e Punëve të Brendshme — 453-454

Minoriteti grek në Shqipëri — politika e PPSH ndaj tij — 6-10, 188-189

Mirëqenia materiale dhe *ngritura e nivelist kulturor* të masave punonjëse — 2-3, 22-24, 27, 196, 199-200, 376-377

N

Ndërtimet — ritmet, perspektiva e zhvillimit të ndërtimeve — 1-5, 47-48, 151, 152, 192-194, 201-202

Ndërtimi i socializmit në Shqipëri — politika e Partisë për ndërtimin socialist të vendit, për konsolidimin e tij dhe për ta çuar deri në fund revolucionin — 20-21, 23-24, 27, 43-48, 87-88, 90-91, 98, 110-111, 120, 154, 183-186, 187-188, 190-191, 222-223, 227-228, 412-414

Ndihmat, kreditë ndërmjet shteteve; *kuptimi marksist-leininist i tyre* — 113-115, 138-140, 226-227, 229

O

Organizata-bazë e Partisë — 303-304, 322-323

P

Partia e Punës e Shqipërisë

- lufta kundër armiqve dhe veprimtarisë armiqësore e antiparti brenda në Parti — 356, 357-359, 370-371

- lufta e saj kundër impe-

- rializmit dhe revizionizmit modern — 35, 68-69, 140, 211, 228-229, 230, 241-242, 275
- Partia e Punës e Shqipërisë — ndërtimi, organizimi dhejeta e brendshme e saj*
- organet udhëheqëse qendrore të Partisë. Metoda dhe stili i punës së tyre. Ndiarma dhe kontrolli për bazën — 254, 255-256, 292-298, 302-303, 321-323, 358-359
 - Kongresi V i PPSH — 145, 413, 488
 - Plenumi i 8-të i KQ të PPSH (26-28 qershor 1969) — 321-345
 - organet udhëheqëse lokale të Partisë. Metoda dhe stili i punës së tyre. Ndiarma dhe kontrolli për bazën — 292-293, 304
 - pranimet në Parti, kandidatët e Partisë — 155, 184-185, 224-225, 417
 - qëndrimi kritik, objektiv i Partisë ndaj të metave dhe gabimeve — 323, 372-373
- Partia e Punës e Shqipërisë — vija politike*
- roli udhëheqës i saj në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare — 49-53, 105-110, 182-183, 431, 432-433
 - vendime, direktiva, detyra të Partisë — studimi dhe zbatimi i tyre — 30-31, 190-191, 244-245, 461-462, 463-464
- Partia Komuniste e Brazilit — 369*
- Partia Komuniste e Cejlonit — 48-49*
- Partia Komuniste e Italisë (m-l) — 42, 346, 348-349, 350-351, 361-364*
- Partia Komuniste M-L e Francës — 427-428, 431*
- Partia Komuniste Peruane — 365, 366, 367-368, 369-374, 375*
- Plani i katërt dhe i pestë pesëvjeçar — 231-232, 233*
- Politika e jashtme dhe pozita ndërkombëtare e RP të Shqipërisë*
- rritja e prestigjit të RPSH në botë; përkrahja internacionale e partive m-l dhe e popujve të botës për PPSH dhe RPSH — 97, 107, 159, 352-354, 433
 - qëndrimi i RPSH ndaj shteteve fqinjë dhe vendeve të tjera — 38-39, 55-56, 62-63, 212-213, 446, 448

- qëndrimi parimor ndaj Kosovës dhe popullsisë shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi — 316-320
- Politika — kuptimi politik i problemeve — 141-142, 299, 300-301*
- Polonia, revizionistët polakë — 59, 83-84*
- Populli shqiptar*
- traditat patriotike, përparimitare e kulturore. Luftërat e tij kundër pushtuesve të huaj dhe regjimeve antipopullore — 89-90, 96-97, 99, 124-128, 130-133, 134, 135-136, 191-192, 204, 216-220, 221, 309-315
 - pjesëmarrja dhe roli i tij në Luftën Nacional-çlirimtare dhe në ndërtimin socialist të vendit — 90-93, 94-95, 106-108, 137, 182, 226-227, 228, 414
- Prona — 44-45*
- Puna — organizimi dhe normimi i saj — 3-4, 300-303, 461-466*
- Pushteti popullor — formë e diktaturës së proletariatit, karakteri demokratik, lidhjet e tij me masat — 106, 109, 184-185*
- R**
- Revizionistët australianë — 267*
- Revizionistët italianë — 66, 281, 347-348, 349-350, 392, 396-397*
- Revizionizmi modern*
- revizionistët modernë — armiq të m-l dhe të revolucionit. Politika demagogjike e tyre — 21, 65, 173-174, 175, 213-214, 266-269, 270-271, 380-391
 - kontradiktat, kriza në gjirin e revizionizmit modern; përcarja dhe disfatat e tij — 58-66, 163, 166-169, 172-173, 174-175, 380-381, 391-398, 418, 443
 - Mbledhja e partive revizioniste në Moskë (5 qershor 1969) — 58-59, 76-77, 159-160, 163-176, 265-275, 276-285, 379-401
 - lufta e forcave m-l, e klasës punëtore dhe e popujve kundër revizionizmit modern — 35, 175-176, 398-402
- Revolucioni proletar. Forcat lëvizëse të tij — 187, 208, 210, 367-370*
- Rilindja Kombëtare Shqiptare, patriotët e Rilindjes — 124-128, 218, 312-313*

Rinia — edukimi i saj me traditat patriotike përparimtare dhe me virtytet më të mira të popullit tonë — 51, 53, 72, 99-100, 121-122, 153-154, 206-207, 337-338, 414 Roli i njeriut dhe i armëve në luftë — 16, 33, 97 Rumania, revizionistët rumunë — 35-36, 64-65, 420-422, 445

RR

Rrethimi imperialisto-revizionist i Shqipërisë dhe lufta për përballimin e tij — 32-33, 64, 155-156, 241-242, 424

S

Sekreti — 13-16 Stalin, Josif Visarionovic — 112, 116, 138-139, 159, 209, 211, 227, 237, 325-326

SH

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, imperializmi amerikan — strategja globale, politika e luftës, e agresionit dhe e sundimit — 38, 67-68, 109, 117-118, 157, 173-174, 210, 374-375 — politika demagogjike, ma-

shtruese — 67-68, 114, 119-120 — veprimtaria armiqësore kundër Shqipërisë — 51, 111-112 Shtypi dhe propaganda borgjeze e revizioniste — 43, 69-70, 79, 83-84, 112, 272, 280

T

Teoria dhe praktika, lidhja midis tyre — 325-326, 328-329, 330-336

Teoritë revizioniste — kritikë pikëpamjeve të revizionistëve hruščovianë mbi paqen, luftën, «bashkekzistencën paqësore» dhe «sovranitetin e kufizuar» — 115-118, 213, 273-274, 283, 386-387, 397-398

Tregtia e brendshme, furnizimi i popullsisë — 476-486

TII

Thashethemet, lufta kundër tyre — 469-475

U

Uniteti moralo-politik i popullit shqiptar rreth Partisë — 94, 155, 156, 160-161, 190, 214, 223

Ushtria Popullore — rritja e nivelit dhe e efektivitetit të

punës politike në ushtri —
11-18

V

*Vietnam — lufta e popullit
vietnamez kundër agresorëve
amerikanë. Përpjekjet e revi-*

*zionistëve sovjetikë për sabotimin e saj — 71, 82, 274, 385
Vigjilanca revolucionare —
32-33, 97-98, 185, 208, 241,
370, 427
Vija e masave, tërheqja e
mendimit të tyre — 46, 47-
-48, 89, 155, 205-206, 321-
-323, 336, 361, 430*

TREGUESI I EMRAVE

A

Alia, Ramiz — 287, 362
Aleksandri i Madh i Maqedenisë — 217
Amendola, Xhovani — 350
Avdalli, Xhevati — 196

B

Bakiri, Subi — 129-130
Bektashi, Haxhi — 101-102
Benediktov — 62
Berlinguer, Henriko — 350,
396
Bonaparti, Napoleon — 219-
-220
Brand, Vili — 83, 409
Brezhnjev, Leonid — 65, 75-
-76, 265-266, 269, 270, 271-
-272, 273, 282, 284, 390, 400,
408-409, 423
Buhali, Larbi — 274

C

Carapkin — 406
Ciu, Mitat — 202-203

D

Dervishi, Rrapo — 129-130
Dë Gol, Sharl — 41, 66
Dizdareviç, Nijaz — 51
Dohnan, Klaus fon — 405
Donzëlo, Fransua — 220
Dragoti, Shinasi — 437
Dubçek, Aleksandër — 35, 75,
78-79, 279, 418, 419-420, 445

DH

Dhrami, Muntaz — 309-310

F

Frashëri, Faslli — 354-355
Frashëri, Mehdi — 108, 354-
-355
Frashëri, Mithat (Lumo Skëndo) — 108, 187

G

Gomulka, Vladislav — 59, 65,
445

Greçko, Andrei — 77, 169, 388
 Gromiko, Andrei — 406, 408
 Guevara, Ernesto Çe — 374

GJ

Gjergjia, Josip — 51

H

Hoxha, Nexhmije — 29, 129-
 -130
 Hadëri, Shaban — 309-310
 Haskaj, Zenel — 222
 Helms, Riçard — 78
 Hitler, Adolf — 81, 109-110
 Hrushov, Nikita — 59, 60, 139,
 140, 163, 168, 266, 268-269
 Husak, Gustav — 34, 79-81,
 84, 273, 279-280, 281-283, 284,
 405

J

Jakova, Tuk — 357

K

Kapo, Hysni — 287, 437, 452
 Kapo, Vito — 259
 Kadar, Janosh — 59, 283, 446
 Kardinali, Tercilio — 352
 Castro, Fidel — 375

Këlcyra, Ali — 108, 141, 187
 Kizinger, Kurt — 407, 409
 Kosigin, Aleksei — 75-76, 270,
 271, 278, 282, 284, 390, 400,
 408-409, 447
 Kupi, Abaz (Bazi i Canës) —
 354-355

L

Libohova, Myfit — 178
 Longo, Luixhi — 350
 Luari, Nexhmedin — 19
 Lula, Anastas — 357

M

Myftiu, Manush — 249
 Macedo, Saturnino Paredes —
 365-367, 370, 371-372, 373-
 -374, 375
 Mara, Hekuran — 19
 Matohiti, Mustafa — 222
 Mehmeti II, sulttan — 217
 Mile, Athina — 100
 Mosadek, Mohamed — 67-68
 Murati II, sulttan — 217

N

Nagi, Imre — 59, 283
 Naser, Gamal Abdel — 425,
 426
 Ngjela, Kiço — 485-486

Nikson, Riçard — 73, 82, 171-
-172, 384, 409, 421

SH

Noli, Fan — 182

Shehu, Abaz — 222

P

Shehu, Agim — 313

Shil, Helmut — 408

Shmid, Helmut — 408

Peçi, Shefqet — 129-130
Polianski, Dimitër — 408

T**Q**

Tashko, Koço — 357

Tepelena, Ali pashë — 131,
219-220

Qemali, Ismail — 312

Tito, Josif Broz — 36-37, 38,
39, 40, 51, 59-62, 63, 140, 225,
421, 422-423, 424

R

Toptani, Esat pashë — 179,
180

Rama, Kristaq — 309-310

Topulli, Ago — 125

Rankoviç, Aleksandër — 36,
63, 318

Topulli, Bajo — 124-125

Runa, Vehib — 141

Topulli, Çerçiz — 124-125, 208

Rustemi, Avni — 177, 178-
-183, 186

U

Ulbrecht, Valter — 270, 445

S**V**

Salaria, Selam Musa — 225

Vid, Vilhelm — 179

Skënderbeu, Gjergj Kastrioti
— 217-218

Spahiu, Bedri — 357

Spahiu, Xhafer — 295

Svoboda, Ludvig — 278

XH

Xhelo, Halim — 180

Y

Ypsilant, Aleksandér — 220

Zeneli, Asim — 222
Zogu, Ahmet — 108, 178, 181,
182, 184, 356

Z

Zatopek, Emil — 79

ZH

Zhivkov, Todor — 64, 445

TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

B

«Bashkimi» (shoqëria ~) — 180-181

Bisedimet e Gjenevës për kufizimin e armëve bërthamore — 171-172

Bullgari — 38, 270, 422, 426

C

Cejlon — 48

D

Deti i Zi — 426

Dofti (rezervuari ~, Gjirokastër) — 188

Drejtoria Politike — 14

«Drita» (gazeta ~) — 313-314

Dropull (Gjirokastër) — 7-8, 188-189

E

Egjipt — 68, 425, 426

Enciklopeditë e Evropës — 219

F

Fabrika e Çimentos — Vlorë — 438

Fabrika e Llambave Elektrike — Vlorë — 438

Fabrika e Pllakave prej Eterniti — Vlorë — 438

Fabrika e Sapunit — Vlorë — 438

Fabrika e Vajit — Vlorë — 441

G

Golem (Gjirokastër) — 147

GJ

Gjirokastër — 5, 153, 190-196, 200-201, 202-203

H

Hekurudha Fier-Ballsh — 232

Hekurudha Vlorë-Fier — 438

Hidrocentrali i Fierzës — 152, 239

Hidrocentrali i Vaut të Dejës — 152

I

Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste — 19, 29, 254

Instituti i Lartë Bujqësor — 253

Instituti i Lartë i Arteve — 246-247

Instituti i Studimeve Ekonomike — 28, 29

Internacionalja e Dytë — 325-326

Izraeli — 425

K

Kajro — 425

Kanali i Suezit — 68, 425, 426

Karaburun (gadishulli ~) — 436, 439

Kelmend (Shkodër) — 487

Kombinati i Konservimit të Peshkut — Vlorë — 438

Kombinati i Tekstileve — Berat — 467-468

Kombinati Metalurgjik — Elbasan — 151

Konferenca e Munihut — 410

Konferenca e Potsdamit — 407

Kooperativa bujqësore e Lakanasit — 480

Kooperativa bujqësore e Lëpushës — Kelmend — 487-490

Kooperativa bujqësore e Mëzezit — Tiranë — 485

Korfuz (ishulli ~) — 220

«Kristçën sajëns monitor» (gazeta ~) — 79

Kurvelesh (krahina ~) — 129-130, 132-133, 158, 161

L

Labëri (krahina ~) — 129-133, 134-135, 136, 141, 150-151, 153, 158, 161, 224

«Lë Mond» (gazeta ~) — 79

Libohovë (Gjirokastër) — 177-178, 188-189

Lindja e Largme — 407

Lufta e Vlorës — 225

LL

«Llaiko vima» (gazeta ~) — 8

M

Mali i Gjerë — 193

Mali i Zi — 316-317, 318, 319

Manastir (Jugosllavi) — 317-318

- Maqedoni — 316-320
 Memaliaj (Tepelenë) — 231,
 232
 Mesdhe (deti ~) — 74, 425,
 426
 Mezgoran (Tepelenë) — 222
 Milano (Itali) — 351
 Miniera e Mëzezit — Tiranë
 — 484-485
 Minierat e Memaliajt dhe të
 Pishkashit — 295
 Minierat e qymyrgurit të Ti-
 ranës — 483-485
 Monumenti i Shpalljes së Pa-
 varësisë — 309-315
 Moskë — 163, 165, 166
 Muzeu historik — Gjirokastër
 — 124-128

N

- Napoli (Itali) — 350, 351
 NATO — 38, 41, 64, 83, 354,
 424, 426
 Ndërmarrja Bujqësore e Kam-
 zës — Tiranë — 480
 Ndërmarrja Bujqësore e Thu-
 manës — Krujë — 478-479,
 481

- Ndërmarrja Bujqësore e Suk-
 thit — Durrës — 478-479
 «Novi drogi» (revista ~) —

84

- O**
 «Oservatore dela domenika»
 (e përvjavshmjë ~) — 81
 Oder-Najse (vija ~) — 83,
 84

P

- Paris — 178-179, 220
 Partia Demokristiane e Italisë
 — 66
 Partia e Lirë Demokrate e
 Gjermanisë Perëndimore —
 408
 Pashaliman (Vlorë) — 436
 Pashallëku i Janinës dhe ai
 i Shkodrës — 219
 Pentagon — 67
 Perandoria Osmane — 217,
 219
 Peru — 367
 Përmet — 87, 89, 93, 95-96,
 98-99, 101-102, 104-105
 «Përpara bustit të Selam Mu-
 sait» — (baladë, A. Shehu)
 — 313-314
 Porti i Durrësit — 437
 Porti i ri i Vlorës — 437-438
 Pragë — 80, 82, 85
 «Pravda» (gazeta ~) — 280
 Progonat (Tepelenë) — 222

R

- Radio Moska — 69

Rafineria e Naftës — Ballsh
— 232

Reforma Agrare — 143, 228

Revolucioni Demokratiko-Bor-
gjez i vitit 1924 në Shqipëri
— 179, 181-182

Revolucioni i Madh Socialist
i Tetorit — 227

S

Sanxhak (Krujë) — 257

Sazan (ishulli ~) — 436

Skela e Vlorës — 440

SH

Shëngjergj (Tiranë) — 355-356

Shkolla e Partisë «V. I. Lenin»
— 304

Shkup (Jugosllavi) — 317-318

Shqipëria e Jugut — 158, 437

Shqipëria e Veriut — 158

T

TASS — 407

Tepelenë — 216, 219, 221-223,
224, 225, 237-238, 240-241,
242-243

Tetovë (Jugosllavi) — 317-318

Tiranë — 50, 182, 476-486

Traktati i fshehtë i Londrës
(prill 1915) — 158-159

Traktati i Varshavës — 65,
82, 83, 421, 443-444

Treport (Vlorë) — 437-438

U

Uji i Ftohtë (Vlorë) — 440-
-441

Universiteti i Tiranës — 139,
253

Usur (lumi ~) — 62, 74, 390,
406

Uzina e Plehrave Fosfatike
— Laç — 232

Uzina e Polivinilkloridit —
Vlorë — 438

Uzina e Sodës — Vlorë —
438

V

Vatikan — 81

Vendet arabe — 274

Vjosë (lumi ~) — 238

Vlorë — 45-46, 181-182, 193,
436-441

Z

«Zëri i popullit» (gazeta ~)
— 8, 62-63, 352, 422, 432

«Zëri i rinisë» (gazeta ~) — 8

Zvërnec (Vlorë) — 437-438

LËNDA

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 41-të V—IX

1969

OBJEKTET SOCIALKULTURORE NË FSHAT JANË TË DOMOSDOSHME PËR POPULLIN — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (5 maj 1969)	1—5
MINORITARËT GEZOJNE TË GJITHA TË DREJ- TAT SI ÇDO QYTETAR I REPUBLIKËS SONË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (5 maj 1969)	6—10
PUNA POLITIKE NË USHTRI TË NGRIHET NË NJË NIVEL MË TË LARTË — Diskutim në mble- dhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (5 maj 1969)	11—18
MEKANIZIMI I BUJQËSISË DO TË BËHET NË PËRSHTATJE ME SITUATAT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (6 maj 1969)	19—31
KUPTIMI DHE ORGANIZIMI DREJT I PUNËS ILE- GALE E LEGALE TË PARTISË — ÇËSHTJE THEMELORE E REVOLUCIONIT — Nga biseda me një delegacion të PK të Cejlonit (17 maj 1969)	32—54
SITUATA NË EVROPËN PLAKË KËRKON INTEN- SIFIKIMIN E LUFTËS KUNDËR KAPITALIZMIT E REVIZIONIZMIT — Nga biseda me ambasadorin kinez (22 maj 1969)	55—73

ALEANCA SOVJETO-AMERIKANE NË VEPRIM KUNDËR POPULLIT ÇEKOSLOVAK — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (23 maj 1969)	74—86
JEMI BIJ DHE USHTARE TË POPULLIT E TË PARTISE QË NUK PLAKEN KURRË — Fjala gjatë vizitës në sallën ku zhvilloi punimet Kongresi i Përmetit (24 maj 1969)	87—88
JU RRITËT ATA HERONJ E HEROINA, GJAKU I TË CILEVE ËSHTË NË THEMELET E SHQIPERISË SË RE SOCIALISTE — Fjala në takimin me pjesëtarë të familjeve të dëshmorëve të rrithit të Përmetit (24 maj 1969)	89—103
VENDIMET HISTORIKE TË KONGRESIT TË PËRMETIT U BËNË ZJARR I PASHUAR PËR POPULLIN — Fjala në pritjen e dhënë me rastin e 25-vjetorit të Kongresit të Përmetit (24 maj 1969)	104—123
NJË MUZE — MONUMENT I RËNDËSISHMËM HISTORIK — Nga biseda pas vizitës në Muzeun historik të Gjirokastrës (26 maj 1969)	124—128
LABËRIA — NJË NGA KOLONAT MË TË ÇELIK-TA TË PARTISE — Fjala në mitingun e Picarit të rrithit të Gjirokastrës (27 maj 1969)	129—162
NË PRAG TË FARSES REVIZIONISTE TË MOSKËS — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (28 maj 1969)	163—176
VRASJA E AVNI RUSTEMIT NGRITI NË KËMBË GJITHË POPULLIN — Fjala në mitingun e qytetit të Libohovës (28 maj 1969)	177—189
TA RUAJMË QYTETIN E GJIROKASTRËS, KËTË XHEVAHIR TË ARKITEKTURËS SË POPULLIT — Fjala në mitingun e qytetit të Gjirokastrës (28 maj 1969)	190—215

TË JEMI TË ARMATOSUR ME ARMË, TË NGRI-TUR POLITIKISHT DHE TË MOBILIZUAR NË PUNË — Fjala në mitingun e qytetit të Tepelenës (29 maj 1969)	216—243
STRUKTURA E SHKOLLËS T'U PËRGJIGJET NEVOJAVE TË NGUTSHME TË EKONOMISË SONË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (5 qershori 1969)	244—256
KËSHILLI POPULLOR ëSHTË PËRFAQËSUES I VULLNETIT TË POPULLIT — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor (7 qershori 1969)	257—264
ZJARR KUNDËR TRADHTISE REVIZIONISTE — Artikull i botuar në gazeten «Zëri i popullit» (10 qershori 1969)	265—275
PSE REVIZIONISTËT SOVJETIKE KANË FRIKË TË FLITET PËR ÇEKOSLOVAKINË NË MBLEDHJEN E MOSKËS? — Artikull i botuar në gazeten «Zëri i popullit» (14 qershori 1969)	276—285
EFEKTET E PUNËS EDUKATIVE TË PARTISË DUKEN NË QËNDRIMIN E NJERËZVE NDAJ PUNËS — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (20 qershori 1969)	286—291
ÇDO FORUM I PARTISË MË PARË DUHET TË USHQEHET QË TË USHQEJË EDHE AI — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (20 qershori 1969)	292—308
NË GURREN E PASHTERSHME TË KRIJIMTARISSË SË POPULLIT DO TË GJEJMË FRYMËZIM TË MADH PËR VEPRA TË BUKURA — Letër drejtuar skulptorëve Kristaq Rama, Muntaz Dhrami e Shaban Hadëri (26 qershori 1969)	309—315

TERRORI RANKOVIÇIAN MAQEDONAS — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (28 qershori 1969)	316—320
NË ÇDO PUNË TË ZBATOJMË NJË METODË DHE STIL LENINIST REVOLUCIONAR — Fjala në Plenumin e 8-të të KQ të PPSH (28 qershori 1969)	321—345
FUTJA E KOMUNISTIT NË MASA DHE TËRHEQJA E TYRE NË REVOLUCION KËRKOJNË ZGJUARSI DHE MPREHTËSI MARKSISTE-LENINISTE — Nga biseda me një delegacion të PK të Italisë (m-l) (12 korrik 1969)	346—364
OBJEKTIVAT ARRIHEN ME AKSIONE REVOLUCIONARE DHE JO ME DISKUTIME SHTERPE — Nga biseda me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë Komuniste Peruane, Saturnino Paredes Macedo (12 korrik 1969)	365—378
ANTIIMPERIALIZMI FALS — MASKË KUNDERREVOLUCIONARE E REVIZIONIZMIT HRUSHOVIAN — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (15 korrik 1969)	379—402
FORCIMI I LIDHJEVE MIDIS MOSKËS E BONIT — PJESE PËRBËRËSE E STRATEGJISË GLOBALE KUNDERREVOLUCIONARE AMERIKANO-SOVJETIKE — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (28 gusht 1969)	403—411
FITORJA SIGUROHET VETËM PO TË UDHËHIQESH NGA TEORIA MARKSISTE-LENINISTE — Nga biseda me disa komunistë francezë (28 gusht 1969)	412—435
E ARDHMJJA E VLOREŠ — Shënime (Gusht 1969)	436—441
POPUJT NUK MPOSHTEN AS NGA TANKET, AS NGA DIPLOMACIA E REVIZIONISTËVE SOVJETIKE — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (4 shtator 1969)	442—448

KUFITARIN TA EDUKOJMË KURDOHERË ME FRYMËN DHE ME DISIPLINËN E RREPTË TË PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (12 shtator 1969)	449—456.
TË VAZHDOJMË ME KËMBËNGULJE DHE NË MËNYRË METODIKE EDUKIMIN E GJITHAN- SHËM TË KLASËS PUNËTORE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (12 shtator 1969)	457—475
SHFRYTËZIMI I MUNDËSIVE PËR FURNIZIMIN E TIRANËS DO TË LEHTËSOJË FURNIZIMIN E MBARË VENDIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (13 shtator 1969)	476—486.
MALËSIA MUND TË PRODHOJË MË SHUMË QU- MËSHT, MISH, GJALPË, DJATHË — Letër drejtuar malësorëve të kooperativës bujqësore të Lëpushës të krahinës së Kelmendit (22 shtator 1969)	487—490.
TREGUESI I LËNDËS	493
TREGUESI I EMRAVE	505
TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA	509.

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1984

